

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuza i njëzetepesë)

nga ajeti 47 i sures "Fusilet" e mbyllet me ajetin 32 të sures
"Xhathije"

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***
(Xhuзи i njëzetepestë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***Edmond ABAZI***

E redaktoi: ***Viktor SHARRA & Esat BUNGURI***

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Ajetet 47 - 48

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِلَيْهِ يُرَدُّ عِلْمُ السَّاعَةِ وَمَا تَخْرُجُ مِنْ ثَمَرَاتٍ مِنْ أَكْمَامِهَا وَمَا
تَحْمِلُ مِنْ أُنْثَى وَلَا تَضَعُ إِلَّا بِعِلْمِهِ وَيَوْمَ يُنَادِيهِمْ أَيْنَ شُرَكَائِيَ قَالُوا
أَذْنَابُكَ مَا مِنَّا مِنْ شَهِيدٍ^٧ وَضَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَدْعُونَ مِنْ قَبْلُ
وَوَظَنُوا مَا لَهُمْ مِنْ حَافِظٍ^٨

Me Emrin e All'lahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!

“Vetëm All'lahu e di se kur do të vijë Ora. Kurrfarë fruti nuk mund të dalë prej kupës së lules dhe asnjë femër nuk mund të mbetet shtatzanë apo të lindë pa dijeninë e Tij. Ditën kur Ai t'i thërrasë njerëzit e t'u thotë: 'Ku janë ata zota që i quanit si ortakët e Mi?', ata do të përgjigjen: 'Askush prej nesh nuk dëshmon sot se ata janë ortakët e Tu.'”

“Idhujt, që ata i adhuronin më parë, do t'i zhgënjëjnë dhe ata do ta dinë se nuk ka më shpëtim.”

Komentimi

All'llahu është i Gjithëditur për çdo gjë

Ajeti i fundit nga seria e mëparshme fliste për ligjin e ngarkimit të njeriut, përgjegjësinë e punëve të tij, të mira qofshin apo të këqija, dhe kthimin e dobisë së punës së tij ndaj vetes, çka është një tregues i përgjithshëm në çështjen e sevapit dhe dënimit në Ditën e Kiametit.

Këtu idhujtarët shtruan këtë pyetje: Kur do të jetë ky Kiamet, për të cilin ti po flet? Dy ajetet që po komentojmë, në fillim i përgjigjen kësaj pyetjeje, ku Kur'ani thotë: me të vërtetë, vetëm All'llahu ka dituri për ardhjen e Kiametit: **"Vetëm All'llahu e di se kur do të vijë Ora..."**.

Atë nuk e di asnjë i Dërguar dhe as një engjëll i afërt. Çështja duhet të jetë kështu për qëllime edukative, ku njeriu të jetë i përgatitur në çdo kohë për Llogaridhënien.

Më poshtë, ajeti shton: Nuk është vetëm dituria për Kiametin nga veçoritë e diturisë së All'llahut, por bashkë me të radhiten edhe gjëra të tjera, si për shembull: sekretet e kësaj bote dhe veçoritë e krijesave të dukshme dhe të padukshme: **"...Kurrfarë fruti nuk mund të dalë prej kupës së lules dhe asnjë femër nuk mund të mbetet shtatzanë apo të lindë pa dijeninë e Tij..."**¹ Me të vërtetë që bimët nuk rriten, kafshët nuk shtohen

¹"Min" tek "mine themerati", "min untha", si dhe "min shehiid" vijnë të gjitha në fund të ajetit dhe janë shtojca që kanë ardhur këtu për siguri, përforcim.

dhe njeriu nuk e hedh farën e tij, veçse me urdhërin e All'llahut të Madhërueshëm dhe bazuar në diturinë dhe urtësinë e Tij.

Fjala "*ekmám*" është shumësi i "*kemmún*", njësoj si "*xhemmun*" dhe do të thotë "*lëkura që mbështjell frutin*". Kurse "*kemmún*" njësoj si "*kummún*", do të thotë "*një pjesë rrobe, copë që mbulon dorën*". Ndërsa "*kemmetun*" është njësoj si "*kubbetun*" dhe është "*kapuçi mbi kokë*".¹

Dijetari Tabersijju thotë në Mexhmaul Bejan: *Tekemmeme err rrexhulu fi theubihi, domethënë mbuloi njeriu veten e vet me rrobë*.

Kurse Fakhru Rrazi e komenton fjalën "*ekmam*" me kuptimin *lëvorja që mbulon frutin*.

Ka nga ata komentues që e kanë komentuar këtë fjalë si: "*ena e frutit*".²

Është e qartë se të gjitha këto mendime bashkohen në një kuptim të vetëm: një nga fazat më të veçanta në botën e gjallesave të gjalla, është faza e zhvillimit në mitër dhe lindje. Prandaj, Kur'ani i dëshmon dhe i përforcon këto dy çështje pa dallim, në botën e njerëzve dhe të kafshëve, apo në botën e bimëve.

All'llahu është Ai që di për pikat e ujit (spermën), kohën e ngjizjes në mitër dhe për çastin e lindjes së saj. Ai e di se kur formohen frutat, kur zhvillohen dhe kur dalin nga perikarpi i tyre.

¹ Shih: "Err Rragib fil mufredat"

² Tefsiri "El Mijzan", vëll.17, f. 401 dhe tefsiri "El Muragij".

Pastaj ajeti kur'anor shton se grupi që e mohon Kiametin dhe tallet me të, do të përballët me një pamje ku do t'u thuhet: **"...Ditën kur Ai t'i thërrasë njerëzit e t'u thotë: 'Ku janë ata zota që i quanit si ortakët e Mi?', ata do të përgjigjen: 'Askush prej nesh nuk dëshmon sot se ata janë ortakët e Tu.'"**¹ Ajo që kemi thënë, është fjalë e kotë. Ishte një fjalë që buronte nga padituria, kryeneçësia dhe tradita e verbër, kurse sot e kuptuam se pohimet tona kanë qenë shumë të kota dhe pa logjikë.

Dhe këta, në të njëjtën kohë që regjistrojnë pranimin e veprave të tyre të kaluara, gjithashtu nuk shikojnë ndonjë dobi të adhurimit të idhujve që kishin adhuruar më parë, përveç All'llahut: **"Idhujt, që ata i adhuronin më parë, do t'i zhgënjejnë..."**.

Me të vërtetë që skena e Kiametit është një pamje e tmerrshme, e frikshme, ku merren prej tyre xhevahiret dhe harrojnë rreziqet e atyre statujave dhe sendeve të tjera që adhuronin, që u bënin sexhde dhe kurban, madje nganjëherë sakrifikonin edhe shpirtrat për hir të tyre.

Ata mendonin se idhujt ua zgjidhnin problemet e tyre dhe se do t'u bënin dobi ditën kur do të kishin nevojë. Me të vërtetë, e gjitha kjo u bë një imagjinatë e shkrirë.

¹ Frazja *"adhen'nake"* vjen prej *"idhanun"* me kuptimin *lajmërim*, kurse fjalia **"e ditën kur Ai thërret ata"** lidhet me aludimin: "përkujto ditën kur Ai i thërret ata...". Për këtë fjali kanë përmendur edhe një koment tjetër, që është: në mesin tonë nuk ka asnjë që të dëshmojë praninë e një shoku për ty, sepse të gjithë e mohojnë praninë e tij.

Atë ditë do të **"...dhe ata do ta dinë se nuk ka më shpëtim."**

Fjala *"mehijs"* vjen nga fjala *"hajsun"*, njësoj si *"hejfun"*, do të thotë *"shmangie dhe heqje dorë nga diçka"*. Përderisa (mehijs) është emër vendi, këtu ajo ka kuptimin e *"strehimit e të ikjes."*

Fjala *"dhannu"* vjen nga fjala *"dhanne"*, e cila ka kuptime të gjera. Nganjëherë, ajo vjen me kuptimin e *"bindjes"*, por gjithashtu edhe me kuptimin e *"hamendësimit"*. Në këtë ajet, kjo fjalë ka ardhur me kuptimin e bindjes, sepse në atë Ditë ata do të binden, se nuk ka shpëtim dhe arratisje nga dënimi i All'llahut.

Rragib Isfihani në librin *"El Mufredat"* thotë: Fjala *"dhanne"* do të thotë doktrinë që arrihet nga argumenti. Nganjëherë kjo doktrinë është e fortë dhe arrin në fazën e bindjes dhe nganjëherë kjo doktrinë është e dobët dhe nuk e kalon cakun e hamendësimit.

Ajetet 49 – 52

لَا يَسْأَلُ الْإِنْسَانُ مِنْ دُعَاءِ الْخَيْرِ وَإِنْ مَسَّهُ الشَّرُّ فَيَئُوسٌ قَنُوطٌ،
وَلَكِنْ أَذْفَنَاهُ رَحْمَةً مِنَّا مِنْ بَعْدِ ضَرَاءٍ مَسَّتْهُ لَيَقُولَنَّ هَذَا لِي وَمَا أَظُنُّ
السَّاعَةَ قَائِمَةً وَلَئِنْ رُجِعْتُ إِلَىٰ رَبِّي إِنَّ لِي عِنْدَهُ لَلْحُسْنَىٰ فَلَنُنَبِّئَنَّ
الَّذِينَ كَفَرُوا بِمَا عَمِلُوا وَلَنُذِيقَنَّهُمْ مِنْ عَذَابٍ غَلِيظٍ. وَإِذَا أَنْعَمْنَا
عَلَى الْإِنْسَانِ أَغْرَضَ وَنَأَىٰ بِجَانِبِهِ وَإِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ فَذُو دُعَاءٍ
عَرِيضٍ. قُلْ أَرَأَيْتُمْ إِنْ كَانَ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ ثُمَّ كَفَرْتُمْ بِهِ مَنْ أَضَلُّ
مِمَّنْ هُوَ فِي شِقَاقٍ بَعِيدٍ.

“Njeriu nuk lodhet kurrë duke kërkuar të mirën, por, nëse e godet e keqja, ai menjëherë bie në dëshpërim dhe humb shpresën.”

“Nëse pas fatkeqësisë, Ne i japim atij që të shijojë nga mirësitë Tona, ai me siguri, do të thotë: ‘Këtë e meritoj! Unë nuk besoj se do të vijë Ora (e Kiametit), por, edhe nëse kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë.’. Në të vërtetë, Ne do t’i njoftojmë mohuesit për atë që kanë bërë dhe do t’i bëjmë të shijojnë një dënim të ashpër.”

“Kur njeriut i dhurojmë dhuntitë Tona, ai shmanget dhe na kthen kurrizin, mirëpo, kur atë e godet e keqja, ai lutet gjerë e gjatë. “

“Thuaju, (o Muhammed): ‘Më thoni! Nëse ky Kur’an është vërtet prej All’liahut dhe ju e mohoni atë, atëherë kush është në humbje më të madhe se ai që është në kundërshtim të hapur me Të?!’”

Komentimi

Të njëjtën linjë për të cilën folën ajetet e kaluara, e ndeshim edhe në përmbajtjen e kësaj serie të re ajetesh që po komentojmë. Ato paraqesin forma të tjera të jetës së njerëzve jobesimtarë apo me besim të dobët, të cilët mbartin mendime të papjekura, qëndrime të lëkundëshme dhe nuk kanë asnjë forcë në përballimin e vështirësive.

All’llahu i Madhëruar thotë: “Njeriu nuk lodhet kurrë duke kërkuar të mirën...”

Dëshira e njeriut nuk ka fund. Sa herë që arrin të marrë diçka, ai kërkon më shumë dhe sado që t’i japësh, ai nuk mjaftohet me të.

“...por, nëse e godet e keqja, ai menjëherë bie në dëshpërim dhe humb shpresën.”

Ajo që nënkuptohet këtu me njeriun, është ai njeri i paedukuar me bazat e edukatës islame, të cilit ende nuk i është ndriçuar zemra me njohjen e All'llahut, me besimin tek Ai dhe që nuk e ka ndjerë ende plotësisht përgjegjësinë. Ajo është një metaforë për njerëzit që kanë rënë pre e botës materiale, për shkak të filozofive dhe mendimeve të gabuara. Të tillë njerëz nuk zotërojnë anën e lartë shpirtërore, e cila i bën të durueshëm dhe të qëndrueshëm dhe të tejkalojnë kufijtë material.

Këta njerëz gëzohen kur iu afrohet dynjaja dhe i humbasin shpresat e mërzitën kur ajo ua kthen shpinën. Në zemrat e tyre nuk futet drita e shpresës dhe udhëzimit.

Fjala *“duaun”* nganjëherë vjen edhe me kuptimin e *“thirrjes”*, e ndonjëherë me kuptimin e *“kërkesës”*. Në ajetin që po komentojmë, ka ardhur në kuptimin e dytë.

Prandaj, thënia e All'llahut të Madhëruar: **“Njeriu nuk lodhet prej kërkesës për mirë”** do të thotë që njeriu nuk mërzitet dhe nuk lodhet kurrë në të kërkuarit e mirësisë dhe të bukurisë.

Komentuesit kanë mendim të ndryshëm për fjalët *“jeusun”* dhe *“kunutun”* se a kanë një kuptim të vetëm apo jo.

Disa prej tyre thonë se ato të dyja janë në një kuptim, kurse përsëritja është për përforcim.¹

Komentues të tjerë kanë thënë se *“jeusun”* vjen nga *“jeise”*, që do të thotë *dëshpërim në zemër*, ndërsa *“kunutun”* do të thotë *shfaqje e dëshpërimit në fytyrë dhe në vepër*.²

¹Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 17, f. 402. Fundi i ajetit është burimi i komentimit.

²Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 27, f. 137 dhe tefsiri “Ruhul Meanij”, vëll. 25, f. 4.

Ndërsa Et Tabersij në komentimin “Mexhmaul Bejan” ka thënë: E para është *dëshpërim nga e mira*, kurse e dyta është *dëshpërim nga mëshira*.¹

Ajo që përfitojmë nga përdorimi kur’anor, është se të dyja afërsisht përdoren për të treguar një kuptim të vetëm. Në tregimin e Jusufit, për shembull, lexojmë se Ja’kubi (*Paqja qoftë mbi të!*) i paralajmëroi djemtë e tij prej dëshpërimit nga mëshira e All’llahut, në kohën kur zemrat e tyre ishin të dëshpëruara për të gjetur Jusufin dhe po ashtu i shfaqnin shenjat e dëshpërimit.²

Kurse në gjendjen e Ibrahimit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) shohim se si ai u habit nga përgëzimi me djalë që i dhanë engjëjt, por ata i thanë: **“Ne ta japim lajmin e mirë me vërtetësi, prandaj mos u bëj shpresëhumbur.”**³

Ajeti që vjen më pas, na tregon një cilësi tjetër të njeriut të paditur, që është shumë larg dijes dhe besimit dhe i veshur me mendjemadhësi: **“Nëse pas fatkeqësisë, Ne i japim atij që të shijojë nga mirësitë Tona, ai me siguri, do të thotë: ‘Këtë e meritoj...’”**⁴, domethënë me të vërtetë e meritoj dhe duhet t’i kem këto të mira dhe këtë pozitë.

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 18.

²Sure “Jusuf”, ajeti 78 e më tej.

³Sure “El Hixhr”, ajeti 55.

⁴ Disa komentues kanë shkruar deri aty, sa kanë thënë se fjalia “*hadha li*” ka kuptimin: kjo mirësi do të qëndrojë gjithmonë me mua.

Me të vërtetë që njeriu mendjemadh harron se në vend të mirësisë, atë mund ta përfshinte belaja, njësoj siç thoshte Karuni: **“Më është dhënë vetëm në sajë të dijes sime!”**.¹

Më pas, ajeti shton se kjo mendjemadhësi e orienton njeriun drejt mohimit të Ahiretit: **“...Unë nuk besoj se do të vijë Ora (e Kiametit)...”**. Edhe sikur të supozojmë se ka Kiamet, gjendja ime do të jetë edhe më e mirë se kjo: **“...por, edhe nëse kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë.”**.

Me të vërtetë, kjo situatë i ngjason asaj historie që kemi dëgjuar tek surja “Kehf” për dy burra, nga të cilët njëri prej tyre ishte i pasur e mendjemadh, kurse tjetri ishte mirënjohës e besimtar. Ajeti tregon me gjuhën e pasanikut mendjemadh fjalët e tij: **“...Unë nuk mendoj se kjo do të shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Ora (e Kiametit). Por, edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky (kopësht).”**.²

Mirëpo All'illahu i paralajmëron njerëzit si këta dhe thotë: **“...Në të vërtetë, Ne do t'i njoftojmë mohuesit për atë që kanë bërë dhe do t'i bëjmë të shijojnë një dënim të ashpër.”**.

“El adhabul galidh” është “dënim i ashpër dhe i akumuluar”.

Të njëjtin kuptim e vëmë re në një vend tjetër në Kur'an, e pikërisht në ajetin 10 të sures “Hud”, ku thuhet: **“E, kur pas fatkeqësisë që e ka goditur atë, Ne i japim atij dhunti, ai me**

¹Sure “El Kasas”, ajeti 78.

² Sure “El Kehf”, ajetet 35-36.

siguri do të thotë: 'Gjynahet e mia janë larguar nga unë!'. Atëherë bëhet i gëzuar dhe mendjemadh."

Ajeti që pason, na përmend një cilësi të tretë të këtyre njerëzve, që është harresa në rast mirësish dhe frika e shqetësimi në rast fatkeqësish.

All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kur njeriut i dhurojmë dhuntitë Tona, ai shmanget dhe na kthen kurrizin, mirëpo, kur atë e godet e keqja, ai lutet gjerë e gjatë."**

Fjala *"neaa"* rrjedh prej *"ne'jun"*, njësoj si *"re'jun"*, dhe do të thotë *"të largohesh"*. Kur shoqërohet me fjalën *"bi xhanibihî"*, atëherë ajo bëhet si metaforë për mendjemadhësinë dhe kryeneqësinë.

Fjala *"el aridhu"* është antonimi *"i gjatë"*. Arabët i përdorin këto dy fjalë për të treguar shtimin dhe shumicën.

Në ajetin 12 të sures *"Junus"* shohim kumtime të ngjashme me këto, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"E, kur njeriun e gjen e keqja, atëherë Na lutet shtrirë ose ulur, ose në këmbë. E, sapo Ne ia largojmë të keqen, vazhdon rrugën, thujse nuk Na është lutur për fatkeqësinë që e ka goditur. Kështu, plëngprishësve (që shkelin kufijtë e All'llahut) iu zbukurohet ajo që punojnë."**

Me të vërtetë, njeriu që humb besimin dhe përkushtimin, ekspozohet si në këto situata, prandaj me ardhjen e mirësive, ai bëhet mendjemadh, harrues i All'llahut.

Ndërsa nga ana tjetër shohim se njerëzit e vërtetë dhe ndjekësit e Pejgamberëve dhe të të Dërguarve, nuk ndryshojnë kur atyre u vijnë mirësitë, nuk përkulen, nuk dëshpërohen e nuk

shqetësohen, kur u kthen shpinën; s'ka dyshim se ata janë prej atyre që përshkruhen në Fjalët e All'Ilahut të Madhëruar **“burra që nuk i devijon as tregtia e as shitja nga përkujtimi i All'Ilahut”**; pra, fitimet e tregtisë nuk i bëjnë që të harrojnë Zotin e tyre. Me të vërtetë, ata e njohin shumë mirë filozofinë e mirësisë dhe të fatkeqësisë në këtë botë. Ata e dinë se sprovat janë alarmet e rrezikut për ta, kurse mirësitë janë testim dhe provim nga ana e All'Ilahut.

Ndonjëherë, prej sprovave është ndëshkimi prej pakujdesinë dhe harresës dhe mirësitë bëhen shkak që i nxisin njerëzit për falënderim.

Këtu na e tërheq vëmendjen përdorimi në Kur'an i dy fjalëve *“edhekna”* dhe *“messehu”*, të cilat kanë kuptimin se *me aq pak sa u afrohet dynjaja atyre, ata ndryshojnë, harrojnë dhe goditen me mendjemadhësi. Këta, vetëm me një “prekje” të vogël të së keqes dhe fatkeqësisë, kaplohen me dëshpërim dhe shqetësim.*

Prej këtu kuptojmë vlerën e zemërgjerësisë, të shpirtit të mbushur me besim, të horizonteve të gjera të mendimit dhe përgatitjen e njeriut në përballimin e problemeve dhe vështirësive që të sfidojë devijimet dhe pasionet e shfrenuara. Të gjitha këto janë fryt i besimit dhe i devotshmërisë.

Dëshmori i mihrabit, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qofsh të mbi të!*), në një nga lutjet e tij, të cilat kanë qenë mësim për shokët e tij, thotë: *“Ne i lutemi Zotit të Lavdishëm të na bëjë ne e ju si ata që mirësitë s'i futën dot në rrugën e gabuar, që asgjë*

*nuk mund t'i ndalë në bindjen ndaj Atij, dhe që pas vdekjes nuk i zë as turpi, dhe as pikëllimi."*¹

Në ajetin e fundit thuhet: **"Thuaju, (o Muhammed): 'Më thoni! Nëse ky Kur'an është vërtet prej All'Ilahut dhe ju e mohoni atë, atëherë kush është në humbje më të madhe se ai që është në kundërshtim të hapur me Të?!'"**²

Është e qartë se kjo fjalë u thuhet njerëzve, të cilëve nuk u bën dobi asnjë argument logjik, prej kryeneçësisë së fortë dhe intolerancës e fanatizmit.

Ajeti u thotë këtyre: Nëse nuk e pranoni vërtetësinë e Kur'anit dhe ekzistencën e një bote pas vdekjes, në të cilën do të vendoseni, atëherë ju përfundimisht nuk keni asnjë argument të prerë për këtë mospranim. Prandaj, mbetet mundësia që të jenë thirrja e Kur'anit dhe çështja e Kiametit, të vërteta të pranishme. Në këtë këndvështrim, ju vetëm përfytyroni fundin e zi e të tmerrshëm që ju pret për shkak të kryeneçësisë, humbjes dhe kundërshtimit tuaj të ashpër ndaj fesë hyjnore.

Kjo është e njëjta metodë që e hasim në argumentimin e Imamëve, gjë të cilën e shohim të qartë në një ngjarje që e kumton dijetari El Kulejni në "El Kafij", ku përmend dialogun e zhvilluar mes Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ibn Ebi Auxhaut.

Dihet se Abdul Kerim ibn Ebi Auxhau ishte prej ateistëve në kohën e tij dhe kishte shkuar disa herë në kohën e Haxhit dhe ishte takuar me Imam Sadikun në tubime dialogjesh. Prej këtyre

¹"Nehxhul Belaga", fjalimi 64.

²"Ere ejtum" zakonisht vjen me kuptimin "akhbirbiruni" -"më lajmëroni" dhe komentohet me po të njëjtin kuptim.

tubimeve disa prej shokëve të tij përqafuan Islamin. Mirëpo, Ibn Ebi Auxhau nuk ishte bërë mysliman. Imami (*Paqja qoftë mbi të!*) theksoi se ai ishte i verbër, prandaj nuk bëhej mysliman.

Dëshmia për këtë çështje është se Imam Sadiku u takua me Ibn Ebi Auxhaun dhe e pyeti: *“Ç’të solli ty në këtë vend?”*.

Ibn Ebi Auxhau iu përgjigj: *“Zakoni i trupit dhe tradita e qytetit. Erdha që të shikoj se sa budallenj janë njerëzit kur qethen dhe hedhin gurët!”*.

Imami i tha: *“Ti vazhdon të jesh në kryeneçësinë dhe humbjen tënde, o Abdul Kerim!”*.¹

Dhe, kur Ibn Ebi Auxhau deshi të bënte debat, Imami i tha atij: *“Nuk ka polemikë në Haxh. Pastaj i tha: Nëse çështja është siç thua ti, atëherë shpëtuam dhe shpëtove. Dhe nëse çështja është siç themi ne, atëherë shpëtuam, kurse ti u shkatërrove.”*

Abdul Kerimi iu afrua atyre që ishin përreth tij dhe u tha: *“Në zemrën time ndjej dhimbje. Më ulni!”*. Ata e ulën dhe ai vdiq.²

¹Imami e thërret atë me këtë emër, sepse ky është emri i tij i vërtetë, pavarësisht se e mohon All'llahun.

²“Usulul Kafij”, vëll.1, f. 77, 78, (Kitabu Teuhijd, kreu: “Huduthul alem”).

Hulumtim

Në ajetet që po komentojmë, kemi lexuar Fjalën e All'llahut të Madhëruar: **“...kur atë e godet e keqja, ai lutet gjerë e gjatë...”**, mirëpo në suren “Isra” thuhet: **“...e kur e godet e keqja, ai humb shpresën.”**¹

Lind pyetja se si mund të harmonizohen këto dy ajete, kur dihet se du’aja është argument i shpresës, ndërkohë që ajeti tjetër flet për dëshpërimin e njerëzve si këta?

Disa komentues i janë përgjigjur kësaj pyetjeje duke i ndarë njerëzit në dy grupe: një grup që dëshpërohet përfundimisht kur e godet një fatkeqësi apo e keqe, dhe tjetri që vazhdon në lutje, pavarësisht se ka frikë dhe shqetësim.²

Një pjesë tjetër e komentuesve kanë thënë se dëshpërimi është pjesë e shpresës së mirë ose largimi i së keqes nga rruga e shkaqeve të zakonshme materiale, dhe kjo nuk e ndalon njeriun që të kthehet tek Zoti i tij me lutje.³

Ka mundësi që qëllimi me fjalët **“ai lutet gjerë e gjatë”** nuk është kërkesë prej All'llahut, por shqetësim dhe frikë e madhe. Argument për këtë është Fjala e All'llahut të Madhëruar në ajetet

¹Sure “Isra”, ajeti 83.

²Tefsiri “Ruhul Bejan”, vëll. 8, f. 280.

³ Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 17, f. 402. Mirëpo ky mendim i komentuesve nuk i përshtatet shumë pozitës, veçanërisht për faktin se ajetet e mësipërme i qortojnë të tillë njerëz.

19 dhe 20 të sures Mearixh, ku thuhet: **“Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm: kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort.”**.

Ose të dy ajetet shprehin dy gjendjet: ku këta njerëz në fillim bëjnë lutje dhe kërkojnë mirësinë prej Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur ata janë të frikësuar dhe të shqetësuar, pastaj nuk kalon një kohë e gjatë veçse goditen me dëshpërim, që e përveteton gjithë qenien e tyre.

Ajetet 53 - 54

سَنُرِيهِمْ آيَاتِنَا فِي الْآفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ أَوَلَمْ يَكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ۚ أَلَا إِنَّهُمْ فِي مِرْيَةٍ مِّنْ لِّقَاءِ رَبِّهِمْ أَلَا إِنَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ مُّحِيطٌ ۝

“Ne do t’u tregojmë atyre Shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kur’ani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?”

“Vërtet, ata dyshojnë në takimin me Zotin e tyre, por le ta dinë se Ai ka nën kontroll çdo gjë.”

Komentimi

Shenjat e të vërtetës në botën e madhe dhe të vogël

Dy ajetet përmbyllëse të kësaj sureje flasin për dy tema të rëndësishme. Ajeti i parë flet për Teuhidin (ose Kur’anin), kurse i dyti për Botën Tjetër.

All'llahu i Madhëruar thotë: **“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet tona në horizonte dhe në veten e tyre, derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë.”**.

“Ajatul afak” – “shenjat në hapësirë”, përfshijnë krijimin e Diellit, të Hënës, yjeve, sistemit të përsosur që e drejton dhe krijimin e gjallesave të ndryshme dhe bimëve, maleve, oqeanëve dhe çfarë ka në to prej çudive dhe sekreteve të pallogaritshme, si dhe gjithçka ka në botën e gjallesave. S’ka dyshim se të gjitha këto argumente janë fakte për Njehsimin dhe ekzistencën e All’llahut.

Për sa u përket **“argumenteve në veten e tyre”**, këtu bëhet fjalë për çështje të tilla si: krijimi i organeve të trupit të njeriut dhe sistemi nervor që kontrollon trurin, lëvizjet e organizuara të zemrës, arteriet, kockat dhe mushkëritë, ngjizja e pikës së ujit dhe zhvillimi i embrionit në errësirat e mitrës, si edhe sekretet e çuditshme të shpirtit.

Të gjitha këto janë një libër i hapur për njohjen e Zotit, Krijuesit të Madhëruar.

Është e vërtetë se këto shenja janë përmendur më parë mjaftueshëm nga ana e All’llahut të Madhëruar mirëpo ky proces dhe kjo dukuri vazhdon ende, sepse All’llahu thotë: **“do t’u bëjmë atyre të mundshme”**, e cila përmban një folje në kohën e tashme që tregon vazhdimësinë e diçkaje. Edhe sikur njeriu të jetojë qindra mijëra vjet, atij do t’i zbulohen në çdo kohë shenja dhe argumente të reja hyjnore, sepse sekretet e botës nuk shterrojnë.

Të gjithë librat dhe kërkimet e shkencave natyrore, dituria e njeriut në fusha të ndryshme (anatomia, fiziologjia e organeve, psikologjia dhe psikoanaliza), si dhe shkencat mbi bimët, kafshët, atmosferën e të tjera, janë në të vërtetë libra dhe kërkime në Teuhidin dhe njohjen e Krijuesit Fuqiplotë. Kjo për shkak se ato ngrenë siparin e sekreteve të çuditshme, që të bëjnë të qartë një pjesë të mençurisë së Krijuesit të Madhërishëm, të fuqisë së Tij të përhershme dhe të diturisë së Tij që ka përfshirë çdo gjë.

Ndonjëherë një nga këto shkenca, madje edhe një degë nga degët e saj të shumta, ku një prej dijetarëve të kësaj shkençe apo dege të saj e kalon jetën e tij në rrugën e hulumtimit dhe në fund thotë: Me keqardhje vazhdoj të mos di asgjë për këtë temë dhe ajo që kam mësuar deri tani më bën mua të zhytem sa më thellë në thellësitë e paditurisë sime.

Le të kthehemi tani tek ajeti i cili përfundon me një fjali të thukët, ku All'illahu i Madhëruar thotë: **“Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?”**.¹

A ka dëshmi më të madhe e më të mirë se kjo, që është shkruar me shkrimin e fuqisë krijuese në ballin e të gjitha gjallesave, mbi gjethet e pemëve, në lulet e ndryshme, midis shtresave të çuditshme të trurit, në membranat e holla të syrit, në horizontet e qiellit e në brendësitë e tokës?! Në çdo gjë që gjallon do të gjesh shenja që tregojnë për Krijuesin, dëshminë krijuese

¹Shumica e komentuesve kanë thënë se “*el bau*” është shtesë dhe “*ue rabbuke*” është në vendin e subjektit. Fjalja “**Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje**” është ndajshim i asaj. Kështu, kuptimi bëhet kështu: “A nuk u mjafton atyre, se Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?”.

dhe njëshmërinë e Tij, si edhe për fuqinë, mençurinë dhe diturinë e Tij.

Ajo që thamë më lart është një nga interpretimet më të njohura të ajetit, në bazë të të cilit është çështja e Njehsimit dhe ku sillen argumentet e të vërtetës në horizonte dhe në shpirtra.

Kurse interpretimi i dytë i referohet mrekullisë së Kur'anit dhe kthjelltësisë së tij. Përmbledhja e këtij intrerpretimi është se All'illahu dëshiron të thotë se: Ne i kemi shfaqur argumentet dhe faktet Tona të ndryshme, jo vetëm në Gadishullin e Arabisë, por në të gjitha anët e botës, edhe në vetet e këtyre idhujtarëve, derisa ta kuptojnë se ky Kur'an është i vërtetë.

Ka nga ato argumente të horizonteve që ia kanë përngjasuar fitores së Islamit në fusha të ndryshme, si në atë të luftës, apo të përballjes ideologjike e intelektuale, apo të fitores së tij në zona që i ka çliruar dhe udhëhequr ato me idetë e njerëzve.

Ishte me të vërtetë i njëjti grup myslimanësh në Mekë, që All'illahu ua lehtësoi çështjen me emigrim, pastaj u zhvendosën në vendet e tjera, që të përqaфонin fenë e tyre popujt në zona të tjera të botës dhe të ngrinin lart flamurin e Islamit.

Nga argumentet e veteve ku merret shembull, janë fitorja e myslimanëve ndaj idhujtarëve të Mekës në betejën e Bedrit dhe në ditën e çlirimit të Mekës, si dhe depërtimi i dritës së Islamit në zemrat e shumicës prej tyre.

Këto argumente të horizonteve dhe të veteve të tyre, e përforcuan faktin se Kur'ani është i vërtetë.

S'ka dyshim, se Krijuesi i Madhërishëm, i Cili dëshmon për çdo gjë, ka dëshmuar edhe për vërtetësinë e Kur'anit nga kjo rrugë.

Pavarësisht se për secilin nga këto dy interpretime ka argumente dhe fakte që e mbivlerësojnë atë, po të vëmë re me kujdes në fundin e ajetit dhe në ajetin që vjen më pas, kuptojmë mençurinë e interpretimit të parë.¹

Ajeti i fundit në sure na tregon thelbin dhe shkakun e mizorisë së këtij grupi idhujtarësh të shthurur. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...Vërtet, ata dyshojnë në takimin me Zotin e tyre..";** ata nuk besojnë në Ditën e Llogarisë dhe të Shpërblimit, sepse bëjnë krime të ndryshme dhe kundërshti. Me të vërtetë, pakujdesia dhe mendjemadhësia i kontrollojnë ata dhe i bën që të harrojnë takimin me All'llahun.

Ajeti vazhdon më tej me fjalët: **"...por le ta dinë se Ai ka nën kontroll çdo gjë."**

¹ Interpretimi i parë ka katër probabilitete, të cilët janë:

i pari: ajetet përforcojnë më së shumti çështjen e Njehsimit dhe të argumenteve të tij.

i dyti: dy fjalët: *afak* dhe *enfus*, janë më të përshtatëshmet me shenjat e Njehsimit (Teuhidit).

i treti: ajeti në fundin e tij na tregon Fjalën e All'llahut të Madhëruar: **"Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?"** për çështjen e Njehsimit dhe dëshminë krijuese të All'llahut në vërtetësinë e Unit të Tij të pastër.

i katërti: ajeti që vjen pas tij flet për Kiametin dhe ne e dimë se rrallë ndodh që zanafilla dhe Kiameti të shoqërohen me njëri-tjetrin.

Me të vërtetë, të gjitha veprat dhe nijetet e tyre janë të ditura nga All'illahu dhe të gjitha ato regjistrohen për gjykatën e Kiametit e të grumbullimit.

Fjala *"mirjetun"* është njësoj si *"xhizjetun"* dhe *"karjetun"*, dhe ka kuptimin e *"dyshimit në marrjen e një vendimi"*. Disa kanë thënë se kuptimi i saj është *dyshim* dhe *mëdyshje e madhe*, dhe se fjala në fakt është marrë nga *"murijet en nakatu"*, e cila ka kuptimin e *"pikimit të gjirit të devesë pas mjeljes së saj"*, me shpresën se ka mbetur një pjesë qumështi në të. Meqenëse kjo punë shoqërohet me dyshim e pavendosmëri, kjo fjalë ka ardhur pikërisht me këtë kuptim.

Kur dëgjojmë përdorimin e fjalës *"el merau"* të *"el muxhadele"*–*"polemikë"*, kjo për shkak se njeriu përpiqet të nxjerrë atë që ka në mendjen e palës tjetër.

Ajeti, në këtë pjesë të tij, është një kundërpërgjigje për dyshimet e jobesimtarëve, në mënyrë të veçantë për Kiametin. Ata thonë: Si mundet që ky dhe' i shpërbërë dhe i përzier mes vedi, të ndahet në pjesë? Dhe kush mund t'i bashkojë pjesët e njeriut? Për më tepër: Kush i përfshin në dijen e tij nijetet dhe veprat e njerëzve gjatë gjithë historisë së njerëzimit?

Kur'ani u përgjigjet të gjitha këtyre dhe thotë: Si mundet që Krijuesi, i Cili ka përfshirë çdo gjë në dijen e Tij, të mos i ketë këto çështje në fuqinë e Tij?!

Pastaj argumenti i përfshirjes së gjithçkaje në diturinë e Tij tregon administrimin e Tij në të gjitha këto çështje. Atëherë, si i lejohet Atij të mos ketë dituri për çështjet që ka krijuar dhe që administron?

Disa komentues kanë thënë se ajeti përqendrohet tek Njehsimi dhe jo te Kiameti. Për këtë dijetari Tabatabai thotë: “Ajo që përftohen nga konteksti është se në ajet ka tërheqje vërejtjeje për ata nuk përfitojnë në diskutime rreth Njehsimit të Tij me qënien e Tij Dëshmitar për çdo gjë dhe ky është argumenti më i fortë i Njehsimit dhe më i qartë për atë që ka logjikë, sepse ata janë në dyshim të madh për takimin me Zotin e tyre dhe se Ai nuk u ka fshehur asgjë nga cilësitë dhe veprat e Veta, krijesave të Tij.”.¹

Mirëpo ky komentim, siç shihet, është i papërshtashëm, sepse shprehja “**takimin me Zotin**” zakonisht vjen si metaforë për Ditën e Kiametit.

Hulumtime

Teuhidi midis argumentit të “nudhum” dhe argumentit “siddikijne”

Filozofët në kërkimet e tyre i kanë kushtuar një rëndësi të madhe *Teuhidit*, për dy lloje të argumentimit për Krijuesin Fuqiplotë: njëri prej tyre është argumenti “*nudhum*”, kurse tjetri është argumenti “*siddikijne*”.

¹Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 17, f. 405.

Argumenti “*nudhum*”, siç duket edhe nga emri i tij, fillon nga sistemi i botës së ekzistencës, i sekreteve dhe hollësive të tij, e të udhëzon drejt burimit të diturisë, fuqisë dhe krijimit që e krijoi këtë gjithësi dhe e administron atë. Kur’ani i Shenjtë është i mbushur me këto lloj argumentesh. Ai përmend shumë lloje të shenjave të All’llahut në qiell e në tokë, në dukuritë e jetës e në sistemin e saj dhe çfarë krijesash përmbajnë. Këtë metodë e përfundon duke konstatuar praninë e Krijuesit të Plotfuqishëm.

Çdo njeri, sipas nivelit të tij në dije e botëkuptim, mundet ta përvetësojë këtë lloj argumentimi. Prej tij përfitojnë dijetarët më të mëdhenj, sipas përgatitjes, kulturës dhe kapacitetit të tyre. Në të njëjtën kohë, prej këtij argumentimi përfiton edhe i pashkolluari, edhe i pamësuar, edhe i pastudiuari në artet e shkencave dhe të diturisë.

Nga ana tjetër, argumenti “*siddikijne*” është një lloj argumentimi që mundëson arritjen tek Uni nëpërmjet vetë Unit). Këta lloj njerëzish e njohin All’llahun nëpërmjet domosdoshmërisë së pranisë së Tij.

Me fjalë të tjera: Qeniet e mundëshme dhe krijesat nuk janë këtu si ndërmjetësuese të konstatimit të ekzistencës së Tij, porse, në të vërtetë, vetë Uni i Tij që tregon qënien e Tij. Kështu që All’llahu i Madhëruar është vërtetues i shprehjes “o Ti që e argumenton veten e Tij me veten e Tij”.¹ Gjithashtu, vërtetues edhe i ajetit: “**All’llahu dëshmoi se nuk ka tjetër Zot veç Tij.**”.²

¹ Kjo është një pjesë nga lutja e transmetuar nga prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*)

² Sure “Ali Imran”, ajeti 18.

Ky argumentim është filozofik dhe i ndërlikuar, thelbin e të cilit e kuptojnë vetëm ata që kuptojnë parimet e tij. Qëllimi ynë nuk është që ta lehtësojmë argumentin, sepse kjo është çështje e librave filozofikë, por ne deshëm që nëpërmjet kësaj paraqitjeje, të qëndrojmë tek idetë dhe mendimet e disa komentuesve, të cilët besojnë se fillimi i ajetit në Fjalën e All'Ilahut të Madhëruar: **“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte”**, përmban tregues të argumentit *“nudhum”*, shkak dhe pasojë, kurse fundin e ajetit ku thuhet: **“A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo send?”**¹ e kanë quajtur tregues të argumentit të *“siddikijne”*.

Mirëpo aty nuk ka krahasues të qartë nga i njëjti ajet, që e forcon idenë e këtij përfundimi.

E vërteta se All'Ilahu përfshin gjithçka

Nuk duhet të mendojmë, në mënyrë absolute, se përfshirja e All'Ilahut të Madhëruar, i ngjason përfshirjes së qenieve dhe gjallesave në atmosferën që rrethon lëmshin e Tokës dhe që e mbulon atë. Kjo për shkak se shembulli i kësaj përfshirjeje është argument i kufizimit, ndërsa përfshirja për të cilën bëhet fjalë këtu, ka kuptimin e lidhjes së të gjitha qenieve dhe gjallesave me Unin e Shenjtë.

E thënë ndryshe: nuk ka në botën e ekzistencës, përveç një ekzistence unike të vetme që qëndron në Unin e Tij. Pjesa tjetër e qenieve dhe gjallesave mbështeten tek Ai dhe lidhen me Të; sikur

¹ Sure “Fussilet”, ajeti 53.

të fshihet kjo lidhje, qoftë edhe për një çast të vetëm, atëherë nuk do të mbesë gjë prej tyre.

Thelbin dhe vërtetësinë e kësaj përfshirjeje, ne e kuptojmë nga fjalët e Prijësit të besimtarëve (*Paqja qofshë mbi të!*), i cili thotë: *“Ai është me gjithçka, por jo me krahasim. Është ndryshe nga çdo gjë, por nuk zhduket.”*.

Këtë kuptim e gjejmë edhe në Duanë e Arafatit të Imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) ku thotë: *“...Qysh mund të argumentohet për Ty me atë që në vetvete ka nevojë për Ty?! Qysh mund të ketë aftësi për atë të të bëjë Ty të dukshëm në një diçka që nuk është te Ty, derisa vetë ai të të dallojë Ty me qartësinë Tënde kur Ti je i Padukshmi; derisa ai do të ketë nevojë për një udhëzues e për një argument që t'i tregojë atij për Ty, madje edhe atëherë kur Ti je aq i larguar, janë vetë shenjat e faktet që të çojnë te Ti; edhe kur syri është i verbuar e nuk të sheh Ty duke vështruar në to, ka pësuar humbje marrëveshja fitimprurëse e robit që nuk ka pjesë prej dashurisë Tënde...”*.¹

Argumentet e horizonteve dhe të veteve të tyre

Nëse njeriu lihet i lirë që të mohojë çdo gjë që mundet, atëherë ai nuk mund të mohojë ekzistencën e një kompozimi të saktë që qëndron e sundon botën e ekzistencës. Ndodh që një shkencëtar, apo dijetar i caktuar, e kalon të gjithë jetën e tij në mësim dhe studime rreth krijimit të syrit dhe sekreteve të tij, apo të trurit dhe zemrës, e lexon shumë libra që kanë shkruar rreth

¹ Një pjesë nga duaaja e Imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) në ditën e Arafatit.

temës, por ai më në fund e pranon se ka shumë sekrete rreth temës së tij, që vazhdojnë të jenë ende të panjohura.

Bota e ekzistencës flet për fuqinë e përhershme që fshihet pas saj, sepse çdo gjë tregon për Krijuesin, Projektuesin. Çdo bimë që çel mbi tokë, thotë me zë “i Vetëm, i Pashoq”.

Këtu do ta lëmë bisedën për çështjet e ndërlikuara shkencore dhe do të kthehemi tek dukuritë e zakonshme rreth nesh, në mënyrë që të prekim argumente të qarta në pohimin e Projektuesit të Madhëruar.

Mjafton të përmendim këtu këta dy shembuj:

Shembulli i parë: Të gjithë e dinë se ka një lak në shputën e këmbëve të njeriut, që në pamje të parë duket i parëndësishëm, por në ekzaminimet fizike të posaçme për kryerjen e shërbimit ushtarak, rezulton se ai djalë që nuk e ka këtë lak, lirohet nga shërbimi ose nxirret në pension tek drejtoria e zyrës së punëve.

Njeriu që nuk e ka këtë lakim lodhet shpejt dhe nuk e ka përgatitjen e mjaftueshme për të kryer shërbimin ushtarak që i thërret në mobilizim.

Kështu, çdo gjë në këtë botë dhe në ekzistencën e njeriut, është e krijuar me përpikmëri dhe rregull, deri edhe laku i thjeshtë në shputën e këmbëve të njeriut.

Shembulli i dytë: Në brendësi të gojës së njeriut dhe syrit të tij ka burime bulëzuese të mirëorganizuara dhe sekrecion të përpiktë, që nxjerr nga porët e vogla dy lëngje plotësisht të ndryshme. Sikur të mos ishin ato të dyja, njeriu nuk do të mund të ishte i aftë të shihte, të fliste apo të përtypte ushqimin e ta

gëlltiste. E thënë ndryshe, jeta është e pamundur pa këto dy lëngje të zakonshme, sepse pa qenë kapakët e syrit vazhdimisht të njomur, është i pamundur rrotullimi i irisit, i cili shkakton shumë dhimbje dhe siklet thjesht me prekjen e trupave të vegjël. Këto trupa do ta pengojnë atë që të lëvizë.

Kështu që, nëse nuk është goja e njeriut dhe faringu i tij i lagësht, atëherë ai s'mund të flasë dhe as ta përtypë apo ta gëlltisë ushqimin. Madje bëhet e pamundur edhe frymëmarrja nëse goja është e thatë. Prandaj duhet që zgavrat e hundës të jenë gjithmonë të lagështa, me qëllim që të lehtësohet hyrja e ajrit dhe kalimi i tij në mënyrë të vazhdueshme.

Uji i syrit zbret nëpërmjet kanaleve të veçanta nga syri tek hunda, që të ruajë lagështinë e tij. Nëse ky kanal bllokohet, qoftë edhe për një ditë të vetme, siç e hasim atë në rastin e disa të sëmurëve, atëherë lotët do të rrjedhin mbi fytyrë vazhdimisht dhe do të jetë një gjë e bezdisshme, lënduese.

E njëjta gjë ndodh edhe te gjëndrat e pështymës në gojë, ku sekrecionet e pakta e shtojnë thatësinë e gjuhës, të gojës dhe të faringut, kurse masa e tepërt e saj e pengon të folurën dhe e bën pështymën të dalë nga goja jashtë. Pastaj, shija e kripur e gjëndrave të lotëve kryen ruajtjen e rrjetit të syrit kundër trupave të huaj, thjesht duke hyrë në sy.

Gjëndrat humbasin çdo lloj shijeje, me qëllim që njeriu të mund të shijojë me shijet e veçanta të ushqimeve, ku kripërat e pranishme në të, e ndihmojnë në tretjen e ushqimit.

Nëse vështrojmë me kujdes në natyrën e formimit kimik dhe fizik të lëngjeve të këtyre gjëndrave dhe sistemet e tyre të

ndërlikuara e të dobishme, shihet qartë se ekzistenca e tyre nuk mund të jetë thjesht rastësi e verbër, por në të vërtetë, ato janë nga argumentet e All'llahut në vetet e tyre dhe pohim i Fjalës së të Vërtetit: **“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre, derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë.”.**

Në një tregim të hershëm, por që është shumë argumentues dhe me shumë domethënie, flet Imam Sadiku në një hadith të njohur me Teuhidul Mufaddal, i cili është ka shumë argumente të horizonteve dhe vetave e tyre që konstatojnë praninë e All'llahut. Ai thotë: *“O Mufaddal! Shikoje me kujdes përshtymën dhe se çfarë dobish ka në të, sepse Ai bëri që përherë të ecë një rrjedhë në gojë, që të lagë fytin dhe kordat të mos thahen. Njeriu nuk do të mund të gëlltiste asnjë ushqim, nëse nuk do të kishte në gojë lagështirë që e ndihmon ta kryejë atë proces.”*¹

Nëse kalojmë trupin e njeriut, shpirti i tij është fokusi i çudive. Ai ka mahnitur të gjithë shkencëtarët dhe ka me mijëra e mijëra nga argumentet e qarta, të cilat dëshmojnë njëzëri: **“...se ai (Kur’ani) është i vërtetë.”.**

Këtu bashkohet fjala jonë me atë të Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe themi: *“U verbua ai sy që nuk të shikon Ty!”*

¹“Biharul Anuar”, vëll. 3, f. 77.

Sure“Esh Shura”

Mekase, numri i ajeteve: 53

Një vështrim i përgjithshëm rreth përmbajtjes së sures

Emërtimi me emrin “Esh Shura”, që do të thotë: *Konsultimi*, i kësaj sureje të bekuar, i referohet përmbajtjes së ajetit 38, i cili fton besimtarët myslimanë në konsultimin e çështjeve të ndryshme.

Duke shtjelluar këtë temë, e ato që përmban sureja prej tërësisë së komenteve dhe përmbajtjes së sureve mekase - prej kërkimeve në zanafillë, Ditës së kthimit, Kur’anit dhe profecisë - ajo analizon dhe çështje të tjera, për të cilat do të flasim shkurtimisht në pikat që vijnë më poshtë:

Pjesa e parë është pjesa më e rëndësishme e sures, sepse diskutimet në të përfshijnë çështjen e frymëzimit, i cili pasqyron rrugët e lidhjes së Pejgamberëve me All’llahun e Madhërueshëm.

Ajo çka bie në sy është se, kjo temë përfshin në tërësinë e saj të gjithë problematikën e sures, sepse nis duke iu referuar asaj dhe përfundon duke cituar atë.

Për ta shtjelluar më tej, kjo sure përmbledh diskutime rreth Kur’anit dhe flet për profecitë e Pejgamberit të Islamit me fillesën e kumtit të tij, që prej ditëve të Pejgamberit të All’llahut, Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Pjesa e dytë përmbledh tregime me kuptim të thellë rreth argumenteve të *Teuhidit* dhe argumenteve të All’llahut.

Në këtë pjesë ka komente edhe rreth *Teuhidit rububij*.

Pjesa e tretë e sures ka tregime për çështjen e kthimit dhe përfundimit të jobesimtarëve në Ditën e Kiametit.

Pjesa e katërt përfshin diskutime morali, të cilat i pasqyrojnë me një formë të veçantë dhe të sofistikuar. Ajo fton për në cilësi të veçanta, si: qëndrimi në Rrugën e Drejtë, pendimi, falja, durimi dhe shuarja e zjarrit të zemërimit.

Surja përfundon me ndeshjen midis vesit të keq dhe mizorisë përballë begative hyjnore, kryeneçësisë e adhurimit të dynjasë, frikës dhe shqetësimit.

Në thelb, sureja përmban një listë të integruar të mësimëve dhe udhëzimeve, që në realitet shërbejnë si shërim për zemrat. Ato janë metoda të ndriçimit për në rrugën e së vërtetës.

Mirësia e leximit të sures

Në një hadith të të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të de mbi familjën e tij!*) thuhet: “Kush lexon suren “*Ha Mim Ajn Sin Kaf*”, është nga ata për të cilët engjëjt bëjnë salavate për të, kërkojnë falje për të, kërkojnë mëshirë për të...”¹

Në një tjetër hadith të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), citohet: “Kush lexon “*Ha Mim Ajn Sin Kaf*”, All'llahu e ringjall Ditën e Kiametit me fytyrën e plotë si hëna në Natën e Bedrit, teksa e vendos para All'llahut që i thotë: “...O rob i im, e ke lexuar vazhdimisht suren “*Ha Mim Ajn Sin Kaf*” dhe nuk e dije se çfarë sevapi kishte. Nëse do ta dije se ç'është ajo dhe ç'është sevapi i saj, nuk do la lije kurrë leximin e saj...por, do ta jap shpërblimin tënd. Futeni në Xhennet!”. Dhe kur hyn në Xhennet, kënaqet me llojet e shumta të begative të All'llahut, të cilat i përmendi në mënyrë të hollësishme Imam Sadiku në hadithin e mësipërm.”²

¹ Tefsiri “Mekhmail Bejan”, vëll. 9, f. 31, fillimi i sures “Esh Shura”.

² “Theuabul A'mal”, marrë nga tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 556.

Ajetet 1-5

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

حم١ عسق، كَذَلِكَ يُوحَىٰ إِلَيْكَ وَإِلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكَ اللَّهُ الْعَزِيزُ
الْحَكِيمُ ٢ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ؛
تَكَادُ السَّمَاوَاتُ يَتَفَطَّرْنَ مِنْ فَوْقِهِنَّ وَالْمَلَائِكَةُ يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ
رَبِّهِمْ وَيَسْتَغْفِرُونَ لِمَنْ فِي الْأَرْضِ إِلَّا إِنْ اللَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ.

Me emrin e All'Ilahut, të Gjithmëshirëshmit, Mëshirëplotit!

"Hâ, Mîm."

"Ajn, Sîn, Kâf."

"Kështu All'Ilahu, i Plotfuqishmi, i Urti, të frymëzon ty (o Muhammed), ashtu siç i ka frymëzuar edhe ata para teje."

"Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Ai është i Larti, i Madhërishmi!"

"Qiejt gati sa nuk çahen nga sipër (prej madhështisë së All'Ilahut), ndërkohë që engjëjt lavdërojnë e falënderojnë Zotin e tyre dhe kërkojnë falje për ata që janë në Tokë. Me të vërtetë që All'Ilahu është Falësi dhe Mëshirëploti."

Komentimi

Qiejt e lartë mbi ta janë gati të pëlcasin!

Edhe një herë tjetër ndeshemi, në fillim të sures, me shkronjat e ndërprera, por këtu ato pasqyrohen në mënyrë të hollësishme. Para nesh kemi pesë shkronja.

“Ha Mim” është e pranishme në shtatë sure kur'anore (*Gafir, Fussilet, Esh Shura, Ez Zukhruf, Ed Dukhan, El Xhathije, El Ahkaf*), mirëpo në Suren *“Esh Shura”* është shtuar pjesa *“Ajn Sin, Kaf”*.

E kemi theksuar shpesh, që komentuesit kanë opinione dhe hulumtime të shumta rreth këtyre shkronjave. Dijetari et Tabersijju në komentimin *“Mexhmaul Bejan”* i ka përmendur njëmbëdhjetë thënie të tyre. Ne kemi përmendur më të rëndësishmet nga këto pohime, në fillim të sureve: *“El Bekare”, “Ali Imran”, “El A’raf”* dhe *“Merjem”*.

Këtu do të përmendim një pjesë të këtyre thënieve të komentuesve, pavarësisht se mungon argumenti i prerë për rregullsinë e tyre.

Një prej atyre është thënia e komentuesve se këto shkronja kanë ardhur si metodë e tërheqjes së vëmendjes së njerëzve ndaj Kur'anit. Idhujtarët dhe kryeneçët ranë në ujdi me njëri-tjetrin për të mos i dëgjuar ajetet e Kur'anit - sidomos kur i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua lexonte atyre - duke shkaktuar shamatë dhe zhurma. Prandaj dhe zbritën shkronjat e ndara (në suret e Kur'anit), për të qenë si një metodë e re në tërheqjen e vëmendjes.

Eruditi i madh Tabatabaij përmend një tjetër alternativë, të cilën vlen ta shtojmë në përmbledhjen e njëmbëdhjetë thënieve të grumbulluara nga eruditi Tabersij, kështu që numri i thënieve rreth shkronjave të ndara bëhet dymbëdhjetë.

Ajo që ka pohuar eruditi Tabatabaij, edhe pse është me thëniet e tjera që nuk kanë argument të prerë e bindës, mirëpo është e dobishme paraqitja e thënies së tij në formë të përmbledhur.

Eruditi Tabatabaiju thotë: "...Nëse në këto sure, ti mediton sadopak në lidhje me shkronjat hapëse, si shkronjat "*mim*", "*ra*", "*tavasin*" apo "*havamim*", në to do të gjesh patjetër ngjashmëri si në përmbajtje, ashtu edhe në përshtatje kontekstesh, si në asnjë sure tjetër. Kjo përforcohet më tepër me faktin se shumica e sureve hapen me të njëjtën shprehje, njëlloj si te hapja me "*Ha Mim*" (*havamimet*), ku thuhet: "**Shpallja e librit është prej All'ilahut!**"¹, apo dhe kuptimi që ka Fjala e Tij në hapjen e sureve me shkronjën "*ra*": "**Këto janë ajetet e librit të pacënueshëm!**"². Shembulli i kësaj është në ajetet hapëse të sureve *Tavasin* dhe në hapëset me shkronjën "*mim*", në ndalimin e dyshimit për librin apo në kuptimet që ka në të.

Mendohet se midis shkronjave të ndara dhe përmbajtjes së sureve që hapen me to, ka një lidhje të veçantë. Këtë e përforcon ajo çka ndeshim në suren "*El A'raf*", e cila nis me "*Elif, Lam, Mim, Sad*". Në përmbajtjen e saj, ajo sikur është bashkuese midis *Mim-ave* dhe *Sad-it*, d.m.th. midis sureve që hapen me shkronjat "*Elif, Lam Mim*" dhe "*Sad*"; po ashtu dhe sureja *Rra'd* fillon me "*Elif,*

¹Sure "*El Mu'minu*", ajeti 2 dhe sure "*El Xathije*", ajeti 2

² Sure "*Junus*", ajeti 1, dhe "*Jusuf*", ajeti 1.

Lam, Mim, Ra'', kështu që në përmbajtjen e saj, ajo është bashkuese midis përmbajtjeve të *Mim-ave* dhe *Ra-ve*.

Nëse medituesi do të thellohej më tej në lidhjet e këtyre shkronjave, duke krahasuar përmbajtjen e sureve që vijnë njëra pas tjetrës, çështja do të ndriçohej edhe më shumë.¹

Ka edhe një interpretim tjetër, të cilin e kemi treguar më parë, dhe që është hipoteza se shkronjat mund të jenë edhe shenja treguese, simbole të emërtimeve të Krijuesit, të begative dhe çështjeve të Tij.

Për shembull, në suren që komentojmë, shkronjën "*Ha*" e kanë konsideruar si Mëshiruesi, shkronjën "*Mim*" si Madhështori, "*Ajn*" si i Gjithëdituri, "*Sin*" si i Shenjti, "*Kaf*" si i Forti, i Fuqishmi, etj.²⁴

Disa dijetarë e kundërshtojnë këtë tezë duke thënë se nëse synimi i shkronjave të ndara, do të ishte që të tjerët të mos kenë njohuri për to, atëherë kjo është krejtësisht e pavërtetë, sepse ka ajete të shumta që flasin qartë për Emrat e All'llahut. Këtu duhet të bëjmë kujdes pasi simbolet dhe shenjat nuk nënkuptojnë gjithmonë që tema apo kuptimi të jenë sekret. Ndonjëherë, ato mund të jenë dhe shenja shkurtimi. Kjo çështje ka qenë e pranishme kohë më parë, madje është shumë e njohur edhe sot në kohët moderne, ku emrat e shumë shoqatave dhe organizatave të mëdha ndërkombëtare dalin në formën e një grupi të shkurtuar shkronjash të ndara, të cilat simbolizojnë një pjesë të emërtimeve të vërtetë.

¹ Tefsiri "*El Mijzan*", vëll. 18, f. 5 dhe 6.

² Ky komentim përftohet nga hadithi i Imam Sadikut. Shih tefsirin e "*Kurtubijit*", vëll. 9, f. 5822.

Pas shkronjave të ndara, ajeti i bekuar flet për frymëzimin dhe thotë: **“Kështu All’llahu, i Plotfuqishmi, i Urti, të frymëzonte ty (o Muhammed), ashtu siç i ka frymëzuar edhe ata para teje.”**

“Kedhalike” është tregues i përmbajtjes së sures.

Burimi i frymëzimit është vetëm një: dituria e All’llahut dhe fuqia e Tij. Gjithashtu, përmbajtja e frymëzimit në parime e në degëzime të shumta e të gjera është një për të gjithë Pejgamberët dhe kumtet e tyre, pavarësisht faktit se ka dallime midis thirrjes së një Pejgamberi nga ajo e një tjetri, çka e diktonte nevoja e kohës dhe rrugëtimit të përsosjes së njeriut.¹

Ajetet që po komentojmë, flasin për shtatë prej cilësive të panumërta dhe të përsosura të All’llahut, ku secila ka radhën e vet në çështjen e frymëzimit për një formë të caktuar. Janë dy cilësi që veçojmë në këtë ajet: **“i Plotfuqishmi, i Urti”**.

Fuqia dhe forca e Tij absolute pohojnë që Ai të jetë Sunduesi i frymëzimit dhe i përmbajtjes së Tij të madhe. Urtësia e Tij vërteton dhe pohon se frymëzimi hyjnor (*el uahjul ilahij*) të jetë i urtë dhe i përshtatshëm me nevojat integrale të njeriut për të gjitha çështjet dhe problemet.

¹Pavarësisht se është folur shumë nga komentuesit rreth referimit të emrit tregues **“Kedhalike”**, duket qartë se përmendja e tij janë vetë këto ajete të zbritura mbi Pejgamberin më të nderuar. Prandaj, kuptimi i ajetit është: *me të vërtetë, frymëzimi është në këtë formë, siç e ka zbritur All’llahu tek ti dhe tek të gjithë Pejgamberët e mëparshëm*. Është përdorur emri tregues për larg, pavarësisht nga afërsia e referimit të tij. Kjo për shkak të madhërimit dhe respektit.

Shprehja “juhá” është argument i vazhdimësisë së frymëzimit, që nga koha kur All'llahu krijoi Ademin, deri në kohën e Pejgamberit të fundit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ngaqë folja e kohës së tashme tregon vazhdimësi.

All'llahu i Madhëruar thotë: **“Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Ai është i Larti, i Madhërishmi!”**.

Në të vërtetë, Sundimi i Tij ç'ka në Qiell dhe në Tokë pohon se Ai nuk duhet jetë i panjohur nga krijesat e Tij. Ai i projekton çështjet dhe nevojat e njerëzve nëpërmjet rrugës së frymëzimit. Kjo përbën cilësinë e tretë prej shtatë cilësive të Tij.

Për sa u përket fjalëve “*el alijju*” dhe “*el adhimu*”, të cilat janë cilësia e katërt dhe e pestë e All'llahut të Madhëruar, në këto ajete ato tregojnë se Ai nuk ka nevojë për asnjë bindje dhe adhurim prej krijesave të Tij dhe se e bëri të mundur projektimin e çështjes së krijesave nëpërmjet rrugës së frymëzimit, me qëllimin e vetëm që t'i begatojë ato.

Ajeti që vjen më pas, shton: **“Qiejt gati sa nuk çahen nga sipër...”**¹, për shkak të zbritjes së frymëzimit nga All'llahu ose për shkak të fyerjes së prishur që idhujtarët dhe jobesimtarët ia referonin Unit të Shenjtë, ngaqë bënin idhujtari me statujat në vend të adhurimit të Tij.

Duke iu referuar asaj që u tha më sipër, del qartë se për fjalinë ka dy kuptime:

¹“*Jetefet'tarne*” vjen nga fjala “*fetare*”, njësoj si “*setare*”, që do të thotë “*çarje për së gjati*”.

Së pari: Ajo veçohet me temën e frymëzimit, që është temë bisede në ajetet paraprirëse. Përmbajtja e saj i ngjason ajetit 21 të sures “El Hashr”, ku thuhet: **“Sikur këtë Kur’an t’ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përulur dhe të copëtuar nga frika e All’lilaut...”**.

S’ka dyshim se Kur’ani është Fjalë e All’lilaut, që shkund qiejt kur zbret, e gati sa nuk i zhduk fare ato. Sikur ai të zbriste mbi male, ata do të çaheshin nga frika, sepse ajo është Fjalë e madhe e një Krijuesi të Urtë.

Mjerë për zemrën e njeriut, se ai është i vetmi që nuk përkulet, nuk dorëzohet e që këmbëngul në arrogancën e mendjemadhësinë e tij!

Së dyti: Qiejt gati pëlcastin dhe zhduken për shkak të idhujtarisë së idhujtarëve dhe adhurimit të tyre ndaj statujave dhe jo All’lilaut. Ata vënë shenjën e barazimit midis qenieve dhe gjallesave më të ulëta, me të Parin pa fillim, të Madhërishmin, Krijuesin e Gjithësisë.

Tefsiri i parë shtjellon ajetet që po komentojmë, të cilat mbështeten në frymëzimin, kurse Tefsiri i dytë përkon me ato që lexojmë në ajetet 90-91 të sures “Merjem”, ku All’lilahu i Madhëruar, pasi përmend fjalët e ulëta të jobesimtarëve, thotë: **“Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s’çahet e malet sa s’rëzohen të thërrmuar, ngaqë ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit.”**.

Duket qartë se midis dy tefsireve nuk ka kundërshtime.

Kurse, për sa i përket mënyrës së çarjes se qiejve dhe shkatërrimit të maleve, që ata janë krijesa të ngurta, për to përmenden fjalë dhe thënie të ndryshme në fund të trajtimit të dy ajeteve në suren “Merjem”.

Nëse do të nxirrnim një konkluzion të përgjithshëm për çka kemi thënë, atëherë theksojmë se tërësia e botës së krijesave inorganike, bimore e të tjera, e ka një lloj logjike dhe ndjenje, pavarësisht se ne nuk e konceptojmë dot atë. Mbi këtë bazë, ato e lartësojnë All'llahun, e falënderojnë Atë, i përulen Atij, e kanë frikë Fjalën e Tij.

Shprehja mund të jetë metaforë e madhështisë dhe rëndësisë së çështjes, siç themi për shembull: në të vërtetë, filan ngjarje ishte shumë madhështore, duket sikur Qielli u bashkua me Tokën.

Pjesa tjetër e ajetit vazhdon me fjalët: **“...ndërkohë që engjëjt lavdërojnë e falënderojnë Zotin e tyre dhe kërkojnë falje për ata që janë në Tokë...”**.

Engjëjt, që janë bartës të frymëzimit të madhëruar dhe ndërmjetësit e Tij, e madhërojnë dhe e falënderojnë gjithmonë All'llahun, e falënderojnë Atë me të gjitha përsosmëritë e Tij. Kur besimtari shmanget ndonjëherë, engjëjt e ndihmojnë dhe kërkojnë falje për të tek Krijuesii Madhëruar.

Kur engjëjt kërkojnë falje për gjynahet e mëdha të besimtarit, ata kërkojnë falje për të gjitha gjynahet e tjera. Kuptimi i thënies në këtë ajet mund të jetë pikërisht për këtë shkak.

Ndeshim një paralelizëm të këtij përgëzimi të madh në ajetin 7 të sures “Gafir” në Fjalën e All'llahut të Madhëruar, ku

thuhet: “Ata (engjëjt), që e mbajnë Fronin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata lypin falje për besimtarët, duke thënë: ‘O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin Rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit të Zjarrit flakërues!’”.

Ajeti i bekuar na tregon për cilësinë e gjashtë dhe të shtatë prej cilësive të All’llahut të Madhërueshëm, duke u përqendruar rreth faljes dhe mëshirës, që lidhen me frymëzimin dhe përmbajtjen e tij, në mënyrë të veçantë për punët e besimtarëve. Në lidhje me këtë, All’llahu i Madhëruar thotë: “...Me të vërtetë që All’llahu është Falësi dhe Mëshirëploti.”.

Me anë të kësaj renditjeje, ajetet plotësuan një kuadër të grupit të 99 attributeve të All’llahut, të cilët janë unikë vetëm për All’llahun e Madhëruar, e që lidhen me frymëzimin. Ajeti mbyllet me një thënie të bukur për përgjigjen e lutjes së engjëjve, në mënyrë të veçantë të kërimit të faljes nga ana e tyre për besimtarët, madje All’llahu i Madhëruar e shton mëshirën tek atributi i faljes, gjë që dëshmon mirësinë e Tij të pafundme.

Për sa i përket çështjes së frymëzimit, do të kemi një trajtim më të hollësishëm në fund të kësaj sureje, kur të flasim për ajetet 51-52.

A kërkojnë falje melekët për të gjithë?

Mund të shtrohet një pyetje tjetër rreth Fjalës së All’llahut të Madhëruar: “...kërkojnë falje për ata që janë në Tokë...”. A

pohon ajeti, kërkimin e faljes së melekëve (engjujve) për të gjithë njerëzit e Tokës, pa dallim? A mund të jetë e mundur kjo?

Kësaj pyetjeje i përgjigjet ajeti 7 i sures “Gafir”, ku thuhet:
“Ata lypin falje për besimtarët.”.

Si rrjedhim, duke u bazuar në këtë, s’ka dyshim se kushti i kërkimit të faljes prej melekëve, është besimi. Melekët janë të pagabueshëm, kështu që nuk kërkojnë të pamundurën për ata që nuk e meritojnë faljen.

Ajetet 6 - 8

وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ اللَّهُ حَفِيظٌ عَلَيْهِمْ وَمَا أَنْتَ عَلَيْهِمْ
بِوَكِيلٍ ۖ وَكَذَلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لِتُنْذِرَ أُمَّ الْقُرَىٰ وَمَنْ
حَوْلَهَا وَتُنْذِرَ يَوْمَ الْجُمُعِ لَا رَيْبَ فِيهِ ۚ فَرِيقٌ فِي الْجَنَّةِ وَفَرِيقٌ فِي
السَّعِيرِ ۖ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَهُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ يُدْخِلُ مَنْ يَشَاءُ
فِي رَحْمَتِهِ وَالظَّالِمُونَ مَا لَهُمْ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ۝

“All’llahu është zotërues, kujdestar i atyre që pos Tij adhurojnë zota të tjerë. Ti (o i Dërguar), nuk je i detyruar ndaj tyre.”

“Prandaj, Ne të shpallëm ty Kur’anin arabisht, që ta këshillosh kryefshatin (Mekën) dhe ato përreth saj, t’u tërheqësh vërejtjen për Ditën e Tubimit (Kiametit), për të cilën nuk ka dyshim. Një grup për në Xhennet, kurse një grup për në zjarr.”

“Sikur të kishte dashur All’llahu, do t’i bënte ata (njerëzit) një popull (të një feje), por Ai fut në mëshirën e Vet atë që do (atë që me vullnetin e vet pranon Rrugën e Drejtë), e jobesimtarët nuk kanë as mbrojtës, as ndihmës.”

Komentimi

Pikënisja nga "*Ummul kurra*"

Ajetet e mësipërme folën për çështjen e idhujtarisë, ndërsa ajeti i parë në këtë seri ajetesh flet për rezultatin e punës së idhujtarëve, si dhe fundin e çështjes së tyre. Në lidhje me këtë, All'Ilahu i Madhëruar thotë: **"...All'Ilahu është zotërues, kujdestar i atyre që pos Tij, adhurojnë zota të tjerë."** Kjo, derisa t'u kërkojë atyre llogari në një kohë të përshtatshme, e t'u japë dënimin që meritojnë për veprat e bëra.

Më tej, ajeti i flet të Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë: **"...Ti nuk je mbrojtës ndaj tyre"**; përgjegjësia jote është përcjellja e kumtit, të dërgosh tek të gjithë njerëzit, thirrjen e All'Ilahut.

Në Librin e All'Ilahut ka shumë ajete që tregojnë për këtë kuptim:

"...Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues."¹

"...E ti, ndaj tyre, nuk je ndonjë arrogant."²

"...Ne nuk të bëjnë përcjellës të tyre."³

"...I Dërguari nuk ka tjetër detyrim, vetëm të kumtojë (shpalljen)."⁴

Këto ajete qartësojnë vërtetësinë e lirisë së njerëzve dhe përzgjedhjes së rrugës që ata dëshirojnë me vullnetin e tyre të lirë. Ato tregojnë se vlera e vërtetë e besimit dhe punës së mirë fshihet

¹ Sure "ElGashije", ajeti 22.

² Sure "Kaf", ajeti 45.

³ Sure "El En'am", ajeti 107.

⁴ Sure "Maide", ajeti 99.

pas vullnetit të lirë të zgjedhjes, jo besimit dhe veprës së detyruar, domethënë vlerës së veprave artificiale.

Kur'an i Madhërishëm i referohet edhe një herë tjetër, çështjes së Shpalljes edhe pse në ajetet e mësipërme është folur gjerë e gjatë për origjinën e saj (shpalljes). Fjala këtu përqendrohet rreth qëllimit përfundimtar të Shpalljes, ku All'illahu i Madhëruar thotë: **"Prandaj, Ne të shpallëm ty Kur'an, arabisht, që ta këshillosh kryefshatin (Mekën) dhe ato përreth saj."**

Kuptimi i togfjalëshit "*Ummul kura*" këtu është për Mekën e Bekuar. Pastaj, All'illahu i thotë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'ua tërheqë vërejtjen njerëzve për Ditën e Kiametit, e cila është Dita e Tubimit të tyre për të dhënë llogari e për të marrë shpërblimin: **"...Dhe t'ua tërheqësh vërejtjen për Ditën e Tubimit (Kiametit), për të cilën nuk ka dyshim."**

Atë ditë, njerëzit do të ndahen në dy grupe: **"...Një grup për në Xhennet, kurse një grup për në zjarr."**

Ka mundësi që fraza "*kedhalike*", të tregojë se: ashtu siç u kemi shpallur të Dërguarve të tjerë Shpalljen me gjuhën e tyre, po ashtu edhe ty ta kemi shpallur Shpalljen, Kur'anin e Shenjtë, me gjuhën tënde, pra në gjuhën arabe.

Kështu që fraza "*kedhalike*" është treguese e asaj që ka zbritur në ajetin paraardhës që thotë: **"...Tek ata që kanë qenë para teje."**

Njëkohësisht, kjo frazë mund të jetë tregues se asaj që vjen pas, domethënë: *Ne e kemi shpallur Kur'an arabisht tek ti, me qëllim për të tërhequr vëmendjen.*

Është e vërtetë se në fund të ajetit, pra nga Fjala e All'llahut të Madhëruar: **“Një grup është për në Xhennet, kurse një grup është për në zjarr.”**, përfitojmë se përgjegjësia e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është përgëzimi dhe tërheqja e vëmendjes, mirëpo për shkak të ndonjë arsyeje, tërheqja e vëmendjes ndikon thellë në shpirtrat e njerëzve kryeneçë dhe injorantë. Për këtë, ajeti e përsërit dy herë thënien **“tërheqja e vëmendjes”**, me ndryshime mes tyre. Në rastin e parë, fjala përfshin tërheqjen e vëmendjes së dëgjuesve, kurse në të dytin përfshin frikësimin e tyre prej diçkaje që duhet të frikësohen, domethënë Kiametit dhe çfarë përmbledhet në të, si llogaridhënia për skandalet, çka do të jetë e dhimbshme dhe shumë e vështirë, për shkak të pranisë së dëshmitarëve, engjëjve dhe njerëzve të tjerë.

Pyetje: Disa mund të shtrojnë pyetjen: Nga Fjala e All'llahut të Madhëruar: **“...që ta këshillosh kryefshatin (Mekën) dhe ata përreth saj”**, përftohet se qëllimi i zbritjes së Kur'anit Famëlartë është për t'itërhequr vëmendjenbanorëve të Mekës dhe rrethinave të saj. A nuk bie në kontradiktë ky kuptim, me nocionin e Islamit botëror?

Përgjigje: Përgjigja për këtë pyetje formësohet nëpërmjet hulumtimit me kujdes të kuptimit që e përmban atë **“ummul kura”** (*kryefshati*).

Fjala **“ummul kura”**, që është një nga emrat e shumtë të Mekës, është e përbërë nga dy fjale, të cilat janë: *“ummun”*, që në

rrënjë ka kuptimin *baza* ose *zanafilla* e çdo gjëje. Prandaj, edhe nëna është emërtuar me këtë emër sepse ajo është bazadhe rrënja e fëmijëve.

Fjala “kurra” është shumësi i “karjetun” dhe ka kuptimin e çdo zone të banuar, ose qytet, pa dallim, sido që të jetë qyteti, i madh apo i vogël, apo thjesht fshat.

Në Kur’anin Kerim ka shumë argumente rreth këtij kuptimi.

Përse Meka u quajt me emrin *ummul kurra*?

Transmetimet islame theksojnë qartë se Toka në zanafillë ka qenë e gjitha e mbuluar me ujë, pastaj nisi të shfaqet toka e thatë, duke dalë në mënyrë graduale prej ujërave. Sot, teoritë shkencore dhe moderne e vërtetojnë plotësisht këtë pohim.

Transmetimet islame na bëjnë me dije se krahina e Qabesë ishte e para zonë që u shfaq nga tërheqja e ujit, pastaj toka e thatë nisi të zgjerohej në rrethinat e Qabesë, e cila njihet edhe si epiqendra e Tokës.

Si rrjedhim, bëhet e qartë se Meka është zanafilla dhe baza e të gjitha fshatrave dhe qyteteve mbi sipërfaqe të Tokës. Prandaj, kur thuhet: **“kryefshati dhe ata përreth tij”**, ka kuptimin e përfshirjes së të gjithë njerëzve që ndodheshin mbi sipërfaqen e rruzullit tokësor.¹

¹Kjo shprehje është përmendur në suren “El En’am” në ajetin 92. Në komentimin e këtij ajeti kemi përmendur sqarim të detajuar.

Për më tepër, ne dimë se Islami nisi të përhapej gradualisht nëpër botë. Në fillim, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u urdhërua të merrej me këshillimin e njerëzve të tij të afërm, siç thuhet dhe në Fjalën e All'llahut të Madhëruar: **"...Dhe tërhiqi vëmendjen farefisit tënd më të afërt."**¹ me qëllim që të forcoheshin bazat e Islamit dhe të ishte më i fuqishëm për t'u përhapur.

Pastaj, erdhi faza e dytë që bënte fjalë për paralajmërimin e arabëve, siç thotë All'llahu i Madhëruar: **"...një Kur'an në gjuhën arabe, për njerëzit me dije."**²

Gjithashtu, edhe thënia e Tij: **"...Se ajo (Shpallja) është lëvdatë e madhe për ty dhe për popullin tënd."**³

Kur u forcuan Shtyllat e Islamit mes këtyre njerëzve, u forcua dhe revokimi i tij. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u urdhëruaqë ta zgjeronte më tej, t'i tërhiqte vëmendjen gjithë botës dhe njerëzve, siç thuhet në fillim të sures "El Furkan": **"...Ai që ia shpalli Furkanin (Kur'anin, dallues mes së vërtetës dhe të pavërtetës) robit të vet (Muhammedit), që të bëhet Pejgamber i botës (këshillues), është i Madhëruar."** Kjo gjendet edhe në ajete të tjera.

Për shkak të këtij obligimi, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nisi të dërgonte kumte te kryetarët e vendeve përreth, por edhe jashtë

¹Sure "Esh Shuara", ajeti 214.

²Sure "Fusilet", ajeti 3.

³Sure "Zukhruf", ajeti 44.

Gadishullit Arabik, ku ftoi në Islam Kesranë, Kajsarin dhe Nexhashiun, si dhe shumë të tjerë.

Sipas këtyre mësimëve, edhe ndjekësit e tij bënë të njëjtën gjë. Ata thirrën në Islam çdo cep të botës, ku përhapën diturinë islame në të gjitha vendet e banuara të tokës.

Përse Dita e Kiametit u quajt me emrin *Dita e Tubimit*?

Për këtë ka thënie të ndryshme, si:

- Për shkak se atë Ditë realizohet bashkimi mes trupit dhe shpirtit.
- Për shkak të tubimit të njeriut me veprën e tij.
- Për shkak të tubimit të zullumqarit me atë që i është bërë padrejtësi.

Duket qartë se shkakun pasqyrohet në tubimin mes krijesave, prej të parave deri tek të fundit, siç lexohet qartë në Fjalën e All'llahut të Madhëruar: **"Thuaj edhe të parëve edhe të fundit! Keni për t'u tubuar në një ditë të caktuar."**¹

Duke iu referuar Fjalës së All'llahut: **"...Një grup është për në Xhennet, një grup për në zjarr"**, njerëzit ndahen në dy grupe. Ajeti që vjen pas tij, shton: **"...Po sikur të kishte dashur All'llahu, do t'i bënte ata një popull (në udhëzim)."**

Besimi i detyruar nuk ka vlerë, kështu që nuk mundet që një besim i tillë të kthehet në kriter për përsosjen njerëzore.

¹Sure "El Uakia", ajetet49-50.

Plotësimi i vërtetë arrihet vetëm kur njeriu ecën vetë, me dëshirën dhe zgjedhjen e tij të lirë e të plotë.

Ajetet kur'anore janë të mbushura plot me argumente të lirisë së njeriut. Shembulli i kësaj zgjedhjeje vjen ngaqë njeriu normalisht dallohet prej gjallesave të tjera, dhe kur i grabitet, i merret vullneti dhe dëshira, është njëlloj si t'i kenë rrëmbyer humanizmin e tij.

Si zotërimi i lirisë, ashtu edhe ai i zgjedhjes, janë rruga e integritetit, që gjithashtu mbetet një rrugë hyjnore e pastër, e cila nuk pranon tjetërsim.

Është për të bërë çudi me disa, që vazhdojnë të besojnë ende tek fatalizmi (*el xhebru*), ndërkohë që pohojnë se janë ndjekës të Profetëve. Në realitet, pranimi i fatalizmit është përgënjeshttrim i thirrjes së të gjithë të Dërguarve.

Kur besohet në fatalizëm (*el xhebru*), nuk ka kuptim ngarkimi i njeriut me vepra; nuk ka kuptim llogaria e as pyetja e përgjigjja, as këshillimi e as porosia, as shpërblimi e as dënimi. Nuk ka kuptim as pendimi e as vendosmëia e tij për të ndrequr veten.

Më pas, ajeti përshkruan njerëzit e Xhennetit duke thënë: **“Por, Ai fut në mëshirën e Vet atë që do. Jobsimtarët nuk kanë as mbrojtës dhe as ndihmës.”**

Banorët e zjarrit personifikohen me përshkrimin “*edh dhulmu*”, që nënkupton: *padrejtësinë*, kështu që bëhet e qartë se qëllimi për “*men jeshau*”, që do të thotë “**kë të dojë**”, në fjalinë e parë emërton grupin që nuk ka bërë padrejtësi.

Mbi këtë bazë njerëzit e drejtë janë prej banorëve të Xhennetit. Përballë tyre janë njerëzite padrejtësisë, zullumit, që mbesin banorë të zjarrit.

Këtu duhet të kemi kujdes se fjala “*dhalim*”, që do të thotë *zullumqar*, në shumë ajete të tjera kur’anore ka një kuptim më të gjerë. Ajo nuk përfshin vetëm ata që u bëjnë padrejtësi të tjerëve, por edhe ata që i bëjnë padrejtësi vetes së tyre, që nga besimi përfshin të shmangurit, kështu që nuk ka padrejtësi më të madhe sesa idhujtaria dhe mosbesimi.

Lukmani i tha djalit të tij teksa po e këshillonte: **“O biri im, mos i përshkruaj All’llahut shokë, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe.”**¹

Ndërsa në një ajet tjetër lexojmë Fjalën e All’llahut të Madhëruar: **“Pra, mallkimi i All’llahut qoftë kundër mizorëve! Të cilët pengojnë nga Rruga e All’llahut dhe përpiqen ta shtrembërojnë atë, e ata janë që nuk besojnë Botën Tjetër.”**²

Disa dijetarë flasin për ndryshimin mes fjalës: “*velij*” dhe “*nesiir*” dhe thonë se fjala: “*el velijju*” ka kuptimin e atij *qëçohet në ndihmën e njeriut, pa kërkesën e tij*.

Ndërsa kuptimi i fjalës “*nesiir*” është më i përgjithshëm.³³

Ka mundësi që fjala “*velij*” të tregojë për fisnikun që përballon njëherësh mbrojtjen dhe ndihmën, për hir të vilajetit të tij pa ndonjë lloj kërkesë.

Kurse “*ennesiru*” është ai që *përfiton mbështetjen e njeriut dhe ndihmën e tij, pasi ka kërkuar ndihmë*.

¹Sure “Lukman”, ajeti13.

²Sure “Hud”, ajetet18-19.

³ Kjo vihet re në tefsirin “Mexhmaul Bejan”, vëll. 8, f. 438; fundi i ajetit 22 i sures “Ankebut”.

Ajetet 9 - 12

أَمْ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ ۚ قَالَ اللَّهُ هُوَ الْوَلِيُّ وَهُوَ يُحْيِي الْمَوْتَى وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۚ وَمَا اخْتَلَفْتُمْ فِيهِ مِنْ شَيْءٍ فَحُكْمُهُ إِلَى اللَّهِ ذَلِكُمُ اللَّهُ رَبِّي عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَإِلَيْهِ أُنِيبُ ۚ فَاطِرُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ جَعَلَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا وَمِنَ الْأَنْعَامِ أَزْوَاجًا يَذُرُّكُمْ فِيهِ لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ۚ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ۚ لَهُ مَقَالِيدُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ يَبْسُطُ الرِّزْقَ لِمَنْ يَشَاءُ وَيَقْدِرُ ۚ إِنَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ۝

“Përkundrazi, ata zgjodhën mbrojtës pos Atij, por vetëm All’Ilahu është Ai, Mbrojtësi, dhe Ai i ngjall të vdekurit dhe Ai ka mundësi për çdo gjë.”

“Për çdo gjë që nuk pajtoheni, gjykimi për atë është tek All’Ilahu. Ai (gjykatësi i famshëm) është All’Ilahu, Zoti im, vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm Atij i drejtohem.”

“Ai është krijues i qiejve dhe i Tokës. Ai, nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte, edhe nga kafshët krijoi çifte, në mënyrë që t’ju shumojë. Asnjë send nuk është si Ai: Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.”

“Të Tij janë çelësat e qiejve dhe të Tokës. Ai begaton shumë atë që do dhe nuk begaton (atë që gjithashtu do). Ai është i Gjithëditur për çdo gjë.”

Komentimi

Kujdestari absolut

Në ajetet e mësipërme u bë e qartë se nuk ka mbrojtës dhe ndihmës tjetër përveç All’llahut. Ajetet që po komentojmë, japin argumente për këtë çështje dhe ndalojnë mbrojtjen pos All’llahut, të Lavdëruarit dhe të Madhëruarit.

Ajeti dëshmon në formën e habisë dhe të ndalimit dhe thotë: **“...Përkundrazi, ata zgjodhën mbrojtës pos Atij.”**¹ Veçse: **“...Po, vetëm All’llahu është Ai, Mbrojtësi.”**

Nëse ata do të dëshironin të zgjidhnin një mbrojtës, atëherë le të zgjedhin All’llahun, sepse argumentet e mbrojtjes së Tij janë të qarta si drita e diellit në ajetet e mëparshme që paraqitën Cilësitë e Tij të përkryera, i Forti dhe i Urti, Zotëruesi dhe i Larti, Madhështori, Falësi dhe Mëshirëbërësi. Këto shtatë cilësi që na u

¹ Disa komentues, si Zamkhashri në tefsirin “El Keshshaf” dhe Fakhru Razi në tefsirin “El Kebir”, kanë thënë se “em” këtu është në kuptimin e pyetjes mohuese. Ndërsa disa të tjerë, si Tabersiju në “Mexhmaul Bejan” dhe Kurtubiju në “El Xhamiu lil Ahkamil Kur’an”, e kanë vlerësuar me kuptimin “bel” (por, mirëpo).

paraqitën, konsiderohen, në vetvete, si argumenti më i fortë se Mbrojtësi i vetëm është All'illahu i Madhëruar.

Më pas ajeti përmendet një argument tjetër, ku thotë: “...**Dhe Ai i ngjall të vdekurit.**”. Duhet të strehohesh tek Ai dhe jo tek tëtjerët, sepse Kiameti dhe Ringjallja janë në dorën e Tij, se ajo që njeriu ka më shumë frikë, është fati i tij pas vdekjes.

Pastaj,ajeti përmend argumentin e tretë, që thotë: “...**Dhe Ai ka mundësi për çdo gjë.**”. Ky është një tregues i kushtit kryesor të mbrojtësit, që është zotërimi i fuqisë së vërtetë nga ana e Tij.

Ajeti në vijim, tregon argumentin e katërt të mbrojtjes (vilajetit) së Tij, të Madhëruarit, teksa thotë: “...**Për çdo gjë që nuk pajtoheni, gjykimi për të është tek All'illahu.**”. Ai është i Vetmi që mund të zgjidhë problemet tuaja.

Në të vërtetë, një prej veçorive të mbrojtjes është që mbrojtësi të mund të parandalojë konfliktet e atyre që janë nën mbrojtjen e tij, me anë të gjykimit të tij të drejtë. Atëherë, a munden vallë, statujat dhe shejtanët ta përballojnë këtë gjë? Apo kjo është çështje që i përket vetëm All'illaut, të Urtit, të Diturit, të Fortit për zgjidhjen e problemeve të robëve të Tij, në zbatimin e gjykimit dhe vullnetit të Tij, e të askujt tjetër.

Atëherë, All'illahu i Gjithëfuqishëm dhe i Urtë, Ai është Sunduesi, Gjykatësi dhe askush tjetër.

Disa komentues u përpoqën tapërkufizojnë nocionin e mosmarrëveshjes, që tregon ajeti me Fjalën e All'illaut të Madhëruar: “...**për çdo gjë që nuk pajtoheni**”, në mosmarrëveshjen që vjen në ajetet me kuptim të tërthortë, ose

vetëm në mosmarrëveshjet dhe konfliktet juridike. Ndërkohë që kuptimi i ajetit është më i gjerë se kaq dhe përfshin pa dallim të gjitha mosmarrëveshjet, qofshin për njohuritë hyjnore apo doktrinat, apo për ligjet, apo për çështjet juridike dhe penale, e të tjera gjëra që ndodhin mes njerëzve për shkak të informacioneve të pakta e të kufizuara të tyre. S'ka dyshim se këto duhet të zgjidhen nëpërmjet rrugës së Shpalljes dhe rikthimit te dituria e All'llahut dhe te vilajeti i Tij i pakufizuar.

Pas renditjes së argumenteve të ndryshme në specifikimin e mbrojtjes së All'llahut, në ajete me gjuhën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thuhet: **"...Ai është All'llahu, Zoti im"**¹, sepse është Ai që përshkruhet me këto cilësi të përkryera, e për këtë shkak: **"...Vetëm tek Ai jam mbështetur dhe vetëm Atij i drejtohem"**; domethënë kthehem, drejtohem tek Ai, në probleme, vështirësi dhe shkarje të ndryshme.

Fjalja: **"...Ai është All'llahu, Zoti im"**, tregon për sundimin absolut të All'llahut, pra ka kuptimin e sundimit të përhershëm, së bashku me administrimin. Dimë se sundimi (rubububijeti) ka dy pjesë: *pjesa krijuese*, që i referohet drejtimit të ekzistencës, dhe *pjesa legislative*, që bën sqarimin e ligjeve, vendosjen e rregullave për udhëzimin e njerëzve, nëpërmjet të Dërguarve dhe Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*).

¹ Në fillim të kësaj fjalie është fjala *"kul"* e nënvizuar, sepse kjo fjali dhe ajo që vjen pas saj, flasin vetëm me gjuhën e Profetit. Kurse fjalia: **"Për çdo gjë që nuk pajtoheni"** është vazhdim i tregimit të All'llahut. Ata që kanë zgjedhur pos kësaj, nuk kanë zgjedhur rrugën e vërtetë.

Më pas, ajeti parashtron çështjen e *"et tevekul"*, dhe çështjen *"el inabetu"*. E para ka kuptimin e rikthimit të të gjitha çështjeve të krijimit te Krijuesi, All'llahu, i Madhëruar. Ndërsa e dyta do të thotë rikthimi i çështjeve legislative tek Ai.¹

Ajeti pasardhës, mund të jetë argumenti i pestë i mbrojtjes absolute të All'llahut ose argumenti i sundimit të Tij. Merituesi i vetëm për t'u mbështetur te ai është vetëm All'llahu dhe askush tjetër. Ajeti thotë: **"...Ai është krijues i qiejve dhe i Tokës."**

Fjala *"fatirun"* vjen prej lëndës *"fetere"*. Në rrënjë ka kuptimin e *çarjes së diçkaje*. E kundërta e saj është *"kat'un"*, që do të thotë, sipas thënies së disave: *çarjepër së gjëri*.

Duket sikur ajeti tregon për çarjen e perdes së mosekzistencës së errët në krijimin e qenieve dhe dalja e krijesave prej saj.

Sipas këtij krahasimi, fjala: *"faturun"* është emërtim për lulëzimin e *hurmove* kur plasariten dhe prej tyre del fruti, hurma.

Ajo çka nënkuptohet këtu me qiejt dhe Tokën, janë të gjithë qiejt dhe Toka dhe çfarë ka në to prej gjallesave, sepse akti i krijimit i përfshin të gjitha ato.

Ajeti u bën një përshkrim tjetër veprave të All'llahut, kur thotë: **"...Ai, nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte, edhe nga kafshët krijoi çifte, në mënyrë që t'ju shumojë."**²

¹ Tefsiri "El Mijzan", vëll. 18, f. 25.

²Përemri *"fijhi"* - *"në të"* i referohet *"et tedbiru"* - *"administrimi"* ose i referohet thënies *"xheale ezvaxhen"* - *"ju krijoi bashkëshorte"* dhe *"jedhreu"* - *"t'ju shumojë"*, vjen nga *"dher'un"* njësoj si *"zer'un"*, që do të thotë *"krijim"*, mirëpo ai është krijim që shoqërohet me shfaqjen e njerëzve. Po ashtu, është përmendur edhe me kuptimin e shpërndarjes - *"elintisharu"*.

Kjo konsiderohet si një nga argumentet më të mëdha rreth sundimit të All'llahut, admistrimit dhe vilajetit të Tij, ku All'llahu i Madhëruar dhe i Lartësuar krijoi për njerëzit bashkëshorte prej vetes së tyre. Nga njëra anë kjo konsiderohet baza e qetësisë shpirtërore dhe zbutjes së egoizmit. Kurse nga ana tjetër martesë konsiderohet si bazë e vazhdimësisë së pasardhësve dhe e shumimit të tyre.

Pavarësisht se kumti i ajetit i drejtohet njeriut nëpërmjet thënies "*jedhreukum*"; porse, çështja është përgjithësuese dhe dëshmon se është një dispozitë e vazhdueshme dhe ligj i vazhdueshëm për të gjitha qeniet e tjera të gjalla, të cilat shumohen në të njëjtën mënyrë.

Në realitet, drejtimi i bisedës të njeriut, tregon pozitën e tij të nderuar, kurse pjesa e qëndrueshmërisë dhe e vazhdimësisë së tij, sqarohet nëpërmjet njeriut si shembull.

Cilësia e tretë që përmend ajeti, është Fjala e All'llahut të Madhëruar: "**...Asnjë send nuk është si Ai!**".

Kjo pjesë e ajetit përmban një të vërtetë thelbësore, sidomos për njohjen e Atributeve të All'llahut, pa të cilat është e pamundur të arrihet të cilësitë e tjera prej cilësive të Tij. Rrëshqitja më e madhe me të cilën përballen rrugëtuesit në Rrugën e All'llahut përfaqësohem me "*ngjashmërinë*" (*et teshbijhu*) duke e ngjasuar Krijuesin Fuqiplotë me cilësitë e krijesave të Tij, gjë që çon në rënien në luginën e idhujtarisë.

S'ka dyshim se ekzistenca e All'llahut të Madhëruar nuk ka as fund dhe as kufizohet në limite. Çdo gjë tjetër përveç Tij ka fund dhe është e kufizuar për nga masa, koha, dija, jeta, vullneti,

vepra...etj. kështu që All'illahu është i pastër nga të metat krijesave të mundshme.

Ajo që qëndron për të tjerët pos Tij, nuk është e vërtetë për Të, nuk zbatohet tek Veta e Tij e Pastër, madje as nuk mund të kuptohet për Të.

Për sa na përket neve, disa çështje janë të lehta e disa janë të vështira, disa ngjarje kanë ndodhur në të kaluarën, e disa ndodhin tani. Disa të tjera do të ndodhin në të ardhmen. Disa gjëra, fenomene e ngjarje janë të vogla e disa janë të mëdha.

Etalonet e këtyre gjërave, treguesit dhe nocionet e tyre konstatojnë se ekzistenca jonë është e kufizuar. Këto janë në përputhje me perceptimin tonë dhe me nevojat tona.

Për sa u përket këtyre specifikimeve, krahasimeve dhe terminologjive të kufizuara, s'ka dyshim që secila prej tyre nuk zbatohet për cilësitë e All'illahut. Për Të nuk ka kuptim afërsia apo largësia, sepse të gjithë janë afër në zbatimin e vullnetit të Tij. Nuk ka kuptim vështirësia apo lehtësia, sepse çdo gjë i është lehtësuar dhe bindur vullnetit të Tij absolut. Nuk ka të ardhme apo të shkuar, sepse çdo gjë për All'illahun e Madhëruar është e pranishme dhe e gatshme.

Në fakt, perceptimi dhe përvetësimi i këtyre kuptimeve është i pamundur, pa e zbrazur mendjen dhe pa e pastruar atë.

Pikërisht për këtë shkak, thuhet: Në të vërtetë, është e lehtë të njohësh ekzistencën së Krijuesit të Plotfuqishëm, por është e vështirë njohja e cilësive të Tij.

Prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebi Talib (*Paqja qoftë mbi të!*) për këtë çështje thotë: “...Në krijimin e Tij, e madhja dhe e vogla, e rënda dhe e lehta, e fuqishmja dhe e dobëta, çdo gjë është e njëjtë.”.¹

Fundi i ajetit tregon disa cilësi të tjera prej cilësive të pafundme të All’llahut: “**...Dhe Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.**”.

Ai është Krijuesi dhe Adnimistruesi, Dëgjuesi dhe Shikuesi. Në të njëjtën kohë, Ai nuk ka as të ngjashëm, as të njëjtë, prandaj nuk kërkohet mbrojtje, veçse prej Tij. Nuk duhet të adhurohet askush dhe asgjë tjetër veç Tij. Kjo bëhet vetëm duke zgjidhur litarët nga adhurimi i tjetërkujt dhe kthimi kah Ai dhe askush tjetër.

Ajeti pasues flet për tre cilësi të tjera prej cilësive të veprimit dhe të Vetës së Tij, ku secila prej tyre qartëson çështjen e vilajetit dhe të sundimit të All’llahut në një dimension tjetër.

All’llahu i Madhëruar thotë: “**...Të Tij janë çelësat e qiejve dhe të Tokës.**”.

Çdo gjë që njeriu zotëron është prej Tij, të Madhëruarit, të Lartësuarit. Çdo gjë që dikush dëshiron, duhet ta kërkojë prej All’llahut, se të Tij janë depot e qiejve dhe të Tokës, dhe jo vetëm “çelësat” e saj: “**Të All’llahut janë pasuritë e qiejve dhe të Tokës.**”.²

Fjala “mekaliid” është shumësi i fjalës “maklid”, që do të thotë çelës. Këtu përdoret si metaforë e sundimit të plotë mbi çdo gjë. Për shembull, thuhet: *me të vërtetë, çelësi i kësaj gjëje është në dorën*

¹“Nehxhul Belaga”, hutbeja 185.

²Sure “El Munafikun”, ajeti 7.

*time, domethënë se programi, rruga dhe kushtet e tij, të gjitha janë nën fuqinë dhe dorën time.*¹

Në atributin tjetër, i cili është fryt dhe rezultat i cilësisë mësipërme, ajeti thotë: **“...Ai begaton shumë atë që do dhe nuk begaton...”**, sepse në dorën e Tij janë të gjitha depot e qiejve dhe të tokës. Të gjitha furnizimet janë në dorën e Tij dhe Ai i ndan ato sipas dëshirës së Tij, e cila buron te urtësia e Tij. Çdo gjë që All'Ilahu jep është e bazuar te interesat e njerëzve.

Një prej çështjeve të përfitimit të të gjitha gjallesave nga furnizimi i All'Ilahut të Madhëruar, është dituria e Tij për masën e nevojës, vendin e saj dhe për çështjet e tjera të jetës. Prandaj, ajeti shton në atributin e fundit, fjalën e All'Ilahu të Madhëruar: **“...Ai është i gjithëditur për çdo gjë.”**.

Ka ajete të tjera që flasin për këtë çështje, siç është ajeti 6 i sures “Hud”, ku thuhet: **“...Nuk ka asnjë gjallesë në Tokë, që All'Ilahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj. Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas vdekjes). Të gjitha (këto) janë në librin e njohur.”**.

Katër ajetet që komentuar, përmendin njëmbëdhjetëtribute prejtributeve të përkryera të All'Ilahut, cilësitë *edh dhatije* (vetore), dhe *el fi'lijetu* (veprore). Ajetet e përshkruajnë All'Ilahun me atributet e vilajetit absolut, me ringjalljen e të vdekurve, me fuqinë e Tij që është mbi gjithçka, me krijimin prej Tij të qiejve dhe Tokës, me krijimin prej Tij të çifteve dhe shumimit të pasardhësve. Nuk ka të ngjashëm për Të, Ai është

¹ Me këtë specifikim kemi bërë një komentim të hollësishëm, që mund të shihet në fund të ajetit 63 të sures “Zumer”.

Dëgjues, Shikues. Të Tij janë depot e qiejve dhe të Tokës. Ai është Furnizuesi dhe i Gjithëdituri për çdo gjë.

Hulumtime

1- Njohja e attributeve të All'llahut të Madhëruar

Dituria jonë dhe e gjallesave është e kufizuar, prandaj ne nuk mund të arrijmë në strehën e Tij dhe tek e vërteta e pakufizuar e Vetës së Krijuesit. Të njohësh të vërtetën e diçkaje, nuk do të thotë ta kuptosh atë. Pra, si mundet atëherë të kuptojmë ne, qeniet e kufizuara, Vetën e të pakufizuarit?

E njëjta gjë mund të thuhet për atributet e All'llahut prej nesh, njerëzve. Nuk ka asnjë mundësi njohjeje për to, sidomos kur atributet e Tij janë Vetë Ai.

Dituria jonë për Vetën e Krijuesit dhe atributet e Tij është dituri e sipërfaqshme, pjesa më e madhe e së cilës vërtitet rreth gjurmëve, shenjave të Tij.

Në anën tjetër, shprehjet tona nuk mund ta sqarojnë qartë Unin e All'llahut dhe atributet e Tij absolute e të pakufizuara, sepse shprehja është vendosur për t'iu përgjigjur nevojave tona në jetën e përditshme. Do të arrinim në qëndrime të gabuara nëse do të përdornim shprehjet tona në përshkrimin e attributeve të

përkryera të All'llahut, siç janë: dituria, zotësia, jeta, mbrojtja, zotërimi dhe atributet e tjera.

Për shembull, themi: Në të vërtetë, All'llahu është "i Pari", por Ai është gjithashtu edhe "i Fundit". Ai është "i Dukshmi", por është edhe "i Fshehti". Ai është në gjithçka, por nuk është me diçka. Është larg çdo gjëje, por jo i panjohur.

Duket se në disa prej këtyre shprehjeve ka kundërtënie e kontradikta, sepse kuptimet i krahasojmë me gjëra dhe krijesa të kufizuara, kurse Ai është i Pari, por nuk mund të jetë i Fundit; është i Dukshëm, por nuk mund të jetë i Fshehur. Vetëm mendimi i përpiktë në Unin e All'llahut dhe atributet e Tij, jep mundësinë e zbatimit të kuptimeve të këtyre shprehjeve për Të, që Ai është i Pari, kur në të njëjtën kohë është edhe i Fundit, që Ai është i Padukshmi, kur në të njëjtën kohë është më se i Dukshmi.

Ne duhet të pranojmë njëzëri, se e rëndësishme në diturinë për përshkrimet e Tij, si të bukurisë dhe madhështisë së Tij të pafundme, është që të ndërgjegjësohemi në të vërtetën absolute, se: **"...Asnjë send nuk është si Ai."**

Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebi Talib, tregon qartë për këtë të vërtetë, kur thotë: *"...Ai njeri, i cili i përshkruan Atij gjendje, nuk beson në njësinë e Tij; as ai që e krahason, nuk e kupton vërtetësinë e Tij. Ai që e përshkruan, nuk e njeh Atë. Ai që tregon për Të dhe e përfytyron Atë, nuk e sqaron dot."*¹ Në një vend tjetër, ai thotë: *"...Çdo gjë që numërohet si një, përveç Atij, është një se është i paktë..."*²

¹"Nehxhul Belaga", hutbeja 186.

²"Nehxhul Belaga", hutbeja 65.

Si konkluzion: Është detyrë që të hulumtohet për atributet e Krijuesit, bazuar në dritën e Fjalës së Tij, të Madhërishmit: **“Asnjë send nuk është si Ai.”**. Ne duhet të shikojmë kah Uni i Tij i Shenjtë nëpërmjet Fjalës së Tij, të Të Lartësuarit: **“...Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.”**. Shprehja: *“SubhanAll’llah”*, në adhurime dhe të tjera, dëshmon për këtë të vërtetë.

2- Vëmendje edukative

Shkronja *“kef”* në fjalinë: **“lejse ke mithlihi shej’un”**– **“Asnjë send nuk është si Ai”**, është për të krahasuar, por gjithashtu ka dhe kuptimin e *të njëjtit*. Kjo përsëritje u bë shkaktare që shumica e komentuesve ta konsiderojnë atë të tepërt, apo se ajo ka ardhur për të përforcuar, e të tjerathënie të dijetarëve.

Ka edhe një koment tjetër, më i bukur, ku thuhet ndonjëherë: *njerëz si ti, nuk largohen nga vendngjarja*. Domethënë, ai që ka trimërinë, logjikën dhe zgjuarsinë si ti, nuk duhet të largohet. Thelbi është se, *kush ka ato cilësi që ke ti, duhet të jetë kështu e kështu*.

Në ajetin që po komentojmë, kuptimi është: Nuk ka të njëjtë me Krijuesin, për të cilin përmendëm cilësitë e Tij, si dituria e gjerë, fuqia madhështore dhe e pallogaritshme.

Disa profesorë dhe dijetarë të gjuhës pohojnë se disa terma kanë të njëjtin kuptim, *mithl*, veçse kjo nuk është e barabartë me to në nocion nga këndvështrimi gjithëpërfshirës. Për shembull:

fjala “*neddun*” është njëlloj si “*dhiddun*” dhe përdoret kur *synohet me ngjashmërinë ajo ngjashmëri në thelb e në lëndë*.

“*Shibhun*” - thuhet kur është fjala vetëm për mënyra, metoda.

“*Musavijun*” - thuhet kur është fjala vetëm për sasinë.

“*Sheklun*” - thuhet kur është fjala për krahasimin e masës dhe të largësisë.

Fjala “*mithlun*” është një nocion më i gjerë dhe më i përgjithshëm, kështu që i përfshin të gjitha kuptimet e përmendura më lart.

Kështu, kur All’llahu dëshiron të ndalojë, të mohojë ndaj Vetës së Tij çdo përngjasim e shembull, thotë: “**...Asnjë send nuk është si Ai.**”¹

3- Disa çështje rreth furnizimit të All’llahut

a) Standardi i dhënies së riskut (furnizimit) dhe vlerësimi i tij

Nuk duhet të mendojmë se dhënia e furnizimit nënkupton dashurinë e All’llahut për ne, apo se ngushtimi i jetesës është argument i zemërimit të Tij. All’llahu mund ta provojë njeriun nëpërmjet dhënies së riskut për të, ndonjëherë madje, dëshiron të testojë durimin dhe përballimin e tij, nëpërmjet rrugës së vështirësive të jetesës.

Nëpërmjet kësaj rruge synohet edukimi i njeriut.

¹ Shih “El Mufredatu Rragib”, lënda “methale”.

Pasuria e madhe, nganjëherë mund të bëhet shkak i ndëshkimit të atyre që e kanë, i lodhjes, rrëmbimit të stabilitetit dhe qetësisë së tyre shpirtërore, siç thotë Kur'ani Famëlartë në ajetin 55 të sures "Teube": **"...Prandaj mos të të mahnisë pasuria e tyre, e as fëmijët e tyre. All'Ilahu do vetëm t'i dënojë me to në jetën e kësaj bote e t'ju nxjerrë shpirtrat duke qenë ashtu, qafirë."**

Edhe në dy ajetet 55-56 të sures "El Mu'minun", lexojmë Fjalën e All'Ilahut të Madhëruar: **"...A mos mendojnë ata se me atë që jemi duke iu dhënë atyre nga pasuria dhe fëmijët, nxitojmë t'u ofrojmë atyre të mirat? Jo, kurrsesi, por ata nuk e kuptojnë."**

b) Përcaktimi i mjeteve të jetesës nuk bie ndesh me përpjekjet

Ajetet që flasin për përcaktimin e sasisë së mjeteve të jetesës, nuk bien ndesh me përpjekjen e njeriut për përfitimin e furnizimit. Duhet që situata të mos jetë nxitëse për ngathtësinë, përtacinë dhe arratisjen nga marrja e përgjegjësisë të luftës, përpjekjes individuale dhe shoqërore, se ka shumë ajete të tjerë kur'anore që e përforcojnë më tej rëndësinë dhe vlerën e përpjekjeve të njeriut.

Qëllimi është që ne të kuptojmë se, pavarësisht përpjekjes dhe punës sonë, ka një dorë të fshehtë, e cila ndalon rezultatet e këtyre mundimeve dhe nganjëherë bën edhe të kundërtën e saj, me qëllim që njerëzit të mos harrojnë se gjatë jetës së tyre të gjatë sociale ekziston një fuqi tjetër, shkaktari i vërtetë i shkaqeve. Është pikërisht ajo fuqi, që administron çështjet e botës.

Këtu nuk duhet që pasojat e përtacisë, lënies pas dore e neglizhencës, të hidhen mbi nocionin efurnizimit të All'llahut të caktuar për çdo njeri, sepse All'llahu i Madhëruar e ka bërë të qartë, se dhënia e riskut është e barabartë me mundin dhe përpjekjen e njeriut.

c) Moskufizimi i furnizimit (rizkut) me nocionin material

Për furnizimin dhe të mirat e jetës ka një kuptim më të gjerë, i cili përfshin edhe riskun shpirtëror. Madje, risku parësor është risku shpirtëror. Në disa lutje hasim shembuj të shumtë që e përforcojnë këtë. Për shembull, rreth Haxhit, ku thuhet: *"...O All'llah, ma bëj risk mua të bëj Haxhin në shtëpinë Tënde të Shenjtë."*

Ndërsa në lutjet e kërimit të bindjes ndaj All'llahut, themi: *"...O All'llah, më jep mbarësi në bindjen dhe largimin nga mëkatet."*

Kurse në lutjet e ditëve të muajit të Ramazanit, themi: *"...O All'llah, më jep në të bindjen e atyre që Të kanë frikë."* (Duaja e ditës së pesëmbëdhjetë). E të tjera lutje shpirtërore.

d) Kur'ani dhe shkaqet që çojnë në shtimin e riskut

Kur'ani Kerim përmend disa çështje të cilat konsiderohen në vetvete një leksion për edukimin e njeriut dhe formimin e tij. Në ajetin 7 të sures "Ibrahim" lexojmë Fjalën e All'llahut, që thotë: *"...Nëse falënderoni, do t'ua shtoj të mirat."*

Ndërsa në ajetin 15të sures "Mulk", All'llahu thotë: *"...Është Ai që jua bëri juve Tokën të përshtatshme, andaj ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij."*

Në suren “A’raf”, ajeti 96, thuhet: **“...E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t’u hapnim begati nga Qielli dhe Toka.”.**

e) Ngushtimi i rizkut dhe edukimi

Ka raste që ngushtimi apo pakësimi i rizkutndodh për t’i ndaluar njerëzit nga padrejtësia, siç e lexojmë në Fjalën e All’llahut: **“...Sikur All’llahu t’ua shumonte begatitë robëve të Vet, ata do të kalonin kufijtë.”.**¹

f) Furnizuesi është All’llahu

Kur’ani Kerim na siguron se ai që u jep furnizim (rizk) njerëzve është All’llahu. Ata nuk duhet të kërkojnë tek tjetër, veç Tij. Madje, ata e kanë për detyrë që pas besimit dhe mbështetjes, të përpiqen me forcat dhe përpjekjet e tyre, siç thuhet në ajetin 3 të sures “Fatir” në Fjalën e All’llahut të Madhëruar: **“...A ka ndonjë zot tjetër përveç All’llahut, që ju furnizon juve nga Qielli dhe Toka?”**; si dhe në ajetin 17 të sures “Ankebut”, ku thuhet: **“...pra, kërkojeni furnizimin tek All’llahu.”.**

Në këtë mënyrë e shkëput edukata kur’anore shpirtin e nevojës së njeriut drejt njerëzve të tjerë. Kjo edukatë e bën njeriun të lidhet me Krijuesin, Formësuesin dhe Furnizuesin e tij. Ajo kultivon në të shpirtin e adhurimit dhe të përkushtimit ndaj All’llahut.

¹ Sure “Esh Shura”, ajeti 27.

Në fund të komentit të ajetit 71 të sures “Nahl” dhe në fund të komentit të ajetit 6 të sures “Hud”, kemi një diskutim të hollësishëm, në mënyrë të veçantë për rizkun dhe përpjekjen në jetë, për shkaqet e rizkut dhe burimet e tij.

Ajetet 13-14

شَرَعَ لَكُم مِّنَ الدِّينِ مَا وَصَّى بِهِ نُوحًا وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ وَمَا وَصَّيْنَا بِهِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى وَعِيسَى أَنْ أَقِيمُوا الدِّينَ وَلَا تَتَفَرَّقُوا فِيهِ كَبُرَ عَلَى الْمُشْرِكِينَ مَا تَدْعُوهُمْ إِلَيْهِ اللَّهُ يَجْتَبِي إِلَيْهِ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي إِلَيْهِ مَنْ يُنِيبُ^{١٣} وَمَا تَفَرَّقُوا إِلَّا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْعِلْمُ بَغْيًا بَيْنَهُمْ وَلَوْلَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِنْ رَبِّكَ إِلَى أَجَلٍ مُّسَمًّى لَفُضِيَ بَيْنَهُمْ وَإِنَّ الَّذِينَ أُورِثُوا الْكِتَابَ مِنْ بَعْدِهِمْ لَفِي شَكٍّ مِنْهُ مُرِيبٍ^{١٤}

“Ai ju përcaktoi juve Fe, atë që i pati përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty, me atë çka patëm porositur Ibrahimin, Musanë dhe Isanë. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thërrisni ata. All’llahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe udhëzon në të atë që i drejtohet Atij.”

“Po ata, pasi u erdhi e vërteta, nuk u përçanë për tjetër, por nga zilia mes tyre. E sikur të mos ishte fjala (vendimi) e hershme nga Zoti yt për deri në një afat të caktuar, do të kryhej (dënimi) mbi ta. Nuk ka dyshim se ata që trashëguan librin prej tyre (prej të parëve), janë në një dyshim të thellë ndaj tij.”

Komentimi

Islami është esenca e legjislacioneve të të gjithë Profetëve

Megjithëse shumë prej diskutimeve të kësaj sureje lidhen me idhujtarët dhe ajetet e kaluara, edhe ajetet që po komentojmë, e sqarojnë se thirrja islame drejt Njehsimit nuk është një thirrje e re. Në të vërtetë, ajo është thirrja e të gjithë Pejgamberëve *“ulul azmi”* (të vendosurit). S’ka dyshim se të gjitha thirrjet e Pejgamberëve për çështjet thelbësore edhe në fetë e ndryshme qiellore janë një, vetëm një.

Ajeti thotë: **“Ai ju përcaktoi juve për Fe atë që i pati përcaktuar Nuhut”,** i cili është nga Pejgamberët e parë prej të vendosurve.

Gjithashtu: **“...Dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musanë dhe Isanë.”**

Në këtë formë, ajo që ishte e pranishme në legjislacionet e të gjithë Pejgamberëve, është e pranishme edhe në legjislacionin tënd. Atë që zotëronin të gjithë njerëzit e mirë së bashku, ti e zotëron atë i vetëm.

Shprehja *“mined din”* na e bën të qartë se harmonia midis të gjitha legjislacioneve qiellore nuk ishte e specifikuar vetëm në *Teuhid* dhe në parimet e besimit, por në të gjithë përmbledhjen e fesë hyjnore, pasi bazat dhe rrënjët ishin dhe janë një.

Për këtë shkak, ka argumente të shumta në ajetet e tjera kur'anore, që sqarojnë se dispozitat e përgjithshme të besimeve, ligjeve dhe mësimeve janë një, për të gjitha fetë.

Si shembull, lexojmë në Kur'anin Kerim, në mënyrë të veçantë shpjegimin e situatës së shumë prej Profetëve, se thirrja e parë e tyre ishte: **“O populli im, adhuroni All'Ilahun!”**.¹

Ndërsa në një vend tjetër lexojmë: **“...Ne dërguam në çdo popull të Dërguar që t'u thonë: 'Adhuroni vetëm All'Ilahun!'”**.²

Gjithashtu, është përmendur paralajmërimi për Ringjallje në thirrjen e shumë Profetëve, si tek: Sure “El E'nam”, ajeti 130; Sure “El A'raf”, ajeti 59; Sure “Esh Shuara”, ajeti 135; Sure “Ta Ha”, ajeti 15, Sure “Mer'jem”, ajeti 31.

Profeti Musai, Isai dhe Shuajbi, (*Paqja qoftë mbi ta!*) kanë folur për Namazin: Sure “Ta Ha”, ajeti 14; Sure “Mer'jem”, ajeti 31; Sure “Hud”, ajeti 87.

Ndërsa Ibrahim bën thirrje për Haxh: Sure “El Haxh”, ajeti 27.

Agjërimi ishte i ligjësuar, i vendosur në të kaluarën tek të gjithë popujt: Sure “El Bekare”, ajeti 183.

Si rrjedhim, të gjithë Profetëve u jepet kjo këshillë: **“...Ta praktikoni Fenë e Drejtë dhe mos u përçani në të!”**.

¹Sure “El A'raf”, ajetet 59, 65, 73, 85; Sure “Hud”, ajetet 50, 61 dhe 84, të cilat kanë ardhur sipas radhës, veçanërisht për Nuhun, Hudin dhe Salihun (*Paqja qoftë mbi ata!*).

²Sure “En Nahl”, ajeti 36.

Pra, ajeti këshillon për dy çështje të rëndësishme:

E **para:** praktikimi i fesë së All'llahut të Madhërueshëm në të gjithë rruzullin tokësor, jo vetëm me punë, por edhe praktikimi, ringjallja dhe përhapja e saj.

E **dyta:** mbrojtja nga fatkeqësitë e mëdha, domethënë ndarja në grupe dhe shfaqja e hipokrizisë në fe.

Më poshtë shtohet: **"...Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thërrisni."**

Këta e morën mbi vete idhujtarinë dhe adhurimin e statujave, për shkak të injorancës dhe fanatizmit, për shumë vite me radhë, kështu që ajo u rrënoj në thellësi të tyre, sa që thirrja në Njehsimin e Zotit i bëri të frikësohen dhe tmerrohen. Për më tepër, interesat e liderëve idhujtarë të palegitimuar janë ruajtur në idhujtari. Njehsimi është baza e revolucionit të të dobtëve, çka qëndron si pengesë para pasionit të mizorëve dhe padrejtësive të tyre.

Siç është në dorë të All'llahut përzgjedhja e Pejgamberëve, gjithashtu edhe udhëzimi i njerëzve është plotësisht në dorën e Tij: **"...All'llahu veçon për të atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij."**

Hulumtime

Ka disa pikandaj të cilave duhet patur kujdes:

1-Fjala “*sherea*” vjen nga fjala *sher’un*, që nga rrënja do të thotë *rrugë e qartë*. Esh *sheriat* thuhet për *rrugën që të çon në lumë*. Më vonë, kjo fjalë u përdor në mënyrë të veçantë për fetë e All’llahut dhe legjislacionet qiellore, sepse vetë rruga e lumturisë pasqyrohet qartë në të. Ajo është rruga që mbërrin te besimi dhe përkushtimi, te paqja dhe drejtësia.

Ashtu siç është uji baza, esenca e pastërtisë, e pastrimit dhe jetës, edhe për këtë term ka një përshtatje të qartë me fenë hyjnore, që i drejton këto vepra nga ana shpirtërore bashkë me shpirtin e njeriut dhe të shoqërisë njerëzore.¹

2- Ky ajet flet vetëm për pesë Profetë të All’llahut që janë: Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhammedi, (*Paqja qoftë mbi ta!*) sepse këta janë Profetët e *ulil azmi*, që do të thotë: *më të vendosurit*, domethënë njerëzit e fesë dhe të legjislacionit. Në të vërtetë, ajeti tregon kufizimin e Sheriatit nga këta pesë Profetë.

3-Në fillim, ajeti përmendi Nuhun, sepse Sheriati i Parë, feja që përfshin të gjitha ligjet adhuresë dhe shoqërore, ka zbritur prej tij, ngaqë ka patur mësimë dhe programe të kufizuara për Profetët që e paraprinë atë.² Për këtë shkak, as Kur’ani dhe as

¹ Ky kuptim ka ardhur në formë të përmbledhur në librin “Lisanul Arab” në “El Mufredatu” i Ragibit dhe në libra të tjerë të gjuhës arabe.

² Ka një shpjegim që e kemi përmendur me këtë veçanti në fundin e ajetit 213 të sures “El Bekare”.

trasmetimet islame nuk kanë folur për librat qiellorë para Nuhut, (*Paqja qoftë mbi të!*).

4- Është e domosdoshme të theksojmë se në përmendjen e pesë Profetëve, është përmendur Nuhu, (*Paqja qoftë mbi të!*) në fillim, pastaj Pejgamberi i Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), më pas Ibrahim, Musai, dhe Isai, (*Paqja qoftë mbi ata!*). Kjo renditje është e tillë për shkak se Nuhu ishte ai që nisi dhe e hapi këtë rrugë. Profeti i Islamit u përmend i dyti për shkak të madhështisë së tij, pastaj të tjerët përmenden sipas radhës së kohës kur jetuan.

5- Gjithashtu, është e domosdoshme të përmendim se Kur'ani i Madhërisë përdor shprehjen: **"...Të shpallëm ty"**, që është e posaçme për Profetin e Islamit. Mirëpo, për Profetët e tjerë Kur'ani përdor shprehjen **"...Ne porositëm"**. Ky ndryshim në shprehje mund të jetë për shkak të rëndësisë së Islamit në krahasim me të gjitha fetë e tjera qiellore.

6- Shprehja: *"men jeshau"*, ka ardhur për mënyrën e përzgjedhjes së Profetëve në fund të ajetit, e cila mund të jetë tregues i përmbledhur i kapaciteteve vetjake të të Dërguarve të All'llahut.

Përsa i përket popujve është përdorur shprehja: *"menjunibu"*, që do të thotë rikthimi tek Krijuesi dhe pendimi prej mëkatit me qëllim që të qartësohet për të gjithë kriteri i udhëzimit të All'llahut dhe kushtet e tij për të gjithë që të gjejnë rrugën e shpëtimit drejt oqeanit të mëshirës së Tij.

Në një Hadith Kudsij thuhet: “...Kush më afrohet Mua një pëllëmbë, i afrohem atij rob i një kut, dhe kush vjen tek Unë duke ecur, i shkoj atij duke nxituar.”¹

Kjo tezë përmendet gjithashtu, në komentin e fjalisë së fundit, se “përzgjedhja” nuk veçohet vetëm për Profetët, por përfshin të gjithë njerëzit e sinqertë që kanë fituar një pozitë të lavdëruar te Krijuesi.

Përderisa një nga shtyllat e thirrjes së Profetëvetë vendosmërisë së lartë (*ulil azmi*), është mospërçarja në fe dhe për këtë ata ftonin, këtu mund të shtrohet pyetja: Cila është baza e të gjitha këtyre mospajtimitve sektare?

Ajeti tjetër i përgjigjet kësaj pyetjeje duke përmendur thelbin e kontradiktave fetare, që është: “**...Po, ata, pasi u erdhi e vërteta, nuk u përçanë për tjetër, por nga zilia mes tyre**”; pra, kontradiktat nuk kanë ndodhur veçse për shkak të dashurisë së kësaj bote, pozitës dhe padrejtësisë, zilisë dhe armiqësisë.

Skllëvërit zullumqarë të dynjasë, ziliqarët dhe keqdashësit, ishin kundërshtarët e feve dhe Profetëve. Ata nxitën grupet që të merrnin një drejtim të caktuar, që të forconin udhëheqjen e tyre dhe të siguronin interesat e tyre në këtë dynja, duke zbuluar hapur zilinë dhe armiqësinë e tyre ndaj besimtarëve të vërtetë të fesë dhe ndaj Profetëve. E gjitha kjo ndodhi pas ardhjes së argumentimit nga ana e All’llahut.

Sipas kësaj radhitjeje, s’ka dyshim se thelbi i përçarjes në fe nuk ishte injoranca, por padrejtësia, shtypja, shmangia nga e

¹Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 27, f. 157; fundi i ajetit në fjalë.

vërteta, pasionet dhe mendimet vetjake. Dijetarët, të cilët kërkojnë dynjanë dhe njerëzit dashakeqë e fanatikët u bënë njëzëri së bashku për t'i mbjellë këto kontradikta.

Ky ajet konsiderohet si një kundërpërgjigje e qartë ndaj atyre që spekulojnë se feja krijoi konflikte mes njerëzve, duke bërë që të ketë shumë gjakderdhje përgjatë historisë. Po të hetonim me kujdes për këtë çështje, do të arrinim në konkluzionin se feja gjithmonë është bazë e njëzëshmërisë dhe e bashkimit të shoqërisë, siç ka ndodhur me Islamin dhe fiset e Hixhazit, deri në popujt jashtë Gadishullit, të cilët falë Islamit i dhanë fund konflikteve, duke u bërë një popull i vetëm.

Janë politikat kolonialiste ato që kanë krijuar përçarje mes njerëzve dhe kanë nxitur konflikte. Ato kanë qenë baza e gjakderdhjes duke imponuar politikat dhe pasionet e tyre të mbrapshta ndaj feve qiellore. Ato ishin dhe mbeten një faktor i madh në prodhimin e përçarjes, e kjo në vetvete buron nga tirania.

Fjala "*el bag'ju*", siç dëshmon rrënja gjuhësore e fjalës, do të thotë: *kërkimi i tejkallimit*, shmangia nga vija e mesme dhe animi nga teprimi ose neglizhenca, pa dallim nëse zbatohet apo jo kjo kërkesë. Sasia dhe cilësia e kësaj kërkesë është e ndryshme. Për këtë shkak, në të shumtën e rasteve kjo fjalë përdoret për padrejtësinë.

Ndonjëherë, kjo fjalë përdoret për çdo kërkesë, pavarësisht të qenit të saj punë e mirë dhe e pëlqyeshme.

Ragibi në librin e tij "*El Mufredatu*", e ndan fjalën "*bag'jun*" në dy kuptime të kundërta: *të pëlqyer* dhe *të papëlqyer*. E

para: Tejkalon kufirin e drejtësisë dhe mbërrin tek bamirësia dhe altruizmi, pra është tejkalimi i detyrimeve dhe arritja e të pëlqyeshmeve. **E dyta:** Tejkalon të drejtën dhe kalon drejt të padrejtës.

Kur'ani Kerim shton: **“...E sikur të mos ishte fjala e hershme nga Zoti yt për deri në një afat të caktuar, do të kryhej mbi ta”,** e cila do të shkatërrojë ndjekësit e së keqes dhe do të ndihmojë ndjekësit e së vërtetës.

Sigurisht, kjo dynja është vendi i provimit, edukimit dhe integritetit. Kjo nuk mund të arrihet pa lirinë e veprimit. Pikërisht, ky është urdhri i krijimit të All'llahut, i Cili është i pranishëm nga fillesa e krijimit të njeriut dhe nuk e pranon kurrë ndryshimin. Kjo është natyra e jetës së kësaj dynjaje, mirëpo ajo që e dallon dhe veçon Botën e Ahiretit është se, të gjitha këto konflikte do të marrin fund dhe njerëzimi do të arrijë bashkimin e plotë. Prandaj, për këtë arsye përdoret shprehja *“jeumulfas'l”* për *Kiametin*.

Fjalja e fundit vjen për të sqaruar situatën e atyre njerëzve që erdhën pas këtij grupi, d.m.th., ata që nuk e kanë arritur kohën e të Dërguarve, por erdhën në botë kur hipokritët dhe përçarësit injektuan në gjakun e shoqërisë njerëzore natyrën djallëzore, për shkak të së cilës, ata nuk mundën ta perceptonin të vërtetën në mënyrë të qartë. Për këtë thuhet: **“...Nuk ka dyshim se ata që trashëguan librin prej tyre, janë në një dyshim të thellë ndaj tij.”**¹

¹Sipas këtij komentimi, i cili harmonizohet në mënyrë të plotë me fjalitë e kaluara, përemri **“ba'dehum”** në kuptimin: **“pas tyre”** u referohet popujve të parë, që krijuan përçarje mes rrymave dhe feve. Ky përemër nuk u referohet Pejgamberëve të përmendur në ajetin paraprirës.

Lidhur me vërtetësinë e fjalës “*rejban*”, komentuesit kanë thënë se me të emërtohet *dyshimi*, i cili zëvendësohet në fund me të vërtetën mbasi kthjellohet prej tij. Kjo çështje mund të jetë edhe treguesi i ardhjes së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me argumente të qarta, i cili fshiu përfundimisht gjurmët e dyshimit dhe mëdyshjes nga zemrat që kërkonin të vërtetën.

Hulumtim

Në tefsirin e Ali ibn Ibrahim përmdnet një transmetim nga Imam Sadiku, (*Paqja qoftë mbi të!*) për thënien e All'lahut të Madhëruar: “**...Të praktikoni Fenë e Drejtë**”, i cili ka thënë: “**...dhe mos u përçani në të**”, kjo është metafor për Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun, (*Paqja qoftë mbi të!*). Pastaj, Imami tha: “**Për idhujtarët është e rëndë kjo në çka ju i thërrisni ata**” nga çështja e vilajetit të Aliut “**All'lahu veçon për të atë që do**” aludim për Aliun, (*Paqja qoftë mbi të!*).¹

Natyrisht, qëllimi nuk është kufizimi i fesë në vilajetin e Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Synimi është sqarimi i të vërtetës, se çështja e vilajetit të Prijësit të besimtarëve, Aliut, konsiderohet gjithashtu, prej bazave të fesë.

¹Tefsiri “Nuruth Thekalejn” , vëll. 4, f. 567.

Ajeti 15

فَلِذَلِكَ فَادْعُ وَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَقُلْ آمَنْتُ
بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ مِنْ كِتَابٍ وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمْ اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ
لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ لَا حُجَّةَ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ اللَّهُ يَجْمَعُ
بَيْنَنَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ^{١٥}

“E për këtë shkak (të përçarjes së tyre), ti thirr dhe përqendrohu ashtu siç të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre, e thuaj: ‘Unë kam besuar në librat që i shpalli All’Ilahu, jam i urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush. All’Ilahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj! Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja. Nuk ka polemikë mes nesh dhe jush. All’Ilahu bën tubimin mes nesh dhe vetëm tek Ai është përfundimi.”

Komentimi

Përqendrohu, ashtu siç të është urdhëruar!

Ajetet e kaluara folën për përçarjen e popujve në të shkuarën për shkak të shtypjes, tiranisë, padrejtësisë dhe shmangies, ndërsa ajeti që po komentojmë, e urdhëron Profetin për t'u përpjekur për zgjidhjen e konflikteve dhe rikthimit të jetës në fenë e Profetëve: **"...e për këtë shkak, ti thirr...!"**.¹ Domethënë, thirri ata në të vetmen Fe hyjnore dhe ndaloji konfliktet.

Më pas ajeti e urdhëron atë që të qëndrojë i palëkundur në këtë rrugë dhe thotë: **"...dhe përqendrohu ashtu siç të është urdhëruar!"**.

Ka mundësi që fjalia **"kema umirte"**– **"siç të është urdhëruar"** është tregues i nivelit të lartë të përqendrimit, ose i atij niveli të përqendrimit, ku masa, mënyra, koha dhe veçoritë e tjera të jenë në zbatim të ligjit të All'llahut.

Duke parë që pasionet e njerëzve konsiderohen si pengesa të mëdha në këtë Rrugë, ajeti thekson urdhrin e tij të tretë: **"...dhe mos shko pas dëshirave të tyre!"**, se çdo grup do të të thërrasë ty pas pasioneve dhe interesave të tyre vetjake. Kështu, thirrja e tyre ka si përfundim përçarjen, konfliktin dhe hipokrizinë; prandaj, ti nuk

¹ Disa komentues kanë thënë se shkronja "lam" në thënien "lidhalike" ka kuptimin "ila"– "për në". Kurse disa të tjerë me kuptimin e nxjerrjes së shkaqeve për një punë. Në rastin e parë fjala "dhalike" është tregues i fesë së Profetëve të mëparshëm, kurse në rastin e dytë është tregues i përçarjes së popujve.

duhet të shkosh kurrresi pas këtyre pasioneve, por duhet t'i bashkosh të gjithë në hijen e të vetmes Fe hyjnore.

Duke e ditur se për çdo thirrje ka një pikënisje, theksohet se pika e nisjes është vetë i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), siç thotë ajeti në urdhrin e katërt të tij: **"...e thuaj: Unë kam besuar në librat që ka zbritur All'llahu."**! Unë nuk bëj dallim në librat qiellorë, i pranoj të gjithë ata, se të gjithë thërrasin në Njehsim, në dituritë e pastra fetare dhe në përkushtim, në të vërtetën dhe drejtësinë. Në të vërtetë, s'ka dyshim se feja ime është bashkuese dhe plotësuese e të gjithë atyre.

Unë nuk jam si njerëzit që u ka zbritur libri, ku secili prej tyre anulon të tjerët, se çifutët anulojnë të krishterët, kurse të krishterët anulojnë çifutët. Ndjekësit dhe ithtarët e secilës fe pranojnë atë që u përshtatet nevojave dhe dëshirave të tyre nga librat fetarë, kurse unë i pranoj të gjithë, sepse të gjithë kanë një dispozitë të vetme thelbësore.

Duke pasur parasysh faktin se ruajtja e bazës së drejtësisë është e domosdoshme për krijimin e unitetit, atëherë ajeti e shtron atë në urdhrin e pestë, ku thotë: **"...jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush"**, pa dallim, si në vendosjen e drejtësisë, në gjykimin e drejtë, apo në të drejtat shoqërore dhe çështje të tjera.¹

Në këtë mënyrë, ajeti në fjalë është i përbërë nga pesë mësimë të rëndësishme, duke filluar me bazën e thirrjes, pastaj shtron mënyrën e përhapjes së saj, domethënë përqendrimin, pastaj tregon për pengesat në rrugë, siç është adhurimi i

¹ Disa komentues e kanë përkufizuar fjalën "el adale" me "el kadhau" –"gjykim", ndërsa në këtë ajet nuk ka argument për këtë përkufizim.

pasioneve, pastaj sqaron pikën e fillimit, që nis me veten dhe në fund qëllimi përfundimtar, përhapja dhe përgjithësimi i drejtësisë.

Pas këtyre pesë mësimëve, ajeti tregon për të përbashkëtat midis popujve, të cilat përmbledhen në pesë fragmente. Në lidhje me to, All'illahu i Madhëruar thotë: **"...All'illahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj"**, dhe gjithsecili është përgjegjës për veprat e tij: **"Ne kemi përgjegjësitë e veprave tona e ju të veprave të tua."**. **"...Nuk ka polemikë mes nesh e jush!"** Nuk ka mes nesh konflikte e polemika, nuk ka dallim asnjëri nga ne ndaj të tjerëve, ne nuk kemi interesa vetjake kundrejt jush.

Normalisht nuk ka nevojë për argumentim e justifikim, sepse e vërteta është e qartë. Përveç kësaj, s'ka dyshim se ne të gjithë do të bashkohemi në një vend të vetëm: **"All'illahu bën tubimin mes nesh."**¹

Ai që do të gjykojë mes nesh atë ditë, është Një dhe vetëm Një: **"...tek Ai është përfundimi."**

S'ka dyshim se Zoti ynë është Një, se përfundimi ynë do të jetë në një vend, se Gjykatësi tek i Cili është përfundimi, është Ai dhe vetëm Një. Pavarësisht gjithë kësaj, s'ka dyshim se të gjithë jemi përgjegjës për veprat tona, se nuk ka dallim mes një njeriu dhe një tjetri, përveçse në besimin dhe punët e mira.

E përfundojmë këtë koment me një hadith të ardhur nga Profeti më i nderuar, Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'illhut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku thuhet: *"Tri gjëra*

¹Përemri vector në fjalën *"bejnena"* tregon për Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'illhut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe besimtarët. Kurse përemri në fjalën *"bejnekom"* është tregues i të gjithë jobesimtarëve, pa dallim nëse janë prej ithtarëve të Librit apo idhujtarëve.

janë shpëtimtare për njeriun dhe tri të tjera janë shkatërruese. Shpëtimtare janë: drejtësia në kënaqësi e zemërim, qëllimi në pasuri e varfëri, frika ndaj All'llahut në fshehtësi dhe haptazi, ndërsa shkatërruese janë: kopracia, ndjekja e egos dhe vetëkënaqësia.”¹

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 38; Burimi i komentit është fundi i ajeteve në fjalë. “Dhuratë mendjeve”, Thëniet e të Dërguarit më fisnik.

Ajetet 16 – 18

وَالَّذِينَ يُحَاجُّونَ فِي اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مَا اسْتُجِيبَ لَهُ حُجَّتُهُمْ دَاحِضَةٌ
عِنْدَ رَبِّهِمْ وَعَلَيْهِمْ غَضَبٌ وَلَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ ۝۱۶ اللَّهُ الَّذِي أَنْزَلَ
الْكِتَابَ بِالْحَقِّ وَالْمِيزَانَ وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّ السَّاعَةَ قَرِيبٌ ۝۱۷ يَسْتَعْجِلُ
بِهَا الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِهَا وَالَّذِينَ آمَنُوا مُشْفِقُونَ مِنْهَا وَيَعْلَمُونَ أَنَّهَا
الْحَقُّ ۝۱۸ إِنَّ الَّذِينَ يُمَارُونَ فِي السَّاعَةِ لَفِي ضَلَالٍ بَعِيدٍ ۝۱۸

“Ata që polemizojnë rreth All’Ilahut, pasi i janë përgjigjur Atij, arsyetimet e tyre do të jenë të pavlefshme te Zoti i tyre,mbi ata do të bjerë zemërimi i Tij e do të dënohen ashpër.”

“All’Ilahu është Ai që e ka shpallur Librin me vërtetësi dhe drejtësi. E si do ta dije ti që ndoshta Dita e Kiametit është afër?!”

“Kiametin kërkojnë ta shpejtojnë ata që nuk besojnë në të, kurse ata që besojnë, kanë frikë nga ai dhe e dinë se është plotësisht i vërtetë. Pa dyshim, ata që kundërshtojnë për Ditën e Kiametit, janë në një gabim shumë të madh!”

Komentimi

Mos kërkoni ngutjen e Kiametit!!

Ajetet e mëparshme folën për detyrat e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si: respektimi nga ana e tij e përmbajtjes së librave qiellorë, zbatimi i drejtësisë midis njerëzve dhe lënia mënjane e çdo polemike e kundërshtie midis tij dhe atyre. Në ajetet që po komentojmë, me qëllim që të plotësohet hulumtimi i mëparshëm dhe të përforcohet fakti se vërtetësia e Profetit të Islamit nuk ka nevojë për argument, thuhet: **“Ata që polemizojnë rreth All'llahut, pasi i janë përgjigjur Atij, arsyetimet e tyre do të jenë të pavlefshme te Zoti i tyre...”**. Meqenëse polemika dhe kundërshtimi i tyre nuk është për të zbuluar të vërtetën, por, për shkak të kryeneçësisë dhe këmbënguljes, ajeti thotë: **“...mbi ata do të bjerë zemërimi i Tij e do të dënohen ashpër.”**.

Komentuesit kanë bërë komente të ndryshme rreth synimit të fjalisë: **“...pasi i janë përgjigjur Atij...”**.

Ata thanë: Ajo që nënkuptohet është përgjigjja e të gjithë njerëzve që kanë zemra të pastra, që nuk kanë nijete të pista, që i janë dorëzuar së vërtetës dhe që i janë përrulur All'llahut të Madhëruar. Ata bazohen te natyra e pastër (*el fitratu*), te përmbajtja e Shpalljes dhe te mrekullitë e ndryshme të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ka mundësi që kjo të jetë përgjigjja e lutjes së të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kundër kundërshtarëve të tij, si në rastin e betejës së Bedrit, e cila çoi në shkatërrimin e pjesës më të madhe të ushtrisë së armikut.

Ndonjëherë, atë fjali e kanë konsideruar si tregues të pranimit të librit nga njerëzit, të cilët ishin në pritje të Profetit të Islamit, para se të vinte, duke përmendur shenjat e shfaqjes së tij nëpërmjet librave ku theksohej besimi dhe dashuria për të. Veçse ata, pas shfaqjes së Islamit, e mohuan atë, ngaqë interesat e tyre të jashtëligjshme viheshin në rrezik.

Duket që komenti i parë është më i pranueshëm, sepse tefsiri i dytë dëshmon se këto ajete kanë zbritur pas betejës së Bedrit, në kohën kur nuk kishte argument për këtë çështje; prandaj, është e qartë se të gjitha këto ajete kanë zbritur në Mekë.

Kurse tefsiri i tretë nuk harmonizohet me metodën e ajetit, sepse duhet të thuhej: pasi iu përgjigjën atij.

Fillimi i ajetit: **“Ata që polemizojnë rreth All'llahut...”** tregon për kundërshtimin e idhujtarëve, në mënyrë të veçantë, të Krijuesit. Ata nuk janë njerëzit e Librit dhe situatat e parashtruara që përmenden në këto kundërshtime të kota, nuk janë për shkak të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Lind pyetja: Cilat ishin temat e shtruara në këto polemika të kota?! Komentuesit kanë mendime të ndryshme rreth kësaj:

Disa thonë se ajo që nënkuptohet në këtë ajet, është predendimi i çifutëve, të cilët thonë se feja e tyre ka qenë e

pranishme para Islamit, kështu që paraprirja e saj është argument se feja e tyre është më e mirë.

Meqenëse ju vazhdoni të pretendoni bashkimin dhe unitetin, atëherë, ejani dhe besoni në fenë e Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse të dyja palët e pranojnë atë.

Mirëpo, siç thamë më lart, është e papranueshme që e drejta në këtë ajet të jetë me jehudët apo me ithtaërt e Librit, sepse “polemizimi rreth All’Ilahut” ka të bëjë më shumë me idhujtarët. Prandaj, fjalia e mësipërme tregon argumentet e fantazuara të idhujtarëve dhe pranimin nga ana e tyre të idhujtarisë, ndërmjetësimin e statujave ose ndjekjen e fesë së baballarëve dhe të gjyshërve.

Sido që të jetë, fanatikët, ata që ngulin këmbë në kokëfortësinë e tyre pasi u është qartësuar e vërteta, çështja e tyre do të skandalizohet në mesin krijesave të All’Ilahut, kështu që ata do t’i përfshijë zemërimi i Krijuesit në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Më pas, Kur’ani i Madhërishëm tregon një nga argumentet e Njehsimit dhe të fuqisë së Krijuesit. Në të njëjtën kohë përfshin edhe përforcimin e profecisë përballë kundërshtuesve me logjikë të cekët: **“All’Ilahu është Ai që e ka shpallur Librin me vërtetësi dhe drejtësi...”**.

Fjala “*el hakku*” është një fjalë gjithëpërfshirëse që përfshin njohuritë dhe besimet e vërteta, lajmet e sakta dhe programet që janë në përputhje me nevojat e natyrshme dhe shoqërore, e të tjera të ngjashme me to, sepse e vërteta është e pranishme dhe nuk është se ka anë fantazuese apo qëndron në mendje.

Fjala “*el mizan*” ka kuptim të përgjithshëm. Pavarësisht se kuptimi gjuhësor i saj është për mjetin e matjes së peshës, mirëpo në kuptimin metaforik, përdoret për çdo etalon dhe për çdo standart të saktë. Madje edhe prania e të Dërguari të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamëve të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), është një standard për njohjen e të vërtetës nga e pavërteta. Peshimi në Ditën e Kiametit ka për qëllim këtë lloj kuptimi, pra ndarjen e të vërtetës nga e pavërteta.

Në bazë të kësaj, Krijuesi i zbriti Librin, Kur'anin, Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili është i vërteti, i drejti dhe peshore e vlerësimit. Ky libër përmban njohuritë, besimet dhe argumentet e tij logjike, ligjet shoqërore, deri edhe programet për edukimin e shpirttrave dhe plotësimin e njerëzve. Të gjitha këto janë argumente të vërtetësisë së Tij.

S'ka dyshim se, kjo përmbajtje madhështore, me këtë thellësi mendimi, nga një njeri analfabet, që nuk dinte shkrim dhe këndim - e që u rrit në një shoqëri, që konsiderohej si njëra nga shoqëritë me më shumë konflikte - vlerësohet si një argument i madhështisë së Krijuesit dhe ekzistencës së një bote pas normales, si dhe pohon vërtetësinë e asaj, për të cilën u dërgua.

Kështu, fjalia e mësipërme vlerësohet si një përgjigje e denjë për idhujtarët dhe njerëzit e Librit.

Nga sa pamë, rezultati i të gjitha këtyre çështjeve, në mënyrë të veçantë shfaqja në formë të plotë e së vërtetës, vërtetimi i drejtësisë dhe ngritja e drejtësisë, qartësohen në Ditën e

Kiametit. Prandaj, ajeti në fundin e tij thotë: **“...E si do ta dije ti që ndoshta Dita e Kiametit është afër?”**.

Se, kur të bëhet Kiameti, të gjithë vijnë në gjykatën e drejtësisë së Tij, e do të përballen me peshoren që peshon edhe kokrrën e mustardës, madje edhe më të vogël se ajo.

Kur’ani i Madhërishëm tregon situatën e jobesimtarëve dhe të besimtarëve para Kiametit dhe thotë: **“Kiametin kërkojnë ta shpejtojnë ata që nuk besojnë në të...”**.

Këta nuk e thonë këtë për shkak se e duan Kiametin dhe dëshirojnë të mbërrijnë shpejt në takimin e të dashurit të zemrave, me All’lahun. Kurrë, jo! Kjo fjalë është si tallje dhe mohim, se sikur ta dinin çfarë i pret ata në Ditën e Kiametit, nuk do ta kërkonin kurrësi në këtë formë.

“...kurse ata që besojnë, kanë frikë nga ai dhe e dinë se është plotësisht i vërtetë...”

Sigurisht që çasti i ardhjes së Kiametit është i fshehtë për të gjithë, deri dhe për Pejgamberët, të Dërguarit dhe engjëjt shumë të afërt. Kjo çështje do të jetë një metodë edukuese e vazhdueshme për besimtarët, sprovë e plotësim i justifikimit të mohuesve, kështu që nuk ka asnjë dyshim se ai, Kiameti, do të ndodhë.

Këtu qartësohet, se sa efekt të madh edukues ka besimi në Kiamet, në gjykatën e madhe të drejtësisë hyjnore, në mënyrë të veçantë për besimtarët, dhe mundësinë e arritjes së kësaj drejtësie në çdo çast.

Si lajmërim të përgjithshëm, ajeti në fund të tij, thotë: **“...Pa dyshim, ata që kundërshtojnë për Ditën e Kiametit, janë në një humbje të madhe!”**.

Sistemi i kësaj bote konsiderohet qartazi si argument i asaj që është paraprirëse e Botës Tjetër. Pa të, krijimi i kësaj bote do të ishte kot, pa asnjë kuptim. Kjo gjë nuk përshtatet me mençurinë e Krijuesit dhe as me drejtësinë e Tij.

Shprehja *“dalalun beid”* tregon se njeriu ndonjëherë mund ta humbë rrugën, veçse ai nuk largohet shumë prej saj, kështu që me pak kërkim e përpjekje, mundet ta rigjejë përsëri rrugën. Por ndonjëherë largësia bëhet aq e madhe, saqë është e vështirë, gati e pamundur, që ta rigjejë dhe një herë rrugën drejt së vërtetës.

Në një hadith lexojmë se një njeri e pyeti të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në një nga udhëtimet e tij, me zë të lartë: “O Muhammed!” I Dërguari i All'llahut iu përgjigj po me zë të lartë: *“Çfarë thua?”*

Burri e pyeti: *“Kur është Kiameti?”*

I Dërguari iu përgjigj: *“S'ka dyshim se me të vërtetë do të bëhet, por çfarë ke përgatitur për të?”*

Ai i tha: *“Dashurinë për All'llahun dhe për të Dërguarin e Tij!”*

I Dërguari i tha: *“Ti do jesh me ata që do.”¹*

¹Tefsiri “El Muragij”, vëll. 25, f. 32.

Ajetet 19-20

اللَّهُ لَطِيفٌ بِعِبَادِهِ يَرْزُقُ مَنْ يَشَاءُ وَهُوَ الْقَوِيُّ الْعَزِيزُ ۝ مَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الْآخِرَةِ نَزِدْ لَهُ فِي حَرْثِهِ وَمَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الدُّنْيَا نُؤْتِهِ مِنْهَا وَمَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ نَصِيبٍ

“All’llahu është i Mirë (i Butë) me robtë e Vet dhe i jep begati kujt të dojë; Ai është i Plotfuqishëm dhe i Pushtetshëm.”

“Atij që dëshiron shpërblim në Jetën Tjetër, Ne do t’ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t’i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në Jetën Tjetër.”

Komentimi

Të mbjellat e dynjasë dhe e Ahiretit

Në ajetet e kaluara u fol për dënimin e ashpër të All’llahut dhe për kërkesën e mohuesve të Kiametit për nxitimin e ardhjes së tij. Ndërsa ajeti i parë i këtij grupi ajetesh e shoqëron zemërimin e All’llahut me mirësinë (butësinë) e Tij duke paraqitur përgjigjen për ata mohues që kërkuan shpejtimin e

Kiametit. Ajeti thotë: **“All’llahu është i Mirë (i Butë) me robtë e Vet...”**.

Kur i kërcënon ata me dënim të ashpër në një vend, Ai u premton bamirësinë e madhe në një vend tjetër, një bamirësi të gjerë e të pakufizuar, kështu që nuk nxiton në dënimin e injorantëve dhe mendjemëdhenjve.

Ajeti shtjellon një nga dukuritë e bamirësisë së Tij të përgjithshme, që është furnizimi me të mira, teksa thotë: **“...dhe i jep begati kujt të dojë...”**. Kjo nuk do të thotë se ekziston një grup njerëzish, të cilët janë privuar nga begatitë e Tij, por ka për qëllim bollëkun në furnizim për atë që do Ai, siç thuhet në ajetin 26 të sures “Rra’d”: **“All’llahu i jep furnizim me bollëk atij që do dhe ia kufizon (atij që do).”**.

Në një ajet të kësaj sureje, lexojmë: **“Sikur All’llahu t’i shtonte mjetet e jetesës për robtë e Vet, ata do ta mbushnin Tokën me mbrapshti.”**¹

Është e qartë se risku, pra *begatia*, përfshin begatinë shpirtërore dhe materiale, ku Vetë All’llahu është burimi i bamirësisë dhe begatisë. Atëherë, përse duhet t’u drejtoheni statujave, të cilat nuk begatojnë, nuk bëjnë bamirësi dhe nuk i zgjidhin dot problemet tuaja?!

Në fund, ajeti thotë: **“...Ai është i Plotfuqishëm dhe i Pushtetshëm.”**.

¹ Sure “Esh Shura”, ajeti 27.

Kur All'Ilahu i Madhëruar u premtom robëve të Vet begatinë dhe mirësinë, atëherë Ai është i aftë ta kryejë me siguri këtë, prandaj nuk ka kurrë tërheqje mbrapa në premtimin e Tij.

Është e domosdoshme të vërejmë te ky shënim, se fjala “*latijf*” ka dy kuptime:

E para: Ai është Zoti i mirësisë, butësisë dashurisë dhe mëshirës.

E dyta: Dituria e Tij për të gjitha çështjet e vogla e të fshehta.

Meqenëse dhënia e rizkut ka nevojë për mirëinformim dhe dituri për gjithçka dhe në çdo vend që të jenë, pa dallim në janë në qiell apo në tokë, për këtë ajeti tregon në fillim butësinë e Tij, pastaj rizkun e Tij, siç thuhet në ajetin 6 të sures “Hud”: **“Nuk ka asnjë gjallesë në Tokë, që All'Ilahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj.”**

Sigurisht, nuk ka asnjë kontradiktë mes këtyre dy kuptimeve, përkundrazi, ata plotësojnë njëri-tjetrin. I miri, i buti (*el latijfu*) është ai njeri që është i plotësuar për nga njohuria dhe dituria, për nga mirësia dhe butësia dhe nga dashuria për njerëzit. Meqenëse Krijuesi është i Gjithëditur për nevojat e robëve të Tij, Ai ua plotëson nevojat e tyre në formën më të mirë, prandaj, Ai është më i merituari për këtë emër, pra “*El Latijfu*”.

Ajeti i mësipërm tregoi për katër attribute nga cilësitë e Krijuesit: *butësia, begatia, fuqia* dhe *ngadhënjimi*. Këto janë argumenti më i madh për pozitën e sundimit të Tij, se “Er

Rabbu", në kuptimin All'Ilahu, Sunduesi, duhet t'i ketë në vetvete këto cilësi.

Ajeti që vjen, përngjason individët e botës ndaj begatisë së Krijuesit dhe mënyrës së përfitimit prej tij, me fermerët, kultivuesit etj, një pjesë e të cilëve bëjnë kultivimin për Ahiretin, ndërsa pjesa tjetër për këtë botë. Ai përcakton përfundimin e secilit grup, sipas përngjasimit të Bamirësit, teksa thotë: **"Atij që dëshiron shpërblim në Jetën Tjetër, Ne do t'ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t'i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në Jetën Tjetër."**¹

Është një përngjasim i mirë dhe metaforë e bukur. Të gjithë njerëzit janë kultivues. Kjo botë është ara, vendi i kultivimit. Veprat tona janë bërthamat, farërat. Mundësitë hyjnore për të mbjellat janë shirat që bien nëpër këto ara. Vetëm se farërat ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra. Një pjesë e tyre kanë prodhim të pakufizuar dhe të përhershëm, pemët e tyre janë gjithmonë në gjelbërim dhe prodhime të dobishme, ndërsa pjesa tjetër janë shumë pak të dobishme, u vjen fundi shpejt dhe prodhojnë fruta të hidhura.

Në të vërtetë, shprehja "*juridu*", në kuptimin *dëshiron*, tregon ndryshimin e njerëzve në nijete. Seria e këtij ajeti konsiderohet një qartësim i asaj që përmendet në ajetin e mëparshëm prej dhuratave dhe begative hyjnore, se disa përfitojnë nga këto dhurata në formën e farërave, bërthamave të

¹Termi "*harthun*", siç thotë Er Ragibu në "*El Mufredat*", në rrënjë do të thotë: *hedhja e farës në tokë* dhe përgatitja për mbjellje. Në Kur'anin Kerim është përdorur shumë herë me këtë kuptim, mirëpo nuk dihet shkaku i konsiderimit të disa komentuesve, se ajo do të thotë *puna dhe fitimi*.

Ahiretit, kurse disa të tjerë i përdorin ato për kënaqësitë e kësaj bote.

Ajeti flet, në mënyrë të veçantë, për ata që mbjellin për Ahiretin: **“...Ne do t’ia shtojmë atë...”**, veçse ai nuk thotë se atë nuk do ta godasë asgjë nga mirësitë e dynjasë. Për sa u përket atyre që mbjellin për këtë botë, thotë: **“...Ne do t’i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në Jetën Tjetër.”**.

Mbi këtë bazë, as ata që kërkojnë dynjanënuk e arrijnë atë që dëshirojnë dheas ata që kërkojnë Ahiretin, nuk privohen nga dynjaja, por ndryshimi mes tyre është se grupi i parë shkon në Ahiret me duar të zbrazura, ndërsa grupi i dytë shkon me duart plot.

Me të njëjtin kuptim vjen në ajetet 18, 19 të sures “Isra”, por në një formë tjetër: **“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë që t’i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij Xhennemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar. Sa për atë që dëshiron Botën Tjetër dhe përpiket për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet.”**.

Shprehja **“...Ne do t’ia shtojmë atë...”**, është në harmoni me çka vjen në ajetet e tjerë kur’anorë, si: **“Kush vjen me një punë të mirë, ai shpërblehet dhjetëfish”**¹ dhe **“Që Ai (All’llahu) do t’u plotësojë shpërblimin e tyre, edhe do t’u shtojë nga mirësia e Ti.”**²

¹Sure “El En’am”, ajeti 160.

² Sure “Fatir”, ajeti 30.

Sido që të jetë, ajeti i mësipërm, është një portret që flet vetë dhe pasqyron mendimin islam për jetën e dynjasë. Dynjaja është e dëshiruar në vetvete. Ajo konsiderohet paraprirëse e Botës Tjetër. Islami e shikon dynjanë si një arë, frutat e së cilës këputen në Ditën e Kiametit.

Shprehjet që kanë zbritur në transmetimet dhe ajetet e tjera kur'anore, e përforcojnë edhe më tej këtë kuptim.

Për shembull, ajeti 261i sures "El Bekare" i ka përgjasuar ata që japin në Rrugë të All'llahut me kokrrën e farës, e cila ka shtatë kallinj dhe në çdo kalli ka njëqind kokrra, madje ndonjëherë edhe më shumë. Ky është modeli për atë që mbjell kokrra për Ahiretin.

Në një hadith të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), lexojmë: "... Dhe nuk i hedh përmbys njerëzit në zjarr, veçse për ato që korrën gjuhëte tyre."¹

Në një hadith tjetër të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: "...Me të vërtetë, pasuria dhe fëmijët janë të mbjellat e kësaj bote, kurse puna e mirë është e mbjella e Ahiretit, dhe All'llahu do t'i bashkojë ato të dyja për popujt."²

Nga ky ajet mund të përfitojmë këtë çështje: ku thuhet se për dynjanë dhe Ahiretin duhen bërë përpjekje dhe nuk mund të fitohen pa lodhje e probleme, ashtu si fara dhe fruti nuk përjashtohen nga lodhja dhe dëmet. Prandaj, më e mira për njeriun është që të mbjellë një pemë dhe të shpenzojë mundin e tij

¹"El Mehexhhetul Bejda", vëll. 5, f. 193, Kapitulli i sëmundjeve të gjuhës.

²"Usulul Kafij", vëll. 5, f. 57, sipas transmetimit të "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 569.

për rritjen e saj, që fruti i saj të jetë me shije të ëmbël gjithmonë, dhe jo një pemë që vdes shpejt e shkatërrohet.

E përfundojmë këtë argument me një hadith Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku thuhet: *“Kush ka për qëllim këtë dynja, All'llahu e ndan çështjen nga ai dhe ia vendos varfërinë para syve. Ai nuk merr asgjë më tepër në dynja, përveç asaj që është shkruar për të. Kush ka për qëllim Ahiretin, All'llahu ia bashkon të mirat dhe e vendos pasurinë e tij në zemrën e tij, dhe i vjen dynjaja pa pasur dëshirë.”*¹

Ajo që është e përhapur në mesin dijetarëve se dynjaja është ara e Ahiretit, në të vërtetë është një citat që e ka burimin te këto ajete që përmendëm.

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 41; fundi i ajeteve është burimi i komentimit.

Ajetet 21-23

أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءُ شَرَعُوا لَهُمْ مِنَ الدِّينِ مَا لَمْ يَأْذَنْ بِهِ اللَّهُ وَلَوْلَا كَلِمَةُ
الْفَصْلِ لَقُضِيَ بَيْنَهُمْ وَإِنَّ الظَّالِمِينَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ تَرَى الظَّالِمِينَ
مُشْفِقِينَ مِمَّا كَسَبُوا وَهُوَ وَاقِعٌ بِهِمْ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ
فِي رَوْضَاتِ الْجَنَّاتِ لَهُمْ مَا يَشَاءُونَ عِنْدَ رَبِّهِمْ ذَلِكَ هُوَ الْفَضْلُ
الْكَبِيرُ ذَلِكَ الَّذِي يُبَشِّرُ اللَّهُ عِبَادَهُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ
قُلْ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا إِلَّا الْمَوَدَّةَ فِي الْقُرْبَى وَمَنْ يَقْتَرِفْ
حَسَنَةً نَّزِدْ لَهُ فِيهَا حُسْنًا إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ شَكُورٌ

“A kanë ata idhuj, të cilët u kanë caktuar një fe që nuk e ka lejuar All’Ilahu?! Sikur të mos kishte qenë Fjala e vendimit të mëparshëm, ata do të ishin gjykuar menjëherë. Për të padrejtët është përgatitur një dënim i dhembshëm.”

“Atë Ditë ti do t’i shohësh keqbërësit se si tmerrohen për atë që kanë fituar, ndërkohë që ndëshkimi Ynë do t’i godasë me siguri. Ndërsa ata që kanë besuar dhe bërë vepra të mira, do të jenë në kopshtet e mrekullueshme të Xhenneteve. Ata do të kenë te Zoti i tyre çfarë të duan; kjo është mirësi e madhe.”

“Kështu i gëzon All’Ilahu robtë e Vet, që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira. Thuaj: ‘Nuk ju kërkoj përkëtë

kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmeve'. Atij që bën vepër të mirë, Ne do t'ia shtojmë shpërblimin. All'llahu, me të vërtetë, është Falës dhe Falënderues."

Shkaku i zbritjes

Në tefsirin "Mexhmaul Bejan" është përmendur shkaku i zbritjes së ajeteve 23-26 të kësaj sureje. Edhe Ebu Hamza Themalijue përmend atë në tefsirin e tij dhe thotë: "Më ka thënë Osman ibn Umejri, i cili ka transmetuar nga Seid ibn Xhubejri, nga Abdullah ibn Abbasi, se kur i Dërguari i All'llahut mbërriti në Medine dhe ndërtoi themelet e Islamit, ensarët thanë ndërmjet njëri-tjetrit: Shkojmë tek i Dërguari i All'llahut dhe i themi atij: nëse ke halle shumë, ja këto janë pasuritë tona. Përdori si të duash ti dhe nuk i duam më."

Për këtë zbriti ajeti: **"...Thuaj: 'Nuk ju kërkoj përkëtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmeve.'"**. I Dërguari ua lexoi atyre duke u thënë që të donin dhe të respektonin të afërmit e tij pas kalimit nga kjo jetë. Ata dolën prej tij duke iu dorëzuar fjalës së tij.

Munafikët thanë: Ky është një mashtrim në qëndrimin e tij. Ai ka dashur të bëjë ironi, të na poshtërojë me farefisninë pas tij. Për këtë arsye zbriti ajeti: **"A mos thonë ata, se ai (Muhammedi)**

shpifi gënjeshtër ndaj All'Ilahut?"¹ Muhammedi u dërgoi lajm atyre dhe ua lexoi ajetin. Ata nisën të qajnë, u ndjenë shumë në faj, kështu që All'Ilahu zbriti ajetin: **"Ai është që pranon pendimin e robëve të Vet."**² Ai dërgoi që t'i gjenin ata dhe i përgëzoi duke u thënë: "I përgjigjet lutjes së atyre që besuan dhe atyre që iu dorëzuan Fjalës së Tij, të të Madhëruarit."³

Komentimi

Shpërblimi i Shpalljes gjendet në dashurinë për të afërmit

Ajeti 13 i kësaj sureje fliste për ardhjen e fesë nga ana e Krijuesit nëpërmjet Pejgamberëve të *ulil azmit* (Profetët e vendosmërisë së lartë). Ajeti i parë në këtë koment, si vazhdimësi e temës, mohon ardhjen e fesë nga të tjerë përveç All'Ilahut. Të gjitha ligjet njerëzore janë të pakonsiderueshëm përballë ligjit të All'Ilahut dhe se sundimi dhe posedimi janë vetëm për All'Ilahun: **"A mos kanë ata ortakë që u përcaktuan atyre fe, të cilën nuk e urdhëroi All'Ilahu?"**.

Ai është Krijuesi, Zotëruesi dhe Projektuesi i botës së ekzistencës. Për këtë shkak veçohet Veta e Tij i Pastër në të drejtën e sundimit dhe posedimit. Askush nuk mund të ndërhyjë në ligjet

¹Sure "Shura", ajeti 24.

²Sure "Shura", ajeti 25.

³Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 44.

e Tij pa leje, prandaj çdo gjë tjetër është e pavlerë para legjislacionit të Tij.

Më pas, Kur'ani i Madhërishëm kërcënon ligjvënësit që bëjnë ligje të kota dhe pa vlerë, ku nëpërmjet ajetit, thotë: **"...Sikur të mos kishte qenë Fjala e vendimit të mëparshëm, ata do të ishin gjykuar menjëherë..."**, prej nga buron dhe urdhri për dënimin e tyre.

Në të njëjtën kohë, ata nuk duhet ta harrojnë se: **"...Për të padrejtët është përgatitur një dënim i dhembshëm..."**.

Ajo që synohet me shprehjen *"kelimetul fasl"*, që do të thotë *ffjala vendimtare*, është periudha kohore e dhënë, e vendosur nga Krijuesi për këto lloj njerëzish, që të kenë liri veprimi me veprat e tyre, me qëllim që të plotësohet justifikimi kundër tyre.

Shprehja *"dhalimin"*, në kuptimin të padrejtët, flet për idhujtarët, të cilët kanë doktrinë të devijuar e të shmangur, përballë ligjeve të All'llahut, për shkak të përhapjes së padrejtësisë në çdo vepër.

Duket qartë se, ajo që nënkuptohet nga shprehja *"adhabun elim"*, që do të thotë *dënim të dhimbshëm*, është dënimi i Ditës së Kiametit. Kjo shprehje zakonisht përdoret me këtë kuptim në Kur'anin Kerim. Ajeti që vjen, e dëshmon këtë të vërtetë, që e pohojnë edhe disa komentues, si Kurtubiju, se me shumë mundësi, këtu përfshin dënimin e dynjasë dhe të Ahiretit.

Më pas, ajeti përmend një sqarim të përgjithshëm rreth *"adhabu dhalimine"*, që ka kuptimin *dënim të zullumqarëve*. Gjithashtu, ajeti jep një sqarim të hollësishëm rreth shprehjes

“xhezaul mu'minine”, që ka kuptimin shpërblim të besimtarëve, kur thotë: “Atë Ditë ti do t’i shohësh keqbërësit se si tmerrohen për atë që kanë fituar, ndërkohë që ndëshkimi Ynë do t’i godasë me siguri. Ndërsa ata që kanë besuar dhe bërë vepra të mira, do të jenë në kopshtet e mrekullueshme të Xhenneteve...”.

Fjalal *“reudatun”* është shumësi i *“reuda”*, që do të thotë: *vendi që përmban ujë dhe shumë pemë*. Për këtë, fjala *“reuda”* përdoret për kopshtet e gjelbëruara. Në mënyrë të qartë përfitojmë nga kjo shprehje, se kopshtet e Xhennetit janë të ndryshme, se besimtarët me veprat e mira janë në kopshtet më të mira të Xhennetit, ndërsa besimtarët mëkatarë do të hyjnë në Xhennet pasi t’i përfshijë falja e All’llahut, edhe pse vendi i tyre nuk është në kopshte.

Begatia dhe mirësia e All’llahut, në mënyrë të veçantë, për besimtarët punëmirë, nuk përfundon këtu. Ata do t’i përfshijë mirësia All’llahut: **“...Ata do të kenë te Zoti i tyre çfarë të duan...”**.

Në këtë konstatim, nuk ka ndonjë krahasim midis veprës dhe shpërblimit, përkundrazi, shpërblimi i tyre është nga të gjitha anët i pallogaritshëm, sepse fjalia: **“...Ata do të kenë te Zoti i tyre çfarë të duan...”** e dëshmon këtë të vërtetë.

Më e bukur se kjo, është shprehja: **“te Zoti i tyre”**, e cila qartëson mirësinë e pafundme të All’llahut ndaj besimtarëve, sepse nuk ka fitore më të madhe sesa të arrish afër vendit dhe pozitës së Krijuesit.

Siç thuhet në mënyrë të veçantë për shehidët, dëshmorët: **“Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer tek Zoti i tyre”¹**, kështu thuhet edhe për besimtarët punëmirë: **“...Ata do të kenë te Zoti i tyre çfarë të duan...”**.

Nuk është për t’u çuditur që ajeti në fund të tij thotë: **“...kjo është mirësi e madhe.”**.

Kemi theksuar shpesh se nuk mund të shpjegohet begatia e Xhenetit nëpërmjet fjalëve. Ne që jemi të prangosur me zinxhirët e botës materiale, nuk mund të konceptojmë nocionet që përmban fjalja: **“...Ata do të kenë te Zoti i tyre çfarë të duan...”**.

Atëherë, çfarë duan besimtarët? Cilat janë këto të mira që qenkan të pranishme aty afër, madje, fare pranë të Madhërishmit?

Kur Krijuesi bën përshkrimin e diçkaje si një begati të madhe, Ai zbulon masën e vërtetë të madhësisë, saqë bëhet edhe më madhështore nga sa e kemi menduar.

Në një shprehje tjetër thuhet se çështja do të shkojë te këta rob, derisa t’u plotësohet çdo gjë që dëshirojnë, d.m.th., do të shfaqen në jetën e tyre rreze drite prej fuqisë së përhershme të Krijuesit: **“Kur Ai dëshiron një send, urdhri i Tij është vetëm t’i thotë: ‘Bëhu’, ai menjëherë bëhet!”²**

A ka begati dhe dhuratë më të bukur dhe më të madhe sesa kjo?

¹Sure “Ali Imran”, ajeti 169.

² Sure “Jasin”, ajeti 82.

Për të sqaruar madhështinë e këtij shpërblimi, ajeti që vjen, thotë: **“Kështu i gëzon All’llahu robtë e Vet, që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira...”**.

Ai i përgëzon ata, që të mos u vështirësohen dhimbjet e bindjes dhe të adhurimit, luftës së pasionit të egos dhe luftës kundër armiqve të All’llahut. Prandaj, ky shpërblim bëhet i qartë duke ngjallur interesin e tyre. Ai u jep atyre forcën dhe fuqinë e duhur për të zgjedhur rrugën e jetës, rrugë që është e mbushur plot me vështirësi dhe probleme për të arritur deri te kënaqësia e Krijuesit.

Dikush mund të mendojë se Profeti i Islamit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) dëshiron të mira dhe shpërblim për përcjelljen e kumtit, prandaj Kur’ani i Madhërueshëm e urdhëroi të Dërguarin që të thotë: **“...Thuaj: ‘Nuk ju kërkoj përkëtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmevë...’”**, domethënë dashurinë për Ehli Bejtin tim.

Dashuria për Ehli Bejtin dhe ndjekja e tyre, siç do të sqarohet me detaje në vijim, ka lidhje me çështjen e udhëheqësisë së Imamëve të pamëkatë prej familjes së Profetit. Udhëheqësia e tyre në realitet konsiderohet vazhdimësi e udhëheqjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Pranimi i udhëheqësisë së Ehli Bejtit është shkak i lumturisë së njerëzve.

Sqarim

Ka diskutime dhe komente të ndryshme nga dijetarët për komentimin e kësaj fjalie. Në disa raste vërejmë se ato komente janë larguar nga nocioni origjinal i ajetit, për shkaqe dhe motive të

ndryshme. Ata kanë përmnendur supozime që nuk janë në përputhje me përmbajtjen e ajetit, as me shkakun e zbritjes së tij e as me argumentet e tjerë historik e transmetues.

Në mënyrë të përgjithshme ka katër komente të njohura për ajetin:

1- Komenti i parë është ajo që thamë më lart, se me farefisni nënkuptohen të afërmit e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Dashuria ndaj tyre konsiderohet si mënyrë e pranimit të drejtimit dhe e udhëheqjes së Imamëve të pagabueshëm, prej familjes së të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si mbështetje në zbatim të kumtit.

Këtë kuptim e kanë zgjedhur pjesa më e madhe e komentuesve të hershëm dhe të gjithë komentuesit shi'itë. Ka shumë transmetime të ardhura nga shi'itët dhe sunitët për këtë aspekt, që do t'i shtjellojmë në vazhdim.

2- Ajo që nënkuptohet është se, shpërblimi i kumtit dhe sevapi i tij, është dashuria e disa gjërave të caktuara që u afron ju me All'llahun.

Ky komentim, të cilin e kanë përmendur disa komentues të *ehli synetit*, nuk harmonizohet me fillimin e ajetit, sepse kuptimi i tij do të jetë: “*Me të vërtetë, unë dëshiroj nga ju që të doni bindjen e Krijuesit dhe ta respektoni në zemrat tuaja*”, ndërkohë që duhej të thuhej: “*Me të vërtetë, unë dëshiroj nga ju që t'i bindeni Krijuesit*” dhe jo të doni bindjen ndaj Krijuesit.

Në shtesë të kësaj, nuk ka njeri që nuk dëshiron afrimin te All'llahu. Madje edhe idhujtarët e dëshironin këtë gjë, teksa mendonin se adhurimi i statujave është një lloj mënyre për t'u afruar te Krijuesi.

3- Ajo që synohet, është dashuria e të afërmve tuaj në adresë të shpërblimit të kumtit, domethënë me farefisninë. Sipas këtij komenti, nuk gjendet asnjë lidhje midis kumtit dhe shpërblimit të tij: ç'përfitim ka i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga dashuria e një njeriu të tij të afërm?! Si mund të konsiderohet kjo çështje, shpërblim i kumtit?!

4- Qëllimi është: *shpërblimi im është që të ruani të afërmit e mi nga vetat tuaja, që të mos më lëndoni mua, sepse unë kam lidhje farefisnie me shumicën e fiseve tuaja.* I Dërguari ishte i lidhur me fiset kurejshe për nga prejardhja e tij, me fiset e tjera me lidhje të tjera, si nëpërmjet martesës, nëpërmjet nënës së tij me disa familje medinase të fisit Beni Nexhar, dhe nëpërmjet nënës mëndake me fisin Beni Sa'd.

Kjo shprehje është komenti më i keq që i është bërë ajetit, sepse kërkimi i shpërblimit të kumtit bëhet nga njerëzit të cilët i besuan atij. Kështu, këtyre njerëzve nuk është nevoja që t'u thuhet këto fjalë, sepse ishin prej atyre që e respektonin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se ai është i Dërguari i All'llahut. Respekti i përhapur për shkak të pranimit të kumtit qëndron më lart se të gjitha çështjet. Në të vërtetë, ky koment duhet të konsiderohet si një prej gjynaheve të mëdha që ka goditur disa komentues, duke deformuar plotësisht konceptimin e ajetit.

Me qëllim që ta kuptojmë më mirë të vërtetën e përmbytjes së ajetit, duhet të kërkojmë ndihmën e ajeteve të tjera të Kur'anit të Madhërishëm.

Në shumë ajete të Kur'anit Famëlartë lexojmë:

“...Unë, për këtë nuk po kërkoj prej jush ndonjë shpërblim. Shpërblimi për mua është vetëm prej Zotit të botëve.”¹

Ka disa shprehje që e veçojnë të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Kur'an. Në njërën prej tyre thuhet: **“Thuaj: ‘...Unë nuk kërkoja prej jush ndonjë shpërblim. Nëse kam kërkuar, ai le t’ju mbetet juve. Shpërblimi im është vetëm prej All'llahut.’”²**

Në një vend tjetër lexojmë: **“Thuaj: ‘...Unë për këtë nuk kërkoj shpërblim prej jush, por vetëm kush të dojë, të marrë rrugën që e afron te Zoti i vet.’”³**

Së fundi: **“Thuaj (Muhammed): ‘Unë nuk po kërkoj prej jush ndonjë shpërblim, dhe unë nuk jam prej atyre që bëjnë trillime.’”⁴**

Diku tjetër, ajeti thotë: **“...Në të vërtetë, unë e kërkoj shpërblimin prej njerëzve që duan të marrin rrugën që i afron te Krijuesi.”.**

¹ Sure “Esh Shuara”, ajetet 109, 127, 145, 164, 180.

² Sure “Sebe”, ajeti 47.

³ Sure “El Furkan”, ajeti 57.

⁴ Sure “Sad”, ajeti 86.

Kur i vendosim këto tre ajete në krah të ajetit që komentojmë, bëhet më i lehtë përfundimi kuptimor se diku, ajeti e ndalon plotësisht shpërblimin.

Përsa i përket ajetit të tretë, ai thotë: Ne të vërtetë, shpërblimi që unë kërkoj prej jush, është për ju.

Së fundi, ajeti të cilin po komentojmë, shton: Me të vërtetë që dashuria dhe respektimi i farefisit është shpërblimi i kumtit tim, domethënë se shpërblimi që unë kërkoja prej jush përfshin këto veçori. Unë nuk përfitoj asgjë prej kësaj, por jeni ju që përfitoni plotësisht nga kjo dashuri dhe respekt. Kjo dashuri shtron rrugën para jush që t'i afroheni Krijuesit.

Mbi këtë bazë, a nënkupton ajeti ndonjë gjë tjetër, përveç çështjes së vazhdimësisë së vijës së kumtit të Profetit të Nderuar nëpërmjet udhëheqësve hyjnorë dhe kalifëve të tij të pagabueshëm, të cilët janë të gjithë prej familjes së tij? Mirëpo ajeti e ka bërë më se të qartë, se respekti është baza e kësaj lidhjeje.

Interesant në këtë çështje është fakti se ka pesëmbëdhjetë burime në Kur'anin Famëlartë, veç atyre që kemi përmendur, ku përmendet fjala: *kurba*, në kuptimin: *të afërmit*. Në këtë gjendje, nuk dimë përse këmbëngulin disa në përkufizimin e kuptimit të fjalës me afrimin të All'Ilahu, duke lënë mënjanë kuptimin e përdorur qartë në shumë ajete kur'anore.

Eshtë e domosdoshme ta tregojmë shënimin që thuhet në fund të ajetit: **"...Atij që bën vepër të mirë, Ne do t'ia shtojmë shpërblimin. All'Ilahu, me të vërtetë, është Falës dhe Falënderues."**

Nuk ka më mirë sesa kur njeriu është gjithmonë nën flamurin e udhëheqësve hyjnorë. Ai i do ata me zemër dhe ecën në hapat e tyre, kërkon prej tyre nëpërmjet Fjalës së Krijuesit, sqarimin e çështjeve të dyshimta, i konsideron ata shembull e model, kështu që rruga dhe vepra e tyre është vetë standardi.

Transmetimet e përmendura në komentimin e këtij ajeti

Argument tjetër rreth komentit të mësipërm janë transmetimet e shumta që përmenden në burimet e *ehli syne* dhe *shi'itëve*, ku sqarohet se me *kurba* nënkuptohen *njerëzit e shtëpisë* dhe të afërmit, në mënyrë të veçantë i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në këtë kontekst do të përmendim shembujt e mëposhtëm:

1-Ahmed ibn Hanbel transmeton për virtytet e sahabëve me zinxhir transmetimi (*sened*) nga Seid ibn Xhubejr, nga Amir, se kur zbriti ajeti ku thuhet: **“...Thuaj: ‘Nuk ju kërkoj përkëtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmeve...’”**, Profetin e pyetën: **“...O i Dërguar i All'llahut! Cilët janë të afërmit e tu? Cilët janë këta që detyrohemi t'i respektojmë dhe t'i duam?”** Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: **“...Aliun, Fatimen dhe dy djemtë e saj (Paqja qoftë mbi ta!).”** Këtë e përsëriti tri herë.¹

2- Në “Mustedrek Es Sahihejn” përmendet se Imam Ali ibn Hysejn, ka thënë: **“...Kur ra dëshmor Prijësi i besimtarëve, Imam**

¹“Ihkakul Hakk”, vëll. 3, f. 2. Ky transmetim është përmendur edhe tek tefsiri i “Kurtubijjut”, vëll. 8, f. 5843; fundi i ajetit në fjalë.

Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), Hasani i biri i Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) qëndroi t'u fliste njerëzve duke thënë: “Me të vërtetë, ne jemi prej Ehli Bejtit që All'llahu e ka bërë obligim dashurinë ndaj tyre për çdo mysliman. I Madhërishmi dhe i Lartësuari i ka thënë Profetit të Tij: “...Thuaj: ‘Nuk ju kërkoj përkëtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve’. Atij që bën vepër të mirë, Ne do t’ia shtojmë shpërblimin...”¹

3- Sujutijju në “Ed Durrul Menthur”, në fund të ajetit që komentojmë, përmend një transmetim të ardhur nga Muxhahidi, nga Ibn Abbasi, i cili për komentin e ajetit: “...Thuaj: ‘Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve...’”, ka thënë: “Të më ruani mua në Ehli Bejtin tim dhe t’i respektoni ata për hatrin tim.”²

Këtu bëhet e qartë dobësia e asaj që transmetohet nga Ibn Abbasi në një formë tjetër, ku thotë se ajo që nënkuptohet, është moslëndimi i Profetit, për shkak të afërsisë së tij me fiset e ndryshme arabe.

4- Ibn Xherir Et Taberij transmeton në tefsirin e tij, me zinxhir transmetimi nga Said ibn Xhubejr dhe me zinxhir tjetër transmetimi nga Omer ibn Shuajb, se ajo që synohet prej këtij ajeti, janë të afërmit e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).³

¹“Mustedrek Es Sahihejn”, vëll. 3, f. 182. Këtë hadith e ka transmetuar Muhibbu Din Et Tabirijju në “Edh Dhekhairu”, f 137; e ka përmendur Ibn Haxher në “Es Sauaikul Muhrikah”, f. 101.

²Tefsiri “Ed Durrul Menthur”, vëll. 6, f. 7; fundi i ajetit në fjalë.

³Tefsiri i “Tabarijju”, vëll. 25, f. 16,17.

5- Dijetari Et-Tabersijju transmeton prej “Sheuahidu Tenzijl” I El Hakimu El Hasekanij, që është prej komentuesve dhe muhadithëve më të njohur të Ehli Syneetit, nga Ebi Uname El Bahilij, se i Dërguari i Islamit, Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “...Në të vërtetë, All’llahu i ka krijuar Pejgamberët prej pemëve të ndryshme. Unë dhe Aliu jemi nga një pemë e vetme. Unë jam rrënja e saj, Aliu dega. Fatimeja është pjalmimi i saj, Hasani dhe Hysejmi janë frutat e saj, ndërsa ndjekësit tanë janë gjethet e saj.” Pastaj shtoi: “...Sikur një rob ta adhurojë All’llahun mes Safasë dhe Mervasë për një mijë vjet, pastaj dhe një mijë vjet të tjerë, edhe një mijë të tjerë, derisa të bëhet plak i moçëm dhe nuk na ka dashur neve, All’llahu do ta hedhë atë me fytyrë përmbys në zjarr.”. Pastaj Profeti lexoi: “...**Thuaj: ‘Nuk ju kërkoj përkëtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmeve...’**”.

6- Gjithashtu, edhe Sujutijju transmeton në “Ed Durrul Menthur” nga Ibn Xherir prej Ebi Ed Dejlm: Kur Ali ibn Hysejmi u zu rob dhe e mbajtën tek portat e Damaskut, një banor i Shamit tha: “*Falënderojmë All’llahun, i Cili ju vrau dhe ju çrrënjosi!*”

Ali ibn Hysejmi e pyeti: “*A e ke lexuar Kur’anin?*”

Burri u përgjigj: “*Po!*”

Ali ibn Hysejmi e pyeti sërish: “*A e ke lexuar suren’Hamim’ (Shura)?*”

Burri tha: “*Jo!*”

Ali ibn Hysejini vazhdoi: *"A nuk e ke lexuar këtë ajet: "...Thuaj: 'Nuk ju kërkoj përkëtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmeve..."?*

Burri i tha: *"A ju jeni ata, për të cilët flet ky ajet?"*

Ali ibn Hysejini i tha: *"Pa dyshim, po."*¹

7- Zamakhsherijju transmeton një hadith nga tefsiri "El Kesh'shaf", që e kanë huazuar edhe Fakhru Razi dhe Kurtubijju në tefsiret e tyre. Ky hadith qartëson pozitën e familjes së Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe rëndësinë e dashurisë ndaj tyre.

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:

- Kush vdes me dashurinë e familjes së Muhammedit, ka vdekur shehid.

- Kush vdes me dashurinë e familjes së Muhammedit, ka vdekur i penduar.

- Kush vdes me dashurinë e familjes së Muhammedit, ka vdekur besimtar me besim të plotësuar.

- Kush vdes me dashurinë e familjes së Muhammedit, e përgëzon engjëlli i vdekjes me Xhennet, pastaj Munkeri dhe Nekiri.

- Kush vdes me dashurinë e familjes së Muhammedit, i hapen në varr dy dyer për në Xhennet.

¹Tefsiri "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 7.

- Kush vdes me dashurinë e familjes së Muhammedit, All'Ilahu e bën varrin që të vizitohet nga engjëjt e mëshirës.

- Kush vdes me dashurinë e Muhammedit, ka vdekur në synet dhe xhema'atu.

- Kush vdes me urrejtjen e familjes së Muhammedit, vjen në Ditën e Kiametit dhe ka të shkruar në ballë: I dëshpëruar nga mëshira e All'Ilahut.

- Kush vdes me urrejtjen e familjes së Muhammedit, vdes qafir, jobesimtar.

- Kush vdes me urrejtjen e familjes së Muhammedit, nuk do ta shijojë aromën e Xhennetit.¹

E çuditshme në këtë çështje është se Fakhru Rrazi, pas përmendjes së këtij hadithi fisnik, të cilin e përcjell autori i tefsirit "El Kesh'shaf", thotë: Edhe unë them: Familja e Muhammedit janë ata, çështja e të cilëve i kthehet atij. Sa më e fortë dhe më e plotësuar të jetë çështja e tyre te ai, ata janë "el alu" (الآل). Nuk ka dyshim se lidhja mes Profetit dhe mes Fatimesë, Aliut, Hasanit dhe Hysejnit, ishte një nga lidhjet më të forta e kjo dihet dhe është *muteuatire*. Për këtë është obligim që ata të jenë "el alu" (الآل). Por, midis dijetarëve ka mendime të ndryshme rreth fjalës "el alu" (الآل). Thuhet se ata janë të afërmit dhe thuhet se janë ymeti i

¹Tefsiri "El Kesh'shaf", vëll. 4, f. 220, 221; tefsiri "El Kebijr", vëll. 27, f. 165, 166; tefsiri i "Kurtubijjut", vëll. 8, f. 5843, dhe tefsiri i "Tha'lebijjut". Fundi i ajetit në fjalë, nga Xheliil ibn Abdullah El Bexhelij (sipas transmetimit të "El Murraxheat", korrespondenca nr.19.)

Profetit. Nëse e mbartim kuptimin e saj për të afërmit, ata janë “el alu” (familja). Nëse e mbartim kuptimin e saj për ymetin të cilët e pranuan ftesën e tij, ata, gjithashtu, janë “el alu”. Në të gjitha vlerësimet konstatohet se ata janë “el alu”. Vallë, po të tjerët a i përfshin kjo fjalë? Për këtë ka mendime të ndryshme:

Autori i tefsirit “El Kesh’shaf”, transmeton se kur zbriti ky ajet, u tha: “...O i Dërguari i All’llahut, cilët janë këta të afërmit e tu, që jemi të detyruar t’i duam? Ai u përgjigj: *‘Aliu me Fatimen dhe dy djemtë e tyre.’*”. Kështu që u vërtetua dhe u konstatua që këta të katërt janë të afërmit e Profetit. Përderisa është konstatuar kjo, atëherë është obligim që ata të jenë të veçantë për respekt dhe madhështim. Kjo argumentohet si vijon:

E para: Fjala e All’llahut të Madhëruar: “...**Vetëm se respektin e dashurisë ndaj të afërmve**” ky argument u sqarua më lart.

E dyta: Nuk ka dyshim se Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e donte shumë Fatimenë, për të cilën ka thënë: “*Fatimeja është pjesë e imja. Mua më lëndon ajo çka e lëndon atë.*”. Është vërtetuar në transmetimet *muteuatire* të ardhura nga i Dërguari i All’llahut, se ai i donte Aliun, Hasanin dhe Hysejnin. Meqenëse është konstatuar kjo, atëherë, është e detyruar për të gjithë ymetin që të veprojnë si Profeti, sepse All’llahu i Madhëruar thotë: “...**Shkoni pas Tij, që të jeni në Rrugën e Drejtë!**”.¹ Dhe: “...**Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij...**”.²

¹Sure “El A’raf”, ajeti 158.

² Sure “En Nur”, ajeti 63.

Dhe: “Thuaju (o Muhammed): ‘Nëse ju e doni All’llahun, atëherë më ndiqni mua, që All’llahu do t’ju dojë...’”.¹

Dhe: “Në të Dërguarin e All’llahut ka një shembull të mrekullueshëm...”.²

E **treta**: Në të vërtetë, du’aja për familjen është një pozitë e nderuar. Kjo dua është bërë përmbyllëse e uljes së fundit në namaz (*et teshehud*) ku thuhet: *O All’llah, bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit! Mëshiroje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit!*

Këtë madhështim nuk e meriton askush, përveç familjes (*el alu*). E gjitha kjo tregon se dashuria për familjen e Profetit Muhammed është detyrë (*vaxhib*).

Shafi u (Zoti qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

“O udhëtar qëndro me gurishtet në Mina

dhe thirr të dëgjojë pushues’ i strukur e këmbësor

Herët në agim kur vërshojnë haxhinjtë në Mina

Vërshim si derdhja e Eufratit vërshues

Nëse dashuria ndaj familjes së Muhammedit është refuzim,

*le të dëshmojnë njerëz e xhindë se unë jam refuzues.”*³

Kjo është pozita e familjes së Profetit Muhammed, pas të cilëve ne kapemi fort dhe u besojmë atyre si udhëheqësit tanë dhe

¹Sure “Ali Imran”, ajeti 31.

²Sure “El Ah’zab”, ajeti 21.

³Tefsiri “El Kebir”, vëll. 27, f. 166.

si llampadarë të fesë dhe jetës sonë. Ne i konsiderojmë ata si shembull e model për ne dhe shohim se vazhdimësia e vijës së profecisë është në drejtimin e tyre.

Sigurisht, ka shumë transmetime të tjera, veç këtyre që përmendëm më lart, në burimet islame. Ne u mjaftuam me shtatë transmetime, duke i cekur ato shkurtimisht. Por, është problem nëse përmendim një çështje e cila është: Në disa burime të Ilmul Kelam, si: Ihkakul Hakki dhe Sherhuhu el Mabsut, përmendet hadithi i njohur i lartpërmendur që flet për komentimin e ajetit: **“Thuaj: ‘Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve.’”**. Ky hadith është përcjellë afërsisht në pesëdhjetë libra prej librave të Ehli Syneetit. Kjo çështje sqaron qartë përhapjen e gjerë të këtij trasmetimi dhe famën e tij, pa marrë parasysh edhe transmetimet e shumta të cilat e përcjellin këtë hadith burimet nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Hulumtime

1- Bisedë me komentuesin e shquar El Alusij

Në tefsirin e tij “Ruhul Meanij”, Alusij shtron një pyetje në formë kundërshtuesve ndaj shi’itëve. Ne po e përmendim atë këtu dhe do ta diskutojmë. Ai thotë: Ka prej shi’itëve që e kanë përmendur ajetin në pozitën e argumentit të udhëheqjes së Aliut (*All’llahu ia ndriçoftë fytyrën!*). Ata kanë thënë: Për Aliun (*All’llahu ia ndriçoftë fytyrën!*) është obligim dashuria ndaj tij. Për atë që

obligohet dashuria ndaj tij, obligohet edhe bindja ndaj tij dhe për atë që obligohet bindja ndaj tij ai është merituesi i udhëheqësisë dhe prijësisë (el Imamet). Nga kjo konkludohet se Aliu është udhëheqës dhe prijës. Në fjalët e tyre ka hulumtime:

Së pari: Argumenti në ajetin për domosdoshmërinë e dashurisë, është se ajeti ka kuptimin për dashurinë ndaj familjes së Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi ta!*). Ndërkohë, që një shumicë e komentuesve nuk e kanë pranuar këtë komentim duke thënë: “Kjo nuk është në pozitën e Profetësisë. Për shkak se akuzon Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) për vepra dhe përkushtim ndaj kësaj bote dhe atëherë fillon të kërkojë përfitime për fëmijët dhe të afërmit e tij. Përveç kësaj, kjo bie në kundërshtim me ajetin: **“Ti nuk po kërkon prej tyre kurrfarë shpërblimi për këtë...”**”¹

Së dyti: Ne nuk e miratojmë se çdo meritues i dashurisë është meritues i bindjes. Ibn Babeuiejeh në librin “El I’tikadat” se Imamitet ka rënë dakord për domosdoshmërinë e dashurisë për alevitet, megjithëse nuk është obligim bindja e secilit prej tyre.

Së treti: Ne nuk e miratojmë thënien që çdo meritues i bindjes është udhëheqës, prijës, dhe teksti kur’anor: **“All’llahu caktoi sundues tuajin, Talutin.”**² e kundërshton këtë.

Së katërti: Sipas ajetit është obligim bindja për të gjithë Ehli Bejtin dhe me këtë argument del që të gjithë të jenë Imamë.

¹ Sure “Jusuf”, ajeti 104.

² Sure “El Bekare”, ajeti 247.

Ndërkohë që te Imamijtë nuk gjendet kjo doktrinë ku të gjithë pjestarët e Ehli Bejtit janë Imamë.”¹

Analizë dhe diskutim

Këto problematika mund të sqarohen me përgjigje të shumta nëse thellohemi te ajeti në fjalë, bazuar edhe te faktet e shumta e të forta që gjenden në këtë ajet dhe në ajetet të tjera kur'anore.

Për këtë themi: Në të vërtetë kjo dashuri nuk është çështje e zakonshme, përkundrazi është pjesë e Profetësisë dhe shpërblim për mesazhin. Për këtë duhet që shpërblimi të jetë i barabartë me të shpërblyerin që të konsiderohet pjesë e tij. Kjo nga njëra anë.

Nga ana tjetër, ka ajete kur'anore që qartësojnë se dobia e kësaj dashurie nuk i kthehet Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*), por dobia e kësaj dashurie u kthehet vetë besimtarëve. Thënë ndryshe: Kjo dashuri konsiderohet çështje shpirtërore që ndikon në udhëzimin e myslimanëve dhe në përsosmërinë e tyre.

Sipas kësaj, pavarësisht se prej ajetit nuk përftohet asgjë veç domosdoshmërisë së dashurisë, mirëpo kjo domosdoshmëri e kësaj dashurie, duke respektuar argumentet e përmendura, ka lidhje me çështjen e udhëheqësisë (*el Imametu*).

Pas këtij shpjegimi të shkurtër, do të hulumtojmë paqartësitë e larpërmendura:

¹ Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëll. 25, f. 28, fundi i ajetit në fjalë.

1- Duhet ta theksojmë se përshkak të disa mbetjeve mendore dhe paraprirja në qëndrime, çuan që disa komentues të mos e komentojnë ajetin me dashurinë për Ehli Bejtin. Përshebull: disa e kanë komentuar fjalën *el kurba* me kuptimin e të afëruarit të Krijuesi, ndërkohë që ajo ka kuptimin e të afërmeve në të gjitha ajetet kur'anore në të cilat gjendet kjo fjalë.

Disa të tjerë e kanë komentuar në kuptimin e të afërmeve të Profetit së bashku me disa fise arabe. Ky komentim e ndryshon totalisht sistemin e ajetit. Shpërblimi për mesazhin kërkohet prej atyre që e pranuan mesazhin.

Në shtesë të kësaj, përse t'i lëmë mënjane transmetimet e shumta që e komentojnë ajetin me vilajetin e Ehli Bejtit të Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*).

Për këtë duhet pohuar se këta komentues nuk e kanë komentuar këtë ajet me mendje të zbrazëta nga fanatizmi, përndryshe nuk do gjendej ndërlëkim në këtë çështje.

Nga këtu bëhet e qartë se kërkesa e këtij shpërblimi nuk bie ndesh as me pozitën e profecisë dhe as nuk është i ngjashëm me zakonet e pasuesve të dynjasë. Ajeti është në përshtatje të plotë me ajetin 104 të sures "Jusuf", i cili mohon çdo lloj shpërblimi, sepse Profeti nuk përfiton nga shpërblimi dashurisë për Ehli Bejtin, përkundrazi janë myslimanët ata që përfitojnë prej këtij shpërblimi.

2- Është e vërtetë se, obligimi i dashurisë normale, nuk është kurrë argument i obligimit të bindjes. Mirëpo, kur kjo dashuri është në nivelin e Shpalljes, atëherë do të bindemi se ajo

përfshin domosdoshmërinë e bindjes. Nga këtu sqarohet se thënia e ibn Babeuejhi (Shejkh Saduk) nuk bie ndesh me atë që thamë.

3- Është e qartë se çdo bindje e obliguar nuk është argument i gradës së udhëheqësisë (Imamatit) dhe prijësisë së madhe. Duhet patur parasysh se obligushmëria e bindjes, e cila është shpërblim për Shpalljen, nuk mund të jetë asgjë tjetër përveç udhëheqësisë.

4-Imami, me kuptimin e udhëheqësit, nuk mund të jetë më shumë se një person në çdo kohë. Bazuar në këtë, nuk gjendet asnjë kuptim për Imamatin e të gjithë pjestarëve të Ehli Bejtit, me përjashtim të dymbëdhjetë Imamëve të pamëkatë. Për këtë çështje duhet përfituar edhe nga roli i transmetimeve për të kuptuar kuptimin e ajetit.

Ajo që tërheq vëmendjen është se vetë Alusiju kujdeset shumë për dashurinë e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ai thotë: “E drejta e domosdoshmërisë së dashurisë së të afërmeve të tij (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!*), është se ata janë të afërmit e tij. Sa më e fortë të jetë afërsia, aq më e madhe është kërkesa e dashurisë... dhe gjurmët e dashurisë, nderimit, respektit dhe e zbatimit të të drejtave janë më të plota. Shumë njerëz kanë neglizhuar rreth kësaj dashurie derisa e quajtën refdun (refuzim) rrugëtimin në këto rrugë. Dhe unë them fjalën e Shafiut:

“O udhëtar qëndro me gurishtet në Mina

dhe thirr të dëgjojë pushues’ i strukur e këmbësor

Herët në agim kur vërshojnë haxhinjtë në Mina

Vërshim si derdhja e Eufratit vërshues

Nëse dashuria ndaj familjes së Muhammedit është refuzim,

le të dëshmojnë njerëz e xhindë se unë jam refuzues.”

E kjo nuk besoj se është në daljen nga ajo që besojnë dijetarët e mëdhenj të Ehli Syneetit për sahabët (*All’llahu qoftë i kënaqur me ta!*). Unë besoj se dashuria për Ehli Bejtin është detyrë e imja e qartë. Atë dashuri e ka bërë obligim All’llahu dhe ka sjellë argumente ndriçuese për këtë.¹

2-Anija e shpëtimit

Fakhru Razi ka përmbledhur në fund të këtij diskutimi një vërejtje, siç e ka përmendur gjithashtu edhe Alusiju. Fakhru Razi beson se do të shuhen disa kontradikta nëpërmjet kësaj vërejtjeje:

Nga njëra anë, i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: “*Shembulli i Ehli Bejtit tim është si shembulli i anijes së Nuhut, që kush hipën në të, shpëton*”, dhe në anën tjetër ka thënë: “*Shokët e mi janë si yjet. Me cilindo që të udhëhiqeni, do të udhëzoheni*.”.

Ne tani jemi të humbur në oqeanin e detyrimeve, të përgjegjësi dhe dallgëve të dyshimeve. Pasionet na shkundin nga çdo anë. Kush dëshiron që ta kalojë këtë det, ka nevojë për dy gjëra:

E para: Duhet që anija të jetë pa ndonjë defekt apo mangësi.

¹Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëll. 25, f. 28; fundi i ajetit në flalë.

E dyta: Duhet që yjet vezullues t'i ndriçojnë rrugën.

Kur njeriu hipën në anije, sytë e tij kontrollojnë yjet vezullues. Tek ata, ai do të gjejë shpresën e shpëtimit. Çdokush prej bijve të traditës Profetike, kur hipën në anijen e dashurisë së familjes së Muhammedit, shikon aty shokët, yjet. Tek ata, ai do të gjejë shpresën se Krijuesi i Madhëruar, do ta çojë drejt lumturisë dhe paqes në dynja dhe Ahiret.¹

Ky krahasim poetik nuk është metaforik, pavarësisht bukurisë së tij, sepse anija e Nuhut ishte mjet shpëtimi në ditën kur dallgët e tufanit dhe ujit mbuluan botën mbarë. Anija ishte në lëvizje të vazhdueshme, jo si sot anijet e zakonshme, të cilat kanë port ankorimi, ku drejtohen duke u orientuar nëpërmjet yjeve.

Ishte vetë qëllimi i anijes, shpëtimi nga mbytja, derisa u tërhoq uji dhe u qetësua rrebeshi.

Në disa transmetime theksohet se i Dërguari më i nderuar, (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*), ka thënë: *"Yjet janë amanet i banorëve të Tokës nga mbytja, kurse Ehli Bejti im është amanet i ymetit tim nga konfliktet për fe."*²

3- Komentimi i shprehjes: "kush bën ndonjë të mirë..."

Fjala *"ikterefe"* në fjalinë: **"Kush bën ndonjë të mirë, Ne ia shumëfishojmë të mirat"**, është marrë nga rrënja: *"karfun"*, njësoj si: *"harkun"*, që do të thotë *pjesët e lëvres shtesë të pemës*, ose nga plagët e marra, ku ndonjëherë janë edhe shenja të shërimit të

¹ Tefsiri "El Kebijr", vëll. 27, f. 167.

² Këtë hadith e transmeton Hakimi nga ibn Abbasi në "El Mustedrekul Uesail", vëll. 3, f. 149.

plagës dhe të përmirësimit të saj. Kjo fjalë u përdor më vonë për përfitimet e të ardhurave pa dallim, të pastra apo të pista.

Mirëpo, siç shpjegohet në fjalor, ky term është përdorur më shumë për të këqijat sesa për të mirat, pavarësisht se ajeti që komentojmë e ka përdorur atë edhe për të mirat.

Disa komentues transmetojnë nga Ibn Abbas dhe (Es Sed dij) se ajo që nënkuptohet nga shprehja “*iktiraful hasene*” – “*bërja e veprës së mirë*”, është respektimi i familjes së Muhammedit.¹

Në një hadith që e kemi përmendur më parë nga Imam Husejn ibn Ali, thuhet “...*Kryerja e veprës së mirë është Dashuria për Ehli Bejtin.*”.

Ajo që nënkuptohet nga këto komente, është se kuptimi i shprehjes “*kryerja e veprës së mirë*”, nuk kufizohet vetëm me dashurinë dhe respektin për Ehli Bejtin. Përkundrazi, ajo ka kuptim më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës. Por, meqenëse kjo fjali është përmendur pas çështjes së dashurisë për të afërmit, për këtë vërtetësia më e qartë e saj është dashuria (*el meuddetu*).²

4- Vendi i zbritjes së këtij ajeti

Surja “Shura” është nga suret e Mekës, siç e kemi thënë edhe në fillim. Vetëm disa komentues besojnë se këto katër ajete, pra ajetet 23-26, kanë zbritur në Medine. Vetë shkaku i zbritjes, të

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 44; fundi i ajetit në fjalë, si dhe tefsiri “Es Safij” dhe tefsiri “El Kurtubij”.

² Burimi i mësipërm.

cilin e përmendëm në fillim të komentit të këtyre ajeteve, e dëshmon qartë këtë kuptim.

Gjithashtu, edhe transmetimet, që e komentojnë Ehli Bejtin me Aliun, Fatimenë dhe dy djemtë e tyre, Hasanin me Hysejnin (*Paqja qoftë mbi ta!*), i përshtaten këtij kuptimi, sepse ne e dimë që martesë e Aliut me më fisniken e grave, Fatime Zahranë (*Paqja qoftë mbi të!*) është bërë në Medinë dhe se lindja e Hasanit dhe Hysejnit, (*Paqja qoftë mbi tëa!*) ka ndodhur në vitin e tretë dhe të katërt Hixhri.

Ajetet 24-26

أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَى عَلَى اللَّهِ كَذِبًا فَإِنْ يَشِإِ اللَّهُ يَخْتِمْ عَلَى قَلْبِكَ
وَيَمْحُ اللَّهُ الْبَاطِلَ وَيُحِقُّ الْحَقَّ بِكَلِمَاتِهِ إِنَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ،
وَهُوَ الَّذِي يَقْبَلُ التَّوْبَةَ عَنْ عِبَادِهِ وَيَعْفُو عَنِ السَّيِّئَاتِ وَيَعْلَمُ مَا
تَفْعَلُونَ، وَيَسْتَجِيبُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَيَزِيدُهُمْ مِنْ
فَضْلِهِ وَالْكَافِرُونَ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ،

“A thonë ata: ‘Ai (Muhammedi) trillon gënjeshtër për All’Ilahun?!’ Po të donte All’Ilahu, do ta vuloste zemrën tënde! All’Ilahu e shkatërron të pavërtetën dhe e forcon të vërtetën me Fjalët e Veta. Ai e di mirë ç’ka në zemrat e tyre.”

“Ai e pranon pendimin e robëve të Vet, i fal gjynahet dhe i di të gjitha çfarë punoni ju.”

“Ai u përgjigjet lutjeve të atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira e u jep edhe më tepër prej dhuntisë së Vet, kurse për mohuesit do të ketë dënim të ashpër.”

Komentimi

Ai e pranon pendimin e robëve të Tij

Këto ajete vlerësohen si vazhdimësi e ajeteve të mëparshme në temën e kumtit dhe shpërblimit të tij, dashurisë dhe respektimit të të afërmeve dhe Ehli Bejtit të Profetit Muhammed (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ajeti i parë thotë se ky popull nuk e pranon Shpalljen e All'llahut, përkundrazi: **“A mosthonë ata se ai** (Muhammedi) **shpifi gënjeshtër ndaj All'llahut...”**. Ky besim është pjellë e mendimeve të tyre, të cilin ia atribuojnë atë Krijuesit?

Ndërkohë: **“...Po të donte All'llahu, do ta vuloste zemrën tënde...”** dhe të zhvesh nga aftësia e të kuptuarit të këtyre ajeteve.

Në të vërtetë, kjo çështje është tregues i argumentimit logjik, se nëse një njeri pohon profecinë dhe sjell argumente të qarta për mrekullitë, atë e përfshin ndihma dhe mbështetja e All'llahut, por nëse ky shpif gënjeshtër për All'llahun, atëherë urtësia e All'llahut vendos që t'ia heqë mrekullitë, t'ia çjerrë maskën dhe ta lërë pa mbrojtjen hyjnore, siç dhe theksohet në ajetet 44 - 46 të sures “El Hakkah”: **“Sikur të trillonte ai** (Muhammedi) **për Ne ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë me fuqinë tonë. E pastaj do t'ia këputnim atij arterien e zemrës.”**.

Disa komentues përmendin supozime të tjera për komentimin e kësaj fjalie, por ajo që shtjelluam më lart është më e mira, më e drejta dhe më e sakta prej tyre.

Vëmë re se një nga akuzat me të cilat idhujtarët dhe jobesimtarët akuzojnë të Dërguarin (*Paqja e bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është se ai, e konsideron shpërblimin e kumtit në dashurinë dhe respektimin e familjarëve të tij, e për këtë ai shpif gënjeshtër për Krijuesin në këtë çështje, vetëm se ajeti i mësipërm e mohon këtë akuzë ndaj tij.

Pavarësisht kësaj, nuk ka dyshim se nocioni i këtij ajeti nuk veçohet në këtë kuptim, se armiqtë e të Dërguarit e kanë akuzuar atë me këtë akuzë në të gjithë Kur'anin dhe Shpalljen, ashtu siç thonë dhe ajetet e tjera kur'anore, si ajeti 38 i sures Junus: **"Përkundër kësaj, ata (idhujtarët) thonë se atë e trilloi ai (Muhammedi). Ti thuaj: 'Silleni pra ju, një kaptinë të ngjashme me këtë.'"**.

Gjithashtu, kjo akuzë vjen po me të njëjtin kuptim, por me një ndryshim të vogël, në ajetet 13 dhe 35 të sures Hud, dhe një pjese tjetër të ajeteve kur'anore.

Më pas, ajeti vazhdon: **"All'Ilahu e shkatërron të pavërtetën dhe e forcon të vërtetën me Fjalët e Veta..."**.

Kjo është përgjegjësi e Krijuesit, për sqarimin e së vërtetës dhe çjerren e maskës së të pavërtetës, që bazohet në urtësinë e Tij. Nëse nuk është kështu, atëherë si është e mundur të lejohet një njeri të shpifë gënjeshtër ndaj Atij, e në të njëjtën kohë ta ndihmojë atë, duke shfaqur në duart e tij mrekullitë?!

Disa idhujtarë mendojnë se është gjynah i madh që i Dërguari (*Paqja e bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të kryejë kësi veprash dhe t'i fshehë ato nga dituria e Krijuesit: **"...Ai e di mirë ç'ka në zemrat e tyre."**

Siç kemi thënë në komentin e ajetit 38 të sures “Fatir”, fjala “*dhatun*” në gjuhën arabe nuk është *esenca e gjërave* dhe e vërteta e tyre; përkundrazi, ky është një term filozofik¹, ku fjala: “*dhat*” ka kuptimin *zotëruesi*, pronari i diçkaje. Kështu që në këtë rast, kuptimi i fjalisë do të ishte: “**...Ai e di mirë ç’ka në zemrat e tyre.**”, pra Krijuesi është i Gjithëditur për mendimet dhe besimet që kontrollojnë zemrat.

Krijuesi e mban gjithnjë të hapur rrugën e kthimit tek Ai për robtë e Tij, prandaj edhe ajetet kur’anore, pas qortimit të veprave të shëmtuara të idhujtarëve dhe mëkatarëve, tregojnë se dyert e pendimit janë të hapura gjithmonë: “**Ai e pranon pendimin e robëve të Vet, i fal gjynahet...**”.

Nëse shtireni sikur jeni penduar dhe në të vërtetë keni fshehur punë të tjera, mos t’ju shkojë ndër mend se kjo gjë është e fshehtë për diturinë e Krijuesit: “**...dhe i di të gjitha çfarë punoni ju.**”.

Thamë për shkakun e zbritjes, se pas zbritjes së ajetit të dashurisë dhe respektimit të të afërmve, disa prej *hipokritëve* dhe njerëzve me besim të dobët, thanë: Me të vërtetë, që këtë fjalë e ka shpifur Muhammedi për Krijuesin. Nëpërmjet kësaj, ai dëshiron të na poshtërojë me të afërmit e vet pas tij. Për këtë arsye zbriti ajeti: “**A mosthonë ata se ai (Muhammedi) shpifi gënjeshtër ndaj All’Ilahut?...**”.

Kur mësuan për zbritjen e këtij ajeti, një pjesë u penduan dhe nisën të qajnë. U bë një situatë shqetësuese, prandaj zbriti

¹Shih “MufredatuRragib”.

ajeti: **“Ai e pranon pendimin...”**, që i përgëzoi me faljen e gjynahut nëse pendohen tek All’llahu me një pendesë të singërtë.

Kurse ajeti i fundit na e bën të qartë shpërblimin e madh të besimtarëve dhe ndëshkimin e rëndë për jobesimtarët. Shkurt dhe qartë, ai thotë: Me të vërtetë, All’llahu i përgjigjet lutjes së besimtarit dhe kërkesave të tij: **“Ai u përgjigjet lutjeve të atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira...”**. Madje **“...e u jep edhe më tepër prej dhuntisë së Vet...”**. Aido t’u japë atyre edhe atë që nuk kanë kërkuar: **“...kurse për mohuesit do të ketë dënim të ashpër.”**.

Komente të shumta janë përmendur për çështjen që u përgjigjet besimtarëve. Disa prej dijetarëve i kanë përkufizuar në kërkesa të përcaktuara qartë dhe saktë, që janë:

- Ai do t’u përgjigjet lutjeve të besimtarëve një e nga një.
- Prej kërkesave është se Ai do të pranojë adhurimet dhe bindjet e tyre.
- Prej saj është ajo që kjo përgjigje është e veçantë për shefatin e tyre për vëllezërit e vet.

Mirëpo, nuk ka asnjë argument për këtë kufizim që All’llahu do t’i përgjigjet lutjes së çdo kërkesë të besimtarëve, të cilët kanë bërë punë të mira. Çështja qëndron më larg se kaq sepse All’llahu do t’u dhurojë atyre besimtarëve nga begatitë e Tij, mirësi të cilat kurrë nuk i kishin menduar e as nuk i kanë kërkuar. Kjo përbën pozitën e lartë të mirësisë dhe mëshirës së All’llahut për besimtarët e devotshëm.

Ajetet 27-31

وَلَوْ بَسَطَ اللَّهُ الرِّزْقَ لِعِبَادِهِ لَبَغَوْا فِي الْأَرْضِ وَلَكِنْ يُنْزِلُ بِقَدَرٍ مَا
يَشَاءُ إِنَّهُ بِعِبَادِهِ خَبِيرٌ بَصِيرٌ^{٢٧} وَهُوَ الَّذِي يُنْزِلُ الْغَيْثَ مِنْ بَعْدِ مَا
قَنُطُوا وَيَنْشُرُ رَحْمَتَهُ وَهُوَ الْوَلِيُّ الْحَمِيدُ^{٢٨} وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقُ السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضِ وَمَا بَثَّ فِيهِمَا مِنْ دَابَّةٍ وَهُوَ عَلَى جَمْعِهِمْ إِذَا يَشَاءُ قَدِيرٌ^{٢٩}
وَمَا أَصَابَكُمْ مِنْ مُصِيبَةٍ فَمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ^{٣٠}
وَمَا أَنْتُمْ بِمُعْجِزِينَ فِي الْأَرْضِ وَمَا لَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا
نَصِيرٍ^{٣١}

“Sikur All’Ilahu t’i shtonte mjetet e jetesës për robtër e Vet, ata do ta mbushnin Tokën me mbrapshti. Por Ai u jep me masë, sa dëshiron, sepse Ai i njeh dhe i sheh mirë robtë e Vet.”

“Është Ai që e zbret shiun, kur ata kanë humbur çdo shpresë dhe përhap mëshirën e Vet; Ai është Mbrojtësi i vërtetë dhe i Denji për falënderim.”

“Një prej shenjave të Tij është krijimi i qiejve dhe i Tokës dhe i qenieve të gjalla, që ka shpërndarë nëpër to; Ai është i Fuqishëm t’i tubojë ata kur të dojë.”

“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë.”

“Në këtë Tokë ju nuk mund t’i shpëtoni Atij, sepse, veç All’lلاهut, nuk ka tjetër mbrojtës apo ndihmës për ju.”

Shkaku i zbritjes

Transmetohet nga një sahab i njohur, Khabbab ibn Erth, se ajeti i parë: **“Sikur All’lلاhu t’i shtonte...”**, ka zbritur për ne, për shkak se ne shikonim pasuritë e shumta të *Beni Kurejdhëve*, *Beni Nedhirëve* dhe *Beni Kajnakaa* të çifutëve. Kështu që kishim shumë dëshirë të zotëronim edhe ne një pasuri të tillë, derisa zbriti ky ajet që paralajmëroi, se sikur Krijuesi të shumonte begatitë tona, ne padyshim do të bënim padrejtësi.¹

Kurse në Tefsirin “Ed Durrul Menthur”, përmendet një hadith tjetër, i cili thotë se ky ajet ka zbritur për popullin e *Es Sufetu*, sepse ata shpresonin në përmirësimin e situatës së tyre në këtë botë.²

Në fund të ajeteve ka një analizë më të hollësishme, e në mënyrë të veçantë për banorët e Sufes dhe rrethinave të tjera.

¹ Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 27, f. 171; Tefsiri “Ruhul Xhinan”; Tefsiri i “Kurtubijut”; fundi i ajetit në fjalë.

² Autori i tefsirit “Ed Durrul Menthur” e përcjell këtë hadith nga Hakimi, Bejhakiju dhe Ebi Neimi, vëll. 6, f. 8.

Komentimi

Të pasurit zullumqarë

Ka mundësi që këto ajete të kenë lidhje me ajetet e mëparshme, duke marrë parasysh atë që përmendet në ajetin e fundit prej ajeteve të mëparshme që All'llahu u përgjigjet lutjes së besimtarëve. Për këtë shtrohet pyetja: Pse shikojmë që mes besimtarëve ka njerëz fukarenj, të varfër, që nuk e marrin atë që kërkojnë, sado e sido që të luten? Ajeti thotë: **“Sikur All'llahu t'i shtonte mjetet e jetesës për robtë e Vet, ata do ta mbushnin Tokën me mbrapshti. Por Ai u jep me masë, sa dëshiron...”**.

Bazuar në këtë, pa dyshim që ndarja e begative bëhet sipas një llogarie tepër të mprehtë nga Krijuesi ndaj robërve të Tij. Kjo ndodh për shkak se: **“...sepse Ai i njeh dhe i sheh mirë robtë e Vet.”**.

Ai e di masën dhe kapacitetin që ka çdo njeri sipas nevojës, prandaj dhe nuk i jep shumë, që të mos bëjë padrejtësi, nuk i jep edhe pak, që të përjetojë mjerimin e varfërisë.

Ka një përngjasim në këtë kuptim me ajetet 6dhe7 të sures “Alak”, ku thuhet: **“Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë, për shkak se e ndjen veten të pavarur.”**.

Është me të vërtetë kështu, sepse hulumtimi mbi gjendjen e njerëzve, e dëshmon këtë pohim të sinqertë. Kur i vë para kjo dynja dhe jetojnë në luks e bollëk të madh, ata e harrojnë Krijuesin dhe largohen prej Tij, mbyten në oqeanin e pasioneve,

bëjnë gjëra që nuk duhej t'i bënin dhe përhapin padrejtësi, tirani e shthurje në Tokë.

Në një tefsir të Ibn Abbasit, në këtë ajet përmendet se, ajo që nënkuptohet nga fjala *"bag'jun"*, nuk është *padrejtësi* dhe *tirania*. Në të vërtetë, *"bag'jun"* do të thotë *"talebun"*- *"kërkesë"*. Kështu që kuptimi i ajetit është se ata kërkojnë më shumë dhe nuk ngopen kurrë.

Tefsiri i parë është pranuar nga ana e shumë komentuesve dhe duket se është më i parapëlqyeri, sepse shprehja: **"jebgune fil erdhi"**, që do të thotë: **"...ata do ta mbushnin Tokën me mbrapshti..."**, është përmendur disa herë në ajetet kur'anore në kuptimin: *çrregullime* dhe *padrejtësi* në Tokë. Për shembull: **"E kur Ai (All'lahu) i shpëtoi ata, ja, ata veprojnë mbrapsht në Tokë, pa arsye."**¹ Dhe: **"Qortim ka vetëm kundër atyre që u bëjnë keq njerëzve dhe që pa të drejtë mbjellin ngatërresa në Tokë..."**²

Është e vërtetë që fjala *"bag'jun"* është përmendur me kuptimin e *kërkesës*, por kur përmendet me fjalën *"fil erdhi"* -*"në tokë"*, atëherë ajo ka kuptimin e *çrregullimit*, *shkatërrimit* dhe të *padrejtësisë në tokë*.

Këtu shtrihen dy pyetje:

E **para**: Nëse ndarja e begative do të ishte sipas këtij programi, atëherë përse shohim njerëz që kanë begati të pamatë,

¹ Sure "Junus", ajeti 23.

² Sure "Shura", ajeti 42.

që kanë bërë çrregullime në Tokë, kanë bërë padrejtësi të ndryshme në dynja dhe Krijuesi nuk i ka ndaluar ata? Qofshin këta individë apo shtetete grabitqare dhe zullumqare?

Përgjigje: Ndonjëherë, shumimi i begative mund të jetë një mënyrë testimi dhe sprove, sepse të gjithë njerëzit duhet të sprovohen në këtë botë, e një pjesë prej tyre sprovohen nëpërmjet pasurisë.

Ndonjëherë ndodh që shumimi i pasurisë të bëhet për një pjesë njerëzish, me qëllim që ta dinë mirë se pasuria nuk mund ta tërheqë pas saj lumturinë. Mbase në këtë mënyrë, ata gjejnë rrugën e vërtetë dhe kthehen te Krijuesi i tyre. Ne po shohim me sytë tanë, se si disa prej shoqërive janë mbytur me lloje të ndryshme begatish dhe pasurish, por në të njëjtën kohë, ato i kanë përfshirë fatkeqësi dhe probleme të ndryshme si: frika, vrasja, ndotja e moralit dhe tmerri me të gjitha llojet e shfaqjes së tij.

Ndonjëherë, pasuria e pallogaritshme mund të jetë një lloj dënimi nga All'llahu, i cili përfshin një pjesë të njerëzve. Ne e shikojmë jetën e tyre nga larg, që duket e bukur, mirëpo nëse e vërejmë më nga brenda, do të shohim hidhërimin në situatat më të ulëta. Në këtë kontekst ka histori të ndryshme për sulltanë të pasurisë kudo në botë.

E dyta: A nuk do të thotë kjo, se kur njeriu është i varfër, ai nuk duhet të përpiqet për të shtuar begati, se Krijuesi e ka vënë të mirën për të, pikërisht në këtë varfëri?

Përgjigje: Begatia mund të jetë e pakët për shkak të përtacisë së njeriut, ndonjëherë dhe neglizhencës së tij, por ky pakësim dhe privim nga begatia, nuk është ajo që përfundimisht

All'llahu dëshiron; përkundrazi, për shkak të veprave, Islami i fton të gjithë në përpjekje, luftë e këmbëngulje, duke u bazuar në origjinën e përpjekjes, shpenzimit të mundit dhe forcës, për të cilën tregojnë ajetet e shumta kur'anore, tradita e të Dërguarit (*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamëve të pastër (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kur njeriu shpenzon tërë mundin e tij, por i mbyllen dyert para syve, duhet ta dijë mirë se ka një interes të përcaktuar në këtë çështje. Ai nuk duhet të dëshpërohet, apo të pikëllohet, nuk duhet të thotë fjalë që çojnë në *kufër, mohimin e Zotit*, por duhet të vazhdojë në përpjekjet e tij, t'i dorëzohet kënaqësisë së Krijuesit.

Vlen të shtjellohet në këtë shënim, se fjala "*ibadihi*", që do të thotë: "*robtë e Tij*", nuk mund të jetë asnjëherë në kontradiktë me tiraninë të shtimi i begatisë, sepse kjo shprehje përdoret për njerëzit e mirë, të këqinj dhe ata me nivel mesatar. Prandaj, Zoti thotë: **"Thuaj: O robtë e Mi, që e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Zotit!"**.¹

Është e vërtetë se Krijuesi e zbret begatinë, aq sa njerëzit të mos bëjnë mizori, tirani, veçse Ai as nuk i ndalon ata dhe as i privon ata, prandaj edhe ajeti që vjen më pas, thotë: **"Është Ai që e zbret shiun, kur ata kanë humbur çdo shpresë dhe përhap mëshirën e Vet..."**.

E si të mos jetë kështu, ndërkohë që: **"...Ai është Mbrojtësi i vërtetë dhe i Denji për falënderim."**?

¹ Sure "Zumer", ajeti 53.

Ky ajet flet për argumente dhe shenja të Njehsimit (*et teuhijdu*). Në të njëjtën kohë, ai sqaron begatinë dhe mirësinë e Krijuesit. Rënia e shiut përmban në vetvete një rregull shumë të përpiktë dhe të mirëllogaritur. Dielli del mbi dete dhe oqeane. Atomet e vogla të ujit ndahen nga kripërat e në formën e reve, ngrihen në qiell, pastaj shtresat e larta e të ftohta të atmosferës bëjnë ngjeshjen e tyre. Më pas, erërat i bartin drejt tokave të thata, e së fundmi, ato shndërrohen në pika shiu për shkak të ajrit të ftohtë dhe presionit të tij të veçantë, kështu që bien në formën e shiut mbi Tokë dhe depërtojnë në të pa e prishur.

Nëse do të shihnim me vëmendje këtë rregull, do të gjenim Shenjat e fuqisë së Krijuesit dhe diturinë e Tij të gërshetuara mes tyre. Ai është Mbikëqyrësi i Falënderuar, i Cili garanton të gjitha nevojat e robëve dhe ata i përfitojnë mirësitë e Tij të shumta.

Duhet thënë se fjala "*gajthun*" do të thotë "*shiu i dobishëm*", siç pohojnë shumë prej komentuesve dhe disa gjuhëtarë, ndërsa fjala "*matarun*" përdoret për të gjitha llojet e tjera të shiut, që janë të dobishëm dhe dëmtes.

Prandaj, pas asaj fjalie vjen shprehja: "**...përhap mëshirën e Vet...**".

O Zot, ç' shprehje e ëmbël dhe gjithëpërfshirëse!

Pra, Ai e shpërndan mëshirën e Tij për të ringjallur tokat e vdekura, zhvillimin e bimësisë, pastrimin e ajrit, garantimin e ujit të pijshëm për njerëzit e pjesën tjetër të gjallesave, si dhe pastërtinë në të gjitha aspektet.

Nëse njeriu dëshiron të kuptojë nocionin e kësaj fjalie kur'anore, atëherë ai duhet të drejtohet drejt maleve dhe

rrjedhave pasi ka rënë shiu, e kur lind dielli, me qëllim që të shohë bukurinë, mirësinë dhe mëshirën e madhe të Krijuesit. Ajo përfshin çdo vend.

Përfitimi prej fjalës “*gajthun*”, mund të jetë për shkak se ajo ka rrënjë të përbashkëta me fjalën “*gauthun*”, që vjen nga fjala “*igathetun*”, që do të thotë “*ndihma*”. Për këtë shkak, disa komentues e kanë konsideruar fjalën e mësipërme si tregues për çdo lloj ndihme nga Krijuesi pas dëshpërimit dhe përhapjes së mëshirës së Tij.¹

Ajeti që vjen pas tij flet për argumentet më të rëndësishme të diturisë dhe fuqisë së Krijuesit, dhe thotë: **“Një prej Shenjave të Tij është krijimi i qiejve dhe i Tokës dhe i qenieve të gjalla, që ka shpërndarë nëpër to...”**.

Qiejt, me madhështinë, yjësitë, me planetet e tyre dhe miliona e miliona yje vezullues të mëdhenj, me sistemin e tyre të përkryer, të cilët habisin njeriun kur i sheh; Toka me burimet e saj të gjalla jetësore dhe bimët e saj të shumëllojshme, lulet, frutat, me begatinë dhe bukuritë e dhuratave të ndryshme... Të gjitha këto konsiderohen argumente dhe Shenja që vërtetojnë ekzistencën e All’llahut.

Në anën tjetër, gjallesat në tokë dhe qiell, llojet e ndryshme të shpendëve dhe qindra e mijëra insekteve, llojet e ndryshme të kafshëve të buta e të egra, zvarranikët, peshqit me gjithë larminë në lloje dhe përmasat e tyre, mrekullitë e ndryshme të pranishme në secilin lloj prej tyre, dhe ç’është më e rëndësishmja, e vërteta e

¹ Në librin “El Mufredatu” Ragibi thotë: “*el gatuhu*”, do të thotë “*ndihmë*”, kurse “*el hajthu*” thuhet për “*shiun*”.

jetës me sekretet e saj, që askush nuk ka mundur të arrijë në esencën e saj, edhe pse pas mijëra vite kërkimesh nga miliona dijetarë e shkencëtarë... Kjo është prej argumenteve të Krijuesit.

Tërheq vëmendjen fjala "*dabbetun*", e cila përfshin *gjallesat e gjalla mikroskopike*, që bëjnë lëvizje të çuditshme, të buta, të lehta. Kjo fjalë përfshin edhe kafshët e mëdha, gjigande, të cilat arrijnë një gjatësi prej dhjetëra metrash e një peshë prej dhjetëra tonelatash. Çdo lloj e madhëron me mënyrën e tij të veçantë dhe e falënderon Krijuesin, duke e bërë të qartë madhësitinë, fuqinë dhe diturinë e Tij të pakufishme.

Në fund, ajeti thotë: **"...Ai është i Fuqishëm t'i tubojë ata kur të dojë."**¹²

Për çfarë bashkimi gjallesash bëhet fjalë? Një numër i madh komentuesish thonë se në Ditën e Kiametit ndodh bashkimi për llogaridhënie dhe shpërblimi i veprave të njerëzve. Ajetet që përmendin Kiametin si Dita e Bashkimit mund të konsiderohen argument për këtë kuptim (njëlloj si në ajetin 7 të kësaj sureje dhe në ajetin 9 të sures "Tegabun").

Pyetje: A do të mblidhen të gjitha gjallesat Ditën e Kiametit, përveç njeriut? Ashtu siç thuhet ndonjëherë, se fjala "*dabbetun*", emërton të tjera gjallesa, veç njeriut. Këtu lind pyetja: si do të bashkohen gjallesat, përveç njeriut, në dhënien e llogarisë, kur ato as nuk gëzojnë mendje, nuk zgjedhin dhe as nuk janë të detyruara, e as të përgjegjshme?

¹"*Idha*", siç thotë autori i tefsirit "*El Kesh'shaf*", përdoret si në foljet e kohës së tashme, ashtu edhe në foljet e kohës së shkuar, si "*uel lejli idha lagsha*". Mirëpo, në shumicën e rasteve, folja është pas "*idha*" në kohën e shkuar dhe shumë pak në të tashmen.

Përgjigje: Përgjigjja e kësaj pyetjeje është përmendur në fund të ajetit 37 të sures “En’Am”: **“Nuk ka asnjë gjallesë në Tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahë, e që nuk janë të ndarë në grupe (të ndryshme), sikurse edhe ju (Zoti i krijoi, i pajisi si ju). Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca. Më në fund, te Zoti i tyre do të tubohen.”**

Kemi thënë se jeta e shumë kafshëve karakterizohet nga një sistem i shkëlqyer dhe i mrekullueshëm. Atëherë, ku qëndron pengesa, që edhe veprat e tyre të jenë rezultat i një logjike dhe ndjenje në to? A është e domosdoshme që të gjitha këto çështje t'i referohen instinktit? Në këtë situatë mund të përfytyrojmë një lloj tubimi dhe llogarie për to. Një shpjegim më të gjerë për këtë temë lexojeni në fund të komentit të ajetit 38 të sures “En’Am”.

Supozohet në tefsirin e ajetit të mësipërm se ajo që nënkuptohet nga fjala “*el xhem’u*” është ekundërta e fjalës “*beth’the*”, sepse fjala “*beth’thun*” tregon për krijimin e llojeve të ndryshme të gjallesave të gjalla. Pastaj, nëse dëshiron Krijuesi, i tubon ato dhe i zhduk.

Ashtu si shumë nga gjallesat, që gjatë gjithë historisë u përhapën në një mënyrë të mrekullueshme, e pastaj u shfarosën dhe u zhdukën, po kështu edhe tubimi dhe shkatërrimi i tyre është në dorën e Krijuesit. Në të vërtetë, kjo u ngjason ajeteve, të cilët thonë: **jep jetë dhe merr jetë**, domethënë Krijuesi.

Atëherë, për këtë, çështja e llogarisë së kafshëve mbetet e huaj për këtë ajet.

Yjet qiellorë

Prej konkluzioneve të rëndësishme që konkludojmë nga ky ajet është se ai tregon për ekzistencën e gjallesave të ndryshme në qiej, pavarësisht mungesës së paraqitjes së një mendimi përfundimtar të dijetarëve në këtë fushë. Me pak fjalë, ata thonë: ka një hipotezë të fortë për ekzistencën e një numri të madh yjesh mes planeteve qiellorë, që kanë në përbërjen e tyre gjallesa të gjalla. Kur'ani e thotë më zë të lartë e të qartë këtë të vërtetë nëpërmjet ajetit: **“...dhe i qenieve të gjalla, që ka shpërndarë nëpër to...”**.

Ai supozim që thonë disa komentues se qëllimi në fjalinë: **“...nëpër to...”**, është i veçantë për Tokën, nuk është e saktë përshkak të pranisë së përemrit femëror i cili i referohet Qiellit dhe Tokës sëbashku (sipas gjuhës arabe). Po ashtu nuk është e rregullt të thuhet ajo që përmendet në disa komentime se kuptimi i fjalës *“dab'betun”* është për *“engjëjt”*, sepse fjala *“dab'betun”* zakonisht përdoret për gjallesat materiale.

Gjithashtu, ky kuptim mund të përfitohet nëpërmjet ajeteve të shumta kur'anore.

Në një hadith të transmetuar nga Ali ibn Ebi Talib (*Paqja goftë mbi të!*), thuhet: *“Yjet në qiell janë qytete, si qytetet që janë në Tokë. Çdo qytet është i lidhur me shtylla prej drite.”*¹

Ka edhe shumë transmetime të tjera në këtë aspekt, të cilat mund t'i shihni në librin *“El Hej'etul Islamijeh”*.

¹“Sefinetul Bihar”, vëll. 2, f. 574; Fjala *“en nexhmu”*, transmetuar nga tefsiri i “Ali ibn Ibrahim el Kummij”, si dhe “Biharul Anuar”, vëll. 55, f. 91.

Ajetet e mëparshme kur'anore flasin për mëshirën hyjnore. Shtrohet pyetja: si mund të bashkohet mëshira dhe të gjitha fatkeqësitë që godasin njerëzimin?

Kësaj pyetjeje i përgjigjet ajeti tjetër, teksa thotë: **“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë...”**.

Madje, ky dënim nuk është shpërblimi për të gjitha veprat tuaja të këqija, pasi: **“...por Ai fal shumë.”**.

Hulumtime

Shkaku i fatkeqësive

Është e domosdoshme të analizojmë me kujdes disa kuptime dhe koncepte që përmenden në këtë ajet:

1- Ky ajet sqaron qartazi se fatkeqësitë që godasin njeriun janë një lloj paralajmërimi dhe dënimi hyjnor, pavarësisht ekzistencës së disa përjashtimeve, për të cilat do të flasim më poshtë.

Me këtë parashtrim bëhen të qarta disa anë të filozofisë së ngjarjeve të dhimbshme dhe problemeve të vështira të jetës, që godasin herë pas here njerëz të ndryshëm.

E veçantë në këtë çështje është se në një hadith që Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka transmetuar nga i Dërguari i All'llahut (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Ajeti më i mirë në Librin e All'llahut është ky ajet. O Ali! Çdo gërvoshtje (gjemb) prej druri që hyn në trupin e njeriut dhe çdo dridhje këmbësh, është për shkak të një gjynahi (mëkati) që ka bërë. Ajo që Zoti e fal në dynja është më e dashur nga ajo që (në Kijamet) ta rishikojë. Dhe ajo që në këtë botë është dhënë si dënim, është më e drejtë nga ajo që të dënohet edhe një herë tjetër në Ahiret.”¹

2- Pavarësisht përgjithësimit të ajetit dhe përfshirjes së të gjitha fatkeqësivë në të, mirëpo për çdo përgjithësim ka përjashtime, e në këtë rast bëjnë përjashtim fatkeqësitë dhe problemet që kanë goditur Profetët e Imamët e mbrojtur (*Paqja qoftë mbi ta!*), me qëllim sprovimin dhe ngritjen e pozitës së tyre.

Gjithashtu, edhe fatkeqësitë me qëllim sprovimin, që përfshijnë të gabueshmit, apo fatkeqësitë që ndodhin për shkak të injorancës dhe mungesës së përkryerjes në çështje të ndryshme, si mungesa e këshillimit dhe të qenit i butë e tolerant, janë gjurmë të krijuara nga vetë veprat e njeriut.

Bashkimi mes argumenteve të ndryshme kur'anore dhe ngjarjeve, bën të domosdoshme analizën e disa burimeve. Megjithatë, kjo nuk është një temë e re për të qenë qendër debati dhe komentesh.

¹ Tefsiri “Mekhmail Bejan”, vëll. 9, f. 48; fundi i ajetit është burimi i diskutimit. Është përmendur ngjashëm me këtë hadith në tefsirin “Ed Durrul Menthur” dhe në tefsirin “Ruhul Meanij”, me disa ndryshime në fundin e ajeteve që po komentojmë.

Si përmbledhje, për fatkeqësitë dhe problemet që godasin njeriun, ka qëllime të ndryshme. Hulumtimet rreth tyre janë bërë në çështjet e Njehsimit (Teuhjdit) dhe të drejtësisë së All'Ilahut.

Aftësitë rriten, zhvillohen dhe plotësohen nën presionin e fatkeqësive. Atyre iu bëhet paralajmërimi për sa i përket së ardhmes, zgjimit nga mendjemadhësia, pakujdesia, shlyerjes së mëkatit, etj.

Meqë shumica e punëve të njerëzve kanë natyrë shpërblyese dhe dënuese, kjo është edhe arsyeja se pse ajeti formulohet në formë të përgjithshme.

Për këtë, në një hadith thuhet se, kur pati hyrë Ali ibn Husejni (*Paqja qoftë mbi të!*) tek Jezid ibn Muauije, ky i fundit i tha: “O Ali, nuk ju ka goditur asnjë fatkeqësi, vetëm se për shkak të asaj që keni vepruar me duart tuaja (duke treguar se fatkeqësia e Kerbelasë është rezultat i veprave tuaja)”.

Imami (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj menjëherë: “Kurrë! Fatkeqësia nuk na zbriti neve, por për neve zbriti: **“Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në Tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në shënime (Leuhi mahfudh) para se të ngjajë ajo, e kjo për All'Ilahun është e lehtë. Ashtu që të mos dëshpëroheni tepër për atë që u ka kaluar, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai u ka dhënë.”**¹; ne jemi nga ata që nuk dëshpërohen për gjërat që kemi humbur në këtë dynja, sigurisht që nuk gëzohemi edhe për ato që na janë dhënë.”²

¹ Sure “El Hadid”, ajetet 22, 23.

² Tefsiri i “Ali ibn Ibrahimit”, sipas transmetimit të komentimit të tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 580.

E përfundojmë këtë plotësim me një hadith tjetër nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) kur u pyet rreth komentit të ajetit të mësipërm. Po ashtu atë e pyetën: A e goditën fatkeqësitë e shumta Aliun dhe Ehli Bejtin e tij për shkak të punëve të tyre? Imam Sadiku iu përgjigj: *“Me të vërtetë, i Dërguari i All'llahut pendohej dhe i kërkonte falje All'llahut njëqind herë për çdo ditë dhe natë, pa bërë asnjë gjynah. All'llahu i veçon të dashurit e Tij në fatkeqësi, që t'i shpërblejë me anë të tyre, pa bërë gjynahe.”*¹

3- Disa dyshojnë se qëllimi me fatkeqësitë në këtë ajet është për fatkeqësitë e dynjasë, sepse kjo botë është vendi i veprave dhe jo i shpërblimit.

Ky është një gabim i madh në interpretim, për shkak të ekzistencës së ajeteve dhe transmetimeve të shumta që garantojnë se njeriu, ndonjëherë shikon në botë vetëm njërën anë të rezultatit të veprave të tij. Ndërsa për atë që thuhet se, dynjaja nuk është shtëpia e shpërblimit, se nuk plotësohet në të likuidimi i të gjitha llogarive, nuk do të thotë kurrëse e ka mungesë të shpërblimit. Mohimi i kësaj të vërtete i përngjan mohimit të parimeve themelore të së vërtetës, siç deklarojnë njohësit e koncepteve islame.

4- Ndonjëherë, fatkeqësitë mund të jenë kolektive dhe për shkak të gjynaheve të kolektivit, masës, siç lexojmë në ajetin 41 të sures “Rrum”: **“Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në Tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit, etj.) e për ta përjetuar atë, një pjesë të asaj të keqeje që bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat).”**

¹“Usulul Kafij” sipas transmetimit të tefsirit “Nuruth Thaekalejn”, vëll 4, f. 581.

Kjo ka lidhje me shoqëritë njerëzore, të cilat janë goditur me fatkeqësi për shkak të punëve të tyre të këqija.

Në ajetin 11 të sures "Rra'd" thuhet: **"All'llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre."**

Këto ajete argumentojnë gërshetimin dhe lidhjen e afërt mes punëve të njeriut dhe sistemit të jetës, sepse nëse njerëzit ecin sipas bazave të fesë, rregullave dhe ligjeve të krijimit, atëherë ata do t'i gëzojnë begatitë e All'llahut, ndërsa me çrregullimin, ata shkatërrojnë jetën e tyre.

Ndonjëherë, kjo gjë mund të vërtetohet me specifikën e njerëzve një për një, sepse çdo njeri do të goditet në trupin e tij, në shpirtin e tij, në pasuritë e tij, në lidhjet e tij të tjera për shkak të mëkatit që kryen, siç dhe përmendet në ajetin e mësipërm.¹

Megjithatë, disa mund të mendojnë se mund të arratisen nga ky ligj hyjnor përfundimtar, prandaj edhe ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë thotë: **"Në këtë Tokë ju nuk mund t'i shpëtoni Atij..."**.² As në Qiell. Si mund të largoheni nga fuqia dhe pushtetit i All'llahut, kur e gjithë bota e ekzistencës është në duart e Tij?!

Nëse besoni në ekzistencë, kush do ju përkrahë dhe ndihmojë? Dijeni mirë: **"...sepse, veç All'llahut, nuk ka tjetër mbrojtës apo ndihmës për ju."**

¹ Tefsiri "El Mijzan", vëll. 18, f. 61.

² "Mu'xhazine" vjen nga fjala "i'xhazun", me kuptimin "arratisja", largimi nga oqeani i fuqisë së All'llahut dhe nga dënimi i Tij.

Ndryshimi mes *“el velijju”* dhe *“en nesiru”* mund të jetë se mbrojtës është ai që të sjell dobinë, kurse ndihmës është ai që largon të keqen. Mbrojtës i thuhet atij që të mbron në mënyrë të pavarur, ndërsa ndihmës i thuhet atij që qëndron në krah të njeriut dhe e ndihmon pa reshtur atë.

Ajeti i fundit materializon dobësinë dhe pafuqinë e njeriut të thjeshtë, kurse ajeti që është para tij, materializon drejtësinë e Krijuesit dhe mëshirën e Tij.¹

Hulumtime

I pari: Fatkeqësitë ju ndodhin për shkak të veprave tuaja!

Disa mendojnë se lidhja e veprave të njerëzve me shpërblimin e All'llahut, është njëlloj si marrëveshjet e kësaj dynjaje, me çka ajo përmban prej shpërblimit dhe dënimit.

E thënë ndryshe, shpërblimi dhe dënimi më së shumti janë për shkak të rezultatit natyror, strukturor e formues të punëve të njeriut. Ajetet e mësipërme janë dëshmitarët më të mirë për këtë të vërtetë.

Në lidhje me këtë, ka transmetime të shumta në burimet islame, nga të cilat do të tregojmë disa, me qëllim që ta plotësojmë këtë temë:

¹Tefsiri *“Fi Dhilalil Kur'an”*, vëll. 7, f. 290.

1- Në një nga fjalimet e “Nehxhul Belaga”, thuhet: “Për All’llahun, çdo popull që jetonte i mbuluar me mirësi, ato mirësi iu zhdukën atyre për shkak të mëkateve që bënin, sepse All’llahu nuk është i padrejtë ndaj robëve të Vet. Sikur njerëzit, pas fatkeqësive dhe ikjes së mirësive, të largoheshin prej mëkatëve dhe t’i drejtoheshin Zotit të tyre me qëllim të sinqertë dhe bindje të plotë në zemër, Ai me siguri do t’ua kthente atyre çdo gjë që u ishte larguar dhe do të rregullonte çdo gjë që ka qenë prishur.”.¹

2- Në një thënie tjetër të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), që ndodhet në librin “Xhamiul Akhbar”, thuhet: “Në të vërtetë, fatkeqësia dhe belaja për zullumqarin është edukim, për besimtarët është provë, për Profetët është ngritje në grada, kurse për miqtë e All’llahut, është keramet (mrekulli).”.²

Ky hadith është dëshmia më e qartë për përjashtimet që përmendëm për këtë ajet.

3- Në një thënie të Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), që ndodhet në “Usul El Kafij”, thuhet: “Nëse robit i shtohen gjynahet dhe nuk ka ndonjë punë të mirë që t’ia fshijë ato, atëherë All’llahu e sprovon atë me dëshpërim, me qëllim që t’ia falë.”.³

4- Në librin “Usulul Kafij” ka një kapitull të veçantë për këtë temë, i cili përmban 12 hadithe.⁴

¹“Nehxhul Belaga”, fjalimi 178.

²“BiharulAnuar”, vëll. 881, f. 198.

³“Usulul Kafij”, vëll. 2, kreuel *ijmanuelkufru*, kapitulli: Përshpejtimi I ndëshkimit të mëkatit, hadithi 2.

⁴Burimi I mëparshëm.

I dyti: Dyshim i madh

Disa njerëz mund të dalin në përfundimin e gabuar e të thonë se i duhet dorëzuar çdo ngjarjeje të dëshpëruar. Por kjo nuk është ajo që nënkupton Kur'an.

Kur'an nuk e deklaron asnjëherë dorëzimin ndaj fatkeqësive, mospërpjekjen njerëzore për zgjidhjen e problemeve, apo përkuljen ndaj padrejtësisë, tiranisë dhe sëmundjeve; përkundrazi, ai bën apel se nëse ndodh të të përfshijnë fatkeqësitë, pavarësisht nxitimit dhe përpjekjeve të tua për t'i larguar ato, atëherë dije se ato të fshijnë gjynahet që ke bërë, se duhet të mendosh për veprat e tua të mëparshme, të kërkoksh falje, ta drejtosh veten e të zbulosh pikat e dobësisë tënde.

Ky është një nga ajetet më të parapëlqyera në Kur'an, kjo për shkak të ndikimit të tij edukues. Ai i lehtëson shqetësimet e njeriut dhe rikthen shpresën e dashurinë së Krijuesit në zemrën dhe shpirtin e tij.

I Treti: Cilët janë “As’habu es Suffetu”?

Ata që shkojnë të vizitojnë varrin e Profetit (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në Medine, shohin një vend të ngritur pak nga toka në një cep të xhamisë, në afërsi të varrit të fisnikut. Skajet e tij kanë një formë të bukur, kështu që shumica e zgjedhin këtë vend për të lexuar Kur'an dhe për të falur namazin.

Ky na kujton vendin e quajtur *es suffetu*, të cilin Profeti (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pati

përgatitur për një grup të huajsh, të cilët përqafuan Islamin dhe nuk kishin vend për t'u strehuar, përveç xhamisë.¹

Sqarim

I pari njeri i huaj që përqafoi Islamin, e që nuk kishte vend në Medine ku të strehohej, ishte një i ri nga populli i Pëllumbave, që quhej *Xhuvejbir*. Është e njohur historia e martesës së tij me *edhDhulfau*, që konsiderohet edhe një nga ngjarjet më të bukura të luftës së ndarjeve shtresore në historinë e Islamit.

I Dërguari i All'llahut (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e lejoi atë që të flinte natën në xhami, sepse ai nuk kishte vend për t'u qetësuar dhe banuar. Kur numri i të huajve u shtua, e të gjithë ishin banorë të xhamisë, çka çoi në një situatë të pazakontë për të, i Dërguari dha urdhër që ata të nxirreshin nga xhamia dhe xhamia të pastrohej. Kështu u mbyllën dyert e shtëpive të sahabëve, me urdhrin e të Dërguarit, (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ishin në rrugën kryesore të xhamisë, përveç derës së Aliut dhe Fatimesë (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Këtu, i Dërguari (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), urdhëroi ndërtimin e një vendi të posaçëm me degë palme, për të qenë një vend i sigurt për qëndrimin e të huajve dhe të varfërve. Pastaj, ishte vetë ai që i vizitonte dhe u jepte ujë, hurma, bukë e ushqime të tjera. Më vonë nisi dhe pjesa

¹“Es Suffetun”, njësoj si “Gussetun”, në gjuhë do të thotë *çadër verore e mbuluar me degë palme*.

tjetër e myslimanëve që të interesoheshin dhe t'i ndihmonin ata nëpërmjet zekatit dhe llojeve të tjera të shpenzimit.

Këta morën pjesë në shumë beteja islame, luftuan me trimëri dhe sinqeritet. Kanë zbritur disa ajete kur'anore, që përmendin mirësinë, çiltërsinë dhe pastërtinë e tyre. Ata u quajtën: *as'habu suffeh*, sepse banuan në ato çadra.

Ajetet 32-36

وَمِنْ آيَاتِهِ الْجَوَارِ فِي الْبَحْرِ كَالْأَعْلَامِ ٣٢ إِنَّ يَشَأْ يُسْكِنِ الرِّيحَ
فَيَظْلَلْنَ رَوَاكِدَ عَلَى ظَهْرِهِ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّكُلِّ صَبَّارٍ شَكُورٍ ٣٣
أَوْ يُوبِقْهُمْ بِمَا كَسَبُوا وَيَعْفُ عَنْ كَثِيرٍ ٣٤ وَيَعْلَمَ الَّذِينَ يُجَادِلُونَ فِي
آيَاتِنَا مَا لَهُمْ مِنْ مَّحِيصٍ ٣٥ فَمَا أُوتِيتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَمَتَاعُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا
وَمَا عِنْدَ اللَّهِ خَيْرٌ وَأَبْقَى لِلَّذِينَ آمَنُوا وَعَلَى رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ٣٦

“Një prej shenjave të Tij janë anijet e mëdha që lundrojnë në det – si malet.”

“Nëse Ai do, e qetëson erën dhe ato mbesin të palëvizshme në sipërfaqen e tij (detit). Këtu ka shenja për çdokënd që është i durueshëm dhe mirënjohës.”

“Ose, Ai mund t’i fundosë anijet, për shkak të gjynaheve që kanë bërë ata. Sidoqoftë, Ai fal shumë.”

“Le ta dinë ata që vënë në dyshim shenjat Tona, se nuk kanë ku t’i shmangen dënimit Tonë.”

“Çdo gjë që ju është dhënë juve, është vetëm kënaqësi në jetën e kësaj bote. Por shpërblimi i All’Ilahut është më i mirë dhe më i përhershëm për ata që besojnë dhe mbështeten te Zoti i tyre.”

Komentimi

Fryrja e erërave dhe lëvizja e anijeve

Këto ajete sqarojnë shenjat, argumentet e Krijuesit e të Njehsimit (*Teuhidit*) dhe vazhdojnë komentimin për të cilin kanë folur ajetet e mëparshme në lidhje me këtë.

Këtu flitet në mënyrë të veçantë për udhëtarët e deteve dhe banorët e bregdeteve. Ajeti thotë: **“Një prej shenjave të Tij janë anijet e mëdha që lundrojnë në det – si malet.”**.

Fjala *“xhiuarun”* është shumësi i fjalës *“xharijetun”*, e cila është një cilësim për anijet. Ajeti ka për qëllim lëvizjen e anijeve, prandaj dhe është përdorur kjo cilësi.

“Xharijetun” thuhet për vajzën e re, sepse rinia dhe gjallëria qarkullojnë në damarët dhe ekzistencën e saj.

Fjala *“a’lamun”*, është shumësi i fjalës *“alemun”*, njëlloj si *“kalemin”*, që do të thotë *“mali”*. Vetëm se ajo në rrënjë ka kuptimin *shenjë e dukshme* dhe gjurmë e mbetuar që lajmëron për diçka të caktuar, si për shembull: *alemu tarik*, shenjat e rrugës dhe *alemu xhejsh*, gjurmët e ushtrisë, e të tjera si këto.

Përse është quajtur *mali* me emrin *alemun*? Kjo për shkak se ai duket qartë nga larg, madje ndonjëherë ndiznin zjarre në majën e tyre që të ktheheshin në fanar, ndriçues dhe udhëzues për udhëtarët. Ekzistenca e zjarrit dhe mungesa e tij, nuk kanë ndikuar në emërtim.

Mbi këtë bazë, Kur'ani e konsideron lëvizjen e anijeve gjigande në këtë ajet, si dhe në shumë ajete të tjera, si shkak të fryrjes në mënyrë konstante të erërave, që është një prej argumenteve të Krijuesit.

Nuk është e rëndësishme lëvizja e anijeve të vogla apo e varkave mbi sipërfaqen e ujit për shkak të fryrjes së erërave. E rëndësishme është lëvizja e varkave dhe anijeve gjigande me avull me ngarkesën e madhe dhe udhëtarët e shumë kur fryjnë erërat, duke kaluar mijëra milje që të arrijnë në destinacion.

Kush është Ai që i ka krijuar këto oqeanë me specifikat, ujërat dhe thellësitë e tyre? Kush ia ka dhënë drurit, prej të cilit ndërtohen anijet, karakteristikën e lundrimit mbi sipërfaqen e ujit?

Kush i urdhëron erërat që të fryjnë në një mënyrë aq të rregullt mbi sipërfaqe të deteve e oqeanëve, me qëllim që njeriu të mund të arrijë nga një pikë e globit në një tjetër, duke përfutur pikërisht prej këtyre erërave?

Nëse i shikojmë me kujdes hartat e marinarëve, në mënyrë të veçantë lëvizjen e erërave dhe informacionet që zotëron njeriu rreth fryrjes së tyre nga dy polet drejt Ekuatorit dhe nga Ekuatori drejt dy poleve, rreth fryrjes së tyre të alternuar nga brigjet dhe Toka në drejtim të deteve e anasjelltas, do të kuptojmë se kjo çështje ka një projektues si dhe një rregull të përgjithshëm.

Në kohën tonë, motorët gjigandë bëjnë të mundur lëvizjen e anijeve dhe shtyrjen e tyre përpara, por dhe erërat kanë ndikimin e tyre në këtë lëvizje. Për të përforcuar këtë, ajeti thotë:

“Nëse Ai do, e qetëson erën dhe ato mbesin të palëvizshme në sipërfaqen e tij (detit)...”; si rezultat, ajeti në fund të tij shton: “...Këtu ka shenja për çdokënd që është i durueshëm dhe mirënjohës.”.

Fryrja e erërave dhe lëvizja e anijeve, krijimi i deteve, rregulli i veçantë dhe i harmonizuar që mbizotëron në këto çështje, janë argumente të ndryshme dhe të padiskutueshme të Vetës së Shenjtë.

Fryrja e erërave bëhet për shkak të ndryshimit të nivelit të nxehtësisë midis dy zonave në sipërfaqen e Tokës. Ajri shtrihet, përhapet për shkak të nxehtësisë, lëviz drejt lartësive. Era ushtron presion mbi ajrin që e rrethon anijen dhe e vë në lëvizje atë. Nga ana tjetër ia liron vendin ajrit më të afërt me të, që të lëvizë drejt shtresave të larta. Sikur Krijuesi ta hiqte këtë karakteristikë, pra atributin e zgjatjes dhe shtrirjes prej ajrit, aty do të zotëronte pushimi dhe qetësia vrasëse. Anijet lundruese do të ndalonin në mes të oqeanëve, e nuk do të mund të lëviznin fare.

“*Sabbarun*” dhe “*shekurun*” janë dy forma hiperbolike. Të parës i jep kuptimin e durimit të tepërt, kurse të dytës kuptimin e falënderimit të madh. Këto dy cilësi gjenden edhe në ajete të tjera të Kur'anit.¹

Këto dy cilësi qartësojnë të vërtetën e besimit. Besimtari i devotshëm është shumë durimtar në probleme dhe sprova dhe shumë falënderues në begati, gjë që përmendet në një hadith nga i Dërguari (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

¹ Sure “Ibrahim”, ajeti 5; Sure “Lukman”, ajeti 31; Sure “Sebe”, ajeti 19, si dhe ajeti që po komentojmë.

tij!), ku thuhet: *“Besimi është dy gjysma, një gjysmë është durim, kurse gjysma tjetër është falënderim.”*¹

Kërkimi në sekretet e sistemit të krijimit ka nevojë për durim, vazhdimësi dhe specifikim të kohës së mjaftueshme, ndërsa në anën tjetër meriton të falënderohet denjësisht Begatuesi.

Kur përmbushen këta dy faktorë (durimi dhe falënderimi), njeriu është i aftë për kërkim në këto shenja. Normalisht që kërkimi në sekretet e krijimit është në vetvete një lloj falënderimi.

Pa dyshim që këto dy cilësi trupëzohen më shumë tek njeriu në kohën që hipën në anije, duke bërë durim në përballjen ndaj ngjarjeve dhe problemeve në det dhe së fundmi falënderon kur mbërrin shëndoshë e mirë në breg.

Për njohjen e madhësisë së kësaj mirësie të All’llahut, ajeti që vjen më pas thotë: **“Ose, Ai mund t’i fundosë anijet, për shkak të gjynaheve që kanë bërë ata...”**, domethënë nëse Ai dëshiron i shkatërron këto anije për shkak të veprave të këqija që kanë kryer udhëtarët.

Siç kemi lexuar dhe në ajetet e mëparshme, fatkeqësitë që e godasin njeriun, më së shumti ndodhin për shkak të veprave të tij.

Por, pavarësisht kësaj, mirësia e All’llahut e përfshin njeriun: **“...Sidoqoftë, Ai fal shumë.”**. Sikur të mos ishte falja e Krijuesit, nuk do të shpëtonte asnjë njeri nga dënimi i Tij, përveç të pagabueshmëve, të veçantit dhe të pastërtit, siç e lexojmë në ajetin 45 të sures “Fatir”, që thotë: **“E, sikur All’llahu t’i kapte**

¹ Tefsiri “Es Safij”, tefsiri “Mekhmail Bejan”, vëll. 8, f. 506; tefsiri “El Kebijr” dhe tefsiri “El Kurtubijj”, fundi i ajetit 31 të sures “Lukman”.

njerëzit sipas veprave (të këqija) të tyre, nuk do të linte mbi faqen e dheut asnjë gjallesë, por Ai i afatizon deri në momentin e caktuar.”.

Ai mundet t'i ndalojë erërat që të fryjnë derisa të qëndrojnë anijet pa lëvizur në mes të detrave e oqeanëve, apo t'i shndërrojë këto erëra në shtrëngata ciklonesh, që t'i shkatërrojë këto varka, dhe anijet me avull, por mirësia e Tij, që është e përgjithshme, e ndalon këtë gjë.

“Le ta dinë ata që vënë në dyshim shenjat Tona, se nuk kanë ku t'i shmangen dënimit Tonë.”¹ ata nuk kanë strehim tjetër përveçse te All'llahu i Madhëruar.

Këta njerëz nuk do t'i përfshijë falja e All'llahut, sepse ata e kundërshtuan All'llahun, duke ditur dhe kuptuar, dhe vazhduan në luftimin e Tij nga armiqësia dhe kokëfortësia. Atëherë, këta nuk do t'i përfshijë falja dhe mëshira e Tij dhe nuk ka shpëtim për ta nga dënimi i Tij.

Fjala *“mehijsun”* është marrë nga fjala *“hajsun”*, njëlloj si *“tajfun”*, që do të thotë *kthim mbrapa, shmangie për një çështje*. Përderisa *“mehijsun”* është emër vendi, prandaj ka ardhur kjo fjalë, në kuptimin *vend arratisje apo strehimi*.

¹Fjalja: **“Le ta dinë ata që vënë në dyshim shenjat Tona...”**, siç thotë Zamakhsheri tefsirin e tij *“El Kesh'shaf”*: ka ardhur në rasën kallëzore për shkak të lidhjes së saj me shpjegimin e munguar. Vlerësimi i saj është: do të hakmerret ndaj tyre, kështu që ta dinë ata që kundërshtojnë, sepse qëllimi është që të hakmerret Krijuesi ndaj këtij grupimi. Qëllimi është që ta dinë ata që kundërshtojnë, se nuk kanë rrugë shpëtimi.

Ndërsa në ajetin e fundit, fjala u drejtohet të gjithëve, kur thuhet: **“Çdo gjë që ju është dhënë juve, është vetëm kënaqësi në jetën e kësaj bote...”**.

As mos e mendoni që ajo do t’u mbetet juve, sepse ajo është si shkrepëtima, e cila ndriçon një çast e pastaj zhduket, apo si qiriu kur e fryn era, apo si flluska mbi sipërfaqen e ujit, mirëpo: **“...Por shpërblimi i All’llahut është më i mirë dhe më i përhershëm për ata që besojnë dhe mbështeten te Zoti i tyre.”**.

Nëse mundeni që ta ndërroni kënaqësinë e kësaj bote të përfunduar, të kufizuar, të kotë dhe në qorrsoak, me kënaqësinë e përhershme dhe të pafundme, vetëm atëherë, ajo është tregtia fitimprurëse më e pashembullt.

Mirësitë e kësaj bote nuk mund të jenë kurrësesi të zbrazëta nga problemet sepse gjenden gjemba të përhershmë në anë të luleve dhe dështimet në krah të shpresave, ndërkohë që shpërblimi i All’llahut nuk përmban asnjë lloj bezdisjeje, përkundrazi, ai është i mirë, i kthjellëti dhe i plotësuar.

Në anën tjetër, këto dhurata, sido që të jenë, do të shkatërrohen përfundimisht. Vetëm shpërblimi i Botës Tjetër është i përhershëm e përfundimtar. Por, a pranon logjika që të vetëkënaqet njeriu nga bizneset fitimprurëse, të goditet nga mendjemadhësia dhe hutimi, t’ia marrin mendjen stolitë e kësaj bote?

Për këtë, në ajetin 38 të sures “Teube” lexojmë: **“A mos ishit të kënaqur me jetën e kësaj bote, sesa me atë të Ardhmen? Përjetimi i jetës së kësaj bote ndaj së Ardhmes, nuk është asgjë.”**.

“Jeta e kësaj bote” tregon për jetën e rëndomtë e të ndotur, kështu që është normale, që çdo kënaqësi apo mjet i përfituar në këtë jetë, do të jetë njëlloj me të në vlerë.

Për këtë përmendet një hadith nga i Dërguari, (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ku thuhet: *“Pasha All'llahun, nuk është kjo dynja në krahasim me Ahiretin, vetëm se njësoj sikur të fusë ndonjëri prej jush gishtin e tij në ujë dhe të shohë se me çfarë do të kthehet me vete!”*.¹

Ajo që theksohet në këtë ajet, është se siguria në besim dhe mbështetje për përfitimin e shpërblimit hyjnor, është për ata që i lënë çështjet e tyre në dorë të All'llahut. Qëndrimi i njerëzve që kundërshtojnë argumentet e All'llahut, bëhet për shkak të dashurisë së tyre ndaj kësaj bote, lidhjes së fortë me kënaqësitë e përkohshme, prandaj i ndryshojnë të vërtetat sipas këtij interesi. Ajeti i fundit është i ngjashëm me ajetin që fliste për ata që polemizonin për argumentet e All'llahut.

¹Tefsiri “Ruhul Bejan”, vëll. 3, f. 429; fundi i ajetit 38 i sures “Teube”.

Ajetet 37-40

وَالَّذِينَ يَحْتَنِبُونَ كَبَائِرَ الْإِثْمِ وَالْفَوَاحِشَ وَإِذَا مَا غَضِبُوا هُمْ يَغْفِرُونَ^{٣٧} وَالَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِرَبِّهِمْ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَمْرُهُمْ شُورَى بَيْنَهُمْ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ^{٣٨} وَالَّذِينَ إِذَا أَصَابَهُمُ الْبَغْيُ هُمْ يَنْتَصِرُونَ^{٣٩} وَجَزَاءُ سَيِّئَةٍ سَيِّئَةٌ مِثْلُهَا فَمَنْ عَفَا وَأَصْلَحَ فَأَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ^{٤٠}

“Për ata që shmangen prej gjynaheve të mëdha e të shëmtuarave dhe që, kur i zemëron dikush, falin.”

“Për ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre, e falin namazin rregullisht dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin; për ata që ndajnë lëmoshë prej asaj që u kemi dhënë Ne.”

“Dhe për ata që, kur i godet ndonjë padrejtësi e madhe, ata kërkojnë ndihmë.”

“Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i All’Ilahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët.”

Komentimi

Besimtarët nuk i dorëzohen padrejtësisë

Këto ajete janë vazhdimësi e diskutimit të përmendur në ajetet e mëparshme, që lidhen me veçantinë e shpërblimit të All'llahut për besimtarët e mbështetur fort tek Ai.

Pas përmendjes së besimit dhe mbështetjes (*et teuekul*), që janë të lidhur me zemrën, këto ajete tregojnë për shtatë lloje programesh praktikë për dy cilësitë e mëparshme, qofshin pozitive apo negative, individuale apo shoqërore, materiale apo shpirtërore. Këto programe sqarojnë bazat e shoqërisë së shëndoshë dhe të qeverisë së drejtë e të fortë.

Ajo që tërheq vëmendjen, është se këto ajete kanë zbritur në Mekë, siç dhe duket qartë, në ato ditë kur nuk ishte formuar ende shoqëria islame, e as nuk ekzistonte qeveria islame. Megjithatë, këto ajete kanë dhënë mendimin e vërtetë islam, me këtë specifikë që prej ditës kur i Dërguari i nderuar (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i mësonte dhe edukonte ata për qëllimin përfundimtar, përgatitjen dhe ndërtimin e shoqërisë islame në të ardhmen.

Cilësia e parë fillon me pastrimin. Ajeti thotë se sevapi i madh hyjnor do të jetë shpërblimi i besimtarëve dhe atyre që mbështeten fort tek Zoti: **“Për ata që shmangen prej gjynaheve të mëdha e të shëmtuarave...”**.

Fjala *“kebairun”* është shumësi i *“kebiretun”*, që do të thotë *gjynahe të mëdha*. Por cili është standardi i gjynaheve të mëdha?

Disa e kanë komentuar atë me gjynahet që ka kërcënuar Kur'ani. Në ajetet e tij flitet për ndëshkimin e tyre me zjarr. Këtu përmbledhen gjynahet që e kalojnë kufirin juridik.

Ndërsa disa mendojnë se ato janë treguese të veprave risi dhe ngjalljes së dyshimeve të besimit në mendjen e njerëzve.

Në kuptimin gjuhësor, fjala *“kebiretun”*, do të thotë *gjynahu*, i cili është i madh dhe i rëndësishëm nga këndvështrimi islam. Një prej shenjave të rëndësisë së gjynaheve të mëdha është se ato janë përmendur në Kur'anin e Shenjtë dhe ai që i kryen ato do të ndëshkohet. Në transmetimet e Ehli Bejtit të Profetit (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për komentin e fjalës *“kebairu”* thuhet: *“Janë ato që All'llahu do ta dënojë me zjarr vepruesin e tyre.”*¹

Kështu që, nëse bëhet e qartë rëndësia dhe madhësia e mëkatit në mënyra të tjera, atëherë do të përfshihen në emërtimin: *“kebair”* – *“mëkate të mëdha”*.

Fjala *“feuahish”* është shumësi i fjalës *“fahishetun”*, që do të thotë *punë shumë të shëmtuaramë nam të keq*. Kjo shprehje është përmendur pas fjalës *“kebair”* – *“gjynahe të mëdha”* dhe është përdorur metoda e përmendjes së të veçantës pas të përgjithshmes. Mbi këtë bazë, një nga shenjat e para të besimit dhe mbështetjes, është largimi nga gjynahet e mëdha, sepse nuk ka mundësi që njeriu të pohojë besimin dhe mbështetjen tek Krijuesi, në një kohë kur është i prekur nga lloj-lloj mëkatesh dhe zemra e tij është kthyer në një fole të shejtanit.

¹Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 1, f. 473.

Edhe cilësia e dytë ka natyrë pastruese, dhe është kontrolli i egoizmit kur inatosesh, çka konsiderohet si një nga gjendjet më të ashpra të njeriut. Për këtë, ajeti thotë: “**...dhe që, kur i zemëron dikush, falin.**”; nuk e humbin kontrollin e vetes kur hidhërohen, nuk kryejnë krime në ato raste, për më tepër bëhet pastrimi i zemrave të tyre dhe zemrave të të tjerëve nga smira.

Kjo cilësi nuk reflektohet vetëm se nën hijen e besimit të vërtetë dhe mbështetjes së vullnetshme tek e vërteta.

Për këtë çështje, është e çuditshme që ajeti nuk thotë se: Ata nuk zemërohen, sepse zemërimi është prej natyrës së njeriut. Ka raste kur zemërimi është i detyruar, në mënyrë të veçantë kur zemërimi është për All'llahun dhe në rrugën e vërtetimit të së vërtetës. Përkundrazi, ajeti thotë: Në të vërtetë, ata nuk e ndotin veten e tyre me gjynah kur zemërohen, dhe kur me shumë butësi falin dhe tolerojnë, sepse të tillë duhet të jenë. Përndryshe, si mund të presë njeriu faljen e All'llahut, në kohën kur thellësitë e shpirtit të tij janë të mbushura me smirë dhe dashuri për hakmarrje? Kur ai nuk njihet asnjë ligj kur zemërohet?

Nëse këtu vëmë re përforcim të zemërimit, kjo ndodh për shkak se kjo gjendje është si zjarri përvëlues, i cili merr flakë në brendësi të thellësive të njeriut. Ka shumë prej tyre që nuk mund ta frenojnë veten gjatë kësaj gjendjeje. Vetëm besimtarët e vërtetë dhe të devotshëm nuk ia dorëzojnë kurrë veten verbërisë së zemërimit dhe urrejtjes.

Në një hadith të Imam Bakir (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Kush e frenon veten e tij kur të dëshirojë diçka, kur të tmerrohet dhe kur të zemërohet, All’llahu e ka ndaluar që ta çojë trupin e tij në zjarr.”¹

Ajeti tjetër tregon për cilësinë e tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë, kur thotë:

- “Për ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre...”
- “...e falin namazin rregullisht...”
- “...dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin...”
- “...për ata që ndajnë lëmoshë prej asaj që u kemi dhënë Ne.”

Ajeti i mëparshëm foli për pastrimin e shpirtit nga mëkatet dhe kapërcimin e zemërimit, ndërsa ajeti që po komentojmë, flet për ndërtimin e *nefsit* në aspekte të ndryshme, ku më e rëndësishmja ndër to, është përgjigjja e thirrjes së Krijuesit nga ana e njerëzve dhe dorëzimi i tyre para urdhëresave të Tij. E gjithë mirësia gjendet në këtë çështje. Ata dorëzohen plotësisht, me gjithë ekzistencën e tyre urdhëresave të All’llahut, dhe nuk dëshirojnë tjetër gjë veçse kënaqësisë së Tij. E kështu duhet të jetë, sepse dorëzimi dhe përgjigja e thirrjes janë dy çështje të patjetërsueshme pas pastrimit të zemrës prej gjurmëve të mëkateve, të cilët pengojnë rrugëtimin drejt të vërtetës.

Ajeti shtjellon disa tema të rëndësishme, në mënyrë të veçantë, namazin, që është dhe shtylla e fesë, lidhja mes krijesave

¹ Tefsiri i “Ali ibn Ibrahimit”, sipas transmetimit të tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 583.

dhe Krijuesit, edukuesi i egove, ngjitja lart e besimtarit, duke ndaluar veprat e këqija dhe të urryerën.

Më pas, ajeti tregon çështjen më të rëndësishme të shoqërisë, që është “*këshillimi*”. Pa të, të gjitha punët mbeten të mangëta. Njeriu i vetëm, sado i fortë dhe largpamës qoftë mendërisht, problemet i shikon ndryshe nga një ose dy këndvështrime të tjera. Në këshillimin rreth çështjeve, mendjet dhe përvojat e ndryshme ndihmojnë njëra-tjetrën. Në këtë rast, çështjet bëhen më të qarta, pakësohen gabimet, mangësitë dhe sigurisht edhe shmangiet.

Prandaj, në një hadith të të Dërguarit (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thuhet: “*Nuk ka njeri që këshillohet nga një tjetër, vetëm se është i udhëzuar në të vërtetën.*”.

Të tërheq vëmendjen fakti, se shprehja është thënë në formën e një programi të vazhdueshëm për besimtarët, jo vetëm në një punë të vetme e të përkufizuar në kohë; përkundrazi, është i nevojshëm këshillimi në të gjitha punët. Duket si e pazakontë, që i Dërguari (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), këshillohej me ndjekësit dhe ndihmësit e tij për çështje të rëndësishme shoqërore dhe ekzekutive, probleme të paqes, luftës dhe çështje të tjera, pavarësisht kompletimit të lartë mendor dhe lidhjes së tij me burimin e frymëzimit. Nganjëherë ai këshillohej me shokët e tij, pavarësisht problemeve që haste për shkak të atij këshillimi. Ai vepronte kështu me qëllim që të ishte shembull dhe model për njerëzit, ngaqë begatitë e këshillimit janë shumë më të mëdha sesa dëmet e tij.

Në fund të ajetit 159 të sures “Ali Imran”, ka disa analiza që vlerësojnë këshillimin, kushtet e tij, përshkrimet e atyre që duhet të këshillojnë si dhe përgjegjësinë e këshilluesve:

a) Këshillimi është i veçantë për punët ekzekutuese dhe për njohjen e tematikës dhe jo për njohjen e ligjeve e dispozitave, sepse ato duhet të merren nga burimi i frymëzimit, nga Libri i Kur’anit dhe Syneti. Shprehja *emruhum* nënkupton se ligjet nuk janë prej çështjeve të njeriut, por prej çështjeve të Krijuesit.

Nuk ka bazë ajo që thonë disa komentues si Alusij, se konsultimi (*shura*), gjithashtu, përfshin edhe ligjet, ndërkohë që nuk ka një tekst specifik për këtë gjë, sidomos për ne që besojmë në mosekzistencën e çdo lloj çështjeje në Islam, se nuk ka një tekst të përgjithshëm apo specifik për të, përndryshe, çfarë dobie ka shprehja: **“Sot ua plotësova fenë tuaj.”**¹? Duhet të studiohen analizat rreth këtij kuptimi në librat e Bazave të Fikhut, (*Jurisprudencës*), sidomos pavlefshmëria e ixhtihadit në kuptimin e ligjvënies në Islam.

b) Disa komentues pohojnë se zbritja e shprehjes: **“...dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin...”**, është specifike për ensarët, për faktin se punët e tyre para Islamit ishin sipas konsultimit; pra, kjo është dëshmi e shoqërisë së ensarëve, të cilët besuan para hixhretit, emigrimit të Profetit (*Paqja e bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i dhanë atij fjalën në Akaba, dhe e ftuan në Medine. Kjo sure është mekase dhe ajetet e lartpërmendura kanë zbritur në Mekë, siç dhe duket qartë.

¹ Sure “Maide”, ajeti 3.

Sido që të jetë, ajeti nuk veçohet për shkak të zbritjes së tij; përkundrazi, ai qartëson një program gjithëpërfshirës.

E mbyllim këtë argument me një hadith të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ku vlerësohet këshillimi. Në të thuhet: *“Nuk ka shembull më të mirë sesa këshillimi. Këshillimi është syri i udhëzimit.”*¹

Cilësia e fundit e këtij ajeti nuk flet vetëm për shpenzimin e pasurisë, por për shpenzimin e gjithçkaje që ka dhënë Krijuesi prej begatisë, logjikës, zgjuarsisë dhe përvojës, me pak fjalë: *shpenzimi në çdo gjë*.

Ajeti që veçon cilësinë e shtatë të besimtarëve të vërtetë dhe të devotshëm, thotë: **“Dhe për ata që, kur i godet ndonjë padrejtësi e madhe, ata kërkojnë ndihmë.”**, domethënë se kur ata përballen me padrejtësinë, nuk i dorëzohen asaj; por, kërkojnë ndihmë nga të tjerët.

Është e qartë se të tjerët janë të detyruar që të ndihmojnë kundër padrejtësisë, se kërkimi i ndihmës pa marrë ndihmë konsiderohet i pakuptimtë, gabim, dhe nuk ka dobi në të. Ai, të cilit i është bërë padrejtësi, është i detyruar t'i bëjë ballë zullumqarit dhe të kërkojë ndihmë. Besimtarët janë të detyruar që t'i përgjigjen atij, siç thuhet në ajetin 72 të sures “Enfal”, në të cilën lexojmë: **“E nëse ata kërkojnë ndihmë prej jush për çështjen e fesë, atëherë jeni të detyruar që t'i ndihmoni.”**

Ky program ndërtues dhe pozitiv, i paralajmëron zullumqarët për pasojën e padrejtësisë ndaj besimtarëve, kur ata nuk e ndalojnë padrejtësinë dhe qëndrojnë me pozitë

¹“Uesailu Shia”, vëll. 8, f. 425, kapitulli 21 nga kapitulli “Ahkamul ishreti”.

zullumqare. Gjithashtu, ai u jep shpresë të shtypurve, që të tjerët do t'i ndihmojnë sa herë që t'u kërkojnë ndihmë.

Fjala *"jentesirune"* vjen nga fjala *"intisarun"*, që do të thotë *kërkimi i ndihmës*. Disa dijetarë e kanë komentuar me kuptimin *"tenasurun"*, megjithatë rezultati mbetet i njëjtë.

Në çdo situatë, çdo i shtypur, nëse nuk mundet të qëndrojë përballë zullumit i vetëm, nuk duhet të heshtë; përkundrazi, ai duhet të përfitojë nga fuqitë e të tjerëve dhe të qëndrojë fort ballë për ballë padrejtësisë. Përgjegjësia e myslimanëve është që t'i përgjigjen thirrjes së shokut për ndihmë.

Mirëpo, kërkimi i ndihmës nuk duhet të dalë prej kufirit të drejtësisë dhe të përfundojë në hakmarrje, dashakeqësi dhe kapërcim të kufirit, prandaj ajeti që vjen pas tij, e kushtëzon atë me thënien: **"Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe..."**.

Nuk duhet ta tejkaloni masën duke nxitur rënien në padrejtësi ndaj vëllezërve tuaj, që pastaj të shndërroheni në njerëz zullumqarë, sidomos të kundërpërgjigjeni me tejkallim në padrejtësi.

Puna e zullumqarit duhet të emërtohet me *"sejjietun"* – *"e keqe"*, vetëm se shpërblimi dhe dënimi i tij nuk është *"sejjietun"* – *"i keq"*. Shohim se ajeti e ka vlerësuar atë si të keqe, për shkak të antonimeve të shprehjeve dhe përdorimit të argumenteve, se zullumqari e konsideron të keqe ngaqë do të dënohet, se përdorimi i shprehjes *"e keqe"* vjen ngaqë dënimi është i ashpër dhe i dhimbshëm. Dhimbja dhe dëmi në vetvete janë të këqija,

pavarësisht se dënimi i zullumqarit dhe ndëshkimi i tij konsiderohet në vetvete, një punë shumë e mirë.

Kjo i ngjason shprehjes që përmendet në ajetin 194 të sures “El Bekare”, ku thuhet: **“Pra, kush ju sulmon ju, kthejini sulmin atij edhe ju, po në atë masë dhe kini frikë nga All’llahu.”**.

Sido që të jetë, kjo shprehje ka mundësi të jetë paraprirëse e faljes, që përmendet në fjalinë që vjen pas saj. Duket sikur ajeti dëshiron të thotë: dënimi, sido që të jetë, është një lloj dhimbjeje, dhe nëse njeriu pendohet te kjo, ai e meriton faljen.

Prandaj, ju duhet të falni, sepse: **“...Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i All’llahut...”**.

Është e vërtetë se njeriu që i bëhet padrejtësi, e ka humbur të drejtën e tij dhe nuk përfiton asgjë në pamje të parë. Por për shkak të faljes së tij, që konsiderohet dhe baza e harmonisë së shoqërisë dhe pastrimit nga armiqësitë, shtimit të lidhjeve të dashurisë, zhdukjes së hakmarrjes dhe stabilizimit shoqëror, Krijuesi ka premtuar t’i japë nga mirësitë e Tij të gjera. Eh, çfarë shprehje e ëmbël (nga ana e All’llahut), ku në të vërtetë Krijuesi e konsideron veten e Tij borxhli ndaj këtyre njerëzve dhe thotë se shpërblimi i tyre është tek Unë.

Në fundin e këtij ajeti lexojmë: **“...Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët.”**.

Kjo fjali mund të jetë treguese për disa shënime:

Së pari: Ka mundësi që të jetë falje, se njeriu ndonjëherë nuk mundet ta kontrollojë plotësisht veten e tij kur dënohet; ai

mundet që ta tejkalojë kufirin dhe të bëhet prej njerëzve zullumqarë.

Së dyti: Kjo falje nuk është me kuptimin e mbrojtjes së zullumqarëve, sepse vërtetë All'llahu nuk i do zullumqarët; përkundrazi, qëllimi është udhëzimi i të humburve dhe forcimi i lidhjeve shoqërore.

Së treti: S'ka dyshim se ata që e meritojnë faljen, janë ata që ndalojnë së bëri padrejtësi, pendohen për çka kanë bërë në të shkuarën dhe nisin të përmirësojnë veten e tyre, dhe jo zullumqarët, të cilët e shtojnë guximin nëpërmjet kësaj faljeje.

E thënë ndryshe, cilido lloj prej faljes dhe dënimit ka pozicionin e tij të veçantë. Për sa i përket faljes, ajo bëhet kur njeriu ka mundësi të hakmerret. Kjo quhet falja ndërtuese, sepse i jep atij që i është bërë padrejtësi, fitoren përballë kontrollit të vetvetes dhe pastrimit të shpirtit, por njëkohësisht e nxit zullumqarin e mundur që të ndreqë veten e shpërdoruar.

Dënimi, hakmarrja, kthimi i tyre me të njëjtën monedhë, ndodhin kur zullumqari vazhdon në padrejtësinë dhe në humbjen e tij. Ai, të cilit i është bërë padrejtësi, ende nuk ka forcuar bazat e kontrollit të tij. Falja këtu është në pozitën e dobët, prandaj duhet të kthehet me të njëjtën monedhë.

Në një hadith të përmendur nga i Dërguari më i nderuar (*Paqja e bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thuhet: “Kur të bëhet Dita e Kiametit, del një thirrës dhe thërret: ‘Ai që e ka shpërblimin e tij tek All'llahu, le të hyjë në Xhennet.’”. Thuhet:

*“Po kush janë ata që e kanë shpërblimin e tyre tek All’llahu?” Thotë:
“Ata që kanë falur njerëzit. Ata hyjnë në Xhennet pa asnjë llogari.”¹*

Ky hadith është rezultat i frymëzuar nga ajeti i fundit në këtë komentim, prandaj themi që ky është Islami i vërtetë, origjinali.

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 52; fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Ajetet 41- 43

وَلَمَنِ انْتَصَرَ بَعْدَ ظُلْمِهِ فَأُولَٰئِكَ مَا عَلَيْهِمْ مِنْ سَبِيلٍ ۚ إِنَّمَا السَّبِيلُ
عَلَى الَّذِينَ يَظْلِمُونَ النَّاسَ وَيَبْغُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ أُولَٰئِكَ
لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ۚ وَلَمَنِ صَبَرَ وَغَفَرَ إِنَّ ذَلِكَ لَمِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ ۝

“Për atë që përgjigjet, kur i është bërë një padrejtësi, nuk ka kurrfarë qortimi ndaj tij.”

“Qortim ka vetëm kundër atyre që u bëjnë padrejtësi njerëzve dhe që pa të drejtë mbjellin ngatërresa në Tokë; për ata ka dënim të dhembshëm.”

“Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme.”

Komentimi

Padrejtësia dhe ndihma

Këto ajete vlerësohen si përforcues, qartësues dhe plotësues të ajeteve të mëparshme për dhënien e ndihmës, dënimit të zullumqarëve dhe faljes në vendin e përshtatshëm. Dënimi i zullumqarit dhe hakmarrja ndaj tij është e drejta e atij, të cilit i është bërë padrejtësi. Askush nuk mund ta ndalojë atë nga e drejta që i takon. Nëse ndodh që i shtypuri të ketë kontroll ndaj zullumqarit dhe të fitojë kundër tij, e në këtë rast ai duron dhe nuk hakmerret, pa dyshim që kjo vlerësohet si një mirësi shumë e madhe.

Në fillim ajeti thotë: **“Për atë që përgjigjet, kur i është bërë një padrejtësi, nuk ka kurrfarë qortimi ndaj tij.”**, kështu që, askush nuk ka të drejtë ta ndalojë për këtë punë, se nuk e fajëson njeri, nuk e qortojnë, nuk e dënojnë. Ai nuk plogështohet në ndihmën e të shtypurve të tillë, sepse dhënia dhe kërkimi i ndihmës janë prej të drejtave normale për çdo viktimë të padrejtësisë. Dhënia e ndihmës ndaj të shtypurve është përgjegjësi e çdo njeriu të lirë dhe të ndërgjegjshëm.

“Qortim ka vetëm kundër atyre që u bëjnë padrejtësi njerëzve dhe që pa të drejtë mbjellin ngatërresa në Tokë...”, duke shtuar edhe dënimin e kësaj bote **“...për ata ka dënim të dhembshëm.”**, të cilët i pret në Ahiret.

Disa komentues shohin ndryshim mes fjalisë, **“u bëjnë padrejtësi njerëzve”** dhe fjalisë **“mbjellin ngatërresa në Tokë”**.

Fjalja e parë dëshmon padrejtësinë, kurse e dyta mendjemadhësinë.¹

Disa dijetarë të tjerë e kanë konsideruar fjalinë e parë treguese të padrejtësisë, kurse të dytën, treguese të kundërshtimit të qeverisë islame.

Fjala “*bag’jun*” në rrënjë ka kuptimin *përpjekje* dhe *mundim* për të arritur marrjen e diçkaje. Më së shumti, me këtë emër emërtohen përpjekjet për të marrë me forcë të drejtat e të tjerëve dhe kalimin e kufijve dhe të drejtave të Krijuesit.

Shprehja “*bi gajril hakk*” – “*pa të drejtë*”, e përforcon më tej këtë kuptim.

Ajeti i fundit tregon edhe një herë tjetër për durimin dhe faljen. Ai siguron se hakmarrja, dënimi dhe ndëshkimi nga zullumqari nuk e pengojnë viktimën që të falë: **“Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme.”**²

Fjala “*el azmu*” në rrënjë ka kuptimin e *të qenit i vendosur në kryerjen e një pune të caktuar*, por ka edhe kuptimin e dëshirës së fortë. Mund të jetë shprehja *azmul umur* që do të thotë *virtyti më i lartë*, tregues i asaj që kjo punë është prej punëve që ka urdhëruar All’llahu të bëhen, që nuk mund të kopjohet, se ajo është nga punët për të cilat njeriu duhet të forcojë virtytin e tij.

¹Tefsiri “El Kesh’shaf”, tefsiri “Ruhul Meanij” dhe tefsiri “Ruhul Bejan”, fundi i ajetit në fjalë.

² Shkronja *Lam* tek “*limen sabere*” është lami i betimit, kurse tek “*lemin azmil umur*” është përforcuese. Që të dyja qartësojnë rëndësinë e kësaj çështjeje hyjnore, siç është falja.

Ajo që tërheq vëmendjen, është përmendja e fjalës *durim* para fjalës *falje*, sepse me mungesën e durimit nuk mund të arrihet kurrë falja dhe toleranca. Njeriu e humb kontrollin ndaj vetes e përpiqet të hakmerret sido që të jetë.

Falja dhe toleranca duhet të përdoren në situatën e fuqisë dhe mundësisë për të bërë padrejtësi. Shprehja **“këto janë nga veprimet më të virtytshme”** mund të jetë për ta përforcuar këtë kuptim, se këmbëngulja rreth diçkaje të caktuar ndodh kur njeriu është i aftë, ka mundësi ta bëjë atë gjë.

Disa dijetarë i kanë komentuar ajetet e mësipërme me revolucionin e Imam Mehdiut (*All'llahu ia shpejtoftë ardhjen!*), me hakmarrjen dhe me fitoren e tij ndaj zullumqarëve, si dhe atyre që bëjnë çrregullime në Tokë. Siç e kemi thënë disa herë më parë, shembuj të tillë komentesh janë një formë sqarimi dhe konfirmimi. Natyrisht, nuk e pengon asgjë që ajeti të jetë në kuptim gjithëpërfshirës.¹

¹Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 585, marrë nga tefsiri i “Ali ibn Ibrahimit”.

Ajetet 44 – 46

وَمَنْ يُضْلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ وَلِيٍّ مِنْ بَعْدِهِ وَتَرَى الظَّالِمِينَ لَمَّا رَأَوْا
 الْعَذَابَ يَقُولُونَ هَلْ إِلَى مَرَدٍّ مِنْ سَبِيلٍ؛ وَتَرَاهُمْ يُعْرَضُونَ عَلَيْهَا
 خَاشِعِينَ مِنَ الدَّلِّ يَنْظُرُونَ مِنْ طَرْفٍ خَفِيٍّ وَقَالَ الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّ
 الْخَاسِرِينَ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنْفُسَهُمْ وَأَهْلِيهِمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَلَا إِنَّ
 الظَّالِمِينَ فِي عَذَابٍ مُقِيمٍ؛ وَمَا كَانَ لَهُمْ مِنْ أَوْلِيَاءَ يَنْصُرُونَهُمْ مِنْ
 دُونِ اللَّهِ وَمَنْ يُضْلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ سَبِيلٍ؛

“Për atë që All’llahu e shpie në humbje, nuk ka mbrojtës tjetër përveç Tij. Ti do të shohësh se si keqbërësit, kur ta shohin dënimin, do të thonë: ‘A ka ndonjë rrugë për t’u kthyer?’”

“Ti do t’i shohësh se si do të përballen me zjarrin të përulur nga poshtërimi dhe duke parë tinëzisht me bisht të syrit. Ata që kanë besuar do të thonë: ‘Me të vërtetë që humbësit janë ata që kanë humbur vetveten dhe familjen e tyre në Ditën e Kiametit’. Me të vërtetë, të padrejtët do të vuajnë një dënim të përhershëm.”

“Ata nuk do të kenë asnjë mbrojtës që do t’i ndihmojë, në vend All’llahut. Për atë që All’llahu e shpie në humbje, s’ka kurrfarë rruge (shpëtimi).”

Komentimi

A ka ndonjë rrugë për kthim mbrapa?

Ajetet e mësipërme folën për zullumqarët, kurse ajetet që kemi në diskutim tregojnë për dënimin e këtij grupimi.

Pasi i konsideron ata prej të humburve, të cilët nuk ka kush t'i mbrojë, ajeti thotë: **“Për atë që All'llahu e shpie në humbje, nuk ka mbrojtës tjetër përveç Tij....”**.

Njohësit e shprehjeve kur'anore sa i përket udhëzimit dhe humbjes, e dinë mirë se nuk ka udhëzim e as humbje të detyruar dhe fataliste. Këta elementë janë rrjedhim i drejtpërdrejtë nga veprat e njerëzve, të mira apo të këqija qofshin. Nganjëherë ndodh që njeriu të bëjë një punë të keqe dhe për shkak të asaj pune Krijuesi ia zhvesh atij suksesin, ia mbyll zemrën, ia ndalon dritën e udhëzimit dhe e lë atë të notojë në errësira.

Kjo është vetë zgjedhja dhe liria. Sikur një njeri këmbëngul në pirjen e alkoolit, e më pas goditet nga lloje të ndryshme sëmundjesh, atëherë, është ai vetë që e sjell këtë situatë dhe këto sëmundje për veten e tij. Krijuesi është shkaktuesi i shkaqeve, ndikon te gjërat, për këtë shkak, nganjëherë, rezultatet lidhen me Të.¹

Ky është një nga ato dënime të shumta e të dhimbshme që u përket mizorëve. Pastaj ajeti shton: **“Ti do të shohësh se si**

¹Ka një shpjegim të hollësishëm në lidhje me këtë në ajetin 36 të sures “Zumer”, ku kemi shtjelluar qartë të gjitha dukuritë e kësaj gjendjeje.

keqbërësit, kur ta shohin dënimin, do të thonë: ‘A ka ndonjë rrugë për t’u kthyer?’”.

Kur’ani i Shenjtë flet disa herë për kërkesën e jobesimtarëve dhe mizorëve për rikthimin në dynja, madje ndonjëherë në prag të vdekjes, si në ajetet 99, 100 të sures “Mu’minun”: **“E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: ‘O Zoti im, më kthe!’, që të bëj vepra të mira e të kompesoj atë që kam lëshuar.”**.

Ditën e Kiametit, kur t’i afrohen shumë afër zjarrit, siç thotë ajeti 27 i sures “En’am”: **“...E t’i shihje ata kur janë ndalur pranë zjarrit dhe thonë: ‘Ah sikur të ktheheshim (në dynja), të mos gënjejme faktet e Zotit tonë e të bëhemi nga besimtarët!’”**.

Mirëpo, sido të jenë kërkesat e tyre, ato do të refuzohen, sepse kthimi mbrapa është krejtësisht i pamundur, se ky është ligj i All’lilahun, i cili nuk pranon ndryshim, se ashtu si njeriu nuk mund të kthehet nga pleqëria në rini, apo nga rinia në fëmijëri, më tej akoma, nga fëmijëria në botën e embrionit, gjë që është e pamundur, ashtu dhe kthimi mbrapa apo rikthimi në dynja nga bota e *Barzakhut*, e Ndërmjetme, apo *Ahireti*, është i pamundur.

Ajeti tjetër përmend dënimin e tretë për këtë grupim, kur thotë: **“Ti do t’i shohësh se si do të përballen me zjarrin të përulur nga poshtërimi dhe duke parë tinëzisht me bisht të syrit...”**.¹

¹Fjala “tarefun” me sukunin e shkronjës “ra”, është paskajore, që do të thotë rrotullimi i syrit, shikim me bisht të syrit. Do të thotë lëvizje vetëm e syrit. Kurse përemri tek “alejha”, i referohet dënimit. Vërtet, dënimi këtu nënkupton zjarrin dhe *Xhelmemin*.

Tmerri dhe frika e madhe do të kontrollojë qenien e tyre, poshtërimi dhe dorëzimi zotërojnë mbi ta. Merr fund çdo gjë prej mendjemadhësisë dhe luftës, padrejtësisë dhe dëmtimit të viktimave. Atyre nuk u mbetet tjetër, veçse të shikojnë me bisht të syrit zjarrin përvëlues.

Kjo është kronologjia e situatës së një njeriu që i frikësohet diçkaje, nga një frikë e madhe të cilën nuk dëshiron ta shikojë me sytë hapur, por njëkohësisht as nuk mund ta shmangë atë, prandaj edhe është i detyruar të shikojë drejt saj, por me bisht të syrit.

Disa komentues kanë thënë se fjalët **“me bisht të syrit”** kanë kuptimin e shikimit me sy gjysmë të hapur, ngaqë nuk mund t'i hapin ato plotësisht, prej frikës dhe tmerrit të madh, nga tronditja prishamendëse dhe pafuqia, kështu që nuk i hapin sytë për të mos e parë gjëmën që i pret.

Kur gjendja e njeriut është e tillë para se të hyjë në zjarr, atëherë çfarë do të ndodhë me të, kur të futet i gjallë në të dhe të përcëllohet në thellësitë e tij?!

Fundit i dënimit thekson se është dëgjimi i fajësimit dhe qortimit të ashpër nga besimtarët, siç vjen në fund të ajetit: **“...Ata që kanë besuar do të thonë: ‘Me të vërtetë që humbësit janë ata që kanë humbur vetveten dhe familjen e tyre në Ditën e Kiametit...’”**.

A ka humbje më të madhe sesa njeriu të humbasë veten e tij, pastaj gruan, fëmijët dhe të afërmit e tij? Rezultati mbetet zjarri ndarës, i cili është thelbi i dënimit të All'Ilahut.

Pastaj, ajeti shton: O populli i Mahsherit: **“...Me të vërtetë, të padrejtët do të vuajnë një dënim të përhershëm.”**.

Në të vërtetë, ky është dënimi që nuk ka shpresë të përfundojë, kështu që nuk kufizohet me një kohë të caktuar.

Nëpërmjet këtij dënimi, gjynahqari digjet nga thellësitë e shpirtit, deri në pjesët e jashtme të trupit, pa dallim.

Ka shumë mundësi që formuluesit e kësaj fjale të jenë besimtarët e vërtetë, vetë Profetët dhe evlijatë e All’llahut, ndjekësit e tyre të veçantë, të cilët janë të pastër nga gjynahet; ata, të cilëve u është bërë padrejtësi dhe janë dëmtuar shumë prej këtyre mizorëve. Është e drejta e tyre që të flasin kështu në atë ditë, gjë që e kanë treguar edhe transmetimet e familjarëve të Profetit (*Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), po me këtë kuptim.¹

Është e domsdoshme të themi për këtë çështje se dënim i përjetshëm për këta të padrejtë në fakt nënkupton se ata janë jobesimtarë, siç është përmendur në disa ajete kur’anore: **“Jobesimtarët janë të padrejtë.”**².

Ajeti që vjen pas tij e dëshmon këtë të vërtetë, kur thotë: **“Ata nuk do të kenë asnjë mbrojtës që do t’i ndihmojë, në vend All’llahut...”**.

Ata i kanë prerë urat e lidhjes së tyre me robtë e sinqertë dhe Pejgamberët, prandaj nuk do të kenë asnjë mbrojtës apo ndihmës atë ditë. Efekti i fuqive materiale që ato zotërojnë, do të

¹Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 586 nga tefsiri i “Ali ibn Ibrahimit”.

² Sure “El Bekare”, ajeti 254.

shterojë atë ditë, prandaj do ta përballojnë dënimin hyjnor të vetëm, fillikat.

Për ta përforcuar këtë koncept, në fundin e tij, ajeti pohon:
“...Për atë që All’llahu e shpie në humbje, s’ka kurrfarë ruge (shpëtimi).”.

Ndërsa në ajetin e parë prej ajeteve në fjalë: **“Për atë që All’llahu e shpie në humbje, nuk ka mbrojtës tjetër përveç Tij...”**.

Në ajetin më lart u mohohet mbrojtja, kurse këtu u ndalohet rrugëdalja. Kjo për shkak të arritjes së qëllimit. Që të kenë një rrugë, ata duhet të gjejnë një argument, por këta të humbur janë të ndaluar, të mohuar, prej kësaj dhe asaj.

“I All’lلاهut është pushteti mbi qiejt dhe Tokën. Ai krijon çfarë të dojë. Ai i dhuron vajza kujt të dojë e djem kujt të dojë.”

“Disave u dhuron të dyja gjinitë: djem e vajza; e, kë të dojë e lë pa fëmijë. Vërtet, Ai është i Gjithëdijshtëm dhe i Fuqishëm.”

Komentimi

Fëmijët janë dhuratë e Mëshiruesit

Në ajetet e mësipërme u përmend një anë e dënimit të dhimbshëm dhe të ashpër për jobesimtarët dhe mizorët, ndërsa në këto ajete paralajmërohen të gjithë njerëzit që të ruhen nga ky përfundim i tmerrshëm dhe i fton ata që t’i përgjigjen ftesës së Krijuesit, që të kthehen në Rrugën e Drejtë dhe të devotshmërisë.

Ajeti i parë thotë: **“Përgjigjuni thirrjes së Zotit tuaj, para se të vijë Dita, të cilën All’lلاhu nuk e kthen më....”**.

Nëse ju përfytyroni ekzistencën e ndonjë strehe tjetër përveç mirësisë së Tij, se dikush mund t’u ndihmojë, përveç mëshirës së Tij, ta dini mirë se jeni në gabim: **“...Atë Ditë ju nuk do të keni kurrfarë strehimi dhe nuk do të mund të mohoni.”**

Shprehja: **“...Dita, të cilën All’lلاhu nuk e kthen më....”**, dëshmon për Ditën e Kiametit dhe jo ditën e vdekjes, ashtu

sikurse shprehja: *min All'llah - nga All'llahu*, tregon se askush nuk mund të marrë vendim për t'u kthyer përballë urdhrut të Krijuesit të Plotfuqishëm.

Sido që të jetë, të gjitha rrugët që besohet se mund ta ndihmojnë njeriun prej dënimit të All'llahut, janë të mbyllura atë ditë. Njëra prej tyre është rikthimi në botën e dynjasë, falja e mëkateve dhe gabimeve.

Ndërsa tjetra është ekzistenca e një strehe në të cilën njeriu është i sigurtë kur strehohet në të.

E fundit, është prania e dikujt që e mbron njeriun.

Ajeti i mësipërm, i mohon këto rrugë.

Disa e kanë komentuar fjalinë: **"...dhe nuk do të mund të mohoni..."**, në kuptimin se ju nuk mund të mohoni mëkatet tuaja atje, sepse argumentet dhe dëshmitarët janë të shumtë, saqë nuk ka vend për mohimin e tyre. Kuptimi i parë është më i parapëlqyer.

Ajeti që vjen pas tij, i flet të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e këshillon atë duke i thënë: **"Nëse ata kthejnë kurrizin, dije se Ne nuk të kemi dërguar ty, si rojë për ata..."**, mos u brengos për ta, sepse ti nuk je përgjegjës për ruajtjen e tyre nga shmangia e devijimi.

"...Detyra jote është vetëm që të kumtosh...", njëlloj është si e pranuan apo nuk e pranuan atë, komunikimin tonë.

Ti vetëm duhet të përcjellësh Mesazhin e All'llahut në mënyrën më të mirë dhe të plotësosh argumentin kundër tyre,

ndërsa zemrat e përgatitura do ta pranojnë atë, pavarësisht se shumica e injorantëve do ta kundërshtojnë, por ti nuk je përgjegjës për ta.

Diçka që i ngjason këtij kuptimi është përmendur në fillim të sures, në Fjalën e All'llahut të Madhëruar: **"Ti (o i Dërguar) nuk je përgjegjës ndaj tyre."**¹

Ajeti përshkruan në mënyrë të plotë, gati-gati fotografike, situatën e këtij grupi jobesimtarësh dhe kundërshtarësh të së vërtetës, teksa thotë: **"...Kur Ne i japim njeriut të shijojë mëshirën Tonë, Ai i gëzohet asaj...."**dhe harron, hutohet në përmendjen e Krijuesit: **"...Por, nëse atë e godet ndonjë e keqe për shkak të asaj që kanë bërë duart e tij, atëherë, ai bëhet mosmirënjohës i vërtetë."**

As mirësitë e All'llahut dhe as falënderimi i Begatuesit nuk e zgjojnë këtë njeri, nuk e tërheqin drejt falënderimit, njohjes dhe bindjes. As ndëshkimet që e godasin për shkak të mëkateve, nuk e zgjojnë nga gjumi i hutimit. Madje, as thirrja e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk e kthjellon dhe nuk bën efekt tek ai.

Faktorët e udhëzimit për nga ana e "legjislacionit" (*et tshri'ij*), janë thirrjet e Profetëve të All'llahut, ndërsa për nga ana e "krijimit" (*et tekuinij*), mund të jenë mirësitë, por mund të jenë edhe fatkeqësitë. Por te këta injorantë, që kanë zemër të vdekur, nuk ndikon asnjë nga këto faktorë. E kjo për shkak të vetë atyre, e jo për shkakun tënd, sepse ti e ke kryer përgjegjësinë e përcjelljes së kumtit.

¹ Sure "Shura", ajeti 6.

Shprehja “*idha edhakna*”, që do të thotë *nëse i japim*, në ajetin e mësipërm tregon lidhjen me mëshirën e Krijuesit, kurse në ajete të tjera kur’anorë dëshmon për dënimin hyjnor, tregues se mirësitë dhe fatkeqësitë në këtë botë, nuk janë asgjë në krahasim me mirësitë dhe fatkeqësitë e Ahiretit. Ajo, gjithashtu, mund të jetë me kuptimin se këta njerëz goditen nga mendjemadhësia dhe mizoria thjesht më pak nga mirësia, e goditen me dëshpërim dhe mohim vetëm më pak nga fatkeqësitë.

Përdorimi i fjalës “*insan*” –“*njeri*”, në këto ajete, tregon natyrën e *njeriut të paedukuar*, se ai ka një mendim të ngushtë dhe ego të dobët. Përsëritja e kësaj, në ajetin e mësipërm, e përforcon këtë kuptim.

Çdo mirësi dhe mëshirë në këtë botë ka si burim të saj Krijuesin. Njerëzit nuk zotërojnë asgjë. Këtë të vërtetë e dëshmon edhe ajeti, i cili thotë: **“I All’llahut është pushteti mbi qiejt dhe Tokën. Ai krijon çfarë të dojë...”**.

Për këtë shkak, të gjithë, pa përjashtim, ushqehen në tavolinën e mirësive të All’llahut. Ata kanë nevojë për mirësinë dhe mëshirën e Tij, kështu që nuk është e logjikshme të jesh mendjemadh në mirësi dhe i dëshpëruar në fatkeqësi.

Çdo gjë që ekziston është prej All’llahut dhe njerëzit nuk zotërojnë asgjë nga vetet e tyre. Këtë të vërtetë e ilustron ajeti, i cili thotë: **“...Ai i dhuron vajza kujt të dojë e djem kujt të dojë. Disave u dhuron të dyja gjinitë: djem e vajza; e, kë të dojë e lë pa fëmijë...”**.

Sipas kësaj logjike, njerëzit ndahen në katër grupe: ai që ka fëmijë djem dhe dëshiron vajza, ai që ka vajza dhe dëshiron djem,

ai që ka edhe djem edhe vajza, dhe grupi që i ka humbur fëmijët e shpreson dhe ka dëshirë që t'i ketë.

Askush nuk mund të zgjedhë në këtë fushë, si në të kaluarën, ashtu edhe në kohët e sotme, pavarësisht përparimit dhe zhvillimit të shkencës e përpjekjeve të shumta. Askush nuk ka mundur t'i dhurojë fëmijë një sterili, apo të përcaktojë llojin e fëmijës sipas dëshirës së njeriut, pavarësisht stimulimit të disa ushqimeve dhe barnave që rrisin mundësinë e lindjes së mashkullit apo femrës, vetëm se kjo mbetet thjesht një hipotezë dhe nuk ka ndonjë rezultat përfundimtar për këtë çështje.

Ky është një shembull i qartë i pafuqisë së njeriut dhe një argument i zotërimit, sundimit dhe krijimit të Krijuesit Fuqiplotë. A ka shembull më të qartë sesa ky?

Për t'u theksuar në këtë çështje, është se këto ajete i japin preferencë femrës ndaj mashkullit, për të bërë të qartë rëndësinë që i jep Islami pozitës së gruas. Në anën tjetër, u thotë atyre që kanë mendime diskriminuese për lindjen e femrës dhe që i urrejnë ato, se Krijuesi dhuron atë që dëshiron Ai, jo atë që dëshironi ju. Ky është argumenti që tregon se është Ai që zgjedh.

Përdorimi i shprehjes "*i dhuron*" konsiderohet një argument i qartë se femrat dhe meshkujt janë prej dhuratave të Krijuesit, e se nuk është e drejtë për myslimanin e vërtetë, që të bëjë dallim mes fëmijëve, nëse janë meshkuj apo femra.

Përdorimi i shprehjes "*u fal çift*", nuk do të thotë martesë, por nënkupton bashkimin e dy dhuratave, fëmijës femër dhe fëmijës mashkull. Në një shprehje tjetër, termi "*tezvixhun*" vjen me kuptimin e *bashkimit midis gjërave të ndryshme ose llojeve të*

shumta, sepse *zeuxhun*, në rrënjë ka kuptimin *dy gjëra* ose *dy njerëz të afruar*.

Disa dijetarë e kanë konsideruar këtë ajet me kuptimin e lindjes së meshkujve dhe femrave me radhë, ndërsa disa të tjerë e kanë vlerësuar në kuptimin e lindjes së dy binjakëve, domethënë mashkullit dhe femrës njëherësh.

Shprehja e mësipërme nuk argumenton asnjë nga komentet e përmendura.

Ajo nuk përshtatet me fillimin e ajetit, ngaqë ajeti dëshiron të flasë për grupin e tretë, të cilët, All'llahu i ka begatuar me vajza dhe djem.

Sido që të jetë, vullneti i All'llahut është ai që gjykon në çdo gjë, jo vetëm për çështjen e lindjes së djemve, sepse Ai është i Gjithëdituri dhe i Urti: **"...Vërtet, Ai është i Gjithëdijshëm dhe i Fuqishëm."**

Fjala "*akim*", që do të thotë "*steril*", është marrë nga fjala "*akmun*", njësoj si trajta e fjalës "*bukhlun*"; po ashtu si "*fehmun*", që në rrënjë ka kuptimin *e thatësisirës* dhe tëngurtësimi pengues për pranimin e ndikimit. Gra sterile emërtohen ato gra, mitrat e të cilave janë të papërgatitura për pranimin e pikës së ujit dhe zhvillimin e fëmijës, ashtu siç emërtohen edhe disa erëra, me termin erëra sterile, për pafuqinë e tyre në bashkimin e reve të shiut. "*Jeumul akim*" emërtohet dita në të cilën nuk ka fare, as gëzim e as kënaqësi, siç dhe emërtohet Dita e Kiametit, "*jeumul akim*", për shkak të mungesës së ekzistencës së një dite tjetër pas saj, që të mund të kompesohet e shkuara.

Së fundi, ushqimi "*el ma'kem*" përdoret për ushqimin që është pastruar nga të gjitha mikrobet, që është sterilizuar.

Ajeti 51

وَمَا كَانَ لِبَشَرٍ أَنْ يُكَلِّمَهُ اللَّهُ إِلَّا وَحْيًا أَوْ مِنْ وَرَاءِ حِجَابٍ أَوْ يُرْسِلَ رَسُولًا فَيُوحِيَ بِإِذْنِهِ مَا يَشَاءُ إِنَّهُ عَلَىٰ حَكِيمٍ

“Asnjë njeriu nuk i është dhënë t’i flasë All’llahu, përveçse me anë të Frymëzimit ose pas perdes, ose me anën e një Kumtuesi (Engjëlli) të dërguar me lejen e Tij, për të shpallur vullnetin e Tij. Ai, me të vërtetë, është i Lartë dhe i Urtë.”

Shkaku i zbritjes

Për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, komentuesit përmendin këtë histori: Një grup jehudësh erdhën tek i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dhe i thanë: *“Përse nuk flet me Krijuesin? Përse nuk e shikon Atë? Nëse je Pejgamber i vërtetë, bëj siç bënte Musai, që e ka parë Krijuesin dhe ka folur drejtpërdrejt me Të! Nuk do të besojmë kurrë në ty, derisa të bësh atë që kërkojmë prej teje.”* Pejgamberi iu përgjigj: *“Me të vërtetë, s’ka dyshim se Musai nuk e ka parë kurrë Krijuesin!”*. Nga këtu zbriti ajeti

i mësipërm, që ka sqaruar mënyrën e lidhjes mes Pejgamberëve dhe Krijuesit.¹

Komentimi

Mënyrat e lidhjes së Profetëve me Krijuesin

Kjo sure, siç thamë në fillimin e saj, flet në mënyrë të veçantë për Shpalljen dhe profecinë, ngaqë ajo fillon me Shpalljen dhe përfundon me të. Ajetet e fundit flasin për këtë temë, d.m.th., për Shpalljen e All'lahut.

Në këto ajete flitet për mirësinë më të rëndësishme të All'lahut, e më e dobishmja ndër to për botën e njerëzve, është Shpallja dhe lidhja mes Profetëve dhe Krijuesit.

Që në fillim, ajeti thotë: **“Asnjë njeriu nuk i është dhënë t’i flasë All’llahu, përveçse me anë të Frymëzimit...”**, sepse Krijuesi është i papërshkueshëm në trup dhe i patrupëzuar.

“...ose pas perdes...”, siç ka bërë Musai kur fliste në malin e Turit dhe dëgjonte përgjigjen nëpërmjet valëve zanore, të cilat ia niste Krijuesi nga hapësira, pa e parë njeri, se nuk është i mundur shikimi i Krijuesit nga syri ynë i lirë.

¹ Tefsiri i “Kurtubijut”, vëll. 8, f. 5873.

“...ose me anën e një Kuntuesi (Engjëlli)...”, siç vepronte besniku, Xhebraili, kur zbriste tek i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“...të dërguar me lejen e Tij, për të shpallur vullnetin e Tij.”.**

Nuk ka rrugë tjetër, përveç këtyre tri mënyrave, për bisedë mes Krijuesit dhe robëve të Tij: **“...Ai, me të vërtetë, është i Lartë dhe i Urtë.”.**

Ai është më i Larti, më i Madhërishmi, që nuk mund të shihet apo të flasë nëpërmjet gjuhës. Të gjitha punët e Tij janë të mençura, e lidhja e Tij me Pejgamberët përmbushet sipas një programi të paracaktuar.

Ky ajet konsiderohet si një kundërpërgjigje për ata që mendojnë me mendjelehtësi se frymëzim do të thotë që Pejgamberët të shohin Krijuesin teksa flasin me Të. Ajeti pasqyron në formë të përpiktë e të përmbledhur, të vërtetën e frymëzimit dhe të shpirtit.

Si konkluzion, nga ajeti mësojmë se lidhja mes Pejgamberëve dhe Krijuesit përmbushet nëpërmjet tri mënyrave, të cilat janë:

1- Frymëzimi, i cili ka qenë i tillë për një numër të madh Profetësh, si Nuhu, etj. Në një ajet thuhet: **“E Ne i thamë: ‘Ndërto anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe sipas urdhrit Tonë.’”.**¹

2- “...ose pas perdes...”, ashtu siç fliste Krijuesi me Musain në malin e Turit: **“e Musait i foli All'Ilahu me fjalë.”**²

¹Sure “El Mu’minun”, ajeti 27.

² Sure “Nisa”, ajeti 64.

Disa komentues janë shprehur se fraza **“ose pas perdes”** mund të përfshijë ëndrrën e sinqertë dhe të vërtetë.

3- Dërimi i të dërguarit, siç është te shpallja e të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Thuaj: Kush është armik i Xhebrailit (është armik i All'llahut), e ai në urdhrin e All'llahut e zbriti Kur'anin në zemrën tënde.”**¹

Frymëzimi nuk kufizohet me këtë mënyrë, për sa i përket të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*); përkundrazi, ai kryhej edhe me mënyra të tjera.

Është e domosdoshme të përmendim se ka raste që frymëzimi mund të përmbushet në kohën e zgjimit, siç u tregua më lart, madje edhe nëpërmjet ëndrrës së vërtetë, siç dhe përmendet në çështjen e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilin e urdhëroi të therte djalin e tij, Ismailin (*Paqja qoftë mbi të!*), me gjithë konsideratën e disa të tjerëve se ai është konfirmim i shprehjes **“ose pas perdes”**.

Edhe pse këto tri mënyra, që i përmend ajeti, konsiderohen si mënyrat kryesore, një pjesë e tyre kanë degëzime të tjera në vetvete. Kështu, disa besojnë se janë engjëjt ata që bëjnë zbritjen e frymëzimit përmes katër rrugëve, të cilat janë:

1- Engjëlli e vendos frymëzimin në shpirtin dhe zemrën e Profetit, pa iu paraqitur, siç dhe e lexojmë në një hadith nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe*

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 97.

mbi familjen e tij!), ku thuhet: “Me të vërtetë që Shpirti i Shenjtë (Xhebraili) më futi në zemër me frymëzim, se nuk do të vdesë asnjë shpirt derisa të plotësojë riskun e tij. Pra, kijeni frikë All’llahun dhe kur të kërkon, kërkojeni në mënyrën më të bukur.”.

2- Ndonjëherë, engjëlli shndërrohet dhe merr formën e njeriut, bisedon me Profetin, siç dhe përmendin hadithet që Xhebraili mori formën dhe u shfaq si Dahjetul Kelbij.¹

3- Ka raste që bëhet në formën e rënies së ziles, zëri i së cilës tingëllon në ezan. Ky ishte një nga frymëzimet më të vështira për Pejgamberët, i cili shkaktonte siklete, deri djersë, edhe pse ishte ftohtë. Madje, nëse ata ishin të hipur mbi kafshë, ajo ndalonte dhe shtrihej për tokë.

4- Qëllonte që Xhebraili të shfaqej edhe në formën e tij origjinale, siç e ka krijuar All’llahu. Kjo gjë ka ndodhur vetëm dy herë gjatë gjithë jetës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), siç dhe do të shihet në analizën e sures “Nexhm”, ajeti 12.²

¹Dehijjetu ibn Khalifetul Kelbij është vëllai i të Dërguarit në mëkim. Ai ishte nga njerëzit më të bukur të asaj kohe, saqë Xhebraili u shfaq me fytyrën e tij, kur erdhi tek i Dërguari. Ai ishte prej shokëve të njohur të Profetit. Profeti Muhammed(*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pati dërguar te Cezari i Romës (Herkuli), si mbartës të kumtit në vitin e gjashtë apo të shtatë Hixhri. Ai ka qenë gjallë deri në ditët e hilafetit të Muavijes.

²Tefsiri “Fi Dhilalil Kur’ani”, vëll. 7, f. 306.

Dy hulumtime

I pari: Kuptimi i frymëzimit në gjuhësi, Kur'an dhe Synet

Ragibi në librin e tij “El Mufredatu” thotë se rrënja e frymëzimit do të thotë njoftimi i shpejtë, qoftë me zë të ulët, apo me shenja nëpërmjet organeve (me sy, dorë, kokë) ose me shkrim.

Nëpërmjet kësaj dalim në përfundimin se frymëzimi, Shpallja përfshin shpejtësinë në njërën anë, dhe njoftimin në anën tjetër. Kjo fjalë përdoret për lidhjen e veçantë dhe të shpejtë të Pejgamberëve me botën e së panjohurës dhe Unin e Krijuesit të Shenjtë.

Për frymëzimin ka kuptime të ndryshme në Kur'anin e lavdishëm. Ndonjëherë, në lidhje me Pejgamberët, ndonjëherë për njerëzit e tjerë, ndonjëherë për lidhjen e veçantë mes njerëzve, ndonjëherë për lidhjen e veçantë mes shejtanëve dhe ndonjëherë në lidhje me kafshët.

Fjala më e bukur në këtë aspekt, është ajo që ka thënë Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), kur i është përgjigjur një njeriu që e pyeti për frymëzimin. Imami e ka ndarë përgjigjen në shtatë pjesë, që janë:

1- Frymëzimi i kumtit dhe profecisë. Shembull: “Ne të frymëzuam ty me Shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe Pejgamberët pas tij; e patëm frymëzuar Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isanë, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin, e Davudit i patëm dhënë Zeburin.”.¹

¹ Sure “Nisa”, ajeti 163.

2- Frymëzimi me kuptimin e instinktit. Shembull: “Zoti yt i dha instinkt bletës.”¹

3- Frymëzimi me kuptimin e njoftimit. Shembull: “Dhe ai doli prej faltores para popullit të vet dhe u dha shenjë, adhuroni (All’Ilahun) mëngjes e mbrëmje.”²

4- Frymëzimi me kuptimin e caktimit. Shembull: “dhe secilit qiell i caktoi atë që i nevojitej.”³

5- Frymëzimi me kuptimin e urdhrit. Shembull: “dhe kur i frymëzova Havarijunët (i urdhërova):‘të më besoni Mua dhe të Dërguarin Tim.’”⁴

6- Frymëzimi me kuptimin e mashtrimeve. Shembull: “Dhe kështu (sikurse edhe ty) çdo Pejgamberi i bëmë armiq disa nga njerëzit dhe nga xhindët e djallëzuar, që me fjalë të shkëlqyera, në mënyrë të fshehtë, nxitin njëri-tjetrin në mashtrime.”⁵

7-Frymëzimi me kuptimin e lajmërimit. Shembull: “Dhe ata i bëmë shembëlltyrë që udhëzonin sipas urdhrit Tonë, i orientuam në punë të mira.”⁶⁷

Disa nga këta shtatë shembuj mund të kenë derivacione të tjera, që shtohen në zbatimin e tyre nga përdorimet e frymëzimit në Kur'an dhe traditën Profetike, prandaj Teflisijju shkroi në

¹ Sure “En Nahl”, ajeti 68.

² Sure “Merjem”, ajeti 11.

³ Sure “Fussilet”, ajeti 12.

⁴ Sure “Maide”, ajeti 111.

⁵ Sure “El En’am”, ajeti 112.

⁶ Sure “El Enbija”, ajeti 73.

⁷ “Biharul Anuar”, vëll. 18, f. 254.

librin e tij “Uxhuhul Kur’an”, ekzistencën e dhjetë kuptimeve të frymëzimit.

Nëpërmjet këtyre përdorimeve të ndryshme të frymëzimit dhe formave të tij, dalim në rezultatin se frymëzimi hyjnor është dy llojesh: *frymëzim legjislativ (el uahju et teshriij)* dhe *frymëzim krijues (el uahju et tekuinij)*.

Frymëzimi legjislativ është ai që u zbriste Profetëve dhe përfaqësonte lidhjen e veçantë midis tyre dhe Krijuesit. Ata iu dorëzoheshin urdhërësave të All’Ilahut dhe të vërtetave nëpërmjet kësaj rruge.

Kurse frymëzimi krijues është ekzistenca e instikteve, aftësive, kushteve dhe ligjeve krijuese të veçanta, që Krijuesi i ka krijuar në thellësi të të gjitha qenieve të kësaj bote.

I dyti: E vërteta e frymëzimit të panjohur

Është folur shumë rreth të vërtetës së frymëzimit, por meqë kjo lidhje e panjohur është jashtë kufijve të konceptimeve tona, përshkrimet nuk mund të japin një pasqyrim të qartë për problematikën. Është e nevojshme të përmendim edhe disa komente, të cilat janë shkruar nga filozofë të vjetër dhe të rinj rreth frymëzimit:

1-Komentimi i disa filozofëve të vjetër

Sipas parakushteve të shqiptuara, ata mendojnë se frymëzimi përkon me lidhjen e Krijuesit me shpirtin e të Dërguarit, së bashku me intelektin veprues, mbizotërues, me hijen e tij mbi botën e ndjesivetë përbashkëta dhe të përfytyrimit.

Sqarimi i kësaj:

Së pari: Të vjetrit besonin se në shpirtin i njeriut ka tri forca: *forca e ndjesisë së përbashkët*, nëpërmjet të cilës njeriu koncepton përfytyrimet konkrete; *forca e përfytyrimit*, nëpërmjet të cilës koncepton përfytyrimet mendore, dhe *forca intelektuale*, nëpërmjet të cilës konceptohen përfytyrimet e plota, të përgjithshme.

Së dyti: Ata besonin në teorinë e *nëntë orbitave* të *Claudius Ptolemy*. Ata besonin se ato orbita kanë shpirt të pavarur, njëlloj si shpirti i trupave tanë. Më tej shtojnë: Në të vërtetë këto shpirta astronomikë marrin frymëzim nga qeniet abstrakte që quhen: *“ukuul”* – *“intelekte”*. Mbi këtë bazë ata thonë për ekzistencën e *nëntë intelekteve*, që karakterizohen nga *nëntë orbitat*.

Së treti: Kishte prej tyre që besonin se egoja njerëzore dhe shpirtat e tyre duhet të frymëzohen nga një qenie e pavarur që quhet *intelekti veprues*, kjo për shkak të shfaqjes së aftësive dhe perceptimit të të vërtetave dhe që emërtohej si *intelekti i dhjetë*. Kurse arsyeja e emërtimeve me *veprues* është se ai është baza e gjetjes së aftësive tek intelektet e pjesëshme.

Së katërti: Ata besonin se sado që të forcohet shpirti i njeriut, ai do ta shtojë lidhjen me intelektin veprues, i cili është depozita dhe burimi i të dhënave. Kështu që një shpirt i fortë dhe i plotësuar mund të përfitojë informacione më të zgjeruara nga intelekti veprues, me urdhër të Krijuesit, madje nënjë kohë fare të shkurtër.

Gjithashtu, nëse fuqizohet forca e përfytyrimit, atëherë, ajo mund t'i përcjellë këto nocione të perceptimit në mënyrë më të

mirë. Kur forcohet ndjenja e përbashkët e njeriut, atëherë, ai i percepton çështjet konkrete të jashtme në një formë më të mirë.

Nëpërmjet këtyre premisave dalim në konkluzionin se shpirti i Profetit ka lidhje shumë të forta me intelektin veprues, sepse është i jashtëzakonshëm. Pikërisht, për këtë arsye ka mundësi që në të shumtën e rasteve t'i marrë informacionet në mënyrë të përgjithëshme prej intelektit veprues.

Gjithashtu, forca e përfytyrimit të Profetit është tepër e fortë dhe në të njëjtën kohë ajo ndjek forcën intelektuale. Për këtë, forca e përfytyrimit arrin të japë paraqitje konkrete, të përshtatshme me paraqitjet e plota të marra nga intelekti veprues. Përshebull: Nëse ato të vërteta të përgjithëshme do të jenë prej nocioneve dhe dispozitave, ato do t'i dëgjonim të përsosura nga e folura e një njeriu që përdor shprehje të balancuara, retorike dhe letrare.

Meqenëse forca e përfytyrimit të tij është plotësisht mbizotëruese ndaj ndjesisë së përbashkët, për këtë, ajo mund t'u japë natyrë perceptimi këtyre përfytyrimeve. Kështu që Profeti mund ta shohë atë person me sy dhe dëgjon fjalët e tij.

Kritikë dhe analizë: Kjo teori mbështetet mbi parakushte, pjesa më e madhe e të cilave refuzohen në kohën e sotme, si p.sh: nëntë trupat qiellorë të *Claudius Ptolemy*, si dhe shpirtrat me intelektet e lidhura me to, që vlerësohen si vazhdimësi e legjendave, për shkak të mungesës së një argumenti të vetëm për t'i provuar ato; madje, ka argumente kundër tyre.

Kjo hipotezë nuk harmonizohet me ajetet kur'anore që flasin në veçanti për frymëzimin, sepse ajetet kur'anor sqarojnë

qartë që frymëzimi është një lloj lidhje me Krijuesin, e cila, herëherës mund të jetë në formën e inspirimit, ndonjëherë tjetër, nëpërmjet engjëllit apo dëgjimit të valëve zanore.

Nga problemet e tjera rreth këtij koncepti është se filozofët dhe mendjet e mëdhaja e klasifikojnë këtë koncept për Profetin, ndërkohë që ne e dimë se metoda e frymëzimit ndryshon totalisht nga ajo e perceptimeve logjike.

Ky grup filozofësh, në formë të paqëllimshme e fyejnë frymëzimin dhe Profetësinë, sepse ata nuk iu bashkuan të vërtetës por ndoqën rrugën e përfytyrimeve dhe legjendave. Ka detaje të tjera rreth kësaj teme të cilat do të vijnë në hulumimet që do të vijnë.

2- Komenti i disa filozofëve të rinj

Ky grup filozofësh e kanë konsideruar frymëzimin, në pak fjalë, si një lloj ndjenje e brendshme. Kështu, në Enciklopedinë e Shekullit të njëzetë, rreth frymëzimit thuhet si më poshtë:

Në perëndim, deri në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, si në të gjitha kombet e qytetëruara, për frymëzimin deklarohet se librat për të ishin të mbushur me lajmet e Pejgamberëve. Ardhja e koncepteve të reja me skepticizmin dhe materializmin për gjërat konkrete, i bënë filozofët perëndimorë të arrinin deri aty, sa të pohonin se çështja e frymëzimit s'është tjetër, veçse jehonë nga legjendat e lashta. Madje, ata e tepruan në këtë drejtim, sa që mohuan Krijuesin bashkë me shpirtin, duke u justifikuar me atë që përmendet rreth frymëzimit në librat e vjetër, se gjoja, ai ishte fabrikim për tërheqjen e njerëzve drejt nënshtrimit të dëshirave,

ose i referoheshin delirit, një sëmundjeje psikike që godet një pjesë të njerëzve që janë tepër nervozë, e ju duket sikur shohin fantazma që flasin, kur në të vërtetë nuk shohin ndonjë gjë të tillë. Ky justifikim qarkulloi në botën perëndimore derisa mori formë doktrina zyrtare e shkencës, sa në vitin 1846 u shfaq argumenti i shpirtrave në Amerikë, që qarkulloi drejt Evropës me argumente bindëse e konkrete për ekzistencën e botës shpirtërore. Kjo teori u mirëprit nga shumë dijetarë të mëdhenj të fushave të ndryshme të mendimit, madje, ajo ndryshoi kryekëput edhe këndvështrimin ndaj çështjeve shpirtërore. Zbulimi për evidentimin e çështjeve të frymëzimit nisi të zhvillohej ngadalë, pasi ishte nën presionin e hipotezave të vjetra. Shkencëtarët iu rikthyen ekzaminimit me metodat e shkencës, duke vendosur në qendër eksperimentimin, ky i konfirmuar jo më nga tradita fetare, as nga mënyra e qerthullit të përfytyrimeve. Kështu, u arritën disa rezultate, ndonjëherë ndryshe nga ajo që kishin konfirmuar dijetarët islamë. Ky qe një hap në rrugën e vërtetimit të një çështjeje që i referohej botës mitologjike.¹

Fjalët këtu janë të shumta dhe përmbledhja e tyre është: Shkencëtarët e kanë konsideruar frymëzimin si forca që nxjerr në dritë emocionet e fshehta, si zbulimi i botës së pavetëdijes të njeriut, e cila është shumë më e fortë sesa bota e vetëdijes. Meqenëse Profetët kanë qenë njerëz të dalluar, ata gëzonin emocione dhe ndërgjegje shumë të forta.

Kriticizëm dhe analizë: Duket qartë se ajo që mbështet ky grupim është thjesht një hipotezë, sepse nuk përmendin asnjë argument mbi këtë. Në fakt, ata i kanë konsideruar Pejgamberët si

¹“Dairetul karnil ishrijn”, i Ferijid El Uxhdij, lënda “ueha”.

njerëz, të cilët përfaqësojnë gjenialitet mendimi dhe personalitet madhështor, pa pranuar lidhjen e tyre me burimin e botës së ekzistencës, Krijuesin e Madhërueshëm, si dhe përfitimin e njohurive nëpërmjet Tij, d.m.th. jashtë qenies së tyre.

Burimi i gabimit të tyre qëndron në faktin se ata tentuan ta matin frymëzimin me standardet e shkencës eksperimentale, pra nëpërmjet mohimit të çdo gjëje jashtë rrezes së këtyre eksperimenteve. Kështu, të gjitha gjallesat që ekzistojnë në këtë botë, duhej të konceptoheshin nëpërmjet këtij standardi; në të kundërt thuhej se ato janë joekzistente.

Kjo metodë arsyetimi ka lënë gjurmë të këqija, jo vetëm në temën e frymëzimit, por edhe në shumë kërkime të tjera shkencore, filozofike dhe ideologjike, prandaj është e papranueshme dhe e refuzuar që në fillësë, sepse në të nuk përmendet asnjë argument në lidhje me qeniet e botës materiale dhe atë çka prodhohet prej tyre.

3- Gjenialiteti intelektual

Disa dijetarë i kanë tejkaluar këto thënie, duke thënë se frymëzimi është rezultat i gjenialitetit intelektual të Profetëve: pa dyshim se Profetët ishin njerëz me shpirt të pastër e gjenialitet të jashtëzakonshëm, që i perceptonin shumë mirë interesat dhe nevojat e shoqërisë njerëzore, kështu që nëpërmjet kësaj, ata i paraqisnin shoqërisë njohuritë dhe ligjet e nevojshme.

Ky pohim mohon qartazi profecinë e Profetëve, i përgënjeshtrojnë fjalët e tyre dhe i akuzon me lloje mashtrimesh të ndryshme. Çdo gjë që përmendëm, nuk konsiderohet komentim i

Shpalljes, por janë supozime të sugjeruara në kufijtë e mendimeve. Ata ngulin këmbë në mosnjohjen e ekzistencës së gjërave të tjera jashtë kornizës së informacioneve që kanë, e si rrjedhim u futën në një rrugë pa krye.

Fjala e vërtetë në frymëzim

Ne, pa dyshim, nuk mund të perceptojmë të vërtetën e frymëzimit dhe bashkëlidhjet e tij, sepse ai është një perceptim jashtë kufijve të perceptimit tonë. Ai është një lidhje jashtë kufijve të bashkëlidhjeve të njohura. Bota e frymëzimit është një botë e panjohur për ne. Si mundet që një njeri i krijuar prej tokës, të lidhet me burimin e botës së ekzistencës?!

Si mundet që Krijuesi i përhershëm dhe i pa fund, të lidhet me një krijesë të kufizuar, që i është mundësuar ekzistenca?! Si e merr vesh, si bindet Profeti, kur i zbret frymëzimi, se kjo lidhje është me Krijuesin?

Këto pyetje janë të vështira që t'u përgjigjemi ne, kështu që nuk ka arsye për të këmbëngulur në kuptimin e tyre.

Përsa i përket temës që konsiderohet e arsyeshme nga ana jonë dhe që mund të pranohet, është prania apo mundësia e pranisë e kësaj lidhjeje të panjohur.

Ne themi: Nuk ka asnjë argument logjik që mohon mundësinë e kësaj çështjeje, përkundrazi ne shohim lidhje të panjohura dhe nuk mund t'i komentojmë ato. Këto lidhje vërtetojnë praninë e perceptimeve të tjera jashtë kufirit të shqisave dhe lidhjeve tona.

Për ta sqaruar më mirë këtë temë po sjellim e shembull:

Supozojmë se kemi qenë në një qytet, ku i gjithë populli është i verbër (i verbër që në lindje). Ne jemi të vetmit që shikojmë me të dy sytë. Pra, të gjithë njerëzit e këtij qyteti kanë vetëm katër shqisa (shqisat e dukshme të njeriut janë pesë), kështu që ne jemi të vetmit që i zotërojmë të pesë shqisat. Në qytet do të shohim shumë ngjarje, për të cilat do të lajmërojmë edhe popullin e tij, të cilët do të habiten shumë nga kjo shqisë e pestë, që mund të shohë ngjarje të shumta. Sado të përpigemi t'ua shpjegojmë atyre shqisën e shikimit, dobinë dhe efektet e saj, ata nuk do të mund të kuptojnë. Nga njëra anë, ata nuk mundën ta mohojnë atë, pasi perceptojnë efektet e saj, ndërsa nga ana tjetër janë të paaftë në konceptimin e të vërtetës së shqisës së shikimit, sepse nuk kanë mundur të shohin gjatë jetës së tyre, qoftë edhe për një çast të vetëm.

Nuk duam të themi se frymëzimi është *shqisa e gjashtë*, përkundrazi, ai është një lloj lidhjeje e konceptimi mes botës së fshehtë dhe Vetës së Shenjtë të All'llahut. Meqenëse nuk e perceptojmë thelbin e tij, mirëpo ne besojmë në praninë e frymëzimit (*el uahju*) përshkak të pranisë së gjurmëve të tij.

Në të vërtetë, ne shohim burra të mëdhenj që i ftojnë njerëzit në çështje që janë mbi standardin e mendimeve të tyre, i ftojnë ata në fenë hyjnore. Këta burra kanë mrekulli të jashtëzakonshme, të cilat e tejkalojnë fuqinë e njeriut. Mrekullitë e tyre qartësojnë lidhjen e tyre me botën e fshehtë, ngaqë gjurmët janë të qarta, vetëm se e vërteta është e fshehur.

A kemi arritur ne, që t'i njohim të gjitha sekretet e kësaj bote, që të mohojmë frymëzimin për shkak të vështirësisë së perceptimit nga ana jonë?!

Edhe në botën e kafshëve ka dukuri të panjohura, që nuk mund t'i komentojmë dhe shpjegojmë. A është e qartë për ne, jeta e panjohur e disa shpendëve shtegtarë, të cilët bëjnë një shtegëtim prej tetëmbëdhjetë mijë kilometrash, nga Poli i Veriut deri në Polin e Jugut dhe anasjelltas? Si ka mundësi që këta shpendë e njohin rrugën në mënyrë të përpiktë, pasi ata udhëtojnë ditën, por shpeshherë edhe netëve të errëta, kur ne nuk mund të ecim dhe në distancë të shkurtër nëse nuk kemi aparatura dhe metoda përcaktuese që na drejtojnë shtegun e rrugës?

Gjithashtu, ka edhe disa peshq që jetojnë në thellësitë e detrave dhe oqeanëve, të cilët kur lëshojnë vezët, kthehen në vendin ku kanë lindur, që ndonjëherë mund të jetë mijëra kilometra larg. Si munden këta peshq, të orientohen drejt vendlindjes së tyre me aq lehtësi?!

Ka shumë shembuj të tjerë të panjohur në jetën tonë, që na bëjnë të mos mohojmë ekzistencën e gjithçkaje. Këtu ia vlen të kujtojmë këshillën e filozofit Ibn Sina (Avicena), i cili thotë: *"Çdo gjë që tingëllon në dëgjimin tënd si kureshtje, lëre aty ku është, sa nuk të ka shkura juar argumenti i saktë, i prerë."*

Le të shohim konkretisht, disa argumente për refuzimin e frymëzimit.

Logjika e refuzuesve të frymëzimit

Disa materialistë, në parashtrimin e çështjes së frymëzimit, thonë se ai është e kundërta e diturisë!

Nëse i pyesim: Si është e mundur kjo? Ata, me një ton mendjemadhësie dhe besimi të tepruar në vetvete, shprehen: Mjafton refuzimi i diçkaje, që shkencat e natyrës nuk e kanë vërtetuar atë. Ne nuk pranojmë gjë tjetër, përveç atyre subjekteve që shkencat eksperimentuese i kanë vërtetuar sipas standardeve të tyre të veçanta.

Në shtesë të kësaj, ne nuk jemi përballur në studimet tona shkencore rreth trupit të njeriut dhe shpirtit të tij, me ndonjë të panjohur që mund të na lidhë me botën që qëndron pas natyrores.

Si mund të besojmë se Profetët, të cilët janë njerëz si ne, të kenë perceptime e ndjesi të ndryshme nga ndjesitë dhe perceptimet tona?

Citati dhe përgjigja e vazhdueshme

Ky lloj shtjellimi i materialistëve për frymëzimin nuk lidhet vetëm me këtë çështje. Ata bëjnë të njëjtën analizë karshi të gjitha çështjeve që lidhen me metafizikën. Për sqarim, themi: Mos harroni se kufiri i shkencës është bota e lëndës, pra aparaturat dhe metodat e përdorura për kërkimet shkencore, si laboratorët, mikroskopët, teleskopët dhe sallat e anatomisë. Të gjitha këto janë të kufizuara përtej kufirit të kësaj bote, se këto shkenca dhe aparaturat e tyre nuk mund të flasin kurrë për atë çka ekziston jashtë kufirit të botës materiale, as me mohim e as në vërtetim.

Prandaj argumenti për këtë është i qartë. Këto aparatura e metoda kanë fuqi të kufizuar dhe një perimetër specifik.

Secila nga shkencat e natyrës nuk mund të hyjë në fushën e shkencës tjetër. Ne nuk mund të refuzojmë ekzistencën e mikrobrit të turbekulozit ngaqë nuk e shohim atë nëpërmjet teleskopit supergjigand që përdoret për yjet, apo të refuzojmë ekzistencën e planetit të Plutonit, sepse nuk e shohim dot nëpërmjet teleskopëve të vegjël apo mikroskopëve.

Metodat përshtaten gjithmonë me llojin e shkencës, kurse metodat e përdorura për njohjen e metafizikës, nuk janë veçse argumentime logjike të forta, të cilat na hapin horizont drejt botës së madhe.

Ata që e nxjerrin shkencën nga perimetri dhe kufiri i saj, nuk janë as shkencëtarë, as filozofë, por vetëm se e mëtojnë atë. Në të njëjtën kohë, ata kanë gabuar dhe janë të humbur.

E rëndësishme është që ne shohim personalitete të mëdhenj, që erdhën dhe përmendën çështje që janë jashtë kufirit të njohurive të njeriut. Kjo vërteton lidhjen e tyre me atë që është pas botës së materies. Por si mund të jetë e panjohur kjo lidhje? Kjo është ajo që nuk na është sqaruar, por e vërteta është se ne e dimë ekzistencën e kësaj lidhjeje.

Disa hadithe rreth çështjes së frymëzimit

Në burimet islame përmenden shumë transmetime në lidhje me frymëzimin, të cilat sqarojnë anë të tjera të kësaj bashkëlidhjeje të panjohur të Profetëve me burimin e frymëzimit:

1- Nga disa transmetime kuptohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka qenë në gjendje normale kur i zbriti frymëzimi nëpërmjet engjëllit. Mirëpo ai ka qenë në gjendje të veçantë kur ishte në lidhje të drejtpërdrejtë, pa ndërmjetës, madje ndonjëherë kishte si një gjendje të fikëti. Kjo përmendet edhe në librin e “Teuhidit” të Shejkh Sadukut, nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), të cilin kur e pyetën për gjendjen e të fikëtit që e kapte të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) teksa i zbriste Shpallja, ai tha: “Ajo ndodhte kur nuk kishte ndërmjetës mes tij dhe All'llahut...”¹

2- Xhebraili i zbriste Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në mënyrë të sjellshme dhe me respekt të madh, siç përmendet në hadithin e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ku thuhet: “Kur Xhebraili i vinte Pejgamberit, ai ulej para tij, siç ulej një skllav, dhe nuk hynte derisa ai t'i jepte leje.”²

3- Në një hadith të transmetuar nga Ibn Abbasi, thuhet: “Kur Profetit i zbriste Shpallja, ai ndjente dhimbje të mëdha, i dhimbte koka dhe kishte shumë rëndesë. Kjo gjendje përkon me Fjalën e All'llahut: **‘Ne do të shpallim ty fjalë të rënda (të mëdha).**’³ Kam dëgjuar se Xhebraili i ka zbritur të Dërguarit të All'llahut shtatëdhjetë mijë herë.”⁴

¹“Et Teuhid”, i Sadukut, f. 115, transmetuar nga “Biharul Anuar”, vëll. 18, f. 256.

² “Ilelu Esh Sheraiu”, vëll. 1, f. 7, hadithi 2, transmetuar nga “Biharul Anuar”, vëll. 18, f. 256.

³Sure“Muzzemmil”, ajeti 5.

⁴“Biharul Anuar”, vëll. 18, f. 256.

Ajetet 52-53

وَكَذَلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ رُوحًا مِنْ أَمْرِنَا مَا كُنْتَ تَدْرِي مَا الْكِتَابُ
وَلَا الْإِيمَانُ وَلَكِنْ جَعَلْنَاهُ نُورًا نَهْدِي بِهِ مَنْ نَشَاءُ مِنْ عِبَادِنَا
وَإِنَّكَ لَتَهْدِي إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ صِرَاطِ اللَّهِ الَّذِي لَهُ مَا فِي
السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ أَلَا إِلَى اللَّهِ تَصِيرُ الْأُمُورُ

“Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty Shpallje me urdhrin dhe vullnetin Tonë. Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç’është besimi. Por atë (Kur’anin), Ne e bëmë dritë, me anë të së cilës udhëzojmë kë të duam nga robtë Tanë. Ti, me të vërtetë, udhëzon në Rrugën e Drejtë.”

“(në) Rrugën e All’Ilahut, të Cilit i përket gjithçka që ndodhet në qiej dhe gjithçka që ndodhet në Tokë. Dhe vërtet, tek All’Ilahu kthehen të gjitha çështjet!”

Komentimi

Kur'ani është shpirt nga Krijuesi

Pas hulumtimit të përgjithshëm në lidhje me frymëzimin në ajetet e mësipërme, ajetet që vijojnë, flasin për zbritjen e frymëzimit mbi të Dërguarin më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty Shpallje me urdhrin dhe vullnetin Tonë....”**.

Shprehja “*kedhalike*”, mund të jetë një dëftues i tre llojeve të frymëzimit (*el uahju*) që përmenden në ajetin e mëparshëm. Ky ajet ka vërtetuar gjithçka që thuhet në lidhje me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Një herë lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me Vetën e pagabueshme e të pastër të Krijuesit, herë nëpërmjet engjëllit të Shpalljes, ndonjëherë edhe nëpërmjet dëgjimit të tingujve të veçantë që u ngjanin valëve zanore, siç dëshmohet në transmetimet islame dhe siç e shpjegoam në fund të ajetit të mësipërm.

Në lidhje me nënkuptimin e fjalës “*ruhun*”, ka dy komente në këtë ajet:

Së pari: Qëllimi i kësaj fjale është Kur'ani Kerim, sepse ai (Kur'ani) është baza e jetës së zemrave dhe jetës së gjallesave. Kështu thonë shumica e komentuesve.¹

¹ Tabrasij në tefsirin “*Mexhmaul Bejan*”, vëll. 9, f. 58; Shejkh Tusij në tefsirin “*Et Tibjan*”, Fakhru Razi në tefsirin “*El Kebijr*” dhe Muragij në tefsirin “*El Muragij*” e të tjerë.

Ragibi në librin “El Mufredatu” thotë: Kur’ani është quajtur me fjalën shpirt për shkak të thënies: **“Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty Shpallje (ruhun) me urdhrin dhe vullnetin Tonë....”**, kjo për shkak se Kur’ani është shkak dhe arsyeja e jetës së Ahiretit.

Ky kuptim është në harmoni të plotë me argumente të ndryshme që gjendet në këtë ajet, njëlloj si shprehja: *“kedhalike”*, e cila dëshmon për çështjen e frymëzimit dheshprehja: *“euhajna”*, do të thotë: *“Ne të shpallëm”*, si dhe shprehje të tjera në lidhje me Kur’anin, që përmenden në fund të ajetit.

Pavarësisht se fjala *“ruhun”*, është përmendur shpesh me kuptime të ndryshme në ajete të tjera të Kur’anit, sipas argumenteve të mësipërme, duket qartë se kjo fjalë është përmendur kryesisht në kuptimin *Kur’ani*.

Në komentin e ajetit 2 të sures “Nahl” thuhet: **“Me urdhrin e Tij ia zbrit engjëjt me Shpallje (ruh) atij që Ai dëshiron nga robtë e Tij.”**. Fjala *“ruh”* në këtë ajet, sipas argumenteve, është përmendur me kuptimin *Kur’ani*, *Shpallja* dhe *profecia*. Në të vërtetë, këto dy ajete komentojnë njëri-tjetrin.

Si mundet që Kur’ani të mos jetë shpirt?

Në ajetin 24 të sures “Enfal” lexojmë: **“O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) All’Ilahut dhe të Dërguarit, kur ai (i Dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë.”**.

Së dyti: Ajo që nënkuptohet është *shpirti i shenjtë* ose *engjëlli më i parapëlqyer*, qoftë edhe ndaj Xhebrailit dhe Mikailit, të cilët e shoqëronin Profetin gjithmonë.

Sipas këtij komenti, shprehja: *“Ne të shpallëm”*, ka kuptimin: *Ne të zbritëm*, domethënë të zbritëm *shpirtin e shenjtë*, apo atë *engjëll madhështor*, pavarësisht se nuk e kemi parë shprehjen *“Ne të shpallëm”* me këtë kuptim tjetër në ajetet e tjera kur'anore. Këtë e përforcojnë disa transmetime të përmendura nga burime të njohura hadithi. Mirëpo, komentimi i parë është në harmoni më shumë me ajetin për shkak të pranisë së argumenteve të shumta. Ka mundësi që ato transmetime, të cilët komentojnë shpirtin me kuptimin e shpirtit të shenjtë, apo të engjëllit më të afërt me Krijuesin, janë tregues të kuptimit të brendshëm të ajetit.

Ajeti shton: **“...Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç'është besimi. Por atë (Kur'anin), Ne e bëmë dritë, me anë të së cilës udhëzojmë kë të duam nga robtë Tanë....”**.

Kjo është pra, ajo mirësi e All'llahut që të ka përfshirë ty dhe ta ka zbritur ty këtë Shpallje qiellore.

Është vullneti i All'llahut që t'i udhëzojë robtë e Tij me këtë dritë qiellore dhe ajo dritë të përfshijë Lindjen dhe Perëndimin, madje të gjitha kohërat dhe vendet deri në fund të kësaj jete.

Disa njerëz me mendime të gabuara supozonin se kjo fjali sqaron se i Dërguari nuk kishte besuar tek All'llahu para profecisë së tij, por kuptimi i ajetit është më se i qartë kur thotë: Në të vërtetë, që ti nuk e ke ditur se çfarë është Kur'ani para se ai të zbriste, nuk i ke ditur mësimet e tij që t'i besojë. Kjo nuk bie në

kundërshtim me besimin Njehsues të të Dërguarit dhe me dituritë e tij të larta rreth bazave të adhurimit të All'llahut.

Përfundimi që del është se mosnjohja e përmbajtjes së Kur'anit ndryshon nga mosnjohja e All'llahut.

Jeta e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) para profecisë, që përmendet në librat e historisë, konsiderohet si një argument i gjallë në këtë kuptim. Madje më e qartë se kjo, është ajo që thotë Prijësi i besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në "Nehxhul Belaga": "Që nga koha kur atë (të Dërguarin e All'llahut) e ndanë nga gjidhënia, All'llahu caktoi pranë tij melekun e Vet më të madh, që ta udhëheqë atë, ditën dhe natën, në rrugën e së mirës dhe mirësjelljes ndaj njerëzve."¹

Ajeti, në fundin e tij, shton: **"...Ti, me të vërtetë, udhëzon në Rrugën e Drejtë."**

Kur'ani është dritë për të gjithë, jo vetëm për ty. Ai është rruga e udhëzimit të njerëzve në hullinë e së drejtës, është një dhunti hyjnore madhështore për ata që ecin në rrugën e së vërtetës; ai është uji i jetës për ata që janë të etur dhe të denjë për ta shijuar atë.

I njëjti kuptim, por me një shprehje tjetër, përmendet në ajetin 44 të sures "Fussilet", ku thuhet: **"Thuaj: 'Ai është për besimtarët udhëzues e shërues. E ata që nuk besojnë, në veshët e tyre kanë shurdhim, dhe ai për ta është verbim.'"**

¹ "Nehxhul Belaga", Hytbeja 192; "El Kasiatu".

Duke komentuar Rrugën e Drejtë, më tej ajeti thotë: **“(në) Rrugën e All’llahut, të Cilit i përket gjithçka që ndodhet në qiej dhe gjithçka që ndodhet në Tokë...”**.

A ka rrugë më të drejtë sesa rruga që përfundon te Krijuesi i botës dhe ekzistencës?

A mund të gjendet rrugë më e mirë sesa kjo?

Lumturia e vërtetë është lumturia, në të cilën të fton Krijuesi. Arritja e saj bëhet përmes rrugës së vetme që e ka zgjedhur Krijuesi për të.

Fjala e fundit e këtij ajeti, i cili është dhe ajeti i fundit në suren “Shura”, është argument i faktit se Rrugë e Drejtë është rruga e vetme që të çon te Krijuesi: **“...Dhe vërtet, tek All’llahu kthehen të gjitha çështjet!”**.

Meqenëse Ai zotëron botën e ekzistencës, e drejton dhe kontrollon atë i Vetëm, meqenëse programet e përsosjes së njeriut duhet të jenë nën mbikëqyrjen e këtij Admistruesi Madhështor, atëherë, Rrugë e Drejtë është rruga e vetme që të çon tek Ai. Kurse rrugët e tjera janë të gabura dhe të çojnë drejt të kotës dhe humbjes. A ka ndonjë tjetër që meriton të adhurohet në këtë botë përveç All’llahut të Madhëruar?

Kjo fjali është përgëzim për të gjithë të përkushtuarit. Në të njëjtën kohë, ajo është kërcënim për zullumqarët dhe mëkatarët, sepse të gjithë, pa përjashtim, do të kthehen te Krijuesi.

Ky është një argument i fortë se Shpallja duhet të jetë vetëm nga Krijuesi, se të gjitha çështjet janë me vullnetin e All’llahut e kontrolli i gjithçkaje është në duart e Tij. Për këtë

arsye, domosdoshmërisht do të jetë Krijuesi, burimi, zanafilla e frymëzimit për Pejgamberët, derisa të përmbushet udhëzimi i vërtetë.

Si konkluzion shohim se fillimi dhe fundi i këtyre ajeteve janë të harmonizuar e të bashkërenduar ndërmjet njëri-tjetrit. Fundi i sures gjithashtu, harmonizohet me fillimin e saj dhe temën e përgjithshme që zhvillohet në të.

Hulumtime

1- Cila ka qenë feja e të Dërguarit para profecisë së tij?

Nuk ka dyshim se i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk u është përlurur kurrë putave para se të ngarkohej me profeci dhe nuk është shmangur kurrë nga vija e Njehsimit. Historia e jetës së tij e pasqyron këtë kuptim. Mirëpo, dijetarët kanë mendime të ndryshme se në cilën fe aderonte ai.

Disa kanë shkuar deri aty, sa thanë se aderonte në fenë e Mesiut (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse Krishtërimi ishte feja e vetme zyrtare e paabroguar para se të dërgohej i Dërguari, (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ndërsa disa të tjerë thanë se bëhej fjalë për fenë e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) sepse ai është lideri i Profetëve dhe babai i

tyre, sepse disa ajete kur'anore përmendin se feja islame është feja e Ibrahimit: **“Feja e babait tuaj, Ibrahimit.”**.¹

Kurse një pjesë dijetarësh nuk kanë përmendur asgjë, por janë mjaftuar duke thënë se dihej që i Dërguari ishte në një fe të caktuar, por nuk ishte e qartë se në cilën.

Të gjitha këto hamendje mbështeten në një argument të caktuar, por ai nuk është i prerë, kështu që më e pranueshmja prej tyre mbetet një thënie tjetër, sipas së cilës: I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka pasur një program të veçantë nga ana e Krijuesit me të cilin punonte. Në të vërtetë ai ka pasur një fe të veçantë, deri në kohën e zbritjes së Islamit tek ai.

Argument rreth kësaj është fjalia që përmendëm pak më lart, e që gjendet në librin “Nexhul Belaga”: *“Që nga koha kur atë (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), e ndanë nga gjidhënia, All'llahu caktoi pranë tij melekun e Vet më të madh për ta udhëhequr, ditën edhe natën, rrugës së mirësisë dhe mirësjelljes ndaj njerëzve.”*.

Prania e një engjëlli të tillë tregon për ekzistencën e një programi të veçantë.

Argumenti tjetër është se historia nuk ka përmendur kurrë se i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është angazhuar me adhurim në tempujt e çifutëve, të krishterëve apo të feve të tjera. Ai nuk u ka qëndruar pranë jobesimtarëve në tempujt e tyre, as atyre që ishin ithtarë të librit në kishat e tyre. Ai vazhdoi me përkushtim në përzgjedhjen e

¹ Sure “El Haxhxh”, ajeti 78.

rrugës së Njehsimit dhe ishte i kapur fort pas bazave të moralit dhe adhurimit të All'llahut.

Në burimet islame përmenden edhe shumë shprehje të tjera, ku thuhet se i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë i përgatitur dhe i mbështetur qysh në fillimet e jetës së tij me shpirtin e shenjtë. Kështu që, s'ka dyshim se ai ka punuar sipas asaj që frymëzohej nga Shpirti i Shenjtë.¹

Eruditi El Mexhlisij mendon se i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka qenë Profet (*nebij*) para se të ishte i Dërguar (*resul*), se engjëjt bisedonin me të, nganjëherë ai dëgjonte zërin e tyre, e hera-herës ishte frymëzimi hyjnor që zbriste mbi të përmes pamjeve vizive të vërteta dhe të sinqerta. Pas dyzet vitesh, ai arriti në gradën e Profetësisë dhe atij zbriti Kur'ani dhe Islami. Për këtë janë përmendur gjashtë argumente, një pjesë e të cilave harmonizohen me atë që kemi thënë më lart.²

2- Përgjigjja e pyetjes

Pas këtij diskutimi, mund të shtrohet pyetja: pse ajeti thotë: **"...Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç'është besimi..."**, pavarësisht atyre që kemi thënë për besimin dhe veprat e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) para profecisë së tij?

¹ "Biharul Anuar", vëll. 18, f. 288.

²Për më tepër shih vëll. 18. të "Biharul Anuar", f. 277.

Edhe pse është theksuar përgjigjja e kësaj pyetjeje në formë të shkurtër në komentin e ajetit, kërkohet dhënia e një plotësimi të mëtejshëm në lidhje me të.

Ajo që nënkuptohet këtu, është se i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk e njihte me hollësi e me detaje këtë fe, as përmbajtjen e Kur'anit, para se t'i zbriste ai dhe para legjislacionit të Islamit.

Për sa i përket fjalës "*besim*" - "*el ijmanu*", po të vërejmë me kujdes, do të shohim se kjo fjalë përmendet pas librit. Duke parë fjalitë e tjera që vijnë pas kësaj fjalë në ajet, bëhet e qartë se ajo që nënkuptohet është besimi në përmbajtjen e këtij libri qiellor dhe nuk është kuptimi për besimin në përgjithësi. Kështu që nuk ka ndonjë kundërshtim në lidhje me atë çka thamë. Por, kjo fjali nuk mund të jetë një strategji e shpirttrave të sëmurë, me anë të së cilës të argumentojnë refuzimin e besimit në mënyrë absolute prej të Dërguarit, e të refuzojnë të vërtetat historike për këtë gjë.

Disa komentime japin përgjigje të tjera për këtë pyetje, të cilat përmbledhtazi janë:

a) Qëllimi me *besimin* nuk është vetëm bindja, por një bashkësi bindjesh e konfirmimi me gjuhë dhe vepra. Kjo është ajo që nënkuptohet me të sipas shpjegimit islam.

b) Ajo që nënkuptohet me *besimin*, është bindja në Njehsimin dhe misionin, kumtin. Ne e dimë mirë se Profeti ka qenë njehsues, pavarësisht se ai nuk e kishte besuar ende kumtin e tij.

c) Ajo që nënkuptohet me *besimin*, janë shtyllat e besimit, të cilat nuk mund të arrihen nga njeriu nëpërmjet logjikës. Rruga e

vetme për këtë, janë argumentet e transmetuara (njëlloj si shumë prej veçorive të Kiametit).

d) Ka një nënkuptim të fshehur në këtë ajet për vlerësim: Nuk ke ditur si t' i ftoje krijesat në besim.¹

Kuptimi i parë është më i parapëlqyeri dhe harmonizohet me përmbajtjen e ajetit.

Çështje letrare

Ka shumë diskutime rreth përemrit në fjalinë: **“Ne e bëmë atë dritë”**, se kujt i referohet. Disa thonë se ky përemër nënkupton vetë Kur'anin, librin madhështor qiellor të të Dërguarit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e disa të tjerë thonë se bëhet fjalë për dritën e All'llahut e të besimit.

Është më e pranueshme që ky përemër t'u referohet të dyjave, Kur'anit dhe besimit, përderisa përfundojnë në një të vërtetë. Kësisoj, nuk ka problem pse u referohet përemri i njëjësit të dyjave.

Zoti ynë, ndriçoji zemrat tona me dritën e besimit, na drejto me mirësinë Tënde, drejt mirësisë dhe lumturisë!

Zoti ynë, na mëshiro me durim, që të mos bëjmë padrejtësi te mirësitë dhe të mos dëshpërohem në fatkeqësi dhe mashtrime!

¹ Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëll. 25, f. 55.

Zoti ynë, na bëj të jemi në radhët e besimtarëve të singertë, atë
Ditë kur mizorët dhe mendjemëdhenjtë do të jenë të hutuar e të humbur,
e besimtarët do të jenë të sigurtë nën hijen e mbrojtjes Tënde!

Pranoje këtë lutje, o Zot i botërave!

Surja “Zuhruf”

Mekase, numri i ajeteve 89

Përmbajtja

Surja “Zuhruf” është prej sureve që ka zbritur në Mekë, përveç ajetit 45 të saj, të cilin një grup prej komentuesve kanë thënë se ky ajet ka zbritur në Medine. Mbase shkaku është se ky ajet flet, në pjesën më të madhe, flet për ithtarët e librit dhe për ndodhinë e miraxhit. Të dy këto hulumtime përputhen më shumë me Medinen. Kështu që do të sqarojmë atë çfarë bëhet fjalë në komentimin e këtij ajeti.

Sido që të jetë çështja, natyra e sureve Mekase rrotullohet përreth boshtit të doktrinës islame, duke filluar që nga zanafilla (krijimi) Ringjallja, Kiameti, Profecia, Kur’ani, paralajmërimi dhe përgëzimi.

Temat e sures mund të përmbliidhen në shtatë kapituj:

Kapitulli i parë është fillimi i sures, që flet për rëndësinë e Kur’anit të lavdishëm, profecinë e Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për kundërshtimin e idhujtarëve ndaj Librit Qiellor (Kur’ani).

Kapitulli i dytë përmend një pjesë të argumenteve të Njehsimit në hapësira dhe mirësitë e shumta të All’llahut kundrejt njerëzve.

Kapitulli i tretë flet për luftën ndaj idhujtarisë dhe mohimit të gjithçkaje që i mvishet All’llahut të Madhëruar, prej thënieve të kota dhe të zbrazëta, për luftën ndaj traditave të verbra, miteve dhe legjendave, si dëshpërimi kur lindte një vajzë, apo besimit se engjëjt janë bijat e All’llahut të Madhëruar

Kapitulli i katërt përcjell dëshmi të Pejgamberëve të mëparshëm dhe popujve të tyre, historinë e tyre për mishërimin e të vërtetave, e thekson në mënyrë të veçantë jetën e Ibrahimit, Musait dhe Isait (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Kapitulli i pestë trajton çështjen e Ringjalljes, shpërblimin e besimtarëve dhe fundin e përbuzur të mohuesve, paralajmëron zullumqarët duke u tërhequr vëmendjen me kërcënime dhe paralajmërime ndëshkimesh të forta.

Kapitulli i gjashtë është nga kapitujt më të rëndësishëm të kësaj sureje. Ai trajton vlerat e kota që kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të pranishme në mendjet e njerëzve materialistë, rënien e tyre në dyshime të ndryshme teksa u japin vlerë problemeve të jetës, duke i peshuar ato në peshoren e dynjasë, saqë arritën derisa të prisnin që Kur’ani të zbriste nga një burrë me pasuri të mëdha, ngaqë e vlerësonin njeriun me pasurinë që gëzonte. Kur’ani, në shumë ajete dhe sure, e hedh poshtë këtë mënyrë të menduari naiv e injorant dhe e lufton atë duke e bërë të qartë me shembullin e lartë të njeriut besimtar të Islamit.

Kapitulli i shtatë është kapitulli i predikimeve dhe këshillave me ndikim të thellë, që plotëson kapitujt e tjerë dhe i shndërron ajetet në bar të plotë shërues, ngaqë thekson me forcë efektin e shpirtit dëgjues.

Kjo sure e ka marrë emrin “Zuhruf” nga ajeti i 35-të, i cili flet për vlerat materiale.

Mirësia e leximit të sures

Leximi i kësaj sureje ka një mirësi të madhe. Në lidhje me këtë, i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): ka thënë: *"Kush lexon suren "Zuhruf", do t'i thuhet në Ditën e Kiametit: O robtë e Mi! Nuk ka frikë për ju sot dhe as mos u dëshpëroni! Hyni në Xhennet!"*.¹

Pa dyshim që fjalia: **"O robtë e Mi, sot nuk ka frikë për ju, e as që do të pikëlloheni"**, është e njëjtë me atë që përmendet në ajetin 68. Fjalia: **"hyni në Xhennet"** është marrë nga ajeti 70, kurse fjalia: **"pa llogaridhënie"** është nga të domosdoshmet e fjalës dhe përmendet në shumë ajete kur'anore.

Pa dyshim që ky është një përgëzim i madh dhe një mirësi që s'ka të krahasuar, që nuk arrihet thjesht me një lexim, por me meditim, besim dhe punë të mira, sepse leximi është paraprirës i mendimit, kurse besimi dhe veprat e mira janë frytet e tij.

¹Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, fillimi i sures "Zuhruf".

Ajetet 1-8

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

حم وَالْكِتَابِ الْمُبِينِ، إِنَّا جَعَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ^٢
وَإِنَّهُ فِي أُمِّ الْكِتَابِ لَدَيْنَا لَعَلِيَّ حَكِيمٌ، أَفَنَضْرِبُ عَنْكُمُ الذِّكْرَ
صَفْحًا أَنْ كُنْتُمْ قَوْمًا مُسْرِفِينَ. وَكَمْ أَرْسَلْنَا مِنْ نَبِيٍّ فِي الْأَوَّلِينَ^٦ وَمَا
يَأْتِيهِمْ مِنْ نَبِيٍّ إِلَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ^٧ فَأَهْلَكْنَا أَشَدَّ مِنْهُمْ بَطْشًا
وَمَضَى مَثَلُ الْأَوَّلِينَ^٨

Me emrin e All'lahut të Gjithmëshirshmit, Mëshirplotit

"Hâ, Mîm."

"Betohem në Librin e qartë!"

"Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kur'anin në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju."

"E ai është te Ne, në Librin kryesor (Leuhi Mahfûdh), i lartësuar dhe plot urtësi."

"A ta tërheqim Përkujtimin (Kur'anin) prej jush ngaqë jeni popull i shfrenuar?"

"Eh, sa Profetë u dërguam Ne breznive të mëparshme."

“Por, sa herë që u vinte atyre ndonjë Profet, ata talleshin me të!”

“Prandaj Ne i shkatërruam ata, edhe pse ishin më të fuqishëm se këta (paganët e Mekës). Kështu, pra, është shembulli i popujve të lashtë.”

Komentimi

Mëkatet tuaja nuk e ndalojnë mëshirën Tonë!

Edhe një herë tjetër përballemi me shkronjat e ndara në fillim të sures, që janë shkronjat: *“ha mim”*. Kjo është sureja e katërt që nis me *“ha mim”*, të cilën e pasojnë edhe tri sure të tjera. Kështu që, së bashku, këto sure formojnë numrin shtatë: *familja e Hamim’eve*, të cilat janë: *“El Mu’min”*, *“Fussilet”*, *“Shura”*, *“Zuhruf”*, *“Dukhan”*, *“Xhathije”* dhe *“Ah’kaf”*.

Shkronjat e ndara i kemi komentuar në mënyrë të hollësishme edhe më parë, ku kemi përmendur fillimin e sures *“El Bekare”*, fillimin e sures *“Ali Imran”*, fillimin e sures *“A’raf”*, fillimin e sures *“Fussilet”*.

All’llahu i Madhëruar betohet për Kur’anin Kerim në ajetin e dytë, teksa thotë: **“Betohem në Librin e qartë!”**. Betohet për këtë libër me të vërteta të qarta, si sqarues i kuptimeve dhe nocioneve, si zbulues i argumenteve të sinqerta, si udhërrëfyes i rrugëve të udhëzimeve dhe udhërrëfimeve të tij.

Pastaj shton: **“Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kur’anin në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju.”**¹

Të qenit e Kur’anit në arabisht ose mund të ketë kuptimin se ai zbriti në gjuhën arabe, që është një nga gjuhët më të përhapura të botës për sqarimin e të vërtetave, e aftë në qartësimin e kërkesave të rëndësishme, me bukurinë dhe elegancën e saj në mënyrën e shprehjes, ose me kuptimin e letërsisë së rrjedhshme dhe pastërtisë së saj, etj, sepse një nga kuptimet e fjalës *arabijun* është: *“elfesijhu”*, që do të thotë: *i pastër në të folur*, çka është tregues i asaj që Kur’ani është në kulmin e pastërtisë dhe kuptimeve, që të zbulohen mirë të vërtetat nëpërmjet termave dhe fjalive, me qëllim që të gjithë ta kuptojnë saktë dhe mirë.

Betimi dhe përgjigjja, këtu janë e njëjta gjë, sepse All’llahu i Lartësuar betohet për Kur’anin se Ai e bëri Kur’anin në gjuhën arabe, që të përfitojnë të gjithë popujt prej tij, t’i perceptojnë me logjikë ajetet e tij. Ky tregon se nuk ka pasur diçka më të lavdishme sesa Kur’ani për t’u betuar, se ai që është më lart se Kur’ani është vetë Kur’ani, se ai është Fjala e All’llahut të Madhëruar, se Fjala e All’llahut është e qartë për Unin e Tij të Shenjtë.

Shprehja *“leal’le”*, nuk tregon se All’llahu i Madhëruar ka dyshim në efektin e Kur’anit, apo se fjala këtu është për lutjen dhe shpresën, të cilat janë të vështira të arrihen dhe të vërtetohen; përkundrazi, ajo tregon për dallimet në aftësitë, mendimet dhe

¹Shkronja *“uau”* në fjalinë *“uel kitabil mubin”*, është për betim që do të thotë: **“Betohem në Librin e qartë!”**. Përgjigjja e këtij betimi është fjalia **“Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kur’anin në gjuhën arabe...”**.

moralet për dëgjuesit e Kur'anit. Gjithashtu, tregon se ndikimi i Kur'anit kërkon përmbushjen e disa kushteve të caktuara, që jepen në mënyrë të përmbledhur me fjalën "*leal'le*".

Një analizë të këtij kuptimi e kemi përmendur në fundin e ajetit 200 të sures "*Ali Imran*".

Më pas, Kur'ani ndalet në sqarimin e tri cilësive të tjera për këtë Libër Qiellor, teksa thotë: "**E ai është te Ne, në Librin kryesor (Leuhi Mahfûdh), i lartësuar dhe plot urtësi.**". Në cilësinë e parë thotë se Kur'ani Kerim është ruajtur dhe vendosur në librin amzë tek All'llahu i Madhëruar, siç e lexojmë në ajetin 22 të sures "*Buruxh*": "**...në Pllakën e Ruajtur mirë** (Leuhi Mahfûdh)".

Tani, të shohim se çfarë nënkuptohet me "*ummul kitab*" dhe me "*el Leuhul Mahfudh*".

Fjala "*el ummu*" në gjuhën arabe do të thotë zanafilla e çdo gjëje dhe baza e saj. Arabët i thonë nënës me këtë emër: "*ummun*", sepse ajo është baza e familjes dhe streha e fëmijëve. Nisur nga kjo, "*ummul kitab*" do të thotë *libri, i cili është baza e të gjithë librave qiellorë*, që është ajo pllakë që ruhet tek All'llahu i Madhëruar, i mbrojtur nga çdo ndryshim apo devijim. Ai është libri i dijes së All'llahut që ruhet tek Ai. Në të janë arkivuar të gjitha të vërtetat e botës, të gjitha ngjarjet e të shkuarës dhe së ardhmes, mbi të gjithë librat qiellorë. Askush nuk mund të arrijë tek ai e të mësojë çfarë ka në të, vetëm nëse do All'llahu i Madhëruar që t'ia mësojë dikujt aq sa Ai dëshiron.

Ky është një përshkrim i madhërishëm për Kur'anin, që buron nga dituria e pafundme e All'llahut. Zanafilla dhe baza e tij është tek Vetë Ai, i Lavdëruari. Për këtë përmendet cilësia e dytë:

“Le alijjun”, që do të thotë: *famë të lartë*, kurse në të tretën: *“hakimun”,* që ka kuptimin: *plot urtësi*.

Pa dyshim se çdo gjë që buron nga dituria e pafundme e All'llahut, duhet të jetë me këto cilësi të vyera.

Disa dijetarë besojnë se lartësimi dhe pozita e lartë e Kur'anit buron në të, se ai i ka tejkaluar të gjithë librat qiellorë dhe i ka anuluar ata. Për këtë, ai mbetet grada më e lartë e mrekullisë.

Dijetarë të tjerë e kanë konsideruar lartësimin e Kur'anit prej përmbajtjes së tij ndaj të vërtetave, që mendjet e njerëzve nuk mund t'i konceptojnë, sepse ato janë larg asaj që asimilojnë mendjet e tyre, pa përmendur të vërtetat që i kuptojnë të gjithë nga shfaqja e Kur'anit.

Këto kuptime nuk përplasen me njëri-tjetrin, pasi bashkohen në nocionin: *“alijjun”,* që do të thotë: *famëlartë*.

Këtu ka një çështje që meriton kujdes, ku fjala: *“hakim”,* që do të thotë: *plot urtësi*, është cilësi e një njeriu të zakonshëm, jo e një libri. Përderisa ky Libër Qiellor është vetë një mësues i madh dhe lektor plot me mençuri, që e përhap atë ngado, pa dyshim se kjo shprehje ka gjetur saktësisht vendin e saj.

Fjala: *“hakim”* përmendet gjithashtu, në kuptimin e *fortesës së mirëmbrojtur*. Të gjitha këto kuptime janë bashkuar në shprehjen e përmendur.

Ajeti që pason, u flet atyre që refuzuan Kur'anin dhe kundërshtarëve të tij, duke thënë: **“A ta tërheqim Përkujtimin (Kur'anin) prej jush ngaqë jeni popull i shfrenuar?”**.

Është e vërtetë se ju keni bërë gjithçka për kundërshtimin e së vërtetës dhe armiqësinë ndaj saj. Me kundërshtitë tuaja arritët që t'i kaloni kufijtë, por mëshira e All'llahut të Madhërueshëm është shumë e madhe, prandaj vazhdojmë ta zbresim sistematikisht këtë Libër Qiellor, i cili ju zgjon nga gjumi. Ajetet e tij e zbukurojnë jetën tuaj, derisa të lëkunden dhe të zgjedhin Rrugën e Drejtë. Kjo është mëshira e përgjithshme e All'llahut, që përfshin armikun dhe mikun, besimtarin dhe jobesimtarin.

Fjala: *“efe nadribu ankum”* këtu, vjen me kuptimin: *a thua Ne ta lëmë këshillimin tuaj?* Kalorësi, kur dëshiron ta kthejë kafshën e tij për një rrugë tjetër, e kthen duke e goditur me kamzhik apo me diçka tjetër; prandaj fjala *“darebe”*, përdoret këtu në vend të fjalës *“sarefe”*.¹

Fjala *“es saflu”* në rrënjë ka kuptimin *ana e diçkaje*, skaji i saj. Gjithashtu, ajo vjen edhe me kuptimin e *gjerësisë* dhe të *zgjerimit*, kurse në ajet është me kuptimin e saj të parë, domethënë: A të lëmë mënjane këtë Kur'an, i cili është esenca e përkujtimit, në një skaj tjetër për andej matanë?

Fjala *“el musrifu”* vjen nga *“israfun”*, që do të thotë: *shfrenim, tejkalim i kufirit*, çka tregon se idhujtarët dhe armiqtë e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) qëndrojnë në limitet e kundërshtisë dhe të armiqësisë absolute.

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, fundi i ajetit në fjalë.

Pastaj, me një shprehje të shkurtër si dëshmuese e atyre që janë thënë duke u tallur me vetë Profetin, (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pse jo, duke kërcënuar refuzuesit dhe kokëfortët, thuhet: **“Eh, sa Profetë u dërguam Ne breznive të mëparshme. Por, sa herë që u vinte atyre ndonjë Profet, ata talleshin me të!”**.

Këto kundërshtime dhe histori talljesh nuk do ta pengonin kurrë mirësinë e All'llahut dhe mëshirën e Tij, sepse ajo është një mbushulli e vazhdueshme qysh nga zanafilla deri në përjetësi, është një ekzistencë që universalizon dhënien e saj te të gjithë njerëzit. Ai, i Madhërishmi, i ka krijuar ato nga mëshira, **“po për këtë edhe i krijoi ata”**¹, prandaj s’ka dyshim se as kundërshtimi dhe as kokëfortësia juaj nuk do ta ndalojë mirësinë e Tij Absolute.

Nuk duhet të heshtë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe besimtarët e vërtetë, ndaj kundërshtimit të së vërtetës dhe ndjekjes së pasioneve, dëshirave dhe parapëlqimeve, të cilat kanë një traditë të gjatë.

Që të mos mendojnë ata, se mirësia e pafundme e All'llahut do të kalojë pa i dënuar, sepse vetë dënimi është në përputhje me mençurinë e Tij. Prandaj ajeti tjetër shton: **“Prandaj Ne i shkatërruam ata, edhe pse ishin më të fuqishëm se këta (paganët e Mekës). Kështu, pra, është shembulli i popujve të lashtë.”**.

Në ajet i thuhet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): Ne të kemi përmendur më parë ty, shembullin e atyre popujve kundërshtues dhe mizorë, të kemi

¹ Sure “Hud”, ajeti 119.

frymëzuar me sqarimin e qartë të gjendjes së tyre, pa shtuar dhe pa pakësuar asgjë. Në mesin e tyre kishte popuj shumë më të fuqishëm sesa arabët, që gëzonin fuqi dhe pasuri, njerëz me ushtri dhe potenciale të mëdha, siç ishte Faraoni. Meditoni rreth asaj që është zbritur në Kur'an për çështjen e tyre, e ta dini mirë, ju, o mizorë kokëfortë, se nuk jeni kurrë të garantuar prej dënimit të dhimbshëm të All'llahut.

Fjala *"el batshu"*, sipas Ragibit në librin *"El Mufredat"*, do të thotë: *marrja e diçkaje me forcë*. Këtu është shoqëruar me fjalën: *"esheddu"* dhe jep kuptimin *forca dhe fuqi shumë e madhe*.

Përemri *"hum"* në frazën *"minhum"*- *"se këta"*, u referohet idhujtarëve arabë, për të cilët u fol në ajetet e mëparshme, vetëm se këtu janë përmendur në formën e të munguarit, ngaqë *nuk janë të dëshiruar* që t'u flitet nga ana e All'llahut të Madhërueshëm.

Disa komentues me emër e kanë vlerësuar fjalinë **"...Kështu, pra, është shembulli i popujve të lashtë."**, si një tregues të kërkesave që u përmendën në suren paraprirëse, në suren *"Shura"*. Por për këtë përkufizim nuk kemi argumente, ngaqë ngjarje për popujt e kaluar janë treguar shumë rrallë në suren *"Shura"*, në një kohë kur përmenden komente të hollësishme rreth tyre në suret e tjera të Kur'anit.

Sido që të jetë, ky ajet i ngjason asaj që përmendet në ajetin 78 të sures *"Kasas"*, ku thuhet: **"Po, a nuk e di ai, se All'llahu shkatërroi para tij nga popuj të atillë, që ishin edhe më të fuqishëm e më të pasur?!"**.

Apo ajo që thuhet në ajetin 21 të sures *"Mu'minun"*, ku teksta paralajmëron idhujtarët arabë, thotë: **"A nuk udhëtuan ata**

nëpër Tokë, e të shohin se si ishte përfundimi i atyre që patën qenë para tyre? Ata ishin edhe më të fuqishëm se këta, e edhe lanë më shumë gjurmë në Tokë, por All'llahu i dënoi për shkak të gjynaheve të tyre dhe nuk patën ndonjë që t'i mbrojë prej dënimit të All'llahut."?!

Ajetet 9 – 14

وَلَيْنُ سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ خَلَقَهُنَّ الْعَزِيزُ
الْعَلِيمُ، الَّذِي جَعَلَ لَكُمْ الْأَرْضَ مَهْدًا وَجَعَلَ لَكُمْ فِيهَا سُبُلًا
لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ^{١١} وَالَّذِي نَزَّلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً بِقَدَرٍ فَأَنْشَرْنَا بِهِ بَلْدَةً
مَيِّتًا كَذَلِكَ نُخْرِجُوهَا^{١٢} وَالَّذِي خَلَقَ الْأَزْوَاجَ كُلَّهَا وَجَعَلَ لَكُمْ مِنْ
الْفُلْكِ وَالْأَنْعَامِ مَا تَرْكَبُونَ^{١٣} لِيَسْتَوُوا عَلَى ظُهُورِهِ ثُمَّ تَذْكُرُوا نِعْمَةَ
رَبِّكُمْ إِذَا اسْتَوَيْتُمْ عَلَيْهِ وَتَقُولُوا سُبْحَانَ الَّذِي سَخَّرَ لَنَا هَذَا وَمَا
كُنَّا لَهُ مُقْرِنِينَ^{١٤} وَإِنَّا إِلَى رَبِّنَا لَمُنْقَلِبُونَ^{١٥}

**“Nëse ti i pyet ata: ‘Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?’.
Ata, me siguri do të thonë: Ato i ka krijuar i Plotfuqishmi dhe I
Gjithëdijshtmi.”**

**“Ai, që jua ka bërë Tokën djep dhe ka krijuar për ju
rrugë nëtë, që të arrini atje ku synoni.”**

**“Ai, që prej qiellit zbret ujë me masë e nëpërmjet tij
ngjall tokën e vdekur -kështu do të ngriheni edhe ju (prej
varreve).”**

**“Ai, që ka krijuar çifte për çdo lloj krijese, që ka bërë
anije e kafshë që t’i shaloni.”**

“E të mbaheni fort mbi to, e pastaj t’i kujtoni dhuntitë e Zotit tuaj dhe të thoni: ‘Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne,se vetë ne këto nuk do të mund t’i kishim nën pushtet.’”

“Dhe ne, me siguri, do të kthehemi te Zoti ynë!”

Komentimi

Disa argumenta të Njehsimit

Këtu fillon komenti rreth Njehsimit dhe idhujtarisë, teksa vijnë në ndihmë ajetet me karakterin dhe natyrën e tyre, për të vërtetuar Njehsimin. Pasi i bën më se të qarta argumentet e pranishme në botën e ekzistencës, përmend pesë shembuj nga dhuratat e pafundme të All’llahut, nxit tek ata ndjenjën e falënderimit dhe troket në prishjen e besimit të tyre mitologjik në lidhje me statujat dhe llojet e tjera të idhujtarisë.

All’llahu i Madhërishëm, në pjesën e parë, thotë: Nëse ti i pyet ata: **“Nëse ti i pyet ata: ‘Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?’ Ata, me siguri do të thonë: Ato i ka krijuar i Plotfuqishmi dhe i Gjithëdijsmi.”**

Kjo shprehje, e cila përmendet me një ndryshim të vogël në katër prej ajeteve të Kur’anit Kerim - sure “El Ankebut”, ajeti 61; sure “Lukman”, ajeti 25; sure “Ez Zumer”, ajeti 38 dhe ajeti që po

diskutojmë¹ -, janë argument se njohja e All'llahut të Madhëruar është një çështje natyrore, e mbjellë në karakterin e njerëzve dhe në natyrën e tyre, në njërën anë, kurse në anën tjetër, ajo argumenton se idhujtarët ishin të vendosur se Krijuesi i qiejve dhe i Tokës është All'llahu i Madhëruar, kështu që nuk besonin se statujat që adhuronin, ishin krijuese, përveç se me ndonjë rast të rrallë.

Në një këndvështrim të tretë, kjo njohje është bazë dhe shtyllë e shkatërrimit të adhurimit të statujave, sepse All'llahu që është meritues në adhurim, është Krijuesi i Gjithësisë dhe projektuesi i saj, e kurrësi krijesat, të cilat nuk kanë asnjë mundësi në këtë aspekt. Mbi bazë të kësaj, njohja e tyre e të qenit të All'llahut të Madhëruar Krijues, ishte një argument i prerë në shkatërrimin e ideologjisë dhe fesë së tyre të prishur.

Shprehja **“i Plotfuqishmi dhe i Gjithëdijshmi.”**, e cila qartëson fuqinë absolute të All'llahut, diturinë dhe urtësinë e Tij, edhe pse është shprehje kur'anore, mirëpo idhujtarët nuk e mohonin këtë gjë, ngaqë domosdoshmëria e njohjes së të qenit të All'llahut të Madhëruar, krijues i Qiellit dhe Tokës, përbën ekzistencën e këtyre dy cilësive (i Plotfuqishmi dhe i Gjithëdijshmi) në të. Idhujtarët besonin në diturinë e statujave dhe në fuqinë e tyre. Ata besonin se statujat e tyre ishin ndërmjetëse për tek All'llahu, një mënyrë për t'iu afruar Atij.

All'llahu tregon pesë mirësi prej mirësive të Tij të mëdha, të cilat konsiderohen si shembull i rregullit të krijimit, si një

¹Në dy vende në Kur'anin e Shenjtë përmendet pohimi i jobesimtarëve për ekzistencën e All'llahut. Në një vend kur flitet për zbritjen e shiut nga qielli, pikërisht në suren “Ankebut”, ajeti 63, dhe në një vend tjetër kur flitet se All'llahu është Krijuesi i tyre, në suren “Ez -Zukhruf”, ajeti 87.

argument prej argumenteve të All'lahut të Madhëruar. Në fillim thuhet: **"Ai, që jua ka bërë Tokën djep..."**.

Dy shprehjet: *"el mehdu"* dhe *"mihadun"* kanë kuptimin e një vendi, i cili është përgatitur për t'u ulur, për të fjetur dhe për të pushuar. Në rrënjë ka kuptimin edhe për vendin ku vendoset fëmija i vogël për të fjetur, *"mehdun"* - *"djep"*.

Në të vërtetë, All'llahu i Madhëruar e bëri Tokën djep të njeriut, edhe pse ajo bën lëvizje mbi bazën e ligjit të tërheqjes. Pavarësisht shtresës së gaztë që e mbështjell atë në çdo skaj, ajo përsëri është e qetë dhe e stabilizuar, saqë banorët e saj nuk ndjejnë asnjë shqetësim. Ne dimë se qetësia shpirtërore është shtylla kryesore e përfitimit të mirësive dhe e shijimit të tyre. Kështu që nuk ka dyshim se këta faktorë të ndryshëm nëse nuk gërshetohen me njëri-tjetrin dhe nuk plotësojnë njëri-tjetrin, atëherë nuk gjendet mundësia e realizimit të qetësisë shpirtërore.

All'llahu i Madhëruar, për të sqaruar mirësinë e dytë, shton: **"...dhe ka krijuar për ju rrugë nëtë, që të arrini atje ku synoni."**

Për këtë mirësi flitet disa herë në Kur'anin e Lavdishëm, si tek surja *"Ta'ha"*, ajeti 53, *"Enbija"*, ajeti 31, *"En Nahl"*, ajeti 15, e të tjera. Kjo është nga ato mirësi, për të cilën shumica e njerëzve janë të pavëmendshëm. Ne e dimë se në tokë ka male të larta, të ulëta, kodra e bregore. Mes pjesës më të madhe të vargmaleve ka ndarje, përmes të cilave, njeriu nuk mund të hapë rrugë. Ndodh që këto male të jenë shkaktarë për ndarjen e globit tokësor në pjesë. E gjitha kjo përbën një nga sekretet e rregullit të krijimit, një

nga dhuntitë e All'llahut të Madhëruar, si dhuratë e Tij e çmuar për njerëzit.

Shumë vende dhe pjesë të globit tokësor lidhen me njëra-tjetrën nëpërmjet rrugëve detare. Kjo gjithashtu, hyn në universalitetin e kuptimit të ajetit.¹

Nga sa thamë, bëhet e qartë se ajo që nënkupton fjalia **“që të arrini atje ku synoni”**, është udhëzimi drejt qëllimit dhe zbulimi i zonave të ndryshme të Tokës, megjithëse disa e kanë konsideruar si tregues të udhëzimit për njohjen e All'llahut. Megjithatë, fjalia mund t'i ketë të dyja kuptimet.

Në ajetin që vijon, përmendet edhe dhurata e tretë, që është dhurata e zbritjes së shiut dhe ringjalljes së tokës së vdekur: **“Ai, që prej qiellit zbret ujë me masë e nëpërmjet tij ngjalltokën e vdekur -kështu do të ngriheni edhe ju.”**, të gjallë nga varret tuaja Ditën e Kiametit.

Mënyra e të shprehurit me fjalën: *“kaddere”*, është tregues interesant për rregullin e veçantë, i cili kontrollon zbritjen e shirave që zbresin në atë masë sa është e dobishme dhe prodhuese, që nuk shkakton dëm e shqetësim për vendin dhe njerëzit.

Është e vërtetë se ndonjëherë mund të ndodhë që të shkaktojnë vërshime, përmbytje, të gërryejnë përrenj, por këto situata janë përjashtuese dhe kanë natyrën e paralajmërimit. E përgjithshmja është se pjesa më e madhe e shirave janë të

¹ Fjala *“es subul”* është shumësi i *“sebil”-“rruga”*. Me të emërtohen të gjitha rrugët tokësore dhe detare, siç e lexojmë dhe në paragrafin 42 nga duaaja e “Xheushenit”: *“O Ti që ke rrugën tënde në Tokë dhe në det!”*.

dobishëm dhe përfitues, se zhvillimi i pemëve dhe bimëve, luleve dhe të mbjellave, bëhet nga begatia e zbritjes së shiut. Po të mos ekzistonte rregulli i zbritjes së shiut me balancim, nuk do të korreshin të gjitha këto begati.

Ajeti i dytë përdor shprehjen *"ensherna"*, që do të thotë: *është nga lënda e jetës*, për mishërimin e aktivizimit të botës së bimëve, sepse tokat e thata që përmbajnë në brendësi rrënjët e bimëve, ashtu siç përmbajnë varret në brendësi të tyre trupat e vdekur, lëvizin dhe gjallërohen me fryrjen e surit të zbritjes së shiut, dridhen dhe nxjerrin bimët e vdekura, kokat e tyre nga dheu dalin në sipërfaqen e tyre, ndodh kiameti i tyre, që shëmbëllen me pamjen e kiametit të njerëzve.

Pas përmendjes së zbritjes së shiut dhe gjallërimit të bimëve, në fazën e katërt tregohet për krijimin e llojeve të ndryshme të kafshëve. Për këtë, All'Ilahu i Madhëruar thotë: **"Ai, që ka krijuar çifte për çdo lloj krijese..."**.

Pa dyshim që, mënyra e të shprehurit me *"el ezvaxh"*, është metaforike për llojet e kafshëve, sepse në ajetin e mëparshëm u përmendën bimët, pavarësisht se disa e konsiderojnë si shenjë të të gjitha llojeve të gjallesave, njësoj si kafshët, bimët dhe sendet, sepse ligji i çiftëzimit i përfshin të gjithë. Për çdo gjë ka një tip dhe racë, si dhe të kundërtin e saj: toka dhe qielli, nata dhe dita, drita dhe errësira, e hidhura dhe e ëmbla, e thata dhe e njoma, dielli dhe hëna, Xhenneti dhe Xhehennemi, përveç Vetës së Shenjtë të All'Ilahut, sepse Vetja e Tij është Një vetme dhe nuk ka të dytë.

Ashtu siç kemi thënë, sipas argumenteve, ajo që nënkuptohet me shprehjen më lart *"el ezvaxh"*, është *"çiftëzimi i*

kafshëve". Ne dimë se rregulli i çiftëzimit është një traditë jetësore për të gjitha gjallesat e gjalla. Speciet me veti të rralla nuk e çenojnë universalitetin e këtij ligji.

Disa studiues e kanë konsideruar "*çiftëzimin*" me kuptimin e llojeve të kafshëve, si shpendët, gjallesat ujore dhe insektet e të tjera.

Në fazën e pestë, ajetet sqarojnë mirësinë e fundit nga ky zinxhir mrekullish, e ato janë mjetet udhëtuese, të cilat All'Ilahu i Madhëruar ia nënshtroi njeriut për të mbuluar rrugët tokësore dhe detare. I Madhëruari thotë: **"...që ka bërë anije e kafshë që t'i shaloni."**

Në të vërtetë, kjo mirësi është një nga dhuratat e All'Ilahut të Madhëruar ndaj njeriut. All'Ilahu i Madhërueshëm i ka ofruar atij mjetet që e ndihmojnë në udhëtimet detare dhe në përshkrimin e shkretëtirave, siç përmendet në ajetin 70 të sures "Isra": **"Ne vërtet i nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në Tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam."**

E vërtetë është se ekzistenca e këtyre mjeteve i dyfishon veprimtarinë e njeriut, e zhvillon dhe lehtëson jetën e tij dy herë më shumë. Deri dhe mjetet e shpejta që shohim sot, që janë prodhuar duke përfutur nga veçori të ndryshme të krijesave dhe që janë vënë në dispozicion të njeriut, pa dyshim, se ato janë prej mirësive të dukshme të All'Ilahut. Këto mjete ia kanë ndryshuar pamjen jetës së njeriut, i kanë dhënë asaj qetësi e shpejtësi dhe i kanë falur siguri.

Ajeti që vjen, përmend qëllimin përfundimtar të krijimit të këtyre mjeteve, teksa thotë: **“E të mbaheni fort mbi to, e pastaj t’i kujtoni dhuntitë e Zotit tuaj dhe të thoni: ‘Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne, se vetë ne këto nuk do të mund t’i kishim nën pushtet.’”**.

Fjala **“E të mbaheni fort mbi to”**, tregon se All’llahu i Madhëruar i ka krijuar këto mjete në atë formë, që mbi to të mund të uleni në mënyrë të rehatshme, e t’i arrini qëllimet tuaja me lehtësi.¹

Ky ajet sqaron dy qëllime të krijimit të mjeteve lëvizëse detare dhe tokësore, prej anijesh dhe kafshësh.

Një prej tyre është përkujtimi i mirësisë së All’llahut të Madhëruar kur rehatohen mbi kurrizet e tyre, ndërsa tjetri është madhështimi i All’llahut të Madhëruar, i cili i ka vënë këto në shërbim të njeriut, pasi e bëri anijen që të jetë e aftë të çajë kreshtat e dallgëve e të udhëtojë drejt vendit të synuar, i bëri kafshët që janë për udhëtim dhe kafshët e tjera, që t’i nënshtrohen urdhrit të njeriut.

Fjala *“mukrinine”* është nga lënda *“ikranun”* dhe ka kuptimin: *zotërimi i fuqisëndaj diçkaje*. Disa studiues, njohës të mirë të gjuhës, thonë se kjo shprehje ka kuptimin e *marrjes së diçkajedhe ruajtjes së saj*, kurse në rrënjë ka kuptimin e rënies së diçkaje shoqëruar me forcën dhe mbrojtjen.

¹Përemri tek *“ala dhuhurili”* i referohet *“ma”-së*, lidhëz e cila përmendet në fjalinë *“ma terkebune”*, që përfshin *anijet dhe kafshët bartëse*. Përdorimi i saj në numrin njëjës është për të vënë në dukje shprehjen.

Kuptimi i fjalisë: **“...se vetë ne këto nuk do të mund t’i kishim nën pushtet.”**, është se nëse nuk do të ishte mirësia e All’llahut dhe kujdesi i Tij, atëherë ne nuk do të kishim mundësi t’i kontrollonim këto mjete dhe t’i ruanim ato. Ato do të shkatërroheshin me fryrjen e erërave të kundërta me lëvizjen e anijeve. Kështu edhe për kafshët e fuqishme, fuqia e të cilave ia kalon disa herë fuqisë së njeriut. Njeriu nuk do të mundej t’u afrohej atyre, sikur mos të ishte shpirti i dorëzimit që i udhëheq ato. Prandaj kur inatoset ndonjë kafshë dhe humb shpirtin e dorëzimit, ajo shndërrohet në një krijesë të rrezikshme, sa nuk mund ta përballojë as fuqia e disa njerëzve bashkë. Në kohën që e ka lënë qetësia e saj, ajo është në gjendje të lidhë me litar dhe kapistër dhjetëra, madje qindra burra, ndërkohë që ajo i dorëzohet dorës së një fëmije të brishtë, të shkojë me të ku të dëshirojë. Pra, duket qartë se All’llahu dëshiron t’ia qartësojë njeriut mirësinë e gjendjes natyrore të kafshëve, nëpërmjet sqarimit të situatave përjashtuese.

Ajeti i fundit, prej ajeteve në fjalë, kujton thënien e besimtarëve, kur i hipin mjetit lëvizës: **“Dhe ne, me siguri, do të kthehemi te Zoti ynë!”**.

Kjo fjali tregon për çështjen e Ringjalljes, pas bisedës rreth Njehsimit, sepse të qëniti i kujdesshëm ndaj Krijuesit dhe fillimit të krijimit, gjithmonë e bën njeriun të vëmendshëm ndaj Ringjalljes.

Ajo është edhe një këshillë, që njerëzit të mos mashtrohen kur t’u hipin këtyre mjeteve, por t’i zotërojnë ato, që të mos mbyten në mashtrimet e dynjasë dhe kënaqësive të saj, përkundrazi, të jenë gjithmonë përkujtues të Ahiretit dhe të mos e harrojnë kurrë atë.

Mendjemadhësia rritet dhe thellohet në situata të veçanta. Ka njerëz që i përdorin mjetet dhe alternativat e tjera të transportit të tyre si një mënyrë për t'u mburrur dhe si shenjë mendjemadhësie ndaj të tjerëve, e këta nuk janë pak.

Një kuptim tjetër është se vendosja mbi mjet dhe zhvendosja nga njëri vend në tjetrin, na kujton zhvendosjen tonë të madhe nga bota e gjallë për në Botën Tjetër. Se në fund, ne do të kthehemi tek All'llahu i Madhërueshëm.

Hulumtim

Përkujtimi i All'llahut në përfitimin e mirësisë

Kur'ani u mëson besimtarëve që të lutën kur të shijojnë dhuratat e All'llahut të Madhëruar dhe begatitë e Tij. Ato lutje, të cilat i japin shkëlqim shpirtit të njeriut, e edukojnë atë dhe me përmbajtjen ndërtuese të tyre, i largojnë prej tij gjurmët e mendjemadhësisë dhe të pakujdesisë.

All'llahu i Madhërueshëm urdhëroi Nuhun: **“E kur të vendosesh ti dhe kush është me ty në anije, atëherë thuaj: ‘Falënderuar qoftë All'llahu, i Cili na shpëtoi prej popullit të padrejtë!’”**.¹

¹Sure“El Mu'minun”, ajeti 28.

All'llahu urdhëroi të thuhet teksa kërkohet një zbarkim në një vend të bekuar: **“Zoti im, më zbarko në një vend të bekuar, e Ti je më i miri i atyre që bëjnë vendosjen.”**¹

Ai, i Madhëruari, urdhëron në këto ajete, që të falënderojmë për begatitë e All'llahut të Lartësuar e ta madhërojmë Atë, sidomos kur hipim e rehatohemi mbi kurriz të kafshëve apo në mjete të tjera.

Nëse shndërrohet përmendja e Begatuesit të vërtetë, në natyrë dhe në virtyt të njeriu, atëherë, ai (njeriu) nuk do të mbytet në errësirën e pakujdesisë, nuk do të bjerë në greminën e mendjemadhësisë. Përkundrazi, dhuratat dhe mirësitë materiale për të do të shërbejnë si shkallë për t'u afrua tek All'llahu i Madhëruar!

Në jetëshkrimin e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimete All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përmendet se sa herë që vendoste këmbën në deve, ai thoshte: *“Falënderimi i qoftë All'llahut!”*, kurse pasi rehatohej në shpinën e kafshës, thoshte: *“Falënderimi i takon All'llahut në çdo situatë! Falënderuar qoftë Ai, që i nënshtroi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi që ta bënim këtë, dhe ne me siguri do të kthehemi tek Zoti ynë!”*²

Në një hadith të ardhur nga Imam Hasan El Muxhteba (*Paqja qofdtë mbi të!*), thuhet se ai ka parë një njeri që hipi mbi kafshën e tij dhe tha: *“Falënderuar qoftë Ai, i Cili na i nënshtroi neve këto!”* Imami i tha atij: *“Nuk je i urdhëruar të thuash këtë, por je urdhëruar të thuash: “Falënderuar qoftë All'llahu, i Cili na ka udhëzuar në Islam! I falënderuar qoftë All'llahu, i Cili na ka dhuruar neve*

¹Sure“El Mu'minun”, ajeti 29.

²Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 27, f. 199.

Muhammedin! I falënderuar qoftë All'llahu, i Cili na bëri ne ymetin më të mirë që ka nxjerrë njerëzimi.'". Pastaj të thuash: "Falënderuar qoftë Ai, i Cili na i nënshtroi neve këto!".¹

Kjo tregon se ajeti nuk ka urdhëruar të thuhet: *"Falënderuar qoftë Ai, i Cili na i nënshtroi neve këto!"*. Përkundrazi, në fillim je urdhëruar që të përmendësh mirësitë e mëdha të All'llahut, mirësinë e udhëzimit në Islam, mirësinë e profecisë së Pejgamberit, *Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), mirësinë që na bëri në sërën e popullit më të mirë, dhe në fund falënderohet All'llahu për nënshttrimin e atyre që hipim në to.

Duhet bërë kujdes me atë që përfitohet nga transmetimet, se kush thotë pasi vendoset në mjetin udhëtues: **"Falënderuar qoftë Ai, që i nënshtroi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë. Dhe ne, me siguri, do të kthehemi tek Zoti ynë!"**, nuk do të goditet nga ndonjë e keqe me urdhër të All'llahut. Prandaj është përcjellë ky postulat në një hadith në dispozitat nga Imamët e familjes së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).²

Kështu, vërejmë një kontrast të madh midis mësimëve ndërtuese islame dhe asaj që vërehet te grupi i mendjemëdhenjve, ndjekësve të pasioneve dhe shmangieve, të cilët i përdorin mjetet e transportimit si mënyrë mburrjeje dhe shfaqjeje të egoizmit të tyre, çka bëhet shkak për kryerjen e llojeve të ndryshme të

¹ Tefsiri "El Kebijr", vëll. 27, f. 199.

² Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 593; "Usulul Kafij", vëll. 3, f. 471, hadithi 5.

mëkateve. Zamakheshheriju në tefsirin e tij “El Kesh’shaf” thotë për disa sulltanë se ata i hipnin mjetit të tyre të veçantë, shkonin nga njëri qytet në një tjetër, të cilët kishin distanca largësie prej gati një muaji, pinin shumë verë për të mos e ndjerë gjatësinë e rrugës dhe lodhjen e saj, sa nuk dilnin fare nga gjendja e turbullt e të dehurit, derisa arrinin në destinacion.!

Ajetet 15-19

وَجَعَلُوا لَهُ مِنْ عِبَادِهِ جُزْءًا إِنَّ الْإِنْسَانَ لَكَفُورٌ مُبِينٌ^{١٥} أَمْ اتَّخَذَ مِمَّا يَخْلُقُ بَنَاتٍ وَأَصْفَاكُمْ بِالْبَنِينَ^{١٦} وَإِذَا بُشِّرَ أَحَدُهُمْ بِمَا ضَرَبَ لِلرَّحْمَنِ مَثَلًا ظَلَّ وَجْهُهُ مُسْوَدًّا وَهُوَ كَظِيمٌ^{١٧} أَوْ مِنْ يُنْشَأُ فِي الْحِلْيَةِ وَهُوَ فِي الْخِصَامِ غَيْرُ مُبِينٍ^{١٨} وَجَعَلُوا الْمَلَائِكَةَ الَّذِينَ هُمْ عِبَادُ الرَّحْمَنِ إِنَاثًا أَشْهَدُوا خَلْقَهُمْ سَتُكْتَبُ شَهَادَتُهُمْ وَيُسْأَلُونَ^{١٩}

“Ata i kanë quajtur si pjesë të Tij disa prej robëve të Tij! Me të vërtetë, njeriu është mohues i hapët.”

“Vallë, prej krijesave të Veta, Ai të zgjedhë vajza e juve t’ju dhurojë djem?!”

“Kur ndonjëri nga ata merr lajmin e mirë për lindjen e asaj, që ia veshin të Gjithmëshirshmit (si pjesë e Tij), atij i nxihet fytyra dhe pikëllohet.”

“Vallë, a është ajo që rritet në stoli dhe e pafuqishme për të kundërshtuar (diçka që mund t’i vishet All’Ilahut si pjesë e Tij)?!”

“Engjëjt, të cilët janë robtë e të Gjithmëshirshmit, ata i bëjnë për femra. A mos vallë ata kanë qenë të pranishëm gjatë krijimit të tyre?! Dëshmia e tyre do të shënohet dhe ata do të përgjigjen (për atë shpifje)!”

Komentimi

Si thonikë engjëjt janë bijat e Zotit?

Pas vërtetimit të shtyllave të Njehsimit nëpërmjet përkujtimit të ajeteve të All'llahut të Madhëruar për ekzistencën, e përkujtimit të mirësive dhe dhuratave të Tij, këto ajete trajtojnë edhe të kundërtën e atyre: luftën ndaj idhujtarisë dhe adhurimit të tjetërkujt përveç All'llahut të Lartësuar. Në fillim thuhet: **“Ata i kanë quajtur si pjesë të Tij...”**, kështu që menduan se engjëjt janë bijat e All'llahut të Madhëruar, se ata janë zotat e tyre. Ky trillim i shëmtuar ishte përhapur në mesin e shumë prej adhuruesve të putave.

Shprehja me **“pjesë”**, në një anë sqaron se këta i konsideronin engjëjt bij të All'llahut të Lartësuar. Në anën tjetër sqaron pranimin e tyre që t'i adhuronin, se ata i mendonin engjëjt pjesë të zotave, karshi All'llahut të Madhëruar.

Kjo shprehje është një argument i qartë për shkatërrimin e besimit mitik të idhujtarëve. Nëse engjëjt do të ishin bijat e All'llahut të Madhëruar, atëherë kjo çon në atë që All'llahu të jetë pjesë. Si rezultat i kësaj del që Veta e All'llahut të Madhëruar është e përbërë, ndërkohë që argumentet logjike dhe tekstet, janë dëshmitarë se Veta e All'llahut nuk është e përbërë, ajo është Një e vetme dhe se pjesa është e veçantë për krijesat e mundshme.

Ajeti shton: **“...Me të vërtetë, njeriu është mohues i hapët.”**, se me gjithë këto mirësi hyjnore që kanë përfshirë ekzistencën e tij - prej të cilave pesë janë përmendur në ajetet e

mësipërme - ai, në vend që të ulë kokën si madhërim për Krijuesin e tij dhe si lavdërim për begatitë e Tij, zgjedh rrugën e refuzimit, u drejtohet krijesave të All'llahut për t'i adhuruar.

Në ajetin pasues, Kur'ani, nxjerr prova logjike të këtyre njerëzve, për hir të ndëshkimit të këtij mendimi supersticioz, se ata parapëlqenin gjininë mashkullore në krahasim me atë femërore. Ata ishin prej atyre, që sipas zakonisht e konsideronin vajzën turp, teksa All'llahu i Madhëruar thotë: **“Vallë, prej krijesave të Veta, Ai të zgjedhë vajza e juve t’ju dhurojë djem?!”. Nëse pozita e femrës është më e ulët në besimin tuaj, atëherë si e pëlqeni veten tuaj dhe e ngrini lart mbi All'llahun, e bëni pjesën e Tij femër, ndërsa pjesën tuaj mashkull?**

Ajeti që vjen, ndjek të njëjtin koment, por me një mënyrë tjetër, ku thotë: **“Kur ndonjëri nga ata merr lajmin e mirë për lindjen e asaj, që ia veshin të Gjithmëshirshmit (si pjesë e Tij), atij i nxihet fytyra dhe pikëllohet.”**.

Ajo që nënkuptohet me shprehjen: **“...që ia veshin të Gjithmëshirshmit (si pjesë e Tij)...”** janë engjëjt, që ata i konsideronin bij të All'llahut; në të njëjtën kohë, ata besonin se engjëjt ishin zotat e tyre, sepse ata ishin të ngjashëm me Atë (*I Lartësuar qoftë All'llahu!*) dhe njëlloj si Ai.

Në të vërtetë, shprehja: *“kadhijm”* rrjedh nga lënda: *“kadhmun”*, që do të thotë *fytyrë*. Ajo, gjithashtu, vjen dhe me kuptimin e *mbylljes së gojës* kur i afrohet uji, pasi është mbushur, prandaj kjo fjalë është përdorur për të shprehur atë se me çfarë është mbushur zemra, me inat apo me shqetësim dhe dëshpërim. Kjo mënyrë të shprehuri tregon për idetë mitike të idhujtarëve të

paformuar në kohën e injorancës për lindjen e femrave, se si ata mërzitëshin e dëshpëroheshin kur dëgjonin se do të bëheshin me vajzë, dhe në të njëjtën kohë besonin se engjëjt janë bijat e All'llahut të Madhëruar!

Ajeti shton: **“Vallë, a është ajo që rritet në stoli dhe e pafuqishme për të kundërshtuar** (diçka që mund t'i vishet All'llahut si pjesë e Tij)?!”¹

Kur'ani ka përmendur këtu dy cilësi prej cilësive të shumta të grave, që të dyja vijnë prej burimit të pasioneve të tyre. Njëra është *lidhja e fortë e grave me aksesorët e bukurisë*, ndërsa tjetra është *moszotërimi i fuqisë së plotë nga ana e tyre për konstatimin e qëllimit të tyre gjatë debatit për shkak të turpit të tyre*.

Një pjesë e grave nuk kanë ndonjë lidhje të fortë me zbukurimin. Gjithashtu, nuk ka dyshim se të jesh e lidhur me zbukurimin apo ta duash atë në kufijtë e përligjur, për femrat nuk quhet turp; përkundrazi, Islami e ka nxitur këtë. Turpi është për ato femra që e kanë bërë zakon tejkalimin e makiazhit dhe zbukurimit. Ajo që synohet është se shumica e femrave në pjesën më të madhe të shoqërive njerëzore, janë mësuar me shpenzimin e tepërt në zbukurime. Ato duken sikur janë lindur në mesin e zbukurimit dhe jetojnë në prehërin e tij.

Ashtu siç nuk ka dyshimin se, një pjesë e femrave kanë përparuar në nivelet më të larta të shoqërisë me forcën e logjikës dhe sqarimit, mirëpo nuk mund të mohohet dobësia e grave në

¹ Fjala “jensheu” është nga lënda “el inshau”, që domethënë krijimi i diçkaje nga asgjëja, kurse këtu është me kuptimin edukimi i një gjëje dhe zhvillimi i saj. Fjala “hiljetun”, do të thotë zbukurim, ndërsa fjala “khisamun” është kundërtënia dhe konflikti për një gjë.

konflikte, diskutime dhe debate nëse do krahasoheshin me forcën e burrit, kjo për shkak të trupit të brishtë dhe ndrojtjes së tyre.

Si mendoni dhe besoni, se femrat janë bijat e All'llahut të Madhëruar, kurse ju jeni të dalluar me djem?

Ajeti i fundit prej këtyre ajeteve, këtë pyetje e sqaron qartë, duke thënë: **“Engjëjt, të cilët janë robtë e të Gjithëmëshirshmit, ata i bëjnë për femra...”**.

Vërtet, ata janë krijesat e All'llahut, të bindur ndaj urdhrit të Tij, të dorëzuar ndaj vullnetit të Tij, siç dhe përmendet në dy ajetet 26 dhe 27 nësuren “Enbija”: **“Ja, ata janë rob të ndershëm! Që nuk flasin para Tij, ata veprojnë me urdhrin e Tij.”**.

Mënyra e të shprehurit me fjalën “*ibad*”, në të vërtetë është një kundërpërgjigje ndaj mendimit të tyre. Nëse engjëjt do të ishin femra, do duhej të thuhej: “*ibadatun*”. Mirëpo, këtu duhet të bëjmë kujdes, sepse fjala “*ibad*” është emërtimi i shumësit mashkullor dhe krijesave që dalin nga korniza e mashkullores dhe femërores, si engjëjt. Kjo i ngjason përdorimit të përemrave mashkullorë njëjës për All'llahun e Madhëruar, ndërkohë që Ai, i Lavdëruari, është mbi këtë ndasi.

Meriton të përmendet këtu, se fjala: “*ibad*” i është shtuar fjalës: “*Rrahman*”, që në këtë fjali do të thotë: *i Gjithëmëshirshëm*. Kjo mënyrë e të shprehurit mund të jetë tregues i asaj që shumica e engjëjve janë zbatues të mëshirës së All'llahut dhe ruajtësit e ligjeve të botës së ekzistencës, rregullave të saj, dhe e gjitha kjo përbën mëshirë.

Por, pse ka ekzistuar kjo legjendë në mesin e arabëve injorantë? Pse ka mbetur llumi i saj deri tani në mendjet e një grupi njerëzish, sa i pikturojnë engjëjt dhe i përfytyrojnë ata në formën e një gruaje apo femre? Madje, dhe kur duan të pikturojnë

atë që quhet mbretëria e lirisë, e pikturojnë në formën e një femre të bukur dhe me flokë të gjatë.

Ky përfytyrim mund ta ketë burimin nga që engjëjt janë të padukshëm nga shikimi, po ashtu si dhe femrat që janë të mbuluara. Ky kuptim vihet re në disa burime femërore në gjuhën arabe, që e konsiderojnë diellin në kuptimin figurativ femëror, kurse hënën mashkullore, ngaqë disku i diellit është i mbuluar nga dallgët e dritës së tij të fuqishme, kështu që nuk ka mundësi të shihet; e kundërta ndodh me diskun e hënës.

Butësia e melekëve dhe delikatesa e tyre ka bërë që ato të konsiderohen femra, sepse femrat nga natyra janë shumë delikate dhe të buta në krahasim me burrat.

Për të bërë habi është se, pas gjithë kësaj lufte të Islamit ndaj këtij mendimi mitik, ata përsëri kur duan të përshkruajnë një femër, thonë: *“Ajo është engjëll”*; kurse për burrat rrallë përdoret kjo mënyrë të shprehuri. Po ashtu mund të zgjedhin fjalën *“engjëll”* apo *“engjëllushe”* si emër për femra.

Më pas, ajeti përgjigjet në formën e pyetjes mohuese, duke thënë: **“A mos vallë ata kanë qenë të pranishëm gjatë krijimit të tyre?! Dëshmia e tyre do të shënohet dhe ata do të përgjigjen (për atë shpifje)!”**.

Këto që thamë, janë përmendur në një formë tjetër edhe në suren *“Nahl”*, në ajetet 57-59. Aty kemi përmendur një koment të hollësishëm rreth besimeve injorante të arabëve në atë që lidhet me groposjen për së gjalli të femrave, besimit të tyre në gjininë femërore, si dhe rreth periudhës së Islamit në ringjalljen e personalitetit të gruas dhe pozitës së saj të lartë.

Ajetet 20-22

وَقَالُوا لَوْ شَاءَ الرَّحْمَنُ مَا عَبَدْنَاهُمْ مَا لَهُمْ بِذَلِكَ مِنْ عِلْمٍ إِنْ هُمْ إِلَّا يَخْرُصُونَ، أَمْ آتَيْنَاهُمْ كِتَابًا مِنْ قَبْلِهِ فَهُمْ بِهِ مُسْتَمْسِكُونَ، بَلْ قَالُوا إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَارِهِمْ مُهْتَدُونَ،

“Dhe ata thonë: ‘Sikur të kishte dashur i Gjithëmëshirshmi, ne nuk do t’i kishim adhuruar ata’. Ata nuk dinë asgjë për këtë, ata vetëm gënjejnë.”

“Vallë, a u kemi dhënë Ne atyre Libër para tij (Kur’anit), të cilit ata i janë përmbajtur?”

“Jo, por ata thonë: ‘Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe ne po ndjekim gjurmët e tyre.’”

Komentimi

Ajetet e mëparshme dhanë përgjigjen e parë logjike për besimin e adhuruesve të putave, të cilët mendonin se engjëjt janë bijat e All'llahut. Përgjigja është: Në të vërtetë se, të parët dhe prania në çdo situatë janë të domosdoshme, për të vërtetuar një pretendim. Ndërkohë që asnjë idhujtarë nuk guxon të thotë se ka qenë i pranishëm kur All'llahu i krijoi engjujt dhe se ai e pa me sytë e tij mënyrën e krijimit të tyre

Këto ajete vazhdojnë të njëjtën temë, por zgjedhin rrugë të tjera, për t'i shkatërruar këto legjenda të shëmtuara. Në fillim përballen shkurtimisht, me një nga argumentet më të dobëta të tyre, pastaj i përgjigjen asaj, teksa thonë: **“Dhe ata thonë: ‘Sikur të kishte dashur i Gjithëmëshirshmi, ne nuk do t'i kishim adhuruar ata...’”**.

Në të vërtetë, kjo mënyrë të shprehuri mund të jetë tregues i asaj se, këta besonin në fatin dhe parashikimin, se ajo që ndodh me ne është me vullnetin e All'llahut, se çdo gjë që ne bëjmë, është me kënaqësinë e All'llahut. Nëse Ai nuk është i kënaqur me veprat dhe besimet tona, do t'i kishte dhënë fund me ne, kështu që përderisa nuk e ka bërë këtë, kjo tregon se është argument i kënaqësisë së Tij.

Këta sajuan legjenda të reja që të kundërshtonin besimet e tyre të para mitike e të prishura. Ata sajuan gënjeshtra të reja për të konfirmuar gënjeshtart e tyre të para. Cilido të ishte qëllimi i tyre, ai ishte i kotë e pa vlera.

Është e vërtetë, se çdo gjë në botën e ekzistencës nuk ndodh vetëm se me lejen e All'llahut të Madhëruar. Kjo nuk nënkupton parashikimin, pasi nuk duhet të harrojmë se All'llahu i Madhëruar është Ai që ka dëshiruar për ne që të jemi vetë zgjedhës, të lirë për zgjedhjen dhe sjelljen tonë, që të na testojë dhe të na edukojë.

Është e vërtetë se All'llahu i Madhëruar, duhet t'i ndalë robtë e Tij nga e kota, mirëpo nuk mund të mohohet fakti se të gjithë Profetët kanë ngulmuar shumë në parandalimin e njerëzve prej të gjitha llojeve të idhujtarisë dhe dualizmit në adhurim.

Logjika e shëndoshë e njeriut i refuzon këto mite. A nuk është logjika, i Dërguari i All'llahut në brendinë e thellë të njeriut?!

Ajeti në fund përgjigjet me një fjali të shkurtër për argumentimin e dobët në adhurimin e statujave dhe thotë: **"...Ata nuk dinë asgjë për këtë, ata vetëm gënjejnë."**

Në të vërtetë, këta nuk kanë as dituri, as besim, as në çështjen e fatalizmit (*el xhebru*) dhe kënaqësisë së All'llahut të Madhëruar në veprat e tyre. Përkundrazi, si shumë prej atyre që ndjekin pasionin dhe krimin, ata e përdorin çështjen e fatalizmit si pretekst për të çliruar veten nga mëkati dhe shthurja. Ata thonë: Në të vërtetë që dora e kadaut dhe e kaderit, na tërhoqën në këtë rrugë dhe na e mbyllën atë neve. Ata e dinë mirë se gënjejnë dhe se ky justifikim është i pavlerë. Nëse dikush do t'i uzurponte ata, ata nuk do të toleronin nga ndëshkimi i tij dhe as nuk do të thonin se ishte i detyruar ta bënte këtë vepër!!

Fjala “*jakhrusun*” vjen nga “*kharesun*”, që në rrënjë ka kuptimin “*tekhmiyn*” –“*hamendësim*”. Kjo fjalë në fillim është përdorur për *hamendësimin e masës së frutave*, pastaj me të është emërtuar *intuita* dhe *hamendësimi*. Kur intuita dhe hamendësimi ndonjëherë gabonin, nuk përshtateshin me realitetin, atëherë u përdor kjo fjalë edhe për *gënjeshtren*, ndërsa “*jakhrusune*” në këtë ajet, është me këtë kuptim.

Sido që të jetë, nga ajetet e shumta kur'anore, duket qartë se adhuruesit e putave argumentonin çështjen e vullnetit të All'Ilahut për të synuar drejtimin të legjendat dhe trillimet e tyre. Ata ia ndalonin vetes disa gjëra dhe ia lejonin disa gjëra të tjera, duke ia atribuar atë All'Ilahut të Madhërueshëm, siç thuhet në ajetin 148 të sures “El Enam”: **“E ata që i shoqëruan Zotit, do të thoshin: ‘Sikur të donte All'Ilahu, nuk do t’i bënim shokë as ne, e as prindërit tanë, e as nuk do të ndalonim asnjë send.’”**.

Ky kuptim është përsëritur në ajetin 35 të sures “Nahl”, ku thuhet **“E, ata që i bënë shokë Zotit (idhujtarët) thanë: ‘Sikur të kishte dashur All'Ilahu, as ne, e as prindërit tanë nuk do të adhuronin asnjë send pos Tij, dhe nuk do të ndalonim asnjë send pos (ndalesave) të Tij.’”**.

Kur'ani i ka përgënjeshtruar ata në fund të sures “En'Am”, ku thotë: **“Kështu patën gënjyer edhe ata që ishin para tyre derisa (për shkak të mëkatit) përjetuan dënimin tonë të ashpër.”**. Po kështu thuhet qartë në fundin e ajetit të sures “Nahl”: **“Po, a mos kanë të Dërguarit detyrim tjetër, përveç se t’i njoftojnë qartazi?!”**.

Ajeti tjetër flet për një argument ndryshe, duke thënë: **“Vallë, a u kemi dhënë Ne atyre Libër para tij (Kur'anit), të cilit**

ata i janë përmbajtur?”¹ Domethënë se këta duhet të kapen pas argumentit logjik për ta vërtetuar këtë pretendim ose ta argumentojnë me argument tekstual. Ndërkohë që për ata nuk gjendej as argument racional e as tekstual, sepse të gjitha argumentet logjike ftojnë në monoiteizëm. Po ashtu edhe thirrjet e të gjithë Profetëve dhe librat qiellorë ftojnë në Njehsimin e All’Ilahut.

Ajeti i fundit prej këtyre ajeteve tregon për justifikimin e tyre, që në të vërtetë mbetet vetëm legjendë e asgjë tjetër. Kjo legjendë u bë bazë e një tjetër legjende, që thotë: **“Jo, por ata thonë: ‘Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhene po ndjekim gjurmët e tyre.’”**.

Ata nuk kishin asnjë argument përveç imitimit (*et taklijd*) të verbër të të parëve, baballarëve dhe gjyshërve të tyre. Çudia qëndron në faktin se ata mendonin se janë të udhëzuar në këtë imitim, në një kohë kur asnjë njeri me logjikë të ftohtë, nuk mund të mbështetet te imitimi për çështjen e besimit dhe të doktrinës. Ne e dimë se baballarët e këtyre idhujtarëve nuk kishin asnjë fije diturie, mendjet e tyre ishin të mbushura me trillime e përfytyrime. Injoranca ishte gjykatësi ndaj mendimit dhe shoqërisë së tyre, siç e sqaron dhe ajeti 170 i sures “El Bekare”: **“Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në Rrugën e Drejtë?”**.

¹“Em” këtu është lidhëz. Ajo është e lidhur me “esh’hedu khalkahum”, kurse për emri në “min kablihi”, i referohet Kur’anit. Ajo që disa kanë supozuar se “em” këtu është ndërprerëse, apo se për emri i referohet të Dërguarit, nuk përshtatet shumë me kontekstet e këtij ajeti.

Imitimi (*et taklijdu*) lejohet vetëm në çështje dytësore. Gjithashtu, *taklidi* duhet të bëhet nga një dijetar. Që do të thotë: Referimi i të paditurit te i dituri, siç i referohet i sëmuri mjekut. Kështu që, në bazë të saj, *taklidi* i tyre është i kotë dhe i zbrazët nga argumentet.

Fjala "*el ummetu*", siç thotë Ragibi në librin "*El Mufredatu*", emërton atë grup, anëtarët e të cilit lidhen ngushtë me njëri-tjetrin, si nga ana e fesë, njëshmërisë së vendit dhe kohës. Nga këtu, kjo fjalë është përdorur ndonjëherë edhe me kuptimin e *medhhebit*, siç është rasti në ajetin në fjalë. Mirëpo, kuptimi i saj në origjinë është për *bashkësinë* dhe *kombin*. Përdorimi i kësaj fjale për *fenë* ka nevojë për argument.

Ajetet 23-25

وَكَذَلِكَ مَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ فِي قَرْيَةٍ مِنْ نَذِيرٍ إِلَّا قَالَ مُتْرَفُوهَا إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَارِهِمْ مُقْتَدُونَ^{٢٣} قَالَ أُولُو جِثَّتِكُمْ بَاهْذَىٰ مِمَّا وَجَدْتُمْ عَلَيْهِ آبَاءَكُمْ قَالُوا إِنَّا بِمَا أُرْسِلْتُمْ بِهِ كَافِرُونَ^{٢٤} فَانْتَقَمْنَا مِنْهُمْ فَانْظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكْذِبِينَ^{٢٥}

“Po ashtu, në çdo vend që Ne kemi dërguar paralajmërues para teje, pasanikët e atij vendi thonin: ‘Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre.’”

“(Çdo i Dërguar) thoshte: ‘Po sikur unë t’ju kem sjellë (një fe) më të ndriçuar se ajo e të parëve tuaj?!’ Ata thonin: ‘Ne e mohojmë mesazhin me të cilën jeni dërguar!’”

“Atëherë, Ne hakmerreshim kundër atyre, prandaj shiko si ka qenë përfundimi i femohuesve.”

Komentimi

Dënimi i këtyre imituesve

Këto ajete vazhdojnë temën e ajeteve të mëparshme rreth argumentit kryesor të idhujtarëve për adhurimin e putave, që ishte traditë e të parëve të tyre. Ajetet thonë: Pa dyshim që ky është një pretendim i kotë dhe i dobët nga idhujtarët arabë: **“Po ashtu, në çdo vend që Ne kemi dërguar paralajmërues para teje, pasanikët e atij vendi thonin: ‘Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre.’”**.

Nga ky ajet mësohet se kundërshtarët janë për luftë ndaj Pejgamberit. Ata flisnin për çështjen e traditës së baballarëve dhe e mbronin atë me të gjitha forcat. Ata jetonin në luks, ishin të pasur dhe mendjemëdhenj. Fjala *“el mutrifu”* vjen nga lënda: *“et tereffuhu”*, që do të thotë një begati shumë e madhe. Meqenëse shumica e atyre që kishin shumë begati mbyteshin në kënaqësi dhe pasione, atëhetë, fjala *“el mutrifu”* i referohet njeriut që bën *zullum me begatinë* dhe mbytet në dehjen e saj, bëhet mendjemadh.¹ Provë për këtë janë më së shumti mbretërit, të fortët dhe pasanikët mendjemëdhenj e egoistë.

Këtyre u kërcënohen interesat dhe egoizmi me revolucionin e Pejgamberëve, u rrezikohet pasuria e tyre e paligjshme, sepse ndodh çlirimi i të dobtëve nga kthetrat e tyre.

¹Lexojmë në gjuhën arabe: *“etrefehu en nimet”*, domethënë: pasuria e ka bërë tiran.

Prandaj, ata përpiqeshin t'i hutonin njerëzit dhe t'i mbanin në injorancë me lloj-lloj metodash e mashtrimesh. Pjesa më e madhe e shkatërrimeve në botë buron nga këta shkapërdarë, të cilët ekzistojnë në vendet e padrejtësisë, armiqësisë, kundërshtimit, shkatërrimit dhe poshtërsisë.

Në ajetin e mëparshëm u përmend se këta ishin mësuar të thonin: **"...Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe ne po ndjekim gjurmët e tyre."**, kurse këtu, Kur'ani përmend se ata thonë: **"...dhe po ndjekim gjurmët e tyre."** Pavarësisht se të dyja mënyrat e të shprehurit i referohen një kuptimi të vetëm, shprehja e parë dëshmon justifikimin preferencial të ideologjisë së të parëve, ndërsa shprehja e dytë dëshmon vendosjen dhe qëndrimin e tyre në ndjekje të të parëve dhe orientimin në gjurmët e tyre.

Sido që të jetë, ky ajet është një lloj qetësimi për mendjen dhe zemrën e Pejgamberit më të nderuar të besimtarëve, të cilët duhet ta dinë mirë, se justifikimet e idhujtarëve dhe argumentimet e tyre nuk janë ndonjë gjë e re, dhe se këtë rrugë kanë përzgjedhur të gjithë të shmangurit dhe të humburit gjatë gjithë historisë.

Ajeti që vjen më pas sqaron me qartësi të plotë përgjigjen e Pejgamberëve të mëparshëm për justifikimet e idhujtarëve dhe të të shmangurve: **"(Çdo i dërguar) thoshte: 'Po sikur unë t'ju kem sjellë (një fe) më të ndriçuar se ajo e të parëve tuaj?!'"**¹

¹Në këtë fjali ka një të fshehtë dhe aludimi i saj është: *"A po ndiqni të parët tuaj, edhe pse ju kam sjellë një fe më të mirë sesa feja e të parëve tuaj?"*; tefsiri "El Kesh'shaf", tefsiri "El Meragij", tefsiri "El Kurtubij" dhe tefsiri "Ruhul Meanij".

Kjo mënyrë të shprehuri është një nga shprehitë më edukative që mund të shtrohet para një kombi kokëfortë dhe mendjemadh, që nuk i plagos e as që i prek ndjenjat e tyre. Kjo shprehje nuk u thotë atyre që ajo që ju thoni është gënjeshtër dhe trillim por u thotë se ajo që ju kam sjellë, është më e mirë, më e udhëzuar sesa feja e të parëve tuaj! Ejani dhe shikoni në të dhe informohuni për të.

Këto mënyra të shprehuri kur'anore na mësojnë kulturën e dialogut dhe të debatit, në mënyrë të veçantë me injorantët mendjemëdhenj.

Ata ishin aq të mbytur prej injorancës, fanatizmit dhe kokëfortësisë, saqë edhe kjo fjalë tejet e kulturuar, nuk ndikoi aspak, por iu përgjigjën Pejgamberëve vetëm me një thënie: **"...Ata thonin: 'Ne emohojmë mesazhin me të cilën jeni dërguar!'"**, pa sjellë asnjë argument për kundërshtimin e tyre dhe pa e parë fare propozimin logjik, të fortë e thelbësor të Pejgamberëve të All'llahut dhe të Dërguarve të Tij.

Këta popuj mizorë e kokëfortë nuk e meritojnë qëndrimin, nuk e meritojnë jetën, prandaj është i domosdoshëm që të zbresë dënimi i All'llahut, t'i shkulë këto probleme nga rruga dhe ta pastrojë atë prej tyre.

Për këtë, ajeti i fundit thotë: **"Atëherë, Ne hakmerreshim kundër atyre..."**, një pjesë prej tyre me tufan, të tjerët me një tërmet shkatërrues, kurse një grup tjetër me ciklonë dhe rrufe. Përmbledhja e thënies është se Ne kemi shkatërruar çdo grup prej tyre, jobesimtar e kokëfortë, me një urdhër të prerë, të ashpër dhe i shkatërruam ata plotësisht.

Së fundi, ajeti i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me qëllim që të marrin mësim idhujtarët e Mekës, teksa thotë: “...**prandaj shiko si kaqenë përfundimi i femohuesve.**”; pra, edhe idhujtarët kokëfortë të Mekës, le të presin të njëjtin fund të dhimbshëm.

Ajetet 26-30

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ ۖ إِلَّا الَّذِي
فَطَرَنِي فَإِنَّهُ سَيَهْدِينِ ۚ وَجَعَلَهَا كَلِمَةً بَاقِيَةً فِي عَقِبِهِ لَعَلَّهُمْ
يَرْجِعُونَ ۚ بَلْ مَتَّعْتُ هَؤُلَاءِ وَآبَاءَهُمْ حَتَّىٰ جَاءَهُمُ الْحَقُّ وَرَسُولٌ
مُبِينٌ ۚ وَلَمَّا جَاءَهُمُ الْحَقُّ قَالُوا هَذَا سِحْرٌ وَإِنَّا بِهِ كَافِرُونَ ۚ

“(Kujto) kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: Në tëvërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuroni ju;”

“në vend të Atij, që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në Rrugën e Drejtë.”

“Ai e bëri këtë fjalë të përhershme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata të kthehen (vazhdimisht tek All’llahu).”

“Kurse Unë i lashë të kënaqen këta dhe etërit e tyre, derisa u erdhi e Vërteta (Kur’ani) dhe i Dërguari, që ua bëri të qarta.”

“Por, kur u erdhi e Vërteta, ata thanë: Kjo është magji dhe ne sigurisht që këtë nuk e besojmë!”

Komentimi

Njehsimi është fjala e përjetshme e Profetëve

Këto ajete paraqesin në mënyrë të përmbledhur historinë e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe se çfarë ndodhi me të dhe kombin Babil, që ishin adhurues të putave, për të plotësuar me të komentin e qortimit të imitimit (*et taklijdu*), që u përmend në ajetet e kaluara. Kjo për shkak se:

Së pari: Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte gjyshi më i madh i arabëve. Këta të fundit e vlerësonin dhe e nderonin shumë atë, e shenjtëronin dhe mburreshin me historinë e tij. Nëse ky besim i tyre dhe këto fjalë kanë qenë të vërteta dhe të sinqerta, atëherë ata e kanë për detyrë që ta ndjekin atë, edhe kur ai grisi perden e traditës. Nëse rruga e tyre ishte imitimi i të parëve, atëherë përse imitojnë adhurimin e putave dhe nuk ndjekin shembullin e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Së dyti: Adhuruesit e putave u mbështetën fort mbi këtë argument të dobët, siç është ndjekja e gjurmëve të të parëve. Këtë gjë, Ibrahim nuk e ka pranuar kurrë prej tyre, siç thotë dhe Kur'ani Kerim në suren "Enbija", ajetet 53 dhe 54: "**Ata thanë: 'I gjetëm të parët tanë, që po i adhuronin'. Ai u tha: 'Edhe të parët tuaj, edhe ju ishit në humbje të qartë.'**".

Së treti: Ky ajet është një lloj përmirësimi për zemrën e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet eAll'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanëve të parë, që të dinë mirë shembullin e atyre kundërshtimeve me kërkimin e faljes dhe

justifikime të kota, të cilat kanë qenë gjithmonë të pranishme, prandaj ata nuk duhet të lëshohen dhe as të mërzhiten.

Ajeti i parë thotë: “(Kujto) **kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: Në tëvërtetë, Unë i urrej dhe s’kam të bëj fare me ato që adhuron ju.**”. Meqenëse kishte shumë adhurues të putave që, gjithashtu, adhuronin All’llahun, Ibrahim bëri menjëherë përjashtim dhe tha: “**...në vend të Atij, që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në Rrugën e Drejtë.**”.

Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) përmend në këtë thënie të përmbledhur, një argument se adhurimi i takon vetëm All’llahut të Lartësuar, sepse, i adhuruar është vetëm Krijuesi dhe Projektuesi. Të gjithë ishin të bindur se Krijuesi është All’llahu i Madhëruar. Për këtë, me këtë thënie, Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon çështjen e udhëzimit të All’llahut *tekuinij* (që në krijim) dhe udhëzimin *teshriij* (legjislativ).¹

Ky kuptim përmendet, gjithashtu, edhe në suren “Shuara” ajetet 77 - 82.

Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ka qenë vetëm nga ndihmësit e zanafillës së Njehsimit dhe luftimit të idhujtarisë gjatë jetës së tij, por ai i shpenzoi të gjitha energjitë e tij, me qëllim përjetësimin e fjalës së Njehsimit përgjithmonë në këtë botë, siç e qartëson ajeti që vijon, kur thotë: “**Ai e bëri këtë fjalë të**

¹Sipas këtij komenti, përjashtimi në fjalinë “**përveç Atij që më krijoi mua**”, është i lidhur me faktin se shumica e adhuruesve të putave nuk ishin mohues të All’llahut; përkundrazi, ata shoqëronin bashkë me Të tjetër kënd. Vetëm se ai supozoi që përjashtimi të jetë i ndarë. Kurse “*il’la*” ka kuptimin *mirëpo*, sepse shprehja “*ma ta’budune*” lidhet me *statujat*. Kjo mënyrë të shprehuri është e pazakontë për All’llahun e Madhëruar. (Mendo thellë!)

përhershme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata të kthehen (vazhdimisht tek All'llahu).".¹

Interesante është se të gjitha fetë që flasin për Teuhidin sot, frymëzohen nga mësimet njehsuese të Profetit Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*). Tre nga Profetët e mëdhenj të All'llahut, që janë: Musai, Isai dhe Muhammedi (*Paqja qoftë mbi ta!*), janë pasardhësit e Profetit Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*). Ky është argument i vërtetësisë së Kur'anit në këtë kapitull.

Është e vërtetë se Profetët para Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*), si Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*), e kanë luftuar idhujtarinë dhe paganizmin dhe e kanë ftuar njerëzimin në Njehsim, besimin në një Zot, por ai që i ka dhënë kësaj fjale stabilitet të fortë, madje dhe ka ngritur flamurin e saj në çdo vend, ishte Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*), shkatërruesi i statujave. Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk është ndalur vetëm në vazhdimësinë e vijës së Teuhidit për kohën e tij, por ka kërkuar vazhdimin e kësaj çështjeje nga All'llahu i Madhëruar në lutjet e tij, ku thotë: **"...dhe më mbro mua dhe bijtë e mi nga adhurimi i idhujve."**²

Ka edhe një koment tjetër, që është se: përemri tek "*xheale*", i referohet All'llahut të Madhëruar, kështu që kuptimi i fjalisë bëhet: me të vërtetë, All'llahu i Madhëruar e ka vënë fjalën e Teuhidit në familjen e Ibrahimit.

Në anën tjetër, është referimi i përemrit ndaj Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*), për të cilin komenti i parë duket më i përshtatshëm, sepse fjalitë e mëparshme flasin për të. Është

¹ Fjala "*el akab*" në rrënjë ka kuptimin *nyjës së këmbës*. Mirëpo kjo fjalë më pas është përdorur për fëmijët dhe për fëmijët e fëmijëve.

² Sure "Ibrahim", ajeti 35.

normale që kjo pjesë të jetë e të gjitha veprave të Ibrahimit, sidomos kur ai e vërteton këtë kuptim në shumë ajete të Kur'anit Kerim. Ibrahim i ishte shumë i vendosur në atë që bijtë dhe pasardhësit e tij të qëndrojnë në fenë e All'llahut, siç e lexojmë në dy ajetet 131, 132 të sures "El Bekare": **"Kur Zoti i vet i tha atij: 'Dorëzohu!' Ai tha: 'I jam dorëzuar Zotit të Gjithësisë!'. E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), edhe Jakubi. (U thanë): O bijtë e mi, All'llahu ua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë!"**.

Mendimi se *"xheale"* do të thotë *krijim*, se kjo është e specifikuar për All'llahun e Madhëruar, është një mendim i gabuar, sepse *"el xha'lu"* është fjalë që emërton, gjithashtu, *veprat e njerëzve* dhe të tjerëve veç tyre. Gjithashtu, në Kur'an ka shumë shembuj për këtë. Kur'ani e përmend hedhjen e Jusufit në pus nga ana e vellezërve të tij, me fjalën *"el xhealu"* ku thotë: **"...Pasi e morën, vendosën që ta hidhnin në fund të një pusi..."**.¹

Nga sa thamë, bëhet e qartë se përemri i kundrinorit në *"xhealeha"* i referohet fjalës së Teuhidit dhe dëshmisë *"nuk ka tjetër Zot veç All'llahut"*. Kjo përfitohet nga fjalia: **"...Në tëvërtetë, Unë i urrej dhe s'kam të bëj fare me ato që adhuronin ju"**, e cila lajmëron për përpjekjet e Profetit Ibrahim që vija e Teuhidit të vazhdojë në brezat e ardhshëm.

Kanë ardhur transmetime të shumta nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), të cilët e konsiderojnë referimin e përemrit të imamati (udhëheqësia). Sikurusht që përemri veprues i referohet All'llahut, sepse All'llahu i Madhëruar e ka vendosur çështjen e udhëheqjes së vazhdueshme të pasardhësit të Ibrahimit (*Paqja qoftë*

¹ Sure "Jusuf", ajeti 15.

mbi të!), siç përftohet nga ajeti 124 i sures “ElBekare”. All’llahu i ka thënë Ibrahimit: **“Unë do të të bëj ty Imam (prijës) të njerëzve”**, ndërsa Profeti Ibrahim (*Paqja qoftë mbi të!*) ka kërkuar që edhe bijtë e tij të jenë gjithashtu prijës. All’llahu iu përgjigj lutjes së tij, me përjashtim të atyre që kanë bërë padrejtësi dhe janë ndotur me mëkate e mizori: **“‘Unë do të të bëj ty Imam (prijës) të njerëzve.’ – ‘Po pasardhësit e mi?’” - pyeti ai. All’llahu tha: ‘Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.’”**.

Mirëpo, që në shikim të parë të ajetit lind paqartësia në mendje e cila është: Ajeti në fjalë nuk flet për udhëheqësinë (el imametu), vetëm nëse fraza *“se jehdini”*, **“dhe i Cili do të më udhëzojë në Rrugën e Drejtë”**, është treguese e këtij kuptimi, sepse udhëzimi i Profetit dhe i Imamëve është një dritë nga udhëzimi Absolut i All’llahut.

Këtu, më mirë do ishte që të thuhej: Në të vërtetë, çështja e prijësisë (imamatit) është e ndërthurur brenda fjalës së Njehsimit, sepse për Teuhidin ka degë dhe njëra prej tyre është Teuhidi në sundim, udhëheqje dhe prijësi. Ne e dimë se vilajeti dhe udhëheqësia e Imamëve është nga All’llahu. Kjo nuk do të thotë se ata janë të pavaruar në vetvete. Këto transmetime konsiderohen prej sqarimit të së vërtetës dhe degë e kuptimit të përgjithshëm të fjalisë: **“Ai e bëri këtë fjalë të përhershme...”**. Për këtë, nuk gjendet kundërshti me komentimin që përmendëm në fillim. (Mendo!)¹

¹ Këto hadithe i ka transmetuar autori i tefsirit “Nuruth Thekalejn” në vëll. 4, f. 596 dhe 597. Janë përmendur, gjithashtu, edhe në tefsirin “El Burhan”, vëll. 4, f. 138, 139.

Dhe duhet përmendur këtu se komentuesit kanë hedhur disa hipoteza për shprehjen **“te pasardhësit e tij”**. Disa studiues e kanë komentuar se bëhet fjalë për të gjithë pasardhësit e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe familjes së tij, disa të tjerë e kanë konsideruar më specifike, për kombin e Ibrahimit dhe ymetin e tij, kurse një grup e ka komentuar për familjen e Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Është më se e dukshme që ajo ka një kuptim më të gjerë, që përfshin të gjithë pasardhësit e tij, gjer në fund të botës.

Në ajetin në vijim vjen edhe përgjigjja rreth pyetjes së një të vërtete, e cila është: Në një situatë të tillë, përse nuk i dënoi All'llahu idhujtarët e Mekës? A nuk kemi lexuar në ajetet e mëparshme, që thuhet: **“dhe Ne u hakmorrëm ndaj tyre”**?

Ajeti përgjigjet: **“Kurse Unë i lashë të kënaqen këta dhe etërit e tyre, derisa uerdhi e Vërteta (Kur'ani) dhe i Dërguari, që ua bëri të qarta.”**, se Ne nuk u mjaftuam me forcën e logjikës për shkatërrimin e idhujtarisë dhe paganizmit, as me forcën e ndjenjës së tyre me **Teuhidin**, por u dhamë atyre mundësi që të plotësonin justifikimin, derisa të zbriste ky libër, të cilit nuk i vishet e kota as para e as mbrapa, e të vinte ky Pejgamber, Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për udhëzimin e tyre.

Fjalja: **“me qëllim që ata të kthehen** (vazhdimisht tek All'llahu)”, në ajetin e mëparshëm tregon se qëllimi i përpjekjeve të nxituara të Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte rikthimi i pasardhësve të tij në vijën e Njehsimit, në një kohë kur arabët pohonin se ata janë nga pasardhësit e Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*). Pavarësisht kësaj, ata nuk u kthyen, por All'llahu i

Madhëruar u dha edhe një shpresë tjetër, derisa t'u vinte Pejgamberi i madh me librin e ri, për t'i zgjuar nga gjumi. Dhe, në të vërtetë, një pjesë e madhe u zgjuan nga gjumi.

Por është e çuditshme se: **“Por, kur u erdhi e Vërteta, ata thanë: Kjo është magji dhe nesigurisht që këtë nuk e besojmë!”**.

Ata e konsideruan Kur'anin e Lavdishëm një magji, kurse Pejgamberin më të Nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si magjisttar. Nëse nuk e tërheqin mbrapsht atë që thanë, dënimi i All'llahut do t'i përfshijë dhe do t'i kapë aty ku nuk ua merr mendja.

Ajetet 31-32

وَقَالُوا لَوْلَا نُزِّلَ هَذَا الْقُرْآنُ عَلَى رَجُلٍ مِنَ الْقَرْيَتَيْنِ عَظِيمٍ ۚ أَهُمْ
يَقْسِمُونَ رَحْمَتَ رَبِّكَ نَحْنُ قَسَمْنَا بَيْنَهُمْ مَعِيشَتَهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا
وَرَفَعْنَا بَعْضَهُمْ فَوْقَ بَعْضٍ دَرَجَاتٍ لِيَتَّخِذَ بَعْضُهُمْ بَعْضًا سُخْرِيًّا
وَرَحْمَتُ رَبِّكَ خَيْرٌ مِمَّا يَجْمَعُونَ ۚ

“Ata thanë: Sikur t’i kishte zbritur ky Kur’an ndonjë njeriu të madh prej njërit nga këto dy qytete.”

“Vallë, a mos janë ata që e ndajnë mëshirën e Zotit tënd? Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët, me qëllim që disa t’u shërbejnë të tjerëve. Mëshira e Zotit tënd është më e mirë nga ajo që grumbullojnë ata.”

Komentimi

Pse nuk i ka zbritur Kur'ani ndonjë të pasuri?

Në ajetet e mëparshme flitej rreth justifikimeve të idhujtarëve me përballjen e thirrjes së Pejgamberëve, të cilët i akuzonin ata, një herë për magji dhe një herë tjetër e përdornin si mjet justifikimi të traditës së të parëve, duke hedhur pas krahëve fjalën e All'llahut. Ajetet e kapitullit që diskutojmë, tregojnë për një justifikim tjetër të dobët të idhujtarëve, të cilët thonë: **“Ata thanë: Sikur t'i kishte zbritur ky Kur'an ndonjë njeriu të madh prej njerit nga këto dy qytete.”**, domethënë Meka dhe Taifi.

Nga njëra anë, ata quheshin të shfajësuar në besnikërinë e tyre me këtë lloj justifikimi, pasi standardi në vlerësimin e tyre ishte pasuria, paraja, pozita e dukshme dhe popullariteti.

Në të vërtetë, këta mendjengushtë mendonin se pasanikët dhe kryetarët zullumqarë të fiseve të tyre ishin njerëzit me të afërt të All'llahut të Madhëruar, kështu që ata habiteshin që nuk zbriti dhurata e madhe Profetike dhe mëshira e All'llahut mbi burra si ata, por zbriti mbi një jetim të varfër e duarthatë, që quhej Muhammed. Për ta, kjo ishte diçka e habitshme, që nuk mund të besohej!

Sistemi i drejtësisë së shkelur e mëkatar kërkon që të ndiqet shembulli i këtij derivimi. Ky është edhe shkak i fatkeqësive të mëdha për shoqërinë njerëzore, madje është faktori kryesor në shmangien ideologjike, që ndonjëherë i ndryshon plotësisht të vërtetat.

Mbajtësi i thirrjes së All'llahut duhet të jetë një njeri, shpirti i përkushtimit të të cilit paguan gjobën e ekzistencës së tij. Ai duhet të ishte një njeri syçelët, i vetëdijshëm, me vullnet dhe vendosmëri, trim, i drejtë, njohës i dhimbjeve të të refuzuarve dhe të shtypurve.

Këto janë vlera që e bëjnë të detyrueshme gatishmërinë për hir të bartjes së Kumtit Hyjnor, jo rrobat luksoze e të shtrenjta, kështjellat madhështore e të bukura, zbukuruar me stoli e bukuri të shumta. Secili prej Pejgamberëve të All'llahut nuk ka qenë i plotësuar në mënyrë të veçantë, me kësoj cilësish dhe të mirash materiale, që të mos përngjasojnë vlerat origjinale me vlerat e rreme.

Nga komentues të ndryshëm ka thënie të shumta për synimin e idhujtarëve, se kush është njeriu i Mekës dhe kush i Taifit.

Shumica e tyre kanë konsideruar Velid ibn Mugiren si njeriun e Mekës dhe Urve ibn Mesud EthThekafij si njeriun e Taifit. Disa të tjerë kanë përmendur se Atabetu ibn Rebiatu është prej Mekës, kurse Habib ibn Omer Eth Thekafij prej Taifit.

Është më se e dukshme që fjala e këtyre idhujtarëve nuk sillet përreth një njeriu të caktuar, përkundrazi, qëllimi i tyre ishte të tregonin njërin prej të pasurve të njohur, që kishte një rreth të njohur për qark vetes.

Kur'ani Kerim i përgjigjet prerë kësaj mënyre të menduari, përbuzëse dhe trilluese. Në fillim thotë: **“Vallë, a mos janë ata që e ndajnë mëshirën e Zotit tënd?...”**; pra, që mund t’ia japin

profecinë kujt të duan, t'i zbresin atij librin qiellor, madje nëse atyre nuk u pëlqen një njeri, e lënë mënjanë atë?

Këta bëjnë një gabim të madh, se në të vërtetë, Zoti yt është Ai që ndan mëshirën e Tij. Ai e di më mirë se kushdo tjetër, se cili e meriton këtë pozitë madhështore dhe cili është i mirëpritur për të, siç dhe thuhet në ajetin 124 të sures "En'am": **"Më së miri, All'illahu e di ku ta vërë Dërgesën (Risaletin) e Vet."**

Kontrasti dhe ndryshimi midis njerëzve për nga ana e standardit të jetesës, nuk tregon në mënyrë absolute kontrastin e tyre në pozitë dhe nivelet jolëndore dhe abstrakte, përkundrazi: **"...Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët, me qëllim që disa t'u shërbejnë të tjerëve..."**.

Jeta e njeriut është jetë sociale, shoqërore, bashkësie, kështu që nuk mund të ecë, përveçse nëpërmjet bashkëpunimit dhe shërbimit të ndërsjellë. Nëse nuk barazohen të gjithë njerëzit në standardin e jetesës, kapaciteteve dhe pozitës së tyre shoqërore, atëherë baza e bashkëpunimit dhe shërbimit të ndërsjellë do të lëkundet, do të shembet.

Bazuar mbi këtë, ata nuk duhet t'i mashtrojnë ky kontrast, por duhet të mendojnë se ai është standardi i vlerave njerëzore. All'illahu thotë: **"...Mëshira e Zotit tënd është më e mirë nga ajo që grumbullojnë ata."** Të gjitha pozitë dhe pasuritë nuk krahasohen as me krahëzat e një mize përballë mëshirës së All'illahut dhe afrimit të Tij.

Në të vërtetë, mënyra e të shprehurit me fjalën "*rabbike*", e cila përmendet dy herë në këtë ajet, është një sinjal i

mrekullueshëm i mirësisë së veçantë të All'Ilahut ndaj Profetit, i dhënies së pozitës së Profetit dhe vulës profetike.

Dy përgjigje të rëndësishme

Për studimin e ajetit të mësipërm rrjedhin dy pyetje. Të dyja i përdorin armiqtë e Islamit si bajoneta shpifjeje për filozofinë islame:

E para: Si e ka vendosur Kur'ani përdorimin e njeriut dhe nënshtrimin e tij po nga ana e njeriut? A nuk i ngjason ky sistemi të niveleve ekonomike, domethënë sistemit të investuesve dhe investimeve?

E dyta: Nëse begatitë dhe mënyrat e jetesës janë të ndara prej All'Ilahut të Madhëruar, atëherë çfarë fryti mund të prodhohet nga mundimet dhe përpjekjet tona? A nuk nënkupton kjo, shuarje të vatrave të përpjekjes dhe llampadarëve të mundimit, të luftës në emër të jetës?

Përgjigja për këto dy pyetje sqarohet në mënyrë shterruese nga teksti i ajetit, sepse ata mendonin se kuptimi i ajetit është se një grup i caktuar prej njerëzve vë në shërbimin e vet një grup tjetër me një shërbim zullumqar e gjakpirës. Ndërkohë që çështja nuk është e tillë. Përkundrazi, shërbimi i njerëzve me njëri-tjetrin ka kuptimin që çdo grup njerëzish ka potenciale dhe përgatitje të veçanta, kanë mundësi të punojnë normalisht sipas situatës në një nga fushat e jetës, kështu që ata ua paraqesin shërbimet e tyre të tjerëve, ashtu sikurse shërbimet e të tjerëve në fusha të tjera, u paraqiten atyre.

Përmbledhje: Këtu bëhet fjalë për përdorim të ndërsjelltë, një shërbim që ka dy anë. Qëllimi i fjalës së nënshtrimit është bashkëpunimi në çështjet e jetës dhe asgjë tjetër.

Sikur njerëzit të ishin të gjithë të barabartë për nga ana e zgjuarsisë dhe përgatitjes shpirtërore e trupore, atëherë nuk do të mund të plotësoheshin nevojat e jetës shoqërore dhe sistemet jetësore, ashtu si dhe qelizat e trupit të njeriut nëse do të ishin të ngjashme për nga ana e ndërtimit, finesës dhe imunitetit, do të shkatërronin sistemin e trupit, sepse dallojnë qelizat e kockave të forta të nyjes së këmbës nga qelizat mikroskopike të syrit. Pa dyshim se, për të dyja këto ka një funksion të posaçëm, për të cilin dhe janë krijuar.

Shembull i gjallë për këtë temë janë shërbimet e ndërsjellta të aparatit të frymëmarrjes, qarkullimi i gjakut, ushqyerja, të gjithë aparatet e trupit të njeriut, të cilat janë një konfirmim i qartë i shprehjes “...me qëllim që disa t’u shërbejnë të tjerëve...”, në kornizën e veprimtarive të brendshme trupore. A është i mundur paradoksi në këtë lloj nënshtrimi? A ka në të defekt dhe mangësi?

Nëse thuhet fjalia: “...duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët...”, ky është një argument i mungesës së drejtësisë shoqërore...

Themi: Kjo është e vërtetë në situatën e komentimit të drejtësisë me barazi, ku drejtësi do të thotë vendosja e çdo gjëje në vendin e vet, brenda sistemit të tij, por a është zinxhiri i autoriteteve dhe gradave në hierarkinë ushtarake, në një organizatë drejtuese, qoftë dhe në shtet, një argument i ekzistencës së padrejtësisë në ato sisteme?

Disa njerëz e përdorin fjalën “barazi” në fushën e sloganeve, pa e kthyer kokën nga kuptimi real i saj. Kjo diferencë nuk duhet të jetë justifikim që njeriu të mashtrojë vëllain e tij të vërtetë, përkundrazi, të gjithë duhet të jenë të lirë në përdorimin e forcave të tyre krijuese, të zhvillimit të gjenialitetit dhe aftësisë shpikëse, të përfitojnë nga rezultatet e veprimtarive të tyre pa shtuar dhe pakësuar gjë, kështu që përgjatë dobësimit të një pjese prej tyre, ata që janë më të aftë duhet të përpiqen dyfish në eliminimin e mangësive, defekteve dhe përmbushjen e nevojave të tyre.

Për sa i përket pyetjes së dytë: Si është e mundur ruajtja e flakës së përpjekjes dhe mundimit tenjeriu, duke qenë se rizku dhe begatia janë të përcaktuara? Dyshimi që lind nga mendimi i tyre është se, All’llahu i Madhëruar nuk i ka bërë përpjekjes së njeriut dhe mundimeve të tij asnjë ndikim e asnjë rol.

Është e vërtetë që All’llahu i Madhëruar ka krijuar aftësitë e ndryshme për veprimtari të ndryshme. Është e vërtetë se faktorët që ndodhen jashtë vullnetit të njeriut janë ndikues në rrugën e jetës së tij, megjithatë, All’llahu i Madhëruar e ka bërë përpjekjen dhe mundimin e tij (njeriut), një nga faktorët bazë. I Madhërishmi e ka bërë të qartë dhe ka thënë: **“Dhe se njeriut nuk i takon tjetër, vetëm se ajo që ka punuar”**¹, se lumturia e njeriut, ajo që vjeldhe fiton, lidhen me përpjekjen dhe mundimin e tij.

Sido që të jetë, njerëzimi nuk është si enët e barabarta, të cilat janë prodhuar në një fabrikë dhe formë të vetme, në një stil të vetëm, me një përmasë të vetme dhe me qëllimin e një përdorimi

¹ Sure “Nexhm”, ajeti 39.

të vetëm. Sikur të ishin të tillë, atyre nuk do t'u mundësohej bashkëjetesa me njëri-tjetrin as dhe për një ditë të vetme.

Gjithashtu, njerëzit nuk janë njëlloj si aparaturat apo pjesët e një makine, të cilën inxhinieri e ka ndërtuar në një formë të caktuar, që bëjnë punën e tyre në mënyrë të detyruar. Përkundrazi, njerëzit kanë lirinë e vullnetit, kanë një përgjegjësi dhe detyrë. Në të njëjtën kohë, ata ndryshojnë në kapacitetet. Pikërisht ky, është ai përbërësi i veçantë, të cilin e quajmë *Njeri*. Kundërthëniet që shtrohen, në shumicën e rasteve burojnë nga mosnjohja e njeriut.

Përmbledhja e fjalës: All'llahu i Madhërueshëm nuk ka parapëlqyer një njeri para të tjerëve. Fjala "**...duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët...**", tregon veçoritë me të cilat dallohet një grup ndaj një grupi tjetër, nënshtrimit të një grupi ndaj grupit tjetër. Përdorimi i fjalisë e ka buriminte këto veçori. E kjo është vetë drejtësia, projektimi dhe urtësia.¹

¹Kemi bërë një koment të hollësishëm në fundin e ajetit 32 të sures "Nisa" dhe një komentim tjetër në fundin e ajetit 165 të sures "En'am".

Ajetet 33-35

وَلَوْلَا أَنْ يَكُونَ النَّاسُ أُمَّةً وَاحِدَةً لَجَعَلْنَا لِمَنْ يَكْفُرُ بِالرَّحْمَنِ
لَبِئُوتِهِمْ سُقْفًا مِنْ فِضَّةٍ وَمَعَارِجَ عَلَيْهَا يَظْهَرُونَ^{٣٣} وَلِبِئُوتِهِمْ أَبْوَابًا
وَسُرُرًا عَلَيْهَا يَتَكَبَّرُونَ^{٣٤} وَزُخْرُفًا وَإِنْ كُلُّ ذَلِكَ لَمَّا مَتَاعُ الْحَيَاةِ
الدُّنْيَا وَالْآخِرَةُ عِنْدَ رَبِّكَ لِلْمُتَّقِينَ^{٣٥}

“Dhe, sikur njerëzit të mos ishin një bashkësi mohuesish, Ne do t'i bënim prej argjendi çatitë e shtëpive të atyre që nuk besojnë në të Gjithëmëshirshmin, madje edhe shkallët nëpër të cilat ngjiten.”

“Edhe dyert e shtëpive të tyre, edhe divanet në të cilat mbështeten.”

“Dhe stoli. Por të gjitha këto janë vetëm kënaqësi të kësaj jete, kurse Jeta Tjetër te Zoti yt është për punëdrejtët që ruhen (nga gjynahet dhe nga dënimi i All'Ilahut).”

Komentimi

Kështjella luksoze me çati prej argjendi!! (vlera mashtruese)

Ajetet vazhdojnë me komentin rreth sistemit të vlerave në Islam dhe moskonsiderimin e pasurisë dhe të bollëkut material si standarde të vlerave. Ajeti i parë thotë: **“Dhe, sikur njerëzit të mos ishin një bashkësi mohuesish, Ne do t’i bënim prej argjendi çatitë e shtëpive të atyre që nuk besojnë në të Gjithëmëshirshmin...”**¹

Do t’u bënim atyre shtëpi me shumë kate dhe me shkallë të bukura: **“...madje edhe shkallët nëpër të cilat ngjiten.”**²

Disa komentues kanë thënë se nënkuptimi i fjalës është për shkallët e ndërtuara prej argjendi dhe mospërsëritja e fjalës “argjend”, është për të qartësuar qëllimin. Duket sikur ata nuk e kanë vlerësuar vetëm ekzistencën e shkallëve si një argument për rëndësinë e shtëpive. Por çështja nuk është e tillë, pasi ekzistenca e shkallëve të shumta është një argument i madhështisë së ndërtesës, ndarjes së saj në disa kate.

¹ Fraza “li bujutihim” – “për shtëpitë e tyre” është ndajshtrim i përfshirjes së “limen jekfur birrahmani”, që do të thotë: “për atë që nuk beson Zotin”. Përsëritja e shkronjës “lam” është për këtë kuptim, ose me kuptimin “ala”, domethënë: “ala bujutihim” – “mbi shtëpitë e tyre”, por supozimi i parë është më i drejtë.

² Fjala “el mearixh” është shumësi i “mi’raxh”, që është një mjet të cilin e përdor njeriu për t’u ngjitur në katet e sipërme.

Fjala “*es sukfu*” është shumësi i fjalës “*sakfun*”. Disa besojnë se është shumësi i “*sakifetun*”, që do me thënë *vendi me çati*, por thënia e parë është më e njohur.

Ajeti tjetër shton: **“Edhe dyert e shtëpive të tyre, edhe divanet në të cilatmbështeten.”**.

Mbase kjo fjali është tregues i dyerve dhe kolltuqeve prej argjendi, ngaqë ajeti i mëparshëm flet për çatitë prej argjendi. Mundet që të jetë ekzistenca e dyerve dhe kolltuqeve të shumta. Në mënyrë specifike janë përmendur këtu për të theksuar rëndësinë, si një argument i madhështisë së kështjellave, ngaqë ata nuk bëjnë për një shtëpi të vogël, të ulët. Dyert e shumta janë specifike për kështjellat dhe shtëpitë luksoze. Kështu është situata edhe për sa i përket pranisë së kolltuqeve.

Ajeti nuk mjaftohet me kaq. Ai largohet nga tema, duke thënë se përveç të gjithave, ne u kemi bërë atyre gjëra të këndshme, lloje të ndryshme zbukurimesh: **“Dhe stoli...”**¹, për të plotësuar jetën materiale si stoli dhe dekorime nga të gjitha anët, kështjella luksoze me shumë kate, dyer e kolltuqe, skulptura e piktura. Të gjitha këto gjëra tërheqëse vërtetojnë qëllimin e skllavërimit të dynjasë si garanci e tyre.

¹ Disa e kanë thënë se fjala “*zukhrufen*” – “*stoli*”, se është e lidhur me fjalën “*sakfen*” – “*çatitë*”, duke besuar se ato janë mjete të pavarura të zbukurimit, që vihen nën shërbimin e këtyre njerëzve. Ndërsa disa të tjerë e kanë thënë se është e lidhur me frazën “*min fidatin*” – “*prej argjendi*”. Në origjinë ka qenë “*min zukhruf*” – “*prej stolive*”, por në rasën kallëzore, me një heqje të lehtë, kuptimi i fjalisë bëhet: *Ne i kemi bërë disa çati dhe kolltuqe të shtëpive të këtyre prej ari, kurse një pjesë prej argjendi*.

Më tej, ajeti shton: “...Por të gjitha këto janë vetëmkënaqësi të kësaj jete, kurse Jeta Tjetër te Zoti yt është për punëdrejtët që ruhen (nga gjynahet dhe nga dënimi i All’llahut).”.

Fjala “ez zukhruf” në rrënjë ka kuptimin e çdo zbukurimi të shoqëruar me piktura dhe skulptura. Ari, një nga sendet më të rëndësishme të bukurisë, quhej me emrin *zukhruf, stoli*. Mirëpo kjo thuhet edhe për fjalën e zbrazët, që nuk ka dobi, “*kelamun muzekhref*”, do të thotë “*fjalë e kotë*”, se ata e mbështjellin dhe e veshin atë me stoli, që të jetë i pranueshëm.

Përmbledhja e fjalës: Këto baza materiale dhe këto mjete e zbukurimetë ulëta të dynjasë nuk kanë vlerë tek All’llahu i Madhëruar. Ato nuk duhet të jenë veçse pjesë e njerëzve të pavlerë siç janë jobesimtarët dhe mohuesit e së vërtetës. Sikur njerëzit të mos ndikoheshin nga kërkuesit e kësaj bote dhe të anonin nga mohimi, All’llahu do t’i caktontekëtovetëm për këtëgrup, që ta dinë të gjithë se këto punë nuk janë standard dhe etaloni personalitetit të njeriut, vlerës dhe pozitës së tij.

Dy hulumtime

1- Islami i shkatërron vlerat e gabuara

Në të vërtetë, nuk mund të gjendet një shprehje më serioze dhe më domethënëse sesa ajo që përmendet në ajetet e mësipërme

për shkatërrimin e standardeve dhe vlerave mashtruese, për ndryshimin e ndërtimit të shoqërisë, e cila rrotullohet rreth standardizimit të personalitetit të njerëzve në të, rreth sasisë së deveve, sasisë së arit e argjendit, numrit të djemve dhe vajzave, shtëpive e aksesoreve zbukurues. Kështu që ata habiteshin shumë, se përse u zgjodh Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për Profet, kur ai ishte jetim dhe i varfër në pasuri.

Puna më e rëndësishme e kumtit qiellor është shkatërrimi i mburrjeve, i këtyre vlerave të gabuara dhe ndërtimi i vlerave origjinale njerëzore mbi rrënojat e tyre, si: përkushtimi, dituria, altruizmi, sakrifica, zemërgjerësia dhe toleranca. Të gjitha reformat dhe riparimet do të jenë të vështira, sipërfaqësore dhe të paqëndrueshme.

Kjo është ajo që ka bërë Islami, Kur'ani dhe i Dërguari më i madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në mënyrë të përsosur. Për këtë arsye, shoqëria që ishte një nga shoqëritë njerëzore më të prapambetura, ngjiti shkallët e udhëzimit dhe triumfit, derisa u rendit në shkallën e parë për një kohë fare të shkurtër.

Është interesante se në një hadith nga Pejgamberi më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për plotësimin e këtij diskutimi, lexojmë: “*Sikur të peshonte tek All'llahu dynjaja sa një krah i mushkonjës, jobesimtari nuk do të pinte as edhe një gllënkë uji prej saj.*”¹

¹Tefsiri “El Keshshaf”, vëll. 4, f. 250.

Prijësi i besimtarëve, Aliu, e përcjell kuptimin e tij në këtë kapitull, ku thotë:

“...Kur Musai, i biri i Imranit, shkoi tek Faraoni së bashku me të vëllanë, Harunin, veshur në lesh të ashpër e me nga një shkop në dorë e i premtoi se do mbetej në vendin që kish e do t’i lejoheshin gjithë nderet, po të nënshtrohej, ky tha: ‘A nuk ju duken të çuditshëm këta dy njerëz, që më sigurojnë se nderet do vazhdojnë të më bëhen e vendi do më ruhet, ndonëse duket qartë varfëria e pozita e tyre e ulët? Po ta kishin këtë pushtet, do t’i kishin veshur kyçet e duarve me byzylyqe ari!’. Ai tha kështu nga krenaria për arin e koleksionet e tij dhe nga neveria që kishte për leshin dhe për veshjet e bëra prej tij. Po të kishte dashur Zoti t’u hapte Profetëve të Tij thesaret e akikut e të floririt e të mblidhte rreth tyre zogjtë e qiejve dhe bishat e dheut, mund ta kishte bërë një gjë të tillë qysh kur i nisi. Por po të kishte vepruar kështu, nuk do kishte më sprovë, as shpërblim, as lajme për punët e Botës Tjetër...”

“...A s’ju bën përshtypje që të gjithë njerëzit, që nga paraardhësit tanë, me Ademin të parin, e deri tek të fundmit në këtë botë, Zoti i ka sprovuar me gurin që nuk sjell as fitim dhe as dëm dhe që as sheh e as dëgjon? Pikërisht me këta gurë e ngriti Ai shtëpinë e Tij të Shenjtë, që e bëripër njerëzit vend të paqes e të sigurisë. Ai e ndërtoi atë shtëpi në pjesën më shkëmbore të Tokës, në një vend malor me fare pak dhé të butë, në luginat më të ngushta midis maleve të rrepta, në hapësirat e pamata me rërë të shkrifët, ku burimet janë të pakta dhe banorët të shpërndarë e të rrallë, ku nuk shtohen dot as devetë, as kuajt, as lopët, as delet dhe as gjë tjetër. Pastaj Ai e urdhëroi Ademin dhe bijtë e tijtë mos e hiqnin atë vend nga vëmendja. Kështu kjo shtëpi u bë pikënisja e udhëtimeve të tyre në kërkim të kullotave, si dhe vend qëndrimi për karvanet...”

“...Zoti mund ta kishte ngulur Shtëpinë e Tij të Shenjtë dhe simbolet e Tij të mëdha në mes të pemishteve të blerta, lumenjve, fushave të buta e

të rrafshhta plot pemë e bollëk frutash, me popullsi të dendur, me qendra të shumta banimi, me grurë të artë, kopshte të harlisura, lëndina të blerta, ara të ujitura, lulishte të lulëzuara dhe me rrugë të rrahura; por atëhere shpërblimi do të ishte më i paktë, sigurisht, për shkak të lehtësisë së këtij detyrimi..."¹

Në një situatë të tillë, njerëzit do të merreshin me vlerat sipërfaqësore e mashtruese, dhe nuk do t'i jepnin rëndësi vlerave reale hyjnore.

Baza e revolucionit islam është pikërisht ndryshimi i vlerave. Nëse myslimanët e sotëm vuajnë ende kushtet mbytëse dhe të vështira nën presionin e armiqve të ashpër xhelatë, kjo është për shkak të shmangies prej vlerave origjinale, mospërhapjes së vlerave dhe ndotjeve prej pirgjeve të injorancës, që gjendet me tepri mes tyre. Për fat të keq, është bërë pasuria dhe pozita në këtë botë, standardi i vlerësimit. Njerëzit kanë harruar diturinë, virtytin, përkushtimin, janë mbytur në detin e joshjeve dhe zbukurimeve materiale, janë bërë si të huaj për Islamin. Kështu, për sa kohë që situata do të vazhdojë të jetë e tillë, ata do të paguajnë garancinë e këtij mëkati të madh. Derisa nuk përpiqen të bëjnë diçka për të ndryshuar, duke filluar nga vlerat eprore të ekzistencës së tyre, ata nuk do t'i përfshijë mëshira e All'Ilahut dhe mirësia e Tij: **"All'Ilahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre."**²

¹"Nehxhul Belaga", hutbeja 192, hutbeja "El Kasiatu".

²Sure "Rra'd", ajeti 11.

2- Përgjigjja e një pyetjeje

Duke parë me kujdes ajetet e përmendura rreth degradimit të njerëzve nga zbukurimet e jashtme, stolive dhe pozitës materiale, vetvetiu lind kjo pyetje: Nëse e vërteta dhe e drejta, janë të tilla, atëherë përse Kur'ani thotë: **“Thuaj: ‘Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira, që All’lhu i krijoi për robtë e Vet?’ Thuaj: ‘Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në Ditën e Kiametit janë të posaçme për ta. Kështu i sqarojmë argumentet një populli që kupton.’”**¹

Apo siç shprehet diku tjetër: **“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani dhe pini e mos e teproni, sepse Ai (All’lhu) nuk i do ata që e teprojnë.”**² Atëherë, si harmonizohen këto dy grupe me ajetet?

Duhet ta kthejmë shikimin te përgjigjja, ku deklarohet ajo që synon ajeti, te kapitulli i diskutimit, që është shkatërrimi i vlerave mashtruese dhe të gabuara. Qëllimi është që njerëzit të mos e konsiderojnë dhe shohin personalitetin e njeriut që të përqendrohet dhe vlerësohet në emër të pasurisë dhe bukurisë së tij. Kjo nuk do të thotë se kapacitetet materiale janë diçka e keqe; përkundrazi, është e rëndësishme që të jenë thjesht aksesore dhe pamje e këndshme për shikimin, e jo një pikësynim apo qëllim në vetvete që duhet të arrihet.

Në të vërtetë, këto kapacitete janë me vlerë kur janë në kufijtë e pranueshëm dhe të përshtatshëm me situatën, larg çdo

¹Sure “A’raf”, ajeti 32.

²Sure “A’raf”, ajeti 31.

lloj teprie e shpërdorimi, jo duke ndërtuar kështjella prej floriri apo argjendi dhe duke depozituar pasuritë që përfiton prej tyre.

Këtu bëhet e qartë, se ekzistenca e një grupi jobesimtarësh dhe mizorësh me këto aftësi materiale, nuk është argument i pozitës së lartë të personalitetit të tyre në shoqëri, por as i ndalimit të besimtarëve prej saj, shijimit të saj brenda kufijve të pranueshëm, me kusht që të mos dëmtojë besimin dhe përkushtimin e tyre. Ky është mendimi dhe qëndrimi i vërtetë i Islamit dhe Kur'anit.

Ajetet 36-40

وَمَنْ يَعُشْ عَنْ ذِكْرِ الرَّحْمَنِ نُقِيضْ لَهُ شَيْطَانًا فَهُوَ لَهُ قَرِينٌ ۖ وَإِنَّهُمْ
لَيَصُدُّونَهُمْ عَنِ السَّبِيلِ وَيَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ مُهْتَدُونَ ۚ حَتَّىٰ إِذَا جَاءَنَا
قَالَ يَا لَيْتَ بَنِي وَبَيْنَكَ بُعْدَ الْمَشْرِقَيْنِ فَبِئْسَ الْقَرِينُ ۚ وَلَنْ
يَنْفَعَكُمْ الْيَوْمَ إِذْ ظَلَمْتُمْ أَنَّكُمْ فِي الْعَذَابِ مُشْتَرِكُونَ ۚ أَفَأَنْتَ
تُسْمِعُ الصُّمَّ أَوْ تَهْدِي الْعُمْى وَمَنْ كَانَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ۖ

“Atij që shmanget nga Këshilla e të Gjithëmëshirshmit (Kur’ani), Ne do t’ia caktojmë një djall, që do t’i bëhet shok i pandashëm.”

“Në të vërtetë, djajtë i shmangin jobesimtarët nga Rruga e Drejtë, ndonëse ata mendojnë se janë të udhëzuar drejt.”

“Dhe, kur të vijë te Ne, (jobesimtari) do t’i thotë (djallit që ekishte shok): ‘Ah, sikur të kishte qenë largësia midis meje dhe teje sa ajo mes lindjes e perëndimit! Sa shok i keq paske qenë ti!’”

“(Atyre do t’u thuhet): Nuk do t’ju bëjë dobi (pendimi) juve sot, sepse ju u larguat nga e vërteta dhe humbët. Me të vërtetë, ju jeni pjesëtarë në dënim.”

“Vallë, a mos ti do të bësh të dëgjojë i shurdhëri dhe të udhëzosh të verbërin dhe atë që është në humbje të qartë?”

Komentimi

Shoqëruesit e shejtanëve

Fjala në ajetet e mëparshme ishte për adhuruesit e kësaj dynjaje, të cilët e vlerësonin çdo gjë sipas standardit material. Ajetet në fjalë, flasin për një nga efektet më vdekjeprurëse që sjell lidhja me dynjanë dhe përqaqimi i saj, ai efekt është largimi nga All'llahu i Madhëruar.

Ajeti i parë thotë: **“Atij që shmanget nga Këshilla e të Gjithëmëshirshmit (Kur'ani), Ne do t'ia caktojmë një djall, që do t'i bëhet shok i pandashëm.”**^{1, 2}

Po, pavëmendshmëria ndaj përmendjes së All'llahut dhe mbyjtja në kënaqësitë e dynjasë, verbimi nga bukuritë dhe joshjet e saj, çojnë në komandimin nga djalli të njeriut. Djalli nuk i ndahet

¹Fjala “ja’shu” vjen nga lënda “el ushvu”. Nëse shoqërohet me “ila”: “ashevtu ilejhi”, atëherë ajo ka kuptimin e udhëzimit nëpërmjet diçkajeme delikatesë. Nëse shoqërohet me “an”: “asa an”, ajo merr kuptimin e kundërshtimit të një gjëje. Kjo është ajo që nënkuptohet në ajetin e përmendur. “Lisanul Arab”, lënda “”ashvun.

²Fjala “nukajjidu” vjen nga lënda “kajdun”. Në rrënjë ka kuptimin lëvizje që mbulon vezën. Më pas ka marrë kuptimin: Bëja e diçkaje sunduese mbi diçka tjetër.

kurrë atij, i hedh një zinxhir në qafë, e shtrëngon fort atë dhe e tërheq drejt vetes, që të shkojë me të ku të dëshirojë ai.

Shpesh kemi thënë se ndër rezultatet e para të veprave të njeriut, sidomos e përmbushjes së dëshirave në këtë botë, si ndotja nga papastërtitë e mëkateve të ndryshme, është formimi i një perdeje në zemër, në të dëgjuar dhe të shikuar, që e largon atë nga All'Ilahu i Madhëruar. Mbi të autorizohen të veprojnë shejtanët. Kjo gjendje mund të vazhdojë derisa atyre t'u përplasen në fytyrë dera e kthimit mbrapsht, sepse shejtanët dhe mendimet e tyre djallëzore vijnë, kur ata e kanë zaptuar plotësisht njeriun nga çdo anë. Ky është rezultat i punës së vetë njeriut. Në ajete të tjeratë Kur'anit litet për zbukurimin e veprave nga ana e djajve, siç thotë ajeti: **“po veprat e tyre (të shëmtuara) ua hijeshoi shejtani”**.¹ Po ashtu ka ajete që flasin për miqësinë me shejtanin, siç është ajeti: **“se ai është mik i tyre”**.²

Ajo që meriton të përmendet është se shprehja *“ia shoqërojmë”*, duke parë edhe kuptimin e saj gjuhësor, tregon për pushtimin nga djajtë. Po ashtu tregon për të qenit e tyre shoqërues. Në të njëjtën kohë, pas saj vjen edhe shprehja: **“...që do t'i bëhet shok i pandashëm...”**, për ta përforcuar këtë kuptim, se shejtanët nuk iu ndahen kurrë njerëzve të tillë, e kurrë nuk largohen prej tyre.

Mënyra e të shprehurit me fjalën *“të Mëshiruesit”*, është tregues interesant se si e kundërshtojnë këta njerëz All'Ilahun, i Cili ka përgjithësuar me mëshirën e Tij gjithçka, duke i përfshirë edhe ata, e ata të jenë të pavëmendshëm në përmendjen e Tij? A

¹ Sure “Nahl”, ajeti 63.

² Sure “Nahl”, ajeti 63.

meritojnë njerëz të tillë, diçka tjetër veç dënimit që të jenë shoqërues të shejtanëve, duke ndjekur urdhrat e tyre, e duke zbatuar atë që u jep shpresë atyre?

Disa komentues mendojnë se shejtanët këtu mund të jenë në kuptimin e gjerë të fjalës, e cila përfshin edhe njerëzit shejtanë. Ata janë konsideruar të humbur. Kokat e atyre që u nënshtrohen kryetarëve të tyre, janë të hutuara ndaj përkujtimit të All'Ilahut të Madhëruar, prandaj bëhen shoqërues të shejtanëve, kështu që nuk është larg zgjerimi i kuptimit.

Ajeti që vjen më pas tregon për ndikimin e djajve dhe thotë: **“Në të vërtetë, djajtë i shmangin jobesimtarët nga Rrugja e Drejtë...”**.¹

Sa herë që këta njerëz vendosin të pendohen dhe të rikthehen në Rrugën e Drejtë të udhëzimit, shejtanët hedhin në rrugën e tyre gurë dhe pengesa, i shtojnë dhe forcojnë pengesat për rrugën e kthimit të tyre, derisa ata të mos kthehen më kurrë në Rrugën e Drejtë. Shejtanët ua zbukurojnë atyre rrugën e humbjes, **“...ndonëse ata mendojnë se janë të udhëzuar drejt.”**, siç lexojmë në ajetin 38 të sures “Ankebut” rreth popullit të Adit dhe Themudit: **“Djalli ua pati zbukuruar veprat e tyre duke i shmangur nga e vërteta, edhe pse e shihnin atë.”**.

Nëse kjo situatë vazhdon kështu, njeriu i pavëmendshëm mbetet injorant në humbjen e tij, kështu që shejtanët vazhdojnë ta humbin atë, derisa t'i ngrihet perdja dhe t'i hapen sytë për të parë të vërtetën: **“Dhe, kur të vijë te Ne, (jobesimtari) do t'i thotë**

¹ Përemri i shumësit “hum” në fjalën “ennehum” dhe fjalia që vijon, u referohen shejtanëve, edhe pse ka ardhur në formën e njëjësit më parë, mirëpo, ai është me kuptimin e shumësit.

(djallit që e kishte shok): **‘Ah, sikur të kishte qenë largësia midis meje dhe teje sa ajo mes lindjes e perëndimit! Sa shok i keq paske qenë ti!’**”.

Llojet e dënimit janë njëra anë e medaljes, ndërsa shoqërimi me shokë të këqinj është ana tjetër. Kur ta vështrojnë në fytyrë me përbuzje, atëherë do të mishërohen para syve të tij kujtimet e humbjes dhe të hidhërimit. Mjerë ai që u bë shok me atë që ia zbukuronte çdo vepër të shëmtuar, që i zgjidhte rrugën e humbjes si të ishte rruga e mirësisë dhe shpëtimit, ndërsa rrugën e shmangies si të ishte rruga e udhëzimit dhe e së drejtës! Mjerë ata që janë lidhur bashkë me të në të njëjtët zinxhirë, në të njëjtin burg!

Në të vërtetë, oborri i Kiametit është mishërimi i gjerë i skenave të kësaj dynjaje, për shoqëruesit, bashkëudhëtarët dhe udhëheqësit. Argumenti për këtu dhe për atje është një, madje sipas mendimit të disa komentuesve, të dyja shoqërohen me një zinxhir të vetëm.

Siç dimë prej njohurive, ajo që nënkuptohet me dy lindjet është: lindja dhe perëndimi, sepse arabët, kur duan të lavdërojnë dy gjini të ndryshme me anë të një shprehjeje të vetme, ata zgjedhin një nga dy shprehjet, siç dhe thonë: dy diejt, duke treguar Diellin dhe Hënën, dy drekat, duke treguar dy namazet e drekës dhe ikindisë, dy darkat, duke treguar për dy namazet e akshamit dhe jacisë.

Disa komente kanë përmendur (por nuk duken shumë të përshtatshme me ajetin në fjalë), se thënia nënkupton lindjen e fillimit të dimrit dhe lindjen e fillimit të pranverës.

Sido që të jetë, kjo mënyrë të shprehuri është metaforike, shprehëse e ekuivalencës për largësitë e mëdha, të cilat mund të përfytyrohen, prandaj dhe merret si shembull largësia e lindjes me perëndimin.

Mirëpo, kjo shpresë nuk realizohet kurrë, sepse nuk mund të ketë ndryshim apo kontrast midis atyre dhe shejtanëve. Prandaj, për këtë, në ajetin që vijon, thuhet: **“(Atyre do t’u thuhet): Nuk do t’ju bëjë dobi (pendimi) juve sot, sepse ju u larguat nga e vërteta dhe humbët. Me të vërtetë, ju jeni pjesëtarë në dënim.”**, prandaj duhet të vuani dënimin e shokut të keq dhe të gjitha llojet e dënimeve, deri në pafundësi.

Kur’ani Kerim e ndërron shpresën e tyre në ndarjen nga shejtanët, me një dëshpërim të përhershëm.

Ka dhe disa mendime të tjera për komentimin e këtij ajeti. Njëri prej tyre është se njeriu mund të ndiejë lehtësim të dhimbjeve të tij kur shikon të dënuarit e tjerë teksa rënkojnë mes dhimbjesh. Siç thotë dhe një fjala e urtë: Nëse fatkeqësia dhe belaja bie për të gjithë, ajo bëhet e përballueshme.¹ Kurse në anën tjetër, atyre u thuhet: Atje nuk ka nga këto lloje dëfrimesh, zemrash dhe mendjesh, përkundrazi, ju do të zhyteni në dënim.²

Gjithashtu, ata mendojnë se kur ndodh fatkeqësia, ajo pakëson stresin, peshën e të cilit njeriu e gjen të shpërndarë midis vetes dhe shokëve të tij, mirëpo kjo situatë nuk ndodh kurrë, sepse për çdo njeri ka një pjesë dënimi, pa u pakësuar aspak edhe dënimi i të tjerëve.

¹“Biharul Anuar”, vëll, 32, f. 261.

Ky ajet është plotësues i ajetit të mëparshëm, kështu që komentimi që zgjodhëm më parë, është më i përshtatshëm.

Kur'ani e lë mënjanë këtë grup, bashkë me çështjen e tyre, duke e drejtuar bisedën për nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që flet për të pavëmendshmit, me zemra të verbuara, që përgënjeshtroan lidhjen e tij me All'llahun. Ata janë nga ai lloj, për të cilët paraprin fjala përreth tyre në ajetet e mësipërme, kur thotë: **“Vallë, a mos ti do të bësh të dëgjojë i shurdhëri dhe të udhëzosh të verbërin dhe atë që është në humbje të qartë?”**.

I njëjti kuptim është përmendur në ajete të tjera të Kur'anit Kerim, që i krahason kokëfortët, të cilët nuk kanë asnjë shpresë në udhëzimin e tyre, pra ata që janë të zhytur në mëkate nga verbimi dhe shurdhërimi, njëlloj me të vdekurit.

Surja “Junus”, në ajetin 42, përmend: **“A mund ta bësh të shurdhërin të dëgjojë, edhe kur ata nuk kuptojnë?”**.

Në ajetin 80 të sures “Neml” thuhet: **“Ti nuk mund t'i bësh të dëgjojnë të vdekurit, e as nuk mund ta bësh të shurdhërin të dëgjojë thirrjen, e sidomos kur ata ta kthejnë shpinën.”**.

Për të gjitha këto mënyra të shprehuri na qartëson Kur'ani, si për llojet e dëgjimit, ashtu edhe të shikimit në jetën e njeriut, të dëgjimit dhe shikimit në jetën sipërfaqësore, ose të dukshme, si dhe dëgjimit dhe shikimit në jetën e brendshme, ose të padukshme. E rëndësishme është pjesa e dytë e konceptimit dhe shikimit të jetës, pasi në qoftë se ajo prishet, atëherë nuk bën dobi, as këshilla, as udhëzimi, as paralajmërimi dhe as përkujtimi.

Ajetet e mëparshme e kanë krahasuar këtë grup me ata njerëz, të cilët kanë shikim të turbullt, pra shikim të kufizuar, ndërsa ajeti i fundit i krahason ata me të shurdhërit dhe të verbërit. Kjo, për shkak se njeriu, nëse merret me punët e dynjasë, atëherë situata e tij është e njëllajtë me atë që ankohet për një dhimbje të lehtë syri. Sa herë që shtohet marrëdhënia dhe angazhimi i tij me punët e dynjasë, ai do të tërhiqet më tepër prej gjërave materiale, duke lënë pas dore, e madje duke mos u dhënë rëndësi çështjeve shpirtërore dhe morale. Kështu, shikimi i tij do të dobësohet si rezultat i dhimbjeve të syrit, derisa të arrijë fazën e verbërisë së plotë. Këmbëngulja për të mirat materiale është argument i prerë për gjendjen morale negative apo pozitive të njeriut, stabilizimit të pasurisë si rezultat i përsëritjes së veprës dhe vazhdimësisë në të. Kur'ani Kerim, gjithashtu, e ka ruajtur këtë konsekuencë.¹

¹ Tefsiri "El Kebijr", vëll. 27, f. 214 dhe 215.

Ajetet 41-45

فَإِنَّمَا نَذْهَبَنَّ بِكَ فَإِنَّا مِنْهُمْ مُنْتَقِمُونَ^١؛ أَوْ نُرِيَنَّكَ الَّذِي وَعَدْنَاهُمْ فَإِنَّا عَلَيْهِمْ مُقْتَدِرُونَ^٢؛ فَاسْتَمْسِكْ بِالَّذِي أُوحِيَ إِلَيْكَ إِنَّكَ عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ^٣؛ وَإِنَّهُ لَذِكْرٌ لَّكَ وَلِقَوْمِكَ وَسَوْفَ تُسْأَلُونَ^٤؛ وَاسْأَلْ مَنْ أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رُسُلِنَا أَجَعَلْنَا مِنْ دُونِ الرَّحْمَنِ آلِهَةً يُعْبَدُونَ^٥؛

“Edhe sikur të të marrim ty, Ne, me siguri do të hakmerremi ndaj tyre.”

“Ose do të të tregojmë atë çka u kemi premtuar atyre. Ne jemi vërtet të Plotfuqishëm mbi ta.”

“Prandaj, përmbaju fort asaj që të është shpallur ty, sepse ti, në të vërtetë, je në Rrugën e Drejtë.”

“Pa dyshim që Kur’ani është përkuqtesë për ty dhe popullin tënd; e ju do të pyeteni!”

“Pyeti të Dërguarit Tanë, që i kemi nisur para teje, a mos kemi urdhëruar Ne që të adhurohen zota të tjerë, përveç të Gjithëmëshirshmit?!”

Përmbaju asaj që të është shpallur!

Në ajetet e mëparshme u fol për jobesimtarët kokëfortë dhe zullumqarë, për të cilët nuk ka asnjë shpresë për udhëzim. Këto ajete i flasin Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke kërcënuar jobesimtarët shumë ashpër nga njëra anë, e duke qetësuar zemrën dhe shpirtin e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nga ana tjetër. Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë thotë: **“Edhe sikur të të marrim ty, Ne, me siguri do të hakmerremi ndaj tyre.”**.

Sido që të jetë qëllimi, qoftë me largimin e tij nga ai popull, apo me vdekjen e tij, apo me shpërguljen e tij nga Meka në Medine, ai qëllim është tregues se edhe nëse nuk do të ishte dëshmitar dhe nuk do ta shihje me sytë e tu situatën e tyre, Ne do të hakmerremi ndaj tyre me dënimin më të ashpër, nëse ata do të vazhdojnë në rrugën e humbjes dhe të mohimit të tyre. Sepse, fjala *“el intikamu”* në rrënjë ka kuptimin e *shpërblimit* dhe *të ndëshkimit*. Me “marrjen e Pejgamberit” nënkuptohet vdekja e tij, siç përmendet në ajetin 46 të sures “Junus”: **“Nëse ta bëjmë të mundshme të shohësh diçka nga (dënimi) që u premtuam atyre, ose ta marrim shpirtin (kurse ti nuk sheh gjë), e ardhmja e tyre është vetëm tek Ne. All'llahu është dëshmues i asaj që punojnë.”**.

I njëjti kuptim përmendet edhe në suren “Rra’d”, ajeti 40 dhe suren “Gafir”, ajeti 77, kështu që komenti i ajetit me kuptimin e “shpërnguljes”, nuk është i përshtatshëm dhe i saktë.

Ajeti në vijim thotë: **“Ose do të të tregojmë atë çka u kemi premtuar atyre. Ne jemi vërtet të Plotfuqishëm mbi ta.”**, se ata janë në dorën Tonë, pa përjashtim, në çdo lloj situatë qofshin. Nëse je apo nuk je në mesin e tyre, ndëshkimi dhe hakmarrja hyjnore është përfundimtare për meritë të vetë tyre. Po që se vazhdojnë me punët e tyre të këqija, njëlloj do t’u ndodhë si të jenë në jetë, si dhe pas vdekjes. Kjo mund të shpejtojë apo dhe të vonohet, por nuk ka pikë dyshimi që do të ndodhë.

Këto garanci kur’anore janë tregues të durimit të paktë të jobesimtarëve, të cilët thonin: ‘Nëse je i vërtetë dhe i sinqertë në atë që thua, atëherë përse nuk zbret ndëshkimin mbi ne’? Nga ana tjetër, ata ishin në pritje të vdekjes së Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo ishte dëshira e tyre. Nëse Pejgamberi i mbyllte përgjithmonë sytë, atëherë ai nuk do të ishte fizikisht i pranishëm dhe çdo gjë merrte fund.

Pas këtyre paralajmërimeve, ajeti e urdhëron Profetin dhe i thotë: **“Prandaj, përmbaju fort asaj që të është shpallur ty, sepse ti, në të vërtetë, je në Rrugën e Drejtë.”**, se në fenë tënde dhe në librin tënd nuk ka as shtrembërimin më të vogël, apo lajthitje dhe shkarje. Mospranimi i tij nga një grup si ky, nuk fakton pavërtetësinë tënde, prandaj vazhdo në rrugën e nisur me të gjitha fuqitë që të janë dhënë, ndërsa pjesa tjetër na mbetet Neve.

Ajeti tjetër shton: **“Pa dyshim që Kur’ani është përkujtesë për ty dhe popullin tënd...”**. Shkaku i zbritjes është zgjimi i njerëzve, njohja e tyre me përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre: **“...e ju do të pyeteni!”**.

Duke u bazuar mbi këtë koment, fjala *“edh dhikru”* do të thotë përmendja e All'llahut të Madhëruar, njohja e detyrimeve fetare dhe informimi i përgjegjësive të njerëzve. Ky kuptim përmendet edhe në ajetet 5 dhe 36 të kësaj sureje, si dhe në shumë ajete të tjera kur'anore.

Është e njohur se fjala *“dhikër”*, është një nga emrat e Kur'anit Kerim. Kjo fjalë është me kuptimin e përmendjes së All'llahut të Madhëruar. Këtë fjalë (*dhikr*) e lexojmë disa herë në suren “Kamer”: **“Ne, Kur'anin e bëmë të lehtë për mësim, por a ka ndokush që merr mësim?”**, si dhe në ajetet 17, 22, 32 dhe 40 të po kësaj sureje.

Fjalja: **“...e ju do të pyeteni!”** dëshmon se qëllimi me pyetjen është zbatimi i këtij programi të All'llahut.

Pavarësisht kësaj, është e çuditshme se shumë prej komentuesve kanë zgjedhur një përfundim tjetër për këtë ajet, që nuk është në përputhje dhe harmoni me ato që thamë. Kuptimi i ajetit është: Kur'ani është baza e fisnikërisë dhe fuqisë, e përmendjes për mirë dhe e namit të mirë për ty, për kombin tënd. Ai u shton fisnikërinë arabëve, kurejshëve dhe ymetit tënd. Ai ka zbritur në gjuhën e tyre dhe së shpejti ata do të përgjigjen për këtë mirësi.¹

Kur'ani e ka ngritur lart thirrjen e Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe arabëve, madje dhe të gjithë myslimanëve në të katër anët e botës. Emri i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përmendet me madhështi mëngjes dhe mbrëmje kur

¹ Tefsiri “El Kebir”, vëll. 27, f. 215, tefsiri “Mexhmaul Bejan”, tefsiri “El Kurtubij”, tefsiri “El Muragij” dhe tefsiri “Ruhul Meanij”, fundi i ajetit në fjalë.

thirren ezanet që prej më shumë se katërmëdhjetë shekujsh. Arabët e kohës së injorancës, më parë të panjohur dhe pa emër, u bënë të njohur në saje të emrit të tij, nga zëri i lartë i ymetit islam që u përhap në të katër pikat e horizontit.

Është e vërtetë se fjala “*edh dhikru*”, ndonjëherë është përmendur me këtë kuptim në Kur’anin e Lavdishëm, vetëm se kuptimi i parë është më shumë i përmendur në ajetet e Kur’anit dhe është shumë më në harmoni me qëllimin e zbritjes së Kur’anit dhe ajeteve të tij.

Disa komentues e kanë konsideruar ajetin 10 të sures “Enbija”, si dëshmitar të komentimit të dytë, i cili thotë: **“A nuk e kuptoni se Ne ua shpallëm librin, në të cilin gjendet krenaria juaj?”**.¹ Ajeti i përshtatet komentit, siç e kemi detajuar në komentin e ngjashëm, në fundin e këtij ajeti.²

Për këtë ajet përmenden transmetime nga burimet e haditheve, për të cilët do të flitet më vonë.

Ajeti i fundit trajton ndalimin e adhurimit të statujave dhe shkatërrimin e besimeve idhujtare me një argument ndryshe: **“Pyeti të Dërguarit Tanë, që i kemi nisur para teje, a mos kemi urdhëruar Ne që të adhurohen zota të tjerë, përveç të Gjithëmëshirshmit?!”.**

¹ Tefsiri “El Kurtubij”, fundi i ajetit në fjalë.

² Një çështje tjetër që mund të jetë argument i komentit të njohur, është fjala “*kaumun*” – “*komb*”, e cila është përmendur në ajetin e mësipërm, sepse Kur’ani përmban metoda që u mëson të gjithë njerëzve *dhikrin* dhe jo vetëm kombit të Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) apo ymetin islam. Mirëpo, kjo thënie mund të jetë përgjigje se ky komb ka përfituar nga përmendja e Kur’anit para të tjerëve, prandaj edhe është bërë përforcim për ata.

Duke treguar se të gjithë të Dërguarit e All'llahut kanë bërë thirrje në Teuhid, Njehsimin e Zotit, edhe Profeti i Islamit, në kundërshtimin e tij ndaj putave, nuk ka bërë ndonjë gjë që nuk e kanë bërë të tjerët para tij. Përkundrazi, me punën e bërë, ai ka ringjallur traditën e përhershme të Profetëve, pasi ishin adhuresit e putave, ata që ecnin në kundërshtim me ideologjinë e Profetëve.

Sipas këtij komenti, ata do të përgjigjen nëse do të ishte Profeti i Islamit. Ajo që nënkuptohet këtu, është i gjithë ymeti, madje edhe kundërshtuesit e tij.

Ata që do të përgjigjen janë ndjekësit e Profetëve të mëparshëm dhe ndjekësit e njerëzve të singertë.

Duhet përmendur se edhe të shmangurit nga zanafilla e Teuhidit, siç janë të krishterët, të cilët sot besojnë në *trininë*, flasin, gjithashtu, për Njehsimin e Zotit, duke thënë: 'Trinia jonë nuk e mohon Njehsimin, që është feja e të gjithë Profetëve!'.

Disa studiues hedhin një tjetër hipotezë për komentin e këtij ajeti, të frymëzuar nga disa transmetime.¹ Sipas tyre, ai që pyet është vetë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kurse të pyeturit janë Profetët e mëparshëm.

Më tej, ata shtuan se kjo çështje është plotësuar në Natën e Miraxhit, sepse Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është takuar me shpirtrat e

¹ Këto transmetime janë përcjellë nga ibn Abbasi në tefsirin "El Kurtubij"; në tefsiri "El Kebijr" dhe në tefsirin "Mexhmaul Bejan." Në tefsirin "Nuruth Thekalej", vëll. 4, f. 605 dhe 607; janë përcjellë dy transmetime të detajuara në këtë kapitull të marra nga libri "El Ihtixhaxh" dhe tefsiri i "Ali ibn Ibrahimit".

Profetëve të kaluar. Për të vërtetuar çështjen e Njehsimit, është shtruar kjo pyetje, për të cilën ka dëgjuar edhe përgjigjen.

Disa studiues kanë shtuar se realizimi i këtij takimi ishte i mundur vetëm për Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), madje edhe në net të tjera, përveç Natës së Miraxhit, sepse largësitë kohore dhe distancat vendore nuk janë pengesë për lidhjen e tij me shpirtrat e Profetëve. Ishte në fuqinë e All'llahut të Madhëruar, që t'i bashkonte në çdo rast ata, kudo dhe në çdo vend.

Këto komente nuk kanë ndonjë problem logjik, përderisa qëllimi i ajetit është mohimi, ndalimi i metodës së idhujtarëve, gjë për të cilën do të qetësohej Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pasi ai ishte vijuesi dhe vazhduesi i çështjes së Teuhidit. Takimi shpirtëror i tij me shpirtrat e Profetëve të së shkuarës, nuk ishte argument bindës para politeistëve, kështu që tefsiri i parë duket shumë në harmoni, ndërsa tefsiri i dytë mund të jetë tregues i brendësisë së ajetit, jo i anës së tij sipërfaqësore, sepse në ajetet kur'anore ka gjëra të dukshme, por edhe të padukshme.

Nëpërmjet përdorimit të emrit "*Err Rrahman*", që është përzgjedhur në këtë ajet nga Emrat e tjerë të All'llahut të Madhëruar, pyetet se si munden këta të lënë mënjane All'llahun, mëshira e të Cilit ka përfshirë universin e gjithçkaje, dhe t'u drejtohen statujave, të cilat as nuk dëmtojnë e as nuk bëjnë dobi?!

Hulumtim

Cili është kombi i Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Ka tri hipoteza për kuptimin e fjalës “*kaumun*”, që do të thotë: *komb, popull*. Në ajet thuhet: **“Pa dyshim që Kur’ani është përkujtesë për ty dhe popullin tënd...”**.

E para: - Ata janë i gjithë ymeti islam.

E dyta: - Ata janë arabët.

E treta: - Ata janë fisi i kurejshëve.

Përderisa fjala “*kaumun*”, është përmendur në disa vendenë Kur’anin Kerim për popujt e Profetëve, apo dhe për popujt bashkëkohës të tyre, atëherë është e qartë se i tillë është edhe kuptimi që synohet në ajet.

Kur’ani Kerim është baza, esenca e përkujtimit, e vetëdijes dhe e zgjimit për të gjithë ymetin e Islamit sipas tefsirit të parë si dhe baza e krenarisë, fisnikërisë dhe nderimit të të gjithë atyre, sipas tefsirit të dytë.

Në shumë transmetime të ardhura nga Ehli Bejti i Profetit (*Paqja qoftë mbi ta!*) lexojmë se ajo që nënkuptohet në ajet me fjalën: “*el kaum*” janë Ehli Bejti i Profetit Muhammed (*Paqja dhe*

تفسير الامثل الجزء الخامس و العشرون

bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe pasardhësit e tij.¹

¹ Këto hadithe i ka mbledhur autori i tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 604 dhe 605.

Ajetet 46-50

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ بِآيَاتِنَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَمَلَئِهِ فَقَالَ إِنِّي رَسُولُ رَبِّ
 الْعَالَمِينَ ۖ فَلَمَّا جَاءَهُمْ بِآيَاتِنَا إِذَا هُمْ مِنْهَا يَضْحَكُونَ ۖ وَمَا نُرِيهِمْ
 مِنْ آيَةٍ إِلَّا هِيَ أَكْبَرُ مِنْ أُخْتِهَا وَأَخَذْنَاهُمْ بِالْعَذَابِ لَعَلَّهُمْ
 يَرْجِعُونَ ۘ وَقَالُوا يَا أَيُّهَ السَّاحِرِ ادْعُ لَنَا رَبَّكَ بِمَا عَهِدَ عِنْدَكَ إِنَّنَا
 لَمُهْتَدُونَ ۙ فَلَمَّا كَشَفْنَا عَنْهُمْ الْعَذَابَ إِذَا هُمْ يَنْكُثُونَ ۝

“Ne dërguam Musain me shenjat Tona te Faraoni dhe
 paria e tij, dhe ai tha: ‘Unë jam i dërguar i Zotit të botëve.’”

“Kur ai u solli atyre shenjat Tona, ata filluan t’i
 përqeshin ato.”

“Çdo shenjë që Ne u tregonim atyre, ishte më e madhe se
 ajo para saj. Prandaj Ne i dënonim ata me ndëshkim, që të
 ktheheshin (në Rrugën e Drejtë).”

“Ata i thoshin (Musait): ‘O magjistar! Lutju Zotit tënd për
 ne, ashtu sipas besëlidhjes tënde me Atë, sepse ne do të
 kthehemi në Rrugë të Drejtë!’”

“Por, sapo ua largonim dënimin, ata e shkelnin
 premtimin.”

Komentimi

Faraonët mendjemëdhenj dhe thyerja e premtimit

Në këto ajete flitet rreth asaj që ndodhi mes Profetit të All'Ilahut, Musait, të birit të Imranit (*Paqja qoftë mbi të!*), dhe Faraonit, si një përgjigje ndaj pyetjes së dobët të politeistëve, të cilët thonin: Nëse All'Ilahu do të dëshironte të dërgonte një të Dërguar, atëherë përse nuk zgjodhi një burrë prej pasanikëve të Mekës ose Taifit për këtë mision madhështor?

Ky shembull jepet ngaqë Faraoni i shkaktoi Musait të njëjtin problem, përdori të njëjtën mënyrë të foluri, kur e vuri Musain (*Paqja qoftë mbi të!*) në qerthullin e sharjeve, talljeve dhe qortimeve të ashpra për veshjen prej leshi, kundrejt moszotërimit të aksesorëve zbukurues prej tij. Ajeti i parë thotë: **“Ne dërguam Musain me shenjat Tona te Faraoni dhe paria e tij, dhe ai tha: ‘Unë jam i dërguar i Zotit të botëve.’”**.

Ajo që nënkuptohet me *“ajatun”*, është për mrekullitë që kishte Musai. Me anë të tyre, ai dëshmonte vërtetësinë e tij. Më të rëndësishmet prej tyre ishin shkopi dhe dora e bardhë.

Fjala *“el meleu”*, siç e kemi thënë edhe më parë, vjen nga lënda *“el melau”*, që do të thotë *populliapo grupi i njerëzve*, të cilët ndjekin një qëllim të vetëm. Aparenca e tyre të mbush sytë për shkak të numrit të shumët të tyre. Sipas Kur'anit, në të shumtën e rasteve, kjo fjalë nënkupton fisnikët dhe pasanikët, ose njerëzit e pallatit.

Përforcimi i cilësisë: *“rabel alemijne”*–**“Zotit të gjithësisë”** është sqarim i pretenduesit i shoqëruar me argument, se pa dyshim, Zoti i gjithësisë, zotëruesi dhe mësuesi i tyre, është i vetmi që e meriton adhurimin, e jo krijesat e dobëta që kanë nevojë, sikurse faraonët dhe statujat.

Tani te shohim se si është sjellë Faraoni dhe rrethi i tij, me argumentet logjike dhe mrekullitë e qarta të Musait (*Paqja qoftë mbi të!*)

Në ajetin vijues, Kur’ani Kerim thotë: **“Kur ai u sollti atyre shenjat Tona, ata filluan t’i përqeshin ato.”**. Një qëndrim i tillë është pozicionimi i parë që mbajnë mizorët dhe injorantët mendjemëdhenj para udhëheqësve të vërtetë, pasi ata nuk i marrin thirrjet dhe argumentet e tyre me seriozitet, nuk hulumtojnë në to për të arritur tek e vërteta. Kështu që atau përgjigjen atyre me ironi dhe tallje, me qëllim që t’i bënin të tjerët të kuptojnë se thirrja, ftesa e tyre nuk e meriton kërkimin, vërtetimin, pranimin dhe nuk mund të merrej seriozisht.

Mirëpo, Ne dërguam argumentet Tona, njërin pas tjetrit, për të plotësuar dëshminë: **“Çdo shenjë që Ne u tregonim atyre, ishte më e madhe se ajo para saj...”**.¹

Përmbledhje:Ne ua treguam atyre argumentet Tona, njëri më i madh se tjetri, më të qartë dhe më të fortë, me qëllim që atyre të mos u mbetet asnjë arsye dhe justifikim, që të zbrisnin nga trilli i mendjemadhësisë dhe të të pëlqyerit të vetes. Pas dëshmisë së

¹ Shprehja *“el ukhtu”*, në gjuhën arabe do të thotë: *barazim i një gjëje në gjinidhe shkallë si dy motra.*

shkopit dhe dorës së bardhë, Ne u treguam atyre mrekullinë e tufanit, të karkalecave, morrave, bretkosave e të tjerave.¹

Më pas ajeti shton: “...**Prandaj Ne i dënonim ata me ndëshkim, që të ktheheshin** (në Rrugën e Drejtë).”; një herë i kaplonte thatësira e madhe, mungesa e shiut dhe pakësimi i frutave, siç dhe thuhet edhe në ajetin 130 të sures “A’raf”: “**Dhe Ne e goditëm popullin e Faraonit me thatësi, me vite zie, që të zinin mend.**”.

Ndonjëherë, ndëshkimi u vinte me ndryshimin e ngjyrës së ujit të Nilit që merrte ngjyrën e gjakut, sa nuk ishte i mirë për t’u pirë, as për të vaditur, ndërsa nganjëherë ishin sëmundjet bimore që shkatërronin të mbjellat.

Gjatë këtyre ngjarjeve të hidhura dhe të dhimbshme, edhe pse ato thërrisnin fort për t’ua tërhequr përkohësisht vëmendjen, ata strukeshin duke kërkuar ndihmë te Musai, thjesht që të qetësonin tufanin, e pastaj harronin çdo gjë. Kështu, ata e bënë Musain objekt të shigjetimit të lloj-lloj akuzave, siç dhe lexojmë në ajetin vijues: “(dhe ata thanë): **Ata i thoshin** (Musait): ‘**O magjistar! Lutju Zotit tënd për ne, ashtu sipas besëlidhjes tënde me Atë, sepse ne do të kthehemi në Rrugë të Drejtë!**’”.

Sa e habitshme kjo shprehje! Ata, herë e quajnë atë magjistar, herë strehohen te ai dhe i ankohen atij për t’ua larguar fatkeqësinë atyre, e herë i premtojnë pranimin e udhëzimit.

Mungesa e harmonisë në qëndrimet e tyre, është bërë shkak i komenteve të ndryshme:

¹ Hollësitë e nëntë mrekullive të Musait, birit të Imranit (*Paqja qoftë mbi të!*), janë përmendur në fundin e ajetit 101 të sures “Isra”.

Disa studiues thonë se këtui, magjistari ka kuptimin e dijetarit, sepse në atë kohë, njerëzit i madhëronin magjistarët, sidomos në Egjipt, pasi i shikonin ata me syrin e dijetarëve. Disa mendonin se magjia mund të jetë me kuptimin e kryerjes së një pune të rëndësishme, siç dhe themi sot në bisedat tona: që filani është ekspert, i paparë në punën e tij, duket sikur bën me magji.

Një grup dijetarësh kanë thënë se ai është magjistar nga pikëpamja e një grupi njerëzish.

Sidoqoftë, duket qartë nga metodika e ajetit, se ata i kishin bërë Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) një premtim të gënjeshtërt, kur në të njëjtën kohë kishin shumënevojë për ndihmën e tij, për situatën e strehimit dhe paraqitjen e nevojave. Megjithatë, ata nuk hiqnin dorë nga mendjemadhësia e tyre, prandaj dhe e shprehën kërkesën ndaj Musait me fjalën **“rabbike”**, që do të thotë: **Zotit tënd, “sipas besës që të ka dhënë”** dhe nuk thanë kurrë: **“Zotin tonë”**, **“ajo që na premtoi neve”**, pavarësisht se Musai ia tha atyre shumë qartë: Me të vërtetë që unë jam i dërguar i Zotit të gjithësisë, dhe jo i dërguari i Zotit tim.

Kjo mënyrë të foluri është praktikë dhe metodë e mendjelehtëve dhe mendjemëdhenjve kur ulen në fronin e qeverisjes.

Por Musai, pavarësisht këtyre fjalëve përbuzëse, nuk hoqi dorë nga përpjekja për udhëzimin e tyre, nuk u dëshpërua për shkak të kokëfortësisë dhe mendjengushtësisë së tyre; përkundrazi, ai vazhdoi në rrugën e tij, e luti Zotin shumë herë që të qetësonte furtunat dhe fatkeqësitë, të cilat pushuan, mirëpo ata, siç thotë ajeti: **“Por, sapo ua largonim dënimin, ata e shkelnin premtimin.”**

Të gjitha këto janë mësimë të gjalla dhe kumtuese për myslimanët dhe ngushëllim për Profetin (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me qëllim që të mos përkulen në mënyrë absolute para kokëfortësisë dhe ashpërsisë së kundërshtarëve, të mos lejojnë dëshpërimin të mbizotërojnë në shpirtrat dhe unet e tyre. Përkundrazi, ta çajnë rrugën e tyre me forcë, burrëri dhe vendosmëri, ashtu siç dhe ka qëndruar Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) me Beni Israilët në vendet e tyre, që kanë vazhduar në rrugën e tyre, derisa dolën fitimtarë përballë faraonëve.

Kjo histori është gjithashtu, një paralajmërim për armiqtë këmbëngulës dhe kokëfortë, për t'iu thënë se ata nuk janë më të fortë dhe më të ashpër se Faraoni dhe rrethi i tij, prandaj le ta shohin përfundimin e çështjes së tyre, e të mendojnë me gjakftohtësi për dënimin e tyre.

Ajetet 51-56

وَنَادَىٰ فِرْعَوْنُ فِي قَوْمِهِ قَالَ يَا قَوْمِ أَلَيْسَ لِي مُلْكُ مِصْرَ وَهَذِهِ
الْأَنْهَارُ تَجْرِي مِن تَحْتِي أَفَلَا تُبْصِرُونَۚ أَمْ أَنَا خَيْرٌ مِّنْ هَذَا الَّذِي
هُوَ مَهِينٌ وَلَا يَكَادُ يُبِينُۚ فَلَوْلَا أُلْقِيَ عَلَيْهِ أَسْوِرَةٌ مِّنْ ذَهَبٍ أَوْ
جَاءَ مَعَهُ الْمَلَائِكَةُ مُقْتَرِنِينَۚ فَاسْتَخَفَّ قَوْمَهُ فَاطَاعُوهُ إِنَّهُمْ كَانُوا
قَوْمًا فَاسِقِينَۚ فَلَمَّا آسَفُونَا انتَقَمْنَا مِنْهُمْ فَأَغْرَقْنَاهُمْ أَجْمَعِينَۚ
فَجَعَلْنَاهُمْ سَلَفًا وَمَثَلًا لِّلْآخِرِينَۚ

“Dhe Faraoni i thërriste popullit të vet: O populli im! Vallë, a nuk më përket mua sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin pranë meje? A nuk shihni?”

“Vallë, a nuk jam unë më i mirë se ky i mjerë, i cili mezi mund të shprehet?”

“Përse nuk i janë dhënë atij byzylykë ari? Përse nuk kanë ardhur bashkë me të engjëjt?”

“Kështu, ai e mashtroi popullin e vet. Ata iu nënshtroan atij, sepse ishin vërtet një popull i pabindur.”

“E, kur Na zemëruan, Ne u hakmorëm ndaj tyre dhe i fundosëm të gjithë.”

“Ne i bëmë ata shembull dhe mësim për popujt e mëvonshëm.”

Komentimi

Nëse është Profet, atëherë përse nuk ka byzylykë prej ari?

Mënyra e të folurit të Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), mrekullitë e tij të ndyshme si dhe sprovat dhe fatkeqësitë që zbritën mbi kokën e popullit të Egjiptit, të cilat këto fatkeqësi u larguan me lutjen e begatshme të Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) pa dyshim se, të gjitha këto ndikuan thellë në atë mjedis. Prej tyre u lëkundën mendjet e njerëzve dhe besimi i tyre te Faraoni, çka e vendosi sistemin e atëhershëm shoqëror dhe fetar në një situatë pikëpyetjeje dhe verifikimi.

Faraoni ngulmonte që me sofizmat dhe dezinformimet e tij, të pengonte përhapjen e udhëzimeve të Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të mos ndikohej mendimi i popullit të Egjiptit. Ai përdori vlerat e dobëta dekadente, që e mbizotëronin atë mjedis, duke bërë krahasimin mes vetes dhe Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), nëpërmjet gjërave materiale, me qëllim që të dukej superior ndaj Musait, siç dhe e përmend Kur’ani Kerim kur thotë: **“Dhe Faraoni i thërriste popullit të vet: ‘O populli im! Vallë, a nuk më përket**

mua sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin pranë meje? A nuk shihni?"¹

Po Musai, çfarë zotëron? Asgjë tjetër përveç një shkopi dhe rrobave të leshta! Atëherë, të kujt janë pushteti dhe pozita e lartë? Të atij apo të miat? A thotë ai të vërtetën, apo unë? Hapini mirë sytë tuaj, e shikojini imtësisht këto çështje!

Kështu, Faraoni lartësoi vlerat e shpikura dhe të këqija, i bëri pasurinë, pozitën dhe prestigjin e pushtetit, standarde njerëzore, ashtu siç dhe ishte gjendja me adhuruesit e putave në kohë të injorancës dhe qëndrimi i tyre para Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Përdorimi i fjalës “*nada*”, që do të thotë: “*thirri*”, nënkupton se Faraoni mblodhi një tubim madhështor me ekspertë të qyteteve dhe këshilltarë të tij, ku foli me zë të lartë, madje urdhëroi që thirrja e tij të shpërndahej si kumt në të katër anët e qyteteve.

Fjala “*el enharu*” ka për qëllim lumin Nil, për shkak se ai është lumë i madh, si det, me shtrat të gjerë, i cili degëzohej në shumë degë dhe ujiste të gjitha zonat e banuara në Egjipt.

Disa studiues kanë thënë se lumi Nil kishte 360 degë. Degët më të rëndësishme ishin: lumi i Mbretit (*nehru melik*), i Tulunit (*nehru tuluu*), i Damjatit (*nehru damjat*) dhe i Tenizit (*nehru tenijs*).

Përse Faraoni fokusohet në mënyrë të veçantë te lumi Nil? Për arsye se të gjitha vendbanimet e Egjiptit, pasuritë, forca dhe

¹ Shkronja “*uau -j*” te fjalia “**dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin pranë meje**” ka mundësi që të jetë lidhëse e “**sundimi i Egjiptit**”, por mund të jetë rrethanore. (Tefsiri “*El Keshshaf*”). Mrëpo, mendimi i parë duket më i përshtatshëm.

zhvillimi i tij, mbështeteshin te Nili, prandaj ai e reklamonte dhe me të i mburrej Musait.

Shprehja: **“...që rrjedhin pranë meje...”**, nuk do të thotë se lumi Nil rridhte vërtet poshtë pallatit të Faraonit, siç kanë thënë një grup komentuesish, pasi ky lumë është shumë herë më i gjerë për të rrjedhur poshtë themeleve të pallatit të Faraonit, por kishte mundësi të ishte ngjitur me pallatin e tij, sepse shumica e pallateve të Egjiptit kanë qenë të tillë. Banesat dhe qytetet shtriheshin dy anëve të brigjeve të këtij lumi, kështu që nënkuptohet se gjoja, ky lumë ishte nën urdhrat e Faraonit, se sistemi i degëzimit të lumit nëpër toka të mbjella e vendbanime, ishte bërë sipas urdhrave të tij.

Më pas shton: **“Vallë, a nuk jam unë më i mirë se ky i mjerë, i cili mezi mund të shprehet?”**; me këtë, ai i shton vetes dy mburrje të mëdha, qeverisjen e Egjiptit dhe mbretërimin e Nilit, ndërsa Musait i përmend disa pika të dobëta, si: varfërinë dhe mbajtjen e gojës.

Kjo ka ndodhur në kohën kur Musai nuk kishte asnjë pengesë në gjuhën e tij, se All’llahu i Lartësuar iu përgjigj lutjes së tij, ia largoi atë, ia hoqi pengesën në mbajtjen e gojës se ia kërkoi Zotit të tij kur Ai e dërgoi me profeci: **“Dhe zgjidhma nyjen e gjuhës sime.”**¹ Në mënyrë të pakundërshtueshme, lutja e tij mori përgjigje dhe Kur’ani është dëshmitar për këtë.

Nuk përbën turp mungesa e zotërimit të ndonjë pasurie të madhe, rrobave luksoze apo pallateve të zbukuruara, që zakonisht arrihen nëpërmjet padrejtësisë ndaj të dobtëve dhe

¹Sure “Ta Ha”, ajeti 27.

mizorisë ndaj tyre; përkundrazi, është krenari sublime, nderim dhe dinjitet njerëzor.

Mënyra e shprehjes me *“mehijnun”* mbase është treguese përshtresat shoqërore në atë kohë ngaqë mendonin se fisnikët dhe pasanikët ishin shtresa e lartë, kurse punëtorët fukarenj ishin shtresë e ulët. Ose është treguese e origjinës së Musait, i cili ishte prej Beni Israilëve dhe Kobtët mendonin se ishin padronët dhe të mëdhenjtë e shoqërisë.

Më pas Faraoni vazhdoi të ngulmonte me dy pretekste të tjera, duke thënë: **“Përse nuk i janë dhënë atij byzylykë ari? Përse nuk kanë ardhur bashkë me të engjëjt?”**.¹ Nëse All'illahu e ka bërë atë të Dërguarin e Tij, atëherë përse nuk i ka dhënë atij byzylykë prej floriri dhe melekë shoqërues, si pjesës tjetër të të Dërguarve?

Thuhet se faraonët besonin se kryetarët duhej të zbukuronin veten e tyre me byzylykë dhe varëse floriri, prandaj ata habiteshin me Musain, i cili nuk kishte asnjë mjet zbukurimi prej tyre, madje vishej me rroba prej leshi si barinjtë. Kjo ishte gjendja e shoqërisë së kohës. Ata kishin si standard të vlerësimit të personalitetit të njeriut, arin, argjendin dhe aksesoret e zbukurimit.

Të Dërguarit e All'illahut u janë kushtuar personalisht këtyre problemeve. Ata dëshironin që t'i hidhnin poshtë këto standarde mashtrimi dhe të mbillnin në vend të tyre vlera origjinale njerëzore, si: diturinë, përkushtimin dhe pastërtinë.

¹Fjala *“mukterinine”*, ka ardhur me kuptimin e shoqëruesit apo bashkëpunëtorit, kurse disa të tjerë thonë se *shoqërimi* këtu, është me kuptimin e shoqëruesit të afërt.

Nëse nuk përmirësohet sistemi i vlerave në një shoqëri, atëherë ajo nuk do ta arrijë lumturinë.

Këto justifikime të Faraonit i përngjasojnë pretekstit të idhujtarëve të Mekës, të cilin e prezantuan disa ajete më parë. Ata thonin: Përse nuk ka zbritur Kur’ani mbi një të madh të Mekës dhe Taifit?!

Këtë pretekst e shtronin shumë prej popujve të humbur e kundërshtues në përballjen me Pejgamberët, kur thonin: Përse All’Ilahu ka dërguar një njeri dhe jo një engjëll?

Herë të tjera, ata thonin: Nëse është njeri, atëherë përse nuk është shoqëruar me një engjëll?

Ndërkohë që Profetët e dërguar te njerëzit duhej të ishin nga raca, lloji i tyre, që t’i njihnin konkretisht nevojat, problemet dhe çështjet e tyre, t’i donin ata dhe të përpiqeshin për të qenë sa më praktikë, një model dhe shembull i madh për ta.¹

Fjala “*el esuiretu*” është shumësi i “*sivarun*”, që do të thotë: “*byzylyk*”, qoftë prej ari apoprej argjendi.

Ajeti në vijim tregon diçka interesante: Faraoni nuk ishte fare i pavëmendshëm ndaj rëndësisë së çështjes. Ai ishte i vetëdijshëm se këto vlera dhe standarde materiale nuk kishin ndonjë peshë, prandaj: **“Kështu, ai e mashtroi popullin e vet. Ata iu nënshtruan atij...”**.

¹Një koment i hollësishëm për këtë kapitull është përmendur në në këtë tefsir në fund të ajetit 9 të sures “En’am”.

Stili i të gjitha qeverive autokratike dhe me sistem të prishur, për të vazhduar realizimin e synimeve dhe egoizmave të tyre, është se i mbajnë njerëzit në standard të ulët ekonomie, mendimi dhe kulture. Ato i lënë ata në errësirë dhe të painformuar, në mënyrë që të mos kuptojnë çfarë ndodh përreth tyre, duke përdorur lloj-lloj metodash. I lënë popujt të mbytur në hutim dhe padituri ndaj problemeve, ngjarjeve dhe të vërtetave, u shfaqin atyre vlera dhe ekuilibra mashtrimi, të degraduara, në vend të ekuilibrave të vërtetë. Këto qeveri zbatojnë procesin e shpëlarjes së plotë të trurit për popujt e tyre, kjo për arsye se zgjimi i botëkuptimit të tyre dhe zhvillimi intelektual i udhëzimit, përbëjnë rrezikun më të madh për to. Populli i orientuar dhe i udhëzuar konsiderohet si armiku më i madh i qeverive autokrate. Ky botëkuptim është njëlloj si ai para një rebeli të pamëshirshëm, të cilin duhet ta luftosh me të gjitha fuqitë që ke.

Metoda faraonike, domethënë frikësimi i mendjeve, është një formë qeverisëse për të gjitha shoqëritë e shthurura të kohës sonë, të cilat me intensifikimin e forcës, qëndrojnë padrejtësisht në pushtet. Faraoni atëherë kishte në dorë mjete të kufizuara, që i përdorte për t'ia arritur qëllimeve të tij, ndërsa sot, mizorët zullumqarë i frikësojnë mendjet e njerëzve nëpërmjet metodave dhe lidhjeve kolektive, gazetave, botimeve periodike, rrjeteve radio-televizive, fushave të elektronikës, llojeve të ndryshme kinematografike, madje dhe sporti është devijuar nga shpikje të ndryshme dhe mënyra argëtimi të shëmtuara, të cilat mbysin popujt në detin e pavëmendjes, që t'u binden dhe dorëzohen atyre. Për këtë, përgjegjësia rëndon mbi supet e dijetarëve të fesë dhe atyre që janë lidhur me të. Ata duhet të ringjallin vijën ideologjike fetare të Pejgamberëve, të luftojnë me programe për

lehtësimin dhe ndriçimin e mendjeve, pasi ajo ka qenë, është dhe mbetet detyra më e rëndësishme e tyre.

Është interesante se ajeti i përmendur mbyllet me fjalinë: **“...sepse ishin vërtet një popull i pabindur.”**, duke dëshmuar se ky popull nuk do të ishte i shthurur e rebelues ndaj bindjes së All’llahut të Madhëruar, nuk do t’u dorëzohej këtyre propagandave dhe përrallave, se ata i përgatitën shkaqet e disfatës me duart e veta, kështu që nuk janë kurrë të pafajshëm në humbjen dhe shkatërrimin e tyre.

Është e vërtetë se Faraoni ua ka prishur mendjen atyre, i ka ngarkuar me bindjet e tij, por vetë ata ndihmuan për këtë degradim moral të mendjes, me ndjekjen e verbër ndaj tij.

Ata ishin një popull i shthurur, që ndiqnin një faraon të shthurur.

Këto ishin krimet e Faraonit me oborrin dhe sofizmat e tij në përballjen me të Dërguarin e All’llahut, Musain (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*). Kështu, në këto ajete tregohet se deri ku ka arritur fundi i çështjes së tyre pas atij qortimi të ashpër me udhërrëfim dhe plotësim pretekstesh në rrugë të ndryshme, nëse nuk përmirësohen për të vërtetën:

Ajeti thotë: **“E, kur Na zemëruan, Ne u hakmorëm ndaj tyre dhe i fundosëm të gjithë.”**. All’llahu i Madhëruar zgjodhi, në mënyrë të veçantë për ta, dënimin me mbytje në mes të të gjitha dënimeve, ngaqë prestigji, fuqia, krenaria dhe forca e tyre ishin të lidhura me madhësitinë e lumit Nil dhe degëzimet e tij të shumta, të cilat Faraoni i përdorte për të mbështetur burimet e fuqisë së tij. Prandaj edhe tha: **“...Vallë, a nuk më përket mua**

sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjve që rrjedhin pranë meje...?”.

Fraza “*asefun*” vjen nga lënda e “*el esef*”, dhe vjen me kuptimin “*gadabun*” - “*zemërim*”. Madje, kjo fjalë përdoret edhe për hidhërimin e shoqëruar me zemërim, siç thotë Ragibi në librin e tij “*El Mufredatu*”.¹ Po ashtu, kjo fjalë mund të përdoret për secilin kuptim më vete.

Disa e kanë komentuar fjalën “*asefun*” me kuptimin “*asefurusulena*”, që do të thotë: “*hidhëruan të dërguarit Tanë*”, por ky komentim duket se është shumë larg të vërtetës.

Nuk ka ndonjë kuptim të dëshpërimit dhe brengosjes në lidhje me All’llahun e Madhëruar, as të hidhërimit në kuptimin që njohim ne; përkundrazi, *hidhërim* i All’llahut do të thotë “*vullnet i ndëshkimit*”, ndërsa *kënaqësi* e Tij do të thotë “*vullnet i sevapit, shpërblimit*”.

Ajeti i fundit, si përmbledhje kuptimplotë, thotë: “**Ne i bëmë ata shembull dhe mësim për popujt e mëvonshëm.**”.

Fjala “*esselefu*”, ka kuptiminin e *çdo gjëje paraprirëse*, prandaj për *brezat e mëparshëm* thuhet *selef*, ndërsa për *brezat e ardhshëm* thuhet *khalf*. Gjithashtu, me këtë fjalë emërtohen edhe procedurat që kryhen para blerjes së diçkaje me *selefen*, që do të thotë: *kapar*, kur çmimi i blerësit paguhet më parë.

E njëjta gjë thuhet edhe për fjalët rreth njerëzve, si mësim, leksion. Historia e Faraonit dhe fundi i tij i dhimbshëm është një mësim i madh që përmendet në këto ajete, si një këshillë për popujt e tjerë.

¹“*Mufredatu Ragib*”, lënda “*esefe*”.

Ajetet 57-62

وَلَمَّا ضَرَبَ ابْنُ مَرْيَمَ مَثَلًا إِذَا قَوْمُكَ مِنْهُ يَصِدُّونَ ۝ وَقَالُوا آلِهَتُنَا خَيْرٌ أَمْ هُوَ مَا ضَرَبُوهُ لَكَ إِلَّا جَدَلًا بَلْ هُمْ قَوْمٌ خَصِمُونَ ۝ إِنْ هُوَ إِلَّا عَبْدٌ أَنْعَمْنَا عَلَيْهِ وَجَعَلْنَاهُ مَثَلًا لِبَنِي إِسْرَائِيلَ ۝ وَلَوْ نَشَاءُ لَجَعَلْنَا مِنْكُمْ مَلَائِكَةً فِي الْأَرْضِ يَخْلُفُونَ ۝ وَإِنَّهُ لَعِلْمٌ لِلْسَّاعَةِ فَلَا تَمْتَرُنَ بِهَا وَاتَّبِعُونِ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ۝ وَلَا يَصُدَّنَّكُمُ الشَّيْطَانُ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُبِينٌ ۝

“Kur u soll si shembull i biri i Merjemes (Isai), populli yt menjëherë nisi të qeshë prej tij.”

“E ata thanë: ‘A janë më të mirë idhujt tanë apo ai?’. Ata ta paraqesin këtë shembull vetëm për shkak se duan polemikë, sepse janë popull grindavec.”

“Isai ishte vetëm një rob, të cilit Ne i dhuruam (Profeci) dhe e bëmë shembull për bijtë e Izraelit.”

“Sikur të duam, Ne (do t’ju shkatërronim dhe) në vendin tuaj do të bënim engjëj, që do t’ju trashëgonin në Tokë.”

“Në të vërtetë, Isai është shenjë e Orës (së Kiametit), në ardhjen e të cilës mos dyshoni kurrsesi. Pra, ndiqmëni mua, kjo është Rruga e Drejtë!”

“Le të mos ju shmangë kurrsesi djalli! Ai është vërtet armiku juaj i hapët.”

Shkaku i zbritjes

Në historinë e ibn Hishamit thuhet: Një ditë, i Dërguari i All'llahut u ul bashkë me Uelid ibn Mugiretun në xhami. Aty erdhi edhe En Nadr ibn Harith, i cili u ul bashkë me ta. Në kuvend nuk kishte njeri tjetër prej burrave kurejshitë. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) foli dhe Nadr ibn Harith e kundërshtoi. Profeti, foli me argumenta derisa e bëri atë të heshtë. Pastaj u lexoi atyre ajetet: **“Me të vërtetë, ju (idhujtarë) dhe idhujt që i adhuronin në vend të All'llahut, do të jeni lëndë djegëse për Xhehennemin. Ju do të vini në të. Sikur këta të ishin zota (të vërtetë), nuk do të vinin atje dhe të gjithë do të mbeten përherë aty.”**¹

Pastaj, i Dërguari i All'llahut u ngrit. Në ato momente erdhi Abdullah ibn Za'berij Es Sehmij, i cili iu ul. Uelidi ibn Mugiretu i tha atij: Për Zotin, Nadir ibn Harith nuk ishte i pranishëm pak më parë me të birin e Abdullahut dhe as nuk u

¹ Sure “El Enbija”, ajetet 98, 99.

ulën. Muhammedi tha se ne dhe këta zota që adhurojmë do të jemi lënda e Xhehennemit. Abdullahu tha: Po ta gjeja këtu, për Zotin, do ta kundërshtoja, por ju pyeteni Muhammedin: A të gjithë ata që adhurojnë tjetër kënd pos All'llahut, janë në Xhehennem bashkë me ato që e kanë adhuruar Atë? Ne adhurojmë engjëjt, kurse çifutët adhurojnë Uzejrin, të krishterët adhurojnë Isanë, të birin e Merjemes (*Paqja qoftë mbi ta!*). Uelidi, bashkë me ata që ishin të pranishëm në kuvend u habitën nga fjala e Abdullah ibn Za`berij. Ata menduan se aidebatoi dhe kundërshtoi. Kjo gjë që tha ibn Za`berij iu përcjell të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili tha: “Në të vërtetë, kushdo që adhuron tjetër pos All'llahut, ai është bashkë me atë që adhuroi. Me të vërtetë, ata adhurojnë shejtanët dhe ata që i kanë urdhëruar t'i adhurojnë ato.”¹

Pas kësaj zbriti ajeti 101 i sures “Enbija”, ku thuhet: **“Ndërsa ata të cilëve u ka prirë mirësia Jonë qysh më parë, do të jenë larg nga Xhehennemi.”**. Po ashtu zbriti edhe ajeti i parë (ajeti 57) prej ajeteve në fjalë: **“Kur u soll si shembull i biri i Merjemes (Isai), populli yt (o Muhammed) menjëherë nisi të qeshë.”**.

¹ Sijretu Ibn Hisham, vëll.1, f. 385, me pakëz shkurtim.

Komentimi

Cilët zota janë në Xhehennem?

Këto ajete flasin rreth pozitës së të qënit të Mesiut (*Paqja qoftë mbi të!*) rob i All'llahut dhe mohojnë thënien e politeistëve për hyjninë e tij dhe hyjninë e statujave. Këto ajete janë plotësim i hulumtimeve të kaluara në ajetet e mëparshme rreth thirrjes së Musait dhe luftës së tij ndaj paganizmit faraonik, paralajmërimit të politeistëve në kohën e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe gjithë politeistëve të botës.

Pavarësisht se ajetet flasin për paqartësi, mirëpo përmbajtja e tyre nuk është e ndërlikuar dhe as enigmatike për shkak të argumenteve që gjenden në këto ajete dhe në ajete të tjera të Kur'anit, me gjithë komentet e ndryshme që përmendin komentuesit.

Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë thotë: **“Kur u soll si shembull i biri i Merjemes (Isai), populli yt menjëherë nisi të qeshë prej tij.”**¹

Çfarë ishte ky “shembull”? Kush ishte ai që foli për të vërtetën e Isait, të birit të Merjemes?

Kjo është një pyetje për të cilën komentuesit kanë dhënë përgjigje të ndryshme, por thellimi në ajetet në vijim e qartëson se

¹ Fjala “jesuddune” vjen nga “saddë”. Koha e tashme e saj është me “kesre”(zanore i), që do të thotë të qeshurit, të bërtiturit, shkaktimi i zhurmës nga turma e çrregullt, kur lidhen dorë më dorë në tallje dhe përqeshje.

“shembulli” ishte nga ana e politeistëve dhe u soll për idhujt, sepse në ajetet pasuese lexojmë: **“...Ata ta paraqesin këtë shembull vetëm se duan polemikë...”**.

Duke e vërejtur këtë të vërtetë dhe atë çka u tha për shkakun e zbritjes, bëhet më e qartë se qëllimi me “shembullin” nënkuptohet tallja e idhujtarëve kur dëgjuan ajetin e bekuar: **“Me të vërtetë, ju (idhujtarë) dhe idhujt që i adhuronit në vend të All’Ilahut, do të jeni lëndë djegëse për Xhehennemin.”**¹ Ata thanë se edhe Isai, i biri i Merjemes, ishte i adhuruar, prandaj, sipas këtij ajeti, edhe ai duhet të ishte në Xhehennem. E ku ka gjë më të mirë sesa të jemi ne dhe putat tona bashkë me Isain?! E thanë atë dhe qeshën, u tallën dhe ironizuan!!

Më pas, ata vazhduan të thonin: **“E ata thanë: ‘A janë më të mirë idhujt tanë apo ai..?’”**. Nëse është nga banorët e Xhehennemit, atëherë zotat tanë nuk janë më të mirë se ai, as më të lartësuar!

Por, dije mirë se këta e dinë të vërtetën: **“...Ata ta paraqesin këtë shembull vetëm për shkak se duan polemikë, sepse janë popull grindavec.”**²

Në të vërtetë, këta e dinë mirë se zotat, të cilët i çojnë në Xhehennem, janë ata që ishin të kënaqur me adhurimin e adhuruesve të tyre, njëllon si Faraoni që i ftonte në adhurimin e tij, jo si Mesia (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili vazhdonte ta refuzonte këtë veprim të tyre dhe ishte larg këtij veprimi.

¹ Sure “El Enbija”, ajeti 98.

²Fjala “khasimune” është shumësi i “khasimun”, dhe bëhet fjalë për atë njeri që polemizon dhe kundërshton shumë.

Madje: **“Isai ishte vetëm një rob, të cilit Ne i dhuruam (Profeci) dhe e bëmë shembull për bijtë e Izraelit.”**. Lindja e tij pa baba ishte një prej argumenteve të All’llahut, ndërsa të folurit e tij në djep, ishte një argument tjetër. Çdo mrekulli prej mrekullive të tij ishte një shenjë e qartë e madhështisë së All’llahut të Madhëruar dhe e pozitës së profecisë së tij.

Isai ka qenë shumë i vendosur gjatë gjithë jetës së tij në adhurimin e All’llahut. Ai i ftoi të gjithë në adhurimin e Tij. Për sa kohë që ishte i pranishëm në popullin e tij, ai nuk lejoi askënd të shmangej nga rruga e Njehsimit. Të krishterët e shpikën trillimin e shenjtërisë së Mesiut dhe të trinisë, pas tij.¹

¹ Në komentimin e ajeteve të mësipërme janë hedhur shumë hipoteza, ku asnjëra prej tyre nuk përshtatet me përmbajtjen e ajeteve:

1- Disa komentues thonë se ajo që synojnë idhujtarët me “shembullin” që sollën, është se pas përkujtimit të Mesias dhe historisë së tij në ajetet e Kur’anit, ata thanë se Muhammedi po përgati terrenin që të na ftojë në adhurimin e tij. Por Kur’ani, në pozitën e mbrojtjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thotë: “Mesiu nuk pretendontese ishte Zot dhe ai (Muhammedi), gjithashtu, nuk do ta bëjë këtë.”.

2- Të tjerë komentues thonë se ajo që nënkuptohet prej “shembullit” në ajetet e përmendura, është përngjasimi që ka përmendur All’llahu i Madhëruar në çështjen e Mesiut, në ajetin 59 të sures “Ali Imran”, ku thotë: **“Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu e pastaj atij i tha: ‘Bëhu!’, ai u bë.”**. Nëse Isai është lindur pa baba, kjo nuk shkakton habi, se dhe Ademi u krijua pa baba dhe pa nënë, madje nga dheu, me urdhrin e All’llahut të Lartësuar.

3- Komentues të tjerë mendojnë se ajo që nënkuptohet me “shembullin”, është fjala e idhujtarëve: Nëse të krishterët kanë adhuruar Mesiun, atëherë përse nuk mund të jenë zotat tanë që janë më lart se ai, meritues të adhurimit?!

Është interesante se në transmetime të shumta që përmenden te shiitët dhe synitët lexojmë se Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka thënë Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Në të vërtetë, tek ti gjendet një ngjashmëri me Isain. Atë e deshën një komb dhe u shkatërruan për këtë, si dhe e urryen një komb dhe prapë u shkatërruan për këtë.”. Munafikët thanë: A nuk kishte shembull tjetër për atë veç Isait? Atëherë zbriti ajeti: “**Kur u soll si shembull i biri i Merjemes (Isai), populli yt menjëherë nisi të qeshë prej tij.**”.

Këtë transmetim që përmendëm e ka përcjellë El Hafidh Ebu Bekr Merdeuijeh, një nga dijetarët e njohur të Ehli Syneetit, në librin e tij “El Menakib” sipas transmetimit të autorit të “Keshful Gummeti”, në faqen 95.

Këtë ngjarje e kanë transmetuar dhe një grup dijetarësh të Ehli Syneetit dhe disa dijetarë të shquar të shiitëve nëpër shumë

Po të shihen me vëmendje veçoritë që janë përmendur në këto ajete, bëhet më se e qartë, se asnjëri nga këto tre komente nuk është i vërtetë, sepse ajetet e sqarojnë shumë mirë:

Së pari - se “shembulli” ishte nga ana e idhujtarëve.

Së dyti- tema shkaktoi zhurmë dhe potere, çka ishte qesharake sipas tyre.

Së treti - ishte diçka në kundërshtim me pozitën e adhurimit të Mesiut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Së katërti -ai realizonte qëllimin e tyre, që është polemika për një çështje që ishte e pavërtetë.

Këto veçori janë në përputhje vetëm me atë që thamë në tekstin e komentimit.

libra, herë pa e përmendur ajetin e mësipërm dhe herë duke e përmendur atë.¹

Argumentet e pranishme në ajete të japin të kuptosh se ky hadith i njohur është si vërtetësi dhe nuk është shkak i zbritjes së ajetit. Shkaku i zbritjes së ajetit është historia e Isait dhe thëniet e politiesitëve. Mirëpo, përderisa Aliut i ndodhi diçka e njëjtë si ajo e Isait, atëherë Profeti e lexoi këtë ajet që ta bënte të qartë se kjo ngjarje rreth Aliut ishte e njëjtë me ngjarjen e Isait në anë të ndryshme.

Mos të mendojnë se All'llahu i Madhëruar ka nevojë për adhurimin e tyre. Ajeti në vijim thotë: **“Sikur të duam, Ne (do t’ju shkatërronim dhe) në vendin tuaj do të bënim engjëj, që do t’ju trashëgonin në Tokë.”**. Sigurisht, engjëj i nënshtrohen urdhrave të All'llahut dhe nuk njohin vepër tjetër përveç bindjes dhe adhurimit të Tij.

Një grup dijetarësh zgjodhën një koment tjetër për ajetin, kuptimi i të cilit nis me rrënjën e tij: Dhe po të duam Ne, do t’i bënim bijtë tuaj engjëj që do t’ju zëvendësonin ju në Tokë. Bazuar mbi këtë, atëherë mos u habitni që Mesia lindi pa baba. Padyshim që All'llahu i Madhëruar është i aftë të krijojë një engjëll prej njeriut.²

¹Për të mësuar më shumë, shih: “Ihkakul Hakki”, vëll. 3, f. 398; më tej: tefsiri “Nuru thThekalejn” vëll. 4, f. 609, tefsiri “Mexhmaul Bejan”, fundi i ajeteve në fjalë.

² Komentin e parë e ka zgjedhur Tabrasij në tefsirin “Mexhmaul Bejan”, Shejkh Tusij në tefsirin “Et Tibjan”, Ebu Fetuh Rrazij në tefsirin “Ruhul Xhinan”, e të tjerë. Kurse komentin e dytë e kanë transmetuar Kurtubijju dhe Alusi në tefsirin “Ruhul Meanij”, Zamkhasheriju në tefsirin “El Keshshaf” dhe Meragij

Meqenëse lindja e engjëllit prej njeriut është e papërshtatshme, disa komentues të mëdhenj e kanë komentuar ajetin me lindjen e fëmijëve, të cilët gëzojnë cilësitë e engjëjve, duke thënë: Ajo që synohet është: Mos u çudisni që një rob si Mesia të ketë fuqi për të ringjallur të vdekurit, të shërojë të sëmurët me lejen e All'llahut, e në të njëjtën kohë të jetë rob i singertë dhe i bindur ndaj urdhërave të All'llahut. S'ka dyshim që All'llahu është i Plofuqishëm që të krijojë prej fëmijëve tuaj nga ata që mbartin cilësitë e engjëjve dhe natyrën e tyre.¹

Mirëpo, komentimi i parë harmonizohet më shumë me fillimin e ajetit se sa komentimet e tjera. Komentet e tjera janë larg të vërtetës.²

Ajeti vijues tregon një veçori tjetër prej veçorive të Mesiut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur thotë: “Me të vërtetë, Isai është shkak i parashenjës së Kiametit: **“Në të vërtetë, Isai është shenjë e Orës (së Kiametit)...**”, ndërsa lindja e tij pa baba është argument i fuqisë së pafundme të All'llahut, që ndriçon me dritën e Tij çështjen e jetës pas vdekjes. Në shumë transmetime qartësohet se kjo zbritje e Mesiut nga qielli përbën argumentin e afrimit të Ditës së Kiametit.

Xhabiri, biri i Abdullahut, thotë: Kam dëgjuar të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të thotë: “Zbret Isai, i biri i Merjemes dhe i thotë prijësi i

në tefsirin e tij. Ata kanë thënë se ky është kuptimi i vetëm i ajetit, apo se është një nga kuptimet e tij.

¹ Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 18, fundi i ajetit në fjalë.

² Sipas tefsirit të parë, “min” është për “zëvendësim”. Sipas tefsirit të dytë dhe të tretë, “min” është me sjellë në ekzistencë dhe pikënisje.

tyre: 'Eja dhe falu me ne!' Ai i përgjigjet: 'Jo! Në të vërtetë, të qenit tuaj prijës të njëri-tjetrit, është nderim i All'llahut për këtë ymet.'".¹

Në një hadith tjetër lexojmë se Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Si do të jeni kur të zbresë në mesin tuaj i biri i Merjemes, ndërsa imami juaj do jetë prej jush?!".²

Sido që të jetë, përdorimi i fjalës "el ilmu" për Mesiun, është një lloj përforcimi dhe metafore. Ajo është tregues se zbritja e tij në mënyrë përfundimtare, është prej shenjave të Kiametit.

Gjithashtu, mendohet se përemri "ennehu" i referohet Kur'anit, kështu që kuptimi i ajetit bëhet: Vërtet që zbritja e Kur'anit, që është Libri i fundit qiellor, është argument i afrimit të Kiametit dhe lajmëron për ndodhinë e tij.

Ajetet e mëparshme dhe ato që vijnë pas, e përforcojnë komentimin e parë.

Ajeti thotë se ardhja e Kiametit është përfundimtare, se ai është i afërt: "**...në ardhjen e të cilës mos dyshoni kurrsesi...**", as nga ana e besimit dhe as nga ana e të qenit të pavëmendshëm ndaj kësaj ngjarjeje.

"...Pra, ndiqmëni mua, kjo është Rruga e Drejtë!". Cila rrugë është më e drejtë sesa ajo që ju lajmëron për të ardhmen e rrezikshme që ju pret, e që tregon rrugën e shpëtimit prej rreziqeve të Ditës së Kiametit?

¹ Ky hadith është përcjellë nga autori i tefsirit "Mexhmaul Bejan", i cili e ka marrë nga "Sahihu" i Muslimit, në fundin e ajeteve në fjalë.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajetit në fjalë; Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 25, f. 88.

Shejtani dëshiron t'ju mbajë në botën e hutimit dhe të lidhjes me të, prandaj kini kujdes: **“Le të mos ju shmangë kurrsesi djalli! Ai është vërtet armiku juaj i hapët.”**.

Armiqësia e tij për ju është shfaqur që herën e parë, në fillim me cytjen e tij ndaj babait dhe nënës suaj, Ademit dhe Havasë, me nxjerrjen e tyre nga Xhenneti, e herë tjetër kur u betua për humbjen e bijve të Ademit dhe mashtrimin e tyre, përveç më të sinqertëve ndër ta. Atëherë, si përuleni para këtij armiku të betuar, që është zotuar për dëmtimin dhe çuarjen tuaj drejt fundit në Xhehennem?!

Si e lejoni atë që të kontrollojë zemrat dhe shpirtrat tuaj dhe t'ju pengojë në Rrugën e të Vërtetës, së Drejtës, me ngacmimet dhe mashtrimet e tij të vazhdueshme?!

Ajetet 63-65

وَلَمَّا جَاءَ عِيسَىٰ بِالْبَيِّنَاتِ قَالَ قَدْ جِئْتُكُمْ بِالْحِكْمَةِ وَلِأُبَيِّنَ لَكُمْ بَعْضَ الَّذِي تَخْتَلِفُونَ فِيهِ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ هُوَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ۚ فَاخْتَلَفَ الْأَحْزَابُ مِنْ بَيْنِهِمْ فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْ عَذَابٍ يَوْمَ أَلِيمٍ ۚ

“E, kur Isai solli argumente të qarta, tha: ‘Ju kam sjellë urtësinë (Profecinë) dhe do t’ju shpjegoj disa gjëra, për të cilat nuk popajtoheni. Prandaj, frikësojuni All’llahut dhe bindmuni mua!’”

“Pa dyshim, All’llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është Rruga e Drejtë!”

“E megjithatë, sektet e ndryshme patën kundërshti midis tyre. Mjerë ata që kanë bërë padrejtësi – për dënimin e Ditës së dhembshme!”

Komentimi

Ata që e tepruan për Mesiun

Në ajetet u përmend një anë e veçorive të jetës së Mesiut (*Paqja qoftë mbi të!*). Këto ajete në fjalë e plotësojnë më tepër, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në thirrjen e Mesiut në Njehsimin e singertë dhe ndalimin e çdo lloj forme të idhujtarisë dhe të politeizmit.

Në fillim, ajeti i parë thotë: **“E, kur Isai solli argumente të qarta, tha: ‘Ju kam sjellë urtësinë (Profecinë) dhe do t’ju shpjegoj disa gjëra, për të cilat nuk po pajtoheni...’”**; këto të fundit ishin *“bejjinatet”*, domethënë *argumentete* All’llahut dhe *mrekullitë*, gjërat themelore të Isait, me anë të të cilave ai sqaronte vërtetësinë e tij në njërën anë, kurse në anën tjetër dëshmonte të vërtetat në lidhje me zanafillën dhe fundin, Kiametin dhe nevojat e jetës njerëzore.

Isai (*Paqja qoftë mbi të!*) e përshkruan përmbajtjen e thirrjes së tij me fjalën *“hikmet”*, që do të thotë: *urtësi*. Dimë se themeli i urtësisë është ndalimi prej një gjëje, me qëllim përmirësimin e saj. Më vonë, me këtë u emërtuan besimet e vërteta, programet e vërteta të jetës, të cilat e mbrojnë njeriun nga llojet e ndryshme të devijimit në vepra e në besim si dhe edukojnë shpirtin e tij me morale të pëlqyera. Për këtë, urtësia këtu ka kuptim të gjerë që përfshin *“urtësinë teorike”* dhe *“urtësinë praktike”*.

Kjo urtësi, në shtesë të atyre që u tha më lart, ka një qëllim tjetër që është largimi i mosmarrëveshjeve që prishin sistemin e

shoqërisë dhe i bën njerëzit të çorientuar dhe konfuzë. Pikërisht, për këtë shkak e shohim Mesin (Paqja qoftë mbi të!) të fokusuar ndaj kësaj çështjeje.

Këtu shtrohet një pyetje, e cila ka tërhequr vëmendjen e shumicës së komentuesve: Përse Isai thotë: **“...Ju kam sjellë urtësinë (Profecinë) dhe do t’ju shpjegoj disa gjëra, për të cilat nuk po pajtoheni...”**? Përse nuk thotë: “që t’jua sqaroj të gjithëve”?

Për këtë pyetje janë dhënë përgjigje të shumta, nga të cilat, më kryesoret janë:

Mosmarrëveshjet midis njerëzve janë dy llojesh: Disa prej tyre ndikojnë në rrugëtimin e tyre për nga ana e besimit dhe e veprimit. Ka prej tyre që nuk kanë lidhje me rrugëtimin, siç janë teoritë e ndryshme rreth formimit të sistemit diellor dhe qiejve, mënyra si janë krijuar orbitat dhe yjet, esenca e shpirtit të njeriut dhe e vërteta e jetës, e të tjera si këto.

Është më se e qartë, se Profetët janë ngarkuar me detyrën e sheshimit të mosmarrëveshjeve nga rrënjët, që t’i shkulin ato nëpërmjet qartësimit të të vërtetave. Sigurisht, ata nuk janë ngarkuar me shterrimin e të gjitha mosmarëveshjeve që ndodhin mes njerëzve.

Mendohet se sqarimi i disa mosmarëveshjeve është rezultat dhe qëllim i thirrjes së Profetëve; domethënë se në fund, ata do të dalin me sukses në zgjidhjen e disa mosmarëveshjeve. Për sa i përket zgjidhjes së të gjitha mosmarëveshjeve të dynjasë, kjo është e pamundur. Prandaj, në shumë ajete të Kur'anit të Lavdishëm bëhet e qartë se një nga veçoritë e Kiametit, është largimi dhe

shterrimi i të gjithë mosmarëveshjeve. Këtë e lexojmë në ajetin 92 të sures “Nahl”, ku thuhet: **“E në Ditën e Gjykimit, Ai gjithsesi do t’ju sqarojë atë gjë rreth të cilës kundërshtoheshit.”**

Ky kuptim përmendet në ajetin 55 të sures “Ali Imran”, 48 të sures “Maide”, 164 të sures “En’Am”, 69 të sures “Haxh”, e të tjerë.¹

Në fund, ajeti shton: **“...Prandaj, frikësojuni All’liahut dhe bindmuni mua!”**.

Me qëllim që të largohet çdo lloj paqartësie për çështjen e të qenit të Mesiut rob i All’liahut, ajeti thotë: **“Pa dyshim, All’lahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhuroni vetëm Atë...!”**.

Ajo që tërheq vëmendjen, është përsëritja në këtë ajet, e fjalës “*rabbun*” dy herë, një herë në të drejtën e tij dhe një herë në të drejtën e njerëzve. Kjo, për t’ua bërë të qartë njerëzve se: *unë dhe ju jemi të barabartë, se Zoti im dhe Zoti juaj janë Një. Unë jam njëlloj si ju, kam nevojë me gjithë qenien time për Krijuesin, Projektuesin, sepse Ai është Sunduesi im...*

Për ta përforcuar më tej këtë çështje, ajeti shton e thotë: **“...prandaj adhuroni vetëm Atë...”**, pasi nuk e meriton adhurimin askush pos Tij, nuk i shkon adhurimi vetëm se Atij, se Ai është

¹Disa komentues të tjerë kanë thënë se shprehja “*ba’dun*” këtu ka kuptimin të gjithë, ose shprehja “**atë pjesë që e kundërshtonit**”, është një shtesë e përshkruesit për të përshkruarin, ose kjo shprehje tregon se: *unë u sqaroj vetëm çështjet e fesë, e jo mosmarrëveshjet tuaja në lidhje me dynjanë*. Mirëpo, asnjë nga këto komente nuk meritojnë t’i kushtojmë vëmendje.

All'Ilahu, ndërsa të tjerët që të gjithë janë të zotëruar. Ai është Sunduesi, kurse të tjerët që të gjithë janë të sunduar.

Më pas, ajeti e mbështet argumentin e tij në një fjali tjetër, që të mos ketë për mëtuesit asnjë justifikim, teksa thotë: **"...Kjo është Rrugë e Drejtë!"**.¹

Rrugë e Drejtë është Rrugë e adhurimit të All'Ilahut të Madhëruar. Ajo rrugë e cila nuk ka asnjë shmangie në të, asnjë deformim, siç dhe thuhet në ajetin 61 të sures "Jasin": **"Të më adhuron Mua, kjo është Rrugë e sigurtë!"**.

Habia qëndron në kontradiktat mes popujve, pas konfirmimeve të qarta: **"E megjithatë, sektet e ndryshme patën kundërshti midis tyre..."**.²

Një pjesë thanë se ai është Zoti që zbriti në Tokë!

Disa të tjerë e konsideruan atë si bir të Zotit të tij.

Të tjerë thanë se ai është një nga tri hyjnitë, tre unet e shenjta: Ati, biri dhe shpirti i shenjtë.

Është edhe një grup i vogël, të cilët e konsiderojnë atë si rob të Zotit dhe si të Dërguarin e Tij, por besimi i shumicës e ka përgjithësuar çështjen e trinisë dhe tre zotave të botës së krishterë.

¹ Një shembull i ngjashëm i këtij ajeti, me një ndryshim të lehtë, përmendet në suren "Merjem" ajeti 36, dhe në suren "Ali Imran", ajeti 51. Përsëritja e këtij kuptimi është përforcim i faktit se Isai (Paqja qoftë mbi të!) e ka përmbushur argumentin e adhurimit dhe të të qenit vetëm rob i All'Ilahut të Madhëruar.

² Përemri në "*bejnehum*" u referohet atyre që u foli Mesia (Paqja qoftë mbi të!) në ajetin e mëparshëm, kur i ftoi ata në adhurimin e All'Ilahut të Madhëruar.

Për këtë çështje transmetohet një ngjarje historike mbresëlënëse, që e kemi përmendur në fundin e ajetit 36 të sures “Merjem”.

Në komentimin e ajetit supozohet, gjithashtu, se mosmarrëveshja nuk gjendej vetëm mes të krishterëve, por kishte mosmarrëveshje edhe mes çifutëve e të krishterëve për Mesin. Ndjekësit e tij tepruan në të dhe e ngritën në pozitën e hyjnisë, në një kohë kur armiqtë e tij e akuzonin atë dhe nënën e tij, me akuza të shpifura dhe të ulëta. Kështu është morali dhe zakoni i injorantëve. Një pjesë synojnë teprimin e gjërave, kurse të tjerët shkojnë drejt abuzimit dhe neglizhencës. Në lidhje me ta, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “*Lidhur me mua, do ta pësojnë dy grupe njerëzish: ata që më duan së tepërmi, sepse kjo dashuri i largon nga e vërteta, dhe ata që më urrejnë së tepërmi, sepse urrejtja i largon nga e vërteta.*”¹

Sa shumë që ngjajnë situatat me njëra-tjetrën!

Në fundin e ajetit, All’llahu i Madhëruar i kërcënon ata me dënimin e dhimbshëm të Ditës së Kiametit, ku thotë: “**...Mjerë ata që kanë bërë padrejtësi – për dënimin e Ditës së dhembshme!**”²

S’ka dyshim që Dita e Kiametit është e dhembshme, sepse llogaridhënia e gjatë është torturë e vërtetë. Ndëshkimet e saj janë të rënda dhe hidhërimi i saj është i padurueshëm.

¹“Nehxhul Belaga”, Fjalët e shkurtra, Fjala 117.

²Duhet patur kujdes se fjala “elimnu”, që do të thotë *i dhembshëm*, është cilësim i ditës dhe jo i dënimit.

Ajetet 66-69

هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا السَّاعَةَ أَنْ تَأْتِيَهُمْ بَغْتَةً وَهُمْ لَا يَشْعُرُونَ ٦٦ الْأَخِلَّاءُ
يَوْمَئِذٍ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ إِلَّا الْمُتَّقِينَ ٦٧ يَا عِبَادِ لَا خَوْفٌ عَلَيْكُمْ
الْيَوْمَ وَلَا أَنْتُمْ تَحْزَنُونَ ٦٨ الَّذِينَ آمَنُوا بِآيَاتِنَا وَكَانُوا مُسْلِمِينَ ٦٩

“A mos presin ata diçka tjetër, përveç Orës (së Kiametit), qëdo t’u vijë papritmas e pa e ndier fare?!”

“Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë All’llahun.”

“(All’llahu do t’u thotë): ‘O robtë e Mi, për ju sot nuk ka frikë dhe as që do të pikëlloheni.’”

“Ju që keni besuar Shpalljet Tona dhe keni qenë myslimanë.”

Komentimi

Çfarë prisni tjetër, përveç dënimit të Ahiretit?

Fjala në ajetet e mëparshme sillej rreth adhuruesve kokëfortë të putave, si dhe rreth të devijuarve e idhujtarëve nga ymeti i Isait (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajetet në fjalë tregojnë fundin e çështjes së tyre. All'Ilahu thotë: **“A mos presin ata diçka tjetër, përveç Orës (së Kiametit), që do t’u vijë papritmas e pa e ndier fare?!”**.

Këto ajete sqarojnë situatën e vërtetë të këtyre njerëzve. Ato tregojnë pozitën e qortimit të një njeriu, i cili nuk dëgjon këshillën e këshilluesit, por përgatit faktorët e shkatërrimit me dorën e vet.

Fjala *“saatun”*, ka për qëllim *“Kiametin”*, në këtë ajet, si dhe në shumë ajete të tjera kur’anore, i referohet Ditës së Kiametit, sepse ngjarjet do të ndodhin shpejt, aq sa duket sikur ndodhin vetëm brenda një ore të vetme.

Kjo fjalë, gjithashtu, është përmendur në kuptimin e çastit të fundit të dynjasë. Kjo mënyrë të shprehuri është përfshirëse e të dyja kuptimeve.

Si do që të jetë, Dita e Kiametit, e cila fillon me fundin katastrofik dhe të menjëhershëm të dynjasë, është përshkruar në ajetin e mësipërm në dy aspekte: **I pari:** të qëniet e saj e befasueshme. **I dyti:** Mungesa e dijes te njerëzit se kur do të ndodhë ajo.

Është e mundur që Kiameti të ndodhë menjëherë dhe papritmas, por ne presim që të ndodhë më parë, që të jemi të përgatitur në përballimin e problemeve që rezultojnë si shkas i tij, vetëm se shansi i keq dhe pikëllues është që ndodhia të jetë katastrofike, e pamëshirshme, shumë e vështirë, në mënyrë të befasishme, kështu që ne mbetemi plotësisht të pavëmendshëm ndaj saj.

Kështu është edhe situata e zullumqarëve. Ata do të merren kur të jenë në hutim të plotë, siç e kanë përshkruar transmetimet e përmendura nga Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili thotë: *"Do të vijë Kiameti kur dy burra janë duke mjel delet dhe dy të tjerë duke palos rrobat."* Më pas, ai lexoi ajetin: **"A mos presin ata diçka tjetër, përveç Orës (së Kiametit), që do t'u vijë papritmas e pa e ndier fare?!"**¹

A ka gjë më të dhimbshme sesa një njeri që është i pavëmendshëm para një ngjarjeje të tillë, që nuk ka rrugë për t'u kthyer pas dhe asnjë mënyrë shpëtimi, i cili mbytet në dallgët e egra, pa qenë i përgatitur me mjetet e duhura të shpëtimit?

Më pas ajeti flet për gjendjen e miqëvetë ngushtë, të cilët e duan njëri-tjetrin, ecin së bashku në rrugën e mëkatit, të shkatërrimit dhe mashtrimit në zbukurimin e dynjasë: **"Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë All'llahun."**²

¹ Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 25, f. 89.

²Fjala *"el ekhil'lau"*, që do të thotë: *"miqtë e ngushtë"*, është shumësi i *"khalil"*, në kuptimin e respektit dhe të dashurisë. Rrënja e saj është nga *"khalel"*, që do të thotë *"ndarje"*, njëlloj si *"sheref"*, që domethënë *"ndarje midis dy trupave"*.

Ky ajet përshkruan panoramën nga Dita e Kiametit. Ai sqaron se fjala “*saah*”, që gjendet në ajet, regon për Ditën e Kiametit, dita në të cilën shkëputen lidhjet vëllazërore, shoqërore dhe miqësore të padenja, përveç lidhjeve që janë krijuar për hir të All’llahut.

Zëvendësimi atë ditë, i kësaj dashurie me armiqësi, është diçka normale, sepse secili prej tyre e shikon shokun si shkakun e hidhërimit dhe fundit të tij të hidhur: Je ti, ai që më nisi në këtë rrugë, që më futi në të. Je ti, ai që në shikimin tim ma zbukuroi këtë dynja, që ma bëri ta dëshiroja dhe shijoja atë. Je ti, ai që më mbyti në detin e hutimit dhe të mendjemadhësisë, që më bëri si të çartur, sa të mos e shihja fundin e rrugës sime, që më bëri të pavëmendshëm ndaj tij.

Kështu do t’i thonë shoku-shokut të gjithë të prishurit, përveç atyre që patën frikë All’llahun, tek të cilët lidhja vëllazërore dhe kontrata e dashurisë janë të përherëshme.

Është normale që miqtë e ngushtë të ndihmojnë njëri-tjetrin në çështjet e përballimit të dynjasë. Nëse shoqëria e tyre është ndërtuar në bazë të së keqes dhe shkatërrimit, atëherë ata janë ortakë në mëkat dhe krim, por nëse është ndërtuar mbi bazën e së mirës dhe shpëtimit, atëherë ata janë ortakë në sevape, mirësi dhe dhurata. Prandaj, nuk ka arsye për t’u çuditur, që një ditë, miku i ngushtë të të shndërrohet në armik, ashtu sikurse për mikun të të shtohet dashuria dhe respekti shumë më tepër se më parë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “Çdo miqësi e ngushtë, që ka qenë në dynja jo për hir të All’llahut të Madhëruar, në Ditën e Kiametit do të kthehet në armiqësi.”¹

Ajeti në vijim, në realitet është qartësim i përshkrimeve të të përkushtuarve dhe situatave të tyre. Është manifestim i veprave përfundimtare, të cilat nxisin krenarinë dhe madhështinë e tyre. Në atë Ditë të vështirë, All’llahu i Madhëruar u thotë atyre:“ (All’llahu do t’u thotë): **‘O robtë e Mi, për ju sot nuk ka frikë dhe as që do të pikëlloheni.’**”.

Sa bukur tingëllon kjo thirrje! Thirrje e drejtpërdrejtë prej All’llahut të Madhëruar, pa ndërmjetës. Një thirrje që nis me cilësimin më të mirë: **“O robtë e Mi!”**. Një thirrje që e largon frikën e njeriut e që e pastron zemrën nga shqetësimi dhe dëshpërimi i së kaluarës.

Ajeti i fundit i sqaron besimtarët dhe robtë e nderuar, me përmendjen e dy fjalive, ku thotë: **“Ju që keni besuar Shpalljet Tona dhe keni qenë myslimanë.”**. Vërtet, këtyre u flitet në mënyrë madhështore dhe ata notojnë në mirësi.

Këto dy fjali janë një përkufizim domethënës dhe retorik për besimin dhe veprat e tyre, pasi ato sqarojnë besimin, që bën të qartë Islamin dhe dorëzimin e tyre ndaj urdhrave të All’llahut të Madhëruar.

¹ Tefsiri i “Ali ibn Ibrahim”t, vëll. 2, f. 287; Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 612.

Ajetet 70-73

ادْخُلُوا الْجَنَّةَ أَنْتُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ تُحْبَرُونَ^{٧٠} يُطَافُ عَلَيْهِمْ بِصِحَافٍ
مِنْ ذَهَبٍ وَأَكْوَابٍ وَفِيهَا مَا تَشْتَهِيهِ الْأَنْفُسُ وَتَلَذُّ الْأَعْيُنُ وَأَنْتُمْ
فِيهَا خَالِدُونَ^{٧١} وَتِلْكَ الْجَنَّةُ الَّتِي أُورِثْتُمُوهَا بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ^{٧٢}
لَكُمْ فِيهَا فَاكِهَةٌ كَثِيرَةٌ مِنْهَا تَأْكُلُونَ^{٧٣}

“Hyni në Xhennet, ju dhe bashkëshortet tuaja të gëzuar.”

“Ku do t’ju shërbehet me pjata dhe gota prej ari. Aty do të ketë çfarë t’ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë.”

“Ja, ky është Xhenneti që ju është dhënë në trashëgim për atë që keni bërë.”

“Aty do të keni fruta të shumëllojshme, prej të cilave do të hani.”

Komentimi

Aty do të kenë çfarë t'u dëshirojë shpirti dhe t'u kënaqet syri

Këto ajete qartësojnë shpërblimin e robëve të sinqertë të All'llahut dhe besimtarëve punëmirë. Ata përgëzohen me Xhennetin e përhershëm, duke u përkujtuar shtatë prej mirësive më të çmuara.

Në fillim u thuhet: **“Hyni në Xhennet...”**. Mikpritësi i tyre i vërtetë është All'llahu i Madhërishëm, i Cili i fton miqtë e Tij duke u thënë: Hyni në Xhennet!

Më pas përmendet mirësia e parë prej të gjitha mirësive të tjera dhe thuhet: **“...ju dhe bashkëshortet tuaja...”**. Është e qartë se të qenit e besimtarëve të mëshirshëm përkrah grave të tyre besimtare, u jep atyre së bashku kënaqësinë dhe gëzimin. Nëse kanë qenë ortakë dhe shoqërues në dëshpërimin e dynjasë, atëherë përsëri do të jenë ortakë në gëzimin e Ahiretit dhe entuziazmin e tij.

Disa komentues e kanë komentuar fjalën *“el ezvaxh”* me kuptimin e *të barabartëve në grada, të shokëve dhe të afërmëve*. Nëse është e vërtetë, atëherë prania e tyre është një mirësi e madhe. Megjithatë, fillimi i ajetit ka kuptimin e parë, pra bashkëshortet.

Më pas, ajeti shton: **“të gëzuar”**.

Fjala *“tuhberun”* vjen nga lënda: *“hibrun”*, që do të thotë: *impakti, afeksioni i kërkuar*. Ndonjëherë përdoret për *zbukurimin*

ose shenjat e gëzimit që shfaqen në fytyrë. Thuhet për dijetarët: *ahbarun*, që përkthehet: *të shkolluar, të ditur*, kjo për shkak të gjurmëve që lënë në shoqërinë njerëzore, siç thotë dhe Prijësi i besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*): “Dijetarët do të jenë, aq sa do jetë edhe koha. Mund t’i humbim nga shikimi, mirëpo shembujt, gjurmët e tyre në zemra janë të pranishme.”.¹

Në sqarim të mirësisë së tretë, ajeti thotë: **“Ku do t’ju shërbehet me pjata dhe gota prej ari...”**, pasi ata mikpritën dhe shërbehen me çastet më të bukura, ushqimet më të shijshme, në kulmin e qetësisë, rehatisë dhe lumturisë.

Fjala “*es sihaafu*” është shumësi i “*sihfetun*”, që në rrënjë vjen nga lënda e “*sihfun*”, që do të thotë “*zgjerim*”, ndërsa këtu ka kuptimin e *enëve të mëdhaja e të gjëra*; fjala “*ekvabun*” është shumësi i “*kubun*”, që janë ato gota uji që nuk kanë kapak.

Në ajet, fjala është për enët prej floriri, duke përjashtuar ushqimin dhe pijen e tyre.

Ndërsa në të katërtën dhe të pestën tregohen dy mirësi të tjera, ku janë bashkuar të gjitha mirësitë e botës materiale dhe shpirtërore. Në ajet thuhet: **“...Aty do të ketë çfarë t’ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin...”**.

I ndjeri Tabarsij, në tefsirin “*Mexhmaul Bejan*”, thotë: Sikur të gjitha krijesat të bashkohen në përshkrimin e mirësive dhe begative të Xhenetit, ato nuk do të jenë kurrë të afta që të shtojnë diçka më shumë nga ajo që përmendet në këtë fjali.

A ka shprehje më të mirë dhe më të bukur se kjo?

¹“*Nehxhul Belaga*”, Fjalët e shkurtra, fjala 147.

Është interesante se kënaqësia e shpirtit është përmendur e ndarë nga kënaqësia e syrit. Kjo ndarje ka kuptim të thellë: A është kjo përmendja e të specifikuarit pas të përgjithëshmit, ku dihet se kënaqësia e shikimit ka rëndësi të veçantë dhe është mbi kënaqësitë e tjera? Apo se fjalia: **"...çfarë t'ju dojë shpirti..."** sqaron kënaqësitë e shijes, nuhatjes, dëgjimit dhe të prekjes, ndërsa fjalia: **"...që ta kënaq syrin..."** sqaron kënaqësitë e syrit e të shikimit?

Disa studiues mendojnë se fjalia: **"...çfarë t'ju dojë shpirti..."**, është treguese e të gjitha kënaqësive trupore, kurse fjalia: **"...që ta kënaq syrin..."**, është treguese e kënaqësive shpirtërore; pra, cila kënaqësi është më e madhe në Xhennet, sesa të shohë njeriu me syrin e zemrës bukurinë e All'Ilahut, së cilës nuk i përngjason asnjë bukuri tjetër?! Pa dyshim, një çast prej atyre çasteve, i tejkalon të gjitha mirësitë materiale të Xhennetit!

Sa më shumë që të shtohet dashuria për të dashurin, aq më e madhe dhe më e bukur do të jetë shija e takimit me të.

Pyetje: A nënkupton nocioni i gjithëpërfshirjes në ajet, se ata do të kërkojnë nga All'Ilahu, lejimin e gjërave që ishin të ndaluara në dynja?

Përgjigje: Artikulimi i kësaj pyetjeje vjen si pasojë e të moskuptuarit, se të ndaluarat dhe të shëmtuarat janë ushqime që dëmtojnë shpirtin e njeriut. Shpirti i shëndoshë dhe i mirë nuk shijon ushqime të tilla, sepse ato anojnë nga helmimi. Pra, ushqimet dëmtuese janë për shpirtrat e sëmurë.

Ndonjëherë shohim disa të sëmurë që, edhe pse janë në gjendje të rënduar, duan të hanë dhe të ushqehen, por sapo

sëmundja largohet prej tyre, bashkë me të largohet edhe ky neps i gënjeshtërt.

Banorët e Xhennetit nuk do të tentojnë kurrë në veprime të tilla, sepse shmangia, prirja e shpirtit dhe tërheqja e tij prej saj, janë prej veçorive të shpirtave të sëmurë, të banorëve të Xhehennemit.

Kjo pyetje i përngjason asaj që përmendet në hadithin, ku tregohet se një banor i shkretëtirës (*a'rabijun*) erdhi te Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i tha: “*A ka deve në Xhennet? Sepse unë e dua devenë aq shumë, sa s’ka më!*”. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), iu kthye si ai që e dinte shumë mirë se në Xhennet kishte aq mirësi, sa me to arabi do ta harronte devenë. I tha: “*O banor i shkretëtirës (ja a’rabiju), nëse All’llahu do të të fusë ty në Xhennet, atëherë ti do të marrësh në të çfarë të të dojë shpirti dhe do të të kënaqen sytë.*”.¹

Thënë ndryshe: Atje është bota ku njeriu harmonizohet me të vërtetat.

Përderisa vlera e mirësisë është tek të qenit e përhershme, ajeti i qetëson banorët e Xhennetit duke u thënë: “**...dhe atjedo të qëndroni përgjithmonë.**”, me qëllim që të mos u turbullohet mendimi në largimin, heqjen e kësaj mirësie të lumturisë dhe kënaqësisë së tyre, e të mos frikësohen në të ardhmen.

Për të qartësuar se të gjitha këto mirësi të Xhennetit jepen si shpërblim, e jo rëndom, kot dhe pa meritë, ajeti shton: “**Ja, ky**

¹Tefsiri “Ruhul Bejan”, vëll. 8, f. 391.

është Xhenneti që ju është dhënë në trashëgim për atë qëkeni bërë.”.

Është interesante se nga njëra anë ajeti paraqet shpërblimin e veprave dhe të qënies të Xhennetit përballë këtyre veprave, ndërsa në anën tjetër, e bën atë trashëgim, që zakonisht përdoret për burimet e të mirave, të cilat njeriu i merr pa shpenzuar asnjë mund dhe përpjekje për t'i arritur. Ky është tregues i faktit se veprat e njeriut janë baza, esenca e çlirimit dhe e shpëtimit të tij.

Disa komentues mendojnë se kjo mënyrë e të shprehurit tregon se për çdo njeri ka një shkallë dhe gradë në Xhennet dhe një vend në Xhehennem, se banorët e Xhennetit i trashëgojnë gradat e banorëve të zjarrit dhe se këta të fundit i trashëgojnë vendet e banorëve të Xhennetit.

Komenti i parë duket më i përshtatshëm.

Fjala në mirësinë e shtatë e të fundit është për frutat e Xhennetit, të cilat janë nga mirësitë më të bekuara të All'Ilahut. Për këtë, ajeti thotë: **“Aty do të keni fruta të shumëllojshme, prej të cilave do të hani.”.**

Enët dhe gotat paraqiten për të treguar për llojet e ndryshme të ushqimit dhe pijeve. Kurse për frutat flitet në ajetin e fundit të këtyre ajeteve. Ajo që tregohet me shprehjen *“minha”*, që do të thotë: *“prej të cilave”*, dëshmon se frutat e Xhennetit janë të shumta, e se nuk mund të konsumohen vetëm se një pjesë prej tyre, prandaj dhe nuk mbarojnë kurrë.

Në një hadith thuhet: “Nuk merr një njeri i Xhennetit një frut, e që vendin e tij të mos e zërë menjëherë një tjetër frut.”.¹

Këto janë disa nga mirësitë e Xhennetit që ngjallin jetën dhe shpresën në shpirta. Xhenneti është në pritje të besimtarëve, vepërmirëve dhe fisnikëve.

¹Tefsiri “Ruhul Bejan”, vëll. 8, f. 392.

Ajetet 74-80

إِنَّ الْمُجْرِمِينَ فِي عَذَابٍ جَهَنَّمَ خَالِدُونَ^{٧٤} لَا يُفْتَرُ عَنْهُمْ وَهُمْ فِيهِ
مُبْلِسُونَ^{٧٥} وَمَا ظَلَمْنَاهُمْ وَلَكِنْ كَانُوا هُمُ الظَّالِمِينَ^{٧٦} وَنَادَوْا يَا
مَالِكُ لِيَقْضِ عَلَيْنَا رَبُّكَ قَالَ إِنَّكُمْ مَا كُثُونَ^{٧٧} لَقَدْ جِئْنَاكُمْ
بِالْحَقِّ وَلَكِنْ أَكْثَرُكُمْ لِلْحَقِّ كَارِهُونَ^{٧٨} أَمْ أَبْرَمُوا أَمْرًا فَإِنَّا
مُبْرَمُونَ^{٧٩} أَمْ يَحْسَبُونَ أَنَّا لَا نَسْمَعُ سِرَّهُمْ وَنَجْوَاهُمْ بَلَىٰ وَرُسُلْنَا
لَدَيْهِمْ يَكْتَئِبُونَ^{٨٠}

“Sa për punëmbropshtët, pa dyshim që ata do të qëndrojnë përherë në dënimin e Xhehennemit.”

“Ai (dënim) nuk do t’u lehtësohet atyre e kurrfarë shprese për shpëtim nuk do të kenë.”

“Ne atyre nuk u bëmë padrejtësi, por ata vetë i bënë keq vetvetes.”

“Ata do të thërrasin: ‘O Malik! (më mirë) Le të na vdesë Zoti yt!’, ndërsa Ai do të thotë: ‘Ju do të qëndroni përherë aty!’”

“Tashmë, Ne ju kemi sjellë të Vërtetën, por shumica prej jush urren të Vërtetën.”

“Nëse ata kurdisin kurthe, edhe Ne do t’u ngremë kurthe.”

“Vallë, a mos kujtojnë ata se Ne nuk i dëgjojmë fjalët e tyre tinzare dhe bisedat e tyre të fshehta? Pa dyshim, Ne dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë (engjëj) që janë pranë tyre, shënojnë.”

Komentimi

Parapëlqejmë të vdesim, që të qetësohemi nga dënimi

Këto ajete e kanë analizuar mirë fjalën *rreth fatit*, caktimit të kriminelëve jobesimtarë në Ditën e Kiametit, për ta bërë të qartë dallimin mes tyre dhe fatit të besimtarëve, të bindurve ndaj urdhrit të All’llahut.

Ajeti i parë thotë: **“Sa për kriminelët, pa dyshim që ata do të qëndrojnë përherë në dënimin e Xhehennemit.”**

Fjala *“el muxhrimu”* vjen nga lënda *“xheremun”*, që në rrënjë ka kuptimin *ndarja, prerja*, dhe përdoret për ndarjen e frutit nga pema, domethënë vjeljes, këputjes, por edhe për prerjen e vetë pemës. Kjo fjalë është përdorur më vonë për kryerjen e një pune të keqe. Mbase ishte ky përdorim, shkak që këto vepra ta ndanin njeriun nga Zoti i tij, nga vlerat njerëzore, ta largonin atë prej tyre.

Por, ajo që nënkuptohet këtu nuk janë të gjithë kriminelët, por janë ata kriminelë që zgjodhën rrugën e mohimit si rrugë të tyre. Kjo duket shumë larg asaj që thonë disa komentues, se shprehja përfshin të gjithë kriminelët.

Ajeti që vjen, shton: **“Ai (dënim) nuk do t’u lehtësohet atyre e kurrfarë shprese për shpëtim nuk do të kenë.”**. Dënimi i tyre është i përhershëm dhe i ashpër .

Fjala *“mublisun”* vjen nga lënda *“iblasun”*, që në rrënjë do të thotë: *dëshpërimi që e godet njeriun nga acarimi i madh, bezdisja dhe shqetësimi*. Ishte ky shqetësim dhe dëshpërim i thellë, që e ftonte njeriun në heshtje. Është përdorur fjala *“iblas”*, në kuptimin *e heshtjes dhe të ndaluarit nga përgjigjja*. Përderisa njeriu dëshpërohet nga çlirimi dhe shpëtimi i vetes së tij prej fatkeqësive të vështira, atëherë kjo fjalë u përdor edhe për dëshpërimin. Për këtë, edhe *“iblisi”*, është quajtur me këtë emër sepse i ka humbur të gjitha shpresat nga mëshira e All’llahut.

Këto dy ajete fokusohen në tri çështje: *përjetësia, moslehtësimi i dënimit dhe dëshpërimin*, si dhe *humbja absolute e shpresës*. E ku ka dënim më të ashpër sesa kur bashkohen të trija këto?

Ajeti që pason, thekson se janë ata që e kanë dashur këtë dënim të ashpër, që e kanë blerë atë me veprat dhe padrejtësinë e tyre ndaj vetes së vet. Në ajet thuhet: **“Ne atyre nuk u bëmë padrejtësi, por ata vetë ishin të padrejtë.”**.

Siç është bërë e qartë në ajetet e mëparshme, burim i mirësive të pafundme janë veprat e besimtarëve të përkushtuar, që kanë frikë All’llahun. Kështu, këto ajete përlllogarisin veprat e

atyre që bëjnë padrejtësi, si shkaktare të këtij dënimi të përhershëm dhe burimit të tij. Nuk ka padrejtësi më të madhe se sa kur njeriu përgënjeshtroi argumentet e All'Ilahut të Madhërueshëm, godet rrënjët e lumturisë së tij, duke u mbështetur në fabrikimin e gënjeshtreve: **“E kush është më i padrejtë sesa ai që shpif për All'Ilahun gënjeshtër?”**.¹

Kur'ani e sheh dëshirën e njeriut dhe veprën e tij, si shkakun kryesor të lumturisë apo vështirësisë.

Më tej, ajeti trajton qartësimin e përbuzjes dhe vendbanimit të tyre, ku thotë: **“Ata do të thërrasin: ‘O Malik! (më mirë) Le të na vdesë Zoti yt...’**”. Edhe pse çdo njeri largohet nga vdekja duke dëshiruar vazhdimin e jetës, qëndrimin në të, por kur fatkeqësitë janë të vazhdueshme dhe laku ngushtohet deri në fyt, atëherë ai lut vdekjen prej All'Ilahut. Nëse kjo dëshirë ndodh ndonjëherë te një pjesë e njerëzve, pa dyshim, ajo përfshin të gjithë zullumqarët, sepse të gjithë do të dëshirojnë të vdesin.

Mirëpo nuk do të ndodhë ajo që ata kërkojnë, sepse Maliku i zjarrit, që është më kryesori në zjarrin e Xhehennemit, me rojet e tij përgjigjen: **“...ndërsa Ai do të thotë: ‘Ju do të qëndroni përherë aty!’**”.²

Është e çuditshme se rojet e zjarrit u përgjigjen atyre pas njëmijë vjetësh, sipas mendimit të disa komentuesve, madje me

¹ Sure “Saff”, ajeti 7.

² Fjala “makithune” vjen nga lënda “mekethe”, që në rrënjë është ndalim i shoqëruar me pritje. Mbase, kjo shprehje e Malikut është si një tallje, siç themi, ndonjëherë për dikënd qëkërkon diçka që s’e meriton: Prit! (intedhir).

përbuzje dhe me një mungesë të madhe interesi. Eh, sa dhimbje të ashpër shkakton ajo përbuzje!¹

Si ka mundësi, që ata kërkojnë një gjë të tillë, duke e ditur mirë se atje nuk ka vdekje? Një kërkesë e tillë është normale nga një njeri që e kanë pllakosur fatkeqësitë dhe dhimbjet, e që i ka prerë shpresat në çdo gjë.

Kur shohin se të gjitha rrugët e shpëtimit u janë mbyllur në fytyrë, ata do të lëshojnë një klithmë nga thellësia e zemrave të tyre, mirëpo është vendosur dënimi kundër tyre, kështu që nuk ka asnjë dobi klithma e tyre, e as nuk ka tellall për ta.

Përse nuk e kërkojnë ata vdekjen drejtpërdrejt prej All'llahut, por e kërkojnë nga Maliku, kryesori i zjarrit? **"...Le të na vdesë Zoti yt..."**! Ata, atë ditë janë të fshehur, kështu që nuk mund ta shohin Zotin e tyre, siç dhe e lexojmë në ajetin 15 të sures "El Mutaaffifijn": **"Jo, dhe jo! Atë ditë do të jenë të penguar prej Zotit të tyre."** Për këtë arsye, ata ia bëjnë kërkesën Malikut, rojes së zjarrit, ngaqë ai është një engjëll shumë i afërt me All'llahun e Madhëruar.

Ajeti tjetër tregon për sëmundjen e tyre të përhershme në zjarrin e Xhehennemit: **"Tashmë, Ne ju kemi sjellë të Vërtetën, por shumica prej jush urren të Vërtetën."**

Ka dy mendime të ndryshme nëse kjo fjalë është e Malikut, rojes së zjarrit të Xhehennemit, - ngaqë përemri i shumësit u

¹Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajeteve në fjalë. Disa komentues kanë thënë se largësia mes pyetjes dhe përgjigjes është 100 vjet, kurse disa thonë se është dyzet vjet. Sado që të jetë, pa dyshim që ky është një argument i përbuzjes dhe mosinteresimit.

referohet engjëjve, prej të cilëve është dhe Maliku, - apo është Fjala e All'llahut të Madhërueshëm.

Konteksti shpreh mundësinë që fjala të jetë e Malikut, ngaqë vjen pas fjalëve të tij të mëparshme, vetëm se përmbajtja e të njëjtit ajet harmonizohet me qenien e saj si Fjalë e All'llahut të Madhëruar. Dëshmi tjetër e kësaj fjale është ajeti 71 i sures "Zumer": Roja e tij u thotë atyre: **"A nuk ju patën ardhur juve të Dërguar nga mesi juaj, që t'ju lexojnë Shpalljet e Zotit tuaj?"**.

Për shprehjen *"bil hakk"* ka një kuptim të gjerë, që përfshin të gjitha të vërtetat vendimtare, edhe pse çështja e Teuhidit, Botës Tjetër dhe Kur'anit vijnë në radhë të parë.

Kjo shprehje tregon se ata nuk kanë kundërshtuar vetëm Pejgamberët, por edhe të vërtetën. Ky kundërshtim i përfshin ata në dënimin e përhershëm e të pafundmë.

Ajeti tjetër pasqyron një rën anë të urrejtjes së tyre ndaj së vërtetës: atë të neveritjes së tyre prej saj. Po kështu, ai pasqyron edhe mbështetjen e tyre për të kotën dhe kapjen pas saj. Në ajet thuhet: **"Nëse ata kurdisin kurthe, edhe Ne do t'u ngremë kurthe."**, pasi këta intrigantë të këqinj kurdisën dhe planifikuan komplete për të shuar dritën e Islamit dhe për të vrarë Pejgamberin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ata nuk u përmbajtën në shtimin e goditjeve me sa fuqi kishin ndaj Islamit dhe myslimanëve.

Në këmbim, ata deshën t'i kompesonin këta në jetën e kësaj bote, kurse në Ahiret me një dënim edhe më të ashpër.

Disa komentues mendojnë se shkaku i zbritjes së këtij ajeti është kurthi i vrasjes së Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) para emigrimit, për të cilin është folur në ajetin 30 të sures "Enfal": **"Përkujto (o i Dërguar) kur ata që nuk besuan thurnin komplete kundër teje."**¹ Me sa duket, ky është për zbatimin, por jo se është shkaku i zbritjes.

Ajeti tjetër është qartësim i një prej sëmundjeve të komplotit, teksa thotë: **"Vallë, a mos kujtojnë ata se Ne nuk i dëgjojmë fjalët e tyre tinzare dhe bisedat e tyre të fshehta...?"**. Pa dyshim, Ne dëgjojmë edhe të dërguarit tanë (engjëjt) dëgjojnë: **"Pa dyshim, Ne dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë (engjëj) që janë pranë tyre, shënojnë."**

Fjala *"es sirru"* është ajo çka fsheh njeriu në zemrën e tij, apo sekretet e tij, të cilat ua thotë vëllezërve dhe shokëve të tij, kurse *"en nexhua"*, është pëshpëritja në vesh.

Por All'llahu i Madhëruar nuk dëgjon vetëm bisedën dhe pëshpëritjet mes tyre në vesh. Ai, madje, e di se çfarë fshehin edhe shpirtrat e tyre, se për Të është njëlloj si sekreti, ashtu dhe ajo që thuhet.

Ndërsa engjëjt kanë për detyrë që të regjistrojnë veprat e njerëzve dhe fjalët e tyre, t'i shkruajnë ato në fletët e veprave të tyre, si dhe të shohin shpërblimin e veprave, fjalëve dhe kurtheve të tyre, si në dynja, ashtu edhe në Ahiret.

¹Tefsiri "El Kebijr", vëll. 27, f. 228. Fundi i ajeteve në fjalë.

Ajetet 81-85

قُلْ إِنْ كَانَ لِلرَّحْمَنِ وَلَدٌ فَأَنَا أَوَّلُ الْعَابِدِينَ^{٨١} سُبْحَانَ رَبِّ السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضِ رَبِّ الْعَرْشِ عَمَّا يَصِفُونَ^{٨٢} فَذَرَهُمْ يَحْضُوا وَيَلْعَبُوا حَتَّى
يُلَاقُوا يَوْمَهُمُ الَّذِي يُوعَدُونَ^{٨٣} وَهُوَ الَّذِي فِي السَّمَاءِ إِلَهٌ وَفِي الْأَرْضِ
إِلَهٌ وَهُوَ الْحَكِيمُ الْعَلِيمُ^{٨٤} وَتَبَارَكَ الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ
وَمَا بَيْنَهُمَا وَعِنْدَهُ عِلْمُ السَّاعَةِ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ^{٨٥}

“Thuaju (o Muhammed): ‘Sikur i Gjithëmëshirshmi të kishte bir, Unë do të isha i pari që do ta adhuroja atë!’”

“Qoftë i lartësuar Zoti i qiejve dhe i Tokës, Zoti i Fronit, nga ajo çfarë i veshin Atij!”

“Lëri ata të flasin marrëzi dhe le të argëtohen derisa të takojnë Ditën që u është premtuar.”

“Ai është i vetmi Zot (i vërtetë) në qiell dhe i vetmi Zot (i vërtetë) në Tokë. Ai është i Urtë dhe i Gjithëdijshtëm.”

“Qoftë i lartësuar në lavdi Ai, të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe gjithçka që gjendet mes tyre. Vetëm Ai ka dijeni mbi Orën (e Kiametit) dhe tek Ai do të ktheheni!”

Komentimi

Lëri ata të zhyten më thellë e të argëtohen!

Në ajetet e mëparshme, sidomos ajetet në fillim të sures, flisnin për idhujtarët arabë dhe besimin e tyre se All'llahu kishte fëmijë, ata mendonin se engjëjt janë bijat e All'llahut. Në disa ajete të tjera flitej për Mesium, (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe për thirrjen e tij në Njehsimin e sinqertë dhe në adhurimin e All'llahut, të Vetëm e të Pashoq. Ajetet që po komentojmë, me një metodë tjetër, e mohojnë këtë lloj besimi të devijuar.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalëthotë: **“Thuaju (o Muhammed): ‘Sikur i Gjithëmëshirshmi të kishte bir, Unë do të isha i pari që do ta adhuroja atë!’”**, sepse besimi im në All'llahun e Madhëruar është më i fortë se i gjithë besimi juaj së bashku. Njohuria ime për Të është më e madhe, kështu që do të isha i pari që do ta madhëroja fëmijën e Tij e t'i bindesha atij para jush.

Përmbajtja e këtij ajeti ngjan pak e ndërlikuar për një grup komentuesish. Këta të fundit përmendin orientime dhe udhëzime të ndryshme për të, një pjesë e të cilave janë shumë të çuditshme.¹ Në të vërtetë, nuk ka asnjë ndërlikim në përmbajtjen e ajetit. Kjo

¹Për shembull, disa komentues thonë se fjala “in” ka kuptimin e ndalimit, kurse shprehja **“unë do jem i pari adhuroes”** ka kuptimin e të parit që adhuron All'llahun. Kështu, kuptimi i ajetit bëhet: **Nuk ka kurrë fëmijë të All'llahut**, sepse unë jam i pari që adhuroj All'llahun! Ndërsa, disa komentues të tjerë fjalën “*abidine*” e kanë komentuar me atij që refuzon adhurimin. Bazuar në këtë, kuptimi bëhet: *Nëse Zoti do të kishte fëmijë, atëherë unë nuk do ta adhuroja kurrë një zot të tillë, sepse për shkak të të qenit të Tij prind, nuk mundet që të jetë Zoti.* Duket qartë se të tillë komentime nuk përputhen me aparencën e ajetit.

metodë e shkëlqyer përdoret me njerëzit kryeneçë, të pabindur dhe fanatikë. Është e njëjta metodë që përdoret në jetën e përditshme kur dikush të thotë “Filani është më i ditur se të gjithë”, në një kohë kur ai nuk di asgjë. Kështu, ti i thua: Nëse ai është më i dituri, atëherë unë jam i pari që do ta ndjek atë! Kjo, si për të kursyer mundimin e atij që foli për kërkimin e një argumenti, që e mbështet atë që mëton ai. Kur përplasat me realitetin kokëfortë, ai zgjohet nga pavëmendja e tij.

Është e qartë se komente të tilla nuk mund të harmonizohen në asnjë mënyrë me kuptimin e brendshëm të ajetit.

Ajeti përmend një argument të qartë për ndalimin e këtyre deklaratave, duke thënë: **“Qoftë i lartësuar Zoti i qiejve dhe i Tokës, Zoti i Fronit, nga ajo çfarë i veshin Atij!”**. S’ka dyshim se Ai është sunduesi i qiejve dhe i Tokës, si dhe kontrolluesi i saj. Është Zot i Arshit të madh. Ai nuk ka nevojë për fëmijë, sepse është i Ekzistuar pafundësisht, Përfshirës i të gjithë botës së ekzistencës dhe Zotërues i të gjithë botës së krijimit. Përkundrazi, ai që ka nevojë për fëmijë, është ai që vdes, se nuk vazhdon ekzistenca e tij vetëm se nëpërmjet fëmijëve. Fëmija është i domosdoshëm për atë që ka nevojë për ndihmë, shoqëri dhe humanizëm, në kohën e pleqërisë dhe vetmisë.

Së fundi: Ekzistenca e fëmijës është argument i trupëzimit, kufizimit dhe centralizimit në hapësirën e kohës dhe të vendit.

Pa dyshim se Zoti i Arshit, i Qiellit dhe i Tokës, është i pa të meta, kështu që nuk ka nevojë për fëmijë.

Përmnedja e frazës “*rabbil arsh*” pas frazës “*rabbi semauati uel erd*”, është përmendje e të përgjithshmes para të veçantës, sepse Arshi, siç kemi thënë më parë, përdoret për tërësinë e botës ekzistuese, i cili është fuqia e sundimi të All’llahut të Madhëruar.

Supozohet që fjala *Arsh* të tregojë për botën e metafizikës, e kundërta e qiejve dhe e tokës që tregojnë për botën materiale. Për më shumë sqarime lexo komentimin e ajetit 255 të sures “Bekare”, në këtë komentim. Në komentimin e ajetit 7 të sures “Gafir”, në këtë komentim, gjendet hulumtim më i gjerë.

Ajeti tjetër vazhdon me përçmimin për këta kryeneçë, madje duke i kërcënuar ata: **“Lëri ata të flasin marrëzi dhe le të argëtohen derisa të takojnë Ditën që u është premtuar.”**, pra, të mbledhin rezultatin e veprave të tyre, të shijojnë rrezikun e çështjeve të tyre.

Ajo që nënkuptohet me “ditën e caktuar”, është Dita e Kiametit. Mendimi i disa komentuesve se me të nënkuptohet çasti i vdekjes, duket shumë larg së vërtetës, sepse shpërblimi i veprave bëhet në Ditën e Kiametit, dhe jo në çastet e vdekjes.

Bëhet fjalë për të njëjtën ditë, për të cilën është betuar All’llahu i Madhërueshëm në ajetin 2 të sures “Buruxh”, ku thotë: **“Pasha ditën e premtuar!”**.

Dy ajetet që vijnë më pas, vazhdojnë hulumtimin rreth çështjes së Njehsimit (et Teuhijd). Në to ka shtatë prej cilësive të All’llahut të Madhëruar. Të gjitha ato kanë efekt në gjykimin dhe përforcimin e bazave të Njehsimit.

Ajeti i parë kundërshton idhujtarët, të cilët besonin në ndarjen e Zotit të Qiellit nga Zoti i Tokës, madje shpikën zot edhe

për detin, edhe për Saharanë, një tjetër zot për luftën, një të katërt për paqen, e zota pas zotash, të shumtë në numër. Prandaj, ajeti thotë: **“Ai është i vetmi Zot (i vërtetë) në qiell dhe i vetmi Zot (i vërtetë) në Tokë...”**. Të qenët e Tij, Zot në Qiell dhe në Tokë, e mbështet fort të qenët e Tij i adhuruar në të dyja këto. Kjo është përmendur në ajetet e mësipërme, që i adhuruari i vërtetë është Zoti i botës, projektuesi i saj, dhe jo zotat e ndryshëm, as engjëjt, as Mesia, as putat, pasi ata nuk e gëzojnë pozitën e hyjnisë, sepse janë vetë të krijuar, të zotëruar, të kontrolluar, e që i gëzojnë begatitë e All’llahut; po ashtu, të gjithë ata e adhurojnë All’llahun e Madhëruar.

Në cilësinë e dytë dhe të tretë thuhet: **“...Ai është i Urtë dhe i Gjithëdijshtëm.”**, pasi të gjitha punët e Tij bëhen në bazë të përpikmërisë, llogarisë dhe rregullave. Ai është i Ditur për gjithçka dhe përfshirës i çështjeve. Ai i di mirë punët e robëve dhe i shpërblen ata me anë të mençurisë dhe urtësisë së Tij.

Ajeti i dytë flet për dy cilësi, të katërtën dhe të pestën, për begatitë e ekzistencës së përhershme të All’llahut, si dhe për mbretërimin, zotërimin e Tij ndaj Qiellit dhe Tokës e çfarë ka midis tyre, duke thënë: **“Qoftë i lartësuar në lavdi Ai, të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe gjithçka që gjendet mes tyre...”**.

Fjala *“tebareke”* vjen nga lënda *“bereke”*, që do të thotë *zotërimi i mirësive të bollshme*, ose ka kuptimin e *qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë*, apo të dyja bashkë. Secila prej tyre konfirmon pozitën e All’llahut të Lartësuar. S’ka dyshim se ekzistenca e Tij është e përhershme dhe pa mbarim. Ai është burimi i mirësive të shumta. E mira më e madhe nuk do të kishte

kuptim të plotë nëse nuk do të ishte e qëndrueshme, e vazhdueshme dhe e përhershme, pasi të mirat, sado shumë të jenë, llogariten të pakta, ngaqë janë me afate të përcaktuara.

Në cilësinë e gjashtë dhe të shtatë thuhet: “**...Vetëm Ai ka dijeni mbi Orën (e Kiametit) dhe tek Ai do të ktheheni!**”. Nëse dëshironi të mira dhe begati, atëherë kërkojini ato prej All’llahut dhe jo nga statujat, sepse s’ka dyshim se në Ditën e Kiametit do të ktheheni tek Ai. Ai është kthimi juaj i vetëm. Në dorën e Tij është çdo gjë, sepse statujat e zotat e tjerë nuk kanë në dorë asgjë.

Hulumtime

1- Në këto ajete është përmendur tri herë shprehja “*i qiejve dhe i tokës*”: një herë në qartësimin e të qenit të All’llahut, Zot dhe kontrollues, projektues i atyre të dyjave; një herë tjetër në të qenit e Tij, Zot në të dyja ato, kurse e treta, në të qenit e Tij Sunduesi dhe i Urti. Të trija këto janë të lidhura me njëra-tjetrën. Ato janë shkak-pasojë e njëra-tjetrës. All’llahu është zotërues dhe sundues, prandaj Ai është Zot, Zotërues. Kështu, Ai është Zot dhe hyjni. Përshkrimi i Tij si i Urti dhe i Dituri, është plotësues i këtyre kuptimeve.

2- Nga disa transmetime islame përftohet se mënyra e të shprehurit në trajtën: “**Ai që është në qiell All’llah, është dhe në tokë All’llah**”, u bë si një përgjigje për pohimet e disa ateistëve dhe idhujtarëve, të cilët e komentonin ajetin sipas sofizmave të

tyre. Sipas tyre, në qiell ka një zot, kurse në tokë një zot tjetër përveç tij. Ndërkohë, ajeti pohon tëkundërtën e asaj dhe thotë: Në të vërtetë, Ai është Zoti që adhurohet në qiell dhe në tokë, që do të thotë se All'llahu i Madhërishëm është i adhuruar në çdo vend.

Ateistë, kur ia shtruan këtë pyetje Imamëve të mbrojtur nga mëkati, ata, (*Paqja qoftë mbi ta!*), iu përgjigjën nëpërmjet rrugës së kundërshtimit dhe zgjidhjes.

Prej atyre përgjigjeve është një ngjarje që përmendet nëtefsirin“El Kafij”, e transmetuar nga Hisham bin Hakem. Në të thuhet: Ebu Shakir Disanij¹ ka thënë: Në Kur'an ka një ajet, e cila është fjala jonë? I thashë: Cili është ai ajet? U përgjigj: **“Ai është i vetmi Zot (i vërtetë) në qiell dhe i vetmi Zot (i vërtetë) në Tokë”**, kështu që nuk dija se si t'i përgjigjesha.

Shkova për Haxh dhe ia thashë çështjen Ebu Abdullahut, Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*). Imami tha: *Kjo është fjala e një ateisti të poshtër e të pistë! Kur të kthehesh tek ai i thuaj: Si e ke, ti, emrin në Kufe? Ai do të përgjigjet: Filani. Pastaj thuaj përsëri: Si e ke emrin në Basra? Ai do të thotë: Filan. Atëherë, thuaj, kështu është edhe All'llahu. Zoti ynë në Qiell, është All'llahu, në Tokë, është All'llahu në dete, është All'llahu, në shkretëtira, është All'llahu, në çdo vend është All'llahu”*.

¹Ebu Shakir Disanijju, ishte një nga dijetarët e grupit *disaniye*, të cilët besonin në adhurimin e dy zotave: zotit të dritës dhe të errësirës.

Hishami tha: Kur u ktheva takova Ebu Shakirin dhe e lajmërova atë për çështjen e ajetit. Ai tha: Kjo është marrë nga Hixhazi.¹

Komentuesi i madh, dijetari Tabrasij ka përmendur dy shkaqe për përsëritjen e fjalës “*el ilah*” në këtë ajet. Shkaku i parë është konfirmimi i të qenit të All’llahut të Madhëruar, Zot në çdo vend. Ndërsa shkaku i dytë është se kjo fjalë tregon se engjëjt e qiellit e adhurojnë Atë, e njerëzit në Tokë e adhurojnë gjithashtu. Në bazë të kësaj, pa dyshim se Ai është Zoti i engjëjve dhe i bijve të Ademit, si dhe i të gjitha krijesave në qiej dhe në Tokë.

¹“Usulul Kafij”, vëll. 1 (Libri i Teuhidit, kapitulli i lëvizjes dhe shpërnguljes, h 10.).

Ajetet 86 - 89

وَلَا يَمْلِكُ الَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ الشَّفَاعَةَ إِلَّا مَنْ شَهِدَ بِالْحَقِّ
وَهُمْ يَعْلَمُونَ^{٨٦} وَلَئِنْ سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَهُمْ لَيَقُولَنَّ اللَّهُ فَأَنَّى
يُؤْفَكُونَ^{٨٧} وَقِيلَ لَهُ يَا رَبِّ إِنَّ هَؤُلَاءِ قَوْمٌ لَا يُؤْمِنُونَ^{٨٨} فَاصْفَحْ عَنْهُمْ
وَقُلْ سَلَامٌ فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ^{٨٩}

“Ata që u adhuruan në vend të All’llahut, nuk do të mund të ndërmjetësojnë për askënd, përveç atyre që dëshmuar për të Vërtetën dhe e dinë mirë.”

“Nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, me siguri që ata do të thonë: ‘All’llahu!’. Atëherë, përse largohen prej Tij?!”

“I Dërguari thotë: ‘O Zoti im, ky është një popull që nuk beson!’”

“Largohu prej tyre (o Muhammed) dhe thuaju: ‘Paqe!’. Ata së shpejti do ta marrin vesh.”

Komentimi

Kush e zotëron ndërmjetësimin (*shefaatin*)?

Në këto ajete të fundit flitet akoma rreth shkatërrimit të besimit të idhujtarisë dhe refuzimit, përgënjeshtërimit dhe për fundin e hidhur të idhujtarëve. Pra, ato sqarojnë prishjen e besimit të tyre me argumente të tjera.

Ajeti i parë thotë: **“Ata që u adhuruan në vend të All’llahut, nuk do të mund të ndërmjetësojnë për askënd...”**, sepse ndërmjetësimi tek All’llahu nuk bëhet, vetëm se me lejen e Tij. All’llahu, i Urti, nuk u ka dhënë leje për këtë këtyre gurëve dhe drurëve që nuk kanë asnjë vlerë, nuk kanë logjikë, ndjenja dhe as perceptim.

Përderisa engjëjt dhe të tjerë si ata, kanë qenë në mesin e zotave të tyre, atëherë fundi i ajetit i përjashton dhe thotë: **“...përveç atyre që dëshmuar për të Vërtetën...”**; janë ata, të cilët iu dorëzuan njëshmërisë së All’llahut të Madhëruar në të gjitha fazat, të cilët ndërmjetësojnë me lejen e All’llahut të Madhëruar.

Mirëpo, çështja nuk është ashtu siç mund ta mendojnë ata, se do të ndërmjetësojnë për këdo, dhe nëse bëhet fjalë për një idhujtar apo politeist, për një të shmangur nga rruga e Teuhidit, apo të humbur nga Rruga e Drejtë; përkundrazi, **“...dhe e dinë mirë...”** mirë se për kë ndërmjetësojnë.

Ata e presin shpresën nga ndërmjetësimi i engjëjve për dy shkaqe:

Së pari: Ata vetë e vërtetonin njëshmërinë e All'Ilahut, teksa dëshmonin për të. Për këtë e kanë dhe marrë lejen e ndërmjetësimit.

Së dyti: Ata e dinë mirë se cili e meriton ndërmjetësimin dhe të drejtën e tij.

Disa studiues e kanë konsideruar fjalinë **“...dhe e dinë mirë...”** si plotësuese të fjalisë: **“...përveç atyre që dëshmuar për të Vërtetën...”**, kështu që kuptimi i ajetit bëhet: S'ka dyshim se ata që dëshmojnë njëshmërinë dhe e kuptojnë të vërtetën e saj, vetëm ata e zotërojnë të drejtën e ndërmjetësimit. Komenti i parë është më pranë të vërtetës.

Sido që të jetë, ajeti e bën më se të qartë kushtin bazë që duhet të realizohet te ndërmjetësuesit te All'Ilahu i Madhëruar. Ata janë dëshmuesit e së vërtetës, që e njohin atë në përjetësi, që janë të rrethuar nga shpirti i Njehsimit. Po kështu, ata janë të njohur me gjendjen e të ndërmjetësuarve dhe situatave të tyre.

Më pas, politeistët e pranojnë me gojën e tyre: **“Nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, me siguri që ata do të thonë: ‘All'Ilahu!’...”**.

E kemi thënë vazhdimisht se rrallë mund të gjendet në mesin e politeistëve arabë, madje edhe të tjerëve, ndonjë që të besojë se janë statujat, ato që i kanë krijuar. Shumica dërmuese e tyre i konsiderojnë statujat si ndërmjetësuese që i ngrenë ata më afër tek All'Ilahu. Ose i konsiderojnë ato si argumente dhe shenja të të dashurve (eulijatë) e shenjtë të All'Ilahut. E më pas, gjejnë pretekst e thonë se i adhuroari ynë duhet të jetë i pranishëm dhe i prekshëm, që të ndjejmë kënaqësi dhe ta adhurojmë. E kur pyeten

se kush është krijuesi i tyre, ata do të thonë me plot gojën: All'llahu.

Kur'ani përmend shpesh se adhurimi nuk i shkon vetëm se Krijuesit të kësaj Gjithësie, Projektuesit të saj. Nëse e dimë se All'llahu është Krijuesi dhe Projektuesi, atëherë nuk mbetet gjë tjetër për ne, veçse të kthejmë adhurimin nga Ai, ta veçojmë Atë me adhurim.

Prandaj, ajeti në fundin e tij thotë: **“...Atëherë, përse largohen prej Tij?”**. Ky është një qortim i ashpër për ata. Nëse ju e kuptuat të vërtetën e çështjes, atëherë përse e kundërshtoni All'llahun dhe adhuronit tjetër veç Tij?

Ajeti që vjen, flet për ankimet e Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tek All'llahu i Madhëruar për këtë komb kryeneç, të cilët nuk kanë mend fare. Në ajet thuhet: **“I Dërguari thotë: ‘O Zoti im, ky është një popull që nuk beson!’”**.

Me këto fjalë nënkuptohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e Alahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka folur e biseduar me atë popull, i ka përkujtuar ata me anë të përgëzimit dhe paralajmërimit, ua ka kujtuar historitë e dhimbshme të popujve të kaluar, i ka paralajmëruar ata me dënimin e All'llahut, i ka ftuar në mëshirën e Tij, në mënyrë që ata të ktheheshin nga rruga e humbjes: Në të vërtetë, unë ua përcolla çështjen aq sa munda, thashë çdo gjë që duhej thënë, por për fat të keq, fjala ime e ngrohtë nuk pati efekt në zemrat e tyre të ftohta ndaj dhe nuk besuan.

Në fund të ajetit, All'llahu i Madhërueshëm e urdhëron Pejgamberin e Tij dhe i thotë: **“Largohu prej tyre (o Muhammed)...”**. *Largimi yt prej tyre të mos jetë shmangie me ndarje, me inat, lëndime dhe me plagosje ndjenjash; përkundrazi, largohu prej tyre dhe thuaj: “...dhe thuaju: ‘Paqe!’...”*, pa selamin e përshëndetjes dhe dashurisë, por me selamin e lamtumirës dhe të ndarjes. Ky selam i ngjason atij që përmendet në ajetin 63 të sures “Furkan”, ku thuhet: **“E kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë ‘Paqe’”**, një paqe që është shenjë e indiferencës së tyre të përzier me ekzaltim dhe glorifikim.

All'llahu i kërcënon ata, duke i paralajmëruar me një fjali me kuptim të thellë që ata të mos mendojnë se Ai do t'i lërë mënjane pas këtij largimi. Në fund të ajetit All'llahu thotë: **“...Ata së shpejti do ta marrin vesh.”**. Sigurisht, më vonë do ta marrin vesh se çfarë zjarri kanë ndezur për veten e tyre, me kokëfortësinë e tyre, e se çfarë dënimi të dhimbshëm kanë përgatitur.

Disa dijetarë përmendin shkakun e zbritjes së ajetit **“Ata që u adhuruan në vend të All'llahut nuk do të mund të ndërmjetësojnë për askënd...”**, që është ngjarja në vijim: “En Nudr ibn Harith dhe një grup prej kurejshëve thanë: ‘Nëse ajo që thotë Muhammedi është e vërtetë, atëherë ne nuk kemi nevojë për ndërmjetësimin e tij, sepse i duam engjëjt. Ata janë miqtë tanë dhe e meritojnë më shumë ndërmjetësimin. Atëherë zbriti ky ajet, i cili, u kujtonte atyre se engjëjt nuk ndërmjetësojnë në Ditën e Kiametit, përveç atyre që dëshmojnë të vërtetën, domethënë besimtarëve.”¹

¹Tefsiri “El Kurtubij”, vëll. 9, f. 5942.

O All'llah, na afro afër Teje dhe të dashurve të Tu dhe na e shto dashurinë për Ty dhe për ata, në mënyrë që të përfitojmë ndërmjetësimin e tyre!

O All'llah, na mbro nga çdo shirk i dukshëm dhe i padukshëm!

O All'llah, na trajto me mirësinë Tënde dhe jo me drejtësinë Tënde në atë Ditë, o Mëshirues i Mëshiruesve!

Sure “Ed Dukhan”

Mekase, 79 ajete

Përmbajtja

Kjo është sureja e pestë nga shtatë “havamimet” (suret që fillojmë me germat “ha mim”) dhe është sure mekase. Ajo përcjell diskutimet dhe komentimet më të plota të sureve për fillimin, zanafillën dhe kthimin, për Kiametin dhe Kur'anin. Ajetet e saj shoqërohen me kritika vendimtare, frikësuese për zemrat e hutuara e të pavëmendshme ndaj Zotit. Ato i ftojnë besimtarët në përkushtim dhe drejtësi.

Përmbajtja e kësaj sureje mund të ndahet në shtatë pjesë:

1- Sureja fillon me shkronja të veçuara. Më pas bëhet shpallja dhe deklarimi i madhështisë së Kur'anit, së bashku me vërtetimin e zbritjes së tij në Natën e Kadrit për herë të parë.

2- Në pjesën e dytë flitet për Teuhidin, për Njëshmërinë e All'llahut të Madhërueshëm dhe për disa aspekte të madhështisë së Tij në botën e ekzistencës.

3-Një pjesë e rëndësishme e sures flet për fundin e jobesimtarëve, dënimin e tyre dhe për llojet e ndryshme të ndëshkimeve të dhimbshme, të cilat kanë zbritur dhe do të zbresin mbi ta.

4- Në pjesën tjetër, sureja flet për historinë e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe të Beni Israilëve me popullin e Faraonit, për mundjen e popullit të Faraonit dhe shkatërrimin e asgjësimin e tyre, me qëllim që të zgjoheshin ata të pavëmendshëm e të hutuar.

5- Në këtë pjesë ndahet formalisht çështja e Kiametit me llojet e ndryshme të dënimeve të dhimbshme që do të marrin banorët e Xhehennemit, kurse shpërblimet e mëdha që do të gëzojnë shpirtrat e të përkushtuarve, trajtohen në një pjesë tjetër të ajeteve të kësaj sureje.

6- Pjesa e gjashtë përfshin temat e tjera që diskutohen në këtë sure. Ato kanë të bëjnë me qëllimin e krijimit si dhe me krijimin e qiellit dhe të tokës.

7- Sureja përfundon ashtu siç fillon, duke deklaruar madhështinë e Kur'anit Kerim. Meqenëse në ajetin 10 të kësaj sureje flitet për "Ed Dukhanul Adhijm" (tymi i madh), kjo sure mori emrin "Ed Dukhan".

Mirësia e leximit të kësaj sureje

Në një hadith të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Kush e lexon suren “Dukhan” natën e xhuma dhe ditën e xhuma, All'llahu i ndërton atij një shtëpi në Xhennet.”.¹

Gjithashtu, transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush e lexon nëdarkë suren “Dukhan”, shtatëdhjetëmijë engjëj kërkojnë falje për atënë mëngjes.”.²

Kurse në një hadith tjetër nga Ebi Hamza Themaliju, nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: “Kush e lexon suren “Dukhan” gjatë namazeve farz dhe nafile, All'llahu do ta ringjallë në Ditën e Kiametit prej të siguruarve, do ta fusë atë nën hijen e Arshit të Tij, do ta marrë në llogari me një llogari të lehtë dhe do t'i jepet libri i tij nga e djathta e vet.”.³

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, fillimi i sures “Dukhan”.

²Po aty.

³Po aty.

Ajetet 1-8

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

حم وَالْكِتَابِ الْمُبِينِ، إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةٍ مُبَارَكَةٍ إِنَّا كُنَّا مُنْذِرِينَ^٢
فِيهَا يُفْرَقُ كُلُّ أَمْرٍ حَكِيمٍ، أَمْرًا مِنْ عِنْدِنَا إِنَّا كُنَّا مُرْسِلِينَ، رَحْمَةً
مِنْ رَبِّكَ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ^١ رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا
بَيْنَهُمَا إِنْ كُنْتُمْ مُوقِنِينَ^٣ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ رَبُّكُمْ وَرَبُّ
آبَائِكُمُ الْأَوَّلِينَ^٤

Me emrin e All'Ilahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Hâ, Mîm."

"Betohem në Librin e qartë!"

"Ne e zbritëm Kur'anin në një natë të bekuar. Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues."

"Në atë (natë të zbritjes së Kur'anit) vendoset çdo punë e urtë."

"Me urdhrin Tonë! Ne gjithmonë kemi nisur të Dërguar."

“Si mëshirë prej Zotit tënd. Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.”

“Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, nëse besoni me bindje.”

“S’ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij. Ai e jep jetën dhe e shkakton vdekjen. Ai është Zoti juaj dhe Zoti i të parëve tuaj të lashtë!”

Komentimi

Zbritja e Kur'anit në Natën e Begatshme

Kjo sure, së bashku me katër suret e kaluara edhe me dy suret që do të vijnë më pas, përbëjnë shtatë suret e “havamim-eve” që fillojnë me shkronja të ndërprera (“Ha, Mim”). Kemi diskutuar shumë për shkronjat e ndërprera në Kur’an në një formë të përgjithshme.¹ Shkronjat “Ha”, “Mim” janë komentuar në mënyrë të veçantë në fillimin e sures së parë të “havamim-eve” (suret “Mu’minun”) dhe në fillimin e sures “Fussilet”.

Duhet theksuar se disa nga komentuesit i kanë komentuar shkronjat “Ha, Mim”, si një betim të përbërë nga dy pjesë: njëri betim është për shkronjat e alfabetit, si: “Ha, Mim”, dhe betimi

¹Shih komentimin e fillimit të sures “El Bekare”, fillimin e sures “Ali Imran” dhe fillimin e sures “El A’raf”.

tjetër është për këtë Libër të Shenjtë, i cili përbëhet nga këto shkronja.

Ajeti i dytë, prej ajeteve në fjalë, betohet në Kur'anin e Shentë dhe thotë: **“Betohem në Librin e qartë!”**, në atë Libër që kanë përmbajtje të qartë dhe njohuri sqaruese, që ka mësim të gjalla, ligje të ndërtuara mbi baza të forta, programe dhe projekte të hollësishme. Ai është Libri që flet vetë për vërtetësinë e tij, ashtu siç lindja e Diellit tregon se ai është i vërtetë!¹

Por le të shohim se ku qëndron synimi i këtij betimi.

Ajeti që pason, e sqaron këtë çështje dhe thotë: **“Ne e zbritëm Kur'anin në një natë të bekuar...”**.

Fjala *“el mubarek”* është nga lënda *“bereke”* dhe ka kuptimin e përfitimit, e dobisë, e përjetësisë dhe e vazhdimësisë. Cila është kjo natë në të cilën gjendet zanafilla e begative, burimi i të mirave dhe i dhuratave të përhershme?

Shumica e komentuesve e kanë pranuar se ajo është Nata e Kadrit, ajo natë e madhe, në të cilën ndryshuan fatet e njerëzve me zbritjen e Kur'anit të Shenjtë. Atë natë caktohen rezultatet e krijesave, atë natë ka zbritur Kur'ani në zemrën e pastër të Pejgamberit, prandaj ajo është një natë vendimtare.

Në pamje të parë të ajetit, duket se i gjithë Kur'ani ka zbritur në Natën e Kadrit.

Po cili është qëllimi kryesor i zbritjes së tij?

¹Do të diskutojmë rreth filozofisë së besimit dhe betimit në Kur'an, si dhe qëllimit kryesor të tyre. Do ta trajtojmë këtë çështje në tefsirin e xhazit të fundit të Kur'anit Kerim, ku në fundin e shumë ajeteve ka betime të përsëritura.

Fundi i ajetit na ka folur për këtë. Në të thuhet: “**...Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues.**”.

Tradita, Rruga Jonë e përhershme është dërgimi i të Dërguarve për paralajmërimin e zullumqarëve dhe politeistëve. Dërgimi i Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me këtë Libër sqarues, ishte hallka e fundit e këtij zinxhiri të bekuar.

Profetët, nga njëra anë paralajmërojnë dhe nga ana tjetër përgëzojnë. Të Dërguarit u thirrën në kohën kur u shtua nevoja e përballimit të zullumqarëve dhe kriminelëve dhe luftimi i tyre. Ata erdhën së bashku me paralajmërimet dhe frikësimin e politeistëve.

Zbritja e menjëhershme dhe zbritja graduale e Kur'anit

1- Ne e dimë se Kur'ani Kerim ka zbritur në një periudhë kohore prej njëzet e tre vitesh, periudhë e cila është koha e profecisë së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Përmbajtja e Kur'anit është e ndërthurur me ngjarjet e ndryshme që kanë ndodhur në jetën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të myslimanëve gjatë 23 viteve të zbritjes. Kanë ndodhur aq shumë ngjarje, sa ne mund ta ndajmë periudhën e zbritjes së Kur'anit nga vetë Kur'ani, por kjo nuk do të kishte asnjë kuptim. Nëse ka qenë kështu, atëherë si ka zbritur Kur'ani i plotë në Natën e Kadrit, sipas kësaj logjike?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje, disa e kanë lidhur me fillimin e zbritjes së Kur'anit në Natën e Kadrit. Bazuar mbi këtë, nuk ka

asnjë pengesë për pranimin e fillimit të zbritjes së Kur'anit në Natën e Kadrit dhe që pjesa tjetër të ketë zbritur gjatë 23 viteve. Vetëm se ky komentim, siç e thamë edhe më lart, nuk harmonizohet me ajete të tjera të Kur'anit të Lavdishëm.

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje duhet të lexojmë me kujdes ajetin ku thuhet: **“Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar.”**. Ajeti tjetër që flet për këtë çështje është ajeti 185 i sures “El Bekare”, i cili thotë: **“Muaji i Ramazanit, në të cilin është zbritur Kur’ani...”**. Po ashtu, në suren “Kadr” lexojmë: **“Ne e zbritëm atë (Kur’anin) në Natën e Kadrit.”**. Nga seria e këtyre ajeteve lexojmë se nata e begatë dhe e bekuar në këtë ajet është Nata e Kadrit, e cila është nga netët e muajit të bekuar të Ramazanit.

Në shtesë të asaj që u tha, në ajete të shumta përftohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e dinte Kur'anin para se ai të zbriste gradualisht, siç thuhet në ajetin 114 të sures “TaHa” thuhet: **“Ti mos nxito me Kur'anin para se të përfundojë Shpallja e tij tek ti.”**.

Në ajetin 16 të sures “Kijame” thuhet: **“Ti (Muhammed), mos e shqipto atë (Kur'anin) me gjuhën tënde, për ta nxënë atë më shpejt!”**.

Nga këto ajete mund të dalim në përfundimin se Kur'ani kishte dy zbritje:

E para: Kur'ani zbriti i gjithi në një kohë. Ai zbriti nga All'llahu i Madhërueshëm në zemrën e pastër të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Natën e Kadrit të muajit Ramazan.

E dyta: Kur'ani ka zbritur gradualisht për 23 vjet, sipas kushteve, ngjarjeve e nevojave.

Dëshmi tjetër e kësaj thënie është se disa transmetime kanë përmendur fjalën “*el inzalu*” dhe disa të tjera fjalën “*et tenzijlu*”. Ajo që kuptohet nga tekstet gjuhësore është se fjala “*tenzilun*” tregon zbritjen e një gjëje në mënyrë graduale, pjesë-pjesë. Kurse fjala “*inzalun*” ka kuptim më të gjerë dhe përfshin si zbritjen graduale, ashtu dhe zbritjen e menjëhershme të diçkaje.¹¹

Është interesante se të gjitha ajetet e përmendura që flasin për zbritjen e Kur'anit në Natën e Kadrit dhe në muajin e Ramazanit, përdorin fjalën “*inzalun*”, e cila tregon zbritjen e plotë dhe të menjëhershme.

Por si zbriti i gjithë Kur'ani në zemrën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)? A ishte ai në formën e këtij Kur'ani që ne kemi në duar, me këto ajete dhe sure, apo kuptimet dhe të vërtetat e tij kanë zbritur në mënyrë të përmbledhur së bashku?

Çështja nuk është shumë e qartë. Ajo që arrijmë të kuptojmë, është se herën e parë, Kur'ani ka zbritur i gjithi menjëherë, brenda një nate të vetme, në zemrën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe herën e dytë ka zbritur gradualisht, për 23 vjet me radhë.

Është e vërtetë se fjala “Kur'an” përdoret për të gjithë Kur'anin, por një pjesë e komentuesve thonë se ky ajet flet për fillimin e zbritjes së Kur'anit. Ata thonë se ajetet e para të Kur'anit

¹ Shih Mufredatu Ragib, lënda “*nezele*”.

kanë zbritur në muajin e Ramazanit, në Natën e Kadrit, por ky mendim e kundërshton aparencën e ajeteve.

Thënia më e dobtë lidhur me këtë çështje është fjala e dikujt që thotë: Kur zbriti sureja “El Hamd” (Fatiha), e cila është përmbledhja e të gjithë Kur’anit, në Natën e Kadrit, është shprehur kështu: **“Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit.”**

Të gjitha këto supozime janë në kundërshtim me aparencën e ajeteve, sepse nga ajetet del qartë se i gjithë Kur’ani ka zbritur në Natën e Kadrit.

E vetmja gjë që qëndron këtu, është ajo që lexojmë në transmetimet e shumta të përcjella në tefsirin e “Ali ibn Ibrahim”, nga Imam Bakiri, Sadiku dhe Ebi Hasan Musa, i biri i Xhaferrit (*Paqja qoftë mbi ta!*), ku thuhet: **“Ne e kemi zbritur atë në një natë të bekuar.”** “Ajo është Nata e Kadrit. All’llahu i Madhëruar e ka zbritur Kur’anin atë natë në “El Bejtul Ma’mur” të gjithin menjëherë. Pastaj, Ai e zbriti nga shtëpia e banuar për tek i Dërguari i All’llahut përgjatë njëzetë e tre viteve.”¹ Ky transmetim ka përdorur fjalën “nuzulun” për tërësinë e zbritjes, kurse për zbritjen graduale ka përdorur fjalën “nezele”.

Po ku është “El Bejtul Ma’mur”? Sqarimi i saj do të bëhet në fundin e ajetit 4 të sures “Tur”.

¹Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 620. Në këtë hadith është përmendur se Kur’ani ka zbritur gradualisht në njëzet vjet. Por ne e dimë se koha e profecisë, gjatë së cilës ka zbritur Kur’ani, ka qenë 23 vjet. Mendohet se kjo thënie ose është një dyshim i autorit transmetues, ose një gabim në kopjimin e hadithit.

Ajo është një shtëpi në qiej, paralel me Qabenë dhe është vendi i adhurimit të engjëjve. Në atë shtëpi bëjnë Haxhin çdo ditë shtatëdhjetëmijë engjëj.

Në cilin qiell gjendet ajo shtëpi? Transmetimet janë të ndryshme në lidhje me këtë, por në shumicën prej tyre thuhet se ajo është në qiellin e katërt, kurse në një pjesë të tyre thuhet se gjendet në qiellin e parë, në atë të dynjasë. Disa transmetime të tjera thonë se shtëpia gjendet në qiellin e shtatë.

Në hadithin që transmeton dijetari Tabrasij në “Mexhmaul Bejan”, në komentimin e sures “Tur”, nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë: “Ajo është një shtëpi në qiellin e katërt, paralel me Qabenë. Është e populluar nga engjëjt, të cilët bëjnë vetëm adhurim. Çdo ditë në të futen shtatëdhjetëmijë engjëj dhe kur dalin prej saj nuk kthehen kurrë më në të.”.¹

Zbritja e plotë e Kur'anit në “El Bejtul Ma'mur” gjatë Natës së Kadrit nuk e kundërshton diturinë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse ai nuk ka asnjë informacion rreth diturisë së fshehtë të All'llahut, por ka dijeni për elementë të tjerë.

Thënë ndryshe, ajo që kuptuam nga ajetet e kaluara, është se Kur'ani ka zbritur te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin*

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 163. Eruditi El Mexhlsij i ka mbledhur në “Biharul Anuar”, vëll. 58, f. 55 hadithet që kanë lidhje me “El Bejtul Ma'mur”. Ao janë 15 hadithe. Në hadithin e gjashtë thuhet: “Çdo ditë hyjnë në të shtatëdhjetëmijë engjëj dhe dalin prej saj dhe nuk kthehen më në të deri në ditën e Kiametit.”. Duket se ky hadith është më i plotësuar dhe më përfshirës sesa të tjerët, f. 58.

mbi të dhe mbi familjen e tij!) dy herë: një herë ka zbritur i plotë Natën e Kadrit dhe herën tjetër ka zbritur gradualisht gjatë 23 viteve. Kjo nuk e kundërshton hadithin e përmendur, i cili thotë: “Me të vërtetë, ai zbriti në Natën e Kadrit të “*El Bejtul Ma’mur*”, sepse zemra e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është e familjarizuar, e informuar për “*El Bejtul Ma’mur*”.

Përmes kësaj përgjigjeje u bë e qartë edhe përgjigjja për një tjetër pyetje, e cila është: “Nëse Kur’ani ka zbritur Natën e Kadrit, atëherë si ishte i mundur fillimi i Shpalljes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në të njëzet e shtatën ditë të muajit Rexheb, sipas transmetimeve të njohura?”

Ajeti që vijon është një përshkrim i qartë i Natës së Kadrit. Ai thotë: “**Në atë** (natë të zbritjes së Kur’anit) **vendoset çdo punë e urtë.**”.

Fjala “*jufruku*” – “*ndahet*”, “*zgjidhet*” që përdoret këtu, tregon se të gjitha çështjet e vazhdimësisë caktohen atë Natë. Fjala “*el hakimju*” sqaron se kjo çështje është e bazuar në dije dhe urtësi. Në të shumtën e rasteve kjo fjalë përmendet si atribut për All’llahun e Madhëruar dhe përshkrimi i çështjeve me këtë cilësi është për siguri dhe përforsim.

Kjo harmonizohet me transmetimet e tjera, që thonë se fatet e bijve të Ademit për një periudhë njëvjeçare caktohen në Natën e Kadrit. Këtë Natë ndahen mirësitë, exhelet, afatet dhe çështje të tjera.

Ajeti tjetër thotë, për siguri, se Kur'ani është i zbritur nga ana e All'llahut të Madhëruar: **“Me urdhrin Tonë! Ne gjithmonë kemi nisur të Dërguar.”**.

Për të paraqitur shkaku kryesor të zbritjes së Kur'anit dhe të dërgimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe caktimin e fateve në Natën e Kadrit, ajeti shton: **“Si mëshirë prej Zotit tënd...”**.

Nuk ka dyshim se mëshira e Tij nuk llogaritet, nuk kufizohet. All'llahu i Madhëruar nuk i braktis robtë e Tij dhe çështjet e tyre. Ai u dërgon atyre mësim të domosdoshme për udhëzimin e tyre në rrugën e tyre drejt All'llahut, sepse e gjithë bota e ekzistencës rrjedh nga mëshira e Tij e gjerë dhe buron prej Tij. Njerëzit janë ata që e gëzojnë më shumë këtë mëshirë se të gjitha krijesat e tjera.

Ky ajet në fund, së bashku me ajetin që pason, tregojnë shtatë cilësi të All'llahut të Madhëruar. Të gjitha ato qartësojnë Njehsimin e Tij. Ajetet thonë: **“...Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.”**, sepse Ai i dëgjon kërkesat e robëve dhe ka dijeni për sekretet e zemrave të tyre.

Më pas qartësohet cilësia e tretë: **“Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, nëse besoni me bindje.”**.

Meqenëse shumë prej idhujtarëve besonin në ekzistencën e zotave dhe të shumë hyjnive, meqenëse mendonin se për çdo krijesë ka një zot dhe meqenëse në ajetin e kaluar u përdor fjala *“rabbike”* – *“Zotit tënd”*, mundet që ata të mendojnë se Zoti i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen*

e tij!) nuk është Zoti i krijesave të tjera. Ky ajet i shkatërron të gjitha këto mendime me fjalinë: **“Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre...”** dhe e përforcon qartazi se All’llahu i të gjitha krijesave është Një.

Kurse fjalia **“...nëse besoni me bindje.”** shtron pyetjen: A është i kushtëzuar me këtë kusht të qenit e All’llahut, Zoti i Botës?

Nga sa duket, ajo që nënkuptohet në përmendjen e kësaj fjalie, është deklarimi i njërit prej dy kuptimeve ose secilit prej të dyve:

E para: Nëse kërkonit që të bindeni, rruga që të çon atje, është të menduarit e thellë në sundimin absolut të All’llahut.

E dyta: Nëse jeni prej atyre që janë bindur, burimi më i mirë në arritjen e këtij besimi, është të meditonit në gjurmët e mëshirës së All’llahut. Nëse ju i shikoni gjurmët në të gjithë botën e ekzistencës, ato do t’ju vërtetojnë se All’llahu është Zoti i çdo gjëje. Nëse e ndani në pjesë bërthamën e çdo atomi, atëherë do të shihnit në të argumentin e kësaj hyjnie. Nëse nuk bindeni edhe pas kësaj, se All’llahu i Madhëruar është Zoti i Vetëm i Gjithësisë, atëherë në çfarë gjëje mund të bindeni e të besoni në këtë botë?!

Në cilësinë e katërt, të pestë dhe të gjashtë thuhet: **“S’ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij. Ai e jep jetën dhe e shkakton vdekjen...”**, sepse jeta dhe vdekja juaj është në dorën e Tij. Ai, i Madhërishmi, është All’llahu juaj dhe Zoti i botrave. Nuk ka tjetër Zot, përveç Tij!

Në cilësinë e shtatë shton: **“...Ai është Zoti juaj dhe Zoti i të parëve tuaj të lashtë!”**, sepse nëse thoni se adhuroni statujat, ngaqë prindërit tuaj i kanë adhuruar më parë, atëherë ta dini se Zoti i tyre është All'llahu, Një dhe i Vetëm. Edhe lidhja juaj e fortë me prindërit tuaj të lashtë ju detyron që të mos adhuroni kënd, veç All'llahut dhe të mos i përuleni tjetërkujt, veç Tij. Nëse ata kanë pasur rrugë tjetër, veç kësaj rruge, atëherë dijeni se ata kanë qenë në gabim, pa asnjë dyshim.

Jeta dhe vdekja janë çështje të All'llahut dhe planifikime të Tij. Nëse ajeti i ka përmendur në mënyrë specifike, kjo është bërë për shkak se ato kanë një rëndësi të madhe. Nuk është hera e parë që Kur'ani fokusohet në çështjen e jetës dhe vdekjes, madje e ka qartësuar shpesh se ato janë nga çështjet e veçanta të All'llahut të Madhëruar. Në të njëjtën kohë, jeta dhe vdekja janë nga çështjet më të ndërlikuara në botën e ekzistencës si dhe argumenti më i qartë i fuqisë së All'llahut të Madhëruar.

Hulumtim

Lidhja e Kur'anit me Natën e Kadrit

Nata e Kadrit përmendet në këto ajete në mënyrë të tërthortë, kurse në ajetet e sures “Kadr” përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë se Kur'ani ka zbritur në Natën e Kadrit. Kjo përmendje është shumë e rëndësishme. Atë Natë caktohen fatet e robëve dhe begatitë e tyre dhe pikërisht atë Natë zbret Kur'ani

Fisnik në zemrën e pastër të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). A nuk tregon kjo, se ka një lidhje të vërtetë mes caktimeve të fateve të njerëzve dhe përmbajtjes së këtij Libri qiellor?

A nuk do të thotë kjo fjalë, se Kur'ani nuk duhet të ndahet nga jetët tuaja shpirtërore, madje as atyre materiale?

Po, atë Natë, në të cilën caktohen fatet, atë Natë është zbritur edhe Kur'ani!

Ajetet 9-16

بَلْ هُمْ فِي شَكٍّ يَلْعَبُونَ ۚ فَارْتَقِبْ يَوْمَ تَأْتِي السَّمَاءُ بِدُخَانٍ مُبِينٍ ۝
يَغْشى النَّاسَ هَذَا عَذَابٌ أَلِيمٌ ۝ رَبَّنَا اكْشِفْ عَنَّا الْعَذَابَ إِنَّا
مُؤْمِنُونَ ۝ أَنَّى لَهُمُ الذِّكْرَى وَقَدْ جَاءَهُمْ رَسُولٌ مُبِينٌ ۝ ثُمَّ تَوَلَّوْا عَنْهُ
وَقَالُوا مُعَلَّمٌ مَجْنُونٌ ۝ إِنَّا كَاشِفُو الْعَذَابِ قَلِيلًا ۝ إِنَّكُمْ عَائِدُونَ ۝ يَوْمَ
نَبْطِشُ الْبَاطِشَةَ الْكُبْرَى إِنَّا مُنْتَقِمُونَ ۝

“Por ata argëtohen duke dyshuar.”

“Prandaj ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshojë tym të qartë.”

“Që do t’i mbulojë njerëzit, (e do t’u thuhet): ‘Ky është dënim i dhembshëm!’”

“(Mohuesit do të thonë): ‘O Zoti ynë, lirona prej dënimit! Ne tashmë besojmë!’”

“E si mund të përfitojnë ata nga këshilla, ndërkohë që më parë atyre u pat ardhur një i Dërguar me shpjegime të qarta.”

“E ata i kthyen shpinën, duke thënë: ‘Ai është një i çmendur i mësuar nga të tjerët.’”

“Edhe sikur t’ju lirojmë nga dënimi pak (kohë), ju me siguri që do të ktheheni (në mosbesim).”

“Ditën, kur do t’i mbërthejmë ata me forcën më të madhe, Ne do të hakmerremi.”

Komentimi

Tymi vrasës

Në ajetet e kaluara u fol për ata që kërkojnë të binden, të cilët kanë rrugë të shumta për ta arritur. Ajeti i parë i këtyre ajeteve thotë: **“Por ata argëtohen duke dyshuar.”**, sepse dyshimi i tyre në vërtetësinë e këtij Libri qiellor dhe në Profecinë tënde nuk vjen për shkak se kjo çështje është shumë e ndërlikuar. Përkundrazi, dyshimi i tyre vjen për shkak të mungesës së seriozitetit të tyre ndaj saj. Ata, një herë tallen dhe e përbuzin, kurse herën tjetër hiqen sikur nuk kanë informacion dhe njohuri. Çdo ditë, ata sajojnë një lojë të re.

Fjala *“jel’abune”* tregon të pështyrit padashur; kur njeriu pështyn pa dashur.

Sido që të jetë, sjellja serioze e ndihmon njeriun që të njohë të vërtetën, kurse sjelljet jokorrekte dhe tallëse e pengojnë atë që të arrijë tek e vërteta.

Më pas, dy ajetet e tjera tregojnë kërcënimet për këta mohues kokëfortë, mizorë, për të cilët thuhet: **“Prandaj ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshojë tym të qartë. Që do t’i mbulojë njerëzit, (e do t’u thuhet): ‘Ky është dënim i dhembshëm!’”**.

Në atë çast, ata do t’i kaplojë frika dhe do t’u hapen sytë. Do të qëndrojnë përballë gabimit të tyre të madh dhe do t’i drejtohen All’llahut të Madhërueshëm me fjalët: **“O Zoti ynë, lirona prej dënimit! Ne tashmë besojmë!”**.

Por All’llahu i Madhëruar e refuzon kërkesën e këtyre dhe u thotë: **“E si mund të përfitojnë ata nga këshilla, ndërkohë që më parë atyre u pat ardhur një i Dërguar me shpjegime të qarta.”**. Një i Dërguar, që ishte i qartë në veten e tij, në mësimet, argumentet dhe mrekullitë e tij, si dhe sqarues për të gjitha ato.

Por mohuesit kokëfortë, në vend që t’i bindeshin atij dhe të besonin në All’llahun, Një dhe të Vetëm, e të pranonin urdhrat e Tij, ata e kundërshtuan Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“E ata i kthyen shpinën, duke thënë: ‘Ai është një i çmendur i mësuar nga të tjerët.’”**.

Kurse herë tjetër, ata thonin: S’ka dyshim se ndonjë fëmijë romak i ka dëgjuar historitë e Pejgamberëve dhe lajmet e tyre dhe ia mësojnë atij. Këto ajete janë shpikje të tij: **“Ne e dimë shumë mirë se ata thonë: ‘Atë, (Muhammedin), po e mëson një njeri!’”. Mirëpo, gjuha e atij që e mëson (supozojnëata), është jo arabe (e paqartë), e kjo (e Kur’anit) është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë.”**¹

¹ Sure “Nahl”, ajeti 103.

Kurse herë të tjera, ata thonin: Me të vërtetë, ai është me çrregullime mendore. Këto fjalë janë pasojë e humbjes së drejtpeshimit mendor...".

Më pas, ajeti shton: **"Edhe sikur t'ju lirojmë nga dënimi pak (kohë), ju me siguri që do të ktheheni."** Kjo tregon se ata, kur shohin dënimin pranë, pendohen për punët e këqija të bëra më parë dhe vendosin që ta rregullojnë sjelljen, vetëm se ky qëndrim i ri i tyre është i përkohshëm, sepse sapo të qetësohen ngjarjet, ata kthehen përsëri në gjendjen që ishin më parë.

Në ajetin e fundit të këtij grupi ajetesh, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ditën, kur do t'i mbërthejmë ata me forcën më të madhe, Ne do të hakmerremi."**¹

Fjala *"el batshu"* tregon marrjen e diçkaje me forcë. Këtu ka kuptimin e hakmarrjes së ashpër dhe përshkrimin e rrëmbimit të fuqishëm; është tregues i dënimit të ashpër që e pret këtë grup.

Si përfundim, ata i presin dënime të dhimbshme, nga të cilat nuk kanë shpëtim.

Fjala *"muntekimune"* do të thotë *ndëshkim* dhe *shpërblim*. Edhe pse në bisedat tona të përditëshme fjala *"el intikamu"* ka kuptimin e ndëshkimit të shoqëruar me ndezjen e zjarrit të zemërimit dhe zbrasje të zemrës nga reagimi dhe dëshira për hakmarrje, mirëpo kjo çështje nuk gjendet në kuptimin gjuhësor të fjalës.

¹ Fjala *"jeumun"* është e lidhur me foljen *"nentekimu"* e cila kuptohet nga fjalia *"inna muntekimune"*. Kështu, fjalia merr trajtën: "Do të hakmerremi ndaj tyre ditën që do t'i kapim me rrëmbimin Tonë të fuqishëm; me të vërtetë, Ne jemi hakmarrës."

Hulumtim

Çfarë nënkuptohet me tymin e qartë (*ed dukhanul mubijn*)?

Komentuesit kanë mendime të ndryshme për tymin që përmendet në këto ajete, si një mënyrë shprehjeje për ndëshkimin e All'llahut.

Për këtë çështje ka dy mendime kryesore:

1- Tymi është tregues i dënimit dhe i ndëshkimit, me të cilët janë sprovuar jobesimtarët kurejshë në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse Profeti i mallkoi ata dhe u lut kundër tyre, kur tha: “O Zot, sprovoi ata me ato vite si vitet e Jusufit!”.¹ Pas kësaj, Mekën e goditi një thatësi e ashpër, sa që u dukej sikur mes Qiellit dhe Tokës ishte një shtyllë prej tymi. Qyteti u kaplua nga uria dhe etja e madhe.

Kurejshët erdhën te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thanë: “O Muhammed, ti na urdhëron që t'i ruajmë lidhjet farefisnore, mirëpo populli yt po shkatërrohet. Nëse Zoti do të na e largonte ndëshkimin prej nesh, atëherë ne do të besonim. Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u lut dhe nga kjo lutje u largua dënimi dhe u përhap e mira, begatia e bollshme. Mirëpo ata nuk e vlerësuan këtë të mirë dhe iu kthyen mohimit përsëri.”.²

¹“Biharul Anuar”, vëll. 18, f. 14. Në shumë burime të tjera, shprehja është në këtë trajtë: “O All'llah, shtojë ashpërsinë Tënde mbi keqbërësit dhe bëji vitet e tyre si vitet e Jusufit!”; “Biharul Anuar”, vëll. 9, f. 158.

²Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 62. Fundi i ajetit në fjalë.

Sipas këtij komentimi, beteja e Bedrit është konsideruar si një rrëmbim i fuqishëm, domethënë si një ndëshkim i ashpër, sepse jobesimtarët morën goditje shkatërruese dhe vdekjeprurëse prej myslimanëve në Bedër.

Sipas këtij komentimi, kuptohet se ai dënim nuk kishte tym. Këtu, tymi është përmendur në mënyrë figurative, për të treguar për atë situatë të vështirë e të dhimbshme.

Disa komentues kanë thënë se “tymi” përdoret nga arabët si një metaforë e së keqes dhe e fatkeqësisë, e cila të përfshin dhe të mposht.¹

Disa komentues të tjerë mendojnë se bëhet fjalë për kohën e thatësirës dhe shiut të pakët, kur qielli mbulohet zakonisht me shtylla tymi, dhe këtu është fjala për situatën kur shiu e zbret tymin në Tokë dhe e bën horizontin të pastër.²

Me gjithë këto cilësi, fjala “tym” këtu është përdorur si metaforë.

2- Me termin “*ed dukhanul mubijnu*” kuptohet ai *tym* i *dendur*, i cili do të mbulojë qiellin në fundin e botës, në prag të Kiametit. Kjo është shenjë e fillimit të çasteve të fundit të kësaj bote dhe fillimit të dënimit të All’llahut për zullumqarët dhe për ata që bëjnë shkatërrime në Tokë.

Këta zullumqarë, në atë çast, do të zgjohen nga gjumi i tyre i shkujdesjes, do të kthjellohen nga hutimi dhe do të kërkojnë largimin e dënimit dhe rikthimin në jetën e zakonshme të dynjasë.

¹Fakhru Razi thotë: Arabët e quajnë të keqen që i mund me emrin “*ed dukhan*”; Tefsiru “*El Kebir*”, vëll. 27, f. 242.

²Tefsiri “*Ruhul Meanij*”, vëll. 25, f. 107.

Sipas këtij komentimi, kuptimi i “*ed dukhan*” është kuptim i vërtetë dhe përmbajtja e këtyre ajeteve është njëlloj si ajo e ajeteve të tjera, ku tregohet se kriminelët dhe jobesimtarët luten dhe kërkojnë që t’u largohen dënimet dhe të rikthehen në dynja, mirëpo lutja e tyre nuk pranohet.¹

Problemi i vetëm i këtij komentimi është se ai nuk harmonizohet me fjalinë “**Edhe sikur t’ju lirojmë nga dënimi pak (kohë), ju me siguri që do të ktheheni.**”, sepse ndëshkimi i All’llahut nuk lehtësohet me përfundimin e dynjasë apo në Kiamet, që njerëzit t’i kthehen përsëri mosbesimit dhe kundërshtimit.

Në qoftë se e konsiderojmë këtë fjali si një problem të kushtëzuar, atëherë do të largohet paradoksi, sepse kuptimi i ajetit bëhet: “Sa herë që Ne ua largojmë atyre sadopak dënimin, ata rikthehen në rrugën e tyre të parë. Kjo është e ngjashme me ajetin 28 të sures “El En’am”, i cili thotë: “**Prandaj, edhe sikur të ktheheshin, ata do të përsërisnin atë që e kishin të ndaluar.**”.

Po ashtu, komentimi i shprehjes “**...rrëmbimin e fuqishëm...**” me ngjarjet e Ditës së Bedrit, duket larg së vërtetës, kurse komenti në lidhje me dënimet e Kiametit² në ajet, është në rregull.

Dëshmi tjetër e komentimit të dytë janë transmetimet e përmendura nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku thuhet se bëhet fjalë për tymin që do të mbulojë botën në prag të ardhjes së Kiametit.

¹Shih ajetet 27-30 të sures “El En’am”.

²Err Rragibu thotë se fjala “*el batshu*” është marrja e diçkaje me dhunë; zakonisht, ajo është paraprirëse e dënimit.

Këtë transmetim e përcjell Hudhejfetu ibn El Jeman nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili ka përmendur katër shenja të afrimit të Kiametit:

E para është dalja e Dexhalit, e dyta është zbritja e Isait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!), e treta është zjarri që shfaqet nga tokat e Adnit dhe e katërta është tymi.

Hadhife pyeti: “O i Dërguar i All'llahut, çfarë është tymi?”

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexoi: **“Prandaj ti prite atë (ditë), kur qielli do të lëshojë tym të qartë...”**, tymi që mbulon çdo gjë nga lindja në perëndim dhe që qëndron dyzet ditë dhe net. Besimtarit do t'i vijë një puhizë e ftohtë, ndërsa jobesimtarit do t'i ngjajë të dehurve dhe ky tym do të dal nga dy vrimat e hundës së tij, nga dy veshët dhe nga mbrapa.”.¹

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Ebi Malik Esharijju, thuhet: “... Zoti juaj ju ka paralajmëruar me tri gjëra: me tymin që merr besimtarët si të ishin të ftohur dhe i fryn deri sa t'u dalë nga veshët; e dyta është kafsha, kurse i treti është Dexhali.”.²

Një sqarim të plotë rreth kafshës së tokës e kemi paraqitur në fundin e ajetit 82 të sures “Neml”.

¹Tefsiri “Ed DurrulMenthur”, vëll. 6, f. 29.

²Po aty.

Ebu Said El Khuderij ka transmetuar hadith nga Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të njëjtë me këtë kuptim.¹

Të njëjta me këto transmetime, me detaje më të shumta, kanë ardhur edhe nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*). Prej atyre transmetimeve përmendim një transmetim nga Prijësi i besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), se i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)ka thënë: “*Dhjetë gjëra duhet të ndodhin patjetër para Kiametit. Prej tyre janë: shpërbërja e dritës, përhapja e pluhurit, dalja e Dexhalit, tymi, kafsha, ardhje e Mehdiut, lindja e diellit nga perëndimi, zbritja e Isait, një shafitje në lindje dhe një tjetër në Gadishullin Arabik, si dhe zjarri që ndizet në shkretëtirën e Adnit e që i drejton njerëzit drejt Mahsherit, vendit të tubimit të tyre.*”²

Nga gjithë sa është thënë, dalim në përfundimin se komentimi i dytë është më i përshtatshëm.

¹Po aty.

²“Biharul Anuar”, vëll. 52, f. 209.

Ajetet 17-21

وَلَقَدْ فَتَنَّا قَبْلَهُمْ قَوْمَ فِرْعَوْنَ وَجَاءَهُمْ رَسُولٌ كَرِيمٌ ۝ أَنْ أَدُّوا إِلَيَّ عِبَادَ اللَّهِ إِنِّي لَكُمْ رَسُولٌ أَمِينٌ ۝ وَأَنْ لَا تَعْلُوا عَلَى اللَّهِ إِنِّي آتِيكُمْ بِسُلْطَانٍ مُبِينٍ ۝ وَإِنِّي عُذْتُ بِرَبِّي وَرَبِّكُمْ أَنْ تَرْجُمُونِ ۝ وَإِنْ لَمْ تُؤْمِنُوا لِي فَاعْتَرِزْ لُونِ ۝

“Përpara tyre Ne vumë në sprovë popullin e Faraonit, kur u pat ardhur i Dërguari fisnik.”

“(i cili u tha): ‘Më sillni robtë e All’lilaut, sepse Unë jam për ju një i Dërguar i besuar.’”

“Dhe mos u madhëroni mbi All’lilahun, sepse unë po ju sjell provë të qartë.”

“Unë kërkoj mbështetje në Zotin tim dhe Zotin tuaj, që të mos më vrisni me gurë!”

“Nëse nuk më besoni, atëherë largohuni prej meje!”

Komentimi

Nëse ju nuk besoni, atëherë mos i pengoni të tjerët të besojnë

Në ajetet e kaluara u diskutua rreth mosbindjes së politeistëve arabë ndaj të vërtetës. Ajetet që janë në diskutim na tregojnë për popujt e kaluar që ecën në të njëjtën rrugë dhe që u sprovuan me një ndëshkim të rëndë, me shkatërrimin e mohuesve. Ky dënim i tyre është njëherësh argëtim për besimtarët dhe paralajmërim për mohuesit dhe kokëfortët. Ai i ngjan historisë së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) me Faraonin. Për këtë, në ajet thuhet: **“Përpara tyre Ne vumë në sprovë popullin e Faraonit...”**.

Fjala *“fetenna”* tregon vendosjen e floririt në furrën e zjarrit për ta pastruar nga mbetjet e tjera. Më pas, kjo fjalë u përdor për të treguar çdo sprovë që jepet për të njohur pastërtinë e njeriut. Kjo sprovë e pastërtisë njerëzore përfshin të gjithë jetën e njeriut dhe të gjitha shoqëritë njerëzore. Thënë ndryshe, kjo dynja është shtëpia e sprovave të shumta.

Populli i Faraonit ishte në kulmin e fuqisë dhe të madhësisë së tij. Ai kishte një qeveri të fortë, pasuri gjigande dhe potenciale të shumta. Pikërisht nga këto, ai u mashtrua dhe u zhyt në mëkate e padrejtësi të pafundme.

Më pas, ajeti shton: **“...kur u pat ardhur i Dërguari fisnik.”**, sepse i Dërguari ishte i ndershëm si nga ana morale,

ashtu edhe nga prejardhja familjare. Ai ishte Musai, i biri i Imranit (*Paqja qoftë mbi të!*).¹

Musai (*Paqja qoftë mbi të!*)u foli atyre me shumë mirësjellje dhe edukatë, me shumë dashuri dhe respekt: **“Më sillni robtë e All’llahut...”**.²

Sipas këtij komentimi, **“robtë e All’llahut”** janë faraonët. Megjithëse kjo mënyrë të shprehuri, në shumicën e ajeteve kur’anore është përdorur për robtëpunëmirë, por në disa ajete në kapituj të ndryshëm përdoret edhe për jobesimtarët dhe kriminelët, me qëllim që të ngacmojë ndjeshmërinë e tyre dhe t’ua tërheqë zemrat drejt të vërtetës.³

Duke u bazuar në këtë mënyrë argumentimi, ajo që nënkuptohet prej fjalisë *“eddu”- “më sillni”*, është bindja ndaj urdhrit të All’llahut të Madhëruar.

Një grup komentuesish kanë përmendur një koment tjetër për këtë fjali. Ata kanë thënë se ata që nënkuptohen me shprehjen **“robtë e All’llahut”**, janë Beni Israilët, kurse me frazën *“eddu”- “më sillni”*, nënkuptohet dorëzimi në dorën e Musait (*Paqja qoftë*

¹Ragibi në“El Mufredat” thotë: Nëse me fjalën *“el keremu”* përshkruhet All’llahu, atëherë ajo është emër i mirësisë dhe begatisë së Tij , sikurse Fjala e Tij: **“Me të vërtetë, Zoti im është i pasur, bujar.”**. E nëse All’llahu e përshkruan njeriun me këtë fjalë, ai është një përshkrim përshkak të moralit të mirë dhe të punëve të mira që bën njeriu. Ky përshkrim është përmendur në Kur’an edhe për çështje të tjera, si: *“kitabun kerim”*, *“kul’lu zeuxhin kerim”*, *“rizkun kerim”*, *“mekamun kerim”*, *“exhrun kerim”*.

²Fjala *“en”* në fjalinë **“Më sillni robtë e All’llahut...”**, është komentim i një foljeje të papërmendur, që kuptohet nga fjala e mëparshme dhe aludimi është: Kam ardhur tek ju që të më sillni robtë e All’llahut.

³Shih ajetet 17 dhe 58 të sures “Furkan” dhe ajeti 13 i sures “Neb’e”.

mbi të!) dhe largimi, heqja e poshtërimit dhe e skllavërisë së tyre. Kështu thuhet në ajetin 17 të sures “Shuara”: **“T’i lejosh Beni Israilët që të vijnë me ne!”**. I njëjti kuptim del edhe nga ajeti 105 i sures “A’raf” dhe nga ajeti 48 i sures “TaHa”.

Me këtë komentim nuk harmonizohet shprehja “*eddu*”- “*më sillni*”, sepse ajo zakonisht përdoret për të treguar lënien e pasurive, të amaneteve dhe detyrimeve, dhe jo për dorëzimin e njerëzve.

Sido që të jetë, në pjesën e mbetur të ajetit thuhet: **“...unë jam i Dërguar besnik tek ju.”**. Kjo shtesë qartëson dhe ndalon çdo akuzë ndaj tij.

Kjo mënyrë të shprehuri i refuzon akuzat e kota që i bënë atij faraonët, si: magjia, përpjekja për të marrë drejtësinë në Egjipt dhe përpjekja për të dëbuar pronarët autoktonë (për të cilat është folur në ajetet e kaluara).

Më pas, Musai (*Paqja qoftë mbi të!)* i ftoi që t’i binden All’llahut të Madhëruar. Pas lirimit të Beni Israilëve, ai u përpoq që të tregonte detyrën e tij ndaj tyre duke u thënë: **“Dhe mos u madhëroni mbi All’llahun, sepse unë po ju sjell provë të qartë.”**; mrekullitë e tij janë të dukshme dhe argumentet e tij kanë logjikë të qartë.

Ajo që synohet me shprehjen “mos bëni mendjemadhësi ndaj All’llahut të Madhëruar”, është mosbërja e asnjë gjëje që nuk harmonizohet me bazat e adhurimit, mosbërja e asnjë kundërshtimi dhe rebelimi, mosdëmtimi i të Dërguarve të All’llahut, apo gjëra të tilla të ngjashme.

Mendjemëdhenjtë dhe skllevërit e kësaj dynjaje nuk mëtonin asnjë akuzë dhe mashtrim, por ato ia ngjisnin kujtdo që e shihnin si kundërshtar të interesave dhe dobive të tyre të paligjshme. Për këtë, Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u vë kufij sjelljeje atyre: **“Unë kërkoj mbështetje në Zotin tim dhe Zotin tuaj, që të mos më vrisni me gurë!”**.

Kjo mënyrë të shprehuri është treguese e asaj që thoshte Musai (*Paqja qoftë mbi të!*): “...unë nuk i kam frikë kërcënimet tuaja dhe do të rezistoj deri në frymën e fundit, sepse All’llahu është mbrojtësi dhe ruajtësi im.”. Shprehje të tilla u jepnin udhëheqësve shpirtërorë një vendosmëri të madhe në thirrjen e tyre dhe ua shtonin qëndresën në luftën ndaj armiqve. Nga ana tjetër, ato e shtonin vendosmërinë e besimtarëve në qëndrimin e tyre në të drejtë, sepse ata e dinin se Imami dhe komandanti i tyre do të qëndronte deri në çastet e fundit.

Kërcënimi me gurëzim tregonte se shumica e të Dërguarve të All’llahut para Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) janë kërcënuar në këtë formë (mbytje), njëri prej të cilëve ishte Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) “Ata thanë: ‘Nëse nuk tërhiqesh nga këto, o Nuh, me siguri, do të gurëzohesh.’”¹

E njëjta situatë ishte edhe në lidhje me Ibrahimin (*Paqja qoftë mbi të!*) kur atë e kërcënoi Azeri dhe i tha: **“Nëse nuk ndalesh, unë do të të gurëzoj”**², edhe me Shuajbin (*Paqja qoftë mbi*

¹ Sure “Esh Shuara”, ajeti 116.

² Sure “Merjem”, ajeti 46.

të!) kur e kërcënuan dhe i thanë: **"...dhe sikur të mos ishte ai grup i yti, ne do të të gurëzonim ty."**¹

Zgjedhja e gurëzimit në vend të vrasjes, është bërë për arsye se vdekja me gurëzim është më e ashpër se të gjitha.²

Disa komentues kanë thënë se gurëzimi mund të jetë me kuptimin e akuzës, të fjalës së keqe dhe kërcënimit.

Kjo fjalë ka mundësi që të jetë përdorur në kuptimin e saj të gjerë, që i përfshin të dyja kuptimet.

Ajeti i fundit i drejtohet popullit dhe i thotë: **"Nëse nuk më besoni, atëherë largohuni prej meje!"**.

Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i bindur se do të depërtonte në mesin e njerëzve dhe të shtresave të ndryshme të tyre, sepse ai zotëronte mrekulli dhe argumente të qarta. Përpjekjet dhe lufta e tij do të jepnin fryte pas njëfarë kohe.

Mirëpo, a mund të qetësoheshin ata mendjemëdhenj mizorë, duke parë me sy rrezikun që kërcënonte interesat dhe pasuritë e tyre të paligjshme? A mund ta pranonin propozimin e Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe çështjen e tij?

Ajetet që vijnë më pas do të qartësojnë epilogun e këtyre ngjarjeve.

¹ Sure "Hud", ajeti 91.

²"Lisanul Arab", lënda: "*Rexhmun*".

Ajetet 22-29

فَدَعَا رَبَّهُ أَنَّ هَؤُلَاءِ قَوْمٌ مُّجْرِمُونَ^{٢٢} فَأَسْرَ بِعِبَادِي لَيْلًا إِنَّكُمْ
مُتَّبِعُونَ^{٢٣} وَأَتْرَكَ الْبَحْرَ رَهْوًا إِنَّهُمْ جُنْدٌ مُّغْرَقُونَ^{٢٤} كَمْ تَرَكُوا مِنْ
جَنَّاتٍ وَعُيُونٍ^{٢٥} وَزُرُوعٍ وَمَقَامٍ كَرِيمٍ^{٢٦} وَنَعْمَةً كَانُوا فِيهَا فَاكِهِينَ^{٢٧}
كَذَلِكَ وَأَوْرَثْنَاهَا قَوْمًا آخَرِينَ^{٢٨} فَمَا بَكَتْ عَلَيْهِمُ السَّمَاءُ
وَالْأَرْضُ وَمَا كَانُوا مُنْظَرِينَ^{٢٩}

“Dhe ai iu lut Zotit të vet: Ky është vërtet një popull keqbërës.”

“(All’Ilahu i tha): Ec bashkë me robtë e Mi natën, e ata do t’ju ndjekin.”

“Lëreni pas detin e hapur, se ata, me siguri, do të fundosen si ushtri.”

“Eh, sa e sa kopshte dhe burime i lanë ata.”

“Sa ara të mbjella dhe ndërtesa fisnike.”

“Dhe sa begati, në të cilat kënaqeshin.”

“Kështu, Ne ua lamë trashëgim ato një populli tjetër.”

“Nuk i vajtoi ata as qielli, as Toka, as nuk iu dha afat atyre.”

Komentimi

I lanë shtëpitë, kopshtet e thesaret dhe ikën!

Musai (*Paqja qoftë mbi të!*)i përdori të gjitha mënyrat e udhëzimit për të depërtuar në zemrat e atyre kriminelëve zullumqarë, por nuk shkaktoi tek ata asnjë efekt. Ai trokiti në çdo derë, mirëpo askush nuk iu përgjigj.

Prandaj ai u mërzit prej tyre dhe nuk gjeti ndonjë zgjidhje tjetër për ta, përveç mallkimit dhe lutjes kundër tyre, sepse ata ishin të shthurur dhe nuk kishin asnjë shpresë për t'u kthyer në udhëzim. Kundër tyre duhet të zbriste dënimi i All'llahut, që t'i shkulte me gjithë rrënjë dhe ta pastronte Tokën nga pislleku i tyre. Për këtë, ajeti i parë prej këtyre ajeteve thotë: **“Dhe ai iu lut Zotit të vet: Ky është vërtet një popull keqbërës.”**.

Shikojeni edukatën e lutjes! Ai nuk thotë: “O All'llah, bëj kështu e ashtu”; përkundrazi, atij i mjafton që të thotë: “O All'llah, s'ka dyshim se ky popull është zullumqar, nuk kanë asnjë shpresë në udhëzimin e tyre!”.

All'llahu i Madhëruar iu përgjigj lutjes së tij. Për t'i dënuar faraonët dhe për të shpëtuar Beni Israilët prej tyre, Ai e urdhëroi Musain (*Paqja qoftë mbi të!*): **“(All'llahu i tha): Ec bashkë me robtë e Mi natën, e ata do t'ju ndjekin.”**, por mos u frikëso, sepse duhet që ata t'ju ndjekin, në mënyrë që të marrin dënimin që i pret.

Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) u urdhërua që të lëvizte natën në shoqërimin e robëve besimtarë të All'llahut, domethënë të Beni Israilëve, si dhe të një grupi prej popullit të Egjiptit, zemrat e të cilëve anuan nga besimi. Ata iu përgjigjën thirrjes së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) që t'i afrohen Nilit dhe ta kalojnë atë, e më pas të vazhdojnë rrugën drejt tokës së premtuar, Palestinës.

Është e vërtetë se lëvizja e Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e mbështetësve të tij u krye natën, por ishte e pashmangshme që një lëvizje kaq masive e njerëzve, të mos shihej nga faraonët. Mbase nuk kishin kaluar as disa orë, kur spiunët e çuan këtë lajm të tmerrshëm te Faraoni dhe ai urdhëroi ndjekjen e tyre me një ushtri gjigande.

E veçanta është se të gjitha këto që ndodhën, janë përmendur në një tregim të shkurtër në ajetet e mësipërme: **"...do t'ju ndjekin."**

Ajo që është paraqitur shkurt këtu, është bërë e qartë edhe në ajetet e tjera të Kur'anit, me shprehje të shkurtuara. Për shembull, në ajetin 77 të sures "TaHa" thuhet: **"Ne i kumtuam Musait: 'Udhëto natën me robtë e Mi, hapu atyre rrugë të terur në det, e mos ki frikë se do të të zënë a do të fundosesh.'"**

Më tej, ajeti pas tij thotë: "Kur të arrish në bregun tjetër, ti duhet të lësh detin me qetësi (të hapur): **"Lëreni pas detin e hapur..."**. Ajo që nënkuptohet me **"detin"** në këto ajete, është lumi i madh i Nilit.

Komentuesit dhe profesorët e gjuhës kanë thënë se fjala *"rehvun"* ka dy kuptime: *"qetësia dhe zgjerimi"* dhe *"të mbeturit i hapur"*. Nuk ka asnjë problem edhe nëse bashkohen të dyja kuptimet.

Por përse iu dha një urdhër i tillë Musait (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Beni Israilët donin që ta kalonin detin, t'i largoheshin rrezikut dhe të vazhdonin jetën në paqe në tokën e premtuar, para se të ktheheshin ujërat, por ata u urdhëruan që të mos nxitonin kur të kalonin lumin e Nilit, sepse urdhri i shkatërrimit dhe i vdekjes së ushtrisë së Faraonit u është paraqitur edhe dallgëve gjigande të Nilit. Është kjo arsyeja, që ajeti në fund thotë: **"...me siguri, do të fundosen si ushtri."**

Ky është urdhri përfundimtar i All'llahut të Madhëruar, i dhënë me të drejtë për këtë komb: që ata të mbyteshin të gjithë në lumin e madh të Nilit, i cili ishte baza e pasurive dhe fuqive të tyre. Me një urdhër të vetëm të All'llahut, ky lumë, që ishte energjia e jetës së tyre, u shndërrua në shkatërrimin dhe vdekjen e tyre.

Kur Faraoni dhe ushtria e tij arritën në bregun e Nilit, Beni Israilët kishin dalë në anën tjetër të lumit. Ushtria e Faraonit pa rrugën e thatë në mesin e Nilit. Kjo mrekulli shihej qartë edhe nga një fëmijë, por mendjemadhësia dhe mizoria e atyre budallenjve, nuk i lejoi ata që të kuptonin këtë të vërtetë të qartë. Ata mbështeten në dyshimet dhe gabimet e tyre.

Ata mbase mendonin se ky ndryshim që ndodhi papritur në Nil, u bë me urdhrin e Faraonit. Mbase Faraoni ua ka thënë këtë gjë ushtarëve të tij dhe ata e kanë ndjekur pas atë. Mirëpo, dallgët e Nilit u përplasën papritur mbi ta. Ata ranë si një ndërtesë e madhe, së cilës i shkatërrohen kolonat. Kështu u mbytën të gjithë.

Ajo që tërheq vëmendjen në këto ajete është se tre ajetet e para, të ajeteve në fjalë e përmbledhin ngjarjen në një formë të mahnitshme dhe me elekuencë të lartë, ku thonë: **“Dhe ai iu lut Zotit të vet: Ky është vërtet një popull keqbërës. (All’llahu i tha): Ec bashkë me robtë e Mi natën, e ata do t’ju ndjekin. Lëreni pas detin e hapur, se ata, me siguri, do të fundosen si ushtri.”.**

Të shprehurit me fjalën *“mugrikune” - “të mbytur”,* edhe pse ata ende nuk ishin mbytur, tregon se ky urdhër i All’llahut ishte i prerë dhe përfundimtar.

Le të shikojmë tani se çfarë ngjarjesh kanë ndodhur pas mbytjes së Faraonit dhe ndjekësve të tij.

Kur’ani Kerim në ajetet e mëposhtme na sqaron se Beni Israilët ishin vijuesit e faraonëve. Në fillim, ajeti thotë: **“Eh, sa e sa kopshte dhe burime i lanë ata.”.**

Kopshtet dhe krojet ishin dy pasuritë më të rëndësishme të Beni Israilëve. Egjipti ishte tokë prodhuese, plot me kopshte që ujiteshin nga Nili. Këto burime, për të cilat flitet, ose janë krojet që buronin atje, ose janë përrenj dhe ujëra që zgjateshin nga Nili dhe kalonin në kopshtet e tyre të pasura e të gjelbra.

Më pas, Kur’ani Kerim shton: **“Sa ara të mbjella dhe ndërtesa fisnike.”.** Edhe këto ishin dy pasuri të tjera të rëndësishme. Arat e mëdha shtriheshin përgjatë Nilit, plot me prodhime bujqësore. Të korrat, ata i përdornin si ushqim për veten e tyre, kurse tepricat i eksportonin jashtë. Pasuri tjetër ishin banesat, të cilat plotësonin nevojat më të rëndësishme të jetës së tyre.

Këto banesa të zbukuruara u bënë shkak që ata të tregoheshin të pavëmendshëm ndaj All'llahut, prandaj Kur'ani nuk tregon asnjë interes për to.

Disa komentues mendojnë se ajo që nënkuptohet me shprehjen *"ndërtesa fisnike"*, janë ngjarjet e këndshme shoqërore, podiumet mbi të cilët hipnin servilët dhe poetët për të lavdëruar Faraonin. Por kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Këta mohues zotëronin mjete të shumta luksoze, përveç katër gjërave të rëndësishme që u përmendën më lart, prandaj Kur'ani, me një fjali koncize thotë për ata: **"Dhe sa begati, në të cilat kënaqeshin."**^{1, 2}

Më pas shton: **"Kështu, Ne ua lamë trashëgim ato një populli tjetër."**³

Me shprehjen **"një populli tjetër"** nënkuptohen Beni Israilët. Kjo është bërë e qartë në ajetin 95 të sures *"Esh Shuara"*. Përdorimi i prapashtesës *"irth"* –*"trashëgimi"*, tregon se ata i përfituan të gjitha këto pasuri pa mundin më të vogël.

Ajeti i mësipërm dhe shembulli i njëjtë me të, i përmendur në suren *"Esh Shuara"*, tregojnë se Beni Israilët u kthyen në Egjipt pas mbyttjes së faraonëve, trashëguan pasuritë e tyre dhe

¹Fjala *"ne'metun"* me zanoren *"e"* të *"nunit"* do të thotë, *"kënaqësi"*, kurse me zanoren *"i"* të saj, *"ne'metun"*, do të thotë *"të begatosh"*.

² Fjala *"fakihine"* është përdorur me disa kuptime. Në fillim, ajo është përdorur në kuptimin e parë me *"të kënaqurit me fruta"*, në kuptimin e dytë me *"ngjarje komike të gëzueshme"* dhe me *"kënaqësinë"* dhe *"shijimin"* në kuptimin e tretë. Kuptimi i fundit është më gjithëpërfshirësi.

³ Fjala *"kedhalike"* është kallëzues i kryefjalës së munguar, aludimi i së cilës është: **çështja është e tillë**. Kjo mënyrë të shprehuri përdoret për diçka të sigurt.

qeverisën atje. Zhvillimi i ngjarjeve e bëri të domosdoshme që Musai (*Paqja qoftë mbi të!*) të mos e linte Egjiptin që të jetonte një boshllëk politik, pas shkatërrimit të shtyllave të qeverisjes së faraonëve.

Kjo nuk e mohon atë që tregohet në ajetet e Kur'anit, se Beni Israilët shkuan në tokën e premtuar, në Palestinë, pas çlirimit të tyre nga faraonët, kurse një grup prej tyre qëndruan në Egjipt. Një gjë e tillë është përmendur me hollësi në Kur'an.

Sqarime më të detajuara për këtë çështje jep fundi i ajetit 59 të sures "Esh Shuara".

Ajeti i fundit i këtyre ajeteve thotë: **"Nuk i vajtoi ata as qielli, as Toka, as nuk iu dha afat atyre."**

Përmendja e detajit ku thuhet se qielli dhe toka nuk qanë, është një metaforë që tregon përbuzjen për ta dhe mungesën e dikujt që t'i mbrojë. Tek arabët është i njohur fakti, se kur ata duan të tregojnë vlerat e të vdekurit, thonë: "Vajtoi për të qielli dhe toka."

Mendohet gjithashtu, se ajo që nënkuptohet me këtë shprehje, është se banorët e qiejve dhe të tokës qajnë për besimtarët e afërt të All'Ilahut, dhe jo për mendjemëdhenjtë e mizorët.

Disa komentues kanë thënë se e qara e qiellit dhe e tokës është një qarje e vërtetë, e cila shfaqet si një skuqje e veçantë, jo si skuqja e perëndimit dhe e lindjes së diellit. Këtë e lexojmë në një

transmetim: *“Kur u vra Hysejini, i biri i Aliut, vajtoi për të qielli. Mënyra e vajtimit ishte skuqja e skajeve të tij.”*¹

Në një transmetim tjetër nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) thuhet: *“Ka vajtuar qielli për Jahjain, të birin e Zekerijait, dhe për Hysejnin, të birin e Aliut (Paqja qoftë mbi ata të dy!) dyzet mëngjese.” E pyeta: “Si është vajtimi i qiellit?” Ai tha: “Dielli lind me ngjyrë të kuqe dhe perëndon po me ngjyrë të kuqe.”*²

Po ashtu, në një hadith tjetër të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) thuhet: *“Nuk ka besimtar që të mos ketë një derë, nëpërmjet së cilës të ngjitet vepra e tij, si dhe një derë tjetër, nga e cila të zbresë kismet, furnizimi i tij. Kur ai vdes, të dyja dyert vajtjnë për të.”*³

Për vdekjen e këtyre të humburve zullumqarë nuk vajton as qielli dhe as toka nuk u dëshpërua, sepse ata ishin krijesa të pista dhe dukej sikur nuk kishin asnjë lidhje me botën njerëzore. Kur u dëbuan këta të huaj nga bota, askush nuk e ndjeu zbrazëtinë e vendit të tyre. Askush nuk e ndjeu humbjen e tyre, as mbi sipërfaqen e tokës, as në skajet e qiellit dhe as në thellësitë e zemrave të njerëzve. Prandaj, syri i askujt nuk derdhi lot për vdekjen e tyre.

E përfundojmë trajtimin e këtyre ajeteve duke përmendur një transmetim, ku thuhet se kur në një rast, Prijësi i besimtarëve, Aliu (Paqja qoftë mbi të!), kaloi nëpër qytete dhe pa gjurmët e mposhtjes së Kistras, një nga shokët që ishte me të recitoi këto vargje:

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 65. Fundi i ajetit në fjalë.

²Po aty.

³Po aty.

"Dhe era ka fryrë mbi kokat e tyre,

sikur ata ishin në exhel, në ditën e caktuar."

Pasi i dëgjoi vargjet, Prijësi i besimtarëve i tha: "Pse nuk thua: 'Eh, sa e sa kopshte dhe burime i lanë ata. Sa ara të mbjella dhe ndërtesa fisnike. Dhe sa begati, në të cilat kënaqeshin. Kështu, Ne ua lamë trashëgim ato një populli tjetër. Nuk i vajtoi ata as qielli, as Toka, as nuk iu dha afat atyre.'" ¹

¹"Sefijnetul Bihar", vëll. 2, f. 531, lënda "mudunun".

Ajetet 30-33

وَلَقَدْ نَجَّيْنَا بَنِي إِسْرَائِيلَ مِنَ الْعَذَابِ الْمُهِينِ ۚ مِنْ فِرْعَوْنَ إِنَّهُ كَانَ
عَالِيًا مِنَ الْمُسْرِفِينَ ۚ وَلَقَدْ اخْتَرْنَاَهُمْ عَلَىٰ عِلْمٍ عَلَىٰ الْعَالَمِينَ ۚ
وَأَتَيْنَاهُمْ مِنَ الْآيَاتِ مَا فِيهِ بَلَاءٌ مُبِينٌ ۚ

“Ne i shpëtuan bijtë e Izraelit nga dënimi poshtërues”,

“prej Faraonit, që ishte tiran, njeri që kalonte çdo kufi të së keqes.”

“Ne i zgjodhëm ata, me qëllim mbi popujt e tjerë (të asaj kohe).”

“Dhe u dhamë shenja, në të cilat ka prova të qarta.”

Komentimi

Beni Israilët në vorbullën e sprovimit

Në ajetet e kaluara u diskutua për mbytjen e faraonëve dhe shkatërrimin e tyre, për përfundimin e qeverisjes së tyre dhe transferimin e saj tek të tjerët. Ajetet në diskutim flasin për shpëtimin e Beni Israilëve dhe çlirimin e tyre. Në to thuhet: “Ne i

shpëtuam bijtë e Izraelit nga dënimi poshtërues"; i shpëtuam ata prej dënimit trupor dhe shpirtëror, prej therjes së fëmijëve meshkuj dhe çnderimit të vajzave, e plot gjëra të tjera si këto. Është e dhimbshme që fati i një populli të jetë në dorën e një armiku gjakatar e djallëzor të tillë dhe të sprovohet me zullumqarë të tillë, që nuk njohin as mëshirë e as humanizëm.

All'llahu i Madhëruar e shpëtoi këtë popull të shtypur nga nënshtrimi i këtyre zullumqarëve më të mëdhenj në histori, përmes revolucionit hyjnor të Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), të birit të Imranit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Për këtë, ajeti thotë: **"prej Faraonit, që ishte tiran, njeri që kalonte çdo kufi të së keqes."**

Fjala *"álijen"* është tregues i mendjemadhësisë dhe tejkallimit të çdo kufiri, ashtu siç përmendet në ajetin 4 të sures *"Kasas"*: **"Me të vërtetë, Faraoni ka ngritur kryet lart në tokë"** dhe arriti deri aty sa deklaroi se ai është zot në tokë.

Fjala *"el musrifu"* rrjedh nga lënda *"israf"* dhe tregon çdo *tejkallim kufiri*, pa dallim nëse është në fjalë apo në vepra. Për këtë qëllim është përdorur fjala *"el musrifu"* në ajete të ndryshme të Kur'anit, kur flitet për çështjen e kriminelëve që tejkalojnë kufirin me padrejtësitë e tyre. Për këto vepra, ata janë quajtur tejkalue të kufirit. Këtë e lexojmë në ajetin 53 të sures *"Zumer"*: **"Thuaj: 'O robtë e Mi, të cilët e kenë ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All'llahut.'"**

Ajeti që pason, na tregon një mirësi tjetër të All'llahut të Madhëruar ndaj Beni Israilëve. Në të thuhet: **"Ne i zgjodhëm ata,**

me qëllim mbi popujt e tjerë (të asaj kohe)", por ata nuk e vlerësuan këtë mirësi dhe e mohuan, prandaj u ndëshkuan.

Ata qenë populli i zgjedhur në kohën e tyre. Këtë e sqaron fjala "*alemine*", e cila saktëson se bëhet fjalë vetëm për njerëzit e një kohe të caktuar dhe jo për njerëzit e të gjitha periudhave, sepse Kur'ani i flet ymetit islam në mënyrë të qartë në ajetin 110 të sures "*AliImran*", ku thotë: **"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve."**

Është e njëjta situatë kur flitet për tokat që kanë trashëguar BeniIsrailët. Për këtë rast, Kur'ani, në ajetin 137 të sures "*Ela'raf*" thotë: **"E atij populli që ishte i nënshtruar, ia trashëguam lindje e perëndim të tokës, që Ne e bekuam (me të mira)."** Që Beni Israilët nuk kanë trashëguar të gjithë tokën, nënkuptohet nga përcaktimi **"lindje e perëndim"**, pra në lindje e perëndim të zonës së tyre.

Disa komentues mendojnë se Beni Israilëve u është kushtuar një përkujdesje e veçantë gjatë historisë. Atyre u janë dërguar Pejgamberë të shumtë në numër, më shumë se popujve të tjerë.

Vetëm se kjo përkujdesje nuk është krejtësisht e veçantë dhe nuk shënon ndonjë dallim thelbësor mes tyre dhe popujve të tjerë. Numri i madh i Pejgamberëve të dërguar tek ata mund të jetë argument se ata ishin në kulmin e rebelimit dhe të kundërshtimit të tyre. Kjo bëhet e qartë nga ngjarjet e ndryshme pas ardhjes së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ata nuk lanë gjë të keqe pa bërë kundër këtij Pejgamberi të madh.

Sidoqoftë, ajo që kemi përmendur më sipër në komentimin e ajetit për Beni Israilët, është pranuar nga shumë komentues.

Nuk duhet harruar se ky popull kokëfortë i dëmtonte gjithmonë Pejgamberët e tij. Ata i kundërshtonin me ashpërsi ligjet e All'llahut të Madhëruar. Vetëm për të shpëtuar nga Nili dhe tmerret e tij, ata i kërkuan Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) që t'u bënte zota që t'i adhuronin. Këtë e përmend edhe Kur'ani. Kjo na tregon se qëllimi i ajetit mund të ketë qenë jo sqarimi i veçorisë së Beni Israilëve, por sqarimi i një të vërtete tjetër. Në këtë kontekst, kuptimi i ajetit bëhet: Megjithëse e dimë shumë mirë se këta do t'i shfrytëzojnë për keq mirësitë e All'llahut dhe dhuratat e Tij, Ne ua kemi dhënë atyre për t'i sprovuar.

Edhe nga ajeti tjetër mësojmë se All'llahu i Madhëruar u ka dhënë atyre dhurata të tjera për t'i sprovuar ata.

Prandaj, sprovimi hyjnor nuk tregon se ata ishin të veçantë; përkundrazi, sprovimi është dënim i nënkuptuar, sepse ata nuk falënderojnë për këto mirësi, nuk i kanë dhënë të drejtën atij që e meriton, e për këtë nuk e kalojnë sprovën. Si rrjedhojë, ata do të gjykojnë për çfarë kanë bërë.

Ajeti i fundit i këtyre ajeteve tregon për disa dhurata të tjera, të cilat All'llahu ua ka dhënë atyre: **“Dhe u dhamë shenja, në të cilat ka sprovë të qarta.”** *Një herë kemi bërë hije me re mbi ata në shkretëtirën e Sinait dhe në luginën e humbur. Një tjetër herë u zbritëm atyre një tavolinë të veçantë plot ushqime dhe mjaltë. Herën e tretë u nxorrëm burime uji nga shkëmbinjtë e thatë. Atyre u kemi dhënë edhe të mira materiale dhe shpirtërore të tjera, por gjithmonë kishim si qëllim sprovimin e tyre, sepse All'llahu i Madhëruar e sprovon një popull me fatkeqësi, kurse disa të tjerë me mirësi. Për këtë, në ajetin e*

168 të sures “ElA’raf” thuhet: **“Ne i provuam me të mira e me të këqija, në mënyrë që të tërhiqen nga e keqja.”**.

Përkujtimi i historisë së Beni Israilëve dhe i qëndrimit ndaj myslimanëve të parë bëhej që ata të mos frikësoheshin nga numri i madh i armiqve dhe nga arroganca e forcës së tyre, që të ishin të qetë e të sigurt, sepse All’llahu, i Cili ua mori jetën faraonëve dhe ua dha trashëgim Beni Israilëve pasurinë dhe qeverisjen e tyre, do t’i ngazëllejë ata me një fitore të shpejtë, ashtu siç i sprovoi ata të parët me këto dhurata, duke lënë të nënkuptohej se *edhe ju do të viheni gjithashtu në sprovë, me qëllim që të kuptohet se çfarë do të bëni pas fitores dhe marrjes së pushtetit.*

Ky është një paralajmërim për të gjithë popujt dhe kombet, në raport me qëndrimet ndaj fitoreve dhe dhuratave, të cilat i arrijnë me mirësinë e All’llahut. Veçse sprovat të tilla janë tejet të vështira.

Ajetet 34-36

إِنَّ هَؤُلَاءِ لَيَقُولُونَ ۚ إِنَّ هِيَ إِلَّا مَوْتُنَا الْأُولَىٰ وَمَا نَحْنُ بِمُنْشَرِينَ ۚ
فَأْتُوا بِآبَائِنَا إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ ۚ

“Me siguriata (jobesimtarët) thonë”:

“Ekziston vetëm vdekja jonë e parë, ne nuk do të ringjallemi!”

“Na i risillni, pra, të parët tanë, nëse thoni të vërtetën!”

Komentimi

Pas vdekjes nuk ka asgjë!

Ajetet e kaluara treguan rreth jetës së faraonëve dhe dënimit të mohuesve. Për politeistët dhe mohuesit është diskutuar edhe një herë tjetër. Këto ajete e kanë rikthyer edhe një herë për diskutim mohimin që politeistët i bëjnë Ahiretit. Kjo çështje është përsëritur në fillim të ajetit, e formuluar me një mënyrë tjetër. Ajeti thotë: **“Me siguriata (jobesimtarët) thonë: ‘Ekziston vetëm vdekja jonë e parë, ne nuk do të ringjallemi!’”**;

ne nuk do të kthehemi në jetë në mënyrë kategorike¹dhe ajo që thotë Muhammedi për Ahiretin, për jetën pas vdekjes, për shpërblimin dhe dënimin, për Xhennetin dhe zjarrin, nuk është e vërtetë; nuk do të ketë kurrë as tubim dhe as ringjallje.

Këtu shtrohet pyetja: “Përse idhujtarët përqendrohen vetëm në vdekjen e parë, e cila nënkupton mungesën e vdekjes së dytë, kur ajo që kanë për qëllim ata, është mohimi i jetës pas vdekjes dhe jo mohimi i vdekjes së dytë? Thënë ndryshe, Profetët i patën lajmëruar ata për jetën pas vdekjes dhe jo për vdekjen për herë të dytë.

Në përgjigje të kësaj themi se ata këmbëngulnin në mohimin e një gjendjeje tjetër pas vdekjes, domethënë ata besonin se njeriu vdes vetëm një herë dhe gjithçka mbaron. Sipas tyre, pas kësaj nuk ka asnjë jetë dhe asnjë vdekje tjetër.²

Kjo ngjason shumë me atë që përmendet në ajetin 29 të sures “El En’am”, ku thuhet: **“Ata thanë: ‘Nuk ka tjetër, vetëm kjo jeta jonë në këtë botë dhe ne nuk do të ringjallemi!’”**.

¹Këtu ka një kundërthënie në referimin e përemrit “hije”. Disa komentues ia kanë referuar atë fjalës “meutetu”. Kështu, fjalia merr trajtën: nuk ka vdekje tjetër, përveç vdekjes sonë të parë (tefsiri “Et Tibjan”, tefsiri “Mexhmaul Bejan” dhe tefsiri “El Keshshaf”). Disa komentues të tjerë kanë thënë se përemri ka kuptimin e dënimit dhe të përfundimit. Mbi bazë të kësaj, kuptimi i fjalisë bëhet: nuk është fundi i çështjes sonë, përveçse vdekja e parë (tefsiri “Ruhul Meanij” dhe tefsiri “El Mijzan”). Mes tyre nuk ka ndonjë ndryshim të madh për nga rezultati.

² Komentuesit kanë dhënë mendime të tjera për komentimin e kësaj fjalie, por të gjitha duken larg së vërtetës. Në njërin prej këtyre mendimeve se vdekjen e parë e kanë komentuar dhe kanë thënë që është vdekja para jetës në këtë botë. Bazuar mbi këtë, kuptimi i ajetit bëhet: pa dyshim se vdekja pas së cilës ka jetë, është vdekja e cila e kemi provuar më parë. Kurse, përsa i përket vdekjes së dytë, pas kësaj nuk ka kurrëfarë jete.

Më pas, ata sjellin një argument imagjinar, të kotë, për t'u qëndruar deklaratave të tyre dhe thonë: **“Na i risillni, pra, të parët tanë, nëse thoni të vërtetën!”**.

Disa komentues kanë thënë se kjo ishte fjala e Ebu Xhehlit. Ai u kthye nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i tha: “Nëse je i vërtetë, atëherë ringjalle gjyshin tënd, Kusaj ibn Kilabin, sepse ai ka qenë njeri i drejtë, i sinqertë, që ta pyesim atë se çfarë ka pas vdekjes.”.¹

E gjitha kjo ishte një justifikim, sepse All'Ilahu i Madhëruar nuk ringjall asnjë prej të vdekurve në këtë botë, që të mund të sjellin lajmet e Botës së Përtejme. Kërkesa e tyre ishte vetëm një justifikim, ashtu siç i kërkuan mrekullitë disa herë dhe megjithëse Profeti ua solli, ata i mohuan plotësisht ato.

Hulumtim

Doktrina e idhujtarëve për Ringjalljen

Idhujtarët në përgjithësi, e në mënyrë të veçantë idhujtarët arabë, nuk kishin një metodë të njësuar në çështjet e tyre të besimit. Ata ndryshonin mes tyre, edhe pse ishin të njëjtë në idhujtari.

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 66, si dhe disa tefsire të tjera.

Disa prej tyre nuk besonin tek All'llahu dhe te Bota Tjetër. Pikërisht për këta flet Kur'ani, pasi ata thonin: **“Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë e jona në këtë botë. Po vdesim dhe po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër, përveç kohës.”**¹

Komentues të tjerë thonin se një pjesë e atyre idhujtarëve besonin në All'llahun e Madhëruar, por gjithashtu besonin edhe se statujat janë ndërmjetësit e tyre tek Ai. Vetëm se ata e mohonin Ahiretin dhe thonin: **“Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur?”**² Ata bënë Haxhin te statujat dhe u ofronin kurbanë atyre. Ata besonin në hallall dhe në haram. Në këtë grup përfshihej pjesa më e madhe e idhujtarëve arabë.

Këta idhujtarë besonin në pavdekshmërinë e shpirtit, si dhe në formën e rimishërimit dhe të shndërrimit të shpirtit në trupa të rinj, apo në një formë tjetër.³

Ata besonin në një shpend që quhej *hametun* - *qyqe*. Ky shpend është përmendur në tregimet e arabëve. Këta besonin se shpirti i njeriut është një zog që shtrihet në trupin e tij. Kur njeriu ikën, largohet nga kjo dynja ose vritet, atëherë ky zog del nga trupi dhe sillet rrotull tij në një mënyrë të frikshme, duke vajtuar në varrin e tij.

Ata besonin gjithashtu, se ky zog në fillim është i vogël dhe më pas rritet, deri sa bëhet me përmasat e kukuvajkës. Ai jeton gjithmonë në frikë e në shqetësim dhe banon në shtëpitë e zbrazura e të shkatërruara, apo në varret e gladiatorëve të vrarë.

¹ Sure “El Xathijeh”, ajeti 24.

² Sure “Jasin”, ajeti 78.

³ “Sherhu Nehxhul Belaga”, i ibn Ebi El Hadijd El Mu'tezilij: vëll. 1, f. 119.

Idhujtarët besonin se, nëse vritet një njeri, qyqja do të klithë në varrin e tij duke thënë: *“Më jepni të pi ujë, se jam e etur.”*¹

Mirëpo Islami i shkatërroi të gjitha këto bestytни. Është transmetuar se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Nuk ka asnjë qyqe.”*²

Sido që të jetë, duket se këta idhujtarë, edhe nëse nuk e besonin Ahiretin dhe Jetën pas vdekjes, ata nuk flisnin për rimishërimin dhe përjetësinë e shpirtave në çfarëdolloj forme.

Përsa i përket ringjalljes trupore, ajo do të jetë në atë formë që e tregon Kur'ani se dheu i njeriut do të mblidhet, do të bashkohet edhe një herë dhe do të rikthehet në jetë përsëri. Për secilin, trupin dhe shpirtin, ka një rikthim të përbashkët. Edhe këtë, idhujtarët e mohonin kategorikisht, e madje jo vetëm që e mohonin, por edhe e kishin frikë, megjithëse Kur'ani ua ka bërë më se të qartë me metoda të ndryshme dhe ua ka paraqitur me fakte.

¹“Bulugul Erbi”, vëll. 2, f. 311.

² Po aty.

Ajetet 37-39

أَهُمْ خَيْرٌ أَمْ قَوْمُ تُبَّعٍ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ أَهْلَكْنَاهُمْ إِنَّهُمْ كَانُوا
مُجْرِمِينَ ۚ وَمَا خَلَقْنَا السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لَاعِبِينَ ۚ مَا
خَلَقْنَاهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ۚ

“A janë këta më të mirë se populli i Tubbas apo ata para tyre? Ne i shkatërruam ata, sepse ishin vërtet punëmbropshtë.”

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur.”

“Ne i kemi krijuar ato me qëllim të plotë, por shumica e tyre nuk e dinë.”

Komentimi

Populli i Tubbeit

Toka e Jemenit - e cila shtrihet në jug të Gadishullit Arabik - ishte e banuar dhe e pasur. Në të kaluarën, ajo ka qenë djepi i zhvillimit dhe i qytetërimit. Atë e qeverisnin mbretërit që

quheshin “Tubeitë” (shumësi i kësaj fjale është “tebabiatur”). Populli i tyre i ndiqnin dhe ata pasonin njëri-tjetrin në qeverisje.

Populli i Tubbeit kishte formuar një shoqëri të fortë. Ata kishin edhe një qeverisje të fortë.

Këto ajete e vazhdojnë diskutimin rreth idhujtarëve të Mekës, rreth kokëfortësisë së tyre dhe mohimit të Ahiretit prej tyre dhe i kërcënojnë idhujtarët nëpërmjet tregimit të historisë së popullit të Tubbeit. Atyre u tregojnë atë që i pret: jo vetëm dënimi hyjnor në Kiamet, por edhe ndëshkimi në këtë dynja, siç u ndëshkua populli kriminel dhe mohues i Tubbeit. Në ajet thuhet: **“A janë këta më të mirë se populli i Tubbas apo ata para tyre? Ne i shkatërruam ata, sepse ishin vërtet punëmbropshtë.”**

Banorët e Hixhazit që kishin jetuar afër tyre, ishin në dijeni të historisë së popullit të Tubbeit. Ajeti nuk e ka shtjelluar më shumë situatën e tyre, por vetëm është mjaftuar duke u thënë që të kenë kujdes që të mos i kaplojë i njëjti dënim si popujt e tjerë, të cilët patën jetuar afër tyre.

Me fjalinë: **“...ata para tyre...”** nënkuptohen shembujt e popullit të Nuhut, të Adit dhe të Themudit.

Më poshtë do të tregojmë për popullin e Tubbeit.

Ajeti që pason, i kthehet edhe një herë tjetër çështjes së Ahiretit dhe e paraqet vërtetësinë e saj me një argumentim të mrekullueshëm: **“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midistyre, për t’u zbavitur.”**

Po, s’ka dyshim se për këtë krijim madhështor ka një qëllim, sepse nëse vdekja, sipas pohimit tuaj, do të ishte

përfundimi i ditëve të të ushqyerit, të pirjes, të fjetjes dhe kryerjes së kënaqësive kafshërore, e pas kësaj çdo gjë përfundon, atëherë ky krijim do të ishte lojë dhe argëtim dhe nuk do të kishte asnjë dobi dhe qëllim.

Nuk mund të besohet se All'llahu, i Afti për çdo gjë, i Mençuri, e ka krijuar këtë sistem dhe krijim madhështor, i cili pas disa ditëve të përfundimit të shpejtë, të mos ketë asnjë qëllim më pas. A mund të përfundojë çdo gjë me përfundimin e jetës tokësore? Kjo çështje nuk harmonizohet në mënyrë absolute me mençurinë e All'llahut.

Mbështetur në këtë kontekst, panorama e situatës së kësaj bote dhe sistemimi i saj, na detyron të besojmë se ajo është porta dhe korridori drejt një bote të përhershme madhështore. Atëherë, përse nuk meditonim për këtë?

Kur'an i ka përmendur këtë të vërtetë shpesh në sure të ndryshme. Në ajetin 16 të sures "Enbija" thuhet: **"Ne nuk e kemi krijuar qiellin dhe Tokën e ç'gjendet në mes tyre, për të luajtur (pa qëllim)."**

Në ajetin 62 të sures "El Uakia" thuhet: **"Sigurisht, ju e dini krijimin e parë (prej një pike fare), atëherë përse nuk mendoni?!"**

Sido që të jetë, s'ka dyshim se ka një qëllim pas krijimit të kësaj bote dhe se ka një botë tjetër që e ndjek atë. Mendimi ateist e mohon Ahiretin. Ateistët mendojnë se ky krijim është bërë kot dhe se nuk ka asnjë dobi dhe asnjë qëllim pas tij.

Më pas, për të përforcuar më tej këtë mendim, shtohet: **"Ne i kemi krijuar ato me qëllim të plotë..."**

Krijimi duhet të ketë domosdoshmërisht një qëllim të arsyeshëm dhe ky qëllim vërtetohet me ekzistencën e Botës Tjetër. Bota Tjetër është një e vërtetë tjetër, në të cilën njerëzit vepërmirë dhe vepërkëqinj nuk janë të barabartë. Ajo është prova ku njerëzit shpërblehen ose dënohen sipas veprave që kanë kryer.

Si përfundim, mund të themi se ky ajet tregon qëllimin e krijimit dhe të sprovimit të njerëzve, shpalos zbatimin e bazave të drejtësisë: **“...por shumica e tyre nuk e dinë.”**, sepse ata nuk e kanë idenë si të mbërrijnë tek e vërteta, edhe pse argumentet e fillimit të krijimit dhe të Ringjalljes janë të qarta e të sqaruara.

Hulumtim

Kush është populli i Tubbeit?

Fjala *“tubbean”* është përmendur në Kur’an vetëm dy herë: një herë në ajetet që po komentojmë, dhe herën tjetër në ajetin 14 të sures *“Kaf”*, ku thuhet: **“Edhe banorët e Ejkes, edhe populli i Tubbas; të gjithë ata i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit, prandaj kundër tyre u përmbush dënimi Im.”**

Ashtu siç e kemi thënë më parë, *“tubbean”* ishte një pseudonim i përgjithshëm i mbretërve të Jemenit, ashtu siç ishin Darët për mbretërinë e Iranit, perandorët në mbretërinë e turqve, faraonët në mbretërinë e Egjiptit dhe Cezarët në mbretërinë e romakëve.

Kurse fjala “*tubbeun*” përdorej për mbretërit e Jemenit, të cilët nga njëra anë i ftonin njerëzit që t’i ndiqnin ata dhe nga ana tjetër pasonin njëri-tjetrin në qeverisje.

Por duket se Kur’ani flet në veçanti për një nga mbretërit e Jemenit, për As’ad Eba Kerb, i cili ishte Faraoni bashkëkohës i Musait (*Paqja qoftë mbi të!*).

Disa komentues besojnë se ai ishte njeri besimtar (mbreti i Tubbeit). Shprehjen “**popullin e Tubbeit**” që përmendet në dy ajete të Kur’anit, e kanë konsideruar si një argument për këtë. Në këto dy ajete, ai nuk ndëshkohet; përkundrazi, populli i tij u ndëshkua. Në një transmetim nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Mos e mallkoni Tubbein, sepse pa dyshim se ai ka qenë i dorëzuar (mysliman).”¹

Në një hadith nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Me të vërtetë që Tubbei i ka thënë fisit Euvs dhe Khazrexh: Qëndroni këtu der sa të shfaqet ky Profet, sepse nëse do ta mbërrija atë nëse jam gjallë, do t’i shërbeja atij dhe do dilja bashkë me të.”²

Në një transmetim tjetër thuhet: “Kur Tubbei, në një nga udhëtimet e tij arriti në Medine dhe zbriti në sheshin e saj, ai kërkoi rabinët çifutë, të cilët banonin aty dhe u tha: ‘S’ka dyshim se unë do ta shkatërroj këtë vend, që të mos ngrihet në të jehudizmi dhe çështja të kthehet në fenë e arabëve.’”.

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 66., fundi i ajetit në fjalë. I njëjti kuptim përmendet në tefsirin “Ed Durrul Menthur” dhe në tefsirin “Ruhul Meanij”, vëll. 25, f. 116.

²Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, fundi i ajetit në fjalë.

Çifuti Shamul, më i dituri i tyre në atë kohë, i tha atij: “O mbret, nuk ka dyshim se ky është vendi ku do të vijë emigrues një Profet nga Beni Ismailët. Vendlindja e tij do jetë Meka dhe ai do ta ketë emrin Ahmed.”. Më pas, ata i përshkruan atij disa karakteristika të Profetit të Islamit. Kur Tubbei i dëgjoi ato karakteristika tha: *“Më duket se ai kishte njohuri për çështjen. Nuk ka rrugë tjetër për këtë vend, nuk paska qenë e shkruar që shkatërrimi i tij të bëhet nga dora ime.”*¹

Në një transmetim në fund të këtij tregimi, thuhet se ai u tha atyre që ishin me të prej fiseve Euvs dhe Khazrexh: “Qëndroni në këtë vend. Nëse shfaqet Profeti i premtuar, atëherë mbështeteni dhe ndihmoheni atë dhe këshillojini fëmijët tuaj për këtë.”. Ai u shkroi një letër që ua la atyre amanet. Në letër ka përmendur se ai besonte në të Dërguarin më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).²

Autori i librit “A’lamul Kur’an” transmeton se Tubbei ishte një nga mbretërit e Jemenit, të cilët kanë çliruar botën. Ai pati shkuar me ushtrinë e tij në Indi dhe i pati pushtuar vendet e asaj zone. Gjithashtu, ai pati drejtuar një ushtri drejt Mekës dhe donte të shkatërronte Qabenë, por atë e goditi një sëmundje kronike dhe mjekët qenë të pafuqishëm për kurimin e saj.

Mes shërbëtorëve të tij ishin një grup dijetarësh. I pari i tyre quhej Shamul. Ai ishte i mençur dhe një ditë i tha Tubbeit: “Sëmundja jote ka ardhur për shkak të nijetit tënd të keq ndaj Qabesë. Ti do të shërohesh nëse do ta largosh mendjen nga kjo ide dhe do të kërkossh falje.”. Tubbei u tërhoq nga ajo që dëshironte

¹Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëll. 25, f. 118.

²Po aty.

dhe vendosi që ta respektonte Qabenë. Sapo u përmirësua gjendja e tij, Qabenë e mbuloi një i ftohtë Jemeni.

Mbulimi i Qabesë nga i ftohti është përmendur edhe në histori të tjera. Edhe sot gjendet në Mekë një vend që quhet "Shtëpia e Tubbeinëve".¹

Si do që të jetë, pjesa më e madhe e historisë së mbretërve të Jemenit është e mbushur me paqartësi dhe nuk kemi shumë njohuri për numrin e tyre apo për kohëgjatësinë e mbretërisë së tyre. Ka transmetime kundërshtuese rreth kësaj teme. Ajo që përmendet më shumë në literaturat islame, apo në librat e komentimit të Kur'anit, apo të hadithit dhe të historisë, ka lidhje me këtë mbret që përmend Kur'ani në dy vende.

¹"A'lamul Kur'an", f. 257-259 (i përmbledhur).

Ajetet 40-42

إِنَّ يَوْمَ الْفُصْلِ مِيقَاتُهُمْ أَجْمَعِينَ، يَوْمَ لَا يُغْنِي مَوْلَى عَنْ مَوْلَى شَيْئًا وَلَا هُمْ يُنصَرُونَ، إِلَّا مَنْ رَحِمَ اللَّهُ إِنَّهُ هُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ؛

“Me të vërtetë, Dita e Gjykimit, është e caktuar për të gjithë ata.”

“Atë Ditë, i afërmi nuk mund ta ndihmojë aspak të afërmin e as ata vetë nuk do t’i ndihmojë kush.”

“Me përjashtim të atyre që i ka mëshiruar All’l-lahu. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe Mëshirëplotë.”

Komentimi

Dita e ndarjes

Këto ajete përforcojnë ajetet e kaluara, të cilat trajtuan çështjen e Ahiretit. Ato argumentojnë rrugën e mençur të krijimit të kësaj bote, të Ringjalljes dhe të Botës Tjetër.

Ajeti i parë sjell këtë argumentim: “Me të vërtetë, Dita e Gjykimit, është e caktuar për të gjithë ata.”.

Është ajo Ditë në të cilën ndahet e vërteta nga e kota dhe veçohen punëmirët nga punëkëqinjtë. Atë Ditë njeriu ndahet më vete, largohet nga shokët më të mirë dhe nga miqtë më të afërt. Po, s'ka dyshim, se Ajo është Ditë e caktuar për të gjithë kriminelët.¹¹

Ajeti që pason, përmend një shpjegim të përmbledhur për këtë Ditë të Ndarjes dhe thotë: **“Atë Ditë, i afërmi nuk mund ta ndihmojë aspak të afërmin e as ata vetë nuk do t'i ndihmojë kush.”**.

Vërtet, ajo është Dita e ndarjes dhe e veçimit, është Dita kur njeriu ndan çdo gjë, përveç punëve të tij. Atë Ditë nuk ka asnjë mik, në çfarëdo kuptimi qoftë, asnjë shok, asnjë mbrojtës. Askush nuk mund ta ndihmojë atë.

Fjala *“el meula”* tregon lidhjen ndërmjet dy gjërave, aq sa nuk ka asnjë pengesë ndërmjet tyre.²

Atë Ditë nuk i përgjigjet shoku-shokut dhe as të afërmit nuk i zgjidhin problem njëri-tjetrit. Atë Ditë prishen të gjitha planet dhe ndërpriten të gjitha lidhjet e dynjasë. Këtë e lexojmë në

¹Komentuesit kanë dhënë mendime të shumta rreth përemrit *“hum”* që ndodhet në frazën *“mikatuhum”* – *“caktimi”*. Disa ia kanë referuar atë të gjithë njerëzimit, kurse komentues të tjerë mendojnë se ky përemër u referohet *“popujve të veçuar”*, për të cilët është treguar në ajetet e kaluara, domethënë populli i Tubbeit dhe kundërshtuesit që ishin para tyre. Kuptimi i parë është më afër të vërtetës.

²Për fjalën *“meula”* janë përmendur shumë kuptime në gjuhë. Disa thonë se ka njëzet e shtatë kuptime: 1- i zoti, 2- xhaxha, 3- djali i xhaxhait, 4- i biri, 5- djali i motrës, 6- i çliruar, 7- çlirues, 8- rob, 9- zotërues, 10- ndjekës, 11- i mirësuar, 12- ortak, 13- aleat, 14- shok, 15- fqinj, 16- mik, 17- dhëndër, 18- i afërm, 19- dhënës, 20- i humbur, i vdekur, 21- mbrojtës, kujdestar, 22- më meritues për diçka, 23- zotëri, jo si zotëruesi dhe çliruesi i skllavit, 24- i dashur, 25- ndihmës, 26- sundimtar në çështje, 27- kujdestar në çështje. (El Gadijru, vëll. 1, f. 362).

ajetin 46 të sures “Tur”: **“Ditën kur dredhia e tyre nuk do t’u bëjë dobi asgjë dhe as që do të ndihmohen.”**.

A ka dallim mes fjalisë **“...nuk do t’u bëjë dobi asgjë...”** dhe fjalisë **“...dhe as që do të ndihmohen”**? E para tregon se atë Ditë, asnjë njeri nuk ka fuqi të zgjidhë problemin e një njeriu tjetër në mënyrë të pavarur, kurse e dyta tregon se ata janë të pafuqishëm për zgjidhjen e problemeve, edhe sikur të bashkëpunojnë mes tyre.

Atje ka vetëm një grup njerëzish që janë të përjashtuar nga kjo situatë. Për atë grup, ajeti pasues thotë: **“Me përjashtim të atyre që i ka mëshiruar All’l-lahu. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe Mëshirëplotë.”**.

Kjo mëshirë e All’l-lahut nuk jepet kot; përkundrazi, ajo përfshin vetëm ata që besuan dhe bënë vepra të mira. Në qoftë se papritur bëjnë ndonjë mëkat, ata e kuptojnë menjëherë dhe nuk i lënë gabimet e vogla që të zmadhohen e të kalojnë masën, sa të ndërpresin lidhjet e tyre me All’l-lahun e Madhëruar. Njerëzit e këtij grupi ngrenë duart e tyre nga All’l-lahu dhe kërkojnë mëshirën e Tij, gjejnë kënaqësinë me të, shuajnë etjen me të dhe kënaqen me ndërmjetësimin e miqve të Tij.

Nga kjo bëhet e qartë se moslejimi i shokëve dhe mbrojtësve për të dhënë ndihmë atë Ditë, nuk e pengon çështjen e ndërmjetësimit, sepse ky i fundit nuk bëhet nga kush të mundet, por vetëm me lejen e All’l-lahut të Madhëruar.

E veçanta këtu është se ajeti ka krahasuar përshkrimin e të Madhërueshmit, me të qenit e Tij Ngadhënjyesi dhe i Mëshirshmi. E para tregon fuqinë e Tij të pafundme, që nuk e njeh mposhtjen

dhe dobësinë, kurse e dyta tregon mëshirën e Tij, e cila nuk ka kufij. Krahاسimi tregon se mëshira e Tij është syri i fuqisë së Tij.

Në disa transmetime të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) përmendet se ajo që nënkuptohet nga fjalia: **“Me përjashtim të atyre që i ka mëshiruar All’l-lahu...”** është për Prijësin e besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ndjekësve të tij.¹

¹Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 629.

Ajetet 43-50

إِنَّ شَجَرَتَ الزَّقُّومِ^٣، طَعَامُ الْأَثِيمِ^٤، كَالْمُهْلِ يَغْلِي فِي الْبُطُونِ^٥، كَغَلِي
الْحَمِيمِ^٦، خُذُوهُ فَاعْتِلُوهُ إِلَى سَوَاءِ الْجَحِيمِ^٧، ثُمَّ صُبُّوا فَوْقَ رَأْسِهِ مِنْ
عَذَابِ الْحَمِيمِ^٨، ذُقْ إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْكَرِيمُ^٩، إِنَّ هَذَا مَا كُنْتُمْ بِهِ
تَمْتَرُونَ^{١٠}.

"Pema e Zekkumit."

"Do të jetë ushqim i gjynahqarit."

"Si tunxh i shkrirë ajo do të vlojë në barkun e tij."

"Ashtu si vlon uji i nxehtë."

"(Engjëjve do t'u thuhet): 'Rrëmbejeni atë dhe çojeni në mestë zjarrit flakërues!'"

"Pastaj, për dënim, hidhni mbi kokën e tij ujë të valuar (duke i thënë):"

"Shijoje këtë, o njeri 'i fuqishëm' dhe 'fisnik'!"

"Ja, ky është dënimin për të cilin ju dyshoni!"

Komentimi

Pema e Zekumit

Në këto ajete përshkruhen llojet e dënimit të Xhehennemit. Ata paraqiten të frikshëm, që trondisin zemrat. Ajetet në fjalë plotësojnë komentimin që u bë në ajetet e kaluara rreth Ditës së Ndarjes, Ditës së Kiametit, dhe thonë: **“Do të jetë ushqim i gjynahqarit.”** Këta kriminelë do të hanë këtë bimë të hidhur e vrasëse dhe ushqimin e pistë që qelbet erë.

Fjala “ez zekum”, siç e kemi përmendur në komentimin e ajetit 62 të sures “Saffat”, sipas fjalës së komentuesve dhe specialistëve të gjuhës, është emri i një peme që ka gjethe të vogla dhe fruta të hidhura. Ajo është e ashpër në prekje, me erë të qelbur, të prishur, që rritet në tokën e Tehamës në Gadishullin Arabik. Idhujtarët e njihnin atë. Ajo është një pemë që e ka lëngun të hidhur dhe, nëse goditet trupi i saj, ajo bymehet, fryhet.¹

Disa komentues mendojnë se Zekumi (në rrënjë) tregon gëlltitjen.² Disa komentues të tjerë thonë se bëhet fjalë për çdo ushqim të pistë në Zjarr (Xhehennem).³

Në një hadith thuhet se sapo fjala zbriti në Kur'an, mohuesit kurejshitë thanë: *“Nuk e njohim këtë pemë, por cili prej jush e di kuptimin e Zekumit?”*.

¹Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, tefsiri “Ruhul Bejan” dhe tefsiri “Ruhul Meanij”

²“Lisanul Arab”, lënda “zekum”.

³“Mufredatu Ragib”, lënda “zekkum”.

Aty ndodhej një njeri nga Afrika, i cili tha: “Tek ne, ajo është hurma dhe gjalpi.” Ai mbase e ka thënë atë me ironi, për t’u tallur, sepse Ebu Xhehli sapo e dëgjoi këtë që tallej, i tha sklaves: Na sill nga ky zekkumi (afrikan). Ajo i solli hurmë dhe gjalpë dhe ai u tha shokëve të tij: “Hani nga kjo me të cilën ju frikëson Muhammedi.”.¹

Fjala “*zekkum*” në gjuhën arabe dhe në përdorime kur’anore, përdoret herë me kuptimin e pemës, e herë me kuptimin e bimës.

Fjala “*ethijm*” tregon atë njeri që qëndron në mëkat. Këtu përdoret për të treguar jobesimtarët dhe kokëfortët zullumqarë, ata që nuk heqin dorë nga mëkati dhe kundërshtimet dhe që i shtojnë ato vazhdimisht.

Më pas, ajeti shton: “**Si tunxh i shkrirë ajo do të vlojë në barkun e tij. Ashtu si vlon uji i nxehtë.**”.

Fjala “*el muhlu*”, sipas shumë komentuesve dhe profesorëve të gjuhës, tregon *metalin e shkrirë*. Sipas disa komentuesve të tjerë dhe fjalorit, kjo fjalë i referohet *llumit të vajit që bie në fund të enës*. Me sa duket, kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Fjala “*uel hamijm*” tregon *ujin e nxehtë që vlon*. Ndonjëherë, kjo fjalë përdoret për shokun e ngushtë dhe besnik. Por kuptimi i parë është më i pranueshëm.

Sido që të jetë, kur hyn *zekumi* në barqet e këtyre, ai shkakton një nxehtësi të lartë, të pallogaritshme dhe vlon njësoj

¹Tefsiri i “Kurtubijut”, vëll. 8, f. 5529. Fundi i ajetit 62, sure “Saffat”.

siç vlon uji. Ky ushqim, në vend që t'u japë atyre fuqi, u shkakton vështirësi, dënim, dhimbje e ndëshkim.

Më pas, All'Ilahu i Madhëruar u flet rojeve të zjarrit dhe u thotë: **“Rrëmbejeni atë dhe çojeni në mes të zjarrit flakërues.”**.

Fjala *“fa'tiluhu”* tregon marrjen, tërheqjen dhe hedhjen brenda, ashtu siç bëjnë ruajtësit e ligjit dhe policët me kriminelët rebelë, kur nuk i dorëzohen asnjë ligji dhe kur nuk e zbatojnë atë.

Fjala *“seuaun”* përdoret për të treguar se largësia në të gjitha skajet është e barabartë, prandaj kudo që të ndodhen mëkatarët, ata do të hidhen në mes të Xhehennemit, ku konsiderohet se nxehtësia është më e madhe, kurse zjarri i rrethon ata nga të gjitha anët.

Ajeti që pason, na tregon një lloj tjetër të ndëshkimit të rëndë e të dhimbshëm që do të marrin ata: **“Pastaj, për dënim, hidhni mbi kokën e tij ujë të vluar.”**. Në këtë mënyrë, ata digjen nga brenda dhe nga jashtë. Përveç kësaj, mbi kokat e tyre derdhet uji i vluar në mes të Xhehennemit.

I njëjti kuptim përmendet në ajetin 19 të sures “Haxh”, ku thuhet: **“...e u hidhet ujë i valë mbi kokat e tyre.”**.

Pas gjithë këtyre llojeve të dënimit trupor fillojnë dënimet shpirtërore. Kriminelit rebel, kundërshtues dhe jobesimtar i thuhet: **“Shijoje këtë, o njeri ‘i fuqishëm’ dhe ‘fisnik’**”, sepse ti je ai që i ke lidhur të vobektit, të dobëtit që ishin në dorën tënde, sepse i ke shtypur siç dëshiroje ti, i ndëshkoje ata si doje dhe mendoje se ishe i fortë, i pamposhtur, i fuqishëm dhe se të gjithë duhej të të respektonin dhe të të vlerësonin.

Po, ti je ai që të ka hipur mendjemadhësia dhe nuk ke lënë mëkat pa bërë. Shijoje pra, rezultatit e veprave të tua! Ashtu siç i ke djegur trupat e njerëzve dhe u ke shkaktuar dhimbje shpirttrave të tyre, le të digjesh tani së brendshmi dhe së jashtmi me zjarrin e zemërimit të All'llahut dhe ujin e vluar, i cili shkrin çfarë ka në barqe dhe lëkurë.

Në një hadith thuhet se Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), një ditë e mori për dore Ebu Xhehlin dhe i tha: “*I mjeri ti, i mjeri!*” Ebu Xhehli u inatos, e tërhoqi dorën e tij dhe tha: “Me çfarë po më kërcënon? Nuk mundesh as ti dhe as shoku yt të më bëni gjë mua, sepse unë jam më i forti dhe më i respektuari i kësaj lugine.”.

Për këtë, ajeti thotë: “Kur e hedhin atë në Xhehennem, ata i thonë atij: “Shijoje tani ti, o i forti dhe i respektuari i Mekës!”¹

Kur’ani i Shenjtë shton në fundin e ajetit, duke thënë: “**Ja, ky është dënimin për të cilin ju dyshonit!**”. Sa shumë që ju kemi treguar për vërtetësinë e kësaj Dite në ajete të ndryshme të Kur’anit dhe me argumente të ndryshme!

A nuk ju kemi thënë: “**E kështu do të jetë edhe Ringjallja!**”?²

A nuk ju kemi thënë: “**Ja, kështu është Ringjallja!**”?³

A nuk kemi thënë: “**...e ajo për All’llahun është e lehtë.**”?⁴

¹ Tefsiri “El Muragij”, vëll. 25, f. 135. Ajetet e fundit janë burimi i komentimit; Tefsiri “Ruhul Meanij” dhe Tefsiri “El Kebijr”.

² Sure “Kaf”, ajeti 11.

³ Sure “Fatir”, ajeti 9.

⁴ Sure “Et Tegabun”, ajeti 7.

A nuk kemi thënë: **“A mos u lodhëm Ne me krijimin e parë?”**¹

Ne pra, ju kemi thënë të vërtetën dhe e kemi bërë të qartë atë në rrugë të ndryshme, mirëpo ju nuk kishit veshë që ta dëgjoni.

Hulumtim

Ndëshkimet trupore dhe shpirtërore

Sipas sqarimeve të Kur'anit, ne e dimë se ka një konceptim trupor, fizik edhe në Ahiret. Bazuar mbi këtë, është normale që të ketë ndëshkime dhe shpërblime konkrete dhe materiale. Prandaj, duke qenë se njeriu tregon kujdes ndaj çështjeve trupore, në ajetet kur'anore dhe në transmetimet islame janë shpjeguar problemet, duke i orientuar më shumë nga çështjet trupore. Vihet re se shpjegimi më i hollësishëm bëhet duke i ilustruar shembujt e dënimeve me ndëshkime dhe shpërblime materiale. Por kjo nuk do të thotë se për shpërblimet dhe ndëshkimet shpirtërore të tregohet më pak.

Në ajetet e mësipërme kemi parë një model të kësaj çështjeje. Bashkë me tregimet për disa dënime trupore të dhimbshme, ka edhe tregime të shkurtra, por me përmbajtje të thellë, për shpërblimet shpirtërore, me të cilat do të dënohen mendjemëdhenjtë.

¹ Sure “Kaf”, ajeti 15.

Në ajete të tjera të Kur'anit shohim një të dhënë të shpërblimeve shpirtërore. All'Ilahu i Madhërishëm thotë në një nga ajetet: **"...edhe një disponim nga All'Ilahu, që është mbi të gjitha..."**¹

Në një ajet tjetër thuhet: **"Kanë 'selam', thënie e Zotit mëshirues!"**²

Së fundi, në një ajet të tretë thuhet: **"Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtje, e ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit, duke qenë të vëllazëruar..."**³

Është i pamundur përshkrimi i kënaqësive të shumta shpirtërore në shumicën e rasteve, e sidomos në atë Botë të gjerë të së Përtejmes. Për këtë, zakonisht është folur në Kur'an. Po ashtu, në Kur'an flitet për dënimet shpirtërore të cilët i përshkruan të shoqëruara me përbuzje dhe përçmim, me qortim të ashpër dhe vërejtje të rëndë, me keqardhje, mërzitje dhe dëshpërim.

¹ Sure "Et Teube", ajeti 72.

² Sure "Jasin", ajeti 58.

³ Sure "El Hixhr", ajeti 47.

Ajetet 51- 57

إِنَّ الْمُتَّقِينَ فِي مَقَامٍ أَمِينٍ ۝ فِي جَنَّاتٍ وَعُيُونٍ ۝ يَلْبَسُونَ مِنْ سُندُسٍ
وَإِسْتَبْرَقٍ مُتَقَابِلِينَ ۝ كَذَلِكَ وَزَوَّجْنَاهُمْ بِحُورٍ عِينٍ ۝ يَدْعُونَ فِيهَا
بِكُلِّ فَاكِهَةٍ آمِنِينَ ۝ لَا يَذُقُونَ فِيهَا الْمَوْتَ إِلَّا الْمَوْتَةَ الْأُولَى
وَوَقَاهُمْ عَذَابَ الْجَحِيمِ ۝ فَضْلًا مِنْ رَبِّكَ ذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ۝

“Të devotshmit, me të vërtetë, do të jenë në vend të sigurt.”

“Midis kopshteve dhe burimeve.”

“Të veshur në petka mëndafshi të hollë dhe armaç, të ulur përballë njëri-tjetrit.”

“Po, kështu do të jetë, dhe Ne do t’i martojmë ata me hyri sybukura.”

“Aty do të kërkojnë çfarëdo frutash që të dëshirojnë e do të jenë të sigurt.”

“Atje nuk do ta provojnë më vdekjen, përveç vdekjes së parë dhe Ai do t’i shpëtojë prej dënimit të zjarrit flakërues.”

“Kjo do të jetë mirësi prej Zotit tënd. Kjo është fitorja madhështore!”

Komentimi

Të devotshmit dhe mirësitë e ndryshme të Xhennetit

Në ajetet e kaluara u diskutua për banorët e zjarrit dhe për ndëshkimet që ata marrin. Ajetet në diskutim tregojnë për dhuratat dhe mirësitë e shumta që marrin banorët e Xhennetit. Ne do t'i krahasojmë dënimet dhe mirësitë për të sqaruar rëndësinë e secilës prej atyre të dyjave. Këto mirësi janë ndarë në shtatë pjesë:

Mirësia e parë: “Të devotshmit, me të vërtetë, do të jenë në vend të sigurt.”¹ Ata nuk i godet asnjë shqetësim apo frikë, por janë në një siguri të plotë përballë problemeve, fatkeqësive, shqetësimeve, dëshpërimeve dhe prej shejtanëve e mizorëve.

Më pas, ajetet vijojnë me **mirësinë e dytë: “Midis kopshteve dhe burimeve.”**

Mënyra e të shprehurit me fjalën “*Xhennat*”, ka mundësi të jetë një tregues i numrit të madh të kopshteve, me të cilët kënaqet çdonjëri prej banorëve të Xhennetit. Kjo fjalë mund të jetë tregues edhe i pozitave dhe gradave të ndryshme të tyre, sepse kopshtet e Xhennetit dhe parqet e tij nuk janë të barabartë; përkundrazi, ata ndryshojnë sipas gradave të ndryshme të banorëve të Xhennetit.

¹ Duhet parë më kujdes se fjala “*emijn*” është përmendur si përshkrim i vendit. Nga kjo nënkuptohet se vendi i banorëve të Xhennetit është i sigurt. Shembuj të tillë përdoren zakonisht për përforsim dhe metaforë.

Mirësia e tretë na tregon për veshjet e bukura të tyre: **“Të veshur në petka mëndafshi të hollë dhe armaç, të ulur përballë njëri-tjetrit.”**.

Fjala *“es sundusu”* tregon këmishat e mëndafsha, të buta e të holla. Disa komentues kanë shtuar se ato petka janë edhe prej floriri.

Kurse fjala *“el istebraku”* tregon këmishat e mëndafsha të trasha. Komentues të tjerë mendojnë se kjo fjalë rrjedh nga fjala perse *“estebere”*, apo *“setbere”*, që do të thotë *“i trashë”*. Ka mundësi edhe që origjina e saj të jetë arabe, e marrë nga *vetëtima*, domethënë *vezullimi*, pasi këto këmisha kanë një vezullim të veçantë.

Sigurisht që në Xhennet nuk është as vapë e nxehtë, as i ftohtë i acartë, që banorët e Xhennetit të veshin këto rroba, por kjo panoramë e përshkruar tregon larminë e rrobave të larmishme, të përgatitura për ta.

Ashtu siç thamë më lart, fjalët me të cilat realizojmë komunikimin e përditshëm, nuk arrijnë që t'i përshkruajnë çështjet e asaj bote madhështore me detaje të plota. Ato munden vetëm të na tregojnë disi për të.

Disa komentues të tjerë mendojnë se veshjet e ndryshme janë shenjë e ndryshimit të pozitave të afërsisë mes banorëve të mirësisë.

Qëndrimi i banorëve të Xhennetit të ulur përballë njëri-tjetrit, pa dallime mes tyre, pa shenja mendjemadhësie ndaj njëri-tjetrit, është një tregues i shpirtit të shoqërimit dhe vëllazërimit që

përhapet në kuvendet e tyre, ku mbizotëron vetëm pastërtia dhe respekti, dashuria dhe toleranca e shpirtit.

Mirësia e katërt është martesë e tyre: **“Po, kështu do të jetë, dhe Ne do t’i martojmë ata me hyri sybukura.”**.

Fjala *“el huuru”* tregon atë njeri që i zgjerohet shumë irisi i syrit dhe i theksohet bardhësia e tij.

Kurse fjala *“el ijnu”* tregon njeriun me sy të mëdhenj. Përderisa bukuria e njeriut është tek syri i tij, atëherë edhe ajeti i përshkruan sytë e bardhosheve *“symëdha”*, *“magjepsëse”* dhe ka përmendur edhe përparësi të tjera të tyre me një mënyrë të mrekullueshme, në disa ajete të Kur’anit.

Mirësia e pestë për banorët e Xhennetit tregohet në këtë ajet: **“Aty do të kërkojnë çfarëdo frutash që të dëshirojnë e do të jenë të sigurt.”**, sepse në Xhennet nuk ka nga ato probleme dhe vështirësi që hasnin në botën e dynjasë për të patur dhe konsumuar fruta; aty, ata janë afër tyre dhe nuk u duhet përpjekje e madhe për t’i kapur në pemët e larta: **“Frutat e të cilit do t’i kapë lehtë.”**¹

Atyre u mjafton vetëm të thonë se cilin frut duan: **“E me fruta të cilat do t’i zgjedhin vetë.”**²

Në Xhennet nuk ka sëmundje dhe shqetësime, që mund të ndodhin në dynja për shkak të konsumit të frutave. Aty nuk ka frikë nga prishja dhe pakësimi i tyre. Banorët e tij janë në rehati, siguri dhe qetësi nga të gjitha anët.

¹ Sure “El Hakk”, ajeti 23.

² Sure “El Uakia”, ajeti 20.

Sido që të jetë, është e sigurt se *zekkumi* është ushqimi i banorëve të Zjarrit. Ai vlon në barqet e tyre si vlimi i zjarrit të Xhehennemit, kurse për banorët e Xhenetit, ushqim janë pemët e shijshme e të pastra, të cilat nuk sjellin asnjë lloj dëmi dhe shqetësimi.

Mirësia e gjashtë prej mirësive të All'llahut të Madhëruar, është përjetësia e Xhenetit për të përkushtuarit. Për këtë, ajeti thotë: **“Atje nuk do ta provojnë më vdekjen, përveç vdekjes së parë...”**.

E veçanta është se Kur'ani Kerim i ka qartësuar mirësitë e përhershme të Xhenetit në mënyra të ndryshme. Një herë thotë: **“Janë të përhershëm në të”**¹ dhe herë tjetër thotë: **“...shpërblim të pakëputur...”**.²

Arsyeja e përdorimit të shprehjes **“vdekjes së parë”** do të sqarohet hollësisht në vijim, në dashtë All'llahu i Madhëruar.

Dhe së fundi, Kur'ani sqaron edhe **mirësinë e shtatë** e të fundit dhe thotë: **“...dhe Ai do t'i shpëtojë prej dënimit të zjarrit flakërues.”**.

Përsosja e këtyre mirësive do të jetë e plotë kur banorët e Xhenetit do të sigurohen se nuk do të dënohen. Në qoftë se ata frikësohen, mund t'u turbullohet pastërtia e besimit dhe, në atë rast, nuk do t'u plotësohen ato mirësi.

¹Kjo shprehje është përmendur në shumë ajete kur'anore, si p.sh. në suret: “Ali Imran”, ajetet 15, 136; “En Nisa”, ajetet 13 dhe 122; “El Maide”, ajeti 85 e të tjera.

² Sure “Hud”, ajeti 108.

Kjo shprehje na tregon se ata që kanë frikë All'Ilahun, edhe nëse gabojnë nga frika, All'Ilahu i Madhëruar do t'ua falë gabimet me mirësinë dhe bujarinë e Tij dhe do t'i qetësojë ata, duke i sqaruar se nuk ka arsye për t'u frikësuar. Thënë ndryshe, mëkatuesit do të bëjnë gabime e do të bien në shkarje, duan apo nuk duan. Ata janë të përfshirë nga frika dhe tmërri prej mëkateve dhe janë të pasigurt nëse do t'i përfshijë falja e All'Ilahut. Ky ajet u jep atyre qetësinë, rehatinë dhe garancinë në këtë drejtim.

Këtu lind pyetja: A i përfshin ky ajet, besimtarët që kalojnë njëfarë kohe në Xhehennem, për shkak të mëkateve që kanë kryer, e më pas futen në Xhennet?

Përgjigje: Mund të themi se ajeti flet për besimtarët e përkushtuar dhe me grada të larta, të cilët e fitojnë Xhennetin që herën e parë, kurse për grupin e dytë, ky ajet nuk funksionon.

Mendohet gjithashtu, se kur këta të futen në Xhennet, nuk do të kenë më frikë se mund të kthehen përsëri në Xhehennem; përkundrazi, ata do të jenë krejt të sigurt për këtë. Kjo do të thotë se ajeti i mësipërm përshkruan situatën e tyre pas hyrjes në Xhennet.

Ajeti i fundit na tregon të shtatë mirësitë dhe thotë: **“Kjo do të jetë mirësi prej Zotit tënd. Kjo është fitorja madhështore!”**.

Të devotshmit kanë bërë shumë vepra të mira, por është i pakundërshtueshëm fakti se të gjitha ato vepra të marra së bashku, nuk i meritojnë të gjitha këto mirësi të përhershme; përkundrazi, ato janë dhuratë nga All'Ilahu i Madhëruar.

Ata nuk i meritojnë të gjitha këto të mira, por është mirësia dhe butësia e All'llahut, e cila bën të mundur që t'i përfshijë begatia e Tij, sepse është Ai që ua ka dhënë atyre logjikën dhe diturinë, është Ai që ka dërguar Profetët dhe Librat qiellorë dhe është Ai që ka derdhur mbi ta suksesin e udhëzimit e të veprës.

Po, pa dyshim se përfitimi i këtyre të mirave të mëdha dhe arritja e të gjitha këtyre dhuratave e shpërblimeve, është plotësuar me mirësinë dhe dhuratën e All'llahut të Madhëruar. Kjo fitore e madhe nuk do të mund të arrihej pa mirësinë dhe bujarinë e Tij.

Hulumtim

Cila është “vdekja e parë”?

Në ajetet e lartpërmendura lexuam se banorët e Xhennetit shijojnë vetëm vdekjen e parë. Në këtë rast shtrohen tri pyetje:

Pyetja e parë: Çfarë nënkuptohet me “vdekje e parë”? Nëse ajo që nënkuptohet është vdekja me të cilën mbaron jeta e dynjasë, atëherë përse ajeti thotë: **“Atje nuk do ta provojnë më vdekjen, përveç vdekjes së parë...”**, megjithëse ata e kanë shijuar atë?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, disa komentues e kanë konsideruar fjalën “*il'la*” në fjalinë “**...përveç vdekjes së parë...**”, se është përdorur me kuptimin “*pas*” dhe se kuptimi i ajetit është

që ata nuk do të shijojnë vdekje tjetër, pas vdekjes së tyre të parë në dynja.

Disa komentues të tjerë kanë thënë: “Përveç vdekjes së parë, që ata e kanë shijuar.”.

Pyetja e dytë: Përse flitet vetëm për vdekjen e parë, kur ne e dimë se njeriu e shijon vdekjen dy herë: një herë kur mbaron jeta e tij, e tjetra është pas jetës së *Berzahut* (Jetës së Ndërmjetme)?

Edhe për këtë pyetje ka disa përgjigje. Nuk janë të gjitha të pranueshme, por e shohim të arsyeshme të mos i përmendim, për shkak të ndjeshmërisë së tyre.

Më e mira është të thuhet se jeta dhe vdekja në Botën e Ndërmjetme nuk i ngjasojnë jetës dhe vdekjes së zakonshme. Jeta e Kiametit i ngjason jetës së dynjasë në shumë aspekte, sidomos në domosdoshmërinë e ringjalljes trupore, por ata, atje janë në një standard shumë më të lartë. Për këtë u thuhet banorëve të Xhenetit: Nuk ka më vdekje pas asaj që ju shijuat. Meqenëse jeta dhe vdekja në Botën e Ndërmjetme (El Barzakh) nuk kanë asnjë ngjashmëri me jetën e dynjasë dhe me vdekjen e saj, për këtë nuk është thënë fjalë rreth atyre të dyjave.¹

Pyetja e tretë: Mungesa e ekzistencës së vdekjes në Kiamet, nuk kufizohet vetëm te banorët e Xhenetit, por nuk vdesin as banorët e Zjarrit. Atëherë, përse është fokusuar ajeti tek banorët e Xhenetit?

¹Jeta dhe vdekja në Botën e Ndërmjetme, fundi i ajetit 11 të sures “El Mu’minun”.

I ndjeri Et Tabrasij ka një përgjigje të shkëlqyer për këtë, ku thotë: "...pa dyshim se ai është një përgëzim për banorët e Xhennetit, se ata do të kenë jetë të përhershme të kënaqshme, kurse për banorët e Xhehennemit, çdo çast prej çasteve të jetës së tyre konsiderohet si vdekje. Duket sikur ata jetojnë dhe vdesin gjithmonë...".

Sido që të jetë, mënyra e të shprehurit me fjalën **"nuk shijojnë"**, tregon se banorët e Xhennetit nuk shohin dhe nuk vuajnë as efektin më të vogël të vdekjes.

Është i bukur një hadith nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili thotë: "All'Ilahu i Lartësuar u thotë një pjese të banorëve të Xhennetit: *'Pasha madhështinë dhe fuqinë Time, pasha lartësinë Time dhe lartësinë e pozitës Sime! Do t'u caktoj atyre sot pesë gjëra: ata do të jenë të rinj dhe nuk do të plaken kurrë. Do të jenë të shëndoshë dhe nuk do të sëmuren kurrë, do të jenë të pasur dhe nuk do të varfërohen kurrë, do të jenë të gëzuar dhe nuk do të dëshpërohen kurrë dhe do të jenë të gjallë përherë e nuk vdesin kurrë!'*". Më pas, Imam Bakiri lexoi këtë ajet: **"Atje nuk do ta provojnë më vdekjen, përveç vdekjes së parë..."**.¹

¹"Usulul Kafij", vëll. 2, f. 598, sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 634.

Ajetet 58-59

فَإِنَّمَا يَسَّرْنَاهُ بِلِسَانِكَ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ۝ فَارْتَقِبْ إِنَّهُمْ مُرْتَقِبُونَ ۝

“Ne e kemi bërë të lehtë atë (Kur’anin) në gjuhën tënde, që ata të mund të marrin këshilla.”

“Prandaj ti prit, se edhe ata vetë po presin!”

Komentimi

Ti prit, se edhe ata janë duke pritur!

Sureja “Dukhan” filloi me qartësimin e madhështisë dhe të thellësisë së Kur’anit dhe përfundon me këto ajete, të cilat sqarojnë efektin e thellë të ajeteve të Kur’anit Kerim, harmonizojnë fillimin dhe fundin e sures si dhe përforcojnë mësimet e Kur’anit dhe të këshillave të tij.

Ajeti i parë thotë: **“Ne e kemi bërë të lehtë atë (Kur’anin) në gjuhën tënde, që ata të mund të marrin këshilla.”**. Edhe pse përmbajtja e Kur’anit është shumë e thellë dhe përmasat janë të shtrira e të gjera, ai është i qartë, i thjeshtë dhe i kuptueshëm nga të gjithë. Ai i ndriçon të gjitha nivelet, sjell shembuj të bukur e të

shkëlqyer. Dyshimet e tij janë aktuale, elokumente. Tregimet e tij janë të vërteta dhe edukative. Argumentet e tij janë të qarta, të sqaruara mirë në të gjithë thellësinë e tij. Është i thjeshtë, i lehtë, me përmbajtje të thellë e të përmbledhur dhe në të njëjtën kohë, ai depërton në thellësitë e zemrave të njerëzve, u tërheq vëmendjen të hutuarve dhe i mëson injorantët që ta përkujtojnë atë që kanë në zemër.

Disa komentues të tjerë kanë përmendur një komentim tjetër për këtë ajet. Sipas tyre, kuptimi i këtij ajeti është: “Edhe nëse je analfabet, ti mundesh t’i lexosh me lehtësinë më të madhe këto ajete të thella, me përmbajtje të pasur, të cilat sqarojnë Shpalljen dhe mrekullinë e All’llahut.”.

Por tefsiri i parë është më i përshtatshëm.

Ky ajet është i ngjashëm me ajetin që është përsëritur disa herë në suren “El Kamer”: **“Ne, Kur’anin e bëmë të lehtë për mësim, por a ka ndokush që merr mësim?!”**¹

Për shkak se ishte një grup që nuk i bindej urdhrit të All’llahut, që nuk dorëzohej e nënshtrohej, pavarësisht përmendjes së gjithë këtyre përshkrimeve, ajeti i fundit i kërcënoi dhe i paralajmëroi ata: **“Prandaj ti prit, se edhe ata vetë po presin!”**. Pra prit, se All’llahu ka premtuar fitore ndaj jobesimtarëve dhe ata le të presin disfatën.

Ti prit zbritjen e një dënimi të ashpër mbi këta kokëfortë zullumqarë dhe lëri ata të presin disfatën e tyre dhe fitoren e besimtarëve, e ta marrin vesh se cila prej pritjeve është e vërtetë.

¹ Sure “El Kamer”, ajetet 17, 22, 32 dhe 40.

Bazuar mbi këtë, nuk duhet të kuptohet nga ajeti, se All'illahu i Madhëruar e urdhëron Pejgamberin e Tij që të ndalojë plotësisht përcjelljen e mesazhit të Tij, të ndalojë veprimtarinë e tij, efektshmërinë e tij, përpjekjen e tij, dhe të mjaftohet me qëndrimin në pritje të rezultatit. Ai është një lloj kërcënimi për ata kokëfortë, të cilët mbase zgjohen nga turpi i tyre dhe vihen në udhë të mbarë.

Hulumtime

1- Fjala “*irtekib*” në origjinalitet vjen nga fjala “*er rekbetu*” – “*qafa*”, sepse kur dikush pret një tjetër, ai zgjat vazhdimisht qafën e tij për të shikuar. Ajo tregon edhe për pritjen e diçkaje dhe mbikqyrjen e saj.

2- Ajeti i mësipërm e sqaron qartë se Kur’ani Kerim nuk ka veçuar ndonjë shtresë të veçantë apo një popull të caktuar, që të ndihmohet pa arsye. Përkundrazi, ajeti u kumton të gjithëve, se ata që ajetet kur’anore i vështirësojnë qëllimisht dhe i bëjnë të pakuptueshme, enigmatike, të mistershme dhe të çuditshme, - që arrin t’i kuptojë disi vetëm një shtresë e veçantë, e cila nuk i koncepton dot përmasat e tij, - janë të pavëmendshëm ndaj shpirtit të Kur’anit.

Kur’ani duhet të jetojë mes njerëzve kudo që të jenë, në qytet dhe në fshat, aty ku ka dhe ku nuk ka njerëz, në rrethet

fillestare dhe universitete, në xhami dhe në fushat e betejës, sepse All'llahu i Madhërueshëm e ka lehtësuar atë që ta kuptojnë të gjithë, që të kapen pas dritave të tij e të ndriçojnë me të jetën e tyre.

Ky ajet synoi prishjen e metodologjisë së këtyre njerëzve, që e kanë mbajtur Kur'anin në kornizën e metodës së leximit të tij sipas rregullave, me texhvid dhe kompleksitetet e tij. Ai sqaron se shqetësimi i tyre i vetëm u bënë shprehjet e tij nga artikulimet, fonetika e tij dhe ruajtja e etikës së pauzave, të thekseve tonikë. Ajeti u thotë atyre se ky nuk është synimi përfundimtar. Synimi përfundimtar është thelbi i mesazhit që përcjell Kur'ani, dhe jo mënyra e ndërtimit të shprehjeve kur'anore.

3- Në një hadith nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: *“Sikur Zoti të mos e kishte lehtësuar atë, askush nga krijesat e Tij nuk do mund ta kuptonte e ta shprehte qoftë edhe një shkronjë nga Kur'ani. Po si mundet të mos kuptohet, kur ai është Fjalë prej Atij që është i Përhershëm, pa fillim dhe pa mbarim?”*.¹

O All'llah, na bëj prej atyre që marrin mësim prej Kur'anit Kerim, që meditojnë e reflektojnë në të, dhe që e jetojnë jetën në të gjitha përmasat e saj, si ndjekës të kuptimeve dhe ligjeve të tij!

O All'llah, na jep neve atë garanci që u ke dhënë të përkushtuarve, që i ke bërë ata të qetë, të bindur para furtunave të ngjarjeve dhe fatkeqësive që do t'i sfidojnë ata!

O Zoti ynë, s'ka dyshim se dhuratat e Tua nuk llogariten dhe mëshira Jote është e pakufishme! Ndëshkimi Yt është i rëndë dhe nuk janë punët

¹Tefsiri “Ruhul Bejan”, vëll. 8, f. 433.

tona që na bëjnë të përfitojmë mëshirën Tënde dhe shpëtimin nga dënimi Yt!

O All'lah, shpërndaje mëshirën Tënde mbi ne dhe na hidh nga mirësitë e Tua, të cilat ua ke premtuar të përkushtuarve prej robëve të Tu, sepse përndryshe, ne nuk kemi mënyrë për të fituar Xhennetin Tënd të përhershëm!

Amin!

Sure “ElXhathije”

Mekase, numri i ajeteve: 37

Përmbajtja e sures

Kjo është surja e gjashtë prej “*havamim-eve*” (suret që fillojnë me gërmat e ndara “*ha mim*”) dhe është sure mekase. Ajo ka zbritur në kohën kur përballja mes myslimanëve dhe idhujtarëve të Mekës u ashpërsua dhe mbizotëroi atmosfera shoqërore në Mekë. Kjo është arsyeja që sureja në fjalë është fokusuar rreth çështjeve të lidhura me Njehsimin, luftimin e idhujtarisë, kërcënimin e idhujtarëve me Gjykatën e Kiametit, me tërheqjen e vëmendjes përmes shkrimit të veprave dhe regjistrimit të hollësishëm të tyre, si dhe me sqarimin e dënimit të popujve të kaluar rebelë.

Përmbajtja e kësaj sureje mund të përmbledhet në shtatë pjesë:

- 1- Madhështia e Kur'anit të Lavdishëm dhe rëndësia e tij.
- 2- Sqarimi i argumenteve të *Njehsimit* para idhujtarëve.
- 3- Përmendja e disa pohimeve të ateistëve dhe kundërpërgjigja e prerë ndaj tyre.
- 4-Paraqitje e shkurtër për dënimin e disa popujve të kaluar, si Beni Israilët, si dëshmi për temat e kësaj sureje.
- 5- Kërcënimi i ashpër i fanatikëve këmbëngulës në besimin e tyre të humbur.
- 6- Thirrja për tolerancë dhe falje, por me vendosmëri dhe jo me shmangie nga Rruga e Drejtë.
- 7- Tregimet e panoramave të tmerrshme të Kiametit, në mënyrë të veçantë të Librit të veprave, të cilat përfshijnë të gjitha punët e njeriut, pa shtuar dhe pa hequr asgjë.

Kjo sure fillon dhe mbaron me cilësitë dhe Emrat madhështorë të All'llahut të Madhëruar, si Ngadhënjyesi dhe i Urti.

Emri i kësaj sureje është marrë nga ajeti i 27-të i saj. Fjala “*el xhathije*” do të thotë “rënie në gjunjë.” Ajo tregon situatën në të cilën gjenden shumë njerëz në Gjykatën e drejtësisë së All'llahut në Ditën e Kiametit.

I ndjeri Et Tabrasijnë tefsirin “*Mexhmaul Bejan*” përmend edhe një emër tjetër të panjohur të kësaj sureje, emrin “*Esh Sheriatu*” - Sheriati, ligji i All'llahut, i nxjerrë nga ajeti i 18-të i kësaj sureje.

Mirësia e leximit të sures

Në një hadith nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) lexojmë: “*Kush lexon suren ‘Ha, Mim el Xhathije’, All'llahu ia mbulon lakuriqësinë dhe ai do ta mposhtë frikën e tij në Ditën e Llogarisë.*”.¹

Në një hadith tjetër nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “*Kush lexon suren “ElXhathije”, nuk do ta shikojë kurrë Zjarrin dhe as do ta dëgjojë frymënxjerrjen e Xhehennemit. Ai do jetë bashkë me Muhammedin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*”.²

¹Tefsiri “*Mexhamul Bejan*”, fillimi i sures “*El Xhathije*”.

²Tefsiri “*El Burhan*”, vëll. 4, f. 167, fillimi i sures “*El Xhathije*”.

Ajetet 1- 6

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

حم ١ تَنْزِيلُ الْكِتَابِ مِنَ اللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ؛ إِنَّ فِي السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضِ لَآيَاتٍ لِّلْمُؤْمِنِينَ ٢ وَفِي خَلْقِكُمْ وَمَا يَبُثُّ مِنْ دَابَّةٍ آيَاتٌ
لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ؛ وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَمَا أَنْزَلَ اللَّهُ مِنَ السَّمَاءِ
مِنْ رِزْقٍ فَأَحْيَا بِهِ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَتَصْرِيفِ الرِّيَّاحِ آيَاتٌ لِّقَوْمٍ
يَعْقِلُونَ ٣ تِلْكَ آيَاتُ اللَّهِ نَتْلُوهَا عَلَيْكَ بِالْحَقِّ فَبِأَيِّ حَدِيثٍ بَعْدَ
اللَّهِ وَآيَاتِهِ يُؤْمِنُونَ ٤

Me emrin e All'Ilahut, të Gjithmëshirmit, Mëshirplotit

“Hâ, Mîm.”

**“Ky Libër është shpallur prej All'Ilahut, të Plotfuqishmit
dhe të Urtit!”**

**“Me të vërtetë, në qiej dhe në Tokë ka shenja për ata që
besojnë.”**

**“Edhe në krijimin tuaj dhe të kafshëve të shpërndara
nëpër Tokë, ka shenja për besimtarët e bindur.”**

“Edhe në ndërrimin e natës dhe të ditës, edhe në ujin që All’llahu e zbret nga qielli, duke gjallëruar nëpërmjet tij tokën e shkretuar, edhe në ndërrimin e erërave, ka shenja për njerëzit që mendojnë.”

“Këto janë Shpalljet e All’llahut, të cilat Ne t’i tregojmë ty me tërëtë vërtetën. Atëherë, në çfarë fjalësh të tjera do të besojnë ata, nëse mohojnë All’llahun dhe shenjat e Tij?!”

Komentimi

Argumentet e All’llahut janë kudo

E përmendëm më sipër se kjo sure është sureja e gjashtë, e cila fillon me shkronjat e ndërprera “Ha, Mim”. Kemi diskutuar shpesh për komentimin e shkronjave të ndërprera në fillimet e sureve “El Bekare” dhe “Ali Imran”, edhe tek *Havamimet*.

Në fillim të sures, i ndejri Et Tabrasi në tefsirin e tij thotë: “Më e mira që mund të thuhet, është se “Ha, Mim” përbën emrin e kësaj sureje.”. Më pas ka transmetuar nga disa komentues se emërtimi i kësaj sureje me “Ha, Mim” është për të treguar se Kur’ani i Shenjtë është i përbërë nga të njëjtat shkronja të alfabetit të gjuhës arabe (elif ba).

Është krejtësisht e vërtetë që Libri i dritës, i udhëzimit dhe udhërrëfimit, zgjidhësi i dilemave dhe problemeve, kjo mrekulli e përhershme e Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut*

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), përbëhet nga këto shkronja të thjeshta. Kulmi i madhështisë së tij qëndron pikërisht në thjeshtësinë e formimit.

Mbase ky ka qenë shkak, që ajeti në vijim flet për madhështinë e Kur'anit: **“Ky Libër është shpallur prej All'Ilahut, të Plotfuqishmit dhe të Urtit!”**.

Fjala *“el azizju”* përdoret me kuptimin *“i forti”*, i cili nuk lodhet kurrë, kurse fjala *“el hakimju”* tregon atë që di të gjitha sekretet, që është i gjithëdijshëm, i urtë, i plotfuqishëm, etj. Thënë ndryshe, këto cilësi janë të mishëruara vetëm tek All'Ilahu i Madhërishëm, prandaj këtë Libër madhështor vetëm Ai mund ta formulonte dhe ta zbriste.

E veçanta e këtij ajeti është përmendja në këtë formë, në fillim të katër sureve të Kur'anit Kerim. Tri prej këtyre sureve janë *havamime-t*, epikërisht suret *“ElMu'minun”*, *“ElXhathije”* dhe *“ElAhkaf”*, kurse tjetra nuk është e këtij grupi. Ajo është surja *“Zumer”*. Përsëritja e njëjtë në fillimin e tri sureve të përmendura më sipër, bëhet për të tërhequr vëmendjen në vërtetësinë, thellësinë dhe madhështinë e përmbajtjes së këtij ajeti. Kjo përsëritje e tillë kërkon që t'i bindë të gjithë, se duhet të meditojnë thellë për çdo fjalë të tij dhe të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të arritur drejt thellësive të asaj që kanë konceptuar nga ky ajet.

Një moment tjetër shumë i rëndësishëm, i cili kërkon vlerësim të madh, është se cilësia, sifati *“el azizju”* - *“i Gjithëfuqishmi”*, ndonjëherë është përmendur për përshkrimin e

vetë Kur'anit, si p.sh: **“Ai është një Libër ngadhënjes.”**¹ Nuk ka dyshim se Kur'ani është Libër ngadhënjes! Tek ai nuk mund të arrijnë duart e atyre që thonë se “nuk ka dobi në të” dhe se nuk duhet të kalojmë kohë për të treguar rëndësinë e tij, “se nuk janë të vërteta fjalët” se “nuk vjetërohen të vërtetat dhe as nuk humbin vlerat e tij”, etj. Ai ua çjerr maskën këtyre falsifikuesve dhe atyre që përpiqen ta falsifikojnë atë dhe ka treguar dhe tregon Rrugën e Drejtë, pavarësisht pengesave që mund t'i vihen përpara.

Ajeti që vjen më pas, tregon qartësinë e argumenteve të All'Ilahut të Madhëruar dhe faktet e Madhështisë së Tij në horizonte dhe në vetet e tyre. Në të thuhet: **“Me të vërtetë, në qiej dhe në Tokë ka shenja për ata që besojnë.”**

Pa dyshim se madhështia e qiejve në njërën anë, organizimi i përsosur i tyre, i sprovuar në miliona vite, sistemi çudibërës i krijesave të Tokës, janë argumente prej argumenteve të All'Ilahut të Madhëruar.

Sipas disa dijetarëve, toka kryen katërmbëdhjetë lëvizje. Ajo rrotullohet rreth vetes së saj me një shpejtësi të madhe, rrotullohet rreth diellit me një lëvizje të shpejtë, kurse lëvizjet e tjera i kryen së bashku me sistemin diellor të galaktikës së *Rrugës së qumështit*. Kështu, toka udhëton në një rrugë që nuk ka fund, që nuk ka kufij, e megjithatë ajo është një vend i qetë, ku njeriu është i stabilizuar mbi të. Asnjë nga krijesat e gjalla nuk ndjen asnjë shqetësim apo tronditje, as sa maja e gjilpërës.

¹ Sure “Fussilet”, ajeti 41.

Toka nuk është aq e ngurtë, sa të mos mund të punohet për t'u mbjellë, sa të mos ndërtohen mbi të ndërtesat shumëkatëshe dhe as nuk është e rrëshqitshme, sa të mos qëndrosh i qetë mbi të.

Në brendësi të saj ka minerale dhe mjete jetese për miliarda njerëz. Pasuri dhe mjete të tilla jetese ka patur si për ata që kanë jetuar në të kaluarën, ka dhe për ata që jetojnë aktualisht, ka edhe për të tjerë që do vijnë në të ardhmen. Toka ka një bukuri magjepsëse.

Malet, detrat dhe atmosfera e Tokës janë njëherësh edhe argumente, edhe sekrete prej sekreteve të All'llahut të Madhërishëm.

Këto shenja të Njehsimit dhe të Madhështisë së All'llahut të Lartësuar e tërheqin vëmendjen e njerëzve dhe u sjellin dobi besimtarëve, kërkuesve të së vërtetës dhe atyre që ecin në Rrugën e All'llahut. Kurse zemërverbuarve, mendjemëdhenjve dhe të hutuarve, Ai ua ka ndaluar konceptimin dhe ndjeshmërinë.

Më pas vjen ajeti për argumentet e horizonteve dhe argumentet në vetet e tyre. Ajeti thotë: **“Edhe në krijimin tuaj dhe të kafshëve të shpërndara nëpër Tokë, ka shenja për besimtarët e bindur.”**

Në një thënie të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), Prijësi i besimtarëve, thuhet: *“A kujton se ti je një trup i vogël, ndërkohë që në brendësinë tënde është bashkangjitur bota e madhe?!”. Çdo gjë që është e pranishme në botën e madhe, ka në një pjesë të saj një model, një shembull të zvogëluar në brendësi të trupit të njeriut dhe shpirtit të tij.*

Cilësitë e modelit janë të kompozuar nga karakteristikat e qenieve të gjalla, nga larmia e strukturës së tyre.

Ndërtimi dhe formimi i një qelize prej qelizave të modelit, është njësoj si ndërtimi i një qyteti të madh industrial të mbushur me sekrete, është njësoj si krijimi i një qimeje me veçoritë dhe sekretet e saj të ndryshme. Të gjitha sekretet e krijimit janë zbuluar me forcën e diturisë dhe të zhvillimit. Ato janë argumente të mëdha prej All'Ilahut të Madhërishëm.

Ekzistenca e damarëve, arterieve, venave të mëdha e të vogla, e enëve shumë të vogla të gjakut, e kapilarëve të pafundëm në trupin e njeriut, mënyrat e lidhjes dhe të komunikimit të tyre me qendrën e drejtimit e të kontrollit, trurin, i cili është një përzierje unike mjaft komplekse, mënyra e funksionimit të sistemeve të brendshme të trupit dhe harmonizimi i çuditshëm i tyre, përballja e ngjarjeve të papritura, mbrojtja heroike e forcave ruajtëse të trupit kundër sulmeve të faktorëve të jashtëm etj, janë argumente të mëdha prej argumenteve të All'Ilahut të Madhëruar.

Për qindra e mijëra lloje të ndryshme qeniesh, duke filluar që nga gjallesat mikroskopike e deri te kafshët gjigande, me veçoritë e tyre dhe strukturën e sistemeve plotësisht të ndryshme, grupe shkencëtarësh mund të shpenzojnë jetët e tyre për të mësuar sjelljet e njërit tip prej tyre. Mund të jenë shkruar mijëra libra për sekretet e këtyre krijesave, e ajo që dimë rreth tyre është shumë pak, në krahasim me atë që nuk dimë. Secila prej këtyre krijesave është argument i diturisë së Krijuesit të krijesave, i mençurisë së Tij, i fuqisë së Tij të pafundme.

Mirëpo, përse ka raste kur një grup jeton dhjetëra vjet nën hijen e këtyre ajeteve, kalon mbi ta dhe nuk arrin ta kuptojë, ta vërë re qoftë edhe vetëm njërin prej tyre?!

Këtë e ka sqaruar Kur'ani Kerim, i cili ka thënë se këto argumente janë specifike për besimtarët, për kërkuesit e bindjes, për njerëzit e mendimit e të intelektit dhe për ata që kanë hapur dyert e zemrave të tyre për të njohur të vërtetën, që janë të etur për dituri dhe bindje. Ata mendojnë për këto argumente me orë të gjata. Nëpërmjet tyre, ata gjejnë paqen dhe lartësohen tek All'Ilahu i Madhëruar.

Ajeti tjetër na përmend edhe tri dhuratat të tjera. Secila prej tyre ka një efekt të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe të qenieve të tjera të gjalla. Secila është një argument prej argumenteve të All'Ilahut të Lartësuar. Ato janë dhuratat e dritës, ujit dhe ajrit. Ajeti thotë: **“Edhe në ndërrimin e natës dhe të ditës, edhe në ujin që All'Ilahu e zbret nga qielli, duke gjallëruar nëpërmjet tij tokën e shkretuar, edhe në ndërrimin e erërave, ka shenja për njerëzit që mendojnë.”.**

Sistemi i dritës dhe i errësirës dhe krijimi i natës dhe i ditës, të cilat pasojnë njëra-tjetrën, është një sistem i drejtpeshuar dhe shumë i saktë. Nëse do të ishte gjithmonë ditë, ose nëse dita do të ishte më e gjatë nga ç'është, atëherë do të ngrihej temperatura deri sa do t'i digjte të gjitha krijesat e gjalla. Nëse do të ishte natë e vazhdueshme, apo nëse nata do të ishte shumë e gjatë, atëherë do të ngurtësoheshin krijesat nga i ftohti i ashpër.

Në komentimin e ajetit supozohet se ndryshimi i natës me ditën nuk nënkupton ndjekjen e njëra-tjetrës, por tregon për

diferencën kohore të natës dhe të ditës në stinët e vitit. Nga këto ndryshime, njeriu përfiton të mirat materiale të nevojshme për jetesë, si: prodhimet e ndryshme bujqësore, bimët, frutat, zbritjen e dëborës, rënien e shirave dhe plot begati të tjera.

Interesante është se shkencëtarët thonë: Pavarësisht ndryshimit të madh mes zonave të ndryshme të Tokës, lidhur me kohëzgjatjen e natës dhe të ditës si dhe me shkurtimin e tyre, nëse ne llogarisim në total të gjitha ditët e vitit, atëherë do të shohim se të gjitha zonat marrin të njëjtin raport të rrezeve të dritës.¹

Më pas, hadithi vazhdon me begatinë e dytë qiellore, domethënë atë të shiut, i cili nuk ka të krahasuar për butësinë, falë natyrës dhe delikatesës së tij. Me fuqinë e tij, ai ringjall jetën kudo dhe sjell bukurinë e mrekullisë.

Kjo nuk duhet të na shkaktojë çudi, kur e dimë se uji përbën pjesën më të madhe të trupit të njeriut dhe të shumë prej kafshëve dhe bimëve të tjera.

Në fragmentin e tretë, ajeti flet për fryrjen e erërave, të cilat e çojnë ajrin e mbushur me oksigjen nga një vend në tjetrin dhe e vënë atë në dispozicion të qenieve të gjalla, largojnë ajrin e ndotur me karbon drejt shkretëtirës dhe pyjeve për ta pastruar, e më pas e rikthejnë atë drejt qyteteve.

E çuditshme është se këto dy grupe qeniesh të gjalla, kafshët dhe bimët, janë të kundërta në mënyrën e funksionimit.

¹ Rreth ndryshimit të natës dhe ditës janë përmendur diskutime të hollësishme në suren "El Bekare", fundi i ajetit 164, në suren "Ali Imran", fundi i ajetit 190, në suren "Junus", fundi i ajetit 6 dhe në fundin e ajetit 71 të sures "El Kasas".

Kafshët e marrin oksigjenin dhe çlirojnë dioksidin e karbonit, kurse bimët bëjnë të kundërtën: thithin dioksidin e karbonit dhe çlirojnë oksigjenin. Kështu bëhet balancimi i sistemeve jetësore dhe ajri nuk mbaron asnjëherë.

Përveç asaj që u tha më lart, fryrja e erërave pllenon edhe bimët, i bën ato bartëse të farave, transferon llojet e ndryshme të bërthamave në tokë, për të mbirë atje, zhvillon kullotat natyrore dhe pyjet, shkakton dallgët përplasëse në zemrat e oqeanëve, ringjall lëvizjen dhe jetën në detra, shkakton dallgë gjigande, e ruan ujin që të mos priset e qelbet, të mos dekompozohet. Janë po këto erëra që i lëvizin anijet mbi sipërfaqen e detrave dhe të oqeanëve.¹

E veçanta është se këto ajete flasin së pari rreth argumenteve të Qiellit dhe të Tokës. Në fund të ajetit të parë thuhet:

S’ka dyshim se ato janë argumente për besimtarët. Më pas flitet për krijimin e qenieve të gjalla. Në fund të ajetit të dytë thuhet: “Me të vërtetë, s’ka dyshim se ato janë argumente për ata që janë të bindur.”. Pastaj flitet për sistemet e dritës dhe të errësirës, të erërave, të shirave. Më tej thuhet: “Pa dyshim se këto janë argumente për ata që logjikojnë.”.

Ky ndryshim i formulimit të mënyrës së të shprehurit, mbase bëhet për shkak se njeriu kalon nëpër tri faza në rrugën e tij drejt njohjes së All’lilaut të Madhëruar. **Faza e parë është meditimi**, e dyta është **faza e bindjes dhe e diturisë** dhe e treta

¹ Komentime të hollësishme rreth efekteve të erërave dhe shirave janë përmendur në fundin e ajeteve 46-50 të sures “Rrum”.

është faza e besimit, apo ajo që njihet si **kontrata e zemrës**. Besimi është faza më fisnike, më e lartë. Pas tij vjen bindja, kurse në fazën e tretë vjen meditimi, të menduarit. Këto faza janë përmendur sipas radhës, në ajetet e përmendura, edhe pse fazat për nga ana e ekzistencës fillojnë me meditim, pastaj me bindjen dhe më pas me besimin.

Thënë ndryshe, një popull që beson, e arrin këtë fazë nëpërmjet shikimit të argumenteve të All'llahut të Madhëruar, kurse ata që nuk janë prej tyre, le të arrijnë të paktën në fazën e bindjes apo të medimit.

Ajeti i fundit bën përmbledhjen e diskutimeve të mëparshme dhe thotë: **“Këto janë Shpalljet e All'llahut, të cilat Ne t’i tregojmë ty me tërëtë vërtetën...”**.

Fjala *“tilke”*, a tregon vetëm argumentet e All'llahut, apo edhe argumentet e All'llahut, edhe shenjat në horizonte dhe në vetet e tyre, për të cilat kemi diskutuar në ajetet e kaluara?

Çdo gjë është e mundur, por këto ajete janë argumentet e All'llahut të Madhëruar në të gjithë botën e ekzistencës. Megjithatë është e mundur që të bashkohen të dyja komentimet.

Sido që të jetë, shprehja *“et tilauetu”*, do të thotë *lexim në mënyrë të vazhdueshme, të përsëritur*. Bazuar në këtë fraza *“tilauetul Kur'an”* do të thotë leximi i ajeteve të Kur'anit në formë të vazhdueshme dhe ajetet të pasojnë njëra-tjetrën.

Këto argumente janë elokuente, shpjeguese, të qarta dhe përmbajnë argumentimin rreth vërtetësisë së tyre dhe vërtetësisë së Atij që i solli.

Nëse ata nuk besuan në këto argumente, atëherë me çfarë do të besojnë? Ky është edhe përfundimi i ajetit: **“...Atëherë, në çfarë fjalësh të tjera do të besojnë ata, nëse mohojnë All’llahun dhe shenjat e Tij?!”**.

Kur’ani i Shenjtë ka një përmbajtje të thellë, sjell argumente dhe fakte për *Njehsimin*. Ai përmban këshilla dhe udhëzime që i tërheqin robtë drejt All’llahut të Madhëruar, tërheqin edhe ato zemra që kanë përgatitje të ulët, si dhe ftojnë çdo njeri të lidhur pas të drejtës, pastërtisë dhe përkushtimit. Nëse këto ajete të qarta nuk arrijnë të kenë efekt tek asnjë njeri, atëherë nuk ka asnjë shpresë në udhëzimin e tyre.

Ajetet 7-10

وَيْلٌ لِّكُلِّ أَفَّاكٍ أَثِيمٍ ۚ يَسْمَعُ آيَاتِ اللَّهِ تُتْلَىٰ عَلَيْهِ ثُمَّ يُصِرُّ مُسْتَكْبِرًا
كَأَن لَّمْ يَسْمَعْهَا فَبَشِّرْهُ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ۚ وَإِذَا عَلِمَ مِنْ آيَاتِنَا شَيْئًا
اتَّخَذَهَا هُزُوًا أُولَٰئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ مُّهِينٌ ۚ مِنْ وَرَائِهِمْ جَهَنَّمُ وَلَا يُغْنِي
عَنْهُمْ مَا كَسَبُوا شَيْئًا وَلَا مَا اتَّخَذُوا مِنْ دُونِ اللَّهِ أَوْلِيَاءَ ۚ وَلَهُمْ
عَذَابٌ عَظِيمٌ

“Mjerë për çdo gjynahqar gënjeshtar!”

“Ai i dëgjon Shpalljet e All’Ilahut që i lexohen e përsëri ngulmon në mendjemadhësi, sikur nuk i ka dëgjuar ato; jepi atij lajmin përdënim të dhembshëm!”

“E, kur merr vesh diçka nga Shpalljet Tona, ai i përqesh. Përnjerëz të tillë do të ketë dënim poshtërues.”

“Pas tyre është Xhehennemi dhe nuk do t’u vijë në ndihmë asgjë nga ato që kanë fituar apo nga ata (idhuj) që i kanë marrë për mbrojtës në vend të All’Ilahut! Ata i pret mundim i madh.”

Komentimi

Mjerë gënjeshtari mëkatar

Ajetet e kaluara folën për një grup njerëzish që e dëgjonin Fjalën e All'llahut, e mbështetur në argumente të ndryshme të *Njehsimit*, këshillave dhe udhërrëfimit. Mirëpo, ato fjalë nuk ndikonin në zemrat e tyre të ngurta.

Këto ajete i shqyrtojnë me hollësi përfundimet e veprave të këtij grupi dhe thonë se, së pari: **“Mjerë për çdo gjynahqar gënjeshtar!”**.

Fjala *“el efaku”* është përdorur si hiperbolë, pra e shton shumë kuptimin që përcjell. Në këtë rast, ajo shton gënjeshtren, tregon atë që thotë një gënjeshtër të madhe.

Kurse fjala *“el ethijmu”* tregon një kriminel, mëkatar, kundërshtues. Sigurisht që edhe këtu i jepet cilësia e hiperbolës.

Në këtë ajet bëhet e qartë se ata që kundërshtojnë, që janë kokëfortë dhe fanatikë përpara argumenteve të All'llahut të Madhëruar, janë prej të mbushurve me mëkate e gënjeshttra. Ata nuk janë të singertë, besnikë dhe të pastër.

Ajeti më pas tregon për mënyrën e kundërshtimit. Ai thotë: **“Ai i dëgjon Shpalljet e All'llahut që i lexohen e përsëri ngulmon në mendjemadhësi, sikur nuk i ka dëgjuar ato; jepi atij lajmin për dënim të dhembshëm!”**. Ai sillet kështu, për shkak të ndotjes së tij me mëkat dhe me gënjeshtër, me kryeneçësi, mendjemadhësi e vetëpëlqim. Ai ecën sikur nuk i ka dëgjuar fare

këto ajete, apo sikur të kishte qenë i shurdhër. Kjo tregohet edhe në ajetin e 7-të të sures "Lukman": **"Kur ndonjërit prej tyre i lexohen Shpalljet Tona, ai e kthen shpinën me mendjemadhësi, sikur nuk i ka dëgjuar, sikur i janë shurdhuar veshët..."**.

Në fundin e tij, ajeti kërcënon me një ndëshkim të ashpër: **"...jepi atij lajmin për dënim të dhembshëm!"**. Ashtu siç ai e ka lënduar zemrën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të besimtarëve dhe u ka shkaktuar atyre dhimbje, edhe ne pa dyshim që do ta ndëshkojmë atë me një ndëshkim të ashpër, sepse ndëshkimi i Kiametit është mishërimi i veprave të njeriut në jetën e kësaj bote.

Një pjesë e komentuesve kanë përmendur se ky ajet dhe ajeti pas tij, janë shenja treguese për Ebu Xhehlin, apo Nadhrin të birin e Harithit, sepse ata grumbullonin tregime dhe legjenda prej joarabëve, me qëllim që t'i çoroditnin njerëzit dhe t'i largonin ata nga feja e vërtetë.

Mirëpo është e qartë se ky ajet nuk është posaçërisht për ata, madje as për idhujtarët arabë, gjithashtu. Ajeti është për të gjithë kriminelët, gënjeshtarët dhe mendjemëdhenjtë në çdo kohë e periudhë. Është për të gjithë ata, të cilët bëjnë sikur nuk i kanë dëgjuar ajetet e All'llahut të Madhëruar dhe thirrjet e Pejgamberëve, që bëjnë sikur nuk i kanë dëgjuar fjalët e Imamëve dhe më të mëdhenjve, sepse të gjitha këto nuk harmonizohen me pasionet e tyre, me qejfet e tyre dhe me dëshirat e tyre të shthurura, nuk i mbështesin mendimet e tyre djallëzore, nuk i pranojnë zakonet e tyre të gabuara, njohuritë e tyre të padobishme dhe traditat e tyre të verbra.

Po, jepu atyre lajmin për dënimin e dhimbshëm!

Përderisa dënimi nuk harmonizohet me përgëzimin, atëherë, kjo mënyrë të shprehuri është tallje dhe përbuzje.

Ajeti pas këtij shton: **“E, kur merr vesh diçka nga Shpalljet Tona, ai i përqesh...”**.

Te këta injorantë egoistë ka dy situata:

E para: Ata i dëgjojnë rrallë ajetet e All’liahut dhe nuk kanë fare interes për to. Ata ecin sikur nuk u interesojnë fare dhe nuk tregojnë respekt. Ata hiqen sikur nuk i kanë dëgjuar ato.

E dyta: Edhe nëse i dëgjojnë dhe kanë interes për to, përsëri fillojnë e tallen. Si ata të situatës së parë, ashtu edhe këta të situatës së dytë i përkasin të njëjtës kategori, sepse nuk ka asnjë ndryshim mes këtij ajeti dhe atij që është para tij.

Është interesante se në fillim, ajeti thotë: **“E, kur merr vesh diçka nga Shpalljet Tona...”**. E më pas nuk thotë se ai tallet me atë që ka mësuar, por thotë se i merr të gjitha ajetet me tallje, qofshin ato që i di, edhe ato që nuk i di. Kulmi i injorancës është kur njeriu mohon diçka apo tallet me të, edhe pse nuk e kupton atë. Ky është argumenti më i mirë për kokëfortësinë dhe mendjengushtësinë e tyre.

Më pas, ajeti përshkruan dënimin e tyre: **“...Përnjerëz të tillë do të ketë dënim poshtërues.”**. E përse të mos jetë i tillë fundi i këtyre, ndërkohë që ata kërkonin të dukeshin fisnikë, të pasur, dhe me pozitë të lartë sociale duke u tallur me argumentet e All’liahut të Madhëruar. All’lahu i Lartësuar do t’i dënojë e do t’i poshtërojë si në këtë jetë ashtu edhe në Jetën Tjetër me dënime të tmerrshëm e poshtërues në Ditën e Kiametit. Ata do të

tërhiqen nga fytyrat e tyre, të lidhur e të prangosur duar e këmbë. Më pas, ata do të hidhen në atë gjendje në Xhehennem. Bashkë me këtë do të hasin edhe qortimin e ashpër të engjëjve të dënimit dhe përbuzjen e tyre.

Kjo qartëson arsyen se përse në ajetin e kaluar, dënimi përshkruhet i dhimbshëm dhe këtu përshkruhet i madh. Secili prej këtyre dënimeve i përshtatet llojit të mëkatit të tyre dhe mënyrës se si e kanë kryer.

Ajeti në vazhdim sqaron dënim poshtërues dhe thotë: **“Pas tyre është Xhehennemi...”**. Mënyra e shprehjes se Xhehennemi është pas tyre, megjithëse ai është para tyre dhe do të hyjnë në të, ka mundësi që të ketë si qëllim se ata u dhanë pas dynjasë dhe e hodhën pas krahëve të tyre Ahiretin dhe dënimin. Kjo është një thënie e njohur sepse kur një njeri nuk interesohet për një çështje, do të thotë se e ka hedhur pas shpine dhe e ka braktisur atë. Në këtë kuptim, ajo është një shprehje normale. Kur'ani i Shenjtë thotë: **“Vërtet që jobesimtarët e duan jetën e këtushme dhe nuk e përfillin një Ditë të vështirë, që do t’u vijë.”**¹

Një grup komentuesish kanë thënë gjithashtu, se fjala *“verae”*, që do të thotë *“pas”* rrjedh nga lënda *“el muvaratu”*. Kjo përdoret për çdo gjë të fshehtë e të padukshme për njeriun, qoftë para tij, apo mbrapa tij dhe nuk e sheh atë. Pra, përdoret për të treguar *çdo gjë të fshehur për njeriun, çdo gjë që i është ndaluar ta shohë*. Në këtë kuptim, fjala *“verae”*, përdoret për dy gjëra të kundërta.

¹Sure “El Insan”, ajeti 27.

Thënë ndryshe, përdorimi i fjalës “*verae*” tregon veprime që lidhen me shkak-pasojën respektive. P.sh., nëse ha një ushqim të prishur, do të sëmuresh. Pra, ngrënia e ushqimit të prishur bëhet shkak i sëmundjes. Po kështu, edhe punët që kanë kryer njerëzit në Dynja, bëhen shkak për dënimin e tmerrshëm të Xhehennemit.

Ajeti jep vazhdimësinë e ngjarjes. Këta, nëse besojnë, do të mendojnë për pasuritë dhe për zotat e tyre, të cilët i shpikën vetë. Ata shpresojnë se këta zota të shpikur prej tyre do t’ua lehtësojnë sadopak rëndesat, do t’i pasurojnë, do t’u bëjnë dobi më tepër, përveç All’llahut. Ata kanë rënë në një dyshim të madh: “**...dhe nuk do t’u vijë në ndihmë asgjë nga ato që kanë fituar apo nga ata (idhuj) që i kanë marrë për mbrojtës në vend të All’llahut.**”.

Ata, atje nuk gjetën asnjë rrugë shpëtimi nga ky dënim, prandaj detyrohen të qëndrojnë në dënimin e All’llahut dhe zjarrin e zemërimit të Tij: “**...Ata i pret mundim i madh.**”.

Këta i kanë zvogëluar ajetet e All’llahut të Madhëruar. Për këtë gjë, All’llahu do t’ua shtojë më shumë dënimin, sepse ngritën krye dhe u mburrën. Për këtë arsye, All’llahu i hodhi ata në dënimin e dhembshëm.

Ky dënim është i madh nga çdo anë. Është i madh në përjetësinë e tij, në ashpërsinë e tij dhe në afrimin e tij me përbuzje e poshtërim. Është i madh në zbatimin e tij, në depërtimin e tij në palcën kurrizore dhe në zemrat e kriminelëve. Ky dënim është i madh, sepse mëkati i madh përpara All’llahut të Madhërishëm nuk ka ndëshkim tjetër, veç ndëshkimit të madh.

Ajetet 11-15

هَذَا هُدًى وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ لَهُمْ عَذَابٌ مِنْ رِجْزٍ أَلِيمٍ
 اللَّهُ الَّذِي سَخَّرَ لَكُمْ الْبَحْرَ لَتَجْرِيَ الْفُلُكُ فِيهِ بِأَمْرِهِ وَلِتَبْتَغُوا مِنْ
 فَضْلِهِ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ» وَسَخَّرَ لَكُمْ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي
 الْأَرْضِ جَمِيعًا مِنْهُ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ» قُلْ لِلَّذِينَ
 آمَنُوا يَغْفِرُوا لِلَّذِينَ لَا يَرْجُونَ أَيَّامَ اللَّهِ لِيَجْزِيَ قَوْمًا بِمَا كَانُوا
 يَكْسِبُونَ» مَنْ عَمِلَ صَالِحًا فَلِنَفْسِهِ وَمَنْ أَسَاءَ فَعَلَيْهَا ثُمَّ إِلَى
 رَبِّكُمْ تُرْجَعُونَ»

“Ky (Kur’ani) është udhërrëfyes në Rrugën e Drejtë. Ata që nuk besojnë Shpalljet e Zotit të tyre, do të vuajnë një mundim të madh, të dhembshëm.”

“All’lillahu është Ai që ka nënshtruar për ju detin, që nëpër të, me urdhrin e Tij, të lundrojnë anijet, për të kërkuar dhuntitë e Tij dhe që ju të jeni mirënjohës.”

“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.”

“Thuaju besimtarëve, që t’i falin ata që nuk shpresojnë në ditët e All’llahut, kështu që Ai të shpërblejë çdo popull sipas veprave të veta.”

“Kush bën mirë, e ka për vete e kush bën keq, e bën kundërvetes; e në fund do të ktheheni (të gjithë) te Zoti juaj.”

Komentimi

Çdo gjë është në shërbim të njeriut

Në ajetet e mësipërme diskutuam për madhësinë e ajeteve të All’llahut. Edhe këto ajete do të trajtojnë të njëjtën temë. Ajeti thotë: **“Ky (Kur’ani) është udhërrëfyese në Rrugën e Drejtë...”**, sepse ai dallon të drejtën nga e padrejta dhe e ndriçon jetën e njeriut, i merr për dore ata që zgjedhin rrugën e vërtetë, për t’i çuar drejt qëllimit të tyre dhe vendit që synojnë. Nga ana tjetër, ajeti thotë: **“...Ata që nuk besojnë Shpalljet e Zotit të tyre, do të vuajnë një mundim të madh, të dhembshëm.”**.

Fjala *“err rrixhzu”* do të thotë *çrregullim, shqetësim, tronditje dhe mospritje*, siç thotë Er Ragib në librin *“El Mufredatu”*.

Me këtë fjalë emërtohen edhe sëmundjet epidemike, edhe sprovat e vështira, furtunat e forta prej dëbore. Edhe ngacmimet djallëzore e të tjera si këto, sepse të gjitha sjellin çrregullim, tronditje e mospritje, sjellin thyerje të disiplinës. Me këtë kuptim

përdoret kjo fjalë edhe për poezitë e luftës (rixhzun), sepse ato janë pjesë të shkurtra që ngjallin frikë dhe shqetësim në radhët e armiqve.

Më pas vijon diskutimi i *Njehsimit*, i cili është përmendur në ajetet e para të kësaj sureje. Ky diskutim u jep idhujtarëve disa mësimë të rëndësishme për Njehsimin e All'llahut të Madhërueshëm dhe njohjen e Tij. Ajeti thotë: **"All'llahu është Ai që ka nënshtruar për ju detin, që nëpër të, meurdhrin e Tij, të lundrojnë anijet, për të kërkuar dhuntitë e Tij dhe që ju të jeni mirënjohës."**

Kush është Ai, që e ka bërë anijen të notojë mbi ujë dhe të mos zhytet? Kush është Ai, që e ka bërë ujin të shtruar, të qetë, për të lëvizur në të, derisa u mundësua që të ecej në të me një lehtësi të madhe? Kush i urdhëroi erërat të frynin mbi sipërfaqen e oqeanëve e të lëviznin anijet?

Ne e dimë mirë se mjetet më të mëdha të transportit të njeriut edhe në të kaluarën, edhe në të tashmen, janë anijet, të cilat transportojnë në të katër anët e botës.

Po të mos ishin anijet, njeriu do ta kishte shumë më të vështirë transportin e njerëzve dhe të mallrave. Edhe këto mjete të thjeshta të transportit janë prej mirësive të All'llahut të Madhëruar.

Është interesante se në ajetin e 32-të të sures "Ibrahim" thuhet: **"...Ai i ka vënë në shërbimin tuaj anijet, që me lejen e Tij, ju të lundroni me ato nëpër dete..."**, kurse këtu ajeti thotë: **"...që ka nënshtruar për ju detin, që nëpër të..."**. Kjo sepse në ajetin e sures "Ibrahim" ka përforsim përnënshtrimin e detit. Pas

kësaj, ajeti 32 i sures “Ibrahim” mbyllet me thënien: “**...Ai i ka krijuar lumenjtë për dobinë tuaj.**”. Në ajetin në fjalë flitet për nënshttrimin e anijeve. Sido që të jetë, edhe deti edhe anijet janë në dobi të njeriut dhe se detrat, lumenjtë, anijet u nënshtrohen njerëzve me urdhrin e All’llahut të Madhëruar.

Qëllimi i këtij nënshttrimi është që të kënaqeni me mirësitë e All’llahut. Këto mirësi i përkasin fushës së tregtisë dhe të veprimtarive ekonomike. Sigurisht që këtu përfshihet edhe transportimi i udhëtarëve nga një vend në tjetrin.

Nga mirësitë e All’llahut ushqehet ndjenja e falënderimit tek njerëzit, mobilizimi i shpirtave të tyre në kryerjen e falënderimit ndaj Bamirësit dhe ecjes në rrugën e njohjes së All’llahut të Madhëruar.

Fjala “*el fulku*”, anije, siç e kemi thënë më parë, përdoret për njëjës dhe shumës.

Për detaje më të shumta rreth nënshttrimit të detrave, anijeve dhe dobive e mirësive të tyre, shihni sërish fundin e ajetit të 14-të të sures “En Nahl” në këtë komentim.

Ajeti në vijim diskuton për çështjet e nënshttrimit të të gjitha krijesave në mënyrë të përgjithshme: “**Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij...**”.

All’llahu ju ka nderuar aq shumë, sa ju ka nënshtuar të gjitha krijesat e botës, i ka vënë ato në shërbimin tuaj, për t’ju garantuar interesat dhe dobitë tuaja. Kështu, për ju janë nënshtuar Dielli dhe Hëna, erërat dhe shiu, malet dhe luginat,

pyjet dhe shkretëtirat, bimët dhe kafshët, mineralet dhe burimet e pasura të mbitokës dhe të nëntokës. All'llahu i Madhëruar i ka urdhëruar të gjitha këto që të jenë në shërbimin tuaj, të jenë të bindura ndaj urdhrit tuaj, zbatuese të dëshirave tuaja, që ju të kënaqeni me mirësitë dhe dhuratat e Tij. I madhëruar qoftë Ai!

Në këtë ajet, fjala **“të gjitha janë prej Tij”** tërheq më shumë vëmendjen. Ajo tregon se të gjitha mirësitë janë prej All'llahut dhe Ai është Krijuesi, Zoti dhe Kontrolluesi i të gjithave. Atëherë, përse e kundërshton njeriu All'llahun dhe mbështetet diku tjetër? Përse i qorton krijesat e dobëta dhe tregohet i pavëmendshëm ndaj Bamirësit? Prandaj, ajeti në fund shton: **“...Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.”**.

Ajeti i mëparshëm u përpoq të ndikonte në shpirtin e njeriut, kurse ky ajet përpiqet të vërë në lëvizje mendjen, logjikën e tij dhe t'i tregojë atij se sa e madhe është mëshira e Zotit. Ai vërtet flet me robtë e Tij dhe, me çdo mënyrë të mundshme, vulos efektin e Tij, herë duke i folur zemrës e herë mendjes, por gjithnjë ka për qëllim që të zgjojë të hutuarit dhe t'i nxisë ata në zgjedhjen e Rrugës së Drejtë.

Këto i kemi përmendur edhe në një diskutim të hollësishëm rreth nënshtrimit të krijesave të ndryshme të botës, në fundin e ajeteve 31-33 të sures “Ibrahim”.

Ajeti që vjen më pas përmend ligjin, rregullin moral që përcakton mënyrën e trajtimit dhe të sjelljes me jobesimtarët, për të plotësuar komentimet logjike, të cilat të ftojnë në këtë rrugë. Ajeti i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të*

dhe mbi familjen e tij!) dhe i thotë: **“Thua ju atyre që besuan: ‘Le t’u falin atyre që nuk presin ndëshkimet e All’llahut.”**.

Mund të ndodhë që sjellja e atyre të jetë e ashpër dhe mënyra e të shprehurit të tyre të jetë e pahijshme, e pakulturar. Kjo mënyrë komunikimi mund të jetë për arsye se ata janë larg shtyllave të besimit dhe bazave të edukatës hyjnore. *Është detyrë e juaja që të ballafaqoheni me ata me mirësjellje, në mënyrë që të mos vazhdojnë me mohimin dhe të mos shtojnë kokëfortësinë e tyre, sepse kështu rritet largësia mes tyre dhe së drejtës.*

Morali i mirë dhe falja, ndjeshmëria dhe toleranca e pakësojnë presionin dhe armiqësinë e tyre. Këta elementë mund të jenë edhe faktor i tërheqjes së tyre drejt besimit, drejt pranimit të tij.

Kjo fjalë e All’llahut të Madhëruar është përmendur shumë në Kur’an: **“Largohu prej tyre (o Muhammed) dhe thuaju: ‘Paqe!’ Ata së shpejti do ta marrin vesh.”**¹

Ashpërsia në marrëdhëniet me injorantët dhe këmbëngulja në ndëshkimin e tyre, zakonisht nuk prodhon gjë. Përkundrazi, injorimi i tyre dhe krenaria para tyre është një metodë e efektshme në zgjimin dhe në udhëzimin e tyre. Por ky nuk është një ligj i përgjithshëm. Sigurisht që nuk mund të mohohet se ekzistojnë raste, kur është i pamundur kurimi dhe përballimi i tyre, përveçse me ashpërsi dhe forcë, por këto janë raste të pakta.

Duhet të sqarohet edhe çështja se “të gjitha ditët janë ditët e All’llahut”. Por shprehja “ditët e All’llahut” është përdorur për

¹ Sure “Ez Zukhruf”, ajeti 89.

të emërtuar ditë të veçanta, që kanë rëndësinë dhe madhësinë e tyre.

Formulime të tilla janë përmendur në dy raste në Kur'anin e Lavdishëm: njëra prej tyre në këtë ajet, kurse tjetra në suren "Ibrahim", ku ka kuptim më të gjerë e më gjithëpërfshirës.

Në transmetimet islame, fjala "ejjamu" –"ditët" është komentuar në mënyra të ndryshme. Njëra prej tyre është ajo që përmendet në tefsirin e Aliut, të birit të Ibrahimit, ku thuhet se *ditët e All'Ilahut* janë tri: Dita e ardhjes së Mehdiut, Dita e vdekjes dhe Dita e Kiametit.¹

Në një hadith tjetër nga Pejgamberi më i nderuar (*Paqja dhe bektimi i All'Ilahut qofshin mbi të!*), lexojmë: "*Ditët e All'Ilahut janë mirësitë e Tij dhe sprovat e Tij.*"²

Sido që të jetë, kjo mënyrë të shprehuri qartëson rëndësinë e Ditës së Kiametit, ditës që do të shfaqet përpara forma e qeverisjes së All'Ilahut të Madhërishëm mbi çdo njeri dhe mbi çdo gjë. Ajo është Dita e drejtësisë, ligjit dhe e Gjykatës së madhe.

Në fund ajeti sqaron dhe thotë: **"...kështu që Ai të shpërblejë çdo popull sipas veprave të veta."** Pra, çdo njeri do të shpërblehet dhe do të ndëshkohet në varësi të punëve që ai bën.

Disa komentues e kanë konsideruar këtë fjali si një kërcënim për jobesimtarët dhe kriminelët, kurse disa të tjerë e kanë konsideruar atë si një përgëzim për besimtarët për këtë falje dhe tolerancë. Nuk ka ndonjë pengesë që të merret edhe si

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 526.

² Po aty.

kërcënim për një grup, edhe si përgëzim për një grup tjetër, siç do të tregohet në ajetin që vijon: **“Kush bën mirë, e ka për vete e kush bën keq, e bën kundër vetes; e në fund do të ktheheni (të gjithë) te Zoti juaj.”**.

Kjo mënyrë të shprehuri, e cila është përmendur në forma të ndryshme në Kur'anin e Shenjtë, është përgjigje për pyetjet: Ç'dëmtim i shkakton kundërshtimi ynë All'Ilahut të Madhëruar dhe çfarë dobie i sjell bindja jonë? Pse e gjithë kjo këmbëngulje për të mos iu bindur urdhrave të Tij dhe për të mos ndaluar para mëkateve e kundërshtive ndaj Tij?!

Ajeti thotë se çdo dëm apo dobi që bëni, do ju referohet juve, sepse ju vetë i zgjidhni shkallët e përsosjes, ju vetë zgjidhni të kryeni vepra të mira apo të liga, ju e bëni vetë përzgjedhjen e rrugës së përsosmërisë apo të devijimit. Sipas veprave të kryera, do të jetë edhe shpërblimi apo dënimi juaj. Të gjitha çështjet e detyrimit, dërgimi i të Dërguarve dhe zbritja e librave kanë këtë qëllim sublim, prandaj edhe Kur'ani Kerim vendos: **“...Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta dijë se vërtet All'Ilahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim.”**¹

Në një vend tjetër thuhet: **“Kush shkon në Rrugë të Drejtë, ai e ka për të mirën e vet, ndërsa kush e humb këtë rrugë, ai humb në dëm të vet.”**²

¹ Sure “Lukman”, ajeti 12.

² Sure “Ez Zumer”, ajeti 41.

Në një vend të tretë lexojmë: **“Kush e pastron veten (nga gjynahet), në tëvërtetë e ka për dobinë e vet, ndërsa kthimi është tek All’llahu.”**¹

Këta shembuj na tregojnë se thirrja e thirrësve për tek All’llahu i Madhëruar, është një shërbim i vërtetë për njerëzit dhe nuk është shërbim për All’llahun, i Cili nuk ka nevojë për gjë dhe as për Pejgamberët e Tij, të cilët shpërblimin e tyre e kanë vetëm tek All’llahu.

Kujdesi ndaj kësaj të vërtete llogaritet si një faktor i rëndësishëm në rrugën drejt bindjes ndaj All’llahut të Madhërishëm dhe largimit nga mëkatet.

¹ Sure “Fatir”, ajeti 18.

Ajetet 16-20

وَلَقَدْ آتَيْنَا بَنِي إِسْرَائِيلَ الْكِتَابَ وَالْحُكْمَ وَالتُّبُوَّةَ وَرَزَقْنَاهُمْ مِنَ
الطَّيِّبَاتِ وَفَضَّلْنَاهُمْ عَلَى الْعَالَمِينَ ١٦ وَآتَيْنَاهُمْ بَيِّنَاتٍ مِنَ الْأَمْرِ فَمَا
اخْتَلَفُوا إِلَّا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْعِلْمُ بَعِيًا بَيْنَهُمْ إِنَّ رَبَّكَ يَقْضِي
بَيْنَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ١٧ ثُمَّ جَعَلْنَاكَ عَلَى شَرِيعَةٍ
مِنَ الْأَمْرِ فَاتَّبِعْهَا وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَ الَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ١٨ إِنَّهُمْ لَن يُغْنُوا
عَنكَ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا وَإِنَّ الظَّالِمِينَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ وَاللَّهُ وَلِيُّ
الْمُتَّقِينَ ١٩ هَذَا بَصَائِرُ لِلنَّاسِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ ٢٠

“Ne u dhamë bijve të Izraelit Librin, pushtetin dhe Profecinë. Ne i begatuam ata me gjëra të mira dhe i ngritëm mbi të gjithëpopujt e tjerë (të asaj kohe).”

“Gjithashtu, Ne u dhamë urdhëzime të qarta mbi Fenë e vërtetë, por ata u përçanë, atëherë kur u erdhi dituria, pasi patën smirënë mes tyre. Zoti yt, me siguri, do t’i gjykojë (ata) në Ditën e Kiametit për kundërshtitë që patën.”

“Dhe tani, Ne të kemi vendosur ty në Rrugën e Drejtë të fesë, prandaj ndiqe atë dhe mos shko pas dëshirave të atyre që nuk dinë!”

“Ata nuk mund të të mbrojnë aspak nga zemërimi i All'Ilahut. Pa dyshim, të padrejtët kanë për mbrojtës njëri-tjetrin, kurse All'Ilahu është Mbrojtësi i atyre që i frikësohen Atij e që ruhen nga gjynahet.”

“Ky (Kur'ani) është tregues i qartë, udhërrëfyes dhe mëshirë përnjerëzit që kanë besim të patundur.”

Komentimi

Ne u patëm dhënë Beni Israilëve të gjitha ato, mirëpo...

Këto ajete trajtojnë shembuj nga jeta e disa popujve të mëparshëm, të cilët i mbuloi bollëku i mirësive të All'Ilahut të Madhëruar, por ata i mohuan ato dhe nuk i ruajtën ashtu siç duhet.

Ajeti i parë thotë: **“Ne u dhamë bijve të Izraelit Librin, pushtetin dhe Profecinë. Ne i begatuam ata me gjëra të mira dhe i ngritëm mbi të gjithëpopujt e tjerë (të asaj kohe).”**

Ky ajet na qartëson pesë mirësi që All'Ilahu ua dha BeniIsrailëve. Në shtesë të tyre është edhe një mirësi e gjashtë, e cila përmendet në fillim të ajetit që vijon (ajeti 17).

Mirësia e parë është libri qiellor, domethënë Teurati, i cili sqaronte dietet fetare, hallallin, haramin dhe rrugën e udhëzimit dhe të lumturisë.

Mirësia e dytë është pozita e qeverisë dhe e gjykimit. Ne e dimë se ata zotëronin një qeveri të fortë dhe të madhe. E dimë se Daudi dhe Sulejmani nuk ishin gjykatësit e vetëm, por shumë prej Beni Israilëve kishin marrë frerët e qeverisjes në kohën e tyre.

Fjala “*el hukmu*” përdoret me kuptimin e gjykimit dhe të qeverisjes. Meqenëse pozita e gjykimit përbën gjithmonë një pjesë të programit të qeverisë, atëherë gjykatësi nuk mund ta kryejë detyrën e tij pa mbrojtjen e shtetit. Mbrojtja e shtetit tregon vendosmërinë ndaj çështjeve të caktuara dhe marrjen në dorë të frerëve të drejtimit të tyre.

Në ajetin e 44-ët të sures “El Maide” lexojmë për rëndësinë e Teuratit: “...**Sipas tij, Profetët që ia kishin dorëzuar veten All’Ilahut...**”.

Mirësia e tretë ishte profecia. All’Ilahu i Madhëruar ka përzgjedhur shumë Profetë nga Beni Israilët. Në një transmetim thuhet se numri i Profetëve të tyre ka qenë një mijë,¹ kurse në një transmetim tjetër thuhet se ka qenë katër mijë.²

Të gjitha këto ishin dhurata dhe mirësi nga All’Ilahu i Madhëruar.

Në **mirësinë e katërt**, ajeti na flet për një fjalë gjithëpërfshirëse. Kuptimi i saj përfshin të gjitha dhuratat materiale. Ajeti thotë: “...**Ne i begatuam ata me gjëra të mira...**”.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 113.

² “Biharul Anua”r, vëll. 11, f. 31, botimi i ri.

Mirësia e pestë është zhvillimi dhe forca e tyre. Atyre u ishte dhënë një zhvillim dhe forcë e madhe dhe nuk mund t'i konkurronte askush. Këtë e bën të qartë ajeti në mbyllje të tij, ku thotë **“...dhe i ngritëm mbi të gjithëpopujt e tjerë.”**.

Fjala *“el alemine”* përdoret për të treguar banorët e asaj kohe, sepse ajeti i 110-të i sures *“Ali Imran”* e thotë qartë: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin...”**.

Po kështu, ne e dimë se i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është më i nderuari i Pejgamberëve dhe i pari i tyre. Mbi këtë bazë themi se edhe ymeti i tij është gjithashtu nga popujt më të mirë. Kjo përmendet në ajetin 89 të sures *“En Nahl”*, ku thuhet: **“Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri i tyre, Ne do të të sjellim ty (Muhammed) dëshmitar kundër këtyre...”**.

Mirësia e gjashtë janë faktet, të cilat ua pati dhënë All'llahu i Madhëruar këtyre mohuesve. Ajeti thotë: **“Gjithashtu, Ne u dhamë urdhëzime të qarta mbi Fenë e vërtetë...”**.

Fjala *“el bejjinatu”* ka mundësi që të jetë treguese e mrekullive të qarta, të cilat All'llahu i Madhëruar ia pati dhënë Musait, të birit të Imranit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të gjithë Pejgamberëve të Beni Israilëve. Por kjo fjalë mund të tregojë edhe argumentet dhe faktet logjike të ligjeve dhe rregullave të përsosura.

Disa komentues janë shprehur se kjo fjalë mund të tregojë edhe shenjat e qarta, që lidhen me Profetin e Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për të cilat ata kishin njohuri dhe i kishin mundësitë që ta njihnin Profetin e

Islamit, ashtu siç njohin djemtë e tyre: **“Atyre që u kemi dhënë Librin, ata e njohin atë (Muhammedin) siç i njohin bijtë e vet.”**¹ Mundet që të përdoret edhe bashkimi i këtyre kuptimeve të ajetit.

Prania e të gjitha këtyre dhuratave, mirësive dhe argumenteve të mëdha, e qartëson tërësisht kuptimin e ajetit, i cili vijon: **“...por ata u përçanë, atëherë kur u erdhi dituria, pasi patën smirënë mes tyre....”**.

Ata filluan grindjet mes tyre, debatuan dhe u përçanë. Fuqia e tyre u dobësua dhe shteti i tyre i fortë u shkri. Ata i goditi poshtërimi dhe u degdisën në endacakë nëpër botë.

Disa komentues thonë se përçarja ndodhi pasi atyre u erdhi dija që t'i kuptonin plotësisht cilësitë e Pejgamberit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kur'ani i Shenjtë i kërcënon në fund të ajetit duke thënë: **“...Zoti yt, me siguri, do t'i gjykojë (ata) në Ditën eKiametit për kundërshtitë që patën.”**. Kështu, ata e humbën fuqinë dhe madhështinë e tyre në këtë botë. Ata i mohuan të gjitha mirësitë, u përçanë mes tyre dhe siguruan ndëshkimin e Ahiretit.

Pasi tregon se si Beni Israilët i mohuan dhuratat e All'llahut të Madhërueshëm, ajeti flet për një dhuratë të madhe, që All'llahu ia dha Profetit të Islamit dhe myslimanëve, ajeti thotë: **“Dhe tani, Ne të kemi vendosur ty në Rrugën e Drejtë të fesë...”**.

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 146.

Fjala “*esh sheriatu*” tregon rrugën që të çon drejt ujit të lumit, niveli i të cilit është më i ulët se bregu. Në kuptimin figurativ, kjo tregon rrugën që të çon drejt realizimit të qëllimit.

Përdorimi i kësaj fjale në kapitullin e fesë së vërtetë, është bërë për të treguar se ajo është rruga që të çon drejt burimit të Shpalljes, drejt kënaqësisë së All'Ilahut të Madhëruar dhe lumturisë së përhershme, që është njësoj si uji i jetës materiale.

Kjo fjalë është përdorur vetëm një herë në Kur'anin e Shenjtë dhe vetëm në çështjen e Islamit.

Me fjalën “*el emru*” nënkuptohet *feja e vërtetë*. Për këtë fjalë është folur edhe në ajetin e kaluar, ku thuhet: **“Gjithashtu, Ne u dhamë urdhëzime të qarta mbi Fenë e vërtetë...”**.

Kjo rrugë ishte rruga e shpëtimit dhe e fitores, prandaj All'Ilahu i Madhëruar e urdhëroi Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“...prandaj ndiqe atë...”**.

Meqenëse duhej demaskuar ndjekja e pasioneve të injorantëve dhe e dëshirave të tyre, ajeti në fund shton: **“...dhe mos shko pas dëshirave të atyre që nuk dinë!”**.

Në të vërtetë, ka vetëm dy rrugë: rruga e Pejgamberëve dhe e Shpalljes dhe rruga e dëshirave të injorantëve dhe e pasioneve të tyre. Në qoftë se njeriu i kthen shpinën të parës, do të bjerë në të dytën e do të ndahet nga vija e Pejgamberëve, do të largohet prej tyre. Me ndjekjen e asaj rruge, prishen, anulohen të gjitha lidhjet, programet, mësimet e Kur'anit dhe të burimit të Shpalljes së All'Ilahut.

Meritojnë të shihen me kujdes thëniet e disa komentuesve. Ata thonë se paria e kurejshëve erdhën te Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thanë: “Kthehu në fenë e baballarëve të tu, sepse ata kanë qenë më të mirë dhe më të drejtë se ti.”. Pas kësaj zbriti ajeti i mësipërm¹¹ dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili vazhdonte të jetonte në Mekë, u dha atyre këtë përgjigje: “*Rruga që të çon drejt të vërtetës është Shpallja qiellore, e cila ka zbritur mbi ju, e jo ajo nga anojnë pasionet e dëshirat e injorantëve.*”.

Udhëheqësit e singertë janë përballur gjithmonë me ngacmimet e injorantëve. Kur ata përcillnin mendime të pastra, injorantët i pyesnin: “A jeni më të ditur ju, apo etërit e hershëm e të mëdhenjtë që kanë qenë para jush?”. Ata vazhdonin me këmbëngulje në rrugën e ngacmimeve, duke u përpjekur të ndalonin thirrjen në të vërtetën. Në të tilla kushte, njeriu e ka të vështirë të ecë në rrugën e plotësimit dhe të përsosjes.

Ajeti që vijon më pas, konsiderohet si një thirrje për të mos u dorëzuar përpara propozimeve të idhujtarëve dhe për të mos pranuar kërkesat e tyre. Ajeti thotë: “**Ata nuk mund të të mbrojnë aspak nga zemërimi i All'llahut.**”, nëse nuk do të ndjekësh fenë e tyre të kotë dhe të përfshihesh në ndëshkimin e All'llahut të Madhëruar. Ata janë të pafuqishëm që të pengojnë ndihmën dhe mbështetjen tënde. Edhe sikur All'llahu i Madhëruar të rrëmbente prej teje një mirësi, ata janë të paaftë që ta rikthejnë atë tek ti.

Edhe pse biseda në këtë ajet i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ajo i nënkupton të gjithë besimtarët.

¹ Tefsiri “El Kebijr”, vëll. 27, f. 265.

Më pas, ajeti shton: **“Pa dyshim, të padrejtët kanë për mbrojtës njëri-tjetrin...”**, sepse të gjithë ata janë nga i njëjti lloj dhe zgjedhin të njëjtën rrugë. Modeli i tyre është një dhe të gjithë janë të dobët, të pafuqishëm.

Asnjëherë mos kujto se je i vetëm, apo se jeni një grup i vogël, e se nuk keni ndihmës. Përkundrazi, **“...kurse All’llahu është Mbrojtësi i atyre që i frikësohen Atij e që ruhen nga gjynahet...”**.

Është e vërtetë se numri i tyre është i madh në dukje dhe në duart e tyre kanë pasuri e fuqi të madhe. Mirëpo, e gjitha kjo nuk konsiderohet veçse një atom pa asnjë vlerë përballë fuqisë së pamasë të All’llahut të Madhëruar.

Ajeti i fundit është një garanci e sigurt e asaj që u tha më lart, është thirrje për ndjekjen e Fesë së Drejtë të All’llahut. Në ajet thuhet: **“Ky (Kur’ani) është tregues i qartë, udhërrëfyes dhe mëshirë përnjerëzit që kanë besim të patundur.”**.

Fjala *“el besairu”* përdoret për të treguar aspektet e shikimit, të mendimit dhe të pikëpamjeve intelektuale. Por këtu, ajo përdoret për të gjitha çështjet që janë baza, esenca e nocionit të kuptimeve dhe konceptimit të tyre.

E veçanta e këtij ajeti është thënia se, me të vërtetë, ky Kur’an është dritë e dijes, është syri i shikimit. Kur’ani nuk është vetëm dritë e një dijeje, por e shumë dijeve, të cilat e furnizojnë njeriun me mendime dhe pikëpamje të vërteta e të qarta për të gjitha fushat e jetës.

Me të njëjtin kuptim janë përmendur edhe shprehje të tjera në ajete të tjera të kur'anore. Ajeti 104 i sures "El En'am" thotë: **"Juve ju erdhën argumente të qarta nga Zoti juaj."**

Në këtë ajet janë shtruar tri tema diskutimi: argumentet, udhëzimi dhe mëshira. Ato janë të bashkërenduara në marrëdhënie të shkakut dhe pasojës në raport me njëra-tjetrën, sepse argumentet e qarta dhe sheriatit i parashikuar, e shtyjnë njeriun drejt udhëzimit, e udhëzimi në vetvete, është esenca, baza e mëshirës së All'Ilahut.

Ajeti thotë se argumentet janë për të gjithë njerëzit, kurse udhëzimi dhe mëshira janë për njerëzit e bindur plotësisht. Ajetet kur'anore janë këshillë për të gjithë njerëzit në çdo kohë dhe në çdo vend, për ata që kanë hyrë në Rugën e Drejtë, kurse udhëzimi dhe mëshira u përkasin të bindurve; pra, jo të gjithëve.

Sidoqoftë, thënia e ajetit se Kur'ani është drita e dijes, dritë e udhëzimit dhe e mëshirës, është një mënyrë e bukur e të shprehurit, e cila u tregon madhësinë e këtij libri qiellor, efektin dhe thellësinë e tij, atyre që kanë zgjedhur rrugën e tij dhe që kërkojnë të vërtetën.

Ajetet 21-23

أَمْ حَسِبَ الَّذِينَ اجْتَرَحُوا السَّيِّئَاتِ أَنْ نَجْعَلَهُمْ كَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَوَاءً مَحْيَاهُمْ وَمَمَاتُهُمْ سَاءَ مَا يَحْكُمُونَ ۚ وَخَلَقَ اللَّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ وَلِتُجْزَىٰ كُلُّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ۚ أَفَرَأَيْتَ مَنِ اتَّخَذَ إِلَٰهَهُ هَوَاهُ وَأَضَلَّهُ اللَّهُ عَلَىٰ عِلْمٍ وَخَتَمَ عَلَىٰ سَمْعِهِ وَقَلْبِهِ وَجَعَلَ عَلَىٰ بَصَرِهِ غِشَاوَةً فَمَنْ يَهْدِيهِ مِنْ بَعْدِ اللَّهِ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ۚ

“A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se Ne do t’i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë? Sa keq që gjykojnë ata!”

“All’Ilahu i krijoi qiejt dhe Tokën me qëllim të plotë, në mënyrë që çdo njeri të jetë i shpërblyer për atë që ka punuar. E, askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”

“Mendo pak! Kush, përveç All’Ilahut, mund ta udhëzojë atënjëri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njëri, të cilin All’Ilahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh?”

Komentimi

Nuk janë të barabartë në jetën dhe në vdekjen e tyre

Në vazhdim të ajeteve të kaluara, ku u diskutua rreth dy grupeve: besimtarëve dhe jobesimtarëve, apo të devotshmëve dhe kriminelëve, ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, i ka bashkuar këto dy grupe në një krahasim parimor midis tyre ku thotë: **“A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se Ne do t’i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë? Sa keq që gjykojnë ata!”**.

A mund të barazohet drita me errësirën, dituria me injorancën, e mira me të shëmtuarën dhe besimi me mohimin?!

A mund të jetë i barabartë rezultati i këtyre çështjeve të pakrahasueshme?!

Kurrë, sepse besimtarët që kanë bërë vepra të mira, janë ndryshe nga kriminelët mohues. Ata dallojnë prej tyre në çdo gjë. Besimi dhe mohimi, vepra e mirë dhe e keqe, i japin nuancat e ngjyrës së tyre gjatë gjithë jetës.

Ky ajet është njësoj si ajeti 28 i sures “Sad”, ku thuhet: **“A t’i trajtojmë njëllor ata që besojnë e bëjnë vepra të mira dhe turbulluesit në Tokë?! A t’i trajtojmë njëllor njerëzit e devotshëm dhe njerëzit e mbrapshtë?!”**.

E njëjta gjë thuhet edhe në ajetet 35 dhe 36 të sures “Kalem”: **“Vallë, a t’i trajtojmë ata që Na nënshtrohen njësoj me**

keqbërësit?! Çfarë keni ju (jobesimtarë)? Si po gjykoni kështu?!".

Fjala "*ixhterehu*" në origjinë vjen nga fjala "*el xherhu*", plaga e shkaktuar te trupi i njeriut nga ndonjë goditje në trupin e njeriut. Meqenëse bërja e mëkateve dhe gjynaheve është plagosje për shpirtin e mëkatarit e gjynahqarit, atëherë kjo fjalë është përdorur edhe për bërjen e gjynaheve. Nga njëherë përdoret me kuptim më të gjerë që përfshin çdo veprim. Edhe pjesët e trupit të njeriut quhen "*el xheuarih*" sepse nëpërmjet tyre njeriu arrin synimet dhe dëshirat e tij si dhe vepron atë që dëshiron.

Ajeti thotë: Është gabim të mendohet se besimi dhe vepra e mirë, apo mohimi dhe mëkati, nuk i lënë gjurmët e tyre në jetën e njeriut, sepse vërtet jeta dhe vdekja e këtyre dy grupeve ndryshojnë plotësisht.

Besimtarët kënaqen dhe përjetojnë një qetësi të veçantë nën hijen e besimit dhe punës së mirë. Besimi dhe puna e mirë nuk shkaktojnë në shpirtat e tyre situata të rënda e të vështira, kurse jobesimtarët që e kanë ndotur veten me mëkate, janë të shqetësuar gjithmonë. Edhe nëse janë në begati, ata janë të frikësuar se mos e humbasin atë; por dhe nëse janë në fatkeqësi, ata nuk kanë fuqi që të përballen me të.

Ajeti 82 i sures "*El En'am*" e përshkruan kështu gjendjen e besimtarëve: **"Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi, pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar."**

Besimtarët janë të sigurt për premtimet e All'llahut të Madhëruar: **"Sigurisht, Ne do t'i ndihmojmë të Dërguarit Tanë**

dhe besimtarët, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në Ditën, kur do të sillen dëshmitarët.”¹

Do t’i ndihmojmë, sepse drita e udhëzimit ndriçon zemrat e grupit të parë dhe bën që të lindë në to drita e Zotit të Lartësuar. Kështu, ata ecin me hapa të qëndrueshëm drejt qëllimit të tyre të shenjtë: **“All’Ilahu është mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë.”**²

Grupi i dytë nuk kanë një synim të qartë për të arritur. Ata nuk kanë as një udhëzim të qartë që të ndjekin. Përkundrazi, ata janë të dehur nga dallgët e dyshimit, të cilat i zhysin në detin e humbjes e të mohimit: **“E kujdestarë të atyre që nuk besuan, janë djajtë që i nxjerrin ata prej drite dhe i hedhin në errësi.”**

Kështu ndodh në jetën e kësaj bote, kurse vdekja është dritarja që na tregon Botën e Përhershme dhe dera e Ahiretit.

Gjendja është siç përshkruhet në ajetin 32 të sures “En Nahl”, ku thuhet: **“të cilëve engjëjt ua marrin shpirtat, duke qenë të pastër. U thonë atyre: ‘Shpëtimi qoftë mbi ju!’ Hyni në Xhennet, si shpërblim për veprat që keni kryer!”**.

Ajeti 29 i sures “Nahl” tregon se kriminelët jobesimtarë, flasin me ta në një mënyrë tjetër: **“të cilëve engjëjt ua marrin shpirtin, duke qenë të padrejtë ndaj vetvetes. Ata do të shfaqin përulshmëri (duke thënë): ‘Ne nuk kemi bërë asgjë të keqe!’.** (Dhe do t’u thuhet): **‘Nuk është kështu! Natyrisht që All’Ilahu i di mirë veprat që keni punuar. Hyni në portat e Xhehennemit,**

¹ Sure “Gafir”, ajeti 51.

² Sure “El Bekare”, ajeti 257.

ku do të mbeten i përgjithmonë!'. Eh, sa vendbanim i shëmtuar është ai për mendjemëdhenjtë!''.

Si përfundim, mund të themi se mosmarrëveshjet dhe përçarja janë të pranishme mes këtyre grupeve në të gjitha aspektet e jetës dhe të vdekjes, janë të pranishme edhe në Botën e Ndërmjetme dhe në Kiamet.¹¹

Ajeti në vijim është komentim i të kaluarës dhe analizë e saj. Në të thuhet: **“All’llahu i krijoi qiejt dhe Tokën me qëllim të plotë, në mënyrë që çdo njeri të jetë i shpërblyer për atë që ka punuar. E, askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”**, sepse e gjithë bota tregon se Krijuesi i saj e ka krijuar dhe e ka ngritur atë mbi rrathët e të vërtetës, që mbi të, të mbizotërojë drejtësia dhe e vërteta. Nëse çështja është e tillë, atëherë si mundet që ata që besuan dhe bënë vepra të mira, All’llahu t’i krahasojë, t’i konsiderojë njësoj si kriminelët dhe jobesimtarët dhe kjo çështje të jetë e përjashtuar nga ligji i krijimit?!

Nga ky koment bëhet e qartë se ‘drejtësia’ nuk nënkupton ‘barazinë’; përkundrazi, ‘drejtësi’ do të thotë që secili të marrë atë që meriton prej dhuratave dhe mirësive, sipas mundësive dhe aftësive të tij.

¹¹Për komentimin e fjalisë: **“se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë”**, që përmendet në ajetin e parë të ajeteve në fjalë, ka disa mendime të tjera. Në njërin prej tyre thuhet se ajo që nënkuptohet nga kjo fjali është se vdekja e kriminelëve dhe jobesimtarëve dhe jeta e tyre janë një. Nuk kanë ndryshime, sepse në to nuk ka mirësi. Ata janë të gjallë, por në të vërtetë janë të vdekur. Nga kjo rrjedh se të dy përemrat u referohen kriminelëve.

Sipas një mendimi tjetër, ajo që nënkuptohet nga jeta është Dita e Kiametit. Që do të thotë se besimtarët dhe jobesimtarët nuk janë të barabartë në vdekje dhe as kur të ringjallen në Ditën e Kiametit.

Pra, ajeti i fundit prej këtyre ajeteve, është një qartësim dhe sqarim, është një analizë tjetër që tregon mungesën e barazisë midis jobesimtarëve dhe besimtarëve. Ajeti thotë: **“Mendo pak! Kush, përveç All’llahut, mund ta udhëzojë atënjëri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njëri, të cilin All’llahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh?”**.

Këtu, vetvetiu shtrohet pyetja: Si mundet, që njeriu të marrë dëshirën e tij për zot?!

Por është e qartë si kristali, se kur njeriu injoron e shmang urdhrat e All’llahut të Madhëruar dhe ndjek atë që i diktojnë pasionet e tij, kur vë në plan të parë bindjen ndaj dëshirës së tij, përkundër bindjes ndaj All’llahut të Madhëruar dhe këtë e konsideron si të drejtë, atëherë ai ka adhurar dëshirën e tij. Në Kur’anin e Shenjtë është përmendur shumë adhurimi i shejtanit, apo adhurimi i rabinëve çifutë. Për shembull, në ajetin 60 të sures “Jasin” thuhet: **“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuroni djallin, se ai është vërtet armik i hapët i juaji”**.

Në ajetin 31 të sures “Teube” thuhet: **“Në vend të All’llahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre...”**.

Në një hadith të dy imamëve, Bakirit dhe Sadikut (*Paqja e Zotit qoftë mbi ata të dy!*), thuhet: *“Për Zotin, ata nuk agjëruan për ta*

dhe as nuk iu falën atyre, por ua lejuan atyre haramin e ua ndaluan hallallin, i ndoqën dhe i adhuruan pa e ndjerë.”¹

Disa komentues e kanë konsideruar këtë si një shprehje treguese për paganët kurejshitë, të cilët nëse e dëshironin apo u pëlqente një gjë, e bënë në formën e një statuje dhe më pas e adhuronin dhe e madhëronin. Sa herë që shihnin një gjë tjetër që u pëlqente më shumë se statuja e tyre që bënë, e braktisnin të parën dhe adhuronin të dytën. Kështu, ata merrnin për zot të tyre atë gjë që u pëlqente më shumë.²

Mirëpo shprehja: **“...që dëshirat e veta i ka bërë zot...”**, është më në harmoni me komentimin e parë.

Kurse për fjalinë **“...të cilin All’llahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje...”**, komentimi i njohur është se All’llahu i Madhëruar i ka humbur ata, sepse Ai e di që ata nuk e meritonin udhëzimin. Kjo tregon se këta i kanë fikur me duart e veta të gjitha dritat e udhëzimit, i kanë shkatërruar ato, i kanë mbyllur të gjitha rrugët e shpëtimit, i kanë shkatërruar të gjitha urat e kthimit mbrapa në Rrugën e Drejtë. Në këtë rast, All’llahu i Lartësuar e ka tërhequr mëshirën dhe mirësinë e tij prej tyre, ua ka hequr atyre fuqinë, i ka lënë në errësirë, ua ka vulosur zemrën dhe dëgjimin dhe në shikimet e tyre ka vënë perde.

E gjitha kjo nuk është gjë tjetër, veçse gjurmë e asaj që kanë planifikuar këta si rrugë të vërtetë të tyre, si dhe një rezultat i turpshëm i zgjedhjes prej tyre, të zotave të tjerë për adhurim.

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 2, f. 209.

² Tefsiri “Ed Durr’rrul Menthur”, vëll. 6, f. 35.

Në të vërtetë, nuk ka gjë më të rrezikshme sesa ndjekja e dëshirës dhe e nefsit. Ajo i mbyll të gjitha dyert e mëshirës dhe rrugët e shpëtimit.

Hadithi i transmetuar nga i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është shumë elokuent dhe i thellë. Në të thuhet: *“Poshtë qiellit, nuk është adhuruar asgjë më e urryer tek All'llahu sesa adhurimi i egos.”*¹

Disa komentues thonë se kjo fjali tregon se ndjekësit e pasionit dhe të dëshirës e kanë zgjedhur rrugën e humbjes si rrugë të tyre, madje duke e ditur mirë këtë, sepse dituria nuk mund të krahasohet gjithmonë me udhëzimin, ashtu siç nuk mund të merret gjithmonë humbja si shembull i injorancës.

Dituria me të cilën njeriu kapet fort pas domosdoshmërive, pas nevojave të tij, është baza e udhëzimit. Prandaj, njeriu e ka për detyrë të arrijë në destinacionin e tij, të arrijë qëllimin e tij, të lëvizë në rrugën e kësaj diturie dhe të mos bëhet si jobesimtarët kokëfortë, për të cilët Kur'ani ka thënë me të drejtë: **“Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi.”**²³

Komentimi i parë, - i shoqëruar me shënimin se përemrat në ajet i referohen All'llahut të Madhëruar, - është më i përshtatshëm. Kjo, për shkak se ajeti thotë: **“duke e ditur, All'llahu e ka humbur atë, ia ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën e tij...”**.

¹ Tefsiri “El Kurtubij”, vëll. 9, f. 5987; tefsiri “Ruhul Bejan” dhe tefsiri “El Muragij”, fundi i ajeteve në fjalë.

² Sure “En Neml”, ajeti 14.

³ Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 18, f. 173.

Nga sa u tha më lart, bëhet e qartë se ajeti nuk flet për rrymën e fatalizmit, përkundrazi është garanci për origjinën e zgjedhjes dhe të përcaktimit të rrugës nga vetë njeriu.

Kemi përmendur diskutime, analiza dhe qartësime të shumta rreth vulosjes së zemrës së njeriut, rreth mbylljes së dëgjimit dhe vënies së perdes nga All'llahu i Madhëruar. Kjo gjë thuhet edhe në fundin e ajetit 7 të sures "El Bekare".¹

Hulumtime

1- Njëri nga idhujt më të rrezikshëm është egoja

Në një hadith më lart mësuam se një nga zotat më të urryer tek All'llahu, është egoja. Kur themi kështu, nuk e teprojmë aspak, sepse idhujt e zakonshëm janë krijesa pa ndjenja e karakteristika të tyre, pa cilësi ndikuese të rëndësishme, kurse idhulli i dëshirës e mashtron njeriun dhe e orienton drejt kryerjes së mëkateve të ndryshme, të cilat e çojnë drejt shmangies.

Përgjithësisht, mund të themi se idhulli i dëshirës ka karakteristika që e bëjnë atë më të urryerin, sepse i zbukuron veprat e këqija në shikimin e njeriut, derisa të arrijë në shkallën që ai të mburret kur i bën ato. Kështu konfirmohet Fjala e të Madhërishmit: **"për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në**

¹Ky tefsir, fundi i ajetit 7 të sures "El Bekare".

jetën e kësajbote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?”¹.

2- Ndjekja e egos është rruga më e pëlqyeshme e depërtimit të shejtanit

Shejtani nuk ka asnjë forcë që ta ngacmojë dhe ta shtyjë njeriun drejt shmangies dhe mëkatit, përveçse ta nxisë atë që të ndjekë egon e tij. Pikërisht kjo gjë, pra ndjekja e egos, e ka rrëzuar dhe e ka shkatërruar shejtanin, e ka dëbuar atë nga rreshti i engjëjve dhe e ka larguar nga pozita e të qenit afër me All’llahun.

3- Ndjekja e egos largon nga njeriu, një nga mënyrat më të rëndësishme të udhëzimit

Bëhet fjalë për perceptimin e drejtë të të vërtetave. Ndjekja e dëshirës vendos një perde në logjikën dhe në syrin e njeriut. Këto ajete na kanë qartësuar ndjekjen e dëshirës dhe respektimin e saj si zot. Ajetet e tjera të Kur’anit e dëshmojnë këtë të vërtetë.

4- Ndjekja e egos e çon njeriun drejt luftimit të All’llahut

Me ndjekjen e egos u sprovua prijësi i adhuruesve të egos, shejtani i mallkuar, i cili kundërshtoi urtësinë e All’llahut të Madhëruar, kur Ai e urdhëroi atë që t’i bënte sexhde Ademit. Shejtani e konsideroi atë si një urdhër të zhveshur nga urtësia.

¹ Sure “Kehf”, ajeti 104.

5- Ndëshkimet e ndjekjes së egos

Do të mjaftonte vetëm një çast, që të tundohesh dhe të ndjekësh dëshirat. Prandaj, duhet të jemi të rezervuar, të kujdesshëm e të zgjuar në këtë çështje. Edhe paralajmërimi i All'llahut të Madhëruar në ajetet kur'anore dhe në transmetimet islame është shumë i ashpër në lidhje me këtë.

Në një hadith të njohur nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Ajo që kam më tepër frikë për ymetin tim, është (ndjekja) e dëshirës dhe shpresa e zgjatur në kohë, sepse dëshira, egoja, e bllokojnë të vërtetën, kurse shpresa e gjatë bën që të harrohet Ahireti.”¹

Në një hadith tjetër nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet se ai është pyetur: “Cili sulltan është më triumfues dhe më i fortë?” Ai tha: “Egoja.”²

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Imam Zejnul Abidin (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Betohem në fuqinë dhe madhësitinë Time, për lavdin dhe shkëlqimin Tim, për pozitën Time të lartë, se asnjë krijesë kërkesat e mia nuk i vë primare nga vetja, përpjekjet e tij do të shpërblehen në Ahiret dhe në zemrën e tij do të vendos panevojshmërinë. Do ia lehtësoj sigurimin e jetesës dhe rriskun e tij do t'ia garantoj në tokë e në qiell. Mirësitë e kësaj bote do të vijnë tek ai me përlësi.”³

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: “Frikësoju nga egoja dhe dëshirat e nefsit (shpirtit) ashtu sikurse frikësohesh nga armiku, sepse nuk ka armik më të keq për njeriun se sa ndjekja e dëshirave të nefsit dhe çka del nga goja.”⁴

¹“Biharul Anuar”, vëll. 70, f. 75, 76, 77.

²“Biharul Anuar”, vëll. 70, f. 75, 76, 77.

³ Po aty.

⁴“Usulul Kafij”, vëll. 2, f. 335 (kapitulli i ndjekjes së egos, hadithi 1).

Sërish, në një hadith tjetër përcillet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Unë do të dëshiroja shpëtimin e këtij ymeti, të shpëtoja këdo që e njeh të drejtën tonë, përveç këtyre të treve: të fortin (të padrejtin), tiranin dhe pasuesin e dëshirës, të shthururin e deklaruar.”¹

Në këtë kapitull ka ajete dhe transmetime të shumta me përmbajtje të pasur.

Në mbyllje po pëmendim një ngjarje me kuptim të thellë. Këtë ngjarje e kanë përmendur disa komentues si shkak i zbritjes si dhe dëshmi për atëqëpo themi. Njëri nga komentueist thotë: “Një natë, Ebu Xhehli bëri tavaf në Qabe. Bashkë me të ishte edhe Uelijd ibn Mugijretu. Ata biseduan për çështjen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ebu Xhehli i tha: “Për Zotin, unë e di mirë se ai thotë të vërtetën.”

Uelijdi i tha atij: “Eh. Po kush të tregoi ty për këtë?”

Ebu Xhehli u përgjigj: “O Aba Shems. Kur ishte i ri ne e quanim atë besniku dhe i vërteti. Dhe kur atij iu plotësua mendja dhe pjekuria, ne e quajmë gënjeshtarë, mashtrues! Për Zotin, unë e di se ai është i vërtetë në atë që thotë.”

Uelijdi i tha: “Çfarë të pengon që ta pranosh dhe t’i besosh atij?” Ebu Xhehli iu përgjigj: “Flasin për mua vajzat e kurejshitëve, se unë ndjek jetimin e Ebu Talibit për shkak se më ka shpartalluar! Pasha Latin dhe Uzanë, nuk do ta ndjek kurrë atë!”

Për të sqaruar këtë çështje, zbriti ajeti: “**...ia ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën e tij...**”²

¹“Biharul Anuar”, vëll. 70, f. 76.

² Tefsir“El Muragij”, vëll. 25, f. 27.

Ajetet 24-25

وَقَالُوا مَا هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا نَمُوتُ وَنَحْيَا وَمَا يُهْلِكُنَا إِلَّا الدَّهْرُ
وَمَا لَهُمْ بِذَلِكَ مِنْ عِلْمٍ إِنْ هُمْ إِلَّا يَظُنُّونَ، وَإِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُنَا
بَيِّنَاتٍ مَا كَانَ حُجَّتَهُمْ إِلَّا أَنْ قَالُوا اتُّوا بِآبَائِنَا إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ،

“Ata thonë: Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim ejetojmë dhe vetëm koha na shkatërron. Ata nuk kanë kurrfarëdijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.”

“Kur atyre u lexohen Shpalljet Tona të qarta, argumenti i tyre i vetëm është: Ringjallni të parët tanë, nëse thoni të vërtetën!”

Komentimi

Doktrinat e ateistëve

Në këto ajete diskutohet rreth mohuesve të Teuhidit. Në to është përmendur emri i një grupi të veçantë prej tyre. Në këtë grup hyjnë ateistët, të cilët e mohojnë në mënyrë absolute ekzistencën e një krijuesi të mençur të botës së ekzistencës, në një kohë kur shumica e idhujtarëve besonin dukshëm në Zot dhe i konsideronin idhujt si ndërmjetës tek Ai. Ajeti i parë thotë: **“Ata**

thonë: Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë...". Pra, njerëzit lindin dhe vdesin duke bërë që kështu të vijojë qenia njerëzore: **"...dhe vetëm koha na shkatërron..."**. Me këtë thënie, ata mohojnë Ahiretin, ashtu siç mohojnë edhe zanafillën. Fjalja e parë dëshmon mohimin e Ahiretit prej tyre, kurse fjalja e dytë mohon zanafillën.

Meriton të vërehet me kujdes fakti, se kjo mënyrë të shprehuri është përmendur në dy ajete të tjera nga ajetet e Kur'anit dhe pikërisht në ajetin 29 të sures "El En'am", ku thuhet: **"Ata thoshin: 'S'ka tjetër, përveç jetës në këtë botë dhe ne nuk do të ringjallemi'"**, si dhe në ajetin 37 të sures "El Mu'minun", ku thuhet: **"Nuk ka Jetë Tjetër përveç jetës së kësaj bote, ne jetojmë e vdesim e nuk do të ringjallemi më."**

Në të dy ajetet është përmendur vetëm mohimi i Ahiretit dhe ky mohim nuk përmendet bashkë me mohimin e zanafillës. Kjo ndodh vetëm në këtë ajet që po komentojmë.

Është e qartë se këta komentues fokusoheshin më shumë tek Ahireti sesa te zanafilla. Këtë e bënin nga frika e tyre se mohimi i zanafillës mund t'ua ndryshonte rrjedhën e jetës të mbushur me pasione, të cilave u ishin dorëzuar.

Komentuesit kanë dhënë disa mendime për fjalinë: **"...vdesim e jetojmë..."**:

1- Njerëzit largohen nga kjo botë, vdesin dhe vendin e tyre e zënë të lindurit.

2- Kuptimi i fjalisë është: *Ne lindim dhe vdesim dhe nuk ka asgjë tjetër, përveç kësaj jete dhe vdekjeje.*

3- Disa vdesin, kurse disa të tjerë mbeten gjallë, edhe pse të gjithë do të vdesin në fund.

4- Ne në fillim kemi qenë të vdekur, pra nuk ka pasur jetë, shpirt, brenda nesh. Më pas na u dha jeta dhe u bëmë të gjallë.

Komentimi i parë është më i përshtatshmi dhe më i parapëlqyeri.

Megjithatë, një grup materialistësh besonin se krijuesi është koha. Një grup tjetër mendonte se krijues është rrotullimi i galaktikës dhe pozicionimet e planeteve. Ata besonin se çdo gjë që ndodh në këtë botë, ndodh për shkak të këtij rrotullimi.¹

Pa dyshim që këto besime të trilluara e humbën kuptimin e tyre me kalimin e kohës. Në mënyrë të veçantë, me përparimin e shkencës së astronomisë, këto njohuri u qartësuan.

Materialistët dhe ateistët e qortonin dhe e shanin ndonjëherë kohën kur ndodhnin ngjarje të hidhura dhe të dhimbshme. Kjo është përmendur në hadithe profetike, në një prej të cilëve, Profeti më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mos e shani me fjalë të këqija kohën, sepse me të vërtetë, All'llahu është vetë koha.”² Kjo thënie tregon se koha është vetëm një shprehje, kurse All'llahu i Madhëruar është kontrolluesi dhe drejtuesi i kësaj bote. Prandaj, nëse ju thoni fjalë të këqija për kontrolluesit e kësaj bote dhe

¹ Disa komentues kanë dhënë një mendim të pestë në komentimin e kësaj fjalie. Ai mendim është: Kjo fjali tregon për rimishërimin, për të cilin besonin një grup paganësh. Ata thonin: Me të vërtetë, ne vdesim e më pas ringjallemi në trupa të tjerë në këtë botë. Mirëpo ky komentim nuk harmonizohet me fjalinë: “...dhe vetëm koha na shkatërroi...”, e cila flet vetëm për shkatërrimin dhe zhdukjen. (Mendo thellë!)

² Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 9, f. 78.

drejtuesit të saj, pa dyshim që keni folur keq për All'llahun e Madhëruar, pa e kuptuar fare këtë.

Dëshmues për këtë fjalë është një hadith tjetër, i transmetuar si *hadith kudsij* nga All'llahu i Madhëruar, në të cilin thuhet: “*Më lëndon Mua i biri i Ademit me sharjen e kohës, e Unë jam vetë koha! Në dorën Time është çështja, e ndryshoj natën dhe ditën.*”¹

Në këtë kontekst, fjala “kohë” ka dy kuptime: koha në kuptimin e orbitave, galaktikave dhe ditëve, për të cilën interesoheshin ateistët, e që e mendonin atë si gjykatëse të sistemit të ekzistencës dhe jetës së njerëzimit, si dhe koha në kuptimin e njerëzve të epokës në të cilën jetonin.

Është e natyrshme se koha në kuptimin e parë është një çështje imagjinare. Ose themi se është një mënyrë e gabuar e të shprehurit, ku fjala “*ed dehu*” – “*koha*”, është përdorur në vend të fjalës All'llahu, i Cili është i Larti dhe Sunduesi i gjithçkaje. Ndërsa koha në kuptimin e dytë është ajo të cilën e kanë qortuar shumë prijësa të mëdhenj, sepse ata i shihnin njerëzit e kohës së tyre si mashtrues, të pavendosur dhe që nuk i zbatonin premtimet.

Kur’ani Kerim u është përgjigjur këtyre opinioneve absurde me një fjali të shkurtër dhe përmbledhëse, ku thuhet: **“...Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.”**

I njëjti kuptim përmendet edhe në ajetin 28 të sures “En Nexhm”, i cili flet për ata që hamendësojnë se engjëjt janë bijat e

¹ Tefsiri “El Kurtubij”, vëll. 9, f. 5991.

All'llahut të Madhëruar: **“Ata nuk kanë asnjë njohuri për këtë, por ndjekin vetëm hamendjen, ndonëse hamendja nuk mund ta zëvendësojë aspaktë vërtetën.”**

Ky kuptim është përmendur gjithashtu, kur është diskutuar për vrasjen e Mesihut, në suren “En Nisa”, ajeti 157, si dhe për besimin e idhujtarëve arabë në idhuj, surja “Junus”, ajeti 66.

Ky është argumenti më i qartë e më i thjeshtë, që tregon se ata nuk kanë asnjë dëshmitar, apo argument logjik për këtë pohim, por mbështeten vetëm në argument imagjinar dhe në hamendje.

Ajeti në vijim tregon një nga justifikimet imagjinare dhe argumentimet e tyre të zbrazëta, të kota për Ahiretin. Ai thotë: **“Kur atyre u lexohen Shpalljet Tona të qarta, argumenti i tyrei vetëm është: Ringjallni të parët tanë, nëse thoni të vërtetën!”**

Këta thonë shpesh se në qoftë se ka qenë e vërtetë jeta e të vdekurve dhe ringjallja e tyre, atëherë na i ringjallni prindërit tanë. Kjo ringjallje do të shërbente si argument i pohimeve tuaja dhe ne do të kuptojmë se sa të singertë jeni. Ne do t'i pyesim ata se çfarë ndodh pas vdekjes. Ata do ta konfirmojnë atë që ju thoni, ose do ta përgënjeshtrojnë.

Ky është argumenti i tyre, por është një argument i rremë dhe i zbrazët, sepse All'llahu i Madhëruar ia ka bërë të qartë njerëzimit fuqinë e Tij në ringjalljen e të vdekurve në mënyra të ndryshme, siç ua ka bërë të qartë edhe krijimin e njeriut të parë nga dheu, edhe shndërrimet e çuditshme të pikës së ujit në mitrën e nënës, edhe krijimin e zgjeruar të qiellit dhe të tokës, edhe ringjalljen e tokave të vdekura pas zbritjes së shirave mbi to. Të

gjitha këto janë përmendur si argumente të gjalla dhe konkrete, që tregojnë edhe mundësinë e ndodhjes së Kiametit dhe ringjalljes së re. Pas gjithë këtij sqarimi, nuk ka më nevojë për argumente të tjera.

Duke mos e përfillur këtë, ata vërtetuan se nuk kishin qëllim tjetër, vetëm se të kërkonin pretekste dhe lutje, kërkesa për të faktuar dhe për të vazhduar në humbjen dhe besimin e tyre të shmangur, sepse po t'u shfaqej një pamje e ringjalljes së të vdekurve, ata do të thonin menjëherë “Kjo është magji”, ashtu siç kanë thënë në raste të ngjashme.

Fjala “*huxhetun*” – “*fakt, argument*”, përdoret për të treguar se kuptimi i një fjale është bosh, i zbrazët. Pra, është një metaforë, që në këtë rast tregon se ata nuk kanë asnjë argument tjetër për këtë çështje. Pretendimet e tyre janë boshe.

Ajetet 26-32

قُلِ اللَّهُ يُحْيِيكُمْ ثُمَّ يُمِيتُكُمْ ثُمَّ يَجْمَعُكُمْ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ لَا رَيْبَ فِيهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ^{٢٦} وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ يُحْسِرُ الْمُبْطِلُونَ^{٢٧} وَتَرَى كُلَّ أُمَّةٍ جَائِيَةً كُلُّ أُمَّةٍ تُدْعَى إِلَى كِتَابِهَا الْيَوْمَ تُجْزَوْنَ مَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ^{٢٨} هَذَا كِتَابُنَا يَنْطِقُ عَلَيْكُمْ بِالْحَقِّ إِنَّا كُنَّا نَسْتَنْسِخُ مَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ^{٢٩} فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَيُدْخِلُهُمْ رَبُّهُمْ فِي رَحْمَتِهِ ذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْمُبِينُ^{٣٠} وَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا أَفَلَمْ تَكُنْ آيَاتِي تُتْلَى عَلَيْكُمْ فَاسْتَكْبَرْتُمْ وَكُنتُمْ قَوْمًا مُّجْرِمِينَ^{٣١} وَإِذَا قِيلَ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ وَالسَّاعَةُ لَا رَيْبَ فِيهَا قُلْتُمْ مَا نَدْرِي مَا السَّاعَةُ إِنْ نُنْظَرُ إِلَّا ظَنًّا وَمَا نَحْنُ بِمُستَيْقِنِينَ^{٣٢}

“Thuaju: All’lillahu jua jep jetën, pastaj ju bën të vdisni e mandej do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit e për këtë nuk ka kurrfarë dyshimi; por shumica e njerëzve nuk e dinë.”

"I All'lahut është pushteti i qiejve dhe i Tokës! E kur të arrijë Ora (e Kiametit), atë ditë mohuesit do të humbasin."

"Atëherë të gjithë popujt do t'i shohësh të gjunjëzuar. Çdo popull do të thirret në Librin e vet (e do t'i thuhet): Sot do të shpërbleheni për atë që keni bërë."

"Ky është Libri Ynë, që do t'ju tregojë të vërtetën. Ne i kemi urdhëruar (engjëjt) që të shkruajnë të gjitha ç'keni bërë."

"Përsa u përket atyre që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, ata do t'i pranojë Zoti i tyre në mëshirën e Vet. Kjo është fitorja e lavdishme!"

"Ndërsa mohuesve do t'u thuhet: Vallë, a nuk ju janë lexuar Shpalljet Mia?! Por ju shfaqët mendjemadhësi dhe u bëtë njerëz të këqij."

"Dhe, kur juve ju thuhej: Premtimi i All'lahut është i vërtetë: Ora (e Kiametit) pa dyshim që do të vijë! - ju thoshit: Ne nuk e dimë ç'është Ora (e Kiametit). Ne mendojmë se është vetëm një hamendje, prandaj nuk jemi të bindur."

Komentimi

Të gjithë janë të gjunjëzuar përpara Gjykatës së Drejtësisë së All'Ilahut

Këto ajete janë një përgjigje tjetër ndaj fjalës së ateistëve, të cilët e mohojnë Zanafillën dhe Ahiretin. Në ajetet e mëparshme është treguar se çfarë thonin ata. Ajeti i parë thotë në fillim: **“Thuaju: All'Ilahu jua jep jetën, pastaj ju bën të vdisni e mandej do t'ju tubojë në Ditën e Kiametit e për këtë nuk ka kurrfarë dyshimi...”**.

Këta nuk besuan në All'Ilahun dhe as në Ditën e Fundit, Kiametin. Pikërisht, përmbajtja e këtij ajeti është argumentimi i këtyre dy mohimeve. Sigurisht që këta nuk mundën të mohojnë origjinën e ekzistencës së jetës dhe krijimin e gjallesave të gjalla dhe gjallesave të vdekura. Nga njëra anë, ky është argumenti i ekzistencës së një mendjeje dhe logjike universale gjithëpërfshirëse, e cila ka bërë të mundur që të ekzistojë jeta në këtë organizim të përsosur, me të fshehta të ndërlikuara e të çuditshme, të cilat kanë magjepsuar mendjet e të gjithë shkencëtarëve. A mund të ndodhin këto, pa pasur një krijues të aftë e të ditur?!

Ajete të ndryshme të Kur'anit e mbështesin fort çështjen e jetës, si një nga argumentet e Njehsimit dhe si fakti më i qartë i Krijuesit.

Nga ana tjetër, atyre u thuhet: “Si është e mundur, që Ai, i Cili është i aftë, i fuqishëm, që krijon jetën së pari, të jetë i pafuqishëm për ta rikthyer atë edhe për së dyti?!”.

Fjala **“...nuk ka kurrfarë dyshimi...”** (nënkupton se nuk ka dyshim në Kiametin), na lajmëron se Kiameti do të ndodhë me siguri. Edhe kjo është tregues i ligjit hyjnor të drejtësisë, i cili jep drejtësi absolute. Ai ligj nuk lejon që të ndodhë si në jetën e kësaj bote, ku askush që ka pasur të drejtë, nuk e ka marrë të drejtën e tij dhe ku askush nga zullumqarët e kriminelët nuk ka marrë dënimin e merituar. Sikur të mos ishte Gjykata Hyjnore e Kiametit, drejtësia hyjnore nuk do të kishte asnjë kuptim.

Meqenëse shumica e njerëzve nuk i shohin me kujdes këto argumente, ajeti shton në fund: **“...por shumica e njerëzve nuk e dinë.”**.

Një nga emrat e Ditës së Kiametit, i përmendur në këtë ajet, është **“jeumul xhem’i” – “Dita e Tubimit”**, sepse të gjitha krijesat e çdo lloji, të gjitha kategoritë njerëzore do të tubohen atë Ditë në një vend të vetëm. Kjo është përmendur edhe në disa ajete të tjera të Kur’anit Kerim, si në suren “Esh Shua’ra”, ajeti 7 dhe në suren “Et Teagabun”, ajeti 9.

Kurse ajeti që vijon më pas është një argument tjetër rreth çështjes së Ahiretit. Edhe këtë e kemi lexuar në ajete të tjera të Kur’anit Kerim. Ajeti thotë: **“I All’lلاهut është pushteti i qiejve dhe i Tokës...”**. Përderisa është sundues i të gjithë botës së ekzistencës së gjerë dhe gjykues i tyre, atëherë është e padiskutueshme që Ai është i aftë edhe të ringjallë të vdekurit.

Për Atë që ka fuqinë absolute, procesi i ringjalljes nuk është gjë e vështirë.

All'Ilahu i Madhëruar e ka bërë këtë botë, tokën arë të Ahiretit. Nga kjo arë pjellore mund të marrësh fitim të bollshëm për në Atë Botë. Prandaj i Madhërishmi, në fund të ajetit thotë: **"...E kur të arrijë Ora (e Kiametit), atë ditë mohuesit do të humbasin."**, sepse ata kanë humbur kapitalin e tyre, jetën, dhe nuk kanë përfituar asgjë prej saj, përveç keqardhjes, dëshpërimit e pendimit.

Jeta dhe mendja, zgjuarsia dhe dhuratat e tjera të jetës janë kapitalet e njeriut në pazarin e kësaj tregtie, mirëpo ndjekësit e së kotës i konvertojnë me kënaqësi që shterohen shpejt. Kur të vijnë në Ditën e Kiametit, kur nuk bën dobi asgjë tjetër, përveç zemrës së pastër, besimit dhe veprës së mirë, ata do të shohin me sytë e tyre dështimin e tyre shembullor. Por do të jetë shumë vonë për t'u penduar!

Fjala *"jakhseru"* tregon humbjen e kapitalit. Ndonjëherë i atribuohet të njëjtit njeri, siç thuhet në fjalor. P.sh: thuhet: *Humbi filani, dështoi tregtia e tij*. Bijtë e dynjasë e përdorin këtë shprehje vetëm për të treguar humbjen e pasurisë, të pozitës dhe dhuratave materiale, edhe pse më e rëndësishme sesa dështimet materiale, është humbja e kapitalit të mendjes, të besimit dhe shpërblimit.

Kurse fjala *"el mubtilu"* përdoret me kuptime të ndryshme. Ajo përdoret për të treguar prishjen e diçkaje, për gënjeshtren, talljen dhe shakanë, shtrimin e një çështjeje të kotë. Të gjitha këto mund të hasen në kuptimin e ajetit.

Njerëzit që e prishën të vërtetën, që përhapën besimin e kotë dhe qëllimet e tij, njerëzit që përgënjeshtroan Pejgamberët e All'llahut dhe u tallën me fjalën e tyre, kanë për ta parë dështimin e tyre të qartë e të dukshëm atë Ditë.

Ajeti që vijon më pas, e materializon panoramën e Kiametit me një shprehje elokumente e shumë të efektshme: **“Atëherë të gjithë popujt do t'i shohësh të gjunjëzuar...”**.

Nga disa thënie të komentuesve përftohet se në të kaluarën të pandehurit uleshin në Kuvendin e Gjykimit në atë mënyrë (të gjunjëzuar), që të dalloheshin nga të tjerët. Edhe në Ditën e Kiametit në atë Gjykatë të madhe, ku do të bëhet gjykimi i tyre, të gjithë do të gjunjëzohen.

Ka mundësi që kjo mënyrë të shprehuri të jetë një shenjë e përgatitjes së tyre që të pranojnë çdo lloj urdhri apo gjykimi ndaj tyre, sepse ai që është gati, i përgatitur, ulet në gjunjë.

Por ajo mund të jetë edhe tregues i dobësisë, pafuqisë, frikës dhe i shqetësimit që i kaplon ata. Edhe bashkimi i të gjitha këtyre kuptimeve në nocionin e ajetit, mund të jetë gjithashtu i mundur.

Fjala “*xhathije*” ka edhe kuptime të tjera dhe njëri prej të cilëve është *tubimi i madh*, grumbullimi grupe-grupe. Ka mundësi që të jetë edhe tregues i *grumbullimit të njerëzimit në Gjykatën e Drejtësisë së All'llahut*, ose tregon *uljen e çdo populli apo grupi të ndarë, larg nga popujt e tjerë*. Por kuptimi i parë është më i përshtatshëm dhe më i njohur.

Më pas, ajeti i dytë sqaron qartë panoramat e Kiametit duke thënë: **“...Çdo popull do të thirret në Librin e vet (e do t'i thuhet): Sot do të shpërbleheni për atë që keni bërë.”**, sepse s'ka dyshim se ky libër është dokumenti i veprave tuaja, në të cilin janë regjistruar të gjitha të mirat dhe të këqijat, veprat e shëmtuara dhe të bukura. Aty janë shënuar edhe fjalët e njeriut, gjithçka. Kjo tregohet në thënien e Kur'anit Kerim: **“...Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë?..”**.¹

Kurse fjalia **“...Çdo popull do të thirret në Librin e vet...”** tregon se për çdo popull ka një libër që përfshin të gjithë njerëzit e tij, krahas librit të veçantë ku janë shënuar veprat përkatëse të çdo njeriu. Kjo gjë nuk duhet të na duket e çuditshme, sepse ne e dimë se për njeriun ka dy lloje veprash: veprat vetjake dhe veprat shoqërore, prandaj janë edhe këto dy lloje librash.²

Mënyra e shprehjes me fjalën *“tud'a”* – *“thirret”*, tregon se këta ftohen në leximin e librit të tyre. Edhe ky kuptim është i njëjtë me atë që përmendet në ajetin 14 të sures “ElIsra”, ku thuhet: **“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”**.

Më pas u vjen edhe një herë tjetër fjala nga ana e All'Ilahut. Ai u thotë: **“Ky është Libri Ynë, që do t'ju tregojë të vërtetën...”**. Ju keni bërë çdo gjë që ju pëlqente dhe nuk e keni besuar kurrë se

¹ Sure “Kehf”, ajeti 49.

² Disa komentues kanë thënë se ajo që nënkuptohet me Librin në ajetin e mësipërm, është Libri Qiellor, që ka zbritur për atë popull. Por në pamje të parë të ajetit, duket se ato janë librat e veprave, sidomos po të vërehet ajeti që vjen më pas. Pjesa më e madhe e komentuesve janë të këtij mendimi.

të gjitha veprat tuaja regjistroheshin diku, mirëpo: **“...Ne i kemi urdhëruar (engjëjt) që të shkruajnë të gjitha ç’keni bërë.”**.

Fjala *“nestensekhu”* përdoret për të treguar fshirjen e një gjëje me një gjë tjetër, për shembull: ia zuri vendin dielli hijes. Më pas është përdorur për të treguar shkrimin e një libri krahas një libri tjetër, pa e fshirë fare librin e parë.

Këtu lind pyetja: Nëse All’llahu i Madhëruar ka urdhëruar regjistrimin e veprave të birit të Ademit, duhet që të jetë edhe një tjetër libër, para këtij libri, ku janë shkruar këto vepra. Prandaj, disa besojnë se librat e veprave të të gjithë njerëzve janë shkruar në *pllakën e ruajtur mirë* dhe se engjëjt janë përgjegjës për ruajtjen e veprave të njeriut. Ata i regjistrojnë ato nga ajo Pllakë e Ruajtur (Leuhil Mahfudh).

Por ky kuptim nuk harmonizohet shumë me ajetin që po komentojmë, madje më i përshtatshmi prej këtyre dy kuptimeve është se: ose këtu bëhet fjalë për regjistrimin me kuptimin e shkrimit fillestar (siç e kanë thënë disa komentues), ose engjëjt roje kopjojnë dhe fotografojnë të njëjtat vepra të njeriut nga libri i krijimit. Prandaj, në ajetet e tjera të Kur’anit Kerim është përmendur shprehja për shkrimin, në vend të regjistrimit, siç e lexojmë në ajetin 12 të sures “Jasin”: **“Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e (punëve të) tyre. Ne e kemi llogaritur çdo gjë në një Libër të qartë.”**¹

¹Në një transmetim nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: *“Me të vërtetë, All’llahu ka caktuar engjëj që zbresin çdo ditë dhe shkruajnë veprat e bijve të Ademit.”*.

Në fundin e ajetit 12 të sures "Jasin" është përmendur një analizë më e zgjeruar rreth llojeve të librave. Aty tregohet se ekzistojnë tre lloje librash ku regjistrohen veprat. Ato janë: libri i veprave vetjake, libri i veprave të popujve, si dhe libri i tubimit të përgjithshëm për të gjithë njerëzit.

Ajeti vijues sqaron takimin përfundimtar me Gjykatën dhe shpalljen e vendimit të Gjykatësit. Aty, secili grup merr shpërblimin e veprave të tij. Ajeti thotë: **"Përsa u përket atyre që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, ata do t'i pranojë Zoti i tyre në mëshirën e Vet...."**.

Përdorimi i rrokjes "fa", me kuptimin "ndarëse" tregon ruajtjen e veprave, llogaritjen e Gjykatës së Drejtësisë hyjnore, si dhe hyrjen e besimtarëve në mëshirën e All'llahut të Madhëruar.

Sipas këtij ajeti, vetëm besimi është i pamjaftueshëm për t'i shpërblyer besimtarët me këtë dhuratë të madhe. Vepra e mirë është kusht, gjithashtu.

Fjala "rabbuhum"-"Zoti i tyre", tregon butësinë e veçantë të All'llahut. Kjo fjalë plotësohet me shprehjen "er rahmetu"- "mëshirë", në vend të fjalës "el Xhennetu" -"Xhenneti".

Fundi i ajetit tregon kulmin e përsosjes, kur thotë: **"...Kjo është fitorja e lavdishme!"**.

Shprehja "mëshirën e All'llahut" ka një kuptim të gjerë. Ajo përfshin Dynjanë dhe Ahiretin. Në ajetet e Kur'anit Kerim, ajo është emërtuar me shumë kuptime. Në ndonjë rast, me të emërtohet *udhëzimi*, ndonjëherë tjetër *shpëtimi nga kapja e armiqve*, një herë të tretë emërtohet *shiu i dendur dhe i bekuar*, apo mirësi të tjera, si *mirësia e dritës dhe e errësirës*. Kjo fjalë është përdorur edhe

me kuptime të tjera. Me të është emërtuar Xhenneti dhe dhuratat e All'Ilahut të Madhëruar në Kiamet.

Fjala “...Kjo është fitorja e lavdishme!” është përsëritur edhe një herë tjetër në ajetin 16 të sures “El En’am”. Në të thuhet se fitorja u takon atyre që shpëtojnë nga dënimi i All'Ilahut të Madhëruar: **“Atë që shpëtohet nga dënimi i kësaj dite, vërtet Zoti e ka mëshiruar. Ky është shpëtimi i vërtetë.”**, kurse këtu thuhet për atë që futet në Xhennet dhe në mëshirën e All'Ilahut. Secila prej atyre të dyjave, në realitet është një shpëtim i madh: shpëtimi nga dënimi dhe hyrja nën mbrojtjen e All'Ilahut, në vendin e mëshirës së Tij.

Këtu mund të bëhet pyetja: A do të hyjnë në Xhennet, besimtarët që nuk kanë vepra të mira?

Përgjigje: Pa dyshim që do të hyjnë, por kjo do të ndodhë, pasi të hyjnë në Xhehennem dhe të pastrohen, sepse ata që vijnë në vendin e mëshirës së All'Ilahut pas llogarisë dhe janë bërës të veprës së mirë dhe besimtarë.

Fjala “*el feuzu*”, siç e përmend Er Ragibu në librin e tij “El Mufredatu”, do të thotë *fitore e shoqëruar me paqe*. Me këtë kuptim është përdorur edhe në 19 vende në ajetet e Kur'anit të Shenjtë. Nganjëherë, Kur'ani e përshkruan fitoren të qartë, e herë tjetër të madhe. Në shumicën e ajeteve është përshkruar si një *fitore e madhe*. Zakonisht, ajo është përdorur në lidhje me Xhennetin, por në disa kuptime është përdorur edhe në lidhje me suksesin e bindjes ndaj All'Ilahut dhe të faljes së mëkateve.

Ajeti që vjen më pas, tregon ata që ishin në krahun përballë dhe thotë: **“Ndërsa mohuesve do t’u thuhet: Vallë, a nuk ju janë**

lexuar Shpalljete Mia?! Por ju shfaqët mendjemadhësi dhe u bëtë njerëz të këqij.”.

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se ai flet vetëm për mohimin, kurse për veprat e këqija që janë faktorë të hyrjes në dënimin e All'llahut dhe shkak i asaj hyrjeje, nuk është përmendur gjë, sepse mohimi është i vetëmjaftueshëm që një njeri të hyjë në dënim, siç është e vetëmjaftueshme për dënim edhe të qënit kriminel.

Gjithashtu, në këtë ajet nuk është përmendur gjë për dënimet e Xhehennemit, por përmendet qortim i ashpër nga e All'llahut. Ky konsiderohet si një nga ndëshkimet më të ashpra e më të mëdha, të cilin e përbuz edhe Xhehennemi.

Është edhe një çështje tjetër që meriton të mbahet parasysh. Nga ky ajet përftohet se All'llahu i Madhëruar nuk do të ndëshkojë askënd, pa dërguar Profetët, para se të zbresë ajetet e Tij. Ky është kulmi i butësisë dhe i mëshirës së Tij.

Një nga problemet më të mëdha të këtyre popujve ishte mendjemadhësia e tyre ndaj argumenteve të All'llahut nga njëra anë dhe vazhdimësia e tyre në mëkate e krime, nga ana tjetër. Kjo mësohet nga fjalia “...dhe u bëtë njerëz të këqij.”.

Ajeti i fundit prej këtyre ajeteve qartëson atë që është thënë në ajetet e kaluara në mënyrë të përmbledhur: çështjen e mendjemadhësisë së jobesimtarëve ndaj argumenteve të All'llahut dhe thirrjes së Pejgamberëve. Ajeti thotë: **“Dhe, kur juve ju thuhej: Premtimi i All'llahut është i vërtetë: Ora (e Kiametit) pa dyshim që do të vijë! - ju thoshit: Ne nuk e dimë ç'është Ora (e**

Kiametit). **Ne mendojmë se është vetëm një hamendje, prandaj nuk jemi të bindur.”.**

Të thuash “...**Ne nuk e dimë ç’është Ora...**” kur kuptimi i Kiametit ishte i njohur për ta, tregon pikërisht mendjemadhësinë e tyre, indiferentizmin dhe mungesën e interesit ndaj kësaj çështjeje. Në qoftë se do të ishin sadopak të interesuar për të gjetur të vërtetën lidhur me këtë çështje, atëherë ata do të mësonin se natyra e Ditës së Kiametit është e qartë si kristali.

Nga këtej u bëhet e qartë edhe përgjigjja për pyetjen që u shtrua. E kjo përgjigje është: në qoftë se ata ishin vërtet në dyshim për këtë çështje, atëherë nuk kanë asnjë përgjegjësi dhe asnjë mëkat. Por dyshimi nuk u lindi nga mungesa e qartësisë së të vërtetës, përkundrazi, ai ishte prodhim i mendjemadhësisë, kryeneçësisë, kokëfortësisë dhe fanatizmit të tyre.

Përmbajtja

Ajetet 47 – 48.....	5
Komentimi.....	6
All'Ilahu është i Gjithëditur për çdo gjë.....	6
Ajetet 49 – 52.....	10
Komentimi.....	11
Hulumtim.....	19
Ajetet 53 – 54.....	21
Komentimi.....	21
Shenjat e të vërtetës në botën e madhe dhe të vogël.....	21
Hulumtime.....	27
Teuhidi midis argumentit të “nudhum” dhe argumentit “siddikijne”	27
E vërteta se All'Ilahu përfshin gjithçka.....	29
Argumentet e horizonteve dhe të veteve të tyre.....	30
Sure“Esh Shura”	34
Një vështrim i përgjithshëm rreth përmbajtjes së sures.....	35
Mirësia e leximit të sures.....	36
Ajetet 1-5.....	37
Komentimi.....	38
Qiejt e lartë mbi ta janë gati të pëlcastin!.....	38
A kërkojnë falje melekët për të gjithë?.....	46
Ajetet 6 – 8.....	47
Komentimi.....	48
Pikënisja nga “Ummul kurra”	48
Ajetet 9 – 12.....	56
Komentimi.....	57
Kujdestari absolut.....	57
Hulumtime.....	65

1- Njohja e attributeve të All'llahut të Madhëruar.....	65
2- Vëmendje educative.....	67
3- Disa çështje rreth furnizimit të All'llahut.....	68
a) Standardi i dhënies së riskut (furnizimit) dhe vlerësimi i tij.....	68
b) Përcaktimi i mjeteve të jetesës nuk bie ndesh me përpjekjet.....	69
c) Moskufizimi i furnizimit (rizkut) me nocionin material.....	70
d) Kur'ani dhe shkaqet që çojnë në shtimin e riskut.....	70
e) Ngushtimi i rizkut dhe edukimi.....	71
f) Furnizuesi është All'llahu.....	71
Ajetet 13-14.....	73
Komentimi.....	74
Islami është esenca e legjislacioneve të të gjithë Profetëve.....	74
Hulumtime.....	77
Ka disa pikandaj të cilave duhet patur kujdes:.....	77
Hulumtim.....	82
Ajeti 15.....	83
Komentimi.....	84
Përgendrohu, ashtu siç të është urdhëruar!.....	84
Ajetet 16 – 18.....	88
Komentimi.....	89
Mos kërkoni ngutjen e Kiametit!!.....	89
Ajetet 19-20.....	95
Komentimi.....	95
Të mbjellat e dynjasë dhe e Ahiretit.....	95
Ajetet 21-23.....	102
Shkaku i zbritjes.....	103
Komentimi.....	104
Shpërblimi i Shpalljes gjendet në dashurinë për të afërmit.....	104
Sqarim.....	108
Transmetimet e përmendura në komentimin e këtij ajeti.....	113
Hulumtime.....	120
1- Bisedë me komentuesin e shquar El Alusij.....	120

Analizë dhe diskutim.....	121
2-Anija e shpëtimit.....	125
3- Komentimi i shprehjes: “kush bën ndonjë të mirë...”	126
4- Vendi i zbritjes së këtij ajeti.....	127
Ajetet 24-26.....	129
Komentimi.....	130
Ai e pranon pendimin e robëve të Tij.....	130
Ajetet 27-31.....	134
Shkaku i zbritjes.....	135
Komentimi.....	136
Të pasurit zullumqarë.....	136
Këtu shtrohen dy pyetje:.....	137
Yjet qiellorë.....	144
Hulumtime.....	145
Shkaku i fatkeqësive.....	145
Hulumtime.....	150
I pari: Fatkeqësitë ju ndodhin për shkak të veprave tuaja!.....	150
I dyti: Dyshim i madh.....	152
I Treti: Cilët janë “As’habu es Suffetu”?.....	152
Sqarim.....	153
Ajetet 32-36.....	155
Komentimi.....	156
Fryrja e erërave dhe lëvizja e anijeve.....	156
Ajetet 37-40.....	163
Komentimi.....	164
Besimtarët nuk i dorëzohen padrejtësisë.....	164
Ajetet 41- 43.....	175
Komentimi.....	176
Padrejtësia dhe ndihma.....	176
Ajetet 44 – 46.....	179
Komentimi.....	180
A ka ndonjë rrugë për kthim mbrapa?.....	180
Ajetet 47 – 50.....	185

Komentimi.....	186
Fëmijët janë dhuratë e Mëshiruesit.....	186
Ajeti 51.....	192
Shkaku i zbritjes.....	192
Komentimi.....	193
Mënyrat e lidhjes së Profetëve me Krijuesin.....	193
Dy hulumtime.....	197
I pari: Kuptimi i frymëzimit në gjuhësi, Kur'an dhe Synet.....	197
I dyti: E vërteta e frymëzimit të panjohur.....	199
1-Komentimi i disa filozofëve të vjetër.....	199
Sqarimi i kësaj:.....	200
2- Komenti i disa filozofëve të rinj.....	202
3- Gjenialiteti intelektual.....	204
Fjala e vërtetë në frymëzim.....	205
Logjika e refuzuesve të frymëzimit.....	208
Citati dhe përgjigja e vazhdueshme.....	208
Disa hadithe rreth çështjes së frymëzimit.....	209
Ajetet 52-53.....	211
Komentimi.....	212
Kur'ani është shpirt nga Krijuesi.....	212
Si mundet që Kur'ani të mos jetë shpirt?.....	213
Hulumtime.....	217
1- Cila ka qenë feja e të Dërguarit para profecisë së tij?.....	217
2- Përgjigja e pyetjes.....	219
Çështje letrare.....	221
Surja "Zuhruf"	223
Përmbajtja.....	224
Mirësia e leximit të sures.....	226
Ajetet 1-8.....	227
Komentimi.....	228
Mëkatet tuaja nuk e ndalojnë mëshirën Tonë!.....	228
Ajetet 9 – 14.....	236

Komentimi.....	237
Disa argumenta të Njehsimit.....	237
Hulumtim.....	245
Përkujtimi i All'Ilahut në përfitimin e mirësisë.....	245
Ajetet 15-19.....	249
Komentimi.....	250
Si thoniqë engjëjt janë bijat e Zotit?.....	250
Ajetet 20-22.....	255
Komentimi.....	256
Ajetet 23-25.....	261
Komentimi.....	262
Dënimi i këtyre imituesve.....	262
Ajetet 26-30.....	266
Komentimi.....	267
Njehsimi është fjala e përjetshme e Profetëve.....	267
Ajetet 31-32.....	274
Komentimi.....	275
Pse nuk i ka zbritur Kur'ani ndonjë të pasuri?.....	275
Dy përgjigje të rëndësishme.....	278
Ajetet 33-35.....	282
Komentimi.....	283
Kështjella luksoze me çati prej argjendi!! (<i>vlera mashtruese</i>).....	283
Dy hulumtime.....	285
1- Islami i shkatërron vlerat e gabuara.....	285
2- Përgjigja e një pyetjeje.....	289
Ajetet 36-40.....	291
Komentimi.....	292
Shoqëruesit e shejtanëve.....	292
Ajetet 41-45.....	299
Komentimi.....	300
Përmbaju asaj që të është shpallur!.....	300
Hulumtim.....	306

Cili është kombi i Pejgamberit (<i>Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>)?.....	306
Ajetet 46-50	308
Komentimi.....	309
Faraonët mendjemëdhenj dhe thyerja e premtimit.....	309
Ajetet 51-56	314
Komentimi.....	315
Nëse është Profet, atëherë përse nuk ka byzylykë prej ari?.....	315
Ajetet 57-62	323
Shkaku i zbritjes.....	324
Komentimi.....	326
Cilët zota janë në Xhehennem?.....	326
Ajetet 63-65	334
Komentimi.....	335
Ata që e tepruan për Mesin.....	335
Ajetet 66-69	340
Komentimi.....	341
Çfarë prisni tjetër, përveç dënimit të Ahiretit?.....	341
Ajetet 70-73	345
Komentimi.....	346
Aty do të kenë çfarë t' u dëshirojë shpirti dhe t' u kënaqet syri.....	346
Ajetet 74-80	352
Komentimi.....	353
Parapëlqejmë të vdesim, që të qetësohemi nga dënimi.....	353
Ajetet 81-85	359
Komentimi.....	360
Lëri ata të zhyten më thellë e të argëtohen!.....	360
Hulumtime.....	364
Ajetet 86 – 89	367
Komentimi.....	368
Kush e zotëron ndërmjetësimin (<i>shefaat</i>)?.....	368
Sure “Ed Dukhan”	373

Përmbajtja.....	374
Mirësia e leximit të kësaj sureje.....	376
Ajetet 1-8.....	377
Komentimi.....	378
Zbritja e Kur'anit në Natën e Begatshme.....	378
Zbritja e menjëhershme dhe zbritja graduale e Kur'anit.....	380
Hulumtim.....	388
Lidhja e Kur'anit me Natën e Kadrit.....	388
Ajetet 9-16.....	389
Komentimi.....	390
Tymi vrasës.....	390
Hulumtim.....	393
Çfarë nënkuptohet me tymin e qartë (<i>ed dukhanul mubijn</i>)?.....	393
Ajetet 17-21.....	399
Komentimi.....	400
Nëse ju nuk besoni, atëherë mos i pengoni të tjerët të besojnë.....	400
Ajetet 22-29.....	405
Komentimi.....	406
I lanë shtëpitë, kopshtet e thesaret dhe ikën!.....	406
Ajetet 30-33.....	414
Komentimi.....	414
Beni Israilët në vorbullën e sprovimit.....	414
Ajetet 34-36.....	419
Komentimi.....	419
Pas vdekjes nuk ka asgjë!.....	419
Hulumtim.....	421
Doktrina e idhujtarëve për Ringjalljen.....	421
Ajetet 37-39.....	424
Komentimi.....	424
Populli i Tubbeit.....	424
Hulumtim.....	427
Kush është populli i Tubbeit?.....	427

Ajetet 40-42.....	431
Komentimi.....	431
Dita e ndarjes.....	431
Ajetet 43-50.....	435
Komentimi.....	436
Pema e Zekumit.....	436
Hulumtim.....	440
Ndëshkimet trupore dhe shpirtërore.....	440
Ajetet 51- 57.....	442
Komentimi.....	443
Të devotshmit dhe mirësitë e ndryshme të Xhennetit.....	443
Hulumtim.....	448
Cila është “vdekja e parë”?.....	448
Ajetet 58-59.....	451
Komentimi.....	451
Ti prit, se edhe ata janë duke pritur!.....	451
Hulumtime.....	453
Sure “ElXhathije”	456
Përmbajtja e sures.....	457
Mirësia e leximit të sures.....	458
Ajetet 1- 6.....	459
Komentimi.....	460
Argumentet e All’llahut janë kudo.....	460
Ajetet 7-10.....	470
Komentimi.....	471
Mjerë gënjeshtari mëkatar.....	471
Ajetet 11-15.....	476
Komentimi.....	477
Çdo gjë është në shërbim të njeriut.....	477
Ajetet 16-20.....	485
Komentimi.....	486
Ne u patëm dhënë Beni Israilëve të gjitha ato, mirëpo.....	486

Ajetet 21-23.....	494
Komentimi.....	495
Nuk janë të barabartë në jetën dhe në vdekjen e tyre.....	495
Hulumtime.....	502
1- Njëri nga idhujt më të rrezikshëm është egoja.....	502
2- Ndjekja e egos është rruga më e pëlqyeshme e depërtimit të shejtanit.....	503
3- Ndjekja e egos largon nga njeriu, një nga mënyrat më të rëndësishme të udhëzimit.....	503
4- Ndjekja e egos e çon njeriun drejt luftimit të All'Ilahut.....	503
5- Ndëshkimet e ndjekjes së egos.....	504
Ajetet 24-25.....	506
Komentimi.....	506
Doktrinat e ateistëve.....	506
Ajetet 26-32.....	512
Komentimi.....	514
Të gjithë janë të gjunjëzuar përpara Gjykatës së Drejtësisë së All'Ilahut.....	514
Përmbajtja.....	524

الأمثل في تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازي

الجزء الرابع و العشرون

تيرانا: 2020

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء بیست و پنجم)

نویسنده: فقیه مفسر حضرت آية الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: ادموند عبازی و وُلْنْتُ مَرِيَا

زیر نظر: وُلْنْتُ مَرِيَا

ویرایش: ویکتور شارا و اسات بونگوری

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت “نسیم”

چاپ: انتشارات “لیلو”

تیرانا: 2020